

DREJTORIA  
E PËRGJITHSHME  
E ARKIVAVE



# Kodikët e Shqipërisë

Tiranë, 2003

**Nën kujdesin e lartë të Shkëlqesisë së Tij Alfred Moisiu,  
President i Republikës së Shqipërisë**

**KODIKËT E SHQIPËRISË**  
(Botim shkencor - kritik i ilustruar)

**Projekt shkencor-kulturor i DPA-së dhe UNESCO-s**

*Në redaksi:*

Prof. Aleks Buda, prof. dr. Giusi Zanichelli (Universiteti i Parmës), prof. as. dr. Kaliopi Naska (**zëvendëskryeredaktor**), Kosta Naço, prof. dr. Kristo Frashëri, Liljana Bërxfholi, Luan Rama, dr. Nevila Nika, dr. Roderic L. Mullen (Universiteti i Birmingamit), prof. dr. Shaban Sinani (**kryeredaktor**), Theofan Popa, Violeta Rakipi.

*Redaktimi shkencor:* prof. dr. Shaban Sinani

*Redaktimi letrar:* Arian Leka, Lila Plasari

*Korrektura:* Lila Plasari

*Përkthimet:* Joan Lena (Anthimus Alexoudes); Luan Rama (Koïchiro Matsuura dhe K. Naska e Sh. Sinani); dr. Musa Ahmeti (Pierre Batiffol); dr. Kristaq Jorgo e Dion Tushi (Johannes Koder dhe Erich Trapp); Albana Gurra (Edoardo Crisci, Roderic L. Mullen).

*Ilustrimet:* dr. Musa Ahmeti, prof. dr. Giusi Zanichelli, Violeta Rakipaj, Ened Bozo.

*Formulimi grafik:* Artion Baboçi

*Autorë:* Alfred Moisiu, Aleks Buda, Anthimus Alexoudes, Erich Trapp, Johannes Koder, Kaliopi Naska, Koïchiro Matsuura, Kosta Naçi, Llambrini Mitrush, Nevila Nika, Pierre Batiffol, Roderic L. Mullen, Shaban Sinani, Theofan Popa.

*Koordinatorë:* Prof. as. dr. Kaliopi Naska, Minella Gjenerali.

© *Copyright* 2003: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave - Tiranë  
**ISBN: 99927-915-0-0**

**Botimi i kësaj vepre u bë i mundur në sajë të mbështetjes financiare të UNESCO-s.**

**La publication de cet ouvrage a été rendue possible grâce à l'appui financier de l'UNESCO.**





## KODIKËT E SHQIPËRISË, PËRMENDORE TË KULTURËS NJERËZORE<sup>1</sup>

ALFRED MOISIU, PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

5

**K**odikët janë dorëshkrimet më të vjetra që janë ruajtur në hapësirën shqiptare. Tradita e shkrimeve të shenjta në Shqipëri ka vazhduar për 15 shekuj me radhë, prej paleokrishtërimit deri në kohët moderne.

Shkrimet ungjillore dhe biblike në Shqipëri janë pjesë e historisë botërore të shkrimit; pjesë e historisë së zhvillimit progresiv të mendimit dhe të kulturës njerëzore.

“Kodiku i Purpurt i Beratit”, një prej varianteve më të hershme të Besëlidhjes së Re, përbën një dorëshkrim të rrallë të letërsisë biblike në shkallë botërore. Sipas dijetarëve vendës dhe të huaj, ai numërohet i treti ose i katërti për nga kronologjia, por çmohet edhe më shumë për nga rëndësia. Të njohësh këtë dorëshkrim është njësoj si të takohesh me kohërat e mjegullta, me atë fazë të mugët të historisë, kur krishtërimi sapo kishte dalë nga fshehtësia. Në shkallë botërore ruhen gjithsej shtatë kodikë të purpurt, të periudhës së fillimeve të krishtërimit. Nuk është e rastit që dy prej tyre gjenden në Shqipëri. Vendi ynë ishte në përbërje të hapësirës burimore biblike.

Tradita e dorëshkrimeve të shenjta është provë se hapësira shqiptare ka pasur në vijimësi një elitë kulturore, që ka ditur jo vetëm të krijojë, por edhe të ruajë kryevepra. Vepra të tilla, që janë përmendore të historisë së mendimit të njerëzimit, na bëjnë optimistë për një imazh tjetër për Shqipërinë tonë. Ato promovojnë vlerën e kulturës së këtij vendi dhe të këtij populli edhe sot, kur kanë kaluar shekuj e mijëvjeçarë nga koha e krijimit. Ato janë kontribut i njohur në historinë botërore.

Historianët le të bëjnë të tyren dhe të na shpjegojnë se si është e mundur që në hapësirën shqiptare u ruajtën shkrime të tilla, të cilat i takojnë kohës kur krishtërimi po kalonte nga stadi i predikimit gojor në atë të predikimit kult. Por ka disa fakte të njohura, që na bëjnë të ditur se “Kodiku i Purpurt i Beratit” dhe dorëshkrime të tjera të krishtërimit të hershëm nuk janë dukuri rastësore në mjedisin shqiptar.

Vetëm pak kohë para se të shkruhej kjo vepër, ishte Shën Jeronimi i Ilirisë, Shën Gjëri, siç e njohin shqiptarët, që i dhuroi Perëndimit “La Vulgata-n”, të parin tekst të Biblës të përkthyer në latinisht, rilindjen e parë shpirtërore europiane. Po në atë shekull, Shën Niketa i Remesianës ose i Dardanisë kompozoi kryelutjen e krishtërimit, “Te Deum laudamus” (“ty Zot të lavdërojmë”), që këndohet edhe sot në katedralet e Perëndimit. Perandorët ilirë të Bizantit, me fuqinë që u jepte detyra, e bënë për herë të parë krishtërimin një fe zyrtare.

Ruajtja e kodikëve të Shqipërisë në këtë mjedis ku kanë kaluar rrebeshe të kohës dhe ku janë kryqëzuar ndikime mospajtuuese, shpreh edhe një herë një prej vlerave etnodalluese të popullit shqiptar, tolerancën ndërfitare të tij, një model tolerance edhe për Shqipërinë e sotme.

Të tilla dorëshkrime janë pjesë e identitetit kulturor të popullit, që i ka ruajtur dhe i japin emër Shqipërisë në botë. Prandaj ne përulemi me emocion dhe nderim para tyre. Shqipëria ka një të ardhme të sigurt europiane, sepse ka një të shkuar të lavdishme europiane.

Në Shqipëri ka ekzistuar një frymë e fortë ekumenizmi, pavarësisht se si ka ndryshuar gjeopolitika. Fryma ekumenike, fryma e përbashkimit, që gjendet edhe në një prej vargjeve të himnit tonë kombëtar, le të gjejë një inkurajim prej kësaj tradite, që promovohet në librin “Kodikët e Shqipërisë”.



1. Shkruar posaçërisht për botimin “Kodikët e Shqipërisë”.



## PIERRE FONDATRICE À L'ÉDIFICE DE LA PATRIMOINE

KOICHIRO MATSUURA  
DIRECTEUR GÉNÉRAL DE L'UNESCO

Vivre en paix et en harmonie nécessite des repères, qui s'édifient progressivement au fil de l'histoire. La construction de l'avenir ne peut donc se faire sans une attention portée à notre passé commun. Le patrimoine écrit conservé dans les bibliothèques et les dépôts d'archives, en tant que reflet de la diversité des langues, des peuples et des cultures, constitue un témoignage exceptionnel du monde passé et présent. Mais c'est un patrimoine extrêmement fragile. En Europe centrale et orientale, par exemple, on estime qu'environ 70 à 80 pour cent du patrimoine documentaire nécessiterait une intervention de sauvegarde immédiate.

Le Codex d'Albanie, véritables trésors du patrimoine spirituel mondial, n'échappent pas à cette menace. Ces manuscrits, parmi lesquels le "Codex Pourpre de Berat", l'une des plus anciennes variantes du Nouveau Testament, sont une référence essentielle de la littérature évangélique et plus généralement de la culture chrétienne.


L'UNESCO porte une attention particulière à la préservation de ce témoignage unique du développement de la littérature biblique et liturgique ancienne à travers l'histoire du monde. C'est à ce titre que le "Codex Pourpre de Berat" figure sur le registre des plus importantes œuvres de l'humanité établi dans le cadre de son programme *Mémoire du Monde*.

Responsable, de par son mandat, du développement culturel et de la protection du patrimoine culturel mondial, l'UNESCO a en effet estimé qu'il était nécessaire d'agir sans tarder pour éviter que le patrimoine documentaire du monde ne subisse de nouveaux dommages. A travers son programme *Mémoire du Monde*, l'UNESCO vise à assurer la préservation du patrimoine documentaire d'intérêt universel et à encourager celle du patrimoine documentaire d'intérêt national et régional, et à faciliter l'accès à un large public. Le patrimoine documentaire illustre ainsi l'expression de la diversité et du pluralisme culturel, auxquels l'UNESCO attache une attention prioritaire.

C'est donc tout naturellement que l'UNESCO a apporté son soutien à la publication du catalogue des Codex d'Albanie. Par cette œuvre remarquable, les Codex d'Albanie seront désormais plus facilement accessibles aux scientifiques, mais aussi à un lectorat beaucoup plus vaste. A la fois informatif et scientifique, le présent catalogue met les manuscrits en lumière et incite au partage de la mémoire.

Il met également en exergue l'un des traits caractéristique de la civilisation et de la culture albanaise: l'effort de conciliation œcuménique qui a marqué de l'histoire albanaise, et qui est bien reflété par ces manuscrits ecclésiastiques que sont les Codex.

Je suis heureux de constater que les efforts de l'UNESCO dans le domaine la préservation du patrimoine documentaire ont ici rencontré une initiative nationale exemplaire. Le catalogue des Codex d'Albanie apporte une pierre fondatrice à l'édifice de la sauvegarde. Il contribue à révéler la richesse, la diversité mais aussi la fragilité des grands trésors du patrimoine spirituel et, par ce biais, incite à les préserver et à en saisir l'incalculable valeur.







## GUR THEMELTAR NË NDËRTESEN E TRASHËGIMISË

KOÏCHIRO MATSUURA  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I UNESCO-S

Për të jetuar në paqe e harmoni ke nevojë për referenca, piketa, të cilat krijohen në mënyrë progresive përgjatë historisë. Ndërtimi i së ardhmes nuk mund të bëhet pa i kushtuar kujdes së kaluarës sonë të përbashkët. Trashëgimia e shkruar, e ruajtur në biblioteka dhe arkiva, si shembëlltyrë e shumëllojshmërisë së gjuhëve, popujve dhe kulturave, përbën njëkohësisht një dëshmi të jashtëzakonshme të së shkuarës sonë dhe të botës së sotme. Por kjo trashëgimi është tejet e brishtë. Për shembull, në Europën Qendrore dhe Lindore llogaritet që rreth 70-80 për qind e trashëgimisë dokumentare të ketë nevojë për një ndërhyrje të shpejtë për ta shpëtuar.

Edhe kodikët e Shqipërisë, këto thesare të vërteta të trashëgimisë shpirtërore botërore, nuk mbeten të pakërcënuar prej këtij rreziku. Këto dorëshkrime, midis të cilëve edhe “Kodiku i Purpurt i Beratit”, një nga variantet më të vjetra të Testamentit të Ri, janë një referencë thelbësore e letërsisë evangjeliste dhe, më përgjithësisht, e kulturës kristiane.

UNESCO i kushton një vëmendje të veçantë ruajtjes së kësaj trashëgimie unike të zhvillimit të letërsisë së vjetër biblike dhe liturgjike përgjatë historisë botërore. Ja pse “Kodikët e Purpurt të Beratit” figurojnë në regjistrin e veprave më të rëndësishme të Njerëzimit, të krijuar në kuadrin e programit *Kujtesa e Botës*.

Nisur nga mandati i saj, si përgjegjëse e zhvillimit kulturor dhe e mbrojtjes së trashëgimisë botërore, UNESCO ka vlerësuar, në fakt, të nevojshme që të veprohet pa humbur kohë për të arritur që trashëgimia dokumentare botërore të mos pësojë dëme të reja. Përmes programit të saj *Kujtesa e Botës* UNESCO synon të sigurojë ruajtjen e trashëgimisë dokumentare me interes universal dhe të nxisë trashëgiminë dokumentare me interes kombëtar e rajonal, si dhe të lehtësojë komunikimin e një publiku të gjerë me to. Trashëgimia dokumentare ilustron kështu shprehjen e ndryshueshmërisë dhe pluralizmit kulturor, të cilave UNESCO u kushton një kujdes përparësor.

Ja pse, në mënyrë krejt të natyrshme, UNESCO i dha mbështetje botimit të “Katalogut të kodikëve të Shqipërisë”. Nga kjo vepër e shënuar, kodikët e Shqipërisë do të jenë tashmë më lehtësisht të pranishëm jo vetëm për shkencëtarët, por edhe për një lexues më të gjerë. Ky katalog, informues dhe njëkohësisht shkencor, nxjerr në dritë dorëshkrimet dhe nxit në përjetimin e përbashkët të kujtesës.

Gjithashtu ai vë në dukje në mënyrë parësore dhe një nga tiparet karakteristike të qytetërimit dhe të kulturës shqiptare: përpjekjen për pajtimin ekumenik, i cili ka spikatur tërësinë e historisë shqiptare dhe është reflektuar në mënyrë aq dalluese në kodikët, këto dorëshkrime kishtarë. Jam i lumtur të konstatoj se përpjekjet e UNESCO-s në fushën e ruajtjes së trashëgimisë dokumentare janë pikëtakuar me një iniciativë kombëtare shembullore. “Katalogu i kodikëve të Shqipërisë” na sjell kështu një gur themeltar në ndërtesën e ruajtjes dhe shpëtimit të trashëgimisë. Ai kontribuon në nxjerrjen në pah të pasurisë, shumëllojshmërisë dhe të brishtësisë së thesareve tona të mëdha të trashëgimisë shpirtërore. Si i tillë, ai nxit në ruajtjen dhe përfitim të vlerës së saj të paçmuar.



## FJALA E BOTUESIT

**D**orëshkrimet biblike, ungjillore dhe liturgjike të Shqipërisë përbëjnë një prej traditave kulturore më të shquara dhe njëherësh më të panjohura të saj.

Është privilegj i historisë së shkrimit në këtë hapësirë, që dorëshkrimet origjinale të ruajtura prej njerëzve të kësaj bote, të “botësë sanë”, siç shkruante Buzuku, fillojnë qysh prej krishtëritit të hershëm. Të dhëna të përmendura prej dijetarëve të një shekulli e ca më parë njoftojnë se dorëshkrime të tilla mund të jenë ruajtur madje qysh prej shekullit të parë, qysh prej atyre kohërave kur kumti i krishtëritit për herë të parë shenjohej në letër prej ungjillorëve të mëdhenj! Tradita e shkrimeve të krishtera në Shqipëri zgjati, të paktën, për 15 shekuj, duke qenë një prej traditave kulturore më të qëndrueshme dhe të pandërprera, madje edhe në ata shekuj të mjegullt kur emri i shqiptarëve në shkrimet laike del shumë rrallë apo mbetet krejt në mënjanësi. Kjo traditë vazhdoi edhe në periudhën pas-osmane, edhe pasi u shpik Gutembergu, duke dëshmuar rrënjët e saj të forta.

Në dorëshkrimet kishtarë të Shqipërisë ka: shkrime biblike (nga Dhjata e Vjetër, si psalmet e Davidit); shkrime ungjillore (nga Dhjata e Re: ungjij dhe fragmente e ligjërime ungjillore); shkrime liturgjike (mesharë, katekizma, omilie, antologji muzikore bizantine të periudhës ekfonetike dhe me alfabetin e ri katërvijësh, kalendarë fetarë); shkrime shenjtorësh (agjiografi), martirësh (martirologji) dhe të etërve të kishës (patrologji); teologji dhe filozofi besimi; rregullore për trajtimin e çështjeve laike të besimtarëve (kanone, nomokanone); arte të zbatuara kishtarë para-ikonografike (miniatura, vinjeta, tabela të Eusebit); trajtesa me karakter didaktik, libra për shkollat fetare e laike.

Botimi i veprës “Kodikët e Shqipërisë” do të ndriçojë në një farë shkalle këtë traditë. Shumë punë mbetet për ta ndriçuar në një shkallë më të thellë atë.

Me këtë vepër do të bëhet e mundur të spikaten së paku këto të dhëna:

- Hapësira shqiptare është një prej vatrave më të rëndësishme, më të hershme dhe më të pasura, në shkallë rajonale e botërore për dorëshkrimet kishtarë.
- Illyricum-i historik, vendi i të parëve të shqiptarëve, u prek fizikisht prej delegatëve të parë të krishtëritit dhe i dha mendimit të krishterë figura të mëdha, prej Shën Cesarit e Shën Astit tek Shën Gjeri (Hieronymus) e Shën Niketa. Kjo hapësirë që në vëmendjen e reformatorëve më të mëdhenj të historisë së krishtëritit, siç që Shën Gjon Gojarti (Chrysostome).
- Shkrimet e kësaj vatre, megjithëse në pjesën më të madhe kanonike, kanë ruajtur ngjyrimet të kulturës vendëse në përgjithësi.
- “Beratinus-1”, një prej arketipeve më të lashta të Dhjatës së Re, është ruajtur në Shqipëri, së paku prej mesit të shekullit të 14-të.
- Në Shqipëri ka ekzistuar një shkollë shkruesish dhe një mjeshtëri lokale shkrimi, të paktën prej një mijëvjeçari.
- Bota shqiptare gjithnjë ka pasur një elitë kulturore dhe klerikale, e cila ka jetuar me shijen e kryeqendrave kulturore dhe është formuar me shkrime me vlerë të jashtëzakonshme dhe me luks metropolitan.

- Rregullimi i jetës shqiptare në bashkësi, përveç së drejtës zakonore dhe asaj qytetare, ka pasur edhe një faktor tjetër të rëndësishëm: faktorin kishtar.

- Enciklopedisë së vlerave shqiptare duhet t'i shtohen një varg personalitetesh, të cilët, për shkaqe të ndryshme, janë thujtë të panjohur, me gjithë rolin e spikatur historik në zhvillimet e përparuara të vendit, si Jan Kukuzeli i Ri, Joasafi i Beratit (apo i Bubullimës), Skuripeki (Skura) dhe zonja konteshë; Anthim Aleksudhi (i mbiquajtur "miku i artit"), Teodor Komneni Laskari (ose Laskarioti); Teodor Gramatia - sekretari; Gjergji i madh (Arianiti); Jani Glikoi (i ëmbli), Teodor Kavalioti-Voskopojari, Teodor Haxhifilipi, dhe shumë e shumë të tjerë: shkruar, murgj, porositës (kitorë), të vetëquajtur, në shumicën e herës: "më i vogli"; "më i përvuajtur"; "më i thjeshti"; "më i përdëlllyeri".

- Kult e kulturë nuk mund të ndahen si traditë, ashtu siç nuk mund të ndahen as etimologjikisht; - Hapësira shqiptare ka qenë historikisht, prej një të shkuare absolutisht të largët (jo duke filluar prej periudhës osmane e këndej, siç gjykohet e vlerësohet ndonjëherë), ekumenike e mospërjashtuese, baza e kulturës së mirëkuptimit; shprehur kjo në fqinjësimin harmonik të gjuhëve të mëdha të besimit: latinisht, greqisht e slavicisht (starosllavisht), madje edhe mbi portikun e të njëjtit manastir (si manastiri i Shën Gjon Vladimirit, ndërtuar prej Karl Topisë) dhe mbi fletët e të njëjtit kodik (dorëshkrimi i Durrësit në bibliotekën e Grotaferrata-s);

- Shkrimet biblike-ungjillore përgatitën shkrimet laike (kronikat e bujarisë arbërore, statutet e qyteteve mesjetare) dhe këto të fundit shkrimet në gjuhët kombëtare (autorët klasikë).

- Shteti shqiptar dhe institucionet e tij, edhe në periudhën kritike të ateizmit, çmoi dhe mori në mbrojtje vlerat e besimit si vlera kulturore.

Dorëshkrimet kishtarë të Shqipërisë, duke qenë pjesë e lëvizjes mendore të këtij vendi, meritojnë iniciativë të mëdha. Këto iniciativë nuk do të mund të ndërmerreshin pa zgjeruar në koncept studimet etnologjike, duke përafuar në objektin e tyre vlerat kulturore antropologjike; që nuk janë kulturë kombëtare dhe pasuri etnike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës; por, megjithatë, janë pjesë e identitetit kulturor të popullit, shprehur me mjete dhe përmbajtje që janë pjesë e zhvillimeve intelektuale me karakter ndërnacional.

Ky vend, që ka toponime të tilla si "Shëndërtat" (Shën Trinia, Shën Triadha), "Munushtirë" (Manastir), Shirgj e Shirgjan (Shën Sergj), "Uarakë" e "Mbrakull" (Orakull e Mrekulli), Shtish e Shmil (Shën Mateu, Shën Matish e Shën Mëhill), Shlonë e Shirokë (Shën Apollonia e Shën Roku), të huajtura në gjuhën tonë prej mëmës ilirishte, duhej të kishte edhe traditën e shkrimeve analogjike.

Le të nderojmë, me këtë hap të parë: shkruarët e (stër)lashtë e të mëpasmë, për përkushtimin dhe artin e tyre; klerikët dhe laikët që i ruajtën dorëshkrimet nga rreziqe që kanë zgjatur më shumë se armiqësitë legjendare në eposin e kreshnikëve; institucionet e tyre, që i vunë në vendin e nderit; dijetarët e mendimtarët shqiptarë, që i njohën e i shpallën si përmendore të kulturës njerëzore që i kthehen vendit të tyre; arkivistët dhe restauratorët që i çmuan dhe i rikthyen në botën e vlerave të mëdha; studiuesit e huaj, që me admirim dhe vendosmëri u dhanë këtyre dorëshkrimeve njohje ndërkombëtare.

Le të kujtojmë, për mbyllje, dy vargje të njohura të Lasgush Poradecit, që lexuesi, pas njohjes me këtë vepër, të mëdyshet në ishin figurë a rrëfim:

*"Atje lart, në Mal të Thatë,  
Zoti Krisht bëkej një kishë..."*

## BËHEN TË NJOHUR 100 KODIKË TË SHQIPËRISË

KALIOPI NASKA  
SHABAN SINANI

13

Në librin “Kodikët e Shqipërisë”, vepër shkencore e ilustruar, janë përzgjedhur e botuar pjesa më e madhe e artikujve dhe shkrimeve me karakter studimor e njoftues për dorëshkrimet ungjillore, që i janë paraqitur publikut për një periudhë afro 135-vjeçare, qysh se ipeshkvi i Beratit, Anthim Aleksudhi (Anthimus Alexoudes), dijetari, “miku i artit”, siç e quanin me mirëdashje në Kostandinopojë, përshkroi, për të parën herë, në librin e tij “Përshkrim i shkurtër i mitropolisë së shenjtë të Beratit...” disa nga kodikët më të vjetër, që ruheshin në kishat e manastiret e besimtarëve shqiptarë.

Në vepër janë përfshirë dhe studime të paleografëve, tekstologëve, kataloguesve dhe bibliologëve të huaj e vendës.

Sikurse do të vihet re prej vetë lexuesit, tradita e shkrimeve kishtarë në Shqipëri ka pasur më shumë vëmendje në shkencën botërore se sa në atë antropologjike shqiptare, në atë kuptim që shkenca amerikane njëson dijen për historinë e kulturës njerëzore. Kjo lidhet me shumë arsye, nga të cilat njëra është ajo e pozitës ateiste të shtetit shqiptar për një periudhë relativisht të gjatë, por kryesorja është mungesa e specialistëve me njohuri ndërdisiplinore për të gjykuar e vlerësuar.

Studiuesit e huaj ia kanë kushtuar vëmendjen kryesore “Kodikut të Purpurt të Beratit” - Codex Purpureus Beratinus **ƒ** - i njohur gjerësisht me emrin e shkurtër “Beratinus”. Në fakt emrin e Beratit e ka marrë si epinom edhe “Kodiku i Artë i Anthimit”, i cili mbiquhet shpesh “Beratinus-2”. Kjo ka ndodhur jo vetëm për faktin se “Beratinus” i takonte një periudhe shumë të hershme (i shkruar në kufijtë e fundmë të paleokrishtërit); jo vetëm sepse për një kohë të gjatë emri i tij është lidhur e vazhdon të lidhet me emrin e Shën Gjon Gojartit (Joan Chrysostome), një prej protagonistëve dhe reformatorëve më të mëdhenj të historisë së krishtërit të hershëm; jo vetëm sepse dorëshkrime si “Beratinus” kanë mbijetuar në botë më pak se gishtat e dorës; por, mbi të gjitha, për faktin se, siç e ka vënë re mençurisht P. Batiffol, në tekstin e këtij dorëshkrimi ka herë pas here “shmangie leximi” (“conflate reading”), që lidhen me karakterin jonormativ të këtyre fragmenteve kalimtare.

“Beratinus” mori rëndësi botërore si një dorëshkrim i hershëm që mund të ndihmonte për të plotësuar historinë e zhvillimit të mendimit ungjillor, nëpërmjet studimeve të posaçme të tekstologjisë kritike (“textual criticism”), që mund të thuhet se, në dijen shqiptare, sapo kanë filluar. Në një vështrim më të gjerë këto studime do të evidentonin se çfarë ndodhi në procesin e kalimit prej fjalës së shenjtë tek shkrimet e shenjta, prej predikimit ungjillor gojor tek predikimi kanonik.

Rëndësia e “Beratinus-it” u theksua edhe më nga fakti se në tipologjinë e tekstit të tij gjenden gjurmë të shkrimeve siriake (të Lindjes) dhe të Perëndimit njëherësh. Këtij mendimi i janë përmbajtur shumë dijetarë, prej Batiffol-it deri tek Aleks Buda e më pas Roderic L. Mullen. Kjo e bën atë një prej dorëshkrimeve më të rëndësishëm për të krahasuar shkollat e shkrimeve ungjillore dhe procesin historik të kanonizimit të shkrimeve të shenjta në përgjithësi.

Për fat të keq, numri i kodikëve me njohje ndërkombëtare të ruajtur në Shqipëri, duke përjashtuar “Kodikun e Artë të Anthimit” (një dorëshkrim i rrallë krysografik, në pergamenë të purpurt) dhe disa të tjerë, me gjithë këtë vëmendje, që e tejkalon interesin e shkencës vendëse, është i kufizuar. Të paktë kanë qenë ata që kanë bërë studime duke pasur njohje të

drejtpërdrejtë për kodikët. Disa të tjerë kanë shkruar duke pasur si burim jo vetë kodikët, por studimet mbi to.

Në Shqipëri dijetari i parë që ka bërë të ditur ekzistencën e Beratinus-it dhe të disa kodikëve të tjerë ka qenë Ilo Mitkë Qafëzezi. Ky qe më shumë i preokupuar për “Kodikun e Kostë Beratit”, në të cilin gjendej një alfabet i panjohur i shqipes me grafema helene, por nuk harroi të përmendte pak më gjerësisht vlerat e thesarit dorëshkrimor beratas. Me këtë rast ai krijoi edhe neologjizmin “shkresëdore”, për “manuscript” - dorëshkrim, që nuk pati fat të mbetej në gjuhën aktive.

Redaksia që përgatiti veprën “Kodikët e Shqipërisë” parapëlqeu në kriter përzgjedhjen e studimeve dhe artikujve me karakter shkencor, botuar në revista akademike-universitare dhe buletine shkencore. Një numër artikujsh të botuar herë pas here në shtyp thjesht për qëllime njohjeje dhe vlerësimi nuk janë përfshirë. Për ndonjë prej këtyre të fundit, që ka pasqyruar përparim të dijes e të informacionit rreth kodikëve, është bërë përjashtim.

Duke iu përmbajtur kuptimit terminologjik që i është dhënë fjalës “kodik” në arkivistikë, kanë mbetur jashtë kësaj vepre një numër studimesh me karakter filologjik, ndër të cilët veçohen studimet e albanologut gjerman Armin Hetzer, shkrimet e të cilit kanë pasur dhe kanë rëndësi për të bërë të njohura vlerat gjuhësore të disa kodikëve të Shqipërisë; si dhe studimet e ak. Alfred Uçi kushtuar veprës së Teodor Kavaliotit: logjikës, fizikës dhe metafizikës së tij, tekste të akademisë së Voskopojës.

Me “kodikë të Shqipërisë” në këtë vepër, me ndonjë përjashtim tejet të rrallë, kuptohet vetëm “Fondi 488” i AQSH-së, ku janë koleksionuar 100 kodikë dhe 17 fragmente. Ndoshta numri i kodikëve që gjenden në fonde të tjerë në këtë arkiv (arkipeshkvia e Gjirokastrës / Drinopolit/, arkipeshkvia e Shkodrës, manastiri i Shën Gjon Vladimirit dhe disa fonde të tjerë, nominale) është i barabartë me ato të “Fondit 488”. Por këto janë ende të pakataloguar në një regest tërësor. Ka dhe për to të dhëna të thjeshta informimi, por në fondin ku gjenden.

Disa kodikë, si “Liturgjia e Shën Gjon Gojartit”, që përshkruan Batiffol-i, pa bërë fjalë për disa të tjerë që ky nuk arriti t’i shohë me sy, si një kodik i shekullit të parë që ruhej në Gjirokastrë, si dhe një kodik tjetër i shekullit të 4-t, ekzistenca e të cilëve pa dyshim do të ndryshonte kalendarin e kulturave në shkallë europiane e botërore, sikurse dihet, më vonë u zhdukën pa gjurmë. Tani ato ekzistojnë vetëm në përshkrimet e studiuesve.

Një numër i madh kodikësh gjenden në institucione të tjera: në Bibliotekën Kombëtare, në Muzeun e Artit Mesjetar të Korçës, në bibliotekat e institucioneve të Akademisë së Shkencave, si dhe në bibliotekat e qytetarëve. Deri në fillim të viteve 1990, nga veprimtarët e shërbimit arkivor, janë raportuar dëshmi për ekzistencën e kodikëve të tjerë mesjetarë në familjet qytetare shqiptare. Në këtë kuptim, mungon një regjistër kombëtar, ndërinstitutional, i të gjithë kodikëve të Shqipërisë.

Shumica e shkrimeve që botohen në këtë vepër janë të karakterit “katalog”. Alexoudis përshkroi 6 dorëshkrime. Batiffol përshkroi e analizoi 16, megjithëse përmendi shumë më tepër: nuk pati mundësi t’i shihte e t’i analizonte. Në formën e një katalogu paraqitet edhe studimi i Johannes Koder-it e Erich Trapp-it: këta patën mundësi të vizitojnë arkivat e Shqipërisë dhe të shohin koleksionin e kodikëve që ishin mbledhur deri atëherë (mesi i viteve 1960) dhe ruheshin në AQSH. Studimet e tyre shpallën në listat ndërkombëtare ekzistencën e një numri kodikësh të panjohur të botës shqiptare. Në atë kohë një pjesë e madhe e kodikëve gjendeshin ende në pronësi të kishave dhe manastireve dhe Koder-Trapp nuk patën mundësi t’i katalogonin të gjithë. Një skedë me të dhëna të plota të përditësuara u përgatit prej tyre për dy më të rëndësishmit e kodikëve të Shqipërisë: Beratinus-1 e Beratinus-2.

Në këtë botim nuk janë përfshirë katalogët e R. Gregory-t (botuar në fillim të shekullit të 20-të) dhe të Gregory-Aland (botuar në fund të shekullit të 20-të), sepse në to bëhet fjalë për rreth 5000 dorëshkrime me karakter kishtar dhe në to disa kodikë të Shqipërisë përmenden sipas radhës kronologjike në listë, por jo më vete. Në këto studime, për vetë karakterin global të tyre, për kodikët e Shqipërisë bëhet fjalë kalimthi.

Kataloguesit e huaj gjithnjë i janë përmbajtur ndarjes së dorëshkrimeve ungjillore në tre grupe: 1. Maiuscule (shkronjëmëdha); 2. Minuscule (shkronjëvogle) dhe 3. Lectionary (ligjërata ungjillore, fragmente ungjijsh, ungjij në perikope).

Të dhënat e kataloguesve të mëdhenj të letërsisë ungjillore (Gregory-Aland), sa u takon kodikëve të Shqipërisë, megjithatë, janë të pranishme në këtë vepër përmes evokimit të tyre prej studiuesve të tjerë.

Në Shqipëri një katalog të kodikëve të Shqipërisë pati përgatitur Theofan Popa, i cili iu kushtua kësaj pune në vitet e fundit të jetës së tij, në vitet 1980. Katalogu i Popës u përgatit për nevoja shërbimi, si mjet informimi dhe kërkimi arkivor. Në këtë katalog, përgjithësisht, kodikët renditen sipas radhës kronologjike, por jo gjithnjë respektohet kriteri kronologjik, kryesisht sepse dorëshkrime të hershme janë zbuluar e pranuar në arkiv në një kohë kur vendin e tyre sipas radhës kohore e kishin zënë të tjera, që ishin bërë më herët pronë e arkivave. Në përshkrimet e Popës herë pas here, në të rrallë, përmendet edhe numri i referencës në inventarët e Gregory-Aland, por nuk zbatohet kriteri klasifikues i tyre. Ende mungon një analogim përfundimtar i numrave të referencës të dorëshkrimeve ungjillore të Shqipërisë në katalogun e AQSH-së dhe në katalogun e Gregory-Aland apo të Koder-Trapp. Botimi “Kodikët e Shqipërisë” mundëson komunikimin e studiuesve brenda dhe jashtë vendit, duke siguruar, pikë së pari, identifikimin e të njëjtit objekt.

Duke qenë se katalogu i Popës nuk qe përgatitur nga autori si një vepër për botim, redaksisë i është dashur të punojë me përgjegjësi me daktiloshkrimin, për qartësimin e mendimit dhe rrjedhshmërinë e frazës, për saktësimin dhe njehsimin e termave, si dhe për disa plotësime të domosdoshme.

Merr rëndësi, në këtë kuadër, studimi i Dr. Roderic L. Mullen, nga universiteti i Birminghamit, i cili përshkroi dhe krahasoi, ndonëse jo tërësisht (vetëm për dorëshkrimet me karakter ungjillor) numrat e referencës të katalogut të Gregory-Aland me ato të katalogut të Popës, duke lehtësuar e mundësuar shfrytëzimin e literaturës shkencore tradicionale dhe të re për kodikët.

Katalogu i Popës, së bashku me studimin hyrës, që është e para vepër me të dhëna arkeografike dhe kulturore-historike thuajse për të 100 kodikët e “Fondit 488”, i cili gjithashtu u krijua nën drejtimin e tij; botohet për herë të parë.

Renditja e artikujve dhe studimeve të përfshirë në këtë vepër bëhet sipas radhës së botimit. Kjo për të respektuar autorët, përparësitë e tyre, si dhe për t'i dhënë mundësi lexuesit të vërejë se çfarë ka sjellë të re, në kohën dhe kontekstin e vet, secili nga studiuesit që është marrë me kodikët. Katalogu dhe studimi hyrës i Popës është vendosur në kronologji, duke pasur si referencë datën e përfundimit dhe të dorëzimit në AQSH (mesi i viteve 1980).

Në shkrimin e emrave të njerëzve dhe të vendeve redaksia ka zbatuar parimin e drejtshkrimit të shqipes, sipas të cilit forma më e hershme e një huazimi është normëformuese, përkundër të tjerave, që mbeten në përdorim më të kufizuar. Shqipja është një gjuhë që e ka prekur fjalorin biblik qysh prej kohës së krishtërimit të hershëm. Një varg emrash të përveçëm biblikë e ungjillorë, toponime historike të kësaj hapësire, emra të përgjithshëm të terminologjisë kishtarë, kanë, për këtë shkak, formën e tyre të shqipëruar. Kështu, është shkruar „Gjon“ për “Joan“, sepse forma “Gjon“ del si e tillë në trajtë të shkruar në faltoret e shqiptarëve qysh në shekullin e 7-të. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, kur emrat e përveçëm nuk kanë të bëjnë me figura biblike, por me personazhe historikë, në kllapa është dhënë edhe forma e huazimit të mëvonshëm të të njëjtit emër biblik, kurse në disa raste të tjera është zbatuar parimi historik dhe është respektuar forma që ka përdorur vetë personaliteti, si: Jan Kukuzeli i Ri, Joasafi i Beratit etj.

Pothuajse të gjithë artikujt dhe studimet e këtij botimi, duke qenë se kanë qenë shkruar dekada e shpesh shekuj më parë, redaksia i ka pajisur me shënime shpjeguese, saktësuese ose krahasuese, në dy forma: si shënime të brendashkruara në tekstin e autorit, duke bërë dallimin me kllapa (katrore ose të kurbëta) dhe si shënime në formën e fusnotës. Në rast se autorët kanë pasur vetë shënime në formë fusnote, shënimet e redaksisë janë dalluar me korsiv.

Për të lehtësuar kuptimin e kësaj lënde relativisht të panjohur në botën shqiptare të letrave është përgatitur një fjalorth shpjegues. Theksojmë se fjalorthi u referohet kuptimeve që kanë këto terma në studimet për kodikët. Në raste të veçanta, kur ka qenë e nevojshme të saktësohet një kuptim prej tjetrit, është dhënë edhe përmbajtja semantike e termit në përdorimin kishtar. Për botimin e kësaj vepre, nga redaksia, punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe bashkëpunëtorët e saj të jashtëm, është punuar afro tre vjet. Një punë e vështirë ka qenë përzgjedhja dhe përgatitja e ilustrimeve, që janë pjesë e rëndësishme e promovimit të kësaj pasurie të madhe.

Redaksia e ndien të nevojshme të falënderojë përzemërsisht Presidentin e Republikës, Alfred Moisiu, i cili i ofroi kujdestarinë e vet të lartë këtij botimi dhe përgatiti me këtë rast një përshëndetje inkurajuese për punë të mëtejshme.

„Kodikët e Shqipërisë“ botohet me mbështetjen financiare të Unesco-s. Ne falënderojmë personalisht Dr. Koïchiro Matsuura, Drejtor i Përgjithshëm i Unesco-s, që vlerësoi rëndësinë e këtij projekti dhe e përshëndeti atë me një fjalë hyrëse të ngrohtë dhe dashamirëse.

Një falënderim i përveçëm i përket Institutit Arkeologjik të Akademisë së Shkencave të Kinës (Pekin), specialistë të të cilit shpëtuan nga dëmtimi i pandreqshëm dy kodikët më të vjetër Beratinus, duke i restauruar me teknologji bashkëkohore dhe duke ua zgjatur jetën për shekujt e ardhshëm. Për fat të keq, nuk qe e mundur që të përfshihej në këtë botim ndonjë studim i këtyre specialistëve, megjithëse Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave shprehu interesin e vet për këtë.

Me këtë vepër do të rezultojë e nevojshme që shkenca shqiptare të këmbëngulë për një përmasë të re të dijes etnologjike, si dije antologjike, siç kuptohet ky term në shkencën e sotme euro-amerikane («cultural anthropology»). Kjo do t'i lejonte që etnologjia të bënte objekt studimi dorëshkrime të krijuara ose të ruajtura në hapësirën shqiptare dhe nga njerëz shqiptarë, në gjuhë dhe shkrime të kulturave perandorake (greqisht, latinisht), të lidhura me kryeqendrat e këtyre kulturave, me rëndësi për historinë e krishtërit të hershëm dhe të mendimit të krishterë në tërësi, me rëndësi për ndikimin në botën shpirtërore laike të kësaj hapësire. Këto dorëshkrime nuk janë traditë kombëtare në kuptimin e ngushtë të fjalës, por janë pjesë e identitetit kulturor të shqiptarëve në kuptimin e gjerë të fjalës, janë pjesë e vlerave europiane të kësaj kulture.

Hapi më i afërm i një strategjie afatgjatë, që do të lejonte integrimin në tërësi të dorëshkrimeve kishtarë të Shqipërisë në inventarët botërorë të tyre, do të ishte: - Botimi në gjuhë të huaj i kësaj vepre që po i paraqitet lexuesit; - Përgatitja e një katalogu me të dhëna të plota për pjesën tjetër të kodikëve të Shqipërisë, të ruajtur jashtë “Fondit 488”; - Krijimi i një inventari kombëtar të këtyre dorëshkrimeve, pavarësisht se pranë cilit institucion ruhen (duke përfshirë edhe ato të familjeve); - Botimi në shqip e gjuhë të huaj i një katalogu me të dhëna ezauruese për gjithë fondin e shkrimeve të krishtera në Shqipëri.

E ndiejmë të nevojshme të theksojmë se lexuesi do të gjejë në këtë vepër një botim me karakter laik, në të cilin historia e dorëshkrimeve biblike e ungjillore, si dhe historia e besimit, qoftë në studimet e autorëve të huaj, ashtu dhe në ato të autorëve shqiptarë, shihen kryesisht si histori kulture. Studimet e tekstologjisë kritike biblike janë një çështje më e thellë, që pret këshillimin e dijetarëve të specializuar, dhe që i takon një të ardhmeje jo të largët.

Shoqata Ndërkombëtare Biblike, me qendër në Londër, që po punon për redaktimin e tekstit të Dhjatës së Re mbi bazën e referencave të dorëshkrimeve më të vjetra, me qëllim që ky tekst të jetë i pranueshëm për të gjitha kishat, dorëshkrimin “Beratinus” e vlerëson si një prej pikëmbështetjeve më të rëndësishme të nismës së saj.



## 100 CODEX DE L'ALBANIE À DÉCOUVRIR

KALIOPI NASKA  
SHABAN SINANI

17

Dans «Les Codex de l'Albanie», œuvre scientifique illustrée, a été choisi et publié la majeure partie des articles et écrits de recherche et d'informations sur les manuscrits évangéliques présentés au public pendant près de 135 ans, époque où l'évêque de Berat, Athimus Alexoudes, chercheur et ami des arts, comme on l'appelait avec bienveillance à Constantinople, a décrit pour la première fois dans son livre «Bref aperçus de l'évêché de Berat» certains des plus anciens codex, conservés dans les églises et les monastères des croyants albanais.

Cette œuvre contient des études de paléographes, de textologues, de catalogueurs et des chercheurs de matière biblique, étrangers et albanais.

Comme les lecteurs peuvent le constater, la tradition des écrits sacrés en Albanie a plutôt intéressé à la science mondiale que à la science anthropologique albanaise, dans le sens que la science américaine unifie le savoir sur l'histoire de la culture humaine, et ceci pour diverses raisons: d'une part la position athée de l'Etat albanais durant une période relativement longue, mais surtout l'absence de spécialistes possédant des connaissances interdisciplinaires, capables de juger et valoriser.

Les chercheurs étrangers ont consacré leur attention aux «Codex Purpureus Beratinus F », généralement connu sous le nom de «Beratinus». En fait le «Codex d'Or d'Anthimus» est l'éponyme du nom de Berat, lequel est souvent surnommé «Beratinus-2». Cela n'est pas seulement produit du fait que «Beratinus» appartenait à une période très ancienne (écrit vers la fin de l'époque paléochrétienne), mais parce que durant une longue période son nom est lié et continue d'être lié au nom de Saint Joan Chrysostome, l'un des majeurs protagonistes et réformistes de l'histoire du christianisme ancien. Aussi du fait que, les manuscrits comme «Beratinus» ont survécu en très petit nombre, et que, comme l'a très justement observé P. Batiffol, dans le texte de ce manuscrit on voit apparaître de temps à autre des déviations de lecture (conflate reading) liés au caractère non normatif de ces fragments.

«Beratinus» a connu une importance mondiale comme manuscrit ancien et peut aider à compléter l'histoire du développement de la pensée évangélique à travers les études particulières de la testologie critique («textual criticism»), dont on peut dire qu'elle a à peine démarrée dans la science albanaise. D'un point de vue plus large ces études auraient mis en évidence ce qui s'est passé pendant le processus du passage de la parole sacrée aux écrits sacrés, du discours religieux évangélique oral au discours canonique.

Ce qui a donné encore plus d'importance à «Beratinus» tient au fait que dans la typologie de ce manuscrit ont été trouvées des traces d'écritures syriaque de l'Orient et de l'Occident à la fois. Cette idée a été continuée par plusieurs chercheurs, de Batiffol jusqu'à Aleks Buda et plus tard Roderic L. Mullen. Ceci fait de ce manuscrit l'un des majeurs afin de comparer les écoles des écrits évangéliques et le processus historique de la canonisation des écrits sacrés en général.

Malheureusement, le nombre des codex internationalement connus conservés en Albanie est limité, à l'exception du «Codex d'Or d'Anthimus» (l'un des plus rares manuscrits écrit en or sur des parchemins pourpres) ainsi que d'autres, malgré l'intention qui dépasse l'intérêt pour la science dans notre pays. Peu ont été ceux qui ont fait des recherches, en toute

connaissance des codex. D'autres ont écrit en ayant comme sources non pas les codex, mais des études les concernant.

En Albanie, le premier chercheur qui a mis en lumière l'existence de «Beratinus» et de certains autres codex est Ilo Mitkë Qafëzezi. Il surtout été préoccupé par le «Codex de Kostantin Berati» dans lequel se trouvait un alphabet inconnu de la langue albanaise à lettres helléniques sans oublier toute fois d'amplement parler des valeurs du trésor que représentent les manuscrits de Berat. A cette occasion il a crée le néologisme «shkresëdore», pour «manuscrit», qui n'eut pas la chance de rester dans le langage d'aujourd'hui.

La rédaction qui a préparé le «Codex de l'Albanie» à plutôt apprécié les études et les articles à caractère scientifiques, publiés dans les revues académiques et universitaires ainsi que dans des bulletins scientifiques. Un certain nombre d'articles publiés de temps à autres, simplement à but informatif et appréciatif ne sont pas intégrés, exception faite pour quelques-uns des plus récents, qui ont reflété une amélioration de connaissance et de l'information, autour des codex.

En tenant en compte le sens terminologique donné au mot «codex» dans la science des archives, un certain nombres d'études à caractère philologique sont restés en dehors de cette publication. Y ont été mis en évidence les études de l'albanologue allemand Armin Hetzer, écrits qui ont eu et qui jouent un rôle majeur grâce auxquels se sont fait connaître les qualités linguistiques de certains codex de l'Albanie, ainsi que les études de l'académicien Alfred Uçi, lequel s'est consacré à l'œuvre de Téodor Kavalioti referant la logique, la physique et la métaphysique des textes de l'Académie de Voskopoja.

Avec les «Codex de l'Albanie» dans cette publication, à quelques exceptions très rares, il faut comprendre seulement le «Fond 488» de l'Archive d'Etat Albanais, où ont été collectionnés 100 codex et 17 fragments. Il se peut que le nombre des codex existant dans d'autres fonds de cette archive (Evêché de Gjirokastra/ Drinopoli, l'évêché de Shkodra, le monastère de Saint Jean Vladimir, ainsi que certain autre fond) est équivaux à ceux du «Fond 488». Mais ceux-ci ne sont pas catalogués dans un registre d'ensemble. Il existe en ce qui les concerne des donnés purement informatives, qui se trouvent dans leur fond.

Quelques codex, comme «La liturgie de Saint Joan Chrysostome», décrit par Batiffol, sans parler d'autres que celui ci n'a pas pu connaître, comme un codex du premier siècle conservé à Gjirokastra ainsi qu'un autre codex du IV siècle, ont plus tard disparu. Leur existence aurait sans doute modifié le calendrier des cultures à l'échelle européenne et mondiale. Actuellement elles existent seulement dans les descriptions données par des chercheurs.

Un grand nombre de codex se trouve dans d'autres institutions: à la Bibliothèque Nationale, au Musée d'Art Médiéval de Korça, dans les bibliothèques des institutions de l'Académie des Sciences ainsi que dans les bibliothèques des habitants. Jusqu'au début des années 1990, des témoignages à propos de l'existence d'autres codex médiévaux dans les familles citadines albanaises ont été rapportés par les employés du service des archives.

En ce sens il manque un registre national, inter institutionnel de tous les codex de l'Albanie. La majorité des écrits publiés dans cette œuvre sont des écrits pour un catalogue. Alexioudis a décrit 6 manuscrits. Battifol en a décrit et analysés 16, même s'il en cite beaucoup plus: il n'a pas eu la possibilité des les voir et de les analyser. L'étude de Johannes Koder et Erich Trapp, est également présenté sous la forme de catalogue. Ils ont eu la possibilité de visiter les archives albanaises et de voir les collections des codex réunis jusqu'à ce temps (moitié des années 1960) conservés aux Archives Nationales Albanaises (AQSH). Leurs recherches ont fait connaître dans les listes internationales l'existence d'un nombre inconnu de codex du monde albanaise. A cette période une grande partie des codex était encore la propriété des églises et des monastères et les chercheurs Koder et Trapp n'ont pas eu la possibilité de tous les cataloguer. Une fiche avec des donnés entières mis à jour a été préparé par Kader et Trapp pour les deux majeurs codex albanaise: «Beratinus-1» et «Beratinus-2».

Cette publication ne contient pas les catalogues de C. R. Gregory (publié au début du XX<sup>ème</sup> siècle) et de Gregory-Aland (publié fin du XX<sup>ème</sup> siècle), et parce que, ces catalogues concernent 5 milles manuscrits à caractère saint dans lesquels certains codex de l'Albanie sont cités suivant l'ordre chronologique de la liste mais pas en soi. Dans ces études à caractère global, on ne parle que très rapidement des codex de l'Albanie.

Les catalogueurs étrangers ont toujours suivi le principe de la séparation des manuscrits évangélistes en trois groupes: 1-de lettres majuscules; 2-de lettres minuscules; 3-Lectioary (Liturgies évangéliques, des fragments du livre d'Evangile et des livres d'Evangile en «*perikope*» («leçons»)).

Les données des plus grands catalogueurs de la littérature évangélique (Gregory-Aland) sur les codex de l'Albanie sont présents dans cette œuvre à travers les références d'autres auteurs.

En Albanie, un catalogue des codex de l'Albanie a été préparé par Theofan Popa, lequel s'est consacré à ce travail dans les dernières années de sa vie, vers les années 1980. Le catalogue de Popa a été préparé pour les besoins du service, comme moyen d'information et de recherches dans les archives. Dans ce catalogue, les codex sont rangés par ordre chronologique. Ce critère n'a pas été toujours respecté parce que, des anciens manuscrits ont été découverts et insérés dans l'archive à un moment ou leur place dans l'ordre temporel était déjà occupée par des codex qui appartenaient précédemment à celle-ci. Dans les descriptions de Popa, le numéro de référence des inventaires de Gregory-Aland, est cité de temps en temps, mais leur critère de classification n'est pas respecté. Il manque également un rapport définitif des numéros de références des manuscrits évangéliques de l'Albanie dans le catalogue de AQSH ainsi que dans les catalogues de Gregory-Aland ou Koder-Trapp. La publication de «Codex de l'Albanie» permet la communication des chercheurs dans le pays et à l'étranger, en assurant premièrement l'identification du même objet.

Puisque le catalogue de Popa n'a pas été préparé par l'auteur comme une œuvre publiable, la rédaction a dû épeler avec responsabilité pour clarifier la pensée et la cohérence de la phrase, le sens et l'unification des termes, ainsi que pour certains ajouts nécessaires.

De ce point de vue, l'étude du Roderic L. Mullen (Ph. D), de l'Université de Birmingham, acquiert une certaine importance puisque celui-ci a décrit et comparé, certes, pas complètement (que pour ce qui concerne les manuscrits à caractère évangélique) les numéros de références du catalogue de Gregory-Aland avec ceux du catalogue de Popa, en facilitant et donnant la possibilité à l'exploitation de la littérature scientifique traditionnelle et nouvelle des plus récents codex.

Le catalogue de Popa ainsi que leur introduction se publie pour la première fois. Il s'agit de la première œuvre avec des données archéographiques, culturelles et historiques et ceci pour les 100 codex du «Fond 488», lequel a été publié sous sa direction également.

Le classement des articles et des études compris dans cette œuvre, est fait suivant l'ordre de publication. Ceci pour respecter les auteurs, leurs priorités, ainsi que pour donner la possibilité au lecteur de voir ce qui a été apporté de nouveau, par chaque chercheur qui a travaillé sur les codex, suivant leur époque et le contexte. Le catalogue et l'introduction de Popa est rentré dans la chronologie en ayant pour référence la date de sa rédaction finale et son dépôt à l'AQSH (milieu des années 1980).

En ce qui concerne l'écriture des noms des personnes et des lieux, la rédaction a pratiqué le principe de la langue écrite albanaise, suivant laquelle, la forme la plus ancienne de l'emprunt est la norme, contrairement aux autres, qui demeurent dans une utilisation restreinte. L'albanais est une langue qui a eu des contacts avec le vocabulaire biblique depuis les temps du christianisme ancien. Des nombreux noms spécifiquement bibliques et évangéliques, des toponymes historiques de cette espace, des noms communs de la terminologie sacrée, ont pour cette raison leur forme albanophone. C'est pourquoi on a écrit *Gjon* pour *Joan*, et la

forme *Gjon* est ainsi utilisée et écrite dans les dictionnaires albanais depuis le VII<sup>ème</sup> siècle. Malgré tout, dans la majorité des cas, lorsque les noms spécifiques n'ont pas à faire à des images bibliques, mais a des personnages historiques, on a également donné entre parenthèse la forme d'emprunt suivante du même nom biblique, et dans d'autres cas a été suivie le principe historique et respecté la forme utilisé par le personne même, comme par ex. Jan Kukuzeli, Josafi i Beratit, etc.

La grande majorité des articles et des études de cette édition ont été écrites des décennies et parfois des siècles avant, de nombreuses notes explicatives ont été ajoutées par la rédaction. Elles explicitent ou comparent suivant deux formes: en tant que notes insérées ou texte de l'auteur entre parenthèses (grandes ou petites) ou bien en tant que notes de bas de page. Lorsque les auteurs n'ont pas ajouté de notes de bas de pages, les notes de rédaction sont mis en évidence en italique.

Un petit dictionnaire explicatif a également été préparé pour faciliter la compréhension de cette matière relativement inconnue par le monde littéraire albanais. Nous tenons à insister sur le fait que le petit dictionnaire se réfère au sens de ces termes dans l'étude des codex. Dans des cas particuliers il s'est avéré nécessaire de mettre en évidence un sens par rapport à un autre. Ainsi, on a donné le contenu sémantique de terme dans son utilisation sacrée. Près de trois ans ont été nécessaires à la rédaction ainsi qu'aux employés de la direction générale des archives et aux collaborateurs extérieurs pour la publication de cette œuvre. L'une de taches les plus difficiles a consisté à choisir et préparer les illustrations qui représentent une partie important de la promotion de ce grande trésor.

La rédaction tient a particulièrement remercier le Président de la République Alfred Moisiu, lequel a offert tout son soin à cet édition et préparé à cette occasion un salut encourageant quant aux travaux à venir. «Codex de l'Albanie» est publié grâce au soutien financier de l'Unesco. Nous remercions personnellement le Dr. Koïchiro Matsuura, Directeur Général de l'Unesco, qui a mis en valeur l'importance de ce projet et l'a salué d'un mot d'introduction chaleureux et bienveillant.

Des remerciements particuliers s'adressent à l'Institut Archéologique de l'Académie des Sciences de Chine (Pékin), aux spécialistes qui ont sauvé des méfaits du temps les deux plus anciens codex de Beratinus en les restaurant grâce aux technologies contemporaines et en prolongeant leur vies pour les siècles futurs. Malheureusement, malgré tout l'intérêt exprimé par la Direction Générale des Archives, il a été impossible d'inclure à cette publication les études de ces spécialistes.

La publication de cette œuvre mettra en évidence la nécessité de la science albanaise pour insister sur une plus large dimension des connaissances ethnologiques comme la science anthropologique, comme nous entendons ce terme dans la science euro-américaine actuelle «cultural antropology». Ceci permettrait à l'ethnologie d'avoir comme objet d'étude des manuscrits créés ou conservés dans l'espace albanais par les albanais, dans des langues où écrits des cultures impériales (grecque, latin) liés aux capitales de ces cultures, importantes dans l'histoire du christianisme ancien et de la pensée chrétienne en général, ainsi qu'à leur influence dans le monde spirituel laïque.

Ces manuscrits ne sont pas une tradition nationale dans le premier sens du terme, mais appartiennent à l'identité culturelle albanaise dans un sens plus large. Elles font partie des valeurs européennes de cette culture.

Le pas le plus proche d'une stratégie à long terme qui permettrait l'intégration de l'ensemble des manuscrits sacrés albanais dans leur inventaires mondiaux, consisterait en:

- La publication de l'œuvre présenté au lecteur en langue étrangère.
- La préparation d'un catalogue avec des données complètes pour l'autre partie des codex albanais conservés en dehors du Fond 488;
- La création d'un inventaire national de ces manuscrits, quelque soit l'institution dans lequel

ils sont conservés (en tenant compte également des manuscrits des familles).

- La publication en Albanie et en langues étrangères d'un catalogue avec des données rassemblant l'ensemble du fond des écrits sacrés en Albanie.

Il nous semble nécessaire d'ajouter que le lecteur trouvera dans cette œuvre une publication à caractère laïque dans lequel l'histoire des manuscrits bibliques et sacrés ainsi que l'histoire des croyances que se soit à travers les études d'auteurs étrangers ou albanais, sont principalement observés comme une histoire culturelle. Les études de la testologie critique biblique représentent un sujet plus profond profond qui attend des conseils de connaisseurs spécialisé dans un futur pas si lointain.

L'Association Internationale Biblique, dont le siège est à Londres, qui travaille pour la rédaction du Nouveau Testament en se basant sur les références des plus vieux manuscrits dans le but que ce texte soit accepté par toutes les églises, considère Beratinus comme un des piliers les plus important de cette initiative.



LIBRA TË SHENJTË NË DORËSHKRIME NË MEMBRANË <sup>1</sup>

ANTIMUS ALEXOUDES

## KAPITULLI IX

## A

Një ungjill që ndodhet në kishën e shenjtë të ungjillëzimit të Hyjlindëses (domethënë të Shën Mërisë) në lagjen e kalasë së Beratit besohet se ka një histori të hershme të trashëguar, dhe për këtë nderohet nga të gjithë banorët e krishterë. Kjo gojëdhënë thotë se ungjilli është shkruar me dorën e vetë atit tonë shenjtor ndër shenjtoret, Gjon Gojarti (Joan Chrysostomos), kryepeshkop i Konstandinopojës. Në kujtim të këtij shenjtë, çdo vit, më 27 janar, bëhet meshë e shenjtë kryepriitore dhe panair <sup>2</sup>. Me këtë rast nxirret edhe ky ungjill, për nderim, në kishën e shenjtë. Të gjithë të krishterët e mbledhur nga çdo anë vijnë duke e puthur me shumë shprestarë, nder dhe respekt.

Elemente të fjalëve të këtij ungjilli të shenjtë janë të arta. Po kështu edhe shkronjat e para, të cilat janë të gjitha të mëdha. Gjithashtu, të katër ungjijtë që përfshihen në të <sup>3</sup>, zbukurohen duke pasur në fillim shembëllimin e portretit të secilit ungjillor, të pikturuar me ar.

## B

Një tjetër dorëshkrim shumë i hershëm, që përmban tekstin e dy ungjillorëve, të Mateut dhe Markut, gjendet në Kishën e Shën Gjergjit të po kësaj lagjeje <sup>4</sup>. Fjalët e tekstit janë të shkruara me argjend mbi membranë (nënkupto: pergamenë) me ngjyrë vishnje të errët <sup>5</sup>, ndërsa shkronjat e para janë të gdhendura në ar dhe argjend, të harkuara <sup>6</sup>.

## C

Ekziston dhe një dorëshkrim tjetër, i ngjashëm me këtë ungjill, në membranë, i madh dhe me shumë fletë. Dy kapakët i ka të veshur me argjend dhe të larë në ar. Ka dy shënime lart, ku thuhet se është pronë e kishës katedrale të Mitropolisë sonë të Beratit (gr. "Velegradon"). Në të njëjtën kishë gjendet edhe një ungjill tjetër, i shkruar mbi pergamenë, me format të vogël.

## D

Ka edhe dy ungjij të tjerë të shkruar me dorë mbi pergamenë të bardhë, që ruhen në kishën e lagjes së Mangalemit.

---

**Shënime të redaksisë:** 1. Marrë nga libri i Anthim Aleksudhit "Përshkrim i shkurtër historik i mitropolisë së Beratit dhe i vendeve që janë nën vartësinë e saj shpirtërore", botuar në Korfuz, në shtypshkronjën Ionia të vëllezërve Kaonë, 1868. Autori ka qenë mitropolit i Beratit. Në tekstin origjinal përdoret rregullisht termi "membranë" për "pergamenë". Të gjitha shënimet në korsiv dhe ato të brendashkruara në tekst janë të redaksisë.

2. Këtu fjala "panair" ka kuptimin e grumbullimit masiv të besimtarëve.

3. Nga këto të dhëna nuk mund të besohet se autori e ka fjalën për "Liturgjinë e Shën Gjon Gojartit", dorëshkrim, një prej kodikëve që e përshkroi edhe Batiffol-i, por më pas u zhduk pa gjurmë.

4. Sipas përshkrimit të Aleksudhit, është fjala për "Kodikun e Purput të Beratit", dyungjillësh, pagëzuar me këtë emër disa vite më vonë nga P. Batiffol.

5. Ngjyra “vishnje e errët” terminologjikisht i përgjigjet së purpurtës perandorake (“purple imperiale”), e cila, prej shekullit të 4-t e në vijim, për disa shekuj me radhë, u përdor përjashtimisht në shkrimet e shenjta.

6. Shënim i vetë autorit: “Mbi njërin prej dy kapakëve (në tekst, shprehimisht: “pllakave”) gjendet një shënim, i shkruar me gërma të epokës së lashtë (nënkupto: “antike”), ku thuhet: “Shikojini gërmat e Shën Gjon Gojartit, që gjenden në këtë ungjill, (të shkruar) me vetë dorën e tij, kur ai ishte në Antioki, në atdheun e vet, shërbëtor i Krishtit. Deri në epokën kur ai jetoi, nga shumë vetë shkruhej me germa të thjeshta. Por theksimi i fuqisë së shkronjave nëpërmjet “shenjave të arta”, domethënë nëpërmjet “oksias”, “varias”, “perispomenit”, “dhasisë” dhe “psilisë” (janë thekse dhe tone gjuhësorë në greqishten antike), nuk mjaftonte. Megjithëse këto tekste kanë pasur të katër ungjijtë, ky që ka mbetur ka vetëm Ungjillin sipas Mateut dhe atë sipas Markut. Ndërsa ungjijtë sipas Lukës dhe Gjonit humbën. Ndërtuesi i manastirit të Teologut (Gjon Teologu) e mori dorëshkrimin në manastir, nga kujdesi dhe admirimi, në shenjë nderimi ndaj Shën Gjon Gojartit dhe si dëshmi e devocionit që kishte për Krishtin. Ndërsa humbja e ungjijve që mungojnë ndodhi kur librat e Teologut u grabitën nga frankët, të quajtur kampanezë (nënkupto: “frankët e Shampanjës”: fr. “Champagne”). Shikoni sa i veçantë është ngjyrimi i shkronjave, por edhe sa e bukur është forma e tyre! Ungjilli i Teologut, i shkruar në Patmo, është i varfër me këto shkronja, siç pashë me vetë sytë e mi në Efes”.



## DORËSHKRIMI GREQISHT [EN GREC] NGA BERATI I SHQIPËRISË *Codex Purpureus* **F**<sup>1</sup>

PIERRE BATIFFOL

25

### I.

Berati<sup>2</sup> është një qytet i vogël osman [i Perandorisë Osmane], i vendosur në hyrje të qafëmalit Apsus [Osumi i sotëm]. Për të arritur në Berat nga porti më i afërt, Vlora, duhen pesëmbëdhjetë orë kalërim; rruga pothuajse nuk ekziston fare. Qyteti është i besimit musliman; nga larg dallohen minaret, të cilat zgjaten mbi shtëpitë e bardha dhe kopshtet e tyre; në hyrje të qytetit ndeshim varrezat e vjetra të të parëve. Tregu është në qendër të qytetit: ndeshim haxhi dhe hoxhë me turban në kokë, ushtarë dhe zyrtarë turq; herë pas here edhe gegë e vllahë, tregtarë nga rrethinat e Elbasanit; përfundimisht edhe shumë hebrenj, të cilët dallohen nga fesi i zi; por, gjithsesi, dominojnë shqiptarët dhe gjuha shqipe. Pjesa e qytetit të vjetër është e rrethuar me mure gjysmë të rrënuara nga koha bizantine; këtu është lagjja “Kala”, tokë e grekëve [ortodoksëve], e të krishterëve, në të cilën nuk gjejmë asnjë gjurmë të xhamive apo pazarit, ngaqë banorët janë të gjithë grekë [ortodoksë]. Në këtë pjesë ndodhet edhe shtëpia e ipeshkvisë, e quajtur “Mitropolia e shenjtë”. Zbrita tatëpjetë në brendi të kalasë, ku mora me qera një shtëpi, dritaret e së cilës shikonin bedenat e kalasë; kisha përshtypjen sikur po vështroja jetën mesjetare bizantine, “në themën Beratase”<sup>3</sup>.

Në “mitropoli” [ipeshkvi] më priti mitropoliti ortodoks, shkëlqesia e tij, prelati i shumëditur, imzot Anthime Alexoudis. Peshkopi i mitropolisë së shenjtë i ishte përkushtuar arkeologjisë, kur këtë ia lejonin punët dhe detyrat e shumta zyrtare. Është anëtar i jashtëm i Sinodit të Stambollit [i Patrikanës?!], ku çdoherë e thërrasin me nofkën: “miku i artit”, nofkë të cilën imzot Anthime Alexoudis vërtet e meriton. Ka zbuluar disa mbishkrime, ka botuar disa medalione<sup>4</sup>; në shtëpinë e tij ka një koleksion modest, me shumë eksponate antike, me një vlerë të jashtëzakonshme<sup>5</sup>, koleksion që i bën nder të veçantë Mitropolisë.

Vetë qyteti i Beratit nuk është vendbanim antik, ngase nuk janë zbuluar mbishkrime, ndërtesa, apo gjëra të tjera nga lashtësia<sup>6</sup>. Në qytet kanë arritur disa eksponate nga antikiteti, por jo shumë të rëndësishme. Mirëpo në qytet ruhen disa dorëshkrime, të cilat janë tepër të veçanta dhe shumë të vjetra. Është e domosdoshme të theksoj se si i kam zbuluar dhe kush më ka treguar për ekzistencën e tyre<sup>7</sup>.

Kur, në vitin 1875, [Ludovico] Duchense ishte i ngarkuar me delegacionin që do të shkonte në malin Athos [Malin e Shenjtë], u shkëput nga rruga dhe vajti deri në Patmos për të përshkruar disa pjesë të dorëshkrimit në greqisht, **N**, të Testamentit të Ri [sot “Codice **N** Vaticana”?], kustosi i bibliotekës së “Théolog-ut”, imzot Sakkélioni, i cili tash jeton në Athinë, i tërhoqi vëmendjen për një vëllim tjetër të një dorëshkrimi greqisht, për të cilin mendonte se ishte i ngjashëm me pjesët e dorëshkrimit **N**, ngaqë, sikurse ky i fundit, ishte i shkruar me shkronja argjendi dhe në pergamenë të purpurt. Duke shënuar këtë të dhënë, Duchense e përmend këtë dorëshkrim vetëm një herë, në vitin 1881, në një studim të tij kritik, si një kujtim të veçantë<sup>8</sup>. Në Greqi ky njoftim nuk ka shqetësuar askënd, por në Gjermani<sup>9</sup> po; dhe mund të thuhet se në vitin 1884 Duchense ishte i vetmi i cili në botën shkencore kishte njohuri për ekzistencën e këtij dorëshkrimi [në pergamenë] të purpurt. Kur më ftoi që ta shikoj, kam kërkuar shënime plotësuese, të cilat m’i ka ofruar Sauvaire, konsulli francez në Janinë, me anë të letrës së datës 27 nëntor 1884, ku ndër të tjera shkruan: “Ipeshkvi i mitropolisë së Beratit, imzot Anthime Alexoudis, para disa vjetësh, ka botuar në gjuhën greke studimin: “*Description abrégée et*

*historique de la sainte métropole de Belgrade, aujourd'hui Bérat*<sup>10</sup> [Vështrim i shkurtër historik i mitropolisë së shenjtë të Beogradit, Beratit të sotëm], vepër kjo shumë pak e njohur dhe, sipas mendimit tim, nuk ekziston asnjë përkthim [i saj] në ndonjë gjuhë tjetër. Vepra ka këtë përmbajtje (marr guximin të bëj një përkthim fjalë për fjalë të saj):

“Kap. IX. Dorëshkrime të vjetra në pergamenë. Mitropolia e Beratit ruan edhe disa dorëshkrime dhe libra të shenjtë:

1. Ungjillin e shenjtë, i cili ruhet në kishën e ungjillizimit [në terminologjinë zyrtare të kishës së ritualit Lindor - evangjelistaj] në kalanë e Beratit, të cilin të gjithë besimtarët e krishterë e besojnë dhe e nderojnë, sipas traditës së lashtë, si dorëshkrimi i atit tonë, Shën Gjon Gojartit, kryepeshkvi të Kostandinopojës, për festën e të cilit, çdo vit, këndohet mesha e shenjtë ipeshkvnore. Gjatë gjithë kësaj kohe, sa zgjat kjo meshë, dorëshkrimi është i ekspozuar për besimtarët, që të gjithë të mund ta shikojnë, ta puthin, ta nderojnë, duke u përkulur para tij me respektin më të madh. Shkronjat e këtij ungjilli të shenjtë janë të shkruara me flori [të gjitha janë maiuscule], si dhe të gjitha inicialet e çdo kapitulli. Në fillim të çdonjërit nga të katër ungjijtë është portreti i ungjillorit, i punuar prej floriri.

2. Ungjilli i dytë, po ashtu, është shumë i vjetër dhe përmban vetëm tekstin e ungjijve sipas Mateut dhe sipas Markut. Ruhet në Kishën e Shën Gjergjit, në të njëjtën famulli. Shkronjat janë prej argjendi të shkruara në pergamenë me ngjyrë qershie [të kuqe] të mbyllur, ndërsa inicialet janë të shkruara me flori dhe argjend, të vëna në rreth dhe brenda kornizës. Në njërën anë të kopertinës është, me shkronja të një kohe shumë të lashtë, e shkruar kjo fjali: “Shikojini shkronjat e këtij ungjilli, të shkruara me dorën e vetë Shën Gjon Gojartit, kur ishte meshtar i ungjillit në atdheun e tij në Antioki...”.

3. Një dorëshkrim tjetër ungjillor, mjaft i madh dhe shumë i rëndë, i lidhur me kopertina prej argjendi, sikurse edhe dy të parët, është pronë e kaptolit<sup>11</sup> tonë. Në të njëjtën kishë ruhet edhe një ungjill tjetër i formatit të vogël, i shkruar në pergamenë.

4. Në fund fare ekzistojnë edhe dy dorëshkrime të ungjijve, në pergamenë të bardhë, të cilët ruhen në kishën e Mangalemit<sup>12</sup>.

Me këtë pjesë të veprës së Alexoudis-it ne u njohëm me dorëshkrimet ungjillore të Beratit. Mendoj se është e domosdoshme të [shpjegoj diçka këtu fillimisht], ngase duhen sqaruar disa hipoteza të dyshimta, për të cilat më ka folur në Athinë Sakkélioni<sup>13</sup>. Ky pretendon se zbulimi i parë i *Beratinus*-it i takon Alexoudis-it dhe, për të përforcuar një ide të tillë për ipeshkvin arkeolog, bën citimin e këtyre radhëve, të cilat ne i përkthyem, duke pretenduar se [më parë] nuk kishte asnjë njohuri për këtë, gjë që hapur vërehet se nuk është e saktë.

## II.

Koleksioni i dorëshkrimeve që gjenden në Berat është i ndarë në grupe të ndryshme. Secila kishë, dhe të tilla janë disa, ka disa dorëshkrime të këtyre librave liturgjikë, si, p.sh., Kisha e Shën Gjergjit dhe kisha e ungjillizimit [evangjelistës]. Posaçërisht duhet theksuar se ipeshkvi është pronar i disa dorëshkrimeve, të cilat i ruan në shtëpinë e tij, në ipeshkvi [mitropoli]. Por, para se të merremi me *Beratinus-in*, më parë të ndalemi tek disa çështje të tjera që lidhen me këto dorëshkrime.

Disa dorëshkrime janë të zakonshme: të gjitha që kam mundur të shikoj ndodhen te kryepeshkvi [mitropolit] dhe janë në rrëmujë të vërtetë, të lëna pas dore dhe në gjendje tepër të rëndë. Më janë dhënë me shumë rezerva, kështu që kam qenë i detyruar t'i shikoj në orët e fundit të qëndrimit tim në Berat. Ia kam arritur që të bëj një përshkrim shumë përmbledhës, edhe pse nuk jam shumë i sigurt nëse ia kam arritur t'i shikoj të gjitha.

Të gjitha këto dorëshkrime janë me tematikë kishtarë. Kam shikuar tre vëllime dorëshkrimesh. Vëllimi i parë [I] është dorëshkrim në letër, format *in quatro*, një dorëshkrim i shekullit të 15-të; Vëllimi i dytë [II] është diçka më i vjetër se i pari, gjithashtu është dorëshkrim në letër, format i vogël, *in folio*;

Vëllimi i tretë [III] daton aty nga fundi i shekullit të 12-të ose fillimi i shekullit të 13-të, është

format i vogël, *in folio*, sikur i mëparmi, por është i shkruar në pergamenë.

Do të veçoja [veç këtyre] dy vëllime me homilie [libër me omilie].

I pari [IV] është koleksion i dorëshkrimeve të Ungjillit sipas Markut, në lëkurë viçi [pergamenë], format i madh, *in quatro*, një dorëshkrim nga fundi i shekullit të 12-të ose fillimi i shekullit të 13-të.

Vëllimi i dytë [V] është i ruajtur mirë. Ky dorëshkrim është koleksion homielësh [omilie] të Shën Gjon Gojartit, për Shën Gjonin; dorëshkrimi është në lëkurë viçi, me dimensione 22 cm x 15 cm. Vëllimi ka 370 fletë me nga një kolonë për fletë (20 rreshta për çdo kolonë). Përafërsisht është i së njëjtës kohë me atë të mëparshmin [IV].

Së bashku me këto pesë grupe dorëshkrimesh, duhet shtuar edhe: një koleksion rregullash dhe dispozitash kishtare [kanon, nomokanon], me format *in quatro* nga shekulli i 15-të [VI]; një leksion [lectionary – fragment ungjillor apo Logos - ligjëratë patrologjike?] i dëmtuar nga *membrana* [pergamenë], gjithashtu format *in quatro* nga shekulli i 13-të;

[VII] një diptik i dëmtuar shumë rëndë, i lidhur me kopertina druri me dimensione 22 x 15 cm, nga i cili janë të ruajtura vetëm 77 fletë, dorëshkrimi i të cilit është nga fundi i shekullit të 14-të. Ky libër, diptik, është vepër e famullisë *Philanthopa*, sipas të dhënave që gjejmë në titull: *Fillimi i diptikut nga famullia e Philanthop-it*, dhe kjo famulli ndodhet në Janinë<sup>14</sup>, siç më kanë dëshmuar të tjerët.

[VIII]. Një diptik tjetër, përafërsisht nga e njëjta kohë, në një gjendje edhe më të keqe se i mëparshmi, nga i cili na janë ruajtur vetëm 23 fletë, me dimensione 21 cm x 14 cm, i takon Kishës së Shën Gjergjit, (Diptiku i Kishës së Shën Gjergjit);

Këtij dorëshkrimi do t'i kthehemi edhe njëherë më vonë.

[IX]. Në fund, do të tërheq vëmendjen edhe mbi dy dorëshkrime të cilat kanë të bëjnë me Shkrimin e Shenjtë:

Njëri dorëshkrim përmban Veprat e Apostujve [X]; ky ka 98 fletë; është i shkruar në pergamenë dhe ka dimensionet: 22 cm x 16 cm. Çdo fletë përmban nga një kolonë, të shkruar me 17 rreshta. Është i shkruar me një kaligrafi të bukur *korsive*, nga shekulli i 12-të, ndërsa vetë dorëshkrimi mban si datë krijimi vitin 1158 [përkatesisht: viti i krijimit të botës, sipas pikëpamjes së kishës Lindore, shkurt a.m.-anno mundi-6666]. Dorëshkrimi është i shoqëruar me shënime anash, në pjesën pa tekst, dhe është i zbukuruar me fije floriri të lidhura.

Pastaj kemi një ungjill [XI] të shekullit të 11-të, i shkruar në *membranë* [pergamenë], me një kaligrafi të bukur *korsive*, i cili ka 255 fletë, me dimensione: 21 cm x 16 cm. Çdo fletë përmban një kolonë, të shkruar me 25 rreshta. Dorëshkrimi ka katër ungjijtë, sipas rendit kanonik të pranuar. I mungon letra e Caprianus-it [Karpianit]; në fillim të çdo vëllimi ndodhen kanonet [tabelat] e Euseb-it, ndërsa në vetë tekstin, afër margjinave, janë shënimet e kapitujve të Amonijev-it dhe Euseb-it. Katër miniatura të tipit të thjeshtë paraqesin katër ungjillorët; ndërsa dekorimet janë plotësuar me disa shirita të pafinesë<sup>15</sup>.

Krahas këtyre dorëshkrimeve të zakonshme duhet të paraqes edhe disa dorëshkrime kaligrafike me një rëndësi të veçantë.

Në paralagjen Mangalem, në hyrje të urës së lashtë të Beratit, u njoftova për restaurimin e një kishë që mbante emrin *Fjetja e Shën Mërisë*, që ishte bërë kohë më parë.

U njoftova se aty ruhej një ungjill nga shekulli i 4-t<sup>16</sup>. Jam futur me plot emocione në kishë dhe kam gjetur një ungjill që ka të paktën 8 shekuj [XII]. Ky është një dorëshkrim në pergamen me 260 fletë në *in quatro*; i shkruar me një *korsiv*, dhe i takon shekullit të 12-të. Teksti përmban katër ungjijtë sipas rendit kanonik të pranuar. Fillon me një kanon të Euseb-it; ndërsa anash tekstit janë disa shënime, së bashku me krerët sipas Amonijev-it dhe Euseb-it. Në fillim dorëshkrimit i janë shtuar 20 fletë letre, në të cilat një dorë [e mëvonshme], e kohës së vendosjes së këtyre fletëve, ka shkruar: *Synaxaire*. Në vëllim janë katër miniatura që shtrihen në tërë faqen, të cilat paraqesin katër ungjillorët, në sfond floriri, të cilët janë të punuar me ngjyra shumë të bukura. Kapitujt janë të zbukuruar me shirita të hollë, ndërsa kanonet e

Euseb-it janë të vëna mes kornizash me shtylla të zbukuruara me lule dhe portikë<sup>17</sup>. Çdo fletë e zbukuruar me dekorime është e mbuluar me mëndafsh të lashtë me vel purpuri<sup>18</sup>. Dorëshkrimi mban këtë shënim: “Ky është një ungjill nga famullia e shenjtë Eleusi ose famullia e re. E shkroi: shumë i dashuri, i shenjtë, i denji mbret, zoti Theodor Komnen Laskari, i ashtuquajtur Gjon Engjëlli, për shkak të mbrojtjes së shenjtë dhe engjëllit, monarkut Kalinik. Ju, që këtë do ta lexoni, luteni që përmes të plotëfuqishmit, t’i kërkonit Zotit, që të na mëshirojë”<sup>19</sup>.

Kuvendi i cekur është [Zonja Shën Mëri e mëshirës], ose ndoshta është i njëjti me atë nga Mesebrija<sup>20</sup>.

Selia ipeshkvnore ruan edhe një ungjill të shkruar në pergamenë, që është i veshur me kopertina argjendi [XIII]. Ky ka 310 fletë, me dimensione 35 cm x 28.5 cm, dhe është i shkruar në dy kolona. Është i shkruar me shkronja *korsive* të mëdha. Eshte dorëshkrim i shekullit të 11-të ose i fillimit të shekullit të 12-të. Inicialet janë jashtë kolonës së tekstit në një lartësi e cila varion nga 3.5 cm deri në 5 cm; këto janë të praruara me flori dhe të plotësuara edhe me ngjyrë blu të hapur [ngjyrë bojë qielli]. Edhe titujt janë të pruar me flori, por të shkruar me shkronja të vogla, me një theksim të veçantë cinoberik. Çdo pjesë është e ndarë nga tjetra me shirit floriri dhe ngjyrë blu të hapur<sup>21</sup>.

### III.

Këtyre dy dorëshkrimeve kaligrafike duhet t’u bashkangjiten edhe dy dorëshkrime të tjera, të një forme tjetër, tepër të veçanta:

- *Liturgia argentea* dhe
- *Codex aureus Anthimi*.

Ekziston një numër shumë i vogël i dorëshkrimeve të krysografisë bizantine<sup>22</sup>. Citohen një psaltir që gjendet në Londër, një ungjill i Firences dhe një tjetër i Shën Petërburgut. [Nga këta], ky i fundit është i vetmi në purpur dhe në lëkurë viçi [pergamenë]<sup>23</sup>. Shto këtu edhe fragmentin e Uspenskit<sup>24</sup>, nuk kemi njohuri për dorëshkrime të tjera<sup>25</sup>. Dorëshkrimet me sfond të purpurt, të shkruara me ngjyrë argjendi, nuk janë shumë të përhapura<sup>26</sup>: Janë të njohur vetëm libri i Gjenezës [Genesis, Vjenë]; psaltiri i Zyrihut, ungjilli Patmos-it, ungjilli i Rossana-s dhe, nëse këtyre u bashkangjisim edhe fletët e palimpsestit nga Dublini<sup>27</sup> dhe të ungjillit të Vjenës [nga shekulli i 12-të], do të kemi një katalog përfundimtar të dorëshkrimeve të njohura me pergamenë të purpurt, të shkruara me ngjyrë argjendi. Koleksioni i Beratit na mundëson zgjerimin e këtij inventari me tre dorëshkrime të reja.

I. I pari nga këto dorëshkrime është pronë e imzot Alexoudis-it. Nuk kam arritur të zbuloj origjinën e tij. Ky është: *Liturgia e shenjtë e Shën Gjon Gojartit* [Chrysostome], shkruar me germa korsive të bukura, për të cilin mund të thuhet pa asnjë dyshim se është i shekullit të 12-të<sup>28</sup>. Ngjyra është e argjendte, por emrat e shenjtorëve dhe përkujtimorja [dedikimi] janë të pruar në flori, sikur edhe vetë titulli. Teksti nuk është i shkruar në fletë, por në *role* të purpurta pergamene, me gjatësi prej dy metra e tetëdhjetë e pesë centimetra [2.85 m] dhe gjerësi prej njëzet e gjashtë centimetra [26 cm]. Pjesa e jashtme, poshtë, është e dëmtuar; është e shkruar në të dyja anët e rolesë, në një kolonë të gjerë trembëdhjetë centimetra [13 cm]. Përkujtimorja [dedikimi] është e rimuar, si në vijim:

mhsqhti ke kai<sup>29</sup>  
 tvn svn doulwn; nikolaun  
 elenhV; grhgoriou; nikol  
 anastasiaV a; nataliaV a;  
 upatiaV; zenhV a; dnmh  
 triou kai annhV<sup>x30</sup>

II. Dorëshkrimi tjetër, të cilin në shenjë nderimi për imzot Anthime Alexoudis-in ne do ta emërtojmë: *Codex aureus Anthimi*, i takon kishës së ungjillizimit (ekklhsia tou euaggelismou thV qeotokou)<sup>31</sup> dhe llogaritet autograf [me shkrimin e dorës] i Shën Gjon Gojartit<sup>32</sup>. Është i

lidhur në kopertina argjendi të shtypur, fijet e të cilit sot janë të grisura. Dorëshkrimi ka 413 fletë, të lidhura nga 4 në një arak. Secila fletë ka dimensione prej 24 centimetrash lartësi dhe 19 cm gjerësi; ky është dimension i formatit të vogël: *in quatro*. Pergamena është shumë e fortë, është e ngjyrosur me ngjyrë të purpurtë me theks blu në të hapur [ngjyrë bojë qielli], pa theksime të zakonshme të elementeve të vjetra të së purpurtës, përmes llumit [mushtit] të verës ose trëndafilit<sup>33</sup>. Ngjyra është e artë. Çdo faqe ka nga një kolonë tekst, ndërsa kolona ka 17 rreshta si edhe te *Codex Theodoræ* në Shën Petërburg. Gjerësia e margjinave është 42 milimetra në kokë, 65 mm në këmbë, 34 mm në pjesët e brendshme dhe 58 mm në këndet e jashtme. Në margjina ndodhen shënimet e kapitujve të Amonijev-Euseb-it, të ashtuquajtura kefalaiia,<sup>34</sup>. Në fillim të çdo ungjilli është një grumbull kefalaiia<sup>35</sup>. Aq sa kam mundur të gjykoj nga një krahasim pjesërisht i themeltë, teksti nuk dallon nga tekstet e tjera të traditës bizantine; është i shkruar në mënyrë shumë korrekte. Shkrimi është një korsiv i shkëlqyeshëm, në të cilin ekziston vetëm pika dhe asnjë shenjë tjetër pikësimi [në origjinal: “interpunction”]. Megjithatë, në çdo fjalë janë të shënuara *thekset*. Dorëshkrimi ka të njëjtën formë si ai te *Codex Theodoræ*<sup>36</sup>; por, në të vërtetë, unë në mes tyre vërej një dallim të rëndësishëm: në *Codex Anthimi* grafema [Ⲅ] ka të njëjtën formë që e ndeshim edhe në shekullin e 9-të, kurse te *Codex Theodoræ* kjo shenjë merr zvetënim në formë *unciali* [Ⲛ], që nuk kemi mundur ta gjejmë në fund të shekullit të 10-të<sup>37</sup>. Pa asnjë mëdyshje, mund ta vendosim *Codex Anthimi* në shekullin e 10-të<sup>38</sup>. Në fillim të çdo kapitulli, te të katër ungjijt, është nga një miniatyrë e vizatuar me ngjyrë floriri; vetëm trupi, pjesërisht, është i punuar me ngjyrë, e cila pothuajse tërësisht është fshirë. Korniza e çdonjërës figurë është paraqitur në mënyrë gjeometrike, ndërsa portreti i ungjillorëve është i tipit të thjeshtë [naiv]<sup>39</sup>.

#### IV.

Më në fund arrijmë deri te dorëshkrimi më i rëndësishëm i thesarit beratas; ai të cilit i është vënë emri *Beratinus*, si pronë e Kishës së Shën Gjergjit dhe që është ruajtur në shtëpinë e ipeshkvit. Debatet [e mia] rreth këtij dorëshkrimi janë botuar në *Mélanges* të shkollës frënge në Romë. Këtu disa çështje janë botuar përsëri, me një numër të madh përmirësimesh dhe korrigjimesh të të dhënave të ndryshme, si dhe me shtojca të tjera. Dëshirojmë që shqyrtimi ynë të shikohet dhe vlerësohet në dritën e këtyre versioneve të reja.

Disponojmë vetëm dy dokumente të cilat mund të na ndihmojnë në ndriçimin e historisë së *Beratinus-it*. Dokumenti i parë është nga Diptiku i Kishës së Shën Gjergjit [Kodiku nr. IX këtu, sipas renditjes së autorit]<sup>40</sup>, të cilin e kam përmendur më herët, pjesët e shkëputura të të cilit ndodhen në shtojcë. Në kronikën e Kishës së Shën Gjergjit, [në anëshkrim], përmendet njëfarë *Skouripékis*, “laik” [shekullar] nga Berati, i cili e kishte për nder që emri i tij ishte shënuar në diptik, për shërbimet që i kishte bërë famullisë<sup>41</sup> dhe qytetit në vitin 1356. Është shkruar se në atë vit serbët kishin ndërmarrë një fushatë të ashpër kundër Beratit [Beogradit]<sup>42</sup>, të cilën qyteti nuk kishte qenë në gjendje ta përballonte. Me këtë rast është dashur që me çdo kusht të shpëtohej thesari kishtar i Beratit dhe lutjes së murgut *Théodoulos* i ishte përgjigjur me përkushtim *Skouripéki*. Ai, së bashku me murgun, kishin ngarkuar në “koshere” bletësh “27” dorëshkrime me vlera të jashtëzakonshme, të cilat “i kishte Theologu” dhe Kisha e *Shën Gjergjit* dhe i kishin vendosur në vend të sigurt.

Pason një regjistër i dëmtuar i dorëshkrimeve, i cili përmban libra liturgjikë dhe shërbese, një regjistër të veçantë të dhuratave kishtarë; një “psaltir të krijuesit” [ktitorit]; “katër ungjij nga Bullgaria”[?]; dhe një vëllim dorëshkrimi të titulluar: “*Katër ungjij të shkruar me dorën e Shën Gjon Gofartit në argjend*”<sup>43</sup>.

Duke u mbështetur në shënimet e imzot *Alexoudis-it*<sup>44</sup>, në fillim këtë dorëshkrim e kam identifikuar si të njëjtë me atë të *Codex aureus Anthimi*. Por kuptimi i fjalës “*i shkruar me argjend*”<sup>45</sup> nuk lë vend për dyshim<sup>46</sup>. Në të duhet të shikojmë sinonimin për “*i shkruar me argjend*”<sup>47</sup>. Atëherë [disa të dhëna rezultojnë] kundër mendimit të ipeshkvit beratas, i cili e kishte shënuar si “ungjill i pruar me argjend”, ose i lidhur me argjend, çka në të vërtetë kishte të bënte me *Codex aureus*. Në fakt, fjalia me këtë kuptim: “*ungjill i shkruar me shkronja*

*argjend*” [sipas Alexoudes] duhej të shënonte vetëm *Codex Beratinus*. Por ndërkaq kemi vërejtur praninë e dorëshkrimit tonë, në thesarin e “Théologu-t” të Beratit, që nga viti 1356. Në kohën e sotme, emrin “Théolog” e mban vetëm një manastir, e ky është ai i Panagia Ardéoussa. Por diptiku i Kishës së Shën Gjergjit na shërben si dëshmi se në shekullin e 15-të ka ekzistuar një manastir në Berat me emrin e Shën Gjergjit dhe të Shën Gjonit-Ungjilltarit, përkatësisht “Théolog-ut”, manastir i cili sot nuk ekziston më. “Théolog-u”, i cili kishte në pronësi Codex F, nuk do të duhej të kërkohej dikund tjetër, pos në Berat. Na mbetet vetëm edhe një gjë, që të interpretojmë edhe dokumentin e dytë, sipas të cilit ato që u pohuan më lart për “Théologu-n” e Beratit janë identifikuar me atë të shquarin “Théolog” nga Patmosi<sup>48</sup>. Përmbajtja e dokumentit të dytë është shënimi<sup>49</sup> i shkruar në fillim të Codex F që, sipas mendimit tim, shkrimi është nga shekulli i kaluar [d.m.th. shekulli i 18-të]<sup>50</sup>, pak më i hershëm se sa lidhja e ungjillit me kopertinën e re [1805]. Analiza gramatikore e dorëshkrimit e vërteton një parashikim të tillë. Lexojmë: “*Shikojini, ju, o lexues, këto shkronja të shkruara me dorën e Shën Gjon Gojartit në kohën që ishte meshtari i ungjillit ... Shikoni ngjyrën e pakrahasueshme të fletëve si dhe vizatimet e bukura të atyre shkronjave!*”

Për të sqaruar unicial-in<sup>51</sup> e formës së shkronjave, autori shton: “*Gjatë kohës së Shën Gjon Gojartit, shumë njerëz kanë shkruar me shkronja të ndara luta grammata<sup>52</sup> dhe kanë “harruar” të shënojnë “forcën” e shenjave të floririt [?]. Me këtë dëshiroj të theksoj veçanërisht thekset e mprehta, ato të rënda dhe shenjat hundore, si dhe hakat e lehtë dhe të ashpër. Nga të katër ungjijtë, të cilët përbënin një vëllim dorëshkrimi, kanë mbetur vetëm ai i Mateut dhe i Markut, ndërsa pjesa që përmbante Ungjillin sipas Lukës dhe sipas Gjonit është zhdukur*”. Sipas kësaj ne njohim Codex F; por, ja edhe një rrëfim i pabesueshëm dhe jo i sigurt që na shërbehet: “*Themeluesi i “Théologu-t”<sup>53</sup> e ka marrë këtë ungjill në manastirin e tij, për shkak të një vizioni dhe një mrekullie “eneken qeaV kai qamatoV”<sup>54</sup>, ose edhe këtë: “për ta shikuar, kundruar dhe për ta admiruar, veçanërisht në shenjë nderimi të Shën Gjon Gojartit; ndërsa dëmtimi ka ndodhur në kohën kur frankët nga Kampanja [Champagne] kanë shkatërruar librat e “Théologu-t”*”. Ky rrëfim bie ndesh me dy të dhëna, që janë kundërthënëse: Fjala është për Berat, nga vetë fakti se dorëshkrimi i kushtohet Shën Gjon Gojartit dhe manastirit të “Théologu-t”. Megjithëse lë për të kuptuar se rreziku erdhi nga “frankët nga Kampanja” [Champagne], çfarë do të ishte shprehja e çuditshme që pason për një rrezik tjetër nga “çetat e Napolit”<sup>55</sup>, që kanë hyrë në Berat dhe kanë plaçkitur kalanë, ngase një gjë e tillë është e padëgjues<sup>56</sup>. Aq më shumë, nëse ky fakt do të ishte i vërtetë, përkundër të gjithave sa njohim nga burimet, kjo më së voni do të duhej të ndodhte në vitin 1281, derisa diptiku i Kishës së Shën Gjergjit - dokument me më shumë vlerë se sa një shënim pa burim - dëshmitar shumë i sigurt, na tregon vitin 1356, kur **Codex F** duhej të ruhej siç ishte, ende i plotë. Pas kësaj vazhdon pohimi i të dhënave të tjera, që na ofron ky shënim, pa ndonjë mbështetje historike dhe vlerë të rëndësishme historike.

Vetëm dy rreshtat e fundit mund të bënin përjashtim, ngase mund të pranohen si një dëshmi vetjake. Ato mund të përkthehen në këtë mënyrë: “*Ungjilli i “Théolog-ut”, [të cilin ai e kishte] shkruar në Patmos, ka gjithashtu shkronjat e (pa)ndara, ashtu siç i kam shikuar me sy të mi, në Efes*”. Me fjalë të tjera, shkruesi i këtij shënimi pohon se në Efes ka shikuar një autograf [?] të Shën Gjon Gojartit dhe dëshmon se shenjat grafike të ungjillit të përmendur janë të ngjashme me ato të cilat i përkasin dorëshkrimit të Shën Gjon Gojartit. Kjo e dhënë nuk është e pavlerë, por nuk na flet gjë për *Beratinus*-in.

Shkurtimisht, me shumë siguri, mund të pohojmë praninë e **Codex F** në Berat në shekullin e 14-të. Ky është i vetmi përfundim për të cilin mund të themi me siguri se është i saktë; duke u tërhequr nga hipotezat e mëparshme të pohuara, të shprehura me shumë rezerva.

## V.

*Codex Beratinus* është në një kopertinë të re, e cila datohet në fillim të këtij shekulli [shekulli i 19-të]. Kapakët brenda janë prej druri pishe. Frontespici është me dekorime argjendi të gdhendura dhe të shtypura në sipërfaqe - punim i argjendarëve grekë [ortodoksë] me cilësi të mesme. Ky mban shënimin: 1805. Faqet e para janë nga një letër e ashpër; e papastër [e cila ishte e ruajtur në ndonjë tinar]. Në të janë ruajtur disa shënime. Faqen e parë e kemi përshkruar dhe është në shtojcë, ndërsa dy të tjerat kanë një përshkrim të shkurtër të dorëshkrimit, të shkruar me dorën e imzot *Alexoudis*-it. Si mbrojtje për faqen e parë, prej lëkure viçi [pergamene], është vendosur një faqe letre, e shkëputur nga ndonjë ungjill i redaktuar dhe i shtypur.

Dorëshkrimi numëron 190 fletë të pafaqosura<sup>57</sup>, të cilat kanë qenë të lidhura fort, por si duket libërlidhësi i ri ato gabimisht i ka prerë, në vend që t'ua linte këndet të lira dhe të paprera. Fletët, të cilat në brendi kanë qenë të dëmtuara, ishin të përforcuara me një shirit të bardhë letre; vetëm një fletë e kemi të lirë, dhe kjo është fleta me nr. 69. Fletët, të cilat kanë qenë të dëmtuara horizontalisht apo vertikalisht, janë qepur me kujdes; pos fletët: 74, 115 dhe 134, [të cilat] kanë mbetur në dy pjesë. Gjashtë faqet e para janë shumë të dëmtuara, shkronjat janë të zbehura, ngjyra e purpurtë është zverdhur fare, për të mos thënë se është zhdukur; por, që nga fleta 7, dorëshkrimi është në gjendje të shkëlqyeshme, pos fletëve 75-78, të cilat janë të dëmtuara rëndë. Ungjilli sipas Mateut mbaron në kolonën e dytë të fletës 112 recto. Fleta 112 verso nuk është e shkruar fare; ndërsa fletët 113 dhe 114 përmbajnë krerët e Ungjillit sipas Markut. Ungjilli sipas Markut fillon me fletën 115. Këndi i poshtëm i fletëve 115 dhe 116 ka qenë i shqyer; është i plotësuar me letër të thjeshtë; në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me fletën 121. Në fletën 144 vërehet një vrimë e madhe, e rrumbullakët, karakteristike për lëkurën e viçit. Shkruesi këtë gjë e kishte parasysh kur ka shkruar rreshtat përkatës. Fletët 177 dhe 181 janë në gjendje tepër të keqe; por të gjitha të tjerat në vazhdim janë në gjendje të shkëlqyeshme, pos 4 fletëve të fundit, të cilat janë në gjendje të ngjashme me 6 fletët e fillimit.


Është më se e qartë se dorëshkrimi një kohë të gjatë nuk ka qenë i lidhur dhe ka qenë nën ndikimin e lagështisë dhe pluhurit, para se të restaurohet në vitin 1805. Në këtë mënyrë, dorëshkrimi ka humbur 40 fletë, të cilat përafërsisht mund t'i shpërndanim në këtë mënyrë: (pos krerëve të Ungjillit sipas Mateut dhe kopertinave): Mateu, I-VI, 3 = 25 fletë përafërsisht; Mateu, VII, 7 = 1 fletë; Mateu, XVIII, 24-XIX, 3 = 2 fletë; Mateu, XXIII, 4-XXIII, 13 = 1 fletë; Marku, XIV, 62-XVI, 20 = 12 fletë.

Pergamena është e fortë dhe me peshë të mesme, është shumë e thatë. Shkronjat zakonisht nuk vërehen nga njëra anë [e fletës] në tjetrën. Lëkura e viçit është e lyer me ngjyrë të purpurt, por sot dominon ngjyra vjollcë, e afërt me llumin e verës, që lë të nënkuptohet se në fillim ka qenë ngjyrë e kuqe e theksuar.

Këndet e fletëve janë zverdhur nga kontaktet me ajrin. Lartësia e fletëve është 31.4 cm, ndërsa gjerësia është 26.8 cm. Vijat në margjina dhe për radhët e shkruara janë bërë me gërvishtje prej një pene të thatë, d.m.th. pa ngjyrë, ndërsa vërehet shumë qartë gdhendja mjeshtrorë në margjinën e qendrës. Çdo radhë përbëhet nga vija të dyfishta, të cilat kanë shërbyer për të shënuar lartësinë e shkronjave, poshtë e lart. Çdo faqe ka nga dy kolona me nga 17 rreshta. Numri i shkronjave është i ndryshueshëm nga 8 në 12 shkronja për për çdo radhë, me një afërsi më shumë 9 se sa 10. Çdo kolonë është 21 cm e lartë dhe 10.9 cm e gjerë. Margjina që ndan kolonat është e gjerë mesatarisht 3.5 cm. Në margjinën lart dhe në vijën e veçantë afër këndit ndodhen vetëm kapitujt, pa ndonjë titull të zakonshëm, dhe këto saktësisht mbi kolonën për të cilën bëhet fjalë. Numrat për referencat e shënimeve të Amonijev-Euseb-it janë të shënuar në margjina. Ngjyra është prej floriri. Gërvishtja e penës është e rrafshët, pa njolla dhe e punuar me shumë kujdes.

Gjashtë fletët e para të Ungjillit sipas Mateut janë të shkruara me shkronja floriri dhe paraqesin

fjalët: **PHRIC, UC**; njësoj është shkruar edhe radha e parë, si titull, te Ungjilli sipas Markut. Shkronjat e para të kapitujve çdoherë janë shumë të theksuara, gati sa tërë gjerësia e marginës, dhe janë dyfish më të mëdha se sa shkronjat e zakonshme, por nuk kanë dekorime. Vetëm shkronja **O** është e dekoruar me një kryq të vogël në mes. Meqenëse Ungjilli sipas Mateut përfundon në mes të kolonës, zbrazësira është mbushur me një shirit floriri, me një motiv të thjeshtë gjeometrik. Në disa raste të rralla shkruesi anon në anën e djathtë të marginës për të përfunduar fjalën e fundit në rreshtin e ri. Me këtë rast, shërbehet me shkronja më të vogla se zakonisht.



Në këtë formë na paraqitet *Codex Bezae Cantabrigiae*.

Dorëshkrimi i takon fazës së hershme [të vjetër] të uncial-it. Shkronjat e rrumbullakëta si: **E, Q, O, C** asnjëherë nuk janë të zgjatura; ndërsa shkronja kuadrat si: **H, M, N, P** nuk janë asnjëherë në pozicion kënddrejtë; as kur ndodhen në fund të rreshtit. Të gjitha shkronjat kanë pozicion të drejtë dhe askund asnjëra nga ato nuk qëndron pjerrtas. Shkronjat janë të rregullta dhe asnjëherë nuk kalojnë vijat që kufizojnë rreshtat, poshtë e lart; bile as **z** ose **ax**. Të vetmet shkronja që zgjaten poshtë vijave në rresht, janë **R** dhe **U**; ndërsa, në disa raste, shkronjat **F** dhe **Y** kalojnë këndet e rreshtave në të dyja anët. Shkronjat e theksuara [inicialet], si p.sh. **x** janë me kënde. Vija e drejtë e shkronjës **x** është e palidhur, lirshëm e hapur në krahë, por gjithnjë duke mos marrë asnjëherë formën e çomages [*keulenform*], e njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkronjat **T, P, G**. Vija horizontale e shkronjës **Q** asnjëherë nuk del jashtë rrethit, të cilin e ndan në dy pjesë të barabarta. Vijat e shkronjës **E** me saktësi e kalojnë mesin e lakores, i cili është në formë gjysmëhëne, duke krijuar kështu një rënie të lehtë, në anën e djathtë. Dy këndet e harqeve të shkronjave **E** dhe **C**, gjithashtu, janë disi të zbutura. Shkronja **W** është pothuajse e mbyllur<sup>58</sup>. Shkronjat e fillimit, [inicialet, nistoret], janë dyfish më të mëdha, por janë të të njëjtit stil grafik, që do të thotë se i takojnë uncial-it të lashtë.



I shikuar në tërësi, autoshkrimi te *Codex Beratinus* është ndër më të bukurit të unicial-it të lashtë, i ngjashëm me atë të *Dioscoride-s* së Vjenës<sup>59</sup>; mund të themi se është edhe më i bukur, i ngjashëm me *Palimpsestin I* nga Shën Petërburgu<sup>60</sup>, për të cilin studiuesit mendojnë se vjen nga fillimi i shekullit të 6-të.

Ky këndvështrim i fillimit është mbështetur në këto të dhëna: Dorëshkrimi nuk përmban shenjat e theksave, dhe për këtë nuk mund të nxjerrim asnjë përfundim; nuk përmban as haket [shenja të posaçme grafike të greqishtes antike], të cilat janë një tregues i sigurt i vjetërsisë së dorëshkrimit<sup>61</sup>. Këtu ndeshim në mënyrë absolute shkrimin *scriptio continua* pa asnjë radhë; teksti është i shkruar gjatë tërë vijës së shënuar dhe fjalët nuk janë të ndara. Shenjat e pikësimit vijnë në fund të fjalisë, të shënuara me një pikë të zgjatur, herë të thjeshtë, herë të dyfishuar, të vënë nga mesi i lartësisë së shkronjave<sup>62</sup>. Apostrofi që shënon elizionin nuk përdoret rregullisht, por çdo herë vendoset kur shkronja e fundit është **P**<sup>63</sup>. Mbi zanoret **I** dhe **Y** është e shënuar vija [një vijë e shkurtër sipër shkronjave, dijareza], veçanërisht atëherë kur nuk janë pjesë e diftongut<sup>64</sup>. Citatet e Testamentit të Vjetër<sup>65</sup> janë të shënuara në margjina me shenjën (>). Ligaturat janë të kufizuara në tre lloje: [ **μ** ] për “*mu*”<sup>66</sup>, që e ndeshim që nga shekulli i 4-të<sup>67</sup>, [ **α** ] për **au**, të cilën e përdor shkruesi i *Dioscoride-s* së Vjenës<sup>68</sup>, dhe grupëzimi i njohur *autou* si [ **α** ] te *Gueferbytanus P*, edhe pse te *Beratinus* i gjejmë vetëm dy herë<sup>69</sup>. Janë përdorur shkurtesat më të vjetra [të moçme], si: **QC, IC, KC, YC, XC, PHR, MHR, PNA, ANOC, OYNOC** (shpesh është përdorur edhe: **OYPANOC**), **DAD, IHL**<sup>70</sup>, një herë edhe **ILHM**, ndërsa asnjëherë **IHM**. Kësaj i duhet shtuar edhe shkurtesa përfundimtare **n**, në fund të rreshtit **tw**; dhe vetëm disa herë **k** për **kai**<sup>71</sup>; një herë **EIN** për **EINAI**<sup>72</sup>; dhe një herë **DOUNA** për **DOUNAI**<sup>73</sup>; një herë **KAQHCCQ** për **KAQHCCQAI**<sup>74</sup>; dhe një herë **DIKOI** për **DIKAI**<sup>75</sup>; por asnjëherë për [ **τ** ] dhe asnjëherë për: **HN, NH, NK, MH** etj.; si dhe asnjëherë: [ **θ** ] dhe asnjëherë tjetër për: [ **ω** ]<sup>76</sup>. Vërejmë, pra, që asnjëra nga parregullsitë e tekstit nuk mund të hedhë poshtë mendimin tonë të parë, se detajet e shkrimit të *Beratinus*-it nuk mund të shkojnë më larg se shekulli i 6-të.

Kur bëhet fjalë për një dorëshkrim kaligrafik, është shumë vështirë për të përcaktuar me saktësi kohën e krijimit të tij vetëm sipas formës dhe lashtësisë së shkronjave. Një element me rëndësi te *Beratinus*-i është i mjaftueshëm për të na përkujtuar këtë. Shikuar se si citohen numrat e ndarjes të Amonijon-it dhe kanonet e Eusebit, titujt e zakonshëm të krerëve [“kefalaia”] të dorëshkrimit. Shkrimi i krerëve ka një formë tjetër nga ajo e tekstit; ky shkrim është më pak i kujdesshëm dhe është i shkruar më shpejt, zgjatet dhe është më i hollë; në të njëjtën kohë, duke qenë i barabartë; në paraqitjen e unicial-eve në formën që e ndeshim në shekullin e 8-të, që është ajo e rrumbullakta dhe kënddrejta<sup>77</sup>. Mund të themi se këtë e ka shkruar një dorë e dytë. Këtë mendim e kam pasur edhe në fillim, kur kam vërejtur se ngjyra ishte më e kuqërremtë, ndërsa gërvishja më pak e theksuar; por ky ndryshim mund të komentohet edhe në një mënyrë tjetër, si kthim i penës në njërën anë dhe një dorë e stërvitur dhe e shpejtë në të shkruar. Unicial-i katror është i ngadaltë, i llogaritur mirë dhe me stil jo shumë të veçantë; në momentet kur shkruesi ka nxituar ose ka qenë i pavëmendshëm, bëhet zgjatja e vijave dhe, në të njëjtën kohë, dorëshkrimi i tij fiton një formë moderne, kështu që ky shpjegim do të ishte i mjaftueshëm për të sqaruar ekzistencën e dy shkrimeve, origjinën e tyre dhe të identitetit të ndryshëm. Megjithatë, nga forma e këtyre dy shkrimeve, vështirë mund të dallohen se cili është nga shekulli i 6-të dhe cili nga shekulli i 7-të.

Një rast i tillë nuk është ri. Diçka e ngjashme është edhe për tre dorëshkrimet e Testamentit të Ri. Tek *Codex Zacynthius x*, nëse shikojmë dorëshkrimin, mendohet se teksti është i shekullit të 8-të, për faktin se e njëta dorë është e identifikuar si për shkrimin, ashtu edhe për dekorimet! Në të vërtetë, *Treguelles*, këtë dorëshkrim e daton të shekullit të 8-të, por sot jemi të mendimit se duhet konsideruar më i lashtë [vjetër], për vetë faktin e mënyrës së shkrimit të vetë tekstit<sup>78</sup>. Ky është rasti i parë. Pyetje e ngjashme është parashtuar edhe në lidhje me *Gueferbytanus P*, ngase, sikur edhe te rasti i *Beratinus*-it, kemi tekst me unicial në formë

kuadrat, sikur edhe kapitujt<sup>79</sup> [kefalalaia] në formën unicial kënddrejtë; me këtë rast duhet të theksojmë se nëse unicial-i i krerëve<sup>80</sup> është shumë i ngjashëm me unicial-in e kefalalaia<sup>81</sup> të *Beratinus*-it, vetë teksti ka disa karakteristika të cilat e bëjnë disi më të ri se sa shkronajt të *Beratinus*-i. Kjo vërehet sidomos te: **A**, **D** dhe **W**. Megjithatë, askush nuk ka dyshuar në përfundimet e *Tischendorf*-it, i cili *Guelferbytanus P* e ka datuar të shekullit të 6-të<sup>82</sup>. Ky është rasti i dytë. Më në fund te *Rossanensis* sikur të izolonim kapitujt<sup>83</sup>, dhe shënimet e Amonijev-it dhe Eusebit, ka ekzistuar mundësia që ta datonim në shekullin e 7-të, por kjo gjë nuk e ka penguar Gebhard-in që të bënte datimin e *Rossanensis* në shekullin e 6-të, në bazë të elementeve të shkëlqyera arkelologjike dhe paleografike<sup>84</sup>. Ky është rasti i tretë.


Këto tre raste nuk janë zgjidhje përfundimtare për pyetjen tonë, por do të na shërbejnë që, duke bërë krahasime me dorëshkrimin e fundit, të mund të nxjerrim një gjykim të sigurt dhe përfundimtar. *Rossanensis* mund të na shërbejë në mënyrë të shkëlqyer për të bërë krahasime: mendojmë se shkrimi i tij tipik dhe datimi i tij janë të sigurtë dhe përfundimtarë<sup>85</sup>. Shkrimi te *Rossanensis* është më i ngjeshur [i afruar, ngjitur] se sa te *Beratinus*; kjo është larg çfarëdo dyshimi për tekstin, në të cilin ndeshim 20 rreshta për kolonë, me përafërsisht 11 shkronja për një rresht; ndërsa te *Beratinus* kemi 17 rreshta me nga 9 shkronja, përafërsisht, për rresht, me një format pothuaj me përmasa identike të të dy dorëshkrimeve. Por kapitujt<sup>86</sup>, janë më shumë të ngjeshur [afruar, ngjitur] te **F**<sup>87</sup> se sa te **S**<sup>88</sup>, sikur që edhe shënimet e Amonijev-it dhe Euseb-it janë më të vogla te **F**<sup>89</sup> se sa te **S**<sup>90</sup>. Vërejmë se te të dy dorëshkrimet kemi vetëm një element kontradiktor për krahasime; por edhe sikur mos të ishte kështu, nga kjo nuk do të mund të përfundonim asgjë, ngase madhësia e shkronjave nuk është e dhënë kronografike<sup>91</sup>. Kam pohuar më lart se te *Beratinus*-i shkronajt e rrumbullakëta nuk zgjaten dhe se shkronjat kuadrate asnjëherë nuk janë kënddrejta, as në fund të rreshtit; për këtë gjë unë jam kritikuar në disa raste, kur u botuan faksimilet përkatëse<sup>92</sup>. Por, pas rishikimit të përshkrimeve që kam bërë, kam mundësi që me siguri të mbroj qëndrimin tim fillestar. Ekzistenca vetëm e disa formave kënddrejta ose kuadrate ka mundësi që ta bëjë më të ri *Beratinus*-in në raport me *Rosanensis*-in; ndërsa, në anën tjetër, disa faktorë të *Rosanensis* duken më të rij se sa elementet e tjera në raport me *Beratinus*. P.sh., në fund të rreshtave, shkronjat **A** kanë një rënie pingule më të lehtë dajhtas; **w** hapen dhe janë shumë më të sheshura; pra, janë këto dy shenja të cilat si të tilla paraqiten në shekullin e 7-të, dhe të cilat *Beratinus* nuk i njeh fare. Me këtë rast shtojmë këtu edhe shkurtesat dhe shkronjat e bashkangjitura, të cilat i kemi përmendur më lart e të cilat janë më të shumta te *Codex F* se sa te *Codex S*. Me një fjalë, meqenëse dukja e përgjithshme e të dy shkrimeve është e njëjtë, nuk besoj se ky detaj i shkrimit mund të dëshmojë për krijimin e mëvonshëm të dorëshkrimit nga Berati në raport me atë nga Rossana; përkundrazi, mund të jetë e kundërta. Nëse, pra, për dorëshkrimin nga Rossana mendohet se është nga fundi i shekullit të 6-të, dhe për dorëshkrimin nga Berati mund të pohohet me siguri se është nga e njëjta periudhë.

## VI.

Na ka mbetur që të shqyrtojmë tekstin e *Beratinus F*: qëllimi im është përcaktimi i karakterit specifik të *Beratinus*-it, duke u mbështetur në vetë dorëshkrimin, si dhe duke shikuar raportet me dorëshkrimet kryesore të Testamentit të Ri; pra, duhen theksuar leksionet [lectionary, mësimet, perikopetë]<sup>93</sup> e tij; si dhe duhen zbuluar ngjashmëritë e tyre.

Leksionet janë të shumta dhe tipike për *Beratinus*-in. Nëse anashkalojmë ato të cilat janë variacione<sup>94</sup> grafike të pastra, ballafaqohemi me leksione të cilat janë fillimisht të parafrazuara dhe të cilat janë krijuar vetvetiu ose nën ndikimin paralel të pjesëve të tjera të ungjijve të tjerë. - Mateu VIII, 14, “*Shikoi vjehrrën e tij të shtrirë dhe në ethe*” - shih: Mateu IX, 2; Marku VII, 30; IX, 28, “*I afrohen të verbërit, duke kërkuar, ndërsa ai thotë...*”<sup>95</sup>; IX, 30, “*Menjëherë i hapen sytë e tij*”; XI, 18, “*Vjen Gjon Pagëzori, as nuk hëngri gjë, as nuk piu.*”<sup>96</sup>; XII, 18, “*I dashuri (im) në të cilin shpirti im kishte gëzim.*”<sup>97</sup>; XII, 43, “*Shpirti i papastër del (nga) njeriu.*”<sup>98</sup>; XIII, 26, “*U duk edhe egjra*”; XIV, 23, “*Të luteni (ndodhej shumë larg tokës) në mbrëmje.*”<sup>99</sup>

- Mateu, XIV, 24, “Era ju ishte kundërshtar. Për të katërtën...”<sup>100</sup>; XVI, 7, “(ata në vete) mendonin duke folur”; XVI, 21, “Dhe nga populli (poetët) dhe se do të vritej. Krerëve [pleqve] të popullit”<sup>101</sup>; XVI, 28, “Vërtet (vërtet), ju them.”<sup>102</sup>; XVII, 18, “Jezusi e urdhëroi (duke i thënë: dil) dhe doli.”; XX, 6, “Gjeti të tjerët duke ndenjor (në shesh) të papunë”<sup>103</sup>; XX, 15, “Ose, nuk më lejohet të bëj çfarë të dëshiroj.”<sup>104</sup>; XXI, 2, “Sapo (hyni) do ta gjeni.”<sup>105</sup>; XXI, 3, “dërgoni ata (ashtu). Po këtë.”<sup>106</sup>; XXI, 5, “Mbreti yt po vjen zemërbutë.”<sup>107</sup>; XXI, 10, “Në lartësi (i vinin në takim shumë, të gëzuar, duke lavdëruar Zotin, të shumtën për atë që kishin shikuar). Kur ai hyri.”<sup>108</sup>; XXI, 21, “A keni besim (sikur kokërr fiku) dhe nëse nuk dyshoni.”<sup>109</sup>; XXI, 38, “Kjo e jona do të jetë (e tij) trashëgimi. Dhe e kapën.”<sup>110</sup>; XXII, 3, “Dhe njëra do të mbetet.”<sup>111</sup>; XXIV, 41, “Tënden (thujat të pranishmëve).”<sup>112</sup>; XXV, 21, “(I) thotë Zotëri.”<sup>113</sup>; XXVI, 53, “Ose (mendoni) po. Në



vend: mendoni”; XXVI, 65, “Dëgjua blasfeminë për [sharjen] Zotin (nga goja e tij).”<sup>114</sup>; XXVII, 1, “Krerët [pleqtë] e popullit (për Jezusin) ta vrasin (Jezusin) dhe ...”

- Mateu XXVII, 16, “Atëherë kishin një të burgosur famëkeq me emrin Barnaba (i cili për shkak të vrasjeve dhe rebelimit ishte futur në burg) kur është sjellë.”<sup>115</sup>;


- Marku, I, 17, “Ju thotë (Jezusi): Ejani.”<sup>116</sup>; II, 3, “Erdhën te ai (disa) duke bartur të paralizuarin”; II, 26, “Nuk u është e lejuar të ushqehen, përpos (udhëheqësve) priftërinjve.”<sup>117</sup>; IV, 10, “E pyetën ata rreth tij së bashku me të dymbëdhjetët (na sqaroni) rrëfimin!”<sup>118</sup>; IV, 33, “Ju rrëfen rrëfimin ashtu që ata mundën ta kuptonin.”; V, 10, “Që të mos i dërgonte jashtë atdheut, dhe atje ndodheshin.”<sup>119</sup>; V, 26, “Duke shpenzuar të tijën (pasurinë)”; VI, 14, “Dhe ju thotë (shërbëtorëve të tij) po”<sup>120</sup>; VI, 35, “Nxënësit e tij (thoshin).”<sup>121</sup>; VI, 51, “Dhe qetësoi erën dhe i shpëtoi ata duke i dërguar”; “Dhe përmbi masën në mes tyre”<sup>122</sup>; VIII, 30, “Që askujt të mos i flasim këto, për të.”<sup>123</sup>; VIII, 38, “Në këtë kurorëshkelje dhe gjak të gabuar.”<sup>124</sup>; IX, 47, “Flake atë (dhe flake nga vetja) do të ndihesh më mirë.”<sup>125</sup>; XI, 3, “Dhe menjëherë dërgoi këtu.”<sup>126</sup>; XI, 4, “Jashtë (në) rrugë.”<sup>127</sup>; XI, 24, “(dhe) për këtë.”; XIII, 9, “Këto janë fillimet e pikëllimit.”<sup>128</sup>; XIV, 5, “Ai vaj mund të shitet.”<sup>129</sup>; XVI, 11, “për të dhënë para.”

Nga këto leksione të ndryshme, të cilat i kemi cituar, pothuajse asnjëri nuk është i papritur, dhe të gjitha mund të sqarohen me rregulla të traditës gojore; po tash, përkundrazi, ja një numër leksionesh për të cilat mendojmë se ndoshta mund të gjejmë paramendim, dhe në të cilat mund të zbulohet diçka e ngjashme me  $\Phi$ . Nuk e di nëse është e domosdoshme që të përkujtoj se për çfarëdo që ka të bëjë me familjen e dorëshkrimeve greqisht të Testamentit të Ri, do t’i përmbahemi klasifikimit të G. Westcottit dhe Hortit.

Ja disa leksione për të cilat mund të pohohet se janë burimore dhe të veçanta: *conflate readings*:

1. Te Mateu XVI, 4, lexojmë: “Ai ju përgjigjet: Në mbrëmje flisni: do të jetë një ditë e bukur, ngase qielli është i skuqur! Në mëngjes: sot do të jetë ftohtë, ngase qielli është skuqur dhe i vranët! Hipokrit, fytyrën e Zotit dini ta komentoni, ndërsa shenjat e kohës nuk mundeni”<sup>130</sup>. Sot është e pranuar e tërë fjalia e cila fillon: “Në mbrëmje”<sup>131</sup>, dhe përfundon me shtojcën: “Ndërsa shenjat e kohës nuk mundeni”<sup>132</sup>, po ky supozim vërtetohet jo vetëm përmes dëshmisë së dorëshkrimeve sikur që është ajo: *Sinaïticus* dhe *Alexandrinus*, por edhe përmes dëshmisë së Shën Jeronimit, Origenit si dhe versionit të Cruetonit. Mungesën duhet llogaritur si leksion të *lashtë* [vjetër], derisa *interpozicionin* si shkallë të lartë të leksioneve të *perëndimit* e cila na paraqitet edhe në: *Codex Bezae*, *Vetus latina*<sup>133</sup>, *Vulgata* etj. Një ndikim i tillë i dyfishtë ka lënë gjurmë edhe në *Codex Beratinus*, shtesa është me vend; por, në vend se të shkrihet me tekstin, ajo lë gjurmë të dukshme, posaçërisht pas përsëritjes: “ai duke m’u përgjigjur pohonte.”

2. Rastet e tjera na tregojnë pak a shumë mënyrën përmbajtësore, kombinimet e ndryshme të një tradite të njëjtë.



Te Mateu XXIV, 45, ndeshim dy tradita, që për njëjërën lexohet: “bashkëbanuesve të tij”, ndërsa për tjetrën: “për shkak të nderimit ndaj tij”. Te *Beratinus* do të ndeshim të dy leximet, dhe sipas tij do të kemi: “për shërbëtorin e shtëpisë.”

3. Te Marku, II, 18, leksioni është i dyfishtë. Në dorëshkrimet më të vjetra lexojmë: “Nxënësit e Gjonit dhe farisejtë,” ndërsa në dorëshkrimet më të reja lexojmë: “dhe ata nga farisejtë.” *Beratinus*, njëkohësisht është i lidhur me të dy leximet; dhe në të është [lexojmë]: “Nxënësit e Gjonit dhe ata nga farisejtë.”

4. Te Marku, VI, 17, ndodhen edhe dy leksione të tjera:

“e kapin Gjonin dhe e fusin në burg” - leksioni i parë; “E lidhin dhe e fusin në burg” - leksioni i dytë, i Perëndimit. Në *Beratinus* shkruan: “e kapin Gjonin dhe e fusin në burg,” dhe me këtë kemi edhe nga një *conflate reading* të leksionit të parë dhe atij të Perëndimit. Vërejmë kalimthi se *conflate reading* e tyre është e ngjashme me versionin *Peschita*.

5. Ja dhe rasti i fundit:

Te Marku, X, 21, lexojmë, me një numër të madh në korsiv dhe me një kualitet të lartë, disa unicial-e (K, M, N, P), “dhe i thotë: Dëshiron të jesh i përkryer, të mungon vetëm,” ndërsa leksioni i vjetër: “dhe i thotë, të mungon vetëm,” ndërsa *Beratinus* ka një variant mjaft të çuditshëm: “dhe i thotë nëse dëshiron, të mungon vetëm.” Nuk shikoj asnjë shkak që “nëse dëshiron” dhe prania e tij, të mund të shpjegohet, sipas mendimit tim, vetëm në dy mënyra: ose shkruesi e ka harruar [tejkualuar]: “të jesh i përkryer”, ose nuk ka dëshiruar të fshijë: “nëse dëshiron”. Në rastin e parë, bëhet fjalë për një gabim të rëndë të shkruesit, për një shkruesi kaq të kujdesshëm; në rastin e dytë, kjo është shenjë e mungesës së kujdesit dhe kritikës. Nuk mund të marr guximin që me të dhëna kaq të pakta të jem i sigurt për t’i vënë në dyshim;

por besoj se ato që janë në vijim mund të vënë jashtë çdo dyshimi dhe konkurrence të dyja traditat, të cilat i kemi zbuluar te një numër i vogël i *conflate reading*, nëse nuk do të ishte e mundur të tregohen qëllimet kritike, të shkruarit të dorëshkrimit tonë.

Një vëzhgim i veçantë është i domosdoshëm para se të vazhdojmë më tutje. Kur flasim për dy tradita, të cilat bëjnë konkurrencë për t'i shëmbëlyer [ngjarë] tekstit të *Beratinus*-it, nuk mund të mohohet fakti se ekziston një traditë absolute e traditës së tekstit të Testamentit të Ri, gjë që ekziston për disa tekste klasike. Pasiqë të bëjmë një gjysmë përjashtimi për *Vaticanus*-in, për të cilin konsiderojmë se është tregues tipik, i saktë dhe i pastër i tekstit *neutral*, një gjë të tillë mund ta themi edhe për *Codex Bezae*, i cili është përfaqësuesi më tipik i dëshmisë së tekstit *perëndimor*, kjo gjë mund të thuhet edhe për tekstet greke të periudhës së “mirë”, që d.m.th. për ato tekste të cilat, pak a shumë, nuk janë të lidhura as me traditën *siriane*, por nuk janë të pranuar as si tekste; por që janë në një shkallë të lartë botimi *variorum*, repektivisht tekste të përziera.

Të provojmë t'i saktësojmë te *Beratinus*.

Pa u hamundur fare, mund të supozojmë se në sfondin [membranën] e dorëshkrimit Sirian, pjesa dërmuese e leksioneve është në favor të leksioneve të Perëndimit. Do të ishte shumë e vështirë, për të bërë një regjistër të saktë; por do të kufizohem në regjistrin e atyre përgjithësisht më të njohurave.

Mateu, VII, 21, “Atit tim në qiell (ai do të shkojë në mbretërinë qiellore).”<sup>134</sup>; X, 12, “Përshëndeteni (duke thënë: paqe në këtë shtëpi!).”<sup>135</sup>; XII, 10, “dhe ja ishte (aty) njeriu.”<sup>136</sup>; XIV, 2, “Nuk është ai Gjoni (Pagëzuesi të cilit unë, kam dhënë urdhër t'i shkurtohet koka.”<sup>137</sup>; XVII, 1, “dhe (ndodhi) pas disa ditësh.”<sup>138</sup>; XVII, 10, “nga këta (të cilët më besojnë mua).”<sup>139</sup>; XVIII, 12, “dhe çfarë mendoni ju.”<sup>140</sup>; XX, 28, “shpërblim për shumë (edhe ju kërkonte që nga i vogli të bëhet i madh dhe i madhi të bëhet i vogël. Kur të hyni dhe të ftoheni në gosti, mos u ulni në tryezë në ato vende në të cilat bini në sy, që asnjëherë të mos ju afrohet ndonjë i shquar, do të afrohet një i ftuar i vogël dhe do të thotë: ejani më lart, dhe kjo do të jetë e dobishme). Kur kanë dalë.”<sup>141</sup>; XXI, 9, “Në lartësi (i vinin në takim shumë, duke ju gëzuar dhe lavdëruar Zotin, për të gjitha ato që kishin shikuar).”<sup>142</sup>; XXVII, 35, “(Që të përmbushen ato të cilat i ka thënë profeti, dhe ju të shpërndani rrobat e mia, dhe pas rrobave të hidhni eshtrat).”<sup>143</sup>; XVII, 40, “dhe ata folën (fatkeq) që e rrëzoj.”<sup>144</sup>.

Marku, II, 23, “dhe (prapë) ajo ndodhi.”<sup>145</sup>; II, 24, “Shiko çfarë (nxënësit tu) bëjnë në dhomë.”<sup>146</sup>; II, 26, “Pos (vetëm udhëheqësve) priftërinjve.”<sup>147</sup>; III, 14, “(dhe i emëron apostuj).”<sup>148</sup>; IV, 31, “Është kokrra më e vogël nga të gjitha.”<sup>149</sup>; VI, 2, “dhe shumë nga ata që e dëgjuan ishin të entuziasmuar (me mësimin e tij), folën.”<sup>150</sup>; VIII, 14, “dhe (nxënësit e tij) harrojnë të marrin me vete.”<sup>151</sup>; VIII, 17, “çfarë mendoni në zemrat tuaja,” “të pabesë.”<sup>152</sup>; VIII, 26, “I flet: (shko në shtëpinë tënde, në fshatin tënd).”<sup>153</sup>; VIII, 34, “(ik) me mua.”<sup>154</sup>; IX, 21, “Pyet Jezusi,” shtojca: “Jezusi.”<sup>155</sup>; XI, 13, “(vetëm) fletë gjethi.”<sup>156</sup>; XI, 31, “dhe ju flet: çfarë të themi? Nëse themi.”<sup>157</sup>; XII, 38, “në sheshe (punohej).”<sup>158</sup>; XII, 43, “ajo e varfra.”<sup>159</sup>; XIII, 19, “fatkeqësitë e tilla që asnjëherë më parë nuk kishin ndodhur.”<sup>160</sup>; XIV, 41, “afër është (fundit), erdhi ora.”<sup>161</sup>; XIV, 61, “dhe e pyeti (për së dyti) duke folur.”<sup>162</sup>.

Këto leksione të cilat tash i cituam janë të mjaftueshme që të konstatohet tipi *perëndimor* i elementeve të ndryshme të *Beratinus*-it; në përpjesëtim më të vogël me të tjerat. Të shikojmë tashi edhe leksionet për të cilat mund të mendohet se janë të lashta [vjetra] dhe *joperëndimore*. Në këtë frymë do të shqyrtojmë shembujt në vazhdim:

Mateu, VI, 10, “në tokë.”<sup>163</sup>; VI, 25, “çfarë do të hani (ose) çfarë do të pini.”<sup>164</sup>; VII, 24, “(do të jetë) njeriu do të jetë i barabartë dhe i arsyeshëm.”<sup>165</sup>; VIII, 13, “shko, dhe ashtu siç ke besuar,”<sup>166</sup>; VIII, 13, “dhe kur kapiteni [centurioni] u kthye në shtëpinë e tij, gjen djalin e tij të shëruar.”<sup>167</sup>; XIV, 19, “nëpër bar.”<sup>168</sup>; XVI, 20, “Ky është Krishti.” pa [mungon] “Jezusi.”<sup>169</sup>; XVIII, 7, “anija, megjithatë iku.” Është hequr: “ka.”<sup>170</sup>; XIX, 5, “Atit (të tij);” Dhe shton: “atij.”<sup>171</sup>; XXII, 25, “martohu.”<sup>172</sup>; XXIV, 48, “do të shkoni.”<sup>173</sup>; XXVI, 8, “vaj i bekuar.”<sup>174</sup>; XXVIII, 19, “Ikni pra.”<sup>175</sup>.

Marku, III, 4, “*Kanë heshtur.*”<sup>176</sup>; IV, 11, “*fshehtësi.*”<sup>177</sup>; IV, 31, “*kokërr.*”<sup>178</sup>; VII, 11, “*nëse.*”<sup>179</sup>; VIII, 15, “*shikoni (dhe) vështroni,*” Shtojcë: “*dhe.*”<sup>180</sup>; IX, 30, “*prej nga është.*”<sup>181</sup>; XII, 28, “*vëzhgoni, shikoni.*”<sup>182</sup>.

Me këtë çfarë kuptojmë nga leksionet, të cilat sapo i cituam, është se teksti i **F**, i cili sipas origjinës *sirik* [kjo është një pikë e pakundërshtuar], me shumicë ka pranuar edhe variante *parasirike*, qofshin ato të tipit Perëndimor - këto janë më të shumtat - qofshin ato të tipit joperëndimor. Së bashku me këtë, pjesa josirike te **F** paraqet karakter analog me pjesët *josirike* te **N**, te **S**, dhe te prototipi nga i cili rrjedh korsivi 13, 69, 124 dhe 346; këto janë fakte të cilat statistika pa ndonjë problem mund t'i vërtetojë; por për të cilat edhe citimet e mëparshme janë të mjaftueshme.

Ndoshta mund të bëjmë edhe një hap përpara. Mund të thuhet se disa koincidenca të **F** me **N** dhe **S**, ose me: 13-69-124-346, me siguri rrjedhin nga një tip [rrënjë] i përbashkët, që në momentin e caktuar, drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte, kanë qenë të ndikuara. Po janë në shtojcë edhe disa raste të koincidence, të cilat do ta mbështesin këtë vëzhgim:

Mateu, XXIV, 18, “*mbrapa në.*”<sup>183</sup>; XXII, 38, “*e para dhe më e madhja (madhe).*”<sup>184</sup>; XXIII, 37, “*e vrave.*”<sup>185</sup>; XXVII, 58, “*Trupi i Jezusit.*”<sup>186</sup>; XV, 31, “*që të shurdhërit të flasin.*”. Në pjesën dërrmuese të dorëshkrimeve: “*që të shurdhërit të dëgjojnë,*” dhe: “*që të shurdhërit të dëgjojnë e flasin.*”<sup>187</sup>; XVI, 4, “*dhe ai ju flet dhe ju përgjigjet,*” në: **F**; “*dhe duke ju përgjegjur Jezusi ju flet,*” në: **S**.<sup>188</sup>

Marku, IV, 34, “*nuk ju ka folur asnjë fjalë.*”<sup>189</sup>; X, 5, “*urdhëroi.*”<sup>190</sup>; X, 36, “*dhe Jezusi.*”<sup>191</sup>; XIII, 32, “*në atë moment.*”<sup>192</sup>; XIV, 49, “*Shkrimi i Shenjtë.*”<sup>193</sup>.

Edhe një fjalë në lidhje me trajtën e *Beratinus*-it. Disa trajta janë të lidhura me gabimet e Itacizmit<sup>194</sup>, shkruesi do të shkruajë: **I** për **EI** ose **EI** për **I**; apo **AI** për **E**, ose **w** për **O** dhe **OY**; shumë më rrallë: **H** për **EI** dhe **E**; ose **Y** për **OI**; kjo është shumë e shpeshtë te shkruesi. Por edhe disa variante, të cilat janë lidhura me detaje të dialektit; të cilat në mënyrë shembullore tregojnë përzierjen [ngatërrimet] e tekstit tonë, ngase nuk janë të përhershme<sup>195</sup>. Disa janë të natyrës gramatikore. Lexojmë: *erdhët ju*, [Mateu, XXV, 36]; *le të vijë* [X, 13]; *hyri* [VII, 13]; aoristi [e kryera e thjeshtë] i dytë fiton vazhdimin e të parit<sup>196</sup>, por kjo formë gjendet edhe te *Beratinus*; vetëm në tre raste, të cilat i kemi cituar. Por, çdokund tjetër gjejmë formën e zakonshme: *keni ardhur; eja; keni dalë*; [Mateu, XXVI, 55; V, 10; XXVI, 39; Marku, XIV, 48, etj.]. Variantet e tjera janë drejtshkrimore. Lexojmë: *Moisi, Mateu, Zebedi, Bartolomeu, Alfeu, Lebedi, Tadej, Gomora, Genezarët, Eli, gjuajtje me gurë [?] Cezareu, shërbëtorët, i kanë shikuar, e ka shikuar, farisej, saducej, Ilija, Pilati, Galileu, vështruar, marrë.*

\*

\* \*

Në fund, lëshimet të cilat asgjë nuk mund t'i arsyetonte; lëshimet të cilat do të ishin për të falënderuar personat të cilëve u jam më së shumti mirënjohës, për misionin dhe për këtë punim. Miku im, Sauvaire, konsull francez në Janinë, profesori im Edouard Tournier, docent në *Ecole des hautes études*, posaçërisht, Deslile, me ndihmën e të cilit janë shtypur këto faqe, dhe në veçanërisht F. J. A. Hortit nga Cambridge-i, modestia e të cilit nuk lejon që unë t'iu prezantoj sugjerimet dhe vërejtjet, të cilat m'i bëri, si dhe ndihmën e çmuar dhe të pakursyer për njohjen e Testamentit të Ri. Të gjithë tashti le të urdhërojnë të pranojnë shprehimisht falënderimet e mia të zjarra.

Paris, nëntor, 1885

#### Shënime plotësuese<sup>197</sup>

Faqe 13, referenca 2. Personi për të cilin bëhet fjalë për këtë kontribut: “Gjon Engjëlli, daja i të mirënjohurit mbret, Teodor Komnen Laskaris”, është vështirë për t'u identifikuar. Pasiqë jam hamendur, rreth emrave të ndryshëm, mendoj se mund të ndalem në supozimin në vijim. Ky Teodor Komnen Laskari ishte ai mbret që, pasi latinët e morën Konstantinopojën më 1206, bëri ringjalljen e mbretërisë bizantine në Nike [Nikopolis?!]. Nuk e njohim gjenealogjinë e këtij Teodorit të parë (Ducange, *Hist. byz.*, f. 218), por dimë

se ka hipur në fron në saje të martesës me princeshën Anë, vajzën e mbretit Aleksi i 3-të Komnen (1195-1202), ndërsa ky nuk kishte trashëgimtarë meshkuj. Megjithatë, Aleksi 3-të kishte dy vëllezër, nga të cilët Isaku 2-të i parapriu në fron (1185-1195), ndërsa atë për një kohë të shkurtër e trashëgoi (1203-1204), derisa i dyti, i njohur me emrin Gjon Engjëlli (Ducange, f. 203). Mos ky Engjëlli ishte murg? Kjo ka shumë të ngjarë. Për çdo rast, na është e qartë se shkruesi nuk i kishte dhënë tituj të tjerë, pos atij “dajë i Teodor Komnenit”, nip i tij nga martesë; duke marrë parasysh se nga njëra anë ishte më i njohur se vëllezërit, ndërsa nga ana tjetër, ndoshta, ende ishte në pushtet kur u shkrua ky kontribut në dorëshkrimin i cili i ishte dorëzuar Eleusus-ës.

Faqe 17, referenca 4. Njëri nga korrespondentët e mi më pyet: kur është krijuar dhe nga kush, legjenda për autografin e Shën Gjon Gojartit: nga *Codex aureus* apo nga *Codex F*? Nuk ka dyshim se është krijuar nga *Codex F*; për këtë kemi dëshmi në përkujtimoren e diptikut të Kishës së Shën Gjergjit: “*katër ungjijtë, të shkruar me dorën e Shën Gjon Gojartit, në argjend,*”, si dhe shënimin që ruhet në faqen e kopertinës së *Codex*-it të përmendur. Si është e mundur atëherë që *Codex aureus* të jetë llogaritur [të jetë mveshur autorësia] si i Shën Gjon Gojartit? Kjo gjë, në fakt është për shkak se i përmenduri [*Codex aureus*] në Berat ishte i vetmi që ekspozohej hapur, si pronë e kishës, në shërbim të plotë; derisa *Codex F* ruhej me kujdes të veçantë në dollapet e shtëpisë së ipeshkvisë dhe asnjëherë nuk ishte i ekspozuar “*puthjeve të të krishterëve të cilët vështronin nga të gjitha anët.*” Sikur të mos ishte i fshehur nga sytë e publikut [popullit], për shkak të natyrës së tij, d.m.th. gjendjes së mirë dhe i tëri në flori. *Codex aureus* tashmë e kishte tejkaluar *Codex F*; shkak për këtë ishte, më duhet ta pranoj, foshnjor; por, sikur edhe besimi për të cilin është fjala. Imzot Alexoudis, me ndërjegje të plotë e ka përshkruar, duke mos mundur të vendosë se me cilin nga dorëshkrimet, me të drejtë, duhej ta bashkangjiste; çdonjëri do t'i kuptojë arsyet e një rezevimi të tillë.

<sup>1</sup> Botuar për herë të parë në Paris, më 1886, nga *Imprimerie Nationale*, me titullin në origjinal: “*Les manuscrits grecs de Bérat d’Albanie et le Codex Purpureus F*”. Të gjitha shënimet shpjeguese të brendashkruara në kllapa katrore dhe ato me korsiv në fusnotë janë të redaksisë. Janë të redaksisë edhe shënimet shpjeguese a saktësuese brendashkruar në kllapa katrore në fusnotat e autorit.

<sup>2</sup> Berati në antikitet përmendet vetëm njëherë, nga Tit Livi (XXXI, 27). Gjithsesi, duhet të kemi parasysh se Antipatrea mund të jetë Berati i sotëm [lidhje kjo tashmë e provuar nga shkenca shqiptare]. Megjithatë, sipas mendimit tim, kjo gjë nuk është shumë e sigurtë, ngase Antipatrea gjendet në dalje të qafëmalit Apsus. Qendra ipeshkvnore e Beratit paraqitet menjëherë pas zhdukjes së ipeshkvive në Byllis, Apolloni, Amantia, Kaninë dhe Vlorë, d.m.th. në shek. XV. Shih: Lequien, *Oriens Christianus* (1740), vëllimi II, shënimi për dioc. *Illyricum*.

<sup>3</sup> Georges Pachymera bën një përkthim të saktë të Beratit në: *Hist. Michael. Palæolog.*, 1. VI, c. XXXII. - Migne, *Patr. Grec*, vëll. CXLIII, col. 971. Sipas, Leake, *Travels in Northern Greece* (Londer, 1835), vëll. I, f. 359, dhe Margaritis Dimitza, *Arcaia gjeografia thV MakedoniaV* [“Gjeografia e vjetër e Maqedonisë”], (Athinë, 1870), në kapitullin: “Belegrade”.

<sup>4</sup> Në veprën *Mémoires*, botim i Sinodit të Stambollit.

<sup>5</sup> Nga koleksioni i tij kemi botuar një medalion bronzi dhe një objekt qeramike në: *Bulletin de la Société des antiquaires de France*, 1885, f. 220. Miku ynë, Beurlier, këtë e ka shoqëruar me dy vizatime dhe një koment arkeologjik përkatës.

<sup>6</sup> Ky vlerësim i Batiffol-it ka ndryshuar, me vërtetimin e lidhjeve dhe të vazhdimësisë kulturore prej Antipatrea-s antike tek Berati historik. Në vitin 1989 u festua 2400-vjetori i themelimit të këtij qyteti.

<sup>7</sup> Nuk më është e njohur që ndonjëri nga udhëpërshkruesit që kanë vizituar Epirin të ketë përmendur dorëshkrimet e Beratit; këtë nuk e ka bërë as Pouqueville (*Voyage en Grèce*, Paris 1820-1822); as Leake (*Travels in Northern Greece*, Londer, 1835); as Gaultier de Claudry (*Guide d’Isambert*, 1876, f. 857); as von Hahn (*Albanesische Studien*, Jena, 1854.); as Aravandinos, (Cronografia thV Hpeirou, [Pasqyrë historike mbi Epirin], Athinë, 1856-1857); as Gillieron (*Grèce et Turquie*, Paris, 1877); as Knight (*Albania*, Londër, 1880.); as de Gubernates, siç më provuan të tjerët [Me sa duket Batiffol nuk kishte dijeni për sa ishte shkruar nga Pouqueville për Kodikun e Gjirokastrës].

<sup>8</sup> *Bulletin critique*, 15 prill 1881, vëll. 1, f. 451, referenca nr. 1: “*Nënshkruesi i këtyre radhëve kishte kënaqësinë që të njoftojë për ekzistencën e kopjes së pestë të dorëshkrimit greqisht, të shkruar me shkronja argjendi në pergamenë dhe në ngjyrë purpuri. Sikur edhe dorëshkrimi i Rossana-s, edhe dorëshkrimi i përmendur përmban tekstin nga Ungjilli sipas Mateut dhe sipas Markut*”.

<sup>9</sup> *Novum Testamentum græce* (ed. oct. crit. major) nga Tischendorff, vëll. III, *Prolegomena* nga R. Grégory

(1884), f. 409, referenca nr. 2.

<sup>10</sup>Ja titulli i origjinalit:

Συνομοῦ ἱστορικῆς περιγραφῆς τῆς ἱεραῦς μητροπόλεως Βελεγραδῶν καὶ τῆς ὑπο τῆν πνευματικὴν αὐτῆς δικαιοδοσίαν ὑπαγομένης ὡραῖς νῦν πρῶτον συνταχθεῖσα καὶ ἰδιοῖν ἀναλῳμασι τυποῖν ἐκδοθεῖσα ὑπο τοῦ μητροπολίτου Βελεγραδῶν Ἀρχιμωυ Δ. Ἀλεξοῦδῆ τοῦ ἐκ Μαδύτων τῆς Ὀπάκικῆς Ἐκκλῆσιας; ἐν Κερκωρα; τυπογραφεῖον ἡ Ἰωνία ἀδελφῶν Κωνσταντῶν;

[Pëshkrim i shkurtër historik i Mitropolisë së shenjtë të Beratit; dhe kohës së kaluar në drejtimin e saj shpirtëror, i cili tashti për herë të parë, del i rregulluar dhe i botuar me shpenzime të shtypit nga ipeshkvi [mitropolit] i Beratit, imzot Anthime D. Alexoudis, nga Maditona në Herzzonezeun trakas. Në Kretë, shtypshkronja “Jonija” vëllezërit Kaon, 1868].

<sup>11</sup> *Kuvend ipeshkvnor.*

<sup>12</sup> Shiko shitesën në vetë tekstin e Menoudisit.

<sup>13</sup> Shiko gazetën: *Ἐβδομαῦ* [Java], nr. 14; korrik 1885.

<sup>14</sup> Shiko, Sathas, *Bibliotheca græca mediævi*, vëll. III (1872) f. XCVII.

<sup>15</sup> Asnjëri nga të 11 dorëshkrimet nuk është i firmosur.

<sup>16</sup> I njëjti person më ka rrëfyer edhe për një kishë në Gjirokastër [Argyroa Kastroa], e cila kishte një ungjill që nga shekulli i parë [1-rë]. Më ka munguar besimi për të udhëtuar deri në Gjirokastër, për të njohur dhe shikuar një relik t kaq të çmuar.

<sup>17</sup> Krahaso: Bordier, *Description des peintures et ornements des manuscrits grecs de la Bibliothèque Nationale* [Përshkrim i pikturave dhe dekorimeve të dorëshkrimeve greke nga Biblioteka Nationale e Parisit], 1884, f. 129, përshkrim nga: *Suppl. gr. 75*.

<sup>18</sup> Këto copëza të vogla mëndafshi janë vënë si mbrojtëse të pikturave. Ndodhen edhe në disa dorëshkrime të tjera. P.sh., në Bibliotekën Kombëtare [Paris] në dorëshkrimet greke, nr. 351, 1242, etj.

<sup>19</sup>To parῶν ἁγίων εὐαγγελίων ἐδοξε πρῶτῃ τῆν ἁγίαν μονὴν τῆν Ἐλεοῦσαν ἠτοῖ τῆν Νεῶν Μονὴν παρα τοῦ περιόχου γείου τοῦ φαίδιμου βασιλεῦς κωρου Γεωργίου Κομνηνοῦ τοῦ Λασκαρεῶ, Ἰωαννοῦ τοῦ Ἀγγελου τοῦ μετονομασθέντος δια τοῦ ἁγίου καὶ ἀγγελικοῦ σχήματος Κωνσταντῶν Κωνσταντῶν. Καὶ οἱ ἀναγινωσκόντες τούτου εὐεσεῖ ἑαυτῶν δια τῶν Κωνσταντῶν ἰνα καὶ οἱ Γεοῦ ἐλεῖσῃ ἡμῶν.

<sup>20</sup> Në një dëshmi [diploma] të shekullit të 11-të gjejmë Kuvendin e Eleoussas [Eluesinë?], nën pushtetin e ipeshkvisë së Mesembrisë; (Miklosich dhe Müller, *Acta patriarchatus, C. P<sup>ani</sup>*, vëll. II, dok. 351) por si ta krahasojmë me tonin? Veçanërisht kur dihet se ka ekzistuar edhe një Eleoussa në Napoli. (Sathas, *Bibl. gr. medii ævi*, III, 55g, sipas dokumentit nga viti 1611), si dhe Nea Monh [Kuvendi i Ri] në Hiju; (Miklosich dhe Müller, *Acta et diplomata græca*, vëll. III, f. 261). Për identifikimin e Komnenit të përmendur, i cili është bërë murg, shih: *Notes additionnelles* [Shënime plotësuese].

<sup>21</sup> Krahaso, *Parisinus gr. 660*. (Bordier, *vepër e cituar*, f. 196).

<sup>22</sup>Wattenbach, *Das Schriftwesen im Mittelalter* (1875), f. 110, Gardthausen, *Griechische Palæographie* (1879), f. 85. Shih studimin: *Chrysographia*, nga Grau në: *Dictionnaire des antiquités* [Fjalor i antikitetit] nga Darembergu dhe Saglia.

<sup>23</sup> J. Belsheim, *Das Evangelium des Marcus nach dem griechischen Codex Theodoræ*, Christiana, 1885; shiko: Papadopoulos, *Palacographikon Deltion* (Stamboll, 1885), f. 5.

<sup>24</sup> Grégory, *Prolegomena*, f. 384.

<sup>25</sup> Shih: Fabricius, *Bibli. eccls.* 1712, f. 58; Héfélé, *Histoire des conciles* [Histroiku i Koncileve, botimi francez] vëll. I, f. 250; Bordier, *Description*, f. 205; shih: *Coislin*, f. 239.

<sup>26</sup> Wattenbach, *vepër e cituar*, dhe Westwood, *Palæographia sacra pictoria*, studim në: *Purple greek mss*. Shih: Gebhardt dhe Harnace, *Evangeliorum Codex Bossanensis, seine Entdeckung ...* (1880), f. 5, dhe nga të njëjtët: *Texte und Untersuchungen zur Geschichte der altchristlichen Literatur*, vëll. I, nr. 4, f. 7.

<sup>27</sup> Grégory, *vepër e cituar*, f. 399.

<sup>28</sup> *Ky dorëshkrim, që ruhej në kohën e vizitës së Batifol-it në Berat, është zhdukur pa gjurmë. Nëse ai do të ishte ruajtur, Arkivat e Shqipërisë do të ishin të vetmit në botë që ruanin tre dorëshkrime në pergamenë të purpurt, nga dy që ruhen sot.*

<sup>29</sup> *Zot, përkujto/*

shërbëtorët tuaj Nikollain/

Elenën, Gregorin/

Nikollën, Anastasinë/

Natalinë, Hipatinë/



Zenen, Dhimitrin dhe/

Ane [red.]

<sup>30</sup> Me siguri janë: Anastasia, Natalia, Hipatia dhe Zene, motra nderi [murgesha?]. Për të nxjerrë një përfundim të tillë na shtyn shenja: <sup>x</sup>. Mungesa e çfarëdo titulli pas emrave të Nikollës, Dhimitrit, Grigorit dhe Ane nuk na pengon që të këto figura të dallojmë personalitete të nderuara nga ato të zakonshmet e jetës së atij manastiri murgjish.

<sup>31</sup> *Kisha e fjetjes së shën Mërisë.*

<sup>32</sup> Shiko shtojcën.

<sup>33</sup> *Ngjyrës së kuqe.*

<sup>34</sup> Kapituj.

<sup>35</sup> Kapitujsh.

<sup>36</sup> G. Belsheim (*vepër e cituar*) ka dhënë një fac-simil-e të shkëlqyer të *Codex Theodoræ*. Pjesa tjetër e këtij punimi nuk është shumë e vlefshme. Në të vërtetë është e pakuptueshme që *Codex Theodoræ* të jetë i shekullit të 9-të; dorëshkrimi nuk mund të jetë më i vjetër se fundi i shekullit 10-të apo fillimi i shekullit të 11-të (*Revue critique*, 1886, f. 201). G. Watenbach, i cili ka studiuar dorëshkrimin origjinal, mendon se është nga shekulli i 12-të (*Anzeiger für die Kunde der deutschen Vorzeit*, 1875, f. 72), mendim ky, të cilin vështirë se mund ta mbrojë njeri.

<sup>37</sup> Cardthausen, *Greichische Palæographie*, f. 184.

<sup>38</sup> *Jashtë çdo dyshimi tashmë është provuar se ky dorëshkrim është jo më i vonët se shekulli i nëntë.*

<sup>39</sup> Ungjillori është paraqitur i ulur, me libër në gjunjë, nuk është i shënuar asnjë element i orendive. Vizatimin, të cilin e ka botuar Bordier (*vepër e cituar*, më lart), f. 219, paraqet një formë të zbukuruar.

<sup>40</sup> *Në Fondin 488 është Kodiku i 27-të i Beratit ku është ruajtur pikërisht ky shënim.*

<sup>41</sup> monh.

<sup>42</sup> Në të njëjtën datë *de Muralt* bën fjalë për invazionin e grekëve nga Mbreti Etjen [sic! - me siguri forma frënge e emrit Stefan, Stepan] Urosh, sipas Miklosich-it, *Monumenta Serbica* (1858), CXL. Shih: *Essai de chronographie byzantine*, vëll. II (1871), f. 655, *ad. ann.* 1356-1357. [Autori, me sa duket, e shënon fjalën: “kral” - (shqip: mbret) - pa e njohur mirë domethënien e saj]. Për historinë e serbëve në Epir në shekullin e 14-të, shih: *Istorikon [Historia] e murgjëve Komnen dhe Prokl*, të cilën e ka ribotuar Destounis, Sankt Petersburg (1858), f. 5, në të cilën Berati përmendet posaçërisht.

<sup>43</sup> tetraeuaggelion to oikeyocean tou Crusostomou ashmografon.

<sup>44</sup> Në komentin e tij të pabotuar të diptikut të përmendur, *Alexoudis-i*, shkruan gjithashtu: “h iera bibloV auth esti kthma tou ierou naou thV panagiaV euaggelistriaV en th auth sunoikia tou Kastrou swzomenou”, duke përmendur gjithashtu *Codex aureus*. [Ky libër i shenjtë [Bibla] është pronë e kishës së shenjtë të shën Mërisë, mbrojtëse e kësaj famullie në Kala]. Shih: Alexoudis, *vepër e cituar*, f. 113.

<sup>45</sup> ashmografon.

<sup>46</sup> AshmografoV= *cui incumbit argenteae suppellectilis cura*. Ducange (*Gloss. m. i inf. gr.*, vëll. 1, f. 139), sipas Syropoulosu, historian i Koncilit Firentinas; në tekstin tonë, siç mund të vërehet, ka një kuptim tjetër: No ashmon [i pazëvendësueshëm, i pa shtypur] është gjithashtu sinonim për: arguroV [argjend] si mund të kuptohej në frymën mesjetare shpirtërore greke (Sophocles, *Greek lexicon of the roman and byzantine periods*, f. 261).

<sup>47</sup> argurogegrammenon.

<sup>48</sup> *Mélanges de l'Ecole française de Rome* (1885), f. 362. Një mendim dhe interpretim të tillë e mbështes edhe në sikurse Sakkélion-i në EbdomaV [Java], *vepër e cituar*, f. 407).

<sup>49</sup> Imzot Alexoudis-i e ka botuar në studimin e tij; në shtojcë; *vepër e cituar*, f. 114, referenca nr. 1. Ja përkthimi tekstual: “*Adspicite, o spectatores, sancti Iohannis Chrysostomi litteras praesentis huius evangelii quas ipse descripsit cum esset Antiochiae in sua patria diaconus evangelii. Usque ad illius tempora scribebatur a plerisque solutae litterae, sed non eo pervenit ut notaret virtutes verborum signis aureis, scilicet accentibus et spiritibus ... Cum vero per partes distincta essent quatuor evangelia, accidit ut praesens evangelium Matheo et Marco constet, Lucas autem et Iohannes separatim exierint. Conditor enim Theologi ea intulit in suum monasterium visionis gratia et miraculi tantum in honorem beati Chrysostomi et in eiusdem amoris quo flagrabat erga Christum. Solutio autem praesentis evangelii facta est quo tempore Franci cognomine Campanenses vastaverunt libros Theologi Adspicite colorem chartarum mirabilem, et pulchritudinem litterarum. Sed et evangelium Theologi, scriptum in Patmo solutas item habet litteras, sicut ipse vidi meis oculis Ephesi.*” [Shikoni, ju që do të lexoni, shkronjat e këtij ungjilli të Shën Gjon Gojartit, të cilat ai vetë i ka shkruar, kur ishte në vendlindjen e tij në Antioki si meshtar i ungjillit. Çdo gjë deri në kohën e tij rregullisht është shkruar me shkronja të ndara, dhe për

këtë shkak nuk ishte praktikuar që me shenja floriri të shënoheshin fjalët dhe shenjat... Fakti se, në të vërtetë, të katër ungjijtë ishin të ndarë në pjesë-pjesë, na bën të kuptojmë se ky ungjill përbëhet vetëm nga ungjijtë sipas Mateut dhe sipas Markut; ndërsa Luka dhe Gjoni ishin të veçantë. Në të vërtetë, themeluesi i “Théolog-ut” këta të dy ungjijë i kishte marrë në manastirin e tij vetëm për t’i shikuar dhe për t’u kënaqur duke i admiruar në shenjë nderimi për Shën Gjon Gojartin, duke treguar dashurinë e tij të madhe që kishte ndaj Krishtit. Dëmtimi i këtij ungjilli ka ndodhur në kohën kur frankët, me emrin Kampanjët [Champange], i kanë shkatërruar librat e “Théolog-ut”. Shikoni ngjyrën e jashtëzakonshme të letres dhe bukurinë e shkronjave. Por ungjilli i “Théolog-ut”, që është shkruar në Patmos, gjithashtu i ka shkronjat të ndara, sikur që i kam shikuar me sytë e mi në Efes.

<sup>50</sup> *Shekulli i kaluar në këtë rast është shekulli i 18-të, ngase Batiffol-i e shkroi librin tij në shekullin e 19-të.*

<sup>51</sup> *Term në paleografi; përdoret për të identifikuar një stil të shkruari me dorë, që karakterizohet nga përdorimi i germës së madhe kapitale gjatë gjithë tekstit, pa ndarje të fjalëve nga njëra-tjetra, pa shenja pikësimi dhe pnevma, shkrim i karakterizuar si imperial - për shkak të ekskluzivitetit të përdorimit të tij fillimisht për perandorët dhe më pas për shkrimet e shenjta. Shkronjat e këtij stili të shkruari janë të papërsëritshme në shkrimet e mesme dhe të vona.*

<sup>52</sup> *Shkronja të ndara /grafema të ndara/.*

<sup>53</sup> Shprehja: “Themeluesi i “Théologu-t” merret pa paragjykime dhe pa përcaktueshmëri tjetër, siç është rasti me diptikon e Kishës së Shën Gjergjit: “to yalthrion tou ktthorov”; [psaltiri i themeluesit].

<sup>54</sup> *Për shkak të një vizioni dhe mrekullie.*

<sup>55</sup> Shprehja vjen nga: Fragkoi Italoï, [frankët, italianët]. Shiko: *Vie de saint Ahtanasios*, [Jeta e shën Athanasit], te: Heuzey, *Mission de Macédoine*, f. 451; pastaj: Italoï [italianët], Pachymere, Gregoras Phrantzes, Nicetas Choniate, etj. Shtojmë këtu se: Kampanhsioi [fj. për fj.: Kampanjezët], nuk gjendet si sinonim vetëm për Kampanoi [frëngjit e Shampanjës], por mund të ishte i njëjtë edhe për “frankët nga Kampanja”, etj.

<sup>56</sup> Shih: G. von Hahn, *Alban. Stud.*, vëll. I, f. 312, dhe: Muralt, *Essai de chronographie byzantine* [Ese për kronografinë bizantine] nga vitet: 1057 deri 1453.

<sup>57</sup> *Të numëtuara.*

<sup>58</sup> Mund të thuhet se vetëm shkronja w, në fund të rreshtave, në disa raste është më e vogël se sa shkronjat tjera; vija qendrore mban lartësinë natyrore, por ato dy anësoret nuk kalojnë gjatësinë e vijës së mesit, kështu që kjo shkronjë merr formën w, formë të cilën ne e gjejmë edhe te *Sinaïticus*.

<sup>59</sup> Cardthausen, *Griechische Palæographie*, f. 150; dhe tab. I.

<sup>60</sup> Tischendorf, *Anecdota sacra et profana* (1855), tab. III-6. Për çfarëdo që i takon shënimit të dorëshkrimit të Testamentit të Ri, referohemi te vepra e cituar nga ne: *Prolegomena* me autorë: C.-R. Gregory si dhe Srivenera, *A plain Introduction to the criticism of the N. T.*, 2. Botim i Cambridge, 1874.

<sup>61</sup> Shih: *Porfirianus Chiocensis O’, Dublinensis Z, le Nitriensis R.*

<sup>62</sup> Shih: *Porfirianus Chiorensis O° i O°, le Patmensis N.*

<sup>63</sup> Kështu është përdorur që në shekullin e 5-të. Shih: Gardthausen, *vepër e cituar*, f. 272.

<sup>64</sup> Vërejtje e njëjtë. Shih: Gregory, *vepër e cituar*, f. 355; për *Alexandrinus*.

<sup>65</sup> Vërejtje e njëjtë. Shih: Gregory, *vepër e cituar*, f. 355; për *Vaticanus*.

<sup>66</sup> mou.

<sup>67</sup> Gardthausen, *vepër e cituar*, tab. I (sipas: *Sinaïticus*).

<sup>68</sup> Gardthausen, *vepër e cituar*, tab. I, f. 152.

<sup>69</sup> Gregory, *vepër e cituar*, f. 386. Gjithashtu në Psaltirin e Zyrihut dhe në *Codex Rossanensis*. (Gebhardt dhe Harnack, *Evang. cod. gr. p. Ross.*, f. XIII).

<sup>70</sup> *Zoti, Jezui, Zotëria [në kuptimin e Zotit], Biri, Krishti, Ati, Nëna, Shpirti, njeriu, qielli, Davidi, Izraeli.*

<sup>71</sup> i.

<sup>72</sup> *Jam, jemi.*

<sup>73</sup> *Dhënë /lejuar/.*

<sup>74</sup> *Vuri.*

<sup>75</sup> *I drejtë, i pafajshëm.*

<sup>76</sup> Këtë shenjë e gjejmë tek *Rossanensis* (Gebhardt dhe Harnack, *vepër e cituar*). Vërejmë se shkurtesat te *Beratinus* janë më të pakta se sa ato te *Rossanensis*. Gjithashtu mund të vërejmë se shkurtesa: K, që është e shumë e rrallë te *Rossanensis*; në të vërtetë është shumë e shpeshtë që nga shekulli i 5-të. (Gregory, *vepër e cituar*, f. 341). Për të më shumë shih: Gardthausen, *vepër e cituar*, f. 244.

- <sup>77</sup> Tischendorf, *Monumenta sacra ined. nov. coll.* Völl. I, tab. 1-6. Këtu mund të vërehet shkrimi fragmentar i Palimpsestit, nga Aktet: *Petropolitanus I*<sup>6</sup>.
- <sup>78</sup> Scrivener, *A plain Introduction ...*, f. 145.
- <sup>79</sup> *kefalaia*.
- <sup>80</sup> *kefalaia*.
- <sup>81</sup> *kefalaia*.
- <sup>82</sup> Tischendorf, *Monum. sacra incl. hoc. coll.* (1869). Völl. VII, f. XII. Kemi pasur fatin të gjejmë një faksimil të *Guelferbytanus P*, *vepër e cituar*. Völl. III (1860), tab. III.
- <sup>83</sup> *kefalaia*.
- <sup>84</sup> Gebhardt dhe Harnack, *Text und [.. ubi supra]*, f. XXV. Shih: Gregory, *vepër e cituar*, f. 409.
- <sup>85</sup> Gregory, *vepër e cituar*, f. 408-409.
- <sup>86</sup> *kefalaia*.
- <sup>87</sup> *Beratinus*.
- <sup>88</sup> *Rossanensis*.
- <sup>89</sup> *Beratinus*.
- <sup>90</sup> *Rossanensis*.
- <sup>91</sup> *Patmiensis* përmban vetëm 60 rreshta për kolonë; *Petropolitanus Cæsareus* dhe *Porfirianus Chiovenensis* (= O<sup>e</sup>), numërojnë nga 80 rreshta: për të tri dorëshkrimet e tyre, mendohet se janë nga shekulli i 6-të.
- <sup>92</sup> *Theologische Literaturzeitung*, 1885, f. 603. Studimi i O. von Gebhardt; botuesi shkencor i *Rossanensis*, mendon se *Codex F*, është më i ri se *Codex S*, për të është më e "sigurtë" ta vendosë në shekullin e 7-të.
- <sup>93</sup> Për këtë term në studimet mbi dorëshkrimet kishtare në gjuhë të ndryshme janë përdorur idioma që kuptimisht nuk barazohen me njëra-tjetrën: *lectionary* (angl.); *Lectionaren* (gjerm.); *perikope* (gr.). *Beratinus* përmban dy ungjij të plotë dhe në këtë rast asnjëri prej termave të mësipërm nuk do të ishte i përshtatshëm, sepse ato identifikojnë fragmente ungjijsh, të renditur sipas radhës kalendarike të shërbesave dhe të referuara ndërmjet tyre (midis dy, tre ose katër ungjijve). U ruajt termi i përdorur nga autori, ndonëse këtu ka kuptimin "pjesë", por pa qenë vetë dorëshkrimi një perikope.
- <sup>94</sup> P.sh. Mateu, XVII, 4, XVII, *poihswnen wde triV shknaV* (su) kai mwush mian, [do të bëjmë këtu tri tenda, ty Mesi një]. su [ty] është natyrisht në vend të soi [ty]; ose si në disa zhvendosje si p.sh. Mateu, XVII, 24 *proselqon tw petrw oi to didracma lambanontev*. [i bashkohen Pjetrit ata të cilët në tempull mblidhnin tatime].
- <sup>95</sup> Kërkuar, duke pyetur, është e shënuar me korsiv, 5, 123, 124, 218, 219, 220; pastaj a, g<sup>1</sup> dhe h: por edhe F është e vetmi i cili e fuqizon. Shiko: Lk. I, 64.
- <sup>96</sup> Ky leksion është i shënuar në korsiv, 346.
- <sup>97</sup> Mungon: "Im." Gjithashtu: a, ff.
- <sup>98</sup> Gjithashtu në korsiv, 440. Shih: Marku, I, 26.
- <sup>99</sup> Dorëshkrimi ynë është i vetmi, sipas botimit kritik të veprës së *Tischendorfit*, që vë këtë shtojcë në këtë vend. Kështu pas: to de ploion hōh meson thV qalasshV hn [Kur ndodhej në mes të detit], dhe kështu që: apecon [ishte larg] ka të bëjë me: ploion [anijen], e jo me: IhsouV [Jezusin]. Kjo shtojcë është karakteristike e dorëshkrimeve: B, 13, 124, 238, 346. Këtu e gjejmë sipas variantit të cilin shkruesi i F nga pakujdesia e ka vënë në tekst, ndërsa teksti burimor nuk e kishte.
- <sup>100</sup> Shiko Marku, VI, 48.
- <sup>101</sup> Mateu, XXI, 23; XXVI, 3, etj. [Ky leksion gjendet në korsiv në: 13, 124, 346].
- <sup>102</sup> Refren [përsëritje] i zakonshëm te Gjoni. (Iv. I, 53; III, 3; III, 3; III, 5; III, 11, etj.).
- <sup>103</sup> Shih: Mateu XX, 3.
- <sup>104</sup> Si duket kemi të bëjmë me gabim të shkruesit, kur kemi parasysh se: MOI [mua] gjendet para: POI.
- <sup>105</sup> Shih: Marku XI, 2, Luc. XIX, 30.
- <sup>106</sup> Shih: Marku. XI, 3.
- <sup>107</sup> Shih: Gjoni, XII, 15.
- <sup>108</sup> Shih: Luka, XIX, 37 dhe Iv, XII, 15. Mendohet se ky datim i takon dorëshkrimin *Kuretenovit* nga Siria.
- <sup>109</sup> Shih: Mateu XCVII, 19.
- <sup>110</sup> Shih: Marku, XII, 7.
- <sup>111</sup> Shih: Mateu, XXII, 4.
- <sup>112</sup> Shih: Luka, XVII, 35.
- <sup>113</sup> Kjo gjendet në korsiv: 346 dhe 435.
- <sup>114</sup> Shih: Luka, XXII, 71.

- <sup>115</sup> Samuel Berger, më ka përmendur që ky leksion gjendet në këtë vend, në shumë dorëshkrime të Vulgatës. Mund t'i bashkohem mendimit të tij. Kjo gjendet në korsiv: 13, 346. Shih: Luka, XXIII, 25.
- <sup>116</sup> Ka shpëtuar pa u shkruar:  $\bar{\iota}$ , për shkak të rrëmujës me tri shkronjat e fundit nga: *autoiV*. Kjo gjendet në korsiv, 21.
- <sup>117</sup> Kjo gjendet në korsiv, 28.
- <sup>118</sup> Shiko: Mateu XV, 15.
- <sup>119</sup> Kjo renditje e fjalive ndodhet te korsivi, 1, 132 dhe 209.
- <sup>120</sup> Shih: Mateu, CIV, 3.
- <sup>121</sup> Shih: Luka, IX, 12.
- <sup>122</sup> Nga: D, 2, pe, b.
- <sup>123</sup> Shih: Luka, IX, 21.
- <sup>124</sup> Shih: Mateu, XII, 45. Kjo gjendet në korsiv, 124.
- <sup>125</sup> Shih: Mateu, XCVIII, 9.
- <sup>126</sup> Kjo renditje është karakteristike për **F**.
- <sup>127</sup> Kjo ndodhet në korsiv, 435.
- <sup>128</sup> Nuk ndodhet në **F**, me siguri si shkak i ndonjë gabimi. Edhe pse, në fakt, ky është leksioni C.
- <sup>129</sup> Kjo renditje është karakteristike për **F**.
- <sup>130</sup> *O de apokrigeiV eipen autoiV; oyiaV genomenhV legete eudia purrazei gar o ouranoV kai prwi shmeron ceimwn purrazei gar stugnazwn o ouranoV; upokritai to men proswnon tou ouranou gignwskete dikrinein ta de shmeia tw n kairwn ou dnasqe.*
- <sup>131</sup> *oyiaV genomenhV.*
- <sup>132</sup> *ta de shmeia tw n kairwn ou dnasqe.*
- <sup>133</sup> Me emrin: *Vetus latina* njihen përgjithësisht përkthimet latine të para Jeronimit.
- <sup>134</sup> **C\*\***, 33; Cureton, *Vetus Latina*, Shën Cipriani.
- <sup>135</sup> D, 1, 22, 209; *Vetus Latina*.
- <sup>136</sup> D, L, *Vet. Lat.* Cureton.
- <sup>137</sup> D, a, b.
- <sup>138</sup> D, *Vetus Latina*, Shën Hilari
- <sup>139</sup> D, b, c, Cureton; Shën Hilari.
- <sup>140</sup> D, a, Cureton.
- <sup>141</sup> D, *Vetus Latina*, Cureton.
- <sup>142</sup> Cureton. Leksioni i saktë i Curetonit është: “*i dolën në takim.*” Në të gjitha rastet, ky variant është i varur nga Luka, XIX, 37 dhe nga Iv. XII, 13, së bashku.
- <sup>143</sup> D, 1, A, B. Shiko: Westcott dhe Hort, II, *Notes on select readings*, f. 20.
- <sup>144</sup> D, M, D, S, a, b, c. Shën Ambrozi. Shih: Marku, XV, 29.
- <sup>145</sup> D, 12, 69, 124, 346, a, ff, g.
- <sup>146</sup> D, M, S, 1, 28, 13, 69, 124, 346. 2 pe, *Vetus latina*. Shih: Mateu, XII, 2.
- <sup>147</sup> D, 33, 13 [sic!], 69, 124, 346. *Vetus latina*. Shih: Mateu. XII, 4.
- <sup>148</sup> ??, [nuk lexohet te Batiffol. sic!], B, C, Ä, 38, 13, (sic!) 69, 124, 346, (sic!), 328.
- <sup>149</sup> D, *Vet. lat.*
- <sup>150</sup> D, 118, 2 pe. *Vet. lat.* Shih: Marku, I, 22.
- <sup>151</sup> D, 13, 69, 124, 346, (sic!), 28. Shih: Mateu, XVI, 5.
- <sup>152</sup> D, 28, 67, 124. 2 pe, a, b, c. (28, 61, /sic./, 69, 124, 346. 2 pe).
- <sup>153</sup> D, 28, 61, (sic!), 13, 69, 346. 2 pe, a, b, f. Shih: Westcott dhe Hort, II, f. 99.
- <sup>154</sup> D, X, 1, 28. 3 pe. *Vet. lat.*
- <sup>155</sup> Ndodh prap edhe te: N, S, 13, 69, 124, 346. 2 pe, 28, a, c, b.
- <sup>156</sup> C<sup>2</sup>, N, S, 13, 69, 124, 346, (sic!, m. a), 28, 2 pe, b, c, q, r.
- <sup>157</sup> D, 28, (sic!), 13, 69, 124, 346. 2 pe, a, b, c.
- <sup>158</sup> D, 2 pe, (a, e, i, r. Vulgata).
- <sup>159</sup> D, S, 3 pe, a, b, i, q.
- <sup>160</sup> D, 2 pe. *Vet. lat.* Leksioni te **2 pe**, (korsiv 81 te Horti) është sipas Tischendorfit, “*fatkeqësi të tilla që asnjëherë më parë nuk kishin ndodhur;*” G. Belscheim, lexon: “*çfarë.*” Në të vërtetë, rëndësia e këtij leksioni është te përdorimi i shumësit “*fatkeqësitë*” në vend: “*fatkeqësi.*” Dhe në vazhdim.
- <sup>161</sup> D, 13, 69, 134. 2 pe. Itala. (sic!).
- <sup>162</sup> 13, 69, 124, 346. 2 pe, c, ff\*.
- <sup>163</sup> Nga: B, N, Z, Ä, Ó, 1, 32, 406, Clem. Orig.

- <sup>164</sup> Nga: B, 3, 124, (sic!), 33. Origéne.
- <sup>165</sup> Nga: B, N, Z, 1, 13, 124, (sic!), 22, 33. Versioni Sahidik. Origen, etj.
- <sup>166</sup> Mungon “7” Nga: B, N. Te sahid. dhe memph.
- <sup>167</sup> [kështu, me këtë renditje është te Batiffol]. Nga: C, N, M, U, X, 124.
- <sup>168</sup> Nga: N, B, C\*, I, S.
- <sup>169</sup> Nga: B, N, L, X. Origen.
- <sup>170</sup> Nga: B, L, S, 1, 33. Versioni Sahidik. Shën Cirili.
- <sup>171</sup> Nga: C, D, S, 1, 13, 69, 124, 346, 33. Versionet: Sahidik dhe Mephisik. Origen. [Ky leksion do të duhej të ishte versioni i Aleksandrisë, por edhe mund të jetë krejt i rastësishëm].
- <sup>172</sup> Nga: N, B, L, S.
- <sup>173</sup> Nga: S, 1, 157, 209.
- <sup>174</sup> Nga: S, 157, a, b, etj.
- <sup>175</sup> Nga: B, Ä, P, S.
- <sup>176</sup> Nga: S, L, a, g<sup>1</sup>, q.
- <sup>177</sup> Nga: G, S, 1, 118.
- <sup>178</sup> Nga: N, B, D, D, P, S.
- <sup>179</sup> Nga: A, S, 33.
- <sup>180</sup> Nga: 13, 69, 124, 346, (sic!), 28 dhe Memphis.
- <sup>181</sup> Nga: N, C, D, L, S.
- <sup>182</sup> Nga: M, U, S.
- <sup>183</sup> F, S, 33.
- <sup>184</sup> F, S, L, Q.
- <sup>185</sup> F, S, Origen dhe Theodoret.
- <sup>186</sup> F, S, peschito.
- <sup>187</sup> F, B, 59, 115, 238; dhe Ó. [Si duket këtu Batiffol, gabon në renditje?].
- <sup>188</sup> F; dhe S, 25, 32, 240, 244. [Si duket edhe këtu Batiffol, gabon në renditje?].
- <sup>189</sup> F, S, 1, 33, 75. Shih: IV, 33.
- <sup>190</sup> F, S, N.
- <sup>191</sup> F, S.
- <sup>192</sup> F, S.
- <sup>193</sup> F, N, 13, 69, 346. 2 pe.
- <sup>194</sup> P.sh. zogj, ngrënia, gëdhij, ushqimi, ushqehem, mendoj, pi. [pastaj: në vend]. Pastaj: kujtim, tri, lajmëroj, bariu, ju, [në vend], etj. Tërheqim vërejtjen posaçërisht në disa përshtatje të tipit: *pyesim së bashku; do të jetë i zgjedhur (i burgosur); ata të cilët janë së bashku; kryqëzoj në kryq; duke biseduar në mes tyre*; pastaj në dyfishimin e bashkëtingëlloreve si psh: *i frushkulluan; leckë; derdhur, lagur*. Në fund tërheqim vëmendjen në gabimet reale [të vërteta]: *transformim [shndërrim]; Mateu. XII, 41; pastaj: ndërtoi; është i njëjtë; (VII, 24); pastaj: i kam dhënë; ose: paparagjykuar*.
- <sup>195</sup> Edhe një shembull me karakteritika të njëjta: numrat janë të shkruar në dy mënyra te *Beratinus*; në disa raste shkruasi numrat i shkruan me shkronja [pesë, dymbëdhjetë]; kurse në raste të tjera i shkruan sipas parimeve të numeracionit grek [12, 30; 1b, 1.]. Në rastin e parë, kjo është rast i zakonshëm edhe me pjesën dërrmuese të dorëshkrimeve, veçanërisht me: N, A, B, C, ... Z, N, S. Ndërsa në rastin e dytë, është vetë ndikimi i *Codex Bezae D*.
- <sup>196</sup> I njëjti fakt, përsëritet në të njëjtat vende edhe te: *Rossanensis S (deficiente N)*. Shih: Beelen, *Grammatica Nuovi Testamenti* (1857), f. 51.
- <sup>197</sup> Janë të autorit. Më tej teksti vijon me transliterimin e dorëshkrimit. Mbi bazën e këtij transliterimi janë bërë plotësimet në kopjen e rindërtuar të dorëshkrimit, paralelisht me restaurimin e origjinalit, në Republikën Popullore të Kinës.



## KODIKU I MANASTIRIT TË SHËN KOZMAIT <sup>1</sup>

LLAMBRINI MITRUSHI

Ky kodik, në të cilin janë regjistruar kontratat e martesës prej vitit 1819-1843, ka qenë ruajtur deri në maj të vitit 1957 në manastirin e shën Kozmait në fshatin Kolkondas, dhe më 1957 zëvendësia e Fierit ia dërgoi ipeshkvnisë (peshkopatës) së Beratit, ku ndodhet dhe sot <sup>2</sup>.

Kodiku është i mbuluar me tre kapakë. Kapaku i jashtëm është pergamenë, me ngjyrë krem dhe mjaft i zverdhur nga koha. Mbi sipërfaqen e tij dallohen kuadrate të formuara nga dy viza të holla paralele në ngjyrë kafe; në pjesën anësore ky kapak paloset me një gjerësi prej 5.6 cm., në një mënyrë që e mbulon krejt kodikun; faqja e sipërme e kapakut është e grisur së gjati dhe mungon gati gjysma. Sipër, mbi pjesën e pagrisur, lexohen këto shënime: *ky regjistër... i të shentit Beogradit, Joasafit... martesat*. Kapaku i midistë është karton i bardhë dhe paloset në pjesën anësore si i pari. Në sipërfaqen e tij janë shkruar disa shënime të parregullta, me karakter fetar. Kapaku i brendshëm është letër pak e trashë me ngjyrë të murrme. Në sipërfaqen e fletës së parë të këtij kapaku është shkruar në dy rreshta ky shënim i plotë: *Ky regjistër i përket të shenjitit të Beogradit Joasafit, për kontratat e martesës, dhe në fletën e dytë janë shkruar në mënyrë të çrregullt: Unë Kola, dhe më poshtë: Unë Petro shkruaj*. Fletët e kodikut janë të bardha dhe pak të zverdhura nga koha, të trasha, pak të ashpra dhe pa vija, me format 22.5 cm x 15.5 cm. Përmban gjithsej 96 fletë të ndara në 5 fashikuj që kanë qenë të qepur me spango, kurse tashti janë të shkëputur dhe 8 fletë të veçanta me format të ndryshëm.

I gjithë kodiku është i shkruar me dorë, në gjuhën greke<sup>3</sup>. Për shkrimin e tij është përdorur ngjyrë e zezë dhe kafe, diku e errët dhe diku e zbardhur. Regjistrimi i kontratave është bërë nga persona të ndryshëm, siç e venë në dukje kaligrafitë e ndryshme ose siç e shkruajnë ata vetë mbi kapakun e regjistrit: *Unë Kola, Unë Petro shkruaj*. Shkruesit, shpesh herë, duke mos e njohur mirë gjuhën greke, shkruajnë me gabime ortografike dhe shumë veshje i emërojnë në formën dialektike<sup>4</sup> të përdorur nga vetë vendësit. Data nuk shënohet rregullisht në çdo kontratë, ngandonjëherë shkruhet vetëm muaji, ose shkruhet *në të njëjtin muaj* ose *në të njëjtin vit* ose nuk shkruhet datë fare. Në fletët e bashkuara të kodikut janë regjistruar 303 kontrata martesë dhe në 7 fletët e veçanta janë regjistruar 12 kontrata martesë të viteve 1824 dhe 1825. Në njëërën nga këto fletë, me format 20 cm x 14.5 cm, në faqen verso është shkruar me një shkrim jo fort të lexueshëm dhe me gabime një dëftesë që u përkthye në këtë mënyrë:

*Nëpërmjet kësaj letre bëj të ditur, unë, Naumi i Pjetrit në Çipllak, mijëra aspra, njëqind grosh, 100 tallara kollorate dhe kthehen me diferencë (kamatë) një velenxë, deri në afatin e Shënmitrit dhe të jetë sigurimi i së vërtetës në çdo kriter.*

*Njëzetë e gjashtë tetor 1824. Dëshmitar Dhimitrin.*

*Unë, Risto Trifoni, dëshmitar.*

Kurse në një fletë tjetër të veçantë me format 14 cm x 9.5 cm, janë mbajtur shënime llogarie për marrjen e taksës për çdo kontratë të shkruar.

Sipas listës së emrave të fshatrave të nxjerra nga kontratat e këtij kodiku, në juridiksionin e manastirit të shën Kozmait bënin pjesë 86 fshatra; 74 emra fshatrash prej tyre gjenden dhe sot përreth Kolkondasit, kurse 12 emra fshatrash të tjerë nuk gjenden. Interes të veçantë ndër këta ka emri i fshatit Muzaqi, si mbeturinë e emrit të krahinës së Myzeqesë, të cilin e

gjejmë të shkruar disa herë në këtë kodik; ai duhet të ketë qenë brenda këtij territori që bën pjesë në juridiksionin e manastirit të shën Kozmait.

Manastiri i shën Kozmait është ndërtuar pranë kishës së shën Mërisë në fshatin Kolkondas, rreth 10 km larg Fierit, për të kujtuar murgun Kozma. Ky murg ishte mik i Ali pashë Tepelenës dhe u vra nga njerëzit e Ahmet Kurt pashës së Beratit në kohën kur po kthehej nga predikimet që kish bërë në Myzeqe. Manastiri u ndërtua pikërisht në afërsi të vendit ku u gjet trupi i murgut Kozma, i cili pas vrasjes u quajt nga të krishterët dëshmor i krishtërimin dhe u mbiquajt shën Kozma. Manastiri u ndërtua me ndihma të mbledhura në popull pas thirrjes që Ali pashë Tepelena u bëri me anë të këtyre dy letrave që po ribotojmë këtu poshtë<sup>5</sup>:

Letra e parë:

*“Juve rum<sup>6</sup> të nahijes së Beratit, myzeqarë dhe vllah grabovarë, katunde dhe çifliqe. Ju lajmëroj se ja ku vura një epitrop që të më ndreqë manastirin e plakut Kozma; ndihmova dhe unë me aspra e të ndihmoni dhe ju si t’ju thotë dhespoti, me qëllim që të ndreqet ky manastir. Për ata që nuk do të japin ndihmën e tyre, do të më mbetet hatëri dhe pastaj do t’i paguajnë dyfish.*

*Sikundër ju urdhëroj ashtu të bëni pas këtij vendimi.*

*Në Gjirokastër, më 12 shtator 1813,,*

Letra e dytë:

*“Hair duaxhitë e mi, mitropolit i Beratit, Kolë Mitro dhe Haxhi Janko. Ju përshëndes dhe ju kallzoj se i mora vesh sa më shkruat dhe u informova me anën e igumenit; u gëzova shumë që u kujdesët për plakun Kozma. Ja tek po vjen aty tani igumeni dhe Nikolla bashkë me kryemjeshtrin dhe të vini të ndreqni odat dhe kullat e manastirit, i cili të bëhet më i miri nga të gjithë manastiret, sepse me ardhjen time aty dëshëroj ta gjej të mbaruar. Pra, të kujdeseni të gjithë që ta ndreqni dhe të gjithë rumët e Beratit, të mëdhenj e të vegjël, të ndihmojnë. Po i shkruaj dhe Ibrahim Arapit t’ju ndihmojë në çdo punë. Të bëni si ju shkruaj. Ju përshëndes.*

*Në Janinë, 12 shtator 1813.<sup>7</sup>*

Për miqësinë e Ali pashë Tepelenës me murgun Kozma në popull ruhet kjo gojëdhënë: Një ditë shën Kozmai, gjatë një udhëtimi, takon në Tepelenë Ali pashën, i cili në këtë kohë ishte bej dhe jo i dëgjuar, dhe i thotë fjalët e tij profetike: *“Do bëhesh pasha i madh, do marrësh Janinën dhe selinë e Kurt pashait të Beratit, do zgjerosh shumë kufijtë e pashallëkut tënd me mjekrën e kuqe në Stamboll”*. Pas disa vjetësh, kur Ali pasha pa se thëniet e Shën Kozmait po vërtetoheshin, e bëri mik të tij, por pa e kuptuar shprehjen e fundit të murgut *“me mjekrën e kuqe në Stamboll”*, që donte të thoshte se turqit do ta vrisnin dhe kokën e prerë me mjekrën e skuqur në gjak do ta çonin në Stamboll.

Populli i Myzeqesë murgun Kozma e besonte deri vonë si parashikues të ngjarjeve me rëndësi, si të shpërthimit të luftërave dhe varfërimit të popullit; prandaj, pas çdo ngjarje me rëndësi që ndodhte ose mendonin se do të ndodhte, thoshnin: *“ka thënë Shën Kozmai,, “... Jeromanahu (kallogjeri) Kozma, shkruan Gj. Haxhi Mihali, në atë kohë të egër dhe të errët, përveç këshillave fetare, popullit i jepte dhe këshilla njerëzore... dhe rekomandonte nxehtë dhe çeljen e shkollave të veçanta...”*. *“Shkolla e parë në këtë kështjellë (Berat) u çel më 1870, një vit pas ardhjes jeromonakut Kozmajt...”*, vazhdon Haxhi Mihali<sup>8</sup>. Por data e ardhjes së murgut Kozma në Berat provohet më saktë nga një shënim në një libër fetar të kishës së shën Gjergjit të kalasë së Beratit, ku thuhet: *1777, muaji gusht, 22, ditë e martë. Erdhi asqeti dhe na predikoi tri ditë, i quajtur Kozma Hieromonahu dhe preu florinjte e grave<sup>9</sup>*. Aty nga fundi i shekullit të 18-të, shtypjet dhe raprezaljet e qeveritarëve turq kundër të krishterëve kishin bërë që krahina të tëra të ndërronin fenë. Për t’i bërë ballë kësaj gjendjeje veproi në Shqipërinë e jugut murgu Kozma.

Në këto veprime, me sa duket, ai gëzonte në fillim përkrahjen e Kurt pashës së Beratit, i cili i kishte dhuruar një fron për të hipur mbi të kur do të predikonte, dhe pastaj edhe të Ali pashë



Tepelenës. Por më vonë Kozmai u vra nga njerëzit e Kurt pashës, ndërsa Ali pashë Tepelena e nderoi duke ndërtuar për kujtim të tij manastirin në Kolkondas. Kjo kujdesje nga ana e Aliut na bën të themi se murgu mund të ketë qenë një këshilltar i fshehtë i Ali pashë Tepelenës dhe i shërbente me veprimet e tij, sidomos kundër Kurt pashës së Beratit, dhe për këtë shkak kryesor mundet që u diktua dhe u vra nga njerëzit e Kurt pashës.

Ky kodik, si dokument i së drejtës zakonore, ka rëndësi historike dhe etnografike. Në këtë kohë Turqia ruante ende mënyrën e vjetër të administrimit, të mbështetur në ligjet fetare të sheriatit, kurse popullsive jomuslimane sulltanët u kishin njohur të drejtën të administroheshin sipas zakoneve dhe kanuneve të tyre. Kështu elementi ortodoks, i udhëhequr nga kisha, formonte një komunitet më vete dhe kishte si organ drejtues mitropolinë; kjo përfshinte në juridiksionin e saj jo vetëm çështjet fetare, por edhe ato civile. Myzeqeja, në fillim të kësaj periudhe, bënte pjesë në pashallëkun e Ali pashë Tepelenës dhe pas shembjes së këtij pashallëku përfshihej në sanxhakun e Beratit. Po kështu dhe nga pikëpamja administrative kishtarë varej nga mitropolia e Beratit me dhespot Joasafin.

Mitropolitët i pajisnin kishat e manastiret e dioqezës së tyre me regjistra të quajtur “*kodikë*”, ku regjistroheshin çështje të ndryshme, si veprime llogarie mbi të hyrat e të dalat e kishës ose manastirit, lindjet, martesat, shkurorëzimet, vdekjet, testamentet etj.

Dhespoti i Beratit, Joasafi, kishte pajisur me kodikë të tillë dhe manastirin e shën Kozmait. Këtë kodik, që bën fjalë për kontratat e martesës, e quante pronë personale të tij, siç e vërteton shënimi mbi kapakun e këtij kodiku, ku shkruhet: *Ky regjistër i përket të shënjtit të Beligradit, Joasafit*. Joasafi nga këto lloje kodikësh kishte një burim të ardhurash që i vilte nga populli, siç e vë në dukje shënimi i gjetur në një fletë të veçantë në këtë kodik, ku janë shënuar llogaritë për regjistrimin e kontratave. Sipas këtij shënimi, për çdo kontratë të shkruar merrej një taksë prej 3 groshësh.

Kodiku, si burim etnografik, hedh dritë për studimin e dokeve të martesës, të veshjeve dhe onomastikës në krahinën e Myzeqesë në gjysmën e parë të shekullit të 20-të. Në këtë punim do të marrim në shqyrtim vetëm doket e lidhura me kontratat e martesës, të cilat, me disa ndryshime, u ruajtën në përgjithësi deri në vitet e para të pasçlirimit të vendit nga banorët fshatarë autoktonë të Myzeqesë, të mbiquajtur “*lalë*”; madje dhe sot aty-këtu gjejmë mbeturina me forma të reja të këtyre zakoneve.

Sipas kodikut formulimi i kontratave bëhej në këtë mënyrë:

*Me mirëdashjen e Atit, me bashkëveprimin e birit dhe me fuqinë e shpirtit të shenjtë, sot unë, Sotir Gjino nga Korkutasi, fejoj nipin tim, Thoma, me të bijën e Papa Avramit, nga Kolkondasi, Sotira, për grua legale dhe i jap asaj dhuratë para martese 150 grosh d.m.th. njëqind e pesëdhjetë dhe rrobat si më poshtë:*

*Të djalit*  
 2 jelekë stofi të mira  
 me shtojet këmishët dhe ndërresat.  
 1 peshli  
 1 shegun shajaku  
 1 qeleposh dhe brez argjendi  
 1 pushai, futa dhe brez  
 1 gjerdan me rupe  
 2 palë këpucë  
 6 palë këpucë

*Jam dakord*  
 Unë Sotir Gjino veqil i djalit

*Të nuses*  
 Prika sipas zakonit bashkë

*Jam dakord*  
 Babai i vajzës Papa Avrami

*Dëshmitarët: Marku i Janko Gjinos, shkes; dhe dëshmitar Vasil Dhespoti. Dëshmitar Niko Doda.*

*Uroj atyre shëndet dhe bekimin e Avramit dhe qoftë për dëshmi.*

Siç shihet nga përmbajtja e kontratës, qëllimi i shpalljes së një dokumenti të tillë ishte i dyfishtë: në një anë të legalizohej fejesa dhe në anën tjetër të mbahej premtimi i dhënë nga dy palët për përgatitjen e pajës.

Më vonë, deri në vitet e para çlirimit, aktmarrëveshja për fejesën dhe prikën bëhej në këtë mënyrë: Ditën e fejesës, në shtëpinë e djalit shtrohej një drekë e pasur. Pasi hahej dreka, fillohej biseda e përgatitjes së pajës dhe afati i ndejtjes në fejesë. Në bisedim merrnin pjesë 2-3 veta nga të afërmit e vajzës dhe një mik; po kështu dhe nga pala e djalit, 2-3 veta të familjes dhe lajmësi (fejesat më parë janë bërë me lajmësi). Pala e vajzës i kërkonte babait të dhëndrit një sasi parash, të quajtura “*para agërllek*”, velenxën, rrobat e nuses dhe këpuce për prindët ose xhaxhallarët e nuses, kurse pala e dhëndrit kërkonte sasinë e pajës së arkës dhe disa peshqeshe, si këmisha ose peshqirë për burrat dhe linja për gratë e fëmijët e familjes dhe të farefisit, të cilat detyrohej t’i sillte nusja bashkë me pajën. Në kërkesa, thonë pleqtë, zakonisht nuk janë prishur fejesat, se kërkesat bëheshin brenda gjendjes ekonomike të të dy palëve; por, megjithatë, bëhej një farë përpjekjeje nga të dy palët sa të arrinin marrëveshje. Pas marrëveshjes kjo shkruhej në dy kopje dhe e ruante secila palë deri sa bëhej martesë e të rinjve.

Sot, si kudo në krahina të ndryshme të Shqipërisë ashtu dhe në Myzeqe, zakoni i fejesave me lajmësi dhe përpilimi i kontratave pothuajse është lënë krejt. Të rinjtë vendosin vetë për fejesën dhe martesën e tyre dhe së bashku, nga të ardhurat e tyre, përgatisin mobiljet dhe veshjet e tyre. Por aty-këtu ndeshet që disa prindër ushtrojnë një farë autoriteti në fëmijët e tyre dhe kërkojnë të ruajnë traditën e kontraktimit të paktën në formë verbale<sup>10</sup>. Për fejesën e të rinjve dhe përgatitjen e pajës ka këtë ndryshim nga e kaluara: në vend të agërllekut në para (pasi marrja e parave, që konsiderohet si blerje, ndalohet me ligj), kërkojnë copa tekstili të shprehura në “*metra*”; sipas gjendjes ekonomike kërkesa shkon nga 30 deri në 70 metra kambriku, pupline e stofash të tjera për ndërresa, fustane etj.<sup>11</sup>.

Tradita e prikës në para, dhënë nga pala e djalit për vajzën, e quajtur në kodik “*dhuratë para martese*” ose “*agirliq*”, e njohur te fshatarët e Myzeqesë me emrat “*agërllek*” ose “*argllëk*” siç del nga hulumtimet e bëra te pleqtë e Myzeqesë, nuk ka pasur qëllime shpërblimi për marrjen e vajzës, por shpërblim për përgatitjen e pajës dhe të dhuratave që do të çonte nusja në shtëpinë e burrit. Këtë formë shpërblimi që e dokumentojmë që nga fillimi i shekullit të 19-të e vërteton më së miri forma e re që ka marrë “*agërlleku*” sot i shprehur në “*metra*” me të cilat vajza përgatit pajën e saj.

Sipas këtij kodiku, zakoni që pala e dhëndrit t’i bëjë nuses rrobat e martesës dhe të japë një sasi para, ka qenë i banorëve autoktonë, lalëve të Myzeqesë. Kurse ardhësit nga krahinat e tjera në disa raste u ishin përshtatur këtyre dokeve dhe shënonin në fund të kontratës së kodikut “*sipas zakonit të myzeqarëve*”. Kurse në raste të tjera ardhësit mbanin doket e tyre, siç shihet në kontratën 193 të këtij kodiku, sipas së cilës dhëndri merrte nga prindët e nuses një sasi para dhe detyrohej t’i bënte asaj vetëm rrobat e nusërisë. Ky zakon, aty nga çereku i parë i shekullit tonë, filloi të hynte dhe në disa banorë autoktonë të Myzeqesë, sidomos në qytetin e Fierit dhe më rrallë në fshatarët, dhe qëndroi deri në çlirimin e vendit. Sipas këtij zakoni, ata prindër që dëshironin të martonin vajzat e tyre me djem të mirë, me zeje ose shkollë, i jepnin dhëndrit një sasi para ose pasuri tjetër të patundshme, si tokë, rrënjë ullinj etj., që përdorshin ose mbeteshin si pasuri në emër të nuses.

### **Burime bibliografike:**

1. Ky artikull është botuar për herë të parë në "Studime historike", viti 1965, nr.3, fq.175-180. Në këtë artikull të gjitha shënimet me korsive janë të redaksisë. Shënimet e tjera janë të autorit. Për të njëjtin kodik, nga e njëjta autore, shih: Ll. Mitrushi, *Dasma në lalët e Myzeqesë*, në "Etnografia shqiptare" II, 1963, f.182.
2. Në kohën kur u shkrua artikulli. Ky kodik prej kohësh gjendet në AQSH.
3. Përkthimi u bë nga Koço Bozhori.
4. *Dialektore*.
5. Përkthimi u bë nga Koço Bozhori.
6. „Rumë“ quheshin nga Perandoria Osmane shtetasit e krishterë të perandorisë. Prej këndeje dhe „Rumeli“ për pjesën europiane të perandorisë. Është një shmangie fonetike nga forma „romë“, banorë të Perandorisë Romake të Lindjes.
7. Letrat janë botuar për herë të parë në vitin 1868 nga A. Aleksudhi, fl. 8.
8. Gj. Haxhi Mihali në "Dituria", 1927, f. 336.
9. Po aty.
10. Teksti është lehtësuar nga frazeologjia e kohës.
11. Këto të dhëna tashmë janë vetëm me vlerë informuese historike.



**KATALOG I DORËSHKRIMEVE NË GREQISHT  
NË ARKIVIN E SHTETIT NË TIRANË**

JOHANNES KODER  
ERICH TRAPP

**Parathënie:**

Në materialin vijues parashtrojmë katalogun e dorëshkrimeve greqisht në Tiranë, të cilin e kemi lajmëruar në shkrimin tonë “Raport mbi një udhëtim në Shqipërinë e Jugut”<sup>1</sup>. Në një hulumtim të parë në Tiranë ne gjetëm nëntëmbëdhjetë dorëshkrime të paketuara në kuti kartoni, për një pjesë të të cilave ishin shënuar përshkrime provizore në shqip<sup>2</sup>. Gjendja e ruajtjes ishte në përgjithësi jo shumë e mirë. Ngaqë ndeshëm aty-këtu signatura të dyfishta, në ca raste edhe numërtime të ndryshme të vjetra, u pa i domosdoshëm një numërtim i ri i njësuar (“Tiranenses graeci”). Numrat 20-25 rezultojnë si fletë të mbetura të shkëputura nga kodikë dorëshkrimesh të humbura.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Arkivit të Shtetit, dorëshkrimet e katalogizuara këtu përfaqësojnë të gjitha ato që ndodhen ende në hapësirën shtetërore të Shqipërisë. Pas gjasash ato duhet të vijnë të gjitha nga Berati, megjithatë ne ia dolëm ta dëshmojmë këtë prejardhje, përmes identifikimit me numrat e katalogut të Alexoudis-it, vetëm për dhjetë kodikë. Sa i takon dorëshkrimeve greqishte të pagjendshme më tani, të cilat ndodheshin më parë në Shqipëri, të krahasohet në Richard Nr. 46, 141, 210-213, 336, 610, 641, 838<sup>3</sup>.

Katalogu u përpunua në parim si pjesë e katalogut të dorëshkrimeve vjeneze të H. Hunger-it<sup>4</sup>, megjithatë u bënë modifikime, përse kjo ishte e domosdoshme për arsye të kushteve të veçanta të punës. Mungesat në përpunim, për të cilat jemi të vetëdijshëm (mungesë e shifrave të pozicionit, e sqarimeve mbi ngjyrat, herë-herë vetëm përshkrime përmbledhëse të gjendjes së ruajtjes, të dhënat për prejardhjen jo gjithnjë të mundshme), janë rrjedhojë pjesërisht e faktit që ne qëndruam në vend për një kohë të pamjaftueshme dhe që, në kushtet e marrëdhënieve shumë të pafavorshme bibliotekare, shpresat qenë varur praktikisht në librat e marra me vete; nga ana tjetër me plotësimin jo të plotë të kërkesës sonë për mikrofilmime, çka e vështirësoi jo pak përpunimin e mëtejshëm të materialit. Kjo e fundit bëhet e dukshme në përshkrimet pjesërisht përmbledhëse të përmbajtjes, megjithatë ndikon në mënyrë fort shqetësuese vetëm në Kodikun 18.

Shpresojmë, megjithatë, pavarësisht këtyre mungesave, t’i paraqesim botës shkencore një katalog, i cili i kënaq në parim pretendimet e deritashme dhe mbyll në këtë mënyrë një boshllëk, pasi jep informacion - në kuadër të mundësive - shterrues, për fondin e sotëm të dorëshkrimeve në greqisht në Shqipëri.

**Shkurtime:**

Kap.:	kapaku	Lit.:	literatura
Gjr.:	gjendja e ruajtjes	Shk.:	shkruesi
fl.:	fletë	Zp.:	zotëruesi i parë
f.:	faqe	Shu.:	shenja të ujit
Ngj.:	ngjyra		

**Literaturë:**

1. Aland = K. Aland, Listë e shkurtër e dorëshkrimeve greqisht të Testamentit të Ri. 1. Vështrim i përgjithshëm, Berlin, 1963.
2. Alexoudis Deltion = A. Alexoudis, Katalog i kishave të shenjta të lagjes Kala, të qytetit të Beratit dhe dorëshkrimet e lashta të gjetura të Mitropolisë së Beligradit (Beratit). Historia e Etnologjisë, viti 5 (1900)-352-369.
3. Aleksudhi. E vërteta kishtare = A. Alexoudis, Kodikë të zonës së Beratit etj. Në "E vërteta kishtare" 20 (1900) dhe 21 (1901).
4. BHG = Bibliotheca Hagiographica Graeca, ed. F. Halkin, I-III, Bruxelles 1957 (*Subsidia hagiographica 8 a*).
5. Briquet = C. M. Briquet, Les filigranes, I-IV, Paris 1907.
6. Ehrhart = A. Ehrhart, Überlieferung und Bestand der hagiographischen und homiletischen Literatur der griechischen Kirche. 1. Die Überlieferung, Leipzig 1937 ff.
7. Gregory = C. R. Gregory, Textkritik des Neuen Testaments, I, Leipzig 1900.
8. Menaion = Menaia, hrsg. v. Bartholomaios Kutlumusianos, I-XII, Venedig 1895.
9. Pentekostarion = Pentekostarion. hrsg. v. Bartholomaios Kutlumusianos, Venedig 1875.
10. PG = J. P. Migne, Patrologiae cursus completus, Series graeca, Paris 1857 ff.
11. Triodion = Triodion, Venedig 1876.

**Përshkrime të dorëshkrimeve:**

**1. Shek. i 14-të. Pergamenë.** 265 x 215 mm. I. 338 fl. (I = fletë e parë; 339 fl. -1). 2 kol., 23 rr. (2<sup>r</sup>-41<sup>v</sup>, 180<sup>r</sup>-339<sup>v</sup>), 20 rr. (42<sup>r</sup>-179<sup>v</sup>).

Ungjill. (I<sup>r</sup>) Shënim i pronarit.-(I<sup>v</sup>) bosh.-(2<sup>r</sup>-339<sup>v</sup>) Lexime për festat e lëvizshme (krhs. Gregory f. 344-364).

Gjr.: E mirë; e shkëputur pas f. 176, 177, 178, 179, 294 çdo 1 fletë, pas f. 281 2 fletë; f. 43-179 prej një dore të dytë; f. 282-286 prej një dore të tretë; f. 287 gjysma e sipërme e grisur (me humbje teksti); f. 199 inicialet të prera.

Zp.: Georgios (I<sup>r</sup>: Ky Ungjill ...).

Ngj.: Inicialet të kuqe rreth 20 mm të larta, portikë zbukurimi mbas f. 180<sup>r</sup> dhe 225<sup>v</sup>.

Kap.: Dy mbulesa druri me shtresë lëkure me stampim të rremë (ornamente), të dëmtuara lehtë; dy togëza ( të paruajtura).

**2. Shek. i 12-të-13-të. Pergamenë.** 260 x 200 mm. 173 fl. (171 fl.+ 83A + 87A). 2 kol., 21-24 rr. Ungjill. (1<sup>r</sup>-170<sup>r</sup>) lexime për festat e lëvizshme (krhs. Gregory f. 344-364).-(170<sup>r</sup>- 171<sup>v</sup>) fragmente perikopeje.

Gjr.: F. 1-10, 23, 87 A të dëmtuara me humbje teksti; f. 169 4 rreshtat e fundit të kol. së djathtë të rëna përsipër prej një dore të dytë; f. 165-171 me gjurmë uji dhe të nxira rëndë.

Ngj.: Inicialet në të kuq dhe të gjelbër rreth 40 mm të larta.

Kap.: Dy mbulesa druri me shtresë lëkure me stampim të rremë (ornamente), të ruajtura keq; dy togëza ( të paruajtura).

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 362 (si Berat. 17); Aland Nr. 1433.

**3. Shek. i 12-të. Pergamenë.** 305 x 240 mm. I. 204 fl. (I = fleta e qëllimit; 202 fl.+158 A+164 A). 2 kol., 40 rr.

Symeon metaphrastes, Menologion (minej) për muajin nëntor.

(1<sup>r</sup>) Tryeza e lëndës.-(1<sup>v</sup>) bosh.

-(2<sup>r</sup>-4<sup>v</sup>). [Vita et passio S. Cosmae et Damiani] *Inc.* Duke ndriçuar nga shprestaria dhe nga predikimi i ungjillit. (ed. G. van Hooff, *An Boll.* 1 (1882) 586-596; krhs. BHG 374).

-(4<sup>v</sup>-13<sup>r</sup>) Martirizimi i dëshmorëve të shenjtë dhe të lavdëruar të Krishtit; Akindhino, Pigosiu, Afthariu, Elpidhofori dhe Anembodhistu. [Passio S. Acindyni, Pegasii, Aphthonii, Elpidephori

et Anempodisti] (PG 116, 9-36; krhs.BHG 23).

- (13<sup>v</sup>-23<sup>r</sup>) Martirizimi i dëshmorëve të shenjtë të Krishtit Akepsima, Josif dhe Aithola.[Passio S. Acepsimae, Josephi et Aeithalae] (PG 116, 832-860; krhs.BHG 20).

- (23<sup>r</sup>-42<sup>r</sup>) Jeta e atit tonë oshënar dhe murg, Joanikit [Vita S. Joannicii] (PG 116, 36-92; krhs. BHG 937).

- (42<sup>r</sup>-47<sup>v</sup>) Jeta dhe martirizimi i shenjtorëve Galaktinos dhe Epistimi [Vita et passio S. Galactionis et Epistimae] ( PG 116,93-108; krhs. BHG 666).

- (47<sup>v</sup>-52<sup>r</sup>) Jeta e atit tonë oshënar dhe konfesor, Palit [Vita S. Pauli confessoris] (PG 116, 884-896; krhs. BHG 1473).

- (52<sup>r</sup>-55<sup>v</sup>) Martirizimi i dëshmorit të shenjtë Jeronos së bashku me dëshmorët e shenjtë atletë në Mitilin [Passio S. Hieronis et sociorum Melitinae] (PG 116,109-120; krhs. BHG 750).

- (55<sup>v</sup>-63<sup>r</sup>) Tregimi i pjesshëm i çudirave të mëdha dhe të lavdëruara të kryeëngjëllit të madh Mihail, të mbledhura nga shkrimi i vjetër dhe i ri. [Laudatio S. archangeli Michaelis] *Inc. Festimet e çështjes engjëjlore, të zburimeve qiellore dhe tani ne duke kryer festën me gëzim dhe hare, të gjithë këtyre rreshtave të Kryetarit... Sa madhështore janë veprat e tua, o Zot, ata që dëgjojnë thonë të gjitha i ke bërë me urtësi. (Krhs. BHG 1294b?).*

- (63<sup>r</sup>-75<sup>v</sup>) Kuptimi i jetës së Nënës së të gjithëve dhe të çudibërësit Matronis [Vita S. Matronae] (PG 116, 920-953; krhs. BHG 1222).

- (75<sup>v</sup>-81<sup>v</sup>) Jeta dhe vepra e oshënares Theoktisti nga Lesboja [Vita S. Theoctistae Lesbiae] (ed. Th. Ioannou, Monumente agjiografike, Venedik 1884, fq.18-39; krhs. BHG 1726).

- (81<sup>v</sup>) Martirizimi i dëshmorit të shenjtë Mina Egjiptianit të martirizuar në Kotiea [Passio S. Menae Aegyptii] (ed. G. van Hooff, An. Boll. 3 [1884] 258-270; krhs. BHG 1250). *Des. mut.* në lidhje me sigurinë e pasigurt, nëpërmjet teksteve a. a. O., fq. 259, Z.15.

- (82<sup>r</sup>-84<sup>v</sup>) [Passio S. Platonis] *Inc. mut.* Të cilat nuk mund as të dëgjojnë, as të lëvizin dorën (krhs. BHG 1552).

- (84<sup>r</sup>-88<sup>v</sup>) Jeta dhe vepra e atit tonë oshënar Amfilokio [Vita S. Amphilochii] (PG 116, 956-969; krhs. BHG 72).

- (88<sup>v</sup>-112<sup>v</sup>) Jeta dhe vepra e atit tonë oshënar, Grigorit, episkopit të Agrigentit [Vita S. Gregorii episcopi Agrigentini] (PG 116, 189-269; krhs. BHG 708).

- (112<sup>v</sup>-118<sup>v</sup>) Martirizimi i dëshmores së shenjtë Ekaterina [Passio S. Aecaterinae] (PG 116, 276-301; krhs. BHG 32).

- (118<sup>v</sup>-157<sup>v</sup>) Të atit tonë ndër shenjtorë, dëshmorit të shenjtë Klementit, episkopit të Romës dhe të apostullit të shenjtë Pjetër [S. Clementis epitome de gestis S. Petri] (PG 2, 469-604; krhs. BHG 345). *Des. mut.* Tregim i përmbledhur. Tepri e tillë çudirash, shkëlqime të tilla, që u bënë për ne.

- (157<sup>v</sup>-162<sup>r</sup>) [Passio S. Petri episcopi Alexandrini] (ed. F. Combefis, Illustrium Christi martyrum 1. triumphus, Paris 1660, S.189-221; krhs.BHG 1503) *Inc. mut.* të atyre dhe mëkatarëve që kur Kishës...

- (162<sup>r</sup>-164<sup>v</sup>, 172<sup>r</sup>-175<sup>v</sup>) [Passio S. Mercurii] (ed. H. Delehaye, Les legende grecques des saints militaires, Paris 1909, fq. 243-258; krhs. BHG 1276). *Inc. mut.* Pasi i bindën ata gjetën këta ... a.a.O.,fq. 243, rr.16.

- (168<sup>r</sup>-171<sup>v</sup>, 180<sup>r</sup>-181<sup>r</sup>) Martirizimi i Shën Jakov Persianit. [Passio S. Jacobi Persae] (krhs. BHG 773).

- (175<sup>v</sup>-179<sup>v</sup>, 164A<sup>r</sup>-167<sup>v</sup>) Jeta dhe vepra e atit tonë oshënar, Alipiut. [Vita S. Alypii] (ed. H. Delehaye, Les saints stylites [Subs. Hagiogr. 14] Bruxelles 1923, fq..170-187; krhs. BHG 64).

- (181<sup>r</sup>-202<sup>v</sup>) Jeta dhe vepra e atit tonë oshënar dhe konfesor, Stefanit të ri [Vita S. Stephani iunioris confessoris] (krhs. BHG 1667). *Des. mut.* U shenjësove o Stefan i çuditshëm me rënkime dhe lotë.

Gjr.: F. 2, 35 të dëmtuara me humbje të vogla teksti; mes f. 81 dhe f. 82 mungon një numër i papërcaktuar fletësh; f. 82-133 të dëmtuara pa humbje teksti; f.134-136 të dëmtuara me

humbje të vogla teksti, 137-153 pa humbje teksti; f. 154-177, 194-202 humbje të mëdha teksti.

Ngj.: E thjeshtë e zezë në çdo fillim paragrafi.

Kap.: Dy mbulesa druri me shtresë lëkure me stampim të rremë (ornamente), dy togëza ( të paruajtura).

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 362 (si Berat. 16); Alexoudis Ekkl. Al. 20. 485 fq. dhe 537 (si Berat. 1 dhe 29); Ehrhard I 2, fq. 444: Konfirmohet supozimi i Ehrhard-it, që Berat. 1 dhe 29 përputhen, por mungojnë vetëm Nr. 11-16 dhe 27 të teksteve normale (krhs. Ehrhard I 2, fq. 392).

**4.Shek. i 13-të. Letër.** 220 x 150mm. 350 fl. (363 fl. + 21A + 155A – 349 bis 363 [krhs. Cod. 20]). 1 kol., 28 rr.

Triodion dhe pendekostarion (fragment).

(1<sup>r</sup>) *inc. mut.* U ngritën me të gjithë djemtë e Faraonit. (= Triodion, fq.322).-(348<sup>r</sup>) *des. mut.* Dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh. (= Pentekostarion, fq.207).

Gjr.: Shumë e keqe, shkrimi fort i dëmtuar dhe i zbehur nga uji, në mjaft raste i palexueshëm; Lidhja krejt e prishur, qoshet mjaft të ngrëna, letra e dëmtuar nga brejtja e krimbave.

Zp.: Theodosios. Glavenica dhe Berati (sipas Alexudis, f. 363, ky ia ka kushtuar kodikun në vitin 1438 kishës të Apostujve të Shenjtë; ky shënim nuk është më i gjendshëm).

Ngj.: Iniciale në ngjyrë të kuqe deri 60 mm të larta, në disa raste edhe në ngjyrë të gjelbër; bordura të zbukuruara dhe gërma po ashtu të zbukuruara në ngjyrë të kuqe në fillim të paragrafëve.

Kap.: Ruhet vetëm kapaku i përparëm (dru i mbuluar me lëkurë) me tre (nga pesë) mbërthecka zbukurimi, i dëmtuar shumë rëndë.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 363 (si Berat. 26); po ai, Ekkl. Al. 20, fq. 525 f. (si Berat. 11).

**5.Shek. i 14-të. Pergamenë.** 225 x 160 mm. 600 fl. (602 fl.-1 dhe 2 [krhs. Cod. 21]). 1 kol. 20 rr.

Theophylaktos i Ohrit

(3<sup>r-v</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Gjonit.-(4<sup>r</sup>-602<sup>r</sup>) Theophylaktos i Ohrit, Shpjegimi i Ungjillit sipas Gjonit-[Enarratio in Evangelium Ionnis] (PG 123,1133-1348 dhe 124, 9-317).-(602<sup>v</sup>) Shënime të shkruesit.

Gjr.: Në përgjithësi e mirë, me njolla të lehta uji, qoshja e djathtë lart nga f. 3-44, 186 dhe 250-1 e dëmtuar pa humbje teksti, f. 256-269, 277-8 dhe 601-2 me humbje të vogla teksti.

Kap.: Kapaku i përparëm (dru me lëkurë me stampim të rremë) në Cod. 21, kapaku i prapëm i dëmtuar shumë rëndë, dy togëza ( të paruajtura).

Lit.: Alexudis Deltion, fq. 365 (si Berat. 30); po ai. Ekkl. Al.20. fq. 526 (si Berat. 15).

**6.Shek. i 8-të-9-të. Pergamenë.** 265 x 180 mm. 144 fl. (147 fl.-1 [krhs. Cod.25] -87-88). 2 kol. 25 rr. [Senkrechte Spitzbogenunziale (vertikale, harqe me majë, ?)]

Ungjill. (2<sup>r</sup>-147<sup>v</sup>) Lexime për festat e lëvizshme dhe të palëvizshme); *des. mut.* Tetëdhjetekatër vjet. (= Luka 2, 37 për shkurtin; krhs. Gregory f. 344-376).

Gjr.: E mirë. Pergamenë e deformuar fort nga uji, skaji i poshtëm i dëmtuar në gjithë shtrirjen pa humbje teksti, f. 2-6 dhe 141-7 me humbje të vogla teksti.

Ngj.: Iniciale deri 50 mm të larta me zbukurime të thjeshta (e kuqe-e gjelbër), në fol. 2<sup>r</sup> dhe 111<sup>r</sup> korniza rreth titujve (e kuqe-e gjelbër) me zogj.

Kap.: Ruhet vetëm kapaku i përparëm, i dëmtuar rëndë nga brejtjet e minjve.

**7. Viti 1322** (f. 183<sup>r</sup> letër. 300 x 220 mm. 190 fl. (I = fleta e qëllimit; 184 fl.+7A + 76 ABCD). 2 kol., 29 rr.

Ungjill. (I<sup>r-v</sup>) bosh.-(1<sup>r</sup>-183<sup>r</sup>) Lexime për festat e lëvizshme (krhs. Gregory 344–364), f. 4<sup>v</sup>,



147<sup>v</sup>, 182<sup>v</sup>, 183<sup>v</sup>-184<sup>v</sup> bosh.

Gjr.: E mirë, skajet e errësuar dhe me njolla uji, fol. I dhe 1-11 mjaft të errësuar, f.1-2 dhe 182-184 të dëmtuara pa humbje teksti, f. 7A dhe 76 ABCD të copëtuara deri në mbetjet më të vogla.

Ngj.: Inicialet të thjeshta në ngjyrë të kuqe deri në 7 cm të larta, në fillimet e kapitujve korniza zbukurimi në ngjyrë të kuqe dhe mbishkrime, në f. 1<sup>r</sup> portal zbukurimi.

Kap.: Dy kapakë druri me mbulesë lëkure në stampim të rremë, dy togëza (të humbura).

**8. Shek. i 14-të. Pergamenë.** 315 x 240 mm. 140 fl. (140 fl.-f. 1 dhe 2 [khrs. Cod.21] + 46A + 136A). 2 kol., 22-25 rr.

Ungjill. (3<sup>r</sup>-140<sup>v</sup>) Predikime për festat e lëvizshme dhe të palëvizshme; *inc. mut.* Thashë se do të marrë prej simes. (= Gjoni 16, 15 për të mërkurën e javës së shtatë pas Pashkëve; khrs. Gregory f. 347-386).

Gjr.: E mirë, skajet të dëmtuara pa humbje teksti, f. 46A dhe 136A të shkëputura.

Ngj.: Inicialet të kuqe deri në 30 mm të larta, në f.7<sup>r</sup> portik zbukurimi (e kuqe, e gjelbër, e kaltër mbi të verdhë të artë, arabeska) me mbishkrime kapitujsh në ar.

Kap.: Dy kapakë druri me mbulesë lëkure me stampim të rremë (ornamente), kapakët dhe lidhje të çlirët, dy togëza të humbura.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 362 f. (si Berat. 22); Alexoudis Ekkli. Al.20, fq. 525 (si Berat. 7); Aland Nr.1434.

**9. Rreth 1400-ës (I-XXI, 1<sup>r</sup>-228<sup>r</sup>) dhe 1438-s (228<sup>v</sup>) dhe rreth 1400-ës (229<sup>r</sup>-230<sup>r</sup>). Pergamenë.** 335 x 265 mm. 252 fl. (230 fl.+1-XXI+226A). 2 kol., 23-27 rr.

Ungjill. (1<sup>r</sup>-228<sup>r</sup>) Predikime për festat e lëvizshme; *inc. mut.* (6<sup>v</sup>) Dhe në mos i dëgjoftë ata, thuaia këtë Kishës (= Mateu 18, 17 për muajin e Rëshajeve; khrs. Gregory, f.347), *des. mut.* (226<sup>v</sup>) Kujtoni si u pati folur kur ishte në Galile. (= Luka, 24, 7 për të Dielën e Pashkëve, 4; khrs. Gregory, f.364).- (228<sup>v</sup>). Shënime nga një dorë e dytë.- (229<sup>r</sup>) bosh.- (229<sup>v</sup>-230<sup>r</sup>). Shënime nga një dorë e tretë.- (230<sup>v</sup>) bosh.

Gjr.: Skaji i sipërm i djathtë i të gjithë librit mungon, humbje teksti; f. I-XX, 1-4 dhe 227-230 pjesërisht të ruajtura, prej f. XXI dhe 5-6 gjysma e brendshme e ruajtur, vizatimi në fol. 61 i prerë.

Shk.: Theodor Grammatikoi (fol.228<sup>v</sup>).

Ngj.: Titujt e kapitujve në ngjyrë të kuqe, inicialet deri 110 mm të larta në të kuqe të thjeshtë ose me trajtim më të pasur (e kuqe, e gjelbër, e kaltër, e verdhë) me ornamente dhe figura, në f.42<sup>r</sup> pamja e plotë e ungjillorit Mark (130 x 90 mm; e kuqe, e verdhë, e kaltër, e gjelbër, e kaftë) në qëndrim shkruesi.

Kap.: Dy kapakë druri me mbulesë lëkure, të ruajtur keq, të çlirtë dhe të ngrënë nga krimbat, në anën e përparme trembëdhjetë, në të pasmen dy thumba zbukurimi ende të ruajtur.

**10. Shek. i 12-të (1158 ?)** Alexoudis jep për f.14<sup>r</sup> një datim sot të palexueshëm). Pergamenë. 220 x 160mm. 99 fl., 1 kol., 17-22rr. (1<sup>r</sup>-3<sup>v</sup>)? Euthalios Diakonos, Prolog i veprimeve. [Prologus Actuum apostolorum] *inc. mut.*] (PG 85, 629 B 10-636 A).- (3<sup>v</sup>-6<sup>r</sup>) çështje e librit të veprimeve të Apostujve (Argumentum libri Actuum apostolorum) (PG 85, 645 A-649 A).- (6<sup>r</sup>-7<sup>r</sup>) Shtegtimi i apostullit Pal. [Peregrinationes Pauli apostoli] (PG 85, 649 B-652 A).- (7<sup>r</sup>-12<sup>v</sup>) Paraqitje e kapitujve të Veprave të Apostujve. [Elenchus capitum libri Actuum apostolorum], *des.* Për Judejtë e Romës (PG 85, 652A-661 B11).- (12<sup>v</sup>-13<sup>v</sup>) Kapitullizim i dëshmimeve të Shenjta të librit të veprave [Elenchus Divinorum testimoniorum quae continet liber Actuum apostolorum] (PG 85, 640B-645A; vetëm fillimet e vargjeve të cituara). (13<sup>r-v</sup>)<sup>5</sup>

Këto shenja ndodhen në këto vende të letrave:

I bashkëngjitet kësaj një paraqitje grafike.

Vijojnë katër distikë në lidhje me kotësinë e fjalëve:

Më kot o njeri shtjellon kuptime të shumta,  
ide retorike, metoda astronomike,  
kundërvënie, justifikime, mendime të mëdha  
të Euklidianeve, Thalistëve, mjeshtrave atikë të fjalës;  
Për një moment një sëmundje i shkatërron të gjitha  
dhe të vendos me të paditurit.  
Para fundit duhet që të mos merremi me gjërat tokësore  
por qielloret të kapim<sup>5</sup>.

(14<sup>r</sup>-99<sup>r</sup>). Veprat e Apostujve me komente të zgjedhura nga Oikumenios, Shpjegim në lidhje me veprat e Apostujve [Commentarius in Acta apostolorum] (PG 118, 41 A-237 D) (99<sup>r</sup>) Euthalios Diakonos, Prolog i katërmbëdhjetë letrave të Palit të apostullit të shenjtë [Prologus in quattuordecim sancti Pauli apostoli epistolas], *des. mut.* Që dhe frymërat e erërave (PG 85, 693 A 1-14).

Gjr.: E mirë, skajet prej f. 1-10 dhe 99 të dëmtuara pa humbje teksti, fillimi dhe fundi i dorëshkrimit të humbura. Ngj.: Korniza zbukurimi të thjeshta në ngjyrë të kuqe, në f. 14<sup>r</sup> portik zbukurimi (e artë, e kuqe).

Kap.: Dy kapakë druri të çlirët, prej mbulesës së lëkurës ruhen vetëm copëza, lidhja e lirshme. Lit.: Alexudis Deltion, fq.360 (si Berat. 14); Alexudis Ekk. Al.20, fq.544 (si Berat. 36); P. Batiffol, Les Manuscrits grecs de Bérat d'Albania et le codex purpureus F, *Archives des Missions scient. et littér.* III 13 (1887) 441 f. (si Berat. 10).

**11. 1312 (fol. 227<sup>r</sup>).** Pergamenë. 185 x 135 mm. 228 fl. (227 + 172A). 1 kol., 26rr.

Katërungjillësh. (1<sup>r</sup>-3<sup>r</sup>) Synopse të ungjijve.-(4<sup>r</sup>-5<sup>r</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Mateut.-(5<sup>r</sup>) Shënim i shkruarit.-(5<sup>v</sup>) Pamje e ungjillorit Mateu.-(6<sup>r</sup>-57<sup>r</sup>) Ungjilli sipas Mateut; *inc. mut.* Faqen e djathtë t'i kthejë atij dhe tjetrën. Se po shihnin ndonjë frymë dhe u tha atyre. (Mateu 5, 39).-(57<sup>r</sup>-58<sup>r</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Markut.-(58<sup>v</sup>) Pamje e ungjillorit Marku.-(59<sup>r</sup>-96<sup>r</sup>) Ungjilli sipas Markut.-(96<sup>v</sup>deri 98<sup>r</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Lukës.-(98<sup>v</sup>)Pamje e ungjillorit Luka.-(99<sup>r</sup>-162<sup>v</sup>) Ungjilli sipas Lukës; *des. mut.* Se po shihnin ndonjë frymë dhe u tha atyre (Lluka 24, 37).-(163<sup>r</sup>-209<sup>v</sup>) Ungjilli sipas Gjonit-(210<sup>r</sup>-227<sup>r</sup>) Tryezë e lëndës e lëndës e perikopeve.-(227<sup>v</sup>) bosh.

Gjr.: Në përgjithësi e mirë, f. 1 e dëmtuar me humbje teksti, pas. f. 5 dhe 162 këputje fletësh, f. 227 e dëmtuar pa humbje teksti.

Ngj.:Iniciale në ngjyrë të kuqe deri në 10mm të larta, në fol. 1-3 harqe zbukurimi në ngjyrë të kuqe, fol. 5<sup>v</sup> pamje e ungjillorit Mateu (e kuqe, e kaltër, e artë), 58<sup>v</sup> pamje e ungjillorit Marko (e kuqe, e kaltër, e artë, violet), 59<sup>r</sup> korniza zbukurimi (e kuqe, e kaltër, e artë), 98<sup>v</sup> pamje e ungjillorit Luka (e kuqe, e kaltër, e gjelbër, e verdhë, e kaftë), 99<sup>r</sup> dhe 163<sup>r</sup> korniza zbukurimi (e kuqe, e kaltër, e artë).

Kap.: Dy kapakë druri (të thyer) me mbulesë lëkure me stampim të rremë (ornamente), një togëz (e humbur).

**12. Rreth 1400-ës.** Letër. 250 x 205 mm. I. 240 fl. (I = fleta e qëllimit; 229 fl.+27A +90A-K). 1 kol., 21 rr.

Katërungjillësh. (1<sup>r</sup>-1<sup>r</sup>) bosh.-(1<sup>v</sup>) Pamje e ungjillorit Mateu, e mbishkruar me katër dymbëdhjetërrokësh:

Duke mos pasur guximin tënd engjëllor,  
Formën e trupit engjëllor që ke,  
Duke mos pasur diçka më shumë se engjëjt,  
Por duke shkruar fjalën tënde të mëshruar.

(2<sup>r</sup>-66<sup>r</sup>) Ungjilli sipas Mateut.-(66<sup>v</sup>) Hypothesis e Ungjillit sipas Markut.-(67<sup>r</sup>-v) Pinax i Ungjillit sipas Markut.-(68<sup>r</sup>) bosh.-(68<sup>v</sup>) Pamje e Ungjillorit Mark e mbishkruar me katër dymbëdhjetërrokëshe:

Duke qëndruar Marku pa folur,  
pavarësisht se ka qëllim të shkruajë,  
jo sepse nuk frymëzohet, por se duke jetuar edhe lëviz,  
edhe merr frymë, e kërkon të shkruajë i qetë.

(69<sup>r</sup>-100<sup>r</sup>) Ungjilli sipas Markut. -(100<sup>v</sup>) Hypothesis i Ungjillit sipas Lukës; *inc.* Ungjilli i shenjtë i shkruar sipas Lukës. Pasi Luka nxënësi... duke parë nxënësit.-(101<sup>r</sup>-102<sup>v</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Lukës.-(103<sup>r</sup>) bosh.-(103<sup>v</sup>) Pamje e Ungjillit sipas Lukës, e mbishkruar me katër dymbëdhjetërrokëshe:

O Luka, mbrojtësi i bujqësisë së Perëndisë,  
Duke parë farat mistike, dua ta shndërrojë;  
Ashtu si gururi bëhet bukë,  
Fjalën tënde ungjillore në grurë,  
Për të mbledhur thesarë në shpirt.

(104<sup>r</sup>-174<sup>r</sup>) Ungjilli sipas Lukës.-(174<sup>v</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Gjonit.-(175<sup>r</sup>) Pamje e ungjillorit Gjon, e mbishkruar me katër dymbëdhjetërrokëshe:

Na godet në mendje vetëtimja e logjikës,  
pasi asnjë shi, asnjë shenjë reje,  
duke i forcuar i biri i Zebedeut,  
njerëzit e panë me shi të padukshëm.

(175<sup>v</sup>-228<sup>v</sup>) Ungjilli sipas Gjonit.-(229<sup>r-v</sup>) bosh.

Gjr.: E mirë.

Shu.: Shkronja N. Po kështu Briquet 8427 (Pisa 1372). (1<sup>v</sup>).

Ngj.: Në përgjithësi e zbehur fort; iniciale rreth 30 mm të larta. Pamje ungjillore e Mateut në ngjyrë të kuqe dhe të verdhë, 170 x 155 mm.-(2<sup>r</sup>). Hapësirë zbukurimi me iniciale në ngjyrë të kuqe 70mm të larta.-(68<sup>r</sup>) Pamje ungjillore e Markut në ngjyrë të kuqe dhe të verdhë, 180 x 140mm.-(69<sup>r</sup>) Hapësirë zbukurimi me iniciale në ngjyrë të kuqe e të verdhë rreth 80 mm të larta.-(103<sup>r</sup>) pamje ungjillore e Lukës në ngjyrë të kuqe dhe të verdhë, 180 x 140mm.-(104<sup>r</sup>) Hapësirë zbukurimi me iniciale në ngjyrë të kuqe rreth 70 mm të larta.-(175<sup>r</sup>) Pamje ungjillore e Gjonit dhe e Prohorit në ngjyrë të kuqe dhe të verdhë 170 x 135mm.-(175<sup>v</sup>) Hapësirë zbukurimi me iniciale në ngjyrë të kuqe rreth 85mm të larta.-(228<sup>v</sup>) Hapësirë zbukurimi në formë shkronjash (rreth 30mm e lartë FX) dhe arabeska.

Kap.: Dy kapakë druri me mbulesë mëndafshi në ngjyrë të kuqe të errët, mbulesa e dëmtuar, njëra (nga dy) kapëset e lëkurës e ruajtur.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 360 (si Berat. 13); Aland Nr. 1705.

**13. 1181 (37<sup>r</sup>). Pergamenë.** 220 x 160 mm. 41 fl. (40fl.+1 = fleta e qëllimit [letër]). 1 kol., 20 rr. Ungjill. (1<sup>r</sup>-36<sup>r</sup>) Predikime për festat e palëvizshme, *inc. mut.* Ata i thonë asaj, grua përse qan... (= Gjoni 20, 13 për 22 korrikun; krhs.: Gregory f. 382-386).-(37<sup>r</sup>). Vërejtje e shkruarit, e ndjekur nga tre dymbëdhjetërrokësh:

Për atë që lexon me dëshirë,  
Për atë që ka shkruar me gishta,  
Për atë që ka përfituar, t'i ruajë të tre ose trininë.

(37<sup>v</sup>-38<sup>r</sup>) bosh.-(38<sup>v</sup>) shënime prej duarsh të mëvonshme. -(39<sup>r</sup>-40<sup>v</sup>) prej pjesës së paruarjtur të Ungjillit janë lidhur fol. 1-2 e duzinës së katërmbëdhjetë: *inc. mut.* Kërkonin që ta sillnin brenda të paralizuarin (= Luka 5,18 për të dielën e javës së 19-të pas Rrëshajave); *des. mut.* ra në dhe të mirë, dhe mbiu dhe dha pemë për njëqind (= Luka 8,8 për të dielën e javës së 21-të pas Rrëshajave; krhs. Gregory fq. 354-355).-(41<sup>r-v</sup>) bosh.

Gjr.: Në përgjithësi fort e ndotur dhe e nxirë; f.1 dhe 33 të dëmtuara me humje teksti.

Shk.: Ioannikios (f. 37<sup>r</sup>: Ky Ungjill i shenjtë i hyjshëm dhe i perëndishëm u shkrua nga dora e murgut dhe dhjakut të padenjë Joanik në vitin 6689).

Ngj.: Iniciale në ngjyrë të kuqe rreth 30 mm të larta; f. 4<sup>v</sup> kornizë zbukurimi e thjeshtë në

ngjyrë të kuqe dhe të kaftë.

Kap.: Vetëm kapaku i pasëm (dru me mbulesë lëkure) i ruajtur.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 365 (si Berat. 32); Alexoudis Ekk. Al. 20, fq. 526 (si Berat. 17); Aland Nr. 1207.

**14. Shek. i 14-të. Pergamenë.** 210 x 150 mm. 144 fl. (139 fl. + 20A + 67A + 77A + 78AB). 1 kol., 24rr.

Tipikon. (1<sup>r</sup>-139<sup>v</sup>) Typikon (Tekst si Typikon, Venedik 1643 me disa ndryshime); *inc. mut.* Në nart... (ndoshta narteks), a. a. O., fq.15, kol. 1.

Gjr.: Para f. 1 mbetje prej shtatëmbëdhjetë fletësh (me to ndoshta prej të gjithave); fort e ndotur, e nxirë dhe e dëmtuar me humbje të mëdha teksti, f. 2 e dëmtuar me humbje të pakta teksti, f. 3-25 pa humbje teksti. Prej f. 78 AB janë ruajtur vetëm copëza; f. 135-139 të dëmtuara me humbje të mëdha teksti.

Ngj.: Iniciale në ngjyrë të kuqe rreth 25 mm të larta dhe korniza të thjeshta zbukurimi në ngjyrë të kuqe.

Kap.: Mungon.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 365 (si Berat. 31); Alexoudis Ekk. Al. 20, fq. 526 (si Berat. 16).

**15. Shek. i 12-të. Pergamenë.** 155 x 120 mm. 195 fl. (197 fl. + 64A-195 dhe 196 [krhs. Cod. 23] deri 197 [krhs. Cod. 22]. 1 kol., 21rr.

Ungjill. (1<sup>r</sup>-140<sup>v</sup>) Lexime për festat e lëvizshme; *inc. mut.* Pa u bërë si fëmijë nuk hyni në mbretërinë e qiejve. (= Mateu 18, 3 për të hënën e javës së nëntë pas Rëshajeve; krhs. Gregory fq. 350-364).-(140<sup>v</sup>) Pinax i Ungjillit sipas Gjonit.-(141<sup>r</sup>) bosh.-(141<sup>v</sup>-142<sup>v</sup>) Hipotezë (Hypothesis ?) e Ungjillit sipas Gjonit; *inc.* Ungjilli i shkruar sipas Joanit. Pasi Joani vëllai i Jakovit dhe i Zebedeut... dhe tjetrin që...-(143<sup>r</sup>-194<sup>v</sup>) Ungjilli sipas Gjonit.

Gjr.: Fillimi i humbur; f. 1-3 të dëmtuara me humbje teksti, f. 4 pa humbje teksti. Mes 64 dhe 64A 1 fletë e shkëputur, prej 64A vetëm gjysma e poshtme e ruajtur. Pas f. 71, 142, 150 përkatësisht nga një fletë e shkëputur; f. 151 dhe 194 të dëmtuara me humbje teksti.

Ngj.: E thjeshtë, iniciale në ngjyrë të kuqe 10 mm të larta.

Kap.: Vetëm kapaku i pasëm (dru me mbulesë lëkure) i ruajtur, lidhja fort e çlirët.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 366 (si Berat. 36); Alexoudis Ekk. Al. 20, fq. 526 (si Berat. 20); Aland Nr. 1709.

**16. Shek. i 14-të. Letër.** 305 x 210 mm. 117fl. (114 fl. + 16A + 22A + 53A). 1 kol., 32rr.

Menaion (minej) për muajin mars. (1<sup>r</sup>-114<sup>v</sup>) Menaion për 1-31 mars (Menaion, vëll. 7 me disa ndryshime).

Gjr.: F.1-2 të dëmtuara me humbje të pakta teksti. Pas f.16 dhe 22 përkatësisht një fletë e shkëputur dhe e zëvendësuar me një të re (210 x 140 mm; shkrim i shek. XIX); f. 113-114 të dëmtuara me humbje teksti. Përgjithësisht me gjurmë uji dhe e ngrënë nga krimbat.

Ngj.: Iniciale në ngjyrë të kuqe rreth 55 mm. të larta.

Kap.: Dy kapakë druri, të ngrënë nga krimbat; lidhja e liruar.

**17. Shek. i 15-të. Pergamenë.** 270 x 205 mm. 174 fl. (173 fl. + 151A). 1 kol., 27-28 rr.

Dorëshkrim patristik (patrologji). (1<sup>r</sup>-<sup>v</sup>) Vasili i Madh, Epistula 22; *des. mut.* Të dobëtit (Saint Basile, Lettres. ed. Y. Courtonne. vëll. I, Letra 22/1-2, rr.34).-(2<sup>r</sup>) Basileios (?), Sermo asceticus; *inc. mut.* Sheh jetën (PG 31, 1512 B 3-1513 A 3). -(2<sup>r</sup>-7<sup>v</sup>) Basileios, Në lidhje me mëkatin ndaj Perëndisë [De iudicio Dei]; *des. mut.* Satanai shkatërrues (PG 31, 653 A-669 C 1).-(8<sup>r</sup>) Në lidhje me besimin [De fide]; *inc. mut.* E mori në dorëzim prej nesh. (PG 31, 689 C 3-692 C).-(8<sup>v</sup>-10<sup>v</sup>). Index moralium (PG 31, 692 D-700 A).-(10<sup>v</sup>) Moralia; *des.mut.* Prej fuqisë së tij, se (PG 31, 700 B 1-10).-(10<sup>v</sup>-16<sup>v</sup>) Moralia; *inc. mut.* Nuk ju them juve (PG 31, 721 A 2 -736 C 7).-(16<sup>v</sup>-20<sup>v</sup>) Fjala asketike [Sermo asceticus] (PG 31, 881 B-888 D).-(20<sup>r</sup>-24<sup>v</sup>) Kushtet sipas

shtrirjes [Regulae fusius tractatae], Prooimion (PG 31, 889 A-901 A).-(24<sup>v</sup>-52<sup>r</sup>) Dekrete asketike [Constitutiones asceticae]; *des. mut.* Duke pyetur mëson (PG 31, 1321 A-1388 C 14).-(52<sup>r</sup>-56<sup>v</sup>) Dekrete asketike [Constitutiones asceticae]; *des. mut.* sa erdhën e zunë. (PG 31, 1389 C 5-1400 C 6).-(57<sup>r</sup>-60<sup>r</sup>) Kapitulli i kushteve gjatë ndarjes [Regularum breviorum capitula], Nr. 194-349 (krhs. PG 31, 1052 D-1077 D, renditje krejt tjetër).-(60<sup>r</sup>-105<sup>r</sup>) Kushtet në gjerësi [Regulae fusius tractatae] (PG 31, 905-1052) me mungesat e mëposhtme: Ajo nuk kishte pretendime ndaj tij (917 C 2-920 B 2), pengojnë qëllimin prej genit të Izraelit, (936 B 3-937 B 4), parabola *vazhdon* prej të tjerëve vjen (937 D 4-961 A 5); 71<sup>v</sup>-72<sup>r</sup> dhe 88<sup>r</sup> bosh pa rënie teksti.-(105<sup>r</sup>-160<sup>v</sup>) Kushte sipas vendndodhjes [Regulae brevius tractatae], Nr. 43-350, u përgjigjen numrat e mëposhtëm:

(PG 31, 1080-1305): 114 (43), 157, 98, 3-5, 287, 6 (50), 288-9, 99, 158-9, 7-9, 85-86 (59-60), 187-9, 21-22, 160-3, 23-29, (70-76), 191, 126, 30, 192, (80), 89, 45-47, (134-6), 16, 204, 151, 122, (140), 173, 31, 195-7, 34, 164-5, 127, 199, (150), 97, 169, 202, 279, 283, 205-7, 17, 90, (160), 152, 172, 239, 208-9, 240-1, 48-49, 210 (170), 50-53, 280, 11, 174, 211-3 (178-180), 54, 175-6, 214, 242-4, 55, 215-6, (189-190), 245, 217, 56, 247-7, 218, 248, 219, 249-252 (199-202), 220, 57, 123, 177-8, 221-2, 137 (210), 58-60, 101, 91, 179, 61, 223, 12, 180 (220), 253, 62, 254, 224, 255-6, 63, 257-260 (228-231), 64, 225, 261-2, 65, 226, 267-270 (242-5), 66, 290-1, 227, 271 (250), 13, 286, 19-20, 67-68, 103, 15, 272, 139 (260), 181, 285, 284, 69, 182, 71-72, 292, 274 (275), 77-78, 230, 275, 113 (280), 79-80, 231, 184-5, 232, Reg fus., 54 (PG 31, 1044 AB) als Nr.287!, Reg. brev. 138, 93, 104 (290), 70, 94, 229, 112, 155, 2, 92, 18, 228, 14 (300), 202, 105, 74, 107, 273, 108-111, 154 (310), 153, 281, 293-5, 81-84, 296-301 (320-5), 95, 302, 125, 303, 140 (330), 186, 190, 304-5, 233-8 (335-340), 306-7, 276-7, 308-313 (345-350).-(160<sup>v</sup>-164<sup>r</sup>) Basileios (?), Poenae in monachos (PG 31, 1305 C-1316 C). (164<sup>r</sup>-173<sup>v</sup>) Athanasios, Jeta dhe vepra e atit tonë oshënar Andonit, [Vita Antonii]; *des. mut.* mundi fantazitë (PG 26, 837 A deri 876 B 1).

Gjr.: E mirë, f. 1 e dëmtuar dhe e ndotur me humbje teksti; fol. 87, 109, 110, 137-139, 141-2, 173 të dëmtuara pa humbje teksti; pas fol. 135 dhe 142 përkatësisht një fletë e shkëputur.

Ngj.: Iniciale të thjeshta në ngjyrë të zezë deri 15 mm të larta.

Kap.: Dy kapakë druri (të dëmtuar rëndë nga brejtja e krimbave), lidhja e çlirët.

**18. Shek. i 13-të-14-të. Letër.** 210 x 145 mm. 411 fl. (409 fl. + 4A + 275A). 1 kol. 26-28 rr (fol.1-61), 19-22 rr. (fol. 62-108), 44-70 rr. (fol. 109-194), 24-31 rr. (fol. 195-409).

Përmbledhje dorëshkrimesh teologjike.

(1<sup>r</sup>-12<sup>r</sup>) Mbetje të një traktati antikonoklastik (?); *des. mut.* Nuk ishte i ikonoklastëve-(12<sup>v</sup>-13<sup>v</sup>) bosh.

- (14<sup>r</sup>-85<sup>v</sup>) Niketas Stethatos, Antialogos (ed. A. Michel, Humbert dhe Kerullarios, Paderborn 1930, fq. 320-342).

- (86<sup>r</sup>-88<sup>v</sup>) Hadrian IV., Letër Basileios të Ohrit (Bessarione 1916, 27-29).-(89<sup>r</sup>-93<sup>v</sup>) Basileios, Letër Hadrian-it (Bessarione 1916. 31-33). (94<sup>r</sup>-102<sup>v</sup>) Germanos II., Letër Gregor-it IX. (Sathas, Biblioteka Mesjetare. II 39-46).

- (103<sup>r-v</sup>) *inc.* Shumë ishin dhe të mëdhenj kombet që ranë dakord, *des.* dhe njëmendshmërinë e lashtë të rehabilitimit të Ortodoksisë.

- (104<sup>r</sup>-108<sup>v</sup>) Gregori IX, Letër Germanos-it II. (Sathas, 1. c. 46 deri 49).

(109<sup>r</sup>-194<sup>r</sup>) Euthymios Zigabenos, Shpjegim i Psaltrit. [Commentarius in Psalterium] (PG 128, 41-1325). – (194<sup>v</sup>) prova shkrimi greqisht-latinisht.

(195<sup>r</sup>-216<sup>r</sup>) Katenë për odet e Testamentit të Vjetër dhe Testamentit të Ri.

- (216<sup>v</sup>) Parafrazë shembëlltyrash të Testamentit të Ri.

- (217<sup>r</sup>-315<sup>v</sup>). *inc. mut.* E dinin dhe tani dhe më përpara... që predikojnë Perëndinë; *des. mut.* Nëse nuk i provon ti i pari ato që thua, nuk është e nevojshme të flasësh për to. (316<sup>v</sup>) Shënim i shkruarit.-(317<sup>r</sup>) bosh.-(317<sup>v</sup>) Prova shkrimi nga dy duar.

- (318<sup>r</sup>-409<sup>v</sup>) Euthymios Zigabenos, Armaturë dogmatike; [Panoplia dogmatica]; *des. mut.* (374<sup>r</sup>). "Fjalët" (PG 130, 20 D deri 149 B 5).

Gjr.: Shumë e keqe, e ndotur, me gjurma uji, e prekur nga brejtja e krimbave, fletë të shumta të ngjitura, f. 1-13 dhe 345-409 të ruajtura pjesërisht; f. 14-28, 36, 40, 44, 49, 74, 75, 81, 85 të dëmtuara me humbje teksti; pas f.108 një fletë e prerë, qoshja e djathtë lart nga f. 217-316 e dëmtuar me humbje teksti.

Ngj.: Iniciale të thjeshta në ngjyrë të kuqe (deri 20 mm të larta), në f. 318<sup>r</sup> kornizë e thjeshtë zbukurimi.

Kap.: Dy kapakë druri, të dëmtuar rëndë dhe të ngrënë nga krimbat, në kapakun e pasëm mbetje lëkure.

Lit.: Alexoudis Deltion, fq. 363 (si Berat. 23); Alexudis Ekk. Al. 20, fq. 525 (si Berat.8).

**19.Viti 1823** (f. 51<sup>r</sup>, 73<sup>r</sup>, 73<sup>v</sup>). Letër. 155 x 100 mm. 159 fl. (162 fl. -1-2 [Kapaku i përparëm] deri 162 [Kapaku i prapëm]). 1-2 kol. Numri i rreshtave ndryshon.

Blllok shënimesh nxënësi.

- (2<sup>r</sup>-161<sup>v</sup>) përmban fjalorë (frëngjisht-italisht, italisht-greqishte e re, latinisht-greqishte e re, greqishte e re-frëngjisht), ushtrime fjalësh në greqisht, përkufizime filozofike, ushtrime matematikore, ushtrime zgjedhimi në latinisht, tabelë foljesh të parregullta të latinishtes.

Gjr.: Qoshet dhe skajet të ngrëna; f.149-157 të dëmtuara me humbje të pakta teksti.

Kap.: Dy kapakë letre, të përbëra nga f. 1+2 respektivisht 162; kapaku i pasmë përgjysmë i grisur dhe i lirshëm; lidhja e çlirët.

**20. Shek. i 15-të. Letër.** 145 x 150 mm. 15 fl. (më parë f. 349-363 të Cod. 4). 1 kol., 17-19 rr. Fragment agjiografik, homilie (?)

- (1<sup>r</sup>-2<sup>v</sup>) *inc. mut.* Ashtu si e ftohta dhe breshëri kur bien në rrymat detare, i bëjnë ato të fryhen, kështu me zjerjen e ziftit që lyen anijet i shkatërron dhe bien në thellësi të detit së bashku me agarinejtë dhe vetëm dhjetë anije shpëtojnë, me ndërmjetimet e Hyjlindëses dhe të gjithë shenjtorëve me Krishtin Jezu, Zotin tonë, lavdia dhe pushteti së bashku me atin e pafillim të tij dhe me shpirtin e tërëmirë dhe të tërëshenjtë tani e përherë dhe në jetët e pambaruara që do të vijjnë, amin!

- (3<sup>r</sup>-11<sup>v</sup>) Fragment homiletik; *inc. mut.* Por thesarin që ndodhet i siguruar në qiell, nuk mund ta matim me kritere monetare dhe sasiore, duhet ta ruajmë me vigjilencën e shpirtit. Pasi, ashtu si kusarët e vjedhin pasurinë kur gjumi e kap të zotit e shtëpisë, dhe do të përgatitet i arratisuri, kështu ndodh dhe me pasurinë shpirtërore; *des. mut.* Kështu edhe ne ta mbrojmë Zotin, në mënyrë që të duhemi dhe të mbrohemi dhe ne prej tij, ta mbajmë dhe ne besimin me duar, ashtu siç mbajmë diçka me gëzim. Dhe të mos e lëmë, që të na ndjehen mëkatet. Të kini guxim. Fjala e Lazarit të katërditshëm.-(12<sup>r</sup>-15<sup>v</sup>) Amphilochios von Ikonion, Fjala e Lazarit të katërditshëm [Oratio in Lazarum quatruiduanum]; *des. mut.* (fol. 15<sup>v</sup>) ik tutje (PG.39, 60 A-65 A 9).

Gjr.: Pesëmbëdhjetë fletë të gjysmës së sipërme të një dorëshkrimi, f. 13 e dëmtuar jashtë me humbje teksti, prej f. 14-15 ruhen mbetje të pakta.

Ngj.: Në f.12<sup>r</sup> iniciale të thjeshta në ngjyrë të kuqe, 30 mm të larta.

Shk.: Berg, ngjashëm Briquet 11653 (Neapel 1441-54).

**21. Shek. i 13-të. Pergamenë.** 310 x 220 mm. 6 fl. (f. 1-2 më parë f. 1-2 e Cod. 5; f. 3-6 më parë si f.1-2 dhe 141-142 e kod.8). 2 kol., 55 rr.

Fragment i një menaioni (minej) për muajin gusht.

(1<sup>r</sup>-4<sup>v</sup>) *inc. mut.* Me furi; në kaminë u çua. *des. mut.* Duke ndritur si ndriçues i tërë shkëlqyer. (Menaion, vëll.12, fq.7-14).-(5<sup>r</sup>-v) *inc. mut.* Në kohën e Dekiut, dhe shenjtë tepër i pasur *des. mut.* ujiti me shprestari (Menaion, vëll.12, fq.54-58).-(6<sup>r</sup>-v) *inc. mut.* vdiq dhe u varros *des. mut.* si zot dhe prift i parë. (Menaion, vëll.12, fq.72-74).

Gjr.: Fol. 1<sup>r</sup> gjysma e sipërme e ngjitur me kapakun e kopertinës së Cod. 5; f. 3 e një të tretës së poshtme e prerë; pergamena mjaft e errësuar.

Ngj.: Iniciale deri 10 mm të larta.

**22. Shek. i 15-të. Letër.** 100 x 135 mm. 1 fl. (më parë f. 197 e Cod. 15), 1 kol., 16 rr.

Fragment i një teksti teologjik.

(1<sup>r-v</sup>) *inc. mut.* U lidhën me martesë... jetë bashkëshortore... ushqente fëmijët... predikimi i apostull Palit; thuaj së hijshmes që unë ta mëshiroj... Eva... këto dhe e kalojnë atë.

Gjr.: Pjesë e mesit e një dorëshkrimi, mjaft e errësuar dhe e ndotur, vrima-vrima.

**23. Shek. i 14-të. Pergamenë.** 230 x 140 mm. 1 fl. (më parë f. 195-196 e Cod. 15). 1 kol., 32 rr. (1<sup>r</sup>) *inc.* Plaku i bëri pesëdhjetë; *des. mut.* luftoi mendimin (ngasjen). (Apophtegmata Patrum, PG 65, 129 D 5-132 A 11). – (1<sup>v</sup>) bosh.

Gjr.: Fletë në gjysmën e sipërme, djathtas e prerë, mjaft e errësuar dhe e ndotur.

**24. Shek. i 15-të. Pergamenë.** 220 x 140 mm. 2 fl. (më parë f. 603-604 të Cod. 5). 2 kol., 21 rr. Fragment i një triodi.

(1<sup>r</sup>) *inc. mut.* E lavdëruar në jetë... Në qepallat e nxënësve tani vjen gjumi, o Krisht... (= Triod f. 381).-(2<sup>v</sup>) *des. mut.* dhe (tregove) jetën e paprishur. (= Triod fq.409).

Gjr.: Skaji i djathtë i poshtëm i grisur me humbje teksti, fort i errësuar dhe i ndotur.

Ngj.: E thjeshtë, iniciale në ngjyrë të kuqe rreth 20 mm të larta.

**25. Shek. i 9-të. Pergamenë.** 265 x 145 mm. 1 fl. (më parë f. 1 e Cod. 6). 1 kol., 40 rr. të pjerrta.

Fragment agjiografik. (1<sup>r</sup>) Prova shkrimi nga shkrues të ndryshëm.-(1<sup>v</sup>) *inc. mut.* (Rr. 18) Dhe ja ungjillor Luka cakton karakterin e hyjshëm dhe të respektuar të së tërëqashtës, nënës së Perëndisë, Marias, që në trupin e saj mori jetë; *des. mut.* të Juljano Paravatit.

Gjr.: Pergamenë fort e errësuar dhe e shtrembëruar; shkrimi i zbehur. Skaji i brendshëm tregon mbetje të një flete të dytë.

#### Shtojcë:

Llambri Mitrusi përshkruan në një artikull<sup>6</sup> një dorëshkrim, sjellë më 1957 në Berat prej Manastirit të Shën Kozmait në Kolkondas. Gjatë qëndrimit tonë të atjeshëm nuk u krijua asnjë mundësi për ta shqyrtuar. Ai përfshin 96 fletë të formatit 225 x 155 mm si dhe 8 fletë të një formati më të vogël dhe përmban 303 kontrata martese të viteve 1819-43 shkruar në greqisht.

#### Listë e mikrofilmave:

Instituti i Bizantinistikës, i Universitetit të Vjenës, zotëron mikrofilma të dorëshkrimeve të mëposhtme: Tir. gr. 3, 5, 10, 14, 16, 17, 18 (vetëm f. 109<sup>r</sup>-216<sup>v</sup>, 318<sup>r</sup>-374<sup>r</sup>), 20-25.

#### Shënime bibliografike:

1. Jahrbuch der Osterreichischen Byzantinischen Gesellschaft, (JÖBG) 15 (1966), 391 -394.

2. I shprehim me këtë rast falenderimin tonë të përzemërt Arkivit të Shtetit të RP të Shqipërisë, për mundësinë që na u krijua të punonim lirisht dhe të papenguar mbi dorëshkrimet.

3. M. Richard, Répertoire des Bibliothèques et des Catalogues de Manuscrits grecs, Paris 1958 (*Publications de l'Institut de Recherche et d'Historie des Textes*). Në lidhje me këtë, për plotësim, të shihet edhe: A. Alexuodis, Përshkrimi i tre Ungjijve, në: Shoqata e Filologëve Grekë, shtojcë e vëllimeve 24-26, Konstandinopojë 1896, f. 114-117; bëhet fjalë për tre dorëshkrime ungjijsh në kishën e Shen Vlashit (Blasioskirche-K.J.) në Vlorë.

4. H. Hunger, Katalog i dorëshkrimeve greke të Bibliotekës Kombëtare të Austrisë, Pjesa 1: Codices Historici. Codices Philosophici et Philologici, Wien 1961 (*Museion* NF 4/1/1). Do të dëshironim të

falënderonim këtu për zemërsisht z. prof. Hunger dhe dr. Otto Kresten për ndihmesën e tyre në datimin e dorëshkrimeve si dhe për këshilla të shumta gjatë përpunimit të Katalogut.

<sup>5</sup>. E njëjta poezi në një trajtë disi të ndryshuar gjendet në Par. Gr. 1686, saec. XV, fleta e qëllimit B<sup>r</sup>.

Na godet në mendje vetëtima e logjikës 12/175<sup>r</sup>

Duke pasur Marku qëllim për ta shkruar 12/68<sup>v</sup>

Që ishin shumë dhe përmendnin kombe të mëdha 18/103<sup>r</sup>

Duke mos pasur guximin tënd engjëllor 12/1<sup>v</sup>

Më kot o njeri shtjellon kuptime të shumta 10/13<sup>v</sup>

Atë që lexon me dëshirë 13/17<sup>r</sup>

Një mijë pikëpyetje shqipton dhe duke kërkuar mjetin 10/13<sup>v</sup>

O Luka, mbrojtësi i Perëndeshës Bujqësi 12/103<sup>v</sup>

<sup>6</sup>. Kodiku i manastirit të Shën Kozmait (Der Codex des Klosters des hl. Kosmas), *Studime Historike* 3 (1965) 175-180 (me përmbledhje në frëngjisht, f.181).






65

Kodiku i 93-të, i Korçës; shek. XIII;  
fl. 12 v. Miniaturë: shembëllim i  
portretit të ungjillorit Mateu.

Kodiku i 93-të, i Korçës; shek. XIII;  
fl. 225 v. Miniaturë: shembëllim i  
portretit të ungjillorit Gjon.





Kodiku i 84-t, i Voskopojës; shek. XVIII; fl. 9 v. Shkrim me vlera kaligrafike, me nistore të zbukuruar me motive floreale dhe me forma gjarpëruese.

1. Kodiku i 35-të, i Beratit; shek. XIII-XIV; fl. 5 v. Vinjetë që gjendet në hyrje të tekstit të ungjillit sipas Gjonit. Anash duket shkronja nistore e zbukuruar.

2. Kodiku i 16-të, i Beratit; shek. XIII; fl. 1 r. Miniaturë: shembëllim i portretit të ungjillorit Mateu me engjëllin.





69

1. Kodiku i 38-të, i Beratit; shek. XIV; fl. 186 r. Miniaturë: shembëllim i portretit të ungjillorit Gjon, me nxënësin e vet Prohorin.

2. Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 97 r. Vinjetë dhe kryeshkronjë e zbukuruar.



1. Kodiku i 11-të, i Vlorës; shek. X; fl. 57 r. Vinjetë, vetëm në një rën kolonë, dhe nistore e zbukuar.

2. Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 233 v. Miniaturë: fasadë arkitekturore kishtare, zbukurim që paraprin tekstin e ungjillit sipas Gjonit (krerët).



1



2




1. Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 146 r. Miniaturë: fasadë arkitekturore kishtare, zbukurim që paraprin tekstin e ungjillit sipas Lukës (krerët).

2. Kodiku i 4-t, i Vlorës; shek. X; fl. 9 r. Vinjetë dhe kryeshkronjë e zbukuruar.



Kodiku i 24-t, i Beratit; shek. X; fl.  
3 r. Një nga kanonet e mirënjohur  
të Eusebit.







Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 93 r. Miniaturë: fasadë arkitekture kishtare, zbukurim që paraprin tekstin e ungjillit sipas Markut (krrerët).

Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 96 v. Miniaturë: shembëllim i portretit të një ungjillori para skrivanisë. Në sfond forma arkitekturore.






Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 236 v. Miniaturë: shembëllim i portretit të ungjillorit Gjon, me nxënësin e vet Prohorin (duke shkruar Zbulesën). Një nga miniaturat me vlera të rralla të artit të hershëm kishtar.


Kodiku i Artë i Anthimit (Beratinus-2); shek. IX; fl. 12 në origjinal.  
E njëjta fletë e rindërtuar. Kaligrafi tipike e ungjijve hrysografikë shkronjëvegjël.



Kodiku i Purpurt i Beratit; shek. VI; fl. 4 në origjinal. E njëjta fletë e rindërtuar. Kaligrafi tipike e ungjijve shkronjëmëdhenj të periudhës së krishtërimt të hershëm. Dallohet shkronja e stilit "uncial".




Kodiku i 15-të, i Beratit; shek. XI-XII; fl. 3 r. Kanon me zbulurime karakteristike me forma të harkuara.





Kodiku i 10-të i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 16 v. Miniaturë: shembëllim i portretit të ungjillorit Mateu. Një nga miniaturat më të bukura të kodikëve të Shqipërisë dhe përgjithësisht të artit paraikonografik. Në sfond duket arkitektura e një ndërtese me përmasë të tretë, të thellësisë.

Kodiku i 10-të i Vlorës; shek. XI-XII. Mbulesa origjinale me zbukurime në bareliev.





## THESARE KULTURORE QË I KTHEHEN POPULLIT <sup>1</sup>

ALEKS BUDA

Edhe librat kanë fatin e vet. Kjo fjalë e urtë e moçme të bie ndërmend menjëherë kur dëgjon për historinë e habitshme të dy kodikëve të lashtë, me prejardhje nga qyteti-muze i Beratit, njëri prej të cilëve ka moshën e respektueshme prej rreth 1400 vjetësh, ndërsa i dyti është *vetëm* njëmijë e njëqind...

Këto thesare të humbura u gjetën të dëmtuara rëndë dhe pasi u restauruan, iu kthyen më në fund popullit e kulturës sonë, të cilëve u përkitnin.

Në vitin 1885, kur studiuesi francez P. Battifol ndërmori një udhëtim të mundimshëm në atë provincë të humbur e të varfër të perandorisë osmane, siç ishte në atë kohë Shqipëria, ai mbeti i habitur që vetëm në Berat mundi ta pasuronte me 3 figura të reja<sup>2</sup> listën e kodikëve *krysografikë* të stilit bizantin, domethënë të shkruar me ar e argjend, listë që në atë kohë as nuk e arrinte një duzinë ekzemplarësh, të shpërndarë në bibliotekat e muzetë më të mëdha të botës. Le të shtojmë, me këtë rast, se edhe sot ky numër nuk ka mundur të rritet shumë... Dhe midis këtyre 3 numrave të rinj që u zbuluan atëherë, dy ishin kodikët për të cilët po bëhet fjalë sot.

Një fakt i tillë mund të jetë i habitshëm sot vetëm për ndonjë njeri që mundohet të shohë<sup>3</sup> me çdo kusht në një histori popullsish të prapambetura, që nuk paskan njohur një shkallë më të lartë qytetërimi dhe bashkë me këtë as nevojën e shkrimit.

Vetë Berati është një shembull i mirë për këtë, me arkitekturën monumentale civile<sup>4</sup> e të kultit, me veprat e pikturës murale e të kavaletit që stoliste nga brenda këto ndërtesa. Këtu ishte zhvilluar qysh herët një traditë e pasur në fushën e arteve të vogla të aplikuara, të artizanatit, të argjendarisë, të skalitjes, të qëndisjes me fije argjendi etj. Në këto kushte Berati u bë në një farë kuptimi qendër e një tradite artistike me tipare pak a shumë të kristalizuar, e cila rrezatoi prej këtej në krahina të tjera të vendit dhe ndikoi edhe në shekujt pasues në fushat e ndryshme të krijimtarisë artistike.

Në këto arte të aplikuara bënte pjesë edhe shkrimi, i cili ishte një art, deri sa e zëvendësoi revolucionin teknik i shtypshkronjës. Disa dhjetëra vëllime dorëshkrime kodikësh nga Berati, që kanë mundur t'u shpëtojnë rrebesheve të kohës e që shkojnë nga shekulli VI deri në fillim të shekullit XV, na japin të drejtën të nxjerrim përfundimin se edhe këtu kemi të bëjmë me një vazhdë e traditë të pandërprerë, që i përgjigjej një nevoje reale, ndonëse mjaft e kufizuar, të një shoqërie të ngritur e të zhvilluar, në të cilën shkrimi, si mjet komunikimi kulturor, luante padyshim një rol të rëndësishëm. Është fjala për kodikë prej lëkure të përpunuar (pergamenë), në ndonjë rast edhe prej papiri<sup>5</sup> dhe së fundi, në shekujt XIV-XV, edhe prej karte. Një varg nga këta kodikë, kryevepra të artit kaligrafik, janë pajisur me ornamente në ballë ose anës së fletës, me vinjeta dhe iniciale dekorative; disa prej tyre përmbajnë edhe piktura në miniaturë, me ngjyra e tipare shumë të holla e delikate, që pasurojnë fondin e veprave pikturale që njohim në vendin tonë. Shumica e tyre nuk kanë të dhëna për kohën kur u hartuan, as edhe për shkruetin e tyre.

Analiza paleografike e tipit të shkrimit na lejon të themi se, përveç dy kodikëve që u përmendën në fillim, si të shekullit VI e IX, shumica e dorëshkrimeve të ruajtura nga Berati në Arkivin tonë Qendror të Shtetit, u përkasin shekujve XI-XII dhe XIII, kur mund të supozojmë se ky qytet ka njohur fazën e lulëzimit të tij të madh. Por arti i të shkruarit ka vazhduar në Berat edhe më

vonë, me gjithë kushtet e vështira që krijoi stuhia shkatërruese e vërshimeve osmane. Është interesant të vemë në dukje se ndërsa, nga njëra anë, sunduesi i vendit, Teodor Muzaka, merrte masa për të siguruar e shpëtuar “nga frika e turqve” dorëshkrimet e vyera e të lashta të këtij qyteti, 10 vjet më vonë, më 1410, siç e thotë vetë shkruesi, me porosi e shpenzime të “qefalisë” (sundimtarit) të qytetit, mbarohej së shkruari në Berat një kodik i ri”. Kështu, mund të themi, kalonte stafeta nga dora në dorë.

Nuk duhet të na habisë fakti se nga përmbajtja tërësia e këtyre kodikëve beratas kanë karakter kishtar, u shërbejnë nevojave të kishës së krishterë, janë shkruar në greqishten bizantine, ashtu si ndjekin edhe ornamentikën dhe stilin paleografik bizantin. Ky është një fenomen historik i natyrshëm, do të thonim, në një kohë kur monopolin e kulturës në gjithë Europën e kishte kisha. Pikërisht për këtë arsye gjuhët e saj<sup>6</sup>, latinishtja dhe greqishtja, ishin bërë edhe gjuhët e kulturës universale dhe diferencimi në gjuhë kulturore nacionale duhej të çante rrugë me luftë kundër mbisundimit të tyre. Dihet se në Shqipëri ky fenomen filloi të shfaqej në hapat e tij të para duke filluar nga shekulli XIV.

Pavarësisht nga këto kufizime në përmbajtjen e tyre, dy kodikët më të lashtë nga dorëshkrimet e Beratit kanë një vlerë të rëndësishme jo vetëm nga pikëpamja historike në përgjithësi, si dëshmi të zhvillimit kulturor-shoqëror të vendit, por edhe nga pikëpamja paleografike, si monumente të lashta të historisë së shkrimit dhe tekstologjisë, si dokumente të literaturës paleokristiane në veçanti.

Më i rëndësishëm, duke qenë më i lashtë, është padyshim kodiku që në gjuhën e shkencës njihet me emrin “*Codex Purpureus Beratinus F*” (Kodiku i Purpurt nga Berati); gërma e ndajshuar përcakton radhën që zë ai në vargun e dorëshkrimeve më të lashta të ruajtura të “*Testamentit të R*” kristian. Kodiku në fjalë, në formën që arriti deri në ditët tona, kishte 190 fletë pergamene, të ngjyera në të kuq të thellë (purpur); ai ishte shkruar me gërma argjendi të tretur, me përjashtim të disa faqeve, ku disa fjalë janë shkruar me ar. Gërmat janë të tipit kuadrat, uncialë majuskule. Shkrimi është i vazhdueshëm, pa ndarje midis fjalëve. Format i fletëve është 314 x 268 milimetra. Analiza e gërmave dhe krahasimi me tekstet e pakta të ruajtura të këtij tipi, i ka shtyrë shkencëtarët t’i caktojnë Kodikut të Purpurt të Beratit shekullin VI si kohë lindjeje.

Kodiku i dytë nga Berati, që na intereson në këtë mes, njihet në shkencë me emrin “*Codex Aureus Anthimi*” (Kodiku i Artë), i mbiquajtur kështu sipas emrit të një peshkopi të Beratit në shekullin XIX<sup>7</sup>. Siç e thotë edhe emri, ky kodik ishte shkruar mbi pergamenë me gërma ari të tretur dhe përbën, për këtë arsye, gjithashtu një realitet<sup>8</sup>, ndonëse si kohë hartimi, analiza paleografike i cakton një epokë më të re, shekullin IX. Si vëllim, Kodiku i Artë është shumë më i madh, ka 413 fletë në format 24 x 19 cm dhe është shkruar me gërma të një tipi më të ri, të rrumbullaktë e me bishta, të quajtur korsiv minuskul. Kodiku ka një ornamentikë mjaft të pasur dhe 4 miniatura. Nga pikëpamja tekstologjike, teksti i kodikut të artë nuk paraqet ndonjë interes, ai është teksti tani i fiksuar i Testamentit të Ri.

Ekzemplarë të shkrimit në argjend e ar janë shumë të rrallë. Në mesjetë arti i shkrimit përjetoj një të tatëpjetë të përgjithshme, që shpjegohet me ndryshimet e rëndësishme ekonomiko-shoqërore që vihen re lidhur me rënien e shoqërisë së vjetër skllavopronare, ndërsa formacioni i ri social-ekonomik që po lindte, karakterizohej në këtë periudhë nga një primitivitet mjaft i theksuar. Lidhur me këtë u ngushtua mjaft përdorimi i shkrimit, kaq i përhapur në kohë antike. Tiparet e gërmave dhe arti e teknika e shkrimit në përgjithësi karakterizohen nga një lloj “*barbarizimi*”. Në këto kushte, ruajtja dhe përdorimi i artit të shkrimit në një lartësi teknike të tillë, siç e dëshmojnë kodikët tanë beratas të shekujve VI dhe IX, dëshmon për vazhdimësinë e traditës së antikës dhe për një nivel të lartë kulturor që ruajtën disa vende të Europës Juglindore, midis tyre edhe vendi ynë, në rrethanat e një tatëpjetë të përgjithshme që përfshiu Europën Perëndimore<sup>9</sup>.

Porse, veç kësaj rëndësie si monumente të historisë së shkrimit e të kulturës, nuk mund të lihet pas dore edhe rëndësia e një karakteri tjetër e Kodikut të Purpurt të Beratit. Shkenca

përparimtare botërore është e interesuar prej kohësh të studiojë historinë e formimit të tekstit të të ashtuquajturave “shkrime të shenjta” të kristianizimit <sup>10</sup>. Kundrejt përpjekjeve të kishës për t’i deklaruar këto si “tabu”, si të paprekshme, të lindura të gatshme nga “frymëzimi hyjnor” dhe prandaj jashtë kompetencës së arsyes njerëzore, shkencë përparimtare, në luftë të ashpër kundër autoritetit kishtar, ka krijuar një degë shkencore të tërë, të quajtur “kritikë tekstologjike e Biblës”, për të vërtetuar historinë e formimit gradual të saj. Është e qartë se për të përcaktuar sa më afër e më saktë tekstin fillestar të Biblës, duhet të njihen së pari variantet e saj më të vjetra; me anë të krahasimit të tyre mund të nxirren në shesh grupet e familjet kryesore të këtyre varianteve dhe mund të hidhet dritë mbi rrugën e formimit historik të këtij teksti themelor të kristianizimit. Një analizë paraprake lejon të thuhet se Kodiku i Purpurt i Beratit ka disa lexime tekste që janë të veçanta për të; në formimin e tekstit të tij kanë kontribuar tradita të ndryshme, që lidhen edhe me Lindjen, me Sirinë, edhe me Perëndimin. Kuptohet, prandaj, përse shkencë vazhdon të interesohet për Kodikun e Purpurt të Beratit, si një nga variantet më të lashtë të tekstit të Testamentit të Ri. Në një botim shkencor, tekstei i dhënë nga Kodiku i Purpurt i Beratit duhet patur domosdo parasys.

Është kjo arsyeja që bota shkencore shqiptare dhe në përgjithësi shkencë ndërkombëtare, u janë mirënjohës institucioneve të Akademisë së Shkencave të RP të Kinës, që mundën të shpëtonin nga vdekja e sigurt dy kodikët e vyer të Beratit. Të fshehur gjatë Luftës së Dytë Botërore, dy kodikët mbetën për më se 20 vjet në qimitirin e lagur të një kishe të Beratit, ku u gjetën, më në fund, pas kërkimesh këmbëngulëse, për t’i siguruar tani përfundimisht për shkencën e kulturën tonë.

Na pëlqen të tregojmë, me këtë rast, se si nganjëherë historia përsëritet. Peripecitë e vuajtjet që pësuan gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore kodikët tanë beratas nuk i pësuan për të parën herë. Shënimet kronikale të ruajtura në disa dorëshkrime të tjera, gjithashtu me prejardhje nga Berati, tregojnë se edhe në vitin 1356 edhe në vitin 1400 kodikët e ruajtur në këtë qytet u detyruan të merrnin rrugët për të gjetur strehim e për t’u fshehur nga rreziku i ushtrive të huaja që po i kanoseshin qytetit. Me këtë rast, shkruarit e këtyre shënimeve kanë rreshtuar emrat e kodikëve të vyer, që ata u kujdesën t’i “evakuonin” dhe nuk çuditemi që midis tyre, pranë kodikëve që ndërkohë kanë humbur, figuron edhe Beratas ynë i Purpurt me germa të argjendta. Edhe diçka më tepër: edhe në këto kohëra të lashta kishte njerëz patriotë, që i donin dhe dinin t’i çmonin librat. Shënimi na thotë se më 1356, dy vetë ngarkuan mbi shpatullat e tyre 27 kodikë dhe i shpëtuan duke i çuar në një vend të sigurt. Nga mirënjohja, na jepet dhe emri i këtij patrioti beratas të shekullit XIV, të quajtur Skuripeqi. Tradita e Skuripeqëve nuk u shua në Berat. Gjatë luftës nacionalçlirimtare, qytetarë beratas u qëndruan me rrezik jete nazistëve që kërkonin të grabitnin dorëshkrimet e ruajtura. Më në fund, meriton të përmendet patrioti plak Nasi Papapavli, i cili mori pjesë aktive në gjurmimin e kodikëve të humbur.

#### **Shënime të redaksisë:**

1. Botuar për herë të parë në të përditshmen “Zëri i popullit”, 28 janar 1972. Ribotohet me ndonjë shkurtim të vogël.
2. Në kuptimin “tituj”, “vepra”, “dorëshkrime”.
3. Nënkupto: „tek shqiptarët“ (fjalë që mungojnë në tekstin e autorit).
4. Me kuptimin „laike“.
5. Në Fondin 488 nuk ka dorëshkrime në “papur” a “papyrus”, por kjo nuk e përjashton ekzistencën e tyre më herët.
6. Gjuhët kishtarë, gjuhët e liturgjisë.
7. Është fjala për Anthem Aleksudhin, që shkroi i pari për kodikët e Beratit. Për nder të tij Batiffoli e quajti këtë kodik me emrin e mitropolitit.
8. Siç është në tekst. Por duhet të jetë radhitje e gabuar e fjalës „raritet“, „gjë e rrallë, e jashtëzakonshme“.
9. U ruajt ky vlerësim i diskutueshëm i autorit, për të respektuar frymën e kohës.
10. Shih shënimin 9.



## RRETH RIZBULIMIT TË DY KODIKËVE TË BERATIT\*

JOHANNES KODER

Në një artikull të shkurtër në gazetën shqiptare “Zëri i popullit”, historiani pranë Universitetit të Tiranës, Aleks Buda, raporton mbi rigjetjen e dy kodikëve të hershëm në Berat, Shqipëria e Jugut<sup>1</sup>. Bëhet fjalë për të famshmin Codex Purpureus Beratinus  $\Phi$ , të fillimit të shek. të 6-të dhe për Codex Aureus Anthimi, të shek. të 9-të. Të dy mbaheshin-tok me të tjerë-që prej Luftës së Dytë Botërore, si të humbur, dhe nuk figurojnë për këtë arsye edhe në katalogun e vogël të dorëshkrimeve në greqisht të Tiranës<sup>2</sup>.

Ata u zbuluan vërtet para pak kohësh në një dhomëzë të lagësht varri të një kishe në Berat dhe për shkak të gjendjes së tyre të përgjithshme të dëshpërueshme iu përcollën menjëherë Akademisë së Shkencave të RP të Kinës, për restaurim. Prej andej u rikthyen në Shqipëri në fillim të vitit 1972, të restauruar e të konservuar dhe-ashtu si dorëshkrimet e tjera, në greqisht, të Shqipërisë-iu dorëzuan për ruajtje Arkivit Shqiptar të Shtetit në Tiranë.

Është një gëzim i madh që të dy dorëshkrimet e çmueshme, të cilët deri më tash qenë të konsultueshëm vetëm përmes përkthimit në Katalogun e Dorëshkrimeve të Beratit, të Anthimus Alexoudes<sup>3</sup>, iu ridhuruan kështu shkencës.

Nëse krahasohet përkthimi i vjetër i A. Alexodes me atë të A. Budës në “Zëri i popullit”, del në pah në mënyrë të qartë se, me gjithë rrethanat e këqija të ruajtjes, nuk rezultojnë humbje fletësh në asnjërin prej të dy dorëshkrimeve. Deri sa të dalë një hulumtim shkencor nga pala kompetente shqiptare, për informacion paraprak mbi gjendjen e sotme të të dy dorëshkrimeve, duhet t’u referohemi fjalë për fjalë të dhënave të Budës dhe Alexoudes-it:

Beratinus 1 (“Codex Purpureus Beratinus  $\Phi$ ”).

Shek. i 6-të. Pergamenë e purpurt. 314 x 268 mm. 190 fl. 2 kol. 17 rr. Bojë argjendi. (Inicialet bojë ari).

Fragment ungjijsh (Mateu e Marku).

Beratinus 2 („Codex Aureus Anthimi“).

Shek. i 9-të. Pergamenë. 240 x 190 mm. 413 fl. 1 kol. 17 rr. Bojë ari. Ungjill. Në krye të çdo teksti, miniaturë (pamje e plotë) e secilit ungjillor.


### **Shënime bibliografike:**

\* Botuar në „Byzantinische Zeitschrift“, München, 1972.

1. A. Buda, Thesare kulturore që i kthehen popullit, „Zëri i popullit“, 23 (7315), 28.01.1972, f. 3 me dy pamje; të krahasohet edhe lajmi i shkurtër në „Zëri i popullit“ 13 (7305), 16.01.1972. Për sugjerimet e vlefshme dhe përkthimin e të dy artikujve falënderoj shumë përzemërsisht z. dr. Robert Schwanke të Institutit të Lindjes në Vjenë.

2. J. Koder-E. Trapp, Katalog i dorëshkrimeve në greqisht në Arkivin e Shtetit në Tiranë, Jahrb. Österr. Byz. Ges. 17 (1968) 197-214.

3. A. Alexoudes, Katalog i kishave të shenjta të lagjes Kala, qyteti i Beratit të mitropolisë të Beogradit /Beratit/, si dhe dorëshkrimet e vjetra të ndodhura. Delt. Hist. Ethnd. Het. 5 (1900) 352-369; atje janë përshkruar si kodiku 1 dhe 2 në f.352. krhs.: P. Battifol, Les manuscrits grecs de Bérat d’Albanie et le codex purpureus  $\Phi$ , Arch. des Missions scient. et litt. III 13 (1887) 441-456.



## KATALOG I KODIKËVE KISHTARË MESJETARË TË SHQIPËRISË

THEOFAN POPA

87

### Beratinus-1

Kodiku i Purpurt i Beratit njihet në botën shkencore me emrin “Codex Purpureus Beratinus”. Ky thesar dorëshkrimor, më i vjetri i lashtësisë sonë, ruan vetëm dy ungjij: të Mateut dhe të Markut. Përbëhet prej 190 fletësh pergamene të ngjyrosura në ngjyrë të purpurt, në të kuqe të thellë, sot shumë e zbehtë. Grafia e kodit është me shkronja argjendi të tretur. Disa fjalë janë të shkruara me ar. Shkronjat janë kapitale, të tipit të përzier, kuadrat, (unciale majusculë). Shkrimi është i vazhdueshëm, pa ndarje midis fjalëve. Nistoret janë të mëdha, por jo të stolisura.

Formati i fletëve është 314 x 268 milimetra. Teksti është në dy kolona, me 17 rreshta për kolonë dhe me një motiv dekorativ të thjeshtë.

Përveç shkrimit kaligrafik, që paraqitet si art më vete, kodiku ruan një dekor me një motiv prej zemrash, që përbrenda kanë nga një lilan tri petalesh. Ky është një motiv interesant për vjetërsinë. Motivi përfshihet brenda dy linjash paralele të vendosura vertikalisht dhe që kryqëzohen horizontalisht, duke krijuar një kënd të drejtë.

Ky motiv i thjeshtë, që simbolizon epiqendrën shpirtërore të njeriut, si më i vjetri në bibliografinë tonë më të lashtë, trashëgohet në kodikë tanë më të vonë, në mënyrë identike, si në Kodikun nr. 4 të Beratit, në Kodikun nr. 8 të Beratit. I stilizuar motivi gjendet edhe në zbukurimoren e disa kodikëve të tjerë, si në Kodikun nr. 5 të Vlorës dhe në Kodikun nr. 11 të Vlorës.

Ky kodik është dëmtuar rëndë gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke qenë i fshehur për një kohë të gjatë në Berat. Është restauruar, por paraqitet mjaft i dëmtuar.

### Beratinus-2

Ky kodik u quajt prej Batiffol-it me emrin “Codex Aureus Anthimi”. Kjo për nder të emrit të peshkopit të Beratit, Anthim Aleksudhi, i cili e kishte ndihmuar Batiffol-in për të njohur antikitetet e Beratit.

Kodiku në fjalë është katërungjillësh, me 420 fletë pergameni, me tekst në njëshkolonë, me format 24 x 19 cm, me grafi prej shkronjash të vogla korsive ari të tipit të vjetër dhe me 17 rreshta për faqe.

Kodiku ka qenë i stolisur me katër figurat e ungjillorëve, të dekoruara me korniza të gjera, me katër vinjeta, nga të cilat tri ruhen, ndonëse mjaft të dëmtuara, kurse e katërta është zhdukur krejt. Nga pjesë të ruajtura të kornizave dhe pjesë të vinjetave është bërë rindërtimi i plotë i tyre në një kopje identike të këtij kodiku.

Çdo figurë e ungjillorëve është pikturuar brenda një katërkëndëshi me përmasa rreth 12 x 19 cm. Janë kompozuar thjesht, pa ndonjë sfond arkitekturor, madje pa tryezën e shkrimit, brenda një katërkëndëshi të ngushtë, saqë figura e Shën Gjonit del pak përmbi linjën e sipërme përkufizuese. Megjithatë, këto figura paraqiten të trajtuara bukur: Shën Gjoni ulur mbi një fron me mbështetëse të lartë të harkuar nga sipër, kurse Shën Marku e Shën Luka mbi stola të vegjël prej druri, në pozicion pak të përkulur mbi ungjillin e hapur që mbajnë mbi gjunjë.

Për portretet e këtyre figurave Batifol-i ka shkruar, qysh në shekullin e 19-të, se “ato janë shuar tërësisht”. Sot ato mund t’i shohim në siluetë. Pjesët e tjera të figurave paraqiten, gjithashtu, të dëmtuara shumë. Tek Shën Marku mungon gjithë pjesa e pergamenit mbi të cilën është pikturuar ungjillori ndenjur. Ngjyrat e veshjeve sot paraqiten si një fushë e rrafshhtë ngjyrë kafeje të errët, të turbullt. Trajtimi i figurave është i një stili grafik të thatë. Rrudhat përcaktohen me anë linjash të zeza, të thyera e të drejta, kurse me linja të lakuara piktori anonim është përpjekur të arrijë format e gjymtyrëve dhe pozicionin e kërrusur të figurave. Kështu, ndonëse të thjeshta, por me vizatim të saktë, këto figura vlerësohen për një finesë të theksuar në vizatimin e siluetës. Pozicionet e figurave pak të kërrusura karakterizohen nga eleganca.

Proporcionet e figurave pak të kërrusura, po të krahasohen me ato të miniaturës më të mirë të shekullit të 10-të, të Kostandinopojës, me siguri do të duken si të një tipi gati naiv, siç e ka vënë në dukje Batifol-i. Për t’i pasuruar artistikisht këto figura të thjeshta, artisti i ka stolitur me korniza të bukura të trefishta, mbushur me motive gjeometrike e shirita të gërshetuar, me medalione të vegjël si vargje prej rruazash ari ose lilanë të stilizuara, të gjitha prej ari, mbi sfondin e purpurtë, me një ton si në blu të errët.

Këto stolisje të kornizave me motivet e tyre të stilizuara florale e gjeometrike, përbëjnë një zbulim artistik jo të zakonshëm, i cili, si pjesë përbërëse e pandarë e kompozimit në tërësi, ia rrit vlerën artistike figurës së pikturuar. Pa këto dekorime të pasura e të bukura të kornizave të gjera, figurat do të paraqiteshin tepër të varfëra, si të cinguara.

Nga katër vinjetat e kodikut ruhen vetëm tri, të vizatuara edhe këto në formë katërkëndëshi kënddrejtë, prej katër brezash të mbushur me motive gjeometrike e florale të stilizuara, me motive shtesë brenda medalionesh të vegjël, ose me motivin e sovajkave, të vendosura në formë zigzagu. Piktori ka krijuar me to trekëndëshe. Fushat e brendshme të vinjetave kanë titullin e ungjillit përkatës. Tek ajo e Ungjillit sipas Lukës ky është shkruar në formë kryqi përfshirë prej një linje të trashë. Tek vinjeta e Ungjillit sipas Markut titulli përfshihet prej dy rrathësh të mëdhenj dhe tek ajo e Ungjillit sipas Gjonit - brenda një fushe katërkëndëshe.

Duke u mbështetur në kaligrafinë me shkronja të vogla ari dhe në tipin korsiv të vjetër të shkronjave, në inicialet e pazhvilluara, në motivet gjeografike e florale të stilizuara të kornizave, si dhe në linjën elegante të trajtimit të figurave, mendojmë që kodiku Beratinus-2 mund t’i atribuohet gjysmës së dytë të shekullit të nëntë dhe mund të shkojë deri nga dekadat e fundit të atij shekulli. Në favor të këtij datimi mendojmë se flet edhe ngjashmëria e kodikut tonë me kodikë të huaj si Cod. Gr. 53 i shën Peterburgut, që K. Witzman e daton te shek. të 20-të.

### **KODIKU I 3-TË, I BERATIT**

(PERIKOPE UNGJËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 28 x 18 cm.

Sasia e fletëve: 145.

Teksti: Në dy kolona për faqe.

Kapakët: Nuk ka pasur.

Ngjyra e shkrimit: Kafe, titujt janë në kafe të kuqërremtë.

Datimi: Gjysma e dytë e shek. IX. Ngjan me Cod. Urbin, Gr. 61 (Vatikan) dhe Cod. Plut. (Laurenziana).

Dekoracione: Ruan dy vinjeta, një në fletën e 2-të dhe tjetrën në fletën e 109-të. Dekoracionet janë në ngjyrë kafe me nuanca. Ka dhe inicialet / nistore / të pikturuara.

Anëshkrime: Ruan një anëshkrim në fletën 143, ku lexohen fjalët: “Fjeti shërbëtori i Perëndisë Mihaili Sidhirofa, në muajin janar 13, ditën e dielë, ora 9.00”.



Vërejtje: Nuk kuptohet se çfarë vlere i jep shifra  $\rho$  greke, vendosur mbi omegën ( $\omega$ ), që dihet se tregon numrin 100.

Fleta e parë e dorëshkrimit është i ndonjë kodiku tjetër dhe duhet të jetë vënë për mbrojtje, meqë Kodiku i 3-të i Beratit nuk kishte kapakë. Teksti i ka shkronjat mjaft të zbehta, sa që herë-herë nuk lidhen fjalët.

Gjendja e kodikut: Ky dorëshkrim ka pësuar shumë dëme. Prej fletës së parë deri në të nëntën është ngrënë pergamena në cepin e majtë ku lidhen fletët, duke dëmtuar mjaft edhe tekstin e kolonës së majtë, sidomos prej fletës 2 deri në fletën 8.

Në fletën 3, në mes të kolonës së djathtë, është ngrënë pak pergameni, por duke mos i zhdukur shkronjat. Gjithashtu në fletën 12 kolona e djathtë ka pësuar pak grisje duke dëmtuar tri shkronja. Prej fletës 13 deri në fletën 16, kolona e djathtë, në të shtatë rreshtat e sipërm, e ka të holluar pergamenën, duke dëmtuar shkronjat, kurse fleta 14, nga hollimi i pergamenës, ka dëmtime në pjesën e poshtme të kolonës së majtë dhe asaj të djathtë. Në fletën 18, kolona e djathtë, rreshtat e sipërm, si dhe në fletën 19, pjesa e poshtme të dy kolonat, janë dëmtuar mjaft nga hollimi i pergamenës. Në fletët 21, 22 dhe 23 është dëmtuar teksti i kolonës së djathtë. Në fletën 26 ka një grisje të rrumbullakët të pergamenës në kolonën e djathtë sipër, duke dëmtuar në pjesën fundore rreshtin e tretë e të katërt. Në fletën 47 kanë humbur dy-tri shkronja në rreshtat 3, 4 dhe 5 të kolonës së djathtë. Sipër fletës 55 ka një grisje në kolonën e majtë, deri në rreshtin 5. Fletët 59, 60, 61 dhe 62 e kanë të dëmtuar tekstin në rreshtin e fundit të kolonës së majtë nga grisja e pergamenës. Fleta 79 ka një grisje në rreshtin 12 nga poshtë të kolonës së djathtë, grisje që ka kaluar mjaft dhe në të majtën. Fleta 86 ka një grisje në katër rreshta të kolonës së djathtë. Në fletët 94, 95 e 96, në kolonën e majtë, rreshtat 4, 5 e 6 kanë të ngrëna në pergamenën e holluar nga dy-tri shkronja. Fleta 114 ka një humbje teksti (çngjyrosje) në rreshtin 7 nga poshtë në kolonën e djathtë. Fleta 126, në rreshtin e fundit të kolonës së majtë, ka të grisura tri shkronja nga hollimi i pergamenës. Fletës 127, nga dëmtimi i pergamenës, i janë zhdukur mjaft shkronja të kolonës së djathtë. Të dyja kolonat e fletëve 130 dhe 133 kanë një shqyerje të vogël mbi rreshtin e tretë nga poshtë, pa e dëmtuar shkrimin. Prej fletës 139 deri në fletën 144 dorëshkrimi ka një vrimë në rreshtin 4 të kolonës së djathtë, e cila vjen duke u zmadhuar e duke dëmtuar shkronjat deri në fletën e fundit 145; kurse prej fletës 142 deri në atë 145 është hapur një vrimë tjetër, po në kolonën e djathtë, duke dëmtuar rreshtin 4 e 5.

Fleta e fundit, në cepin e sipërm, ka të dëmtuar rreshtat e kolonës së djathtë. Tre rreshtat e parë janë zhdukur krejt, i katërti ruan shkronja, kurse i pesti ka të dëmtuara disa shkronja. Në fletën e fundit teksti i perikopesë është i pambyllur.

Rreshtat e kolonave: Çdo kolonë ka 25 rreshta.

## **KODIKU I 4-T, I BERATIT**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 20.5 x 16 cm; trashësia 9 cm.

Sasia e fletëve: 238.

Teksti: Me një kolonë, me 25 rreshta për faqe.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë dhe kjo riveshur sipër me pëlhurë, që ruhet në mënyrë fragmentare.

Grafia e tekstit: Kafe e çelët në të kuqe. Shënimet e kanoneve, si dhe titujt e ungjijve dhe inicialet e perikopeve, janë prej ari.

Kodi përmban katër ungjijtë: Ungjillin sipas Mateut, sipas Markut, sipas Lukës dhe sipas Gjonit.

Në gjashtë faqet e para janë vënë kanonet që tregojnë perikopetë, që lexohen gjatë gjithë vitit, sipas festave. Kanonet janë ato të Eusebit. Ka dhe shënime rreth kanoneve.

Zbukurime: Në tri fletët e para ruhen gjashtë kanone me ornamente prej skenash të ndryshme, të pikturuara me motive lulesh të stilizuara, ku mbizotëron më tepër bluja, kurse kornizat e tyre përkufizuese janë prej linjash ari. Janë pikturuar nga dy pallonj, thëllëza dhe tre çifte zogjsh të stilizuar, mbi çdo kanon nga dy shpezë.

Kodiku ka vinjeta të pikturuara me të njëjtat motive lulesh si dhe kanonet. Këto gjenden në fletët: 6, 7, 9, 73, 74, 75, 113, 115, 117, 186, si dhe në fletën 189, recto e verso. Kodiku ka figura të pikturuara. Në fletën 8 është figura e ungjillorit Mateu. Ndërmjet fletës 74 e 75 është marrë një fletë, në të cilën ka qenë figura e ungjillorit Mark. Në fletën 116 ruhet figura e ungjillorit Luka. Në fletën 189 ruhet figura e ungjillorit Gjon. Këto figura, ndonëse kanë pësuar shumë dëme, sidomos në portretet, paraqiten nga më interesantet për nga vlera e tyre artistike, vështruar nga çdo aspekt, si në kompozimin real të tyre, si për ngjyrat e kultivuara dhe gracioze, përdorur në mënyrë harmonike, por sidomos për arritjen e tyre me një plastikë të theksuar reale, që vërehet më mirë tek figura e Shën Lukës.

Grafia e teksit mund të thuhet se do të jetë marrë nga kaligrafët më të shquar në përgjithësi në artin e kaligrafisë bizantine - është grafi e dorës së parë nga çdo aspekt. Gjithashtu, sa u takon zbukurimeve, si për kanonet dhe vinjetat, për motivet e luleve dhe për dekoret e ndryshme, mund të thuhet se janë të një niveli shumë të lartë artistik. Sa për shpezët, pallonjtë, thëllëzat, zogjtë e stilizuar, këto flasin për vjetërsinë e këtij kodiku dhe për ndikimin e tipareve antike.

Të gjitha këto na bëjnë të pohojmë se burimi i këtij kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 10-të. Fleta e fundit nuk ka lidhje me shkruesin e kodikut, ajo është përdorur për të përfunduar lidhjen e kodikut. Kjo fletë përmban një pjesë nga teksti i Ungjillit sipas Gjonit, pikërisht pjesa që bën fjalë për episodin e dënimit / faljes së lavires.

## **KODIKU I 5-TË, I VLORËS**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 23 x 18 cm.

Sasia e fletëve: 308.

Teksti: Në një kolonë, me 22 rreshta.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë dhe me pesë figura të punuara në pllaka argjendi, nga të cilat katër janë me figurat e ungjillorëve: të Mateut, Markut, Lukës dhe të Gjonit; secila me përmasa 7 cm x 5.5 cm. Kurse pllaka e mesit përmban një skenë të punuar me savat në basoreliev. Figurat në portrete janë mjaft të dëmtuara. Ungjillorët janë punuar në gjysmëfigurë. Pllakat janë mbërthyer me gozhdë argjendi me koka të rruzullta, që dalin mbi sipërfaqe për të mos dëmtuar basorelievin e figurave. Figurat e ungjillorëve janë arritur me mjaft art.

Fleta e parë e kodikut ka këtë frazë me shkronja të imta: "Libri i Pandokratorit". Pandokratori ka qenë një manastir i dëgjuar në Kostandinopojë. Kjo frazë është shkruar po aty dhe katër herë të tjera, nga duar të ndryshme. Në anën tjetër të fletës së parë ruhet një tekst i imët, që flet mbi kanonet e ungjijve sipas Eusebit. Ky tekst është i përfshirë prej brezash katërkëndorë, me ornamente. Kjo vazhdon në faqen e tretë, me kornizë të njëllajtë.

Në faqet e para të kodikut gjenden 9 kanone të stolisura me lule të stilizuara brenda skemave të ndryshme, ku mbizotërojnë ngjyrat blu dhe e kuqja. Sipër janë të stolisura me shpezë të ndryshme, si thëllëza, pëllumba, rosa e të tjera, si dhe me bisqe e lule të çelura anash vinjetave. Kodiku ruan katër figurat e ungjillorëve në faqet përballë me fletën ku fillon teksti

ungjillor. Figurat e ungjillorëve janë më të vona nga koha e shkrimit të kodikut. Janë pikturuar mbi letër dhe janë ngjitur mbi faqen e pashkruar të pergamenës.

Shtojcë pas tetraungjillit: Prej fletës 298 deri në fletën 306 janë shkruar 10 perikope nga ungjijtë ndryshëm. Duket ndryshimi i kaligrafisë dhe prania e një dore tjetër. Fleta 307 përmban sqarime me shkronja të imëta nga orologjia, që tregon çfarë duhet lexuar në festat fetare të vitit, në shërbesat e kultit. Fleta e fundit është shkruar me shkronja të arta, me siguri prej një dore tjetër nga ato më të parat. Që kjo faqe e shkëputur është marrë nga ndonjë libër tjetër dhe ngjitur këtu, e mësojmë nga përmbajtja e frazave letrare teologjike.

Dëmet që ka pësuar kodiku janë fare të pakta në krahasim me ato të kodikëve të tjerë. Fleta 2 është e shkëputur, fleta 4 ka një prerje në mes të kolonës së djathtë të pikturës së kanonit, në mënyrë vertikale deri poshtë në linjën përkufizuese të kanonit, si dhe në linjë horizontale, duke mos dëmtuar shënimet e kanonit. Në fletën 11 ka patur një shënim prej 6-7 rreshtash, i cili është fshirë krejt. Në fletën 12 teksti është zbehur shumë nga të fshirët dhe me vështirësi lexohet. Prej fletës 290 e deri në fund janë gati duke u shkëputur fletët, për shkak të dobësimit të të lidhurit, prandaj duhet të qepen. Kodiku ka disa fletë të ndotura, ka mjaft pikime dylli, të cilat mund të pastrohen lehtë duke mos dëmtuar tekstin

Përmbajtjet e krerëve të çdo ungjilli janë shkruar me ar. Tek Ungjilli sipas Gjonit janë zbehur mjaft.

Kapakët prej lëkure e kanë të dëmtuar lëkurën në vendin e lidhjes, si poshtë dhe sipër.

Duke u mbështetur në motivet e vinjetave dhe në mënyrën artistike të realizimit të tyre, në pikturimin e shpezëve mbi to, si dhe në tekstin me shkrim kaligrafik të tipit të vjetër, ka të ngjarë që ky kodik t'i përkasë mesit të shekullit të 11-të.

Kodi nuk e ruan nënshkrimin e riprodhuesit.

## **KODIKU I 6-TË, I BERATIT**

(PERIKOPE UNGJIJSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 21 x 19 cm.

Sasia e fletetëve: 50.

Teksti: Në dy kolona, me 26 rreshta për kolonë.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë.

Datimi: viti 1043.

Kodiku ka tri vinjeta të pikturuara dy në formë shiriti dhe një me gërshetime të dy ngjyrave, blu dhe kafe. Vinjeta e fletës 31 ruhet më mirë. Është e ndarë në 9 katërkëndëshe, secila me nga një ornament në formë luleje të stilizuar. Ajo e fletës 1 është e errësuar (ka qenë në ngjyrë blu dhe të kuqe të errët).

Kodiku ka dhe disa germa iniciale të pikturuara. Relativisht më të bukura janë dy **T** (gr. „tau“) në fletën 33, me ngjyrë të kuqe dhe blu.

Dëmtimet: Ky kodik është shumë i dëmtuar nga insektet, si në kapakët dhe në fletët me tekstin. Prej fletës 1 deri në fletën 9 pergamena është ngrënë nga insektet në kolonat e majta, duke dëmtuar shumë tekstin. Në disa nga këto faqe teksti është zhdukur nga zbehja, si në fletët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9. Gjithashtu zhdukje të pjesshme të tekstit kanë fletët: 11, 12, 14, 15. Fleta 18 ka një grisje, por janë ruajtur copat e pergamenës, të cilat mundet të restaurohen. Fleta 21 ka shumë zbehtësi. Fletët 23-26 janë prerë me thikë në kolonën e majtë deri në rreshtin 10, por duke mos zhdukur shkronjat. Kurse fleta 23 ka 7 rreshta të fshirë shumë. Në fletën 30 është zbehur shumë teksti i kolonës së djathtë. Kjo përsëritet edhe në fletët 36, 39-43, 45 dhe 46. Fletët 48 dhe 49 e 50 kanë tekste me grafi të ndryshme prej asaj bazë, gjë që tregon se janë disa duar shkruesish, të ndryshme prej asaj të kopjuesit.

Vlera e këtij kodiku qëndron në datimin e saktë që ai e ruan. Me anën e kaligrafisë së këtij kodiku mund të bëhen krahasime me paleografinë e teksteve të padatuara dhe mund të datohen me shumë përafërsi. Ky tekst duhet t'i përkasë kishës së ndonjë fshati, duke u mbështetur në nivelin jo aq të lartë artistik të tij, si dhe në vinjetat, në inicialet dhe në grafina të tij.

## **KODIKU I 7-TË, I VLORËS**

(PERIKOPE UNGJËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 27 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 287.

Teksti: Në dy kolona për faqe, me 21 rreshta për kolonë.

Grafia: Me shkronja të vogla të tipit të vjetër, në ngjyrë kafe, me dy pikësime të kuqe.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me pëlhurë në ngjyrë blu. Në faqen e sipërme ka një medalion argjendi ku është punuar figura e Krishtit. Kjo mban datën 1886. Kurse kapaku i faqes së poshtme ka një pllakë argjendi në formë trapezoidi, me skenën e pagëzimit të Krishtit.

Punimi i këtyre ilustrimeve është me forma naive, pa art.

Zbukurimet: Kodiku stoliset me katër vinjeta në formën e germës **π** ("pi") greke, të stolisura me lule të stilizuara mbi një sfond ari.

Germat fillestare të tekstit stolisen me ar dhe zbukurohen me ngjyrë blu.

Vinjeta ruhen në fletët 1, 40, 100, 131. Kodiku ka patur dhe dy vinjeta të tjera. Në fletën 81 kjo ka qenë në formë shiriti. Tjetra ruhej në fletën 269.

Inicialet e perikopeve janë të zbukuruar me ngjyrë blu e jeshile, kurse disa të tjera janë fare të thjeshta, në ngjyrë kafe në të kuqe.

Dëmet që ka pësuar kodiku nuk janë të pakta. Fleta 1 ka shumë vrima prej brejtjes nga insektet. Fleta 9 ka pak prishje poshtë, në mes dy kolonave, duke mos prekur tekstin. Fleta 11 e ka të prerë pak pergamenën pas rreshtit 7 të kolonës së djathtë. Fleta 18 ka grisje të pergamenës në cepin e fundmë të kolonës së djathtë, por pa e dëmtuar tekstin. Fleta 34 ka të shqitur pjesën e poshtme të saj. Fleta 36, në kolonën e majtë, ka një grisje prej poshtë deri në rreshtin e katërt, po kështu dhe fleta 38. Fletës 41 i janë zbehur dy rreshtat e poshtëm të kolonës së djathtë. Gjysma e dy rreshtave të kolonës së majtë të fletës 47 ka të grisur pergamenën në mes të kolonës së majtë, deri afër rreshtit 11 nga sipër. Fleta 62 ka grisje në pjesën e poshtme. Fleta 68 ka mjaft grisje në pjesën e poshtme, po kështu dhe fleta 73. Fleta 82 ka të prera dy rreshta të kolonës së majtë. Me sa kuptohet, kanë prerë vinjetën dhe e kanë marrë. Fleta 83 ka një të grisur poshtë. Fleta 86 e 87 janë grisur shumë nga pjesa e poshtme, si dhe fleta 104. Fletët 116, 135, 137, 139, 141, 145, 147, 155 nga poshtë kanë grisje dhe janë shqitur nga vëllimi. Fleta 174 është grisur në pjesën e poshtme; tri rreshtat e kolonës së majtë i ka të qepura pas grisjes. Fleta 231 është shqitur shumë dhe ka grisje të vogla. Shumë fletë të tekstit janë të zbehta: 239, 240, 241, 232, 233, 244, 245, 247. Fleta 262 ka zbehje teksti në dy kolonat poshtë. Kjo përsëritet dhe në fletët: 263, 264, 265, 267, 268, 270, 271, 273, 278, 279, 281, 286.

Në fletën 2 ruhen dy shënime dhuratash.

Vinjeta e fl. 3 është e ngjashme me një vinjetë të Psaltrit të Petërburgut (Cod. Gr. 214); me një vinjetë të Cod. Gr. 44 të Patmosit dhe me një tjetër te Cod. 110 të Oksfordit, të gjithë të shek. të 10-të, deri shek. i 11-të.

## KODIKU I 8-TË, I BERATIT

(PERIKOPE UNGJIJSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 26.4 x 21.4 cm (përmasa e fletës së brendshme).

Sasia e fletëve: 348.

Teksti: Në dy kolona, i shkruar prej duarsh të ndryshme, prandaj dhe numri i kolonave dhe i rreshtave të tyre ndryshon sipas shkruarit. Prej fletës 3 deri në fletën 42 kolonat kanë nga 23 rreshta. Prej fletës 43 deri në fletën 182 kolonat kanë nga 23 rreshta. Prej fletës 184 deri në fletën 285 kolonat kanë përsëri nga 23 rreshta. Prej fletës 288 deri në fletën 292 kolonat kanë nga 22 rreshta. Prej fletës 294 deri në fletën 335 kolonat kanë nga 23 rreshta. Fleta 336 ka nga 35 e 36 rreshta. Prej fletës 337 kolonat kanë nga 23 rreshta, deri në fletën 348, që është mbyllja e dorëshkrimit.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me lëkurë, mbi të cilën, në të dy faqet, të sipërmen e të poshtmen, përmban ornamente lineare dhe florale të stilizuara, të stampuara me presë, që kanë rëndësinë e tyre, sepse i përkasin kulturës së shekullit të 11-të, kur është shkruar kodiku. Ornamentet në lëkurë dhe në përgjithësi kapakët janë në gjendje shumë të mirë për kohën kur janë punuar.

Grafia: Jo unike, përmban të paktën shkrimin e tre njerëzve të ndryshëm. Kësaj i përgjigjet numër i ndryshëm i kolonave. Të tria grafitë janë anonime. Kolonat janë me 23 rreshta (autori i parë), me 20 rreshta (autori i dytë) dhe me 22 rreshta (autori i tretë). Shkrimi i të tre autorëve ka vlerë kaligrafike. Deri në fletën 43 shkrimi është në ngjyrë kafe të çelët, kurse prej fletës 43 deri në fletën 182 është në ngjyrë kafe të errët. Shkrimi i tekstit prej fletës 288 deri në fletën 292 është i errët në të zezë. Kjo është grafi pak e imët. Në disa krerë perikopesh, sidomos tek vinjetat, grafia është me ngjyrë ari ose më saktë e shkruar me ar. Zbukurimet: Ky kodik ka pasur 11 vinjeta, nga të cilat vetëm ajo e fletës 184 ruhet. Kjo vinjetë përmban lule në ngjyrë blu në të gjelbër, të stilizuara, mbi një sfond ari të ndritshëm, siç janë dhe vinjetat e kodikëve më të hershëm, të shekullit të 10-të dhe të 11-të. Dy vinjeta të tjera si kjo janë prerë e marrë, duke dëmtuar dhe një pjesë të kolonës pranë. Këtë e vërteton titulli prej ari i perikopesë, si dhe nistorja në ar e me ngjyrë zbukuruese blu. Njëra nga këto ka qenë në fletën 293 dhe tjetra në fletën 203. Në këtë fletë është prerë edhe titulli i perikopesë me shkrim ari, si dhe iniciali i stolisur me ar e bojë blu. Nëntë vinjeta të tjera janë vizatuar prej linjash të holla të kuqe me motive të ndryshme gjeometrike, florale, të bukura. Këto, si dhe inicialet më të stolisura, me ngjyrë të kuqe, janë në fletët: 43, 293, 311, 320, 321, 332, 333, 337 dhe 339.

Gjendja fizike e kodikut është e mirë, përveç dy vinjetave që janë prerë e grabitur. Kodiku nuk ka pësuar ndonjë dëm tjetër.

Si për grafinë e tij, si dhe dekorimet e vinjetave e të inicialeve, kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 11-të.

## KODIKU I 9-TË, I BERATIT

(PERIKOPE UNGJIJSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 31.5 x 24 cm.

Sasia e fletëve: 151.

Teksti: Në dy kolona dhe përmban ungjij në perikope. Në fletën e parë, kolona e parë, gjendet një pjesë teksti nga jeta e martirëve. Në të njëjtën fletë, nga fundi i kolonës së majtë, është një poezi mbi martirët, e cila vazhdon edhe gjatë gjithë kolonës së djathtë deri në

gjysmën e kolonës së majtë recto. Nën të fillon një perikope e letrës së Palit për hebrejtë. Kolona e djathtë në këtë faqe përmban perikopenë e Ungjillit sipas Gjonit, mbi pësimet e Krishtit. Kolona e majtë e fletës së dytë përmban një perikope të Ungjillit sipas Mateut. Nën të është tregimi mbi rigjetjen e relikeve të Shën Stefanit. Kolona e djathtë ka poezi kushtuar Shën Stefanit, shkruar me alfabetin e vjetër muzikologjik bizantin. Këto dy fletë, me tekste fragmentare, janë më të vona nga teksti kryesor (të shekullit të 13-të ose të 14-të). Me rëndësi janë kompozimet me nota bizantine në fletën 2, që, në krahasim me dorëshkrime të ngjashme që gjenden në përbërje të kodikëve të tjerë, tregojnë zhvillimin e tyre si traditë gjatë shekujve. Dy fletët e fundit të kodikut përmbajnë një tregim mbi martirizimin e dëshmorëve të Romës. Një kolonë e kësaj pjese të fundme duhet t'i atribuohet kohës prej gjysmës së dytë të shekullit të 11-të, deri në fillimin e shekullit të 12-të.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë, e cila përmban po ato dekorime të presuara që kanë dhe kapakët e Kodikut të 8-të të Beratit, me zbukurime të ndryshme lineare dhe florale të stilizuara.

Kodiku përmban poezi kushtuar Shën Mërisë, si në faqen e parë recto, ashtu dhe në atë verso.

Shkrimi është i imët dhe me rreshta jo të dendur. Duket sikur autori ka pasur për qëllim të vendosë paralelisht tekstin dhe notat.

Kodi ruan një vinjetë formën e germës “p”-pi greke - në faqen 7, sikurse gjendet edhe në kodikë të tjerë të shekullit të 11-të. Ky ka po ashtu dy dekore florale të stilizuara, vizatuar me ngjyrë blu mbi sfond ari, me iniciale prej ari e bojë blu. Titulli i perikopesë shkruhet me shkronja ari. Vinjeta e dytë, gjithashtu, vendoset mbi sfond ari dhe ka linja blu me të bardhë, të rruzullta e të harkuara. Titulli me shkronjën nistore janë prej ari.

Grafia: Në ngjyrë kafe në të kuqe.

Dëmet: Fletës së dytë i mungon një e treta; pergamena e pjesës që ruhet është e ngrënë deri tek notat. Prej fletës 9 deri në fletën 12 ka një shqitje të lidhjes nga sipër, kurse fleta 13 ka të dëmtuar pergamenën në tre rreshta në kolonën e parë sipër. Fletët 75-76 janë prerë mjaft nga ana e poshtme, me sa duket duke shënuar vizat, të cilat orientojnë rreshtat dhe distancën e kolonave. Fleta 86 ka një të prerë të pjerrët në kolonën e majtë, kurse fleta 123 ka një të qepur prej gjysmës së kolonës së djathtë e deri poshtë në fund. Fleta 143 ka një fragment të grisur e të qepur në pjesën e poshtme të kolonës së majtë.

Në përgjithësi gjendja fizike e kodit rezulton relativisht e mirë.

## **KODIKU I 10-TË, I VLORËS**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 28.2 x 20.3 cm.

Sasia e fletëve: 305.

Teksti: Në një kolonë, me shkronja të tipit të periudhës së mesme, në ngjyrë kafe.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me kadife të gjelbër dhe me dy pllaka argjendi mbi to.

Pllaka e sipërme ka figurën e Krishtit të kryqëzuar dhe e poshtmeja ka figurën e Shën Vlashit, punuar në basoreliev me sovajkë, pa ndonjë vlerë artistike. Është punë e shekullit të 19-të. Duke qenë pronë e manastirit të Shën Vlashit, në shekujt e vonët kanë punuar e vendosur mbi të figurën e këtij shenjti.

Datimi: Kopjim i fundit të shekullit të 11-të, që mund të shkojë deri në fillim të shekullit të 12-të.

Autori i shkrimit dëshmohej nga shënimi autograf në fund të fletës së fundit, ku thuhet: „Këto shkrime janë të zotit Mina“.

Ky kodik nuk ka pësuar dëme, përveç pesë fletëve të fundit, të cilat janë shkëputur nga vëllimi me gjithë kapakun.

Zbukurimet: Ky kodik është një nga më të stolisurit dhe nga më të bukurit në përgjithësi për miniaturën e dorëshkrimeve tona mesjetare.

Në faqet që paraprijnë fillimin e çdo ungjilli ruhen skenat me figurën e ungjillorit përkatës:

- Në fletën 16 verso është skena e ungjillorit Mateu.
- Në fletën 150 verso është skena e ungjillorit Luka.
- Në fletën 236 verso është skena e ungjillorit Gjon.
- Në fletën 3 ruhet një vinjetë e vogël në formë shiriti me dy linja të bardha të gërshetuara mbi sfond të kuq. Kjo vinjetë gjendet para listës së krerëve të çdo ungjilli.
- Në fletën para listës së perikopeve, bashkë me përmbajtjen e secilës prej këtyre, është pikturuar nga një fasadë arkitekturore kishë të stilizuar, që qëndron mbi kolona mermeri, të cilat japin idenë se janë solide. Këto fasada janë të stolisura me kubera, punuar me ngjyra të ndryshme (blu, të kuqe dhe ar). Mbi to janë pikturuar zogj të ndryshëm, veçmas pallonj. Në krye të faqes së brendshme të secilës është shkruar titulli me shkronja kapitale ari, si p.sh.: „Krerët e Ungjillit sipas Mateut“.

Para fletës me pikturën e çdo ungjillori pikturohet një katërkëndësh kënddrejtë, përkufizuar prej një shiriti të stolisur nga brenda prej linjash të kurbëta, të cilat lëshojnë gjethe të vogla të stilizuara me ngjyrë blu, të gjelbër ose të kuqe. Brenda katërkëndëshit është pikturuar një kryq i madh ngjyrë ari, nga fundi i të cilit dalin disa linja të lakuara, me të njëjtat ngjyra që kanë dhe kornizat. Kurse pranë Ungjillit sipas Lukës, para pikturës së kishës, ruhet një fushë katërkëndëshe stolisur gjithashtu prej linjash të kurbëta, vizatuar me ngjyrë të verdhë e të kuqe.

Figurat e ungjillorëve janë pikturuar secila mbi një fasadë arkitekturore. Figura e Mateut gjendet mbi një fasadë bazilike me dy pirgje të vegjël anash dhe një kambanare në mes. Ungjillori qëndron i ulur para tavolinës së shkrimit, me mjetet e të shkruarit, duke lexuar tekstin që ka shkruar. E gjithë skena vendoset mbi një sfond ari. Në të tria anët kjo është e përkufizuar prej një shiriti mjaft të gjerë me lule jasemini mbi sfond ari. Shiriti sipër ka dhe një lepur, që e vështron një dhelpër.

Figura e ungjillorit Luka duket si e pikturuar mbi një taracë të një godine me arkitekturë laike-familjare. Ungjillori ka tavolinën e shkrimit para dhe shihet duke ndenjur mbi një karrige pa mbështetëse, në veprim, duke mprehur mjetet e shkrimit. Kjo ruhet relativisht shumë më mirë nga ajo e Mateut. Figura e Lukës qëndron ndenjur me një karrige me mbështetëse, duke shkruar ungjillin, të cilin e mban mbi gjunjë para tavolinës së shkrimit. Taraca ka një si tendë që qëndron mbi pesë kolona, me një mbulesë në formë palme, të gjitha mbi sfond ari. Në kornizën që e rrethon figurën, në pjesën e sipërme, është dhënë një dhelpër e struktur, që bëhet gati për t'iu hedhur një gjeli që nuk e ka parë rrezikun.

Ungjillori Gjon pikturohet mbi një sfond shkëmbor, duke shikuar rrezet nga qielli dhe duke i diktuar nxënësit të tij, Prohorit, që po shkruan ndenjur mbi një tavolinë. Figura e Gjonit me Prohorin ngjan me një miniaturë të Cod. Gr. 41, i shek. të 12-të, që ruhet në Moske.

Secili ungjill në faqen fillestare sipër stoliset me nga një vinjetë në formën e germës „P“-pi greke - me motive lulësh të stilizuara mbi sfond ari.

Titulli i çdo ungjilli shkruhet me shkronja kapitale ari.

Nistoret e çdo ungjilli janë pikturuar me ngjyrë blu dhe ar, në mënyrë artistikisht të veçantë.

Fleta e fundit 305 ruan një shënim, me dorën e peshkopit Joasaf të Beratit, që mban datën 30 mars 1889, ku thuhet se „ky kodik është pronë e kishës së Shën Vlashit të Vlorës“.

**KODIKU I 11-TË, I VLORËS**

(PERIKOPE UNGJUSH)

Materiali: Pergamenë.

Numri i fletëve: 254.

Grafia: E tipit të vjetër. Shkrimi është kaligrafik. Teksti është shkruar me germa të vogla, me ngjyrë kafe. Titujt e ungjijve janë shkruar me shkronja kapitale dhe këto janë prej ari.

Shkrimi: Në dy kolona për faqe. Madhësia e faqes është 32 cm x 25.5 cm. Numri i rreshtave për faqe është jo i njësuar.

Stolisjet: Kodiku nuk përmban zbatime artistike në miniaturë, por në fillim të perikopeve gjendet si rregull një vinjetë. Nga këto, pesë kanë formën e një katërkëndëshi kënddrejtë. Të tjerat kanë formën e një shiriti me shtrirje horizontale, që zbukurohet me lule tri dhe pesëpetalëshe. Këto kufizohen me vijëza të holla elegante të bardha, të ngjashme me ato që përshkruhen për kodikët e vjetër të Beratit dhe për Kodikun e 5-të të Vlorës.

Artistikisht dhe me shije janë vizatuar inicialet, të cilat janë të shumta, të mëdha dhe të zhvilluara mirë.

Sido që këto motive janë stilizuar bukur prej linjëzash dhe vijëzash e lulësh, të vëna në dukje qartë mbi një sfond prej ari të ndritshëm, duhet thënë se nuk e kanë finesën e zbukurimeve të ngjashme në kodikë më të hershëm. Kjo tregon se ky kodik duhet të jetë i një kohe relativisht të mëvonshme.

Duke u nisur nga grafia dhe karakteri i zbukurimeve, mund të arrihet në përfundimin se ky dorëshkrim nuk mund të jetë më i hershëm se gjysma e dytë e shekullit të 12-të.

Shënime: Në vinjetën me numër 81 ruhet një shënim që mezi lexohet, ku gjendet emri i autorit riprodhues: "... e shkroi meshtari Joan" (Gjon), pa datë.

**KODIKU I 12-TË, I BERATIT**

(OMILIE NGA UNGJILLI SIPAS GJONIT)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 22.2. x 16.6 cm.

Sasia e fletëve: 603.

Teksti: Në një kolonë, me 20 rreshta, me grafi të tipit të periudhës së mesme.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë, mbi të cilën ka ornamente të presuara, njësoj si dhe ato të kodikëve të shekullit të 10-të e të 11-të. Këto ornamente gjenden në kapakun e sipërm, kurse kapaku i poshtëm mungon, është vënë i ri nga restauratorët e arkivit.

Omiliet janë shpjegime rreth temave ungjillore. Në këtë tekst ka shpjegime vetëm nga Ungjilli sipas Gjonit.

Ky kodik nuk përmban asnjë motiv dekorativ, përveç vetë shkrimit të tij, që është i bukur (kaligrafik).

Kodiku i 12-të është një nga ata që kanë pësuar shumë dëme. Përveç kapakut të poshtëm, i cili është zhdukur, kodiku ka shumë fletë të dëmtuara, duke përfshirë dhe pjesë të tekstit.

Prej fletës 12 deri në fletën 28 cepi i sipërm i dorëshkrimit është dëmtuar nga lagështira. Fletët e para kanë të dëmtuar edhe tekstin. Lagështi dhe grisje vërehen deri në fletën 73. Po kështu dhe fletët 176 e 177, 179, 185, 195, 203, 208, 210, 220, 236, 240, 247, 249, 250, 255. Prej fletës 257 deri në fletën 268 poshtë, pergamena është kalbur dhe grisur, aq sa janë dëmtuar dy rreshtat e parë të tekstit. Pergamena poshtë ka pësuar dëme pa prekur tekstin



në fletët 271 e 272. Fleta 276 ka një të grisur poshtë, kurse faqja verso e saj është nxirë shumë. Edhe në fletën 277 është dëmtuar shumë teksti. Në fletët 306, 315, 321 një pjesë e pergamenës është këputur, duke mos prekur tekstin. Ndërmjet fletës 357 e 358 është grisur dhe hequr një fletë. Fletët 367 e 368 kanë pësuar ndotje. Prej fletës 551 deri në fletën 554, në cepin e sipërm fletët janë dëmtuar duke prekur fundin e katër rreshtave. Prej fletës 563 është dëmtuar rreshti i parë. Gjithashtu dhe në fletët 566, 567, 570, 572, 574, 576, 577. Në fletën 599 janë dëmtuar 4 rreshtat e fundit. Në fletën 601 është dëmtuar pjesa e fundme dhe tre rreshta, kurse në faqen verso 6 rreshta. Dy fletët e fundit të kodikut kanë pësuar shumë dëme, si grisje të pergamenës, duke përfshirë rreshtat e shkronjat, por dhe errësim të faqeve. Nisur nga grafia e tekstit, ka të ngjarë që dorëshkrimi t'i përkasë gjysmës së dytë të shekullit të 11-të. Por duhet bërë krahasim me shpjegimin e Ungjillit të Gjonit, që ka shkruar Theofilakti i Ohrit, i cili ka qenë i shquar në penë në çështjet teologjike.

## KODIKU I 13-TË, I BERATIT

(UNGJILL NË PERIKOPE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 35 x 37.7 cm.

Sasia e fletëve: 320.

Kapakët: Prej dërrase dhe të veshur me pllaka argjendi. Këto ruajnë dy mbishkrime. Në të parin thuhet: „Ky ungjill është punuar në kohën e Andreas e të Joanit të Papa Janit dhe në kohën e Nikollë Anastasit dhe të Kostandinit, të bijtë e Joanit, me kontributin e tyre“. Në shënimin e dytë thuhet: „... Dhe iu kushtua tempullit të nderuar të fjetjes së Shën Mërisë, më 1729, mars 30 - me dorën e voskopjarit Filip Anastasit“.

Dy kapakët prej argjendi kanë skena të punuara në relief. Mbi kapakun e sipërm përfytyrohet skena e ngjalljes së Krishtit për të çliruar të drejtët. Katër skenat e tjera përfytyrojnë katër ungjillorët, secili duke shkruar ungjillin, mbi sfonde arkitekturore. Vetëm Gjoni qëndron mbi një sfond shpelle dhe me katër figurat simbolike të profetit Daniel.

Në kapakun e poshtëm, në mes, përfytyrohet skena e fjetjes së Shën Mërisë, që duhet të nënkuptojë vdekjen e saj. Katër figurat e tjera përfytyrojnë katër engjëj, ndër të cilët Mihaeli, Gabrieli dhe Rafaeli. Secila figurë engjëlli është punuar në një pjesë të veçantë argjendi dhe është e larë me ar. Këto janë mbërthyer mbi kapakun e sipërm prej argjendi. Sfondi prej argjendi, si në kapakun e sipërm dhe në të poshtëmin, është trajtuar (zbukuruar) prej linjash të kurbëta e të rruzullta mbushur me lule të stilizuara, punuar me sovajkë në relief. Figurat e skenave ilustruese janë punuar me rrahje.

Në bazë të grafisë, datimi i kodikut duhet t'i jetë prej shekullit të 12-të deri në fillimin e shekullit të 12-të.

Kodiku stoliset me tri vinjeta. E para është në fletën hyrëse, e dyta në fletën 85 dhe e treta në fletën 185. Dy të parat nuk kanë ndonjë finesë, sikurse stolisjet e vinjetave të kodikëve të mëparshëm. Vinjeta e tretë është në formën e germës „P“ -pi greke - vendosur në një fushë me linja të kryqëzuara, të përkufizuara prej linjash më të holla prej ari, në formë kafazi.

Inicialet e kodikut janë të mëdha, në ngjyrë blu, përkufizuar prej linjzash ari. Kjo u përngjan vinjetave të vjetra, por pa finesën e tyre. Prej ari janë dhe titujt e perikopeve. Grafia është në ngjyrë kafe, ka vlerë artistike.

Për ruajtjen e figurave të kapakëve është mirë që këto të vendosen mbi një shtresë të butë, që të mos dëmtohen format e figurave, se janë me vlerë artistike.

**KODIKU I 14-TË, I BERATIT**

(JETË SHENJTORËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 22-23 x 17.3 cm.

Sasia e fletëve: 150.

Teksti: Në një kolonë, me shkronja të tipit të vonë, ngjyrë kafe.

Kodikun nuk ka pasur kapakë, por i janë vënë nga arkivi.

Fletët e para mungojnë, por edhe nga fundi duhet të mungojnë disa fletë. Dy fletët e fundit janë të errësuara. Dëme të tjera ky kodik nuk ka, veçse është shkruar në fletë pergamene që duken si mbeturina, në shumë raste me pjesë të prera dhe prej kualiteti të dobët; duhet të ketë shërbyer në ndonjë manastir të vobektë.

Fleta 11: Jeta e Shën Konstandinit dhe Elenës.

Fleta 12: Fillimi i mbretërimit të Konstandinit.

Fleta 20: Vizita e Konstandinit në Romë.

Fleta 21: Konstandini i madh pagëzohet nga Silvestri.

Fleta 21: Mbi vdekjen e Maksimi(li)an Galerit.

Fleta 22 verso: Konstandini i madh mund një mbretëri.

Fleta 23: Mbi qytetin bizantin.

Fleta 24: Konstandini ndërton Kostandinopojën.

Fleta 27: Mbi filozofin Efimon – Aleksandri, shenjtor ndër shenjtorët.

Fleta 28: Mbi gjithë tempujt që ka ndërtuar mbretëresha Elena.

Fleta 35: Si mendojmë për mbretin.

Fleta 44 verso: E atit tonë Teodorit të madh, igumenit të Studitit (sipas emrit të një prej manastireve më të mëdhenj të Kostandinopojës).

Fleta 45: Fjalë mbi lindjen e Gjon Pagëzorit.

Fleta 47: Kujtime mbi profetin dhe pararendësin, apostullin dhe dëshmorin Gjon Pagëzori.

Fleta 49 verso: Logos (ligjëratë) mbi gjetjen e një dore të Gjon Pagëzorit.

Fleta 63: Fjalë mbi apostujt korifej Pjetrin dhe Palin.

Fleta 83 verso: Martirizimi i Shën Pandeimonit.

Fleta 105 verso: Jeta dhe veprimtaria e atit tonë Simeon.

Fleta 123 verso: Martirizimi i Shën Marenës.

Fleta 130: Logos i Grigorit të Nisit, mbi protomartir Stefanin.

Fleta 138: Martirizimi i një dëshmori.

Fleta 141: Jeta dhe veprimtaria e oshënares Theoktiste.

Prej gjysmës së fletës 144 verso grafia ndryshon; shfaqet një shkrim shumë i imët, që vazhdon deri në fletën 153 verso.

Sipas grafisë ky kodik duhet t'i atribuohet fundit të shekullit të 11-të deri nga fundi i shekullit të 12-të.

**KODIKU I 15-TË I BERATIT**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 21 x 16.5 cm.

Sasia e fletëve: 256.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, por shkrimi është kaligrafik, ka vlera estetike.

Eshtë shkruar me bojë në ngjyrë kafeje dhe përmban komente anësore. Këto të fundit janë me grafi të imët të kuqe.

Titujt e perikopeve: Me shkronja kapitale ari. Inicialet janë jo shumë të mëdha, por edhe këto në ngjyrë ari. Krerët e ungjijve janë shkruar me shkronja të kuqe.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë të stampuar me presim. Ornamenti përmban lule të çelura prej 5-6 petalesh, si dhe disa motive lineare e korniza linjëdrejta ose të gërshetuara.

Stolisja e kodikut: Në fletën fillestare të çdo ungjilli gjendet nga një vinjetë në formën e germës „P“ -pi greke - por pa art.

Ungjijtë janë ndarë në krerë, sipas pjesëve të ndryshme të tekstit.

Lëkura e kapakëve ka pjesë të shkëputura anash, si dhe shumë vrima për shkak të brejtjes nga mola. Fletët 1 dhe 2 të kodikut janë errësuar mjaft. Po ashtu dhe fleta e fundit, me numër 256.

Duke u mbështetur në grafinë e bukur të kodikut, shkrimi i tij duhet t'i datohet afërsisht kohës prej shekullit të 11-të deri në shekullin e 12-të.

## **KODIKU I 16-TË, I BERATIT**

(PERIKOPE UNGJIJSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 27.4 x 18.8 cm.

Sasia e fletëve: 161.

Teksti: Në një kolonë, me 12-13 rreshta për kolonë, me grafi të tipit të vonët, shkruar me ngjyrë kafe të errët, me pikëzime të kuqe. Titujt e perikopeve janë me shkronja kapitale të kuqe.

Kapaku i sipërm i kodikut është prej dërrase, mbështjellë me pëlhurë prej liri, e mbuluar me kapak argjendi, që përmban një skenë të kryqëzimit të Krishtit. Në këtë skenë, pranë kryqit, janë këto figura: Shën Mëria, Gjoni dhe një figurë tjetër. Anash krahëve horizontale të kryqit, në pjesën e sipërme, ruhen dy figura engjëjsh me fletë të hapura, me krye të përkulur nga kryqi dhe me dorën e djathtë të hapur, shenjë që mund të tregojë habitje dhe mallëngjim. Engjëllit të anës së majtë i ruhet vetëm një fletë. Në cepin e djathtë poshtë, brenda një medalioni, ruhet një figurë ungjillori me ungjillin në duar, në përmasa të gjysmëfigurës. Nën këmbët e Krishtit ruhet një figurë pa brezore, duke shkukur gozhdët nga këmbët e Krishtit. Vetë figura e Krishtit të kryqëzuar nuk ruhet. Me siguri duhet të ketë qenë dhe një figurë engjëlli nga e majta, si dhe një figurë ungjillori tjetër po nga e majta, për simetri të kompozimit në tërësi të skenës. Por nuk janë më. Nën kryqin e Krishtit ruhet një figurë kafke, që mund të përfytyrohet si kafka e Adamit. Këto figura janë punuar me rrahje mbi forma dhe janë arrirë me nivel të lartë artistik.

Kodiku në fjalë ruan vetëm një vinjetë në faqen e parë, në formë katërkëndëshi. Në fushën e saj gjendet titulli i ungjillit. Kjo vinjetë stoliset prej linjash të trasha të kurbëta në ngjyrë blu, mbi një sfond të kuq. Por nuk ka ndonjë vlerë të veçantë artistike.

Si grafia, ashtu dhe kapakët prej argjendi me skenën e punuar në reliev me mjeshtëri të rrallë artistike, flasin për një vjetërsi jo më të lashtë se shekulli i 13-të.

Në skenën punuar në argjend, mbi krahun horizontal të kryqit, lexohen fjalët në reliev: “Mbreti i lavdisë”. Ndërsa pranë figurës së Gjoni, me shkrim vertikal, lexohet: “Joan Theologu”.

Duke qenë se punimet e argjendarisë me figura në pllaka argjendi, krijuar gjatë mesjetës paraturke, tek ne janë ruajtur fare të pakta, kapaku me skenën e kryqëzimit të Krishtit, me figurat që përmendëm, kanë vlerë artistike dhe historike, sepse dëshmojnë për zhvillimin e suksesshëm të arteve të aplikuara gjatë asaj periudhe mesjetare në vendin tonë.

**KODIKU I 17-TË, I BERATIT**

(PUNËT / VEPRAT E APOSTOJVE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 22 x 15.5 cm.

Sasia e fletëve: 99.

Kodiku stoliset me një vinjetë të realizuar me ar në ngjyrë të zbehtë, në formën e germës „p“-pi greke.

Grafia, duke përfshirë inicialet, është në ngjyrë kafe.

Kapakët: Janë prej dërrase dhe mjaft të dëmtuar. Lidhja e kapakëve dhe e fletëve është cilësisht e keqe dhe e dobët.

Fletët e para të kodikut mungojnë. Nga fleta 94 deri në fund fletët janë të shkëputura / të shqitura. Fleta e fundit është e dëmtuar, por pa e prekur tekstin; ajo paraqitet e ndotur në shumë vende.

Shkrimi është i tipit të vonët, por ka vlerë bukurshkrimore.

Kodiku duhet të jetë i fundit të shekullit të 13-të. Datimi i tij mund të shtyhet deri në dekadat e para të shekullit të 14-të.

**KODIKU I 18-TË I BERATIT**

(PSALMET E DAVIDIT, ME KOMENTE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 28.5 x 23.5 cm.

Sasia e fletëve: 175.

Teksti: Në një kolonë, komentet dallohen se janë me shkronja më të imëta, ngjyra është kafe e çelët.

Grafia: E tipit të vonët

Kapakët: Mungojnë. Në mungesë të të parëve, janë vënë të rij nga restauratorët e arkivit.

Datimi: Sipas tipit të paleografisë, me vlera artistike, kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 12-të.

Autori i dorëshkrimit është anonim.

Mungesat: Në fletën 1 gjendet psalmi 9, gjë që do të thotë se mungojnë psalmet paraardhëse, prej 1–9. Teksti mbaron me psalmin 150.

Stolisjet: Kodiku nuk ka ndonjë figurë ilustruese dhe as dekore vinjetash ose të ndonjë aplikimi tjetër, të ndryshëm.

Kodiku ka pësuar këto dëme: është i ndotur, sidomos në fletët 7, 19, 57, aq sa ndotja ka arritur të zhdukë dhe tekstin. Në fletët 58, 141 verso, 123, 161, 137 verso dhe 159 shfaqet ndotje më pak intensive. Ka ndotje edhe në fletë të tjera, duke përfshirë fletët e fundit.

**KODIKU I 19-TË, I BERATIT**

(UNGJILL NË PERIKOPE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 15.5 x 11.5 cm.

Sasia e fletëve: 195.

Teksti: Në një kolonë, me shkronja të tipit të vonë, në ngjyrë kafe.

Kapakët e vjetër mungojnë. Ka kapakë të rij, të vendosur nga arkivistët.

Kodikut i mungojnë fletët e fillimit, prej fletës 1 deri në fletën 4. Këto janë dëmtuar nga brejtja e insekteve. Në fletën 65 është prerë pergamena bashkë me tekstin, deri në rreshtin 10. Ndërmjet fletës 143 dhe fletës 145 është këputur fleta e ndërmjetme dhe pergameni me gjithë tekst është marrë. Kurse fleta 152 është rruhur dhe teksti është zhdukur në thellësi deri në rreshtin 12. Fleta 184 është dëmtuar në cepin e sipërm, duke bërë të palexueshme pjesë të katër rreshtave. Fleta e fundit është errësuar dhe ka disa vrima, që nuk e pengojnë leximin e tekstit.

Autori i dorëshkrimit është anonim.

Datimi duhet t'i atribuohet periudhës prej shekullit të 12-të në atë të 13-të.

Nuk ka ilustrime dhe forma të tjera të artit të zbatuar.

## **KODIKU I 20-TË, I BERATIT**

(JETËSHKRIME MARTIRËSH E SHENJTORËSH DHE TË TJERA)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat e fletëve: 38.3 x 21-22 cm.

Sasia e fletëve: 190.

Teksti: Në dy kolona, me grafi të tipit të vonët, shkruar në ngjyrë kafe, me 34 rreshta për kolonë, me shkrim në madhësi mesatare.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me lëkurë, mbi të cilën janë stampuar motive lineare, ku formohen dhe zemra (këto vendosen në një kornizë katrore), si dhe me lule të stlizuara shumëpetalëshe. Këto janë stampuar si në kapakun e sipërm, dhe në të poshtmin. Lëkura është grisur ngapak nëpër qoshe, por mund të restaurohet.

Datimi: Kopjuar në shekullin e 12-të.

Autori i grafisë është anonim.

Zbukurime: Nuk ka. Inicialet janë shkronja kapitale, por të një madhësie të vogël, ngjyrë të kuqe.

Dëmet: Fletët 1 dhe 2 janë nxirë shumë anash. Fleta 3 është ndotur shumë në 4 rreshta të kolonës së majtë. Kodiku është dëmtuar prej shqitjes me forcë të pesë fletëve, gjegjësisht të fletëve 11 deri 16. Fletët 108 deri 119 janë shkëputur nga lidhja, ndërsa tri fletë të tjera pas këtyre janë gati në shkëputje. Ky dëm mund të riparohet prej libërlidhësve. Fleta 176 ka të prerë një pjesë pergamene nga poshtë, në mënyrë horizontale, por pa e dëmtuar tekstin. Fleta 184 e ka të prerë pergamenën në mënyrë vertikale, duke dëmtuar gjithë tekstin e kolonës së djathtë. Fleta e fundit është errësuar mjaft, por teksti lexohet.

Kodiku përmban:

- Logos /ligjëratë, mbi një festë që lidhet me emrin e Krishtit, kolona 14, fleta 1.
- Mbi martirizimin e Niqiforit, kolona 26, fleta 8 verso.
- Martirizimi i Shën Vlashit, kolona 20, fleta 14.
- Jetëshkrimi i Shën Martinianit, kolona 52, fleta 21.
- Martirizimi i Theodor Stratilatit, kolona 50, fleta 33 verso.
- Martirizimi i një tjetri dëshmori të kishës, kolona 29, fleta 41 verso.
- Mbi lutjen se ç'është më e fuqishme se mbretëria, kolona 9, fleta 49, punë e Shën Gjon Gojartit.
- Mbi ata që kanë fjetur me besë dhe mbi meshimet që bëhen për ta, punë e Joan Damaskinoit, kolona 132, fleta 52.
- Tregim mbi rrjedhën e gjakut të Krishtit, kolona 14, fleta 88.
- Për një mrekulli mbi ikonën e Krishtit në qytetin Verit, kolona 14, fleta 92.
- Histori të ndryshme mbi mrekullitë që bëhen mbi ikonat, kolona 5, fleta 95.
- Mbi një mrekulli tjetër që ka ngjarë para ikonës së Krishtit, kolona 3, fleta 96.

- Martirizimi i 40 shenjtorëve, kolona 28, fleta 102.
- Testamenti i 40 shenjtorëve, kolona 8, fleta 109.
- Martirizimi i Shën Prokopit, kolona 78, fleta 127 verso.
- Martirizimi i Shën Pandelejmonit, kolona 53, fleta 141.
- Tregime mbi perandorin Kostandin, kolona 40, fleta 154.
- Mbi Shën Gjon Pagëzorin dhe mbi gjetjen e kokës së tij, kolona 85, fleta 170.

Në fletën 2 ruhet ky anëshkrim i vonë me shkronja të zeza: “Ky libër është i (kishës) së Shën Marenës”.

Në fletën 27 verso sipër ruhet ky anëshkrim: “Nga Vlora arriti ...” (tekst i palexueshëm).

Në fletën e parë ruhen disa pjesë nga poezitë e quajtura zbritësore të vjeshtës, të shkruara nga Stavro Xapakia (njëra ka titullin “Kryqin përvijes Moisiu”), këto pjesërisht të zbehta, në ngjyrë të zezë, që do të thotë se janë të kohës osmane.

Në fletën 123 verso ruhen 6 shënime me shkronja të zeza të kohës së vonë. Në njërin prej tyre, ai që shkruan shënimet vëren se këtë libër e mori nga ipeshkvia dhe si e lexoi ia ktheu kishës. Të tjerat janë tekste të përdorimit kishtar, pa datë e pa nënshkrim.

## **KODIKU I 21-TË, I BERATIT**

(PERIKOPE UNGJËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 21.6 x 15.3 cm.

Sasia e fletëve: 40. Fleta e fundit, e 41-ta, është prej letre dhe nuk ka tekst.

Teksti: Në një kolonë, me 20 rreshta për kolonë, me grafi të tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët, por me pikësim në ngjyrë të kuqe.

Kodiku nuk ka pasur kapakë. I janë vënë të rinj nga restauratorët e AQSH.

Datimi: Në fletën 37 shkruhet se koha e kopjimit të kodikut është viti 1181. Ruhet dhe emri i autorit të kopjimit: “U shkrua me dorën e diakon Joanikit” (“dhjakut Gjon”).

Stolisjet: Në fletën 3 verso kodiku ka një vinjetë në formë gërsheti të formuar prej shiritash në shtrirje horizontale, me tri ngjyra: të kuqe, kafe e të bardhë. Inicialet janë të mëdha, por të thjeshta, në ngjyrë kafe.

Dëmtimet: Fleta 1 recto është e palexueshme nga errësimi, kurse e njëjta fletë, faqja verso, mund të lexohet. Ka dhe grisje anësore. Të gjitha fletët e kodikut janë errësuar në anët. Fleta e fundit është ndotur nga lagështia, por teksti mund të lexohet. Fleta 35 ka pësuar një grisje të vogël në cepin e sipërm, duke dëmtuar geramat e fundit të dy rreshtave të parë.

## **KODIKU I 22-TË, I BERATIT**

(UNGJILL NË PERIKOPE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 25.8 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 172.

Teksti: Në dy kolona, me 22-23 rreshta për kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, shkruar në ngjyrë kafe të çelët; në disa fletë titujt janë në ngjyrë të kuqe, po ashtu dhe inicialet.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë, me zbukurime lineare të stampuara në presë.

Dëmtimet: Lëkura e kapakut është grisur mjaft në pjesën ku ngjitet. Pesë fletët e para

janë ngrënë nga insektet nga ana e djathtë, duke dëmtuar 9 rreshta. Në kolonën e majtë është dëmtuar shumë një vinjetë dhe teksti shoqërues. 6 rreshtat e fundit ruhen pjesërisht, po ashtu dhe në faqen verso. Prej fletës 2 deri në fletën 24 është dëmtuar pjesa e sipërme e kodikut, në qoshen e majtë. Dëmtimi ka ndodhur për shkak të kalbjes nga lagështia. Ka dhe vende ku është grisur teksti, duke dëmtuar dhe leximin. Lagështia ka cënuar dy rreshtat e parë të kolonës së djathtë, por duke mos e dëmtuar tekstin. Fletët prej 82 deri 86 janë grisur ca në cepin e poshtëm, duke mos dëmtuar tekstin. Fleta 88 është grisur dhe është marrë, duke lënë në dorëshkrim një pjesë fragmentare, me rreshta të paplotë. Dëmtimi prej lagështisë rifillon prapë prej fletës 92 deri në fletën 103, si dhe prej fletës 126 deri në fletën 130, ku janë dëmtuar rreshtat e parë të kolonave. Fleta e fundit, fleta 172, është dëmtuar në rreshtat e sipërm, në cepat.

Zbukurimet: Në fletën e parë ruhet një vinjetë e dëmtuar shumë. I dëmtuar është dhe teksti shoqërues (i errësuar). Në fletën 131 ruhet një tjetër vinjetë në formë shiriti, ndarë në trekëndëshe, formuar prej linjash të gjelbra, me lule të bardha të stilizuara, vendosur mbi një sfond të kuq. Edhe në fletën 137 ruhet një vinjetë në formë shiriti, me vendosje horizontale, me gërshetim linjash të bardha mbi sfond të kuq. Inicialet janë të mëdha dhe duken të pikturuara bukur.

Duke u bazuar në grafisë me vlera bukurshkrimore, kodiku në fjalë duhet t'i atribuohet kohës prej shekullit të 12-të deri në shekullin e 13-të.

## **KODIKU I 23-TË, I BERATIT**

(MUZIKË BIZANTINE KISHTARE, OKTOIH E TË TJERA)

Materiali: Letër.

Përmasat: 23 x 14.2 cm.

Sasia e fletëve: 159.

Teksti: Përmban poezi kishtare bizantine, shkruar në një kolonë, me ngjyrë kafe. Inicialet janë të kuqe, pa stolisje.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me pëlhurë liri dhe lëkurë, e cila ka mbetur fragmentare. Para kapakëve ka pasur një veshje me fletë pergamene për të forcuar letrën. Ka të ngjarë që, si dërrasa, dhe pëlhura, të jenë të shekullit të 13-të.

Dëmtimet: Dëm skandaloz mbi kodikun përbën grisja dhe marrja nga një gjysmë flete në fillimin e çdo zëri muzikor të muzikës bizantine. Këto kanë qenë të stolisura dhe me vinjeta. Ky dëm është bërë në fletët 11, 23, 36, të cilat janë grisur e marrë në tërësi. Ndërsa ndërmjet fletës 47 e 48, si dhe fletes 55, i është marrë gjysma.

Dëme të tjera: Zbehja e tepërt e gjysmës së fletës së parë, e cila duhet të ketë pasë shënime rreth historisë dhe burimit të kodikut. Prej fletës 2 deri në fletën 17 është dëmtuar teksti prej cepit të sipërm deri në gjysmën e fletës. Por në fletët që pasojnë dëmi në tekst vjen duke u zvogëluar. Dëmi ka ardhur nga lagështia. Në fund të kodikut, aty ku janë lidhur fletët, është brejtur nga insektet pjesa prej fletës 9 deri në fletën 42, duke mos e dëmtuar tekstin. Duhet vlerësuar kjo gjendje, që të mos vazhdojë dëmtimi prej insekteve. Për këtë duhet të merren masa dezinfektimi. Përsëri fillon dëmtimi nga insektet ndërmjet fletëve 97 dhe 142.

Gjithashtu prej fletës 157 deri në 159, që është e fundit, ka vazhduar brejtja nga insektet. Një vrimë në mes të fletëve 157 dhe 159 ka dëmtuar një fjalë dhe notën muzikore.

Autori i dorëshkrimit, në fletën e fundit prej letre, ka lënë këto fjalë: "U shkrua me dorën time, të të përvuajturit Mihail Slavopulit, në vitin 1292".

Zbukurime: Kodiku ka dy vinjeta. E para është në fletën 64; kjo ka formën e germës „P“ -pi greke - dhe është e stolisur me dekore zemrash të stilizuara brenda linjash të kurbëta, që vendosen mbi një sfond të gjelbër dhe të kuq. Kurse vinjeta e dytë është në formën e dy

shiritave. Nga këto, i pari është në trajtë gërsheti prej dy linjash, bardhë e kuq, mbi sfond të gjelbër, përkufizuar prej dy linjash horizontale të kuqe. Kjo lidhet me vinjetën e sipërme me dekor në formën e një vargu germash „w“-omega greke, që përshkohen prej një linje të bardhë. Shënime: Emri i autorit të poezisë me nota bizantine ruhet në disa vende, si dhe në fund të tekstit të fletës 55, ku shkruhet: „e Joan monakut“ - e murgut Gjon.

## KODIKU I 24-T, I BERATIT

(UNGJILL ME PERIKOPE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 33 x 22.6 cm.

Sasia e fletëve: 252.

Teksti: I shkruar në dy kolona, me 27 rreshta për kolonë, me grafi të tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët.

Në bazë të grafisë, kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 15-të.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë të thjeshtë, pa ornamente. Duke qenë se kjo është grisur në pjesën e poshtme, më vonë është plotësuar me beze të gomuar.

Autori i grafisë së kodikut është anonim.

Në fletën 251 gjendet një shënim, që ruhet aq shumë i dëmtuar, për shkak të grisjes së fletës në mënyrë vertikale, aq sa nuk mund të lexohet gjë, përveç dy fjalëve: “i është dhënë Gjergjit të Madh”. Në fund gjendet gjithashtu viti i dorëshkrimit: 6946, gjegjësisht 1438, sipas kalendarit të ri, si dhe shënimi: „e shkroi Teodor Gramatia“, që do të thotë „sekretari“. Ky Gjergj i madh që përmendet në tekst nuk mund të jetë heroi ynë kombëtar - Gjergj Kastrioti, për arsye se ky në atë nuk ishte bërë i dëgjuar, që të mund të quhej „i madh“, por ka mundësi të jetë fjala për Gjergj Arianitasin, i cili atëherë sundonte në Myzeqe.

Shkruesi i shënimit fragmentar është sekretari Teodor, që duhet të ketë qenë funksionar i qytetit të Beratit. Në atë kohë Berati ka qenë “qytet shumë i shkëlqyer“, siç shkruan piktori Onufri në një mbishkrim autograf të tij në një kishë në Kostur, të cilën ai e ka pikturuar.

Dëmet: Dorëshkrimi në fjalë është një nga më të dëmtuarit. Prej fletës 1 deri në fletën 26 materiali është grirë nga dëmtimi, duke zhdukur kolonën e djathtë dhe duke lënë vetëm fragmente të vogla e të mëdha vetëm në kolonën e majtë. Prej fletës 29 deri në fletën e fundit kodiku fletët i ka të ngrëna nga insektet në pjesën e sipërme në linjë horizontale. Dëmtimi vazhdon në mënyrë të pjerrët deri në gjysmën e fletëve, duke i zhdukur deri në rreshtin 10 fjalët e tyre anësore. Fleta 83 është dëmtuar nga grisja dhe marrja e vinjetës në kolonën e majtë. Katër fletët e fundit të kodikut kanë mbetur fragmente.

Zbukurime: Në fletën 64 ruhet e pikturuar figura e ungjillorit Marku, i cili paraqitet ndenjmur mbi një stol duke shkruar ungjillin. Në fletën 150 ruhet një vinjetë në formë shiriti përshkruar prej një linje të bardhë në trajtë zigzage, që krijon trekëndëshe; në secilën nga këto është pikturuar nga një lilan tri-katër petalesh, mbi sfond të zi dhe të kuq të errët, që japin kontrast. Në fletën 164 një figurë në miniaturë me dorë të zgjatur është dhënë si iniciali epsilon „g“. Në fletën 173 është një tjetër figurë, ku përdoret si nistore po shenja e epsilonit, me veshje blu. Në fletën 201 gjendet një vinjetë pa vlerë artistike.

Incialët kodiku i ka të stolisura dhe të thjeshta, në fillim të mëdha, me ngjyra blu, të kuqe dhe të bardhë, me figura insektesh të stilizuara. Këto ngjyra kontrastuese dëshmojnë dhe për datimin e kodikut si të shekullit të 15-të.



## KODIKU I 25-TË, I BERATIT

(ANTOLOGJI PATROLOGJIKE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 30 x 27 cm.

Sasia e fletëve: 503.

Teksti: Në dy kolona, grafi e tipit të vonë prej fletës 493 deri në fletën 503. Ka gjithashtu grafi me shkronja korsive, në ngjyrë kafe. Të dy shkrimet janë me vlerë kaligrafike.

Kodiku nuk ka pasur kapakë kur u gjet. Ata që ka, i janë vënë nga arkivistët.

Datimi: Në bazë të grafisë së tipit të vonë, duhet t'i atribuohet shekullit të 13-të.

Legjenda e kodit:

Mbi hirotoninë klerikale, fleta 1;

Të ndryshme, fleta 3;

Mbi veten dhe të atin dhe Vasilin si apologjetik. Peshkop Nika u hirotonis nga Sasimi, fleta 36 verso;

Pas kthimit të ikjes, Nika kishte për qëllim ta dorëzonte atë si peshkop të Sasimit, fleta 39;

Mbi Grigorin, peshkopin e Nisit (që u tregua) me përvojë, fleta 41;

Mbi njerëzit e kulturuar, mbi ata që janë në agoni, si dhe mbi arkondin zemërak, fleta 52;

Mbi fjalimet e Joanit (Gjonit) dhe mbi vëllain e tij Cesar (epitaf), fleta 60;

Mbi motrën e tyre Gorgonia (epitaf), fleta 69;

Epitafi i tetë në prani të Shën Vasilit, fleta 79;

Logos (ligjëratë, fjalim) i parë paqësor, fleta 100;

Logos i dytë paqësor, fleta 110 verso;

Logos i tretë paqësor, fleta 116 verso;

Theofania, fleta 124;

Mbi epifaninë, fleta 132;

Mbi pagëzimin, fleta 142;

Mbi Pashkën, fleta 167;

Mbi Pashkën, Logosi i 2-të, fleta 169;

Mbi të Dielën e Re, fleta 184;

Mbi pendikostikën (pesëdhjetoren), fleta 189;

Mbi mbajtjen e rregullit në biseda, leksione (liturgjike), fleta 197 verso;

Mbi arianët, fleta 211 verso;

Mbi dogmën e shenjtë dhe rregullin e peshkopëve, fleta 261;

Mbi teologjinë, fleta 265;

Kundër tre peshkopëve nga Egjipti, që janë kthyer (konvertuar?!), fleta 284;

Mbi dashurinë për vobegësinë, fleta 290;

Mbi presbiterin (priftin, meshtarin) Klidon, fleta 304 verso;

Po mbi Klidonin meshtar, Logos 2, fleta 307 verso;

Mbi vetveten, Logos 1; mbi ata që quhen si dashamirës për atë që do të jetë i Katedrës së Kostandinopojës, fleta 313 verso;

Mbi veten e tij, fleta 319 verso;

Mbi një filozof, fleta 329 verso;

Mbi ditën e kujtimit, fleta 340;

Mbi Athanasin, peshkop i Aleksandrisë, fleta 349;

Mbi Makabejt, fleta 365;

Mbi rregullimin (sistemimin) e peshkopëve në prezencë (paraqitje), fleta 373;

Mbi Shën Vasilin, fleta 385;

Kundër atyre që janë pro Julianit, Logos 1, fleta 423;

Mbi të njëjtën temë, Logos 2, fleta 466;

Mbi saktësinë dhe mbi autenticitetin e Ungjillit, fleta 484;

Mbi nektarin, fleta 493;

Omilie; fjalët e tjera janë zhdukur nga grisja e pergamenës, fleta 494;

Mbi virgjëreshën (Shën Mërinë), Logos këshillues, fleta 495;

Dhoksologjia (himn kishtar, që konsiderohet nga më të parët, nga më të vjetrit), fleta 497;

Jeta e atit, shenjt ndër shenjtorë, Grigorit të ... Theologut, fleta 498;

Pjesa prej fletës 503, me 5 fletët e fundit, është dëmtuar shumë. Teksti është i palexueshëm nga grisja e pergamenës. Disa fletë të tjera që përmbante ky artikull janë zhdukur.

Ky është një nga ata kodikë që kanë pësuar shumë dëme:

Fleta e parë disa fjalë i ka të fshira në tekst. Fletët 121 e 122 kanë pësuar fshirje të disa fjalëve dhe shkronjave në tekst nga fundi i rreshtave të kolonave anësore. Në fletët 121-126 rreshtat e fundit të kolonave anësore janë të përskuqur prej një lënde që është derdhur mbi to, por duke mos dëmtuar shkrimin. Fleta 178 ka pësuar një grisje në kolonën anësore dhe ka nevojë të restaurohet. Në disa fletë ka njolla, si në fletën 121, ku njollat nuk i kanë zhdukur shkronjat. Prej fletës 119 deri në fletën 238 ka zhdukje shkronjash nga një lagështi e vazhdueshme, por fatmirësisht kjo nuk ka depërtuar thellë në tekst. Po një dëm i tillë ka ngjarë edhe në fletët 141-165, si dhe në fletët 269-289. Po ky dëm vazhdon në fletët 299-303, si dhe në fletët 345-352. Në vazhdim dëmtimi rishfaqet në fletën 355 verso, në fletët 356 dhe në 363 verso, në fletët 364, 367, 369-370, 371-374. I njëjti dëmtim rifillon prej fletës 445 deri në 453, përsëri prej fletës 458 deri në 460, prej fletës 463 deri në 492. Kurse fletët e fundit janë dëmtuar shumë prej insekteve, në pjesën e sipërme, sidomos prej fletës 493 deri në 503, që është fleta e fundit.

Ngrëniet nga insektet, të fletëve të pergamenës, fillojnë prej skajit të poshtëm ku lidhen fletët e kodikut dhe shfaqen në fletët 266-503, që është fleta e fundit, duke mos e dëmtuar tekstin, por duke e shëmtuar kodikun.

Ky kodik nuk ka stolisje, përveç grafisë së tij bukurshkrimore dhe një vinjete në fletën e parë, në ngjyrë kafe, por pa ndonjë vlerë artistike, si dhe rrallë ndonjë germë nistore, vizatuar në format të madh, po në ngjyrë kafe.

## **KODIKU I 26-TË, I BERATIT**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 18 x 14 cm.

Sasia e fletëve: 185.

Teksti: Në një kolonë, me 19 rreshta për kolonë.

Grafia: Në ngjyrë kafe në të kuqe. Pikëzimet mbi fjalët janë të kuqe, me përjashtime ku rezultojnë me të njëjtën ngjyrë si teksti. Titujt me shkronja të vogla të kuqe. Stili i grafisë është i tipit të vonë, gjë që na ndihmon për datimin e kodikut.

Në fletën 13 ruhet një shënim anësor me shkronja edhe më të imëta nga ato të tekstit, në të cilin autori korrekton një profeci në tekst, duke thënë se nuk i përket profetit Eremia, por profetit Zaharia.

Kodiku nuk ka pasur kapakë. Është pajisur me kapakë të rij nga restauratorët e AQSH.

Para tekstit të çdo ungjilli është renditur lista e perikopeve, përveç Ungjillit sipas Mateut, që nuk e ruan listën e perikopeve, as faqet fillestare, deri tek tregimi i “gjyqit të fundit”.

Kodiku ruan nga një vinjetë mbi faqet fillestare të tre ungjillorëve, veç atij të Mateut, që është zhdukur. Vinjetat janë në formën e germës “p”-pi greke - me motive vizuale të bardha, vendosur mbi sfond të kuqërremtë, që variojnë. Janë të bukura, por shumë të zbehta.

Dëmtimet: Ungjillit sipas Mateut i mungojnë fletët e kreut të fundit. Fletët 3 e 4 e kanë të brejtur një pjesë në cepin e sipërm të pergamenës. Fleta 15, faqja verso, ka të dëmtuar rreth 6 rreshta. Fleta 39, në pjesën e poshtme të tekstit, ka një të ngrënë të pergamenës, që, për më tepër, duket se është ngjitur në fletën tjetër. Edhe fleta 47, pjesa poshtë tekstit, gjithashtu është grisur. Fletët 57-61 janë të shkëputura nga lidhja dhe ka rrezik të zhduken, prandaj duhet të rilidhen. Fleta 66, në një pjesë të madhe, i ka të zhdukur rreshtat në një pjesë të madhe nga lagështia, në faqen recto dhe në atë verso. Fleta 82 dhe ajo 83, si dhe fleta 84, kanë një grisje nga lagështia në cepin e poshtëm. Fletëve 86, 87, 94, 106, 113 dhe 114 deri 117 u janë fshirë pjesë të rëndësishme nga shënimet anësore të tekstit. Ato kanë gjithashtu dhe një të grisur jashtë tekstit. Kjo grisje del edhe në fletën 151. Prej fletës 179 deri në atë 184 pergamena është brejtur nga mola në pjesën anësore të fletëve, duke mos dëmtuar tekstin. Fletët e fundit të Ungjillit sipas Gjonit mungojnë, që prej kreut 17, stihu 2 (vargu 2), deri në fund të ungjillit, që ka kreun 21. Fleta e fundit e kodikut është shumë e zbehtë dhe ka disa fjalë të zhdukura. Dy copa të vogla të shkëputura nga ky kodik, që vërtetohet nga krahasimi i grafisë së tyre me atë të kodikut, është konstatuar se u përkasin fletëve të zhdukura nga Ungjilli sipas Gjonit: aty janë fjalë pikërisht nga përshkrimi i gjykimit të Krishtit nga Pilati. Ky kodik ka pësuar dëme nga lagështia, e cila, pasi është tharë, i ka lënë fletët e pergamenës të zhdrejta, të shtrembëruara. Nga ky shkak nuk është lidhur mirë kodiku. Mendojmë që kodiku ka nevojë për një restaurim të plotë, që të mund t'i drejtohen fletët, gjë mund të realizohet pa shumë vështirësi. Duhet të pastrohen shumë fletë të ndotura, si dhe lidhja të bëhet më e fortë, që kodiku të mund të përdoret lehtë nga ata që do ta studiojnë. Kodiku në fjalë, duke u mbështetur në grafinë e tij, duhet t'i atribuohet me përafërsi fundit të shekullit të 14-të. Kodiku nuk ruan asnjë zbukurim.

## **KODIKU I 27-TË, I BERATIT**

(OMILIE, FJALIME NË STIL SHPJEGUES NGA TEKSTI I DHJATËS SË RE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 32 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 194.

Teksti: Një kolonë, shkronjat janë të tipit të mesëm, në ngjyrë kafe, me 32 rreshta për faqe. Teksti përmban 28 omilie. Omilia e 28-të ka mbetur vetëm një fragment, në gjysmën e fletës.

Kapakët: Origjinalët e vetë kodikut kanë qenë të veshur me lëkurë. Por, duke qenë këta kapakë shumë të dëmtuar, kodiku është pajisur me kapakë të rij nga restauratorët e AQSH.

Dëmtimet: Fleta 1 ka shumë rreshta të tekstit të fshirë. Prej fletës 1 deri në fletën 40 cepi i poshtëm i pergamenës është ngrënë nga insektet, duke cënuar edhe shkronjat. Prej fletës 49 deri në fletën 65 janë ngrënë pjesa e djathtë e fletëve duke mos prekur tekstin. Në fletët 68 e 69 janë zhdukur pak shkronja nga pikimi i ujit. Në fletën 90 verso janë zhdukur dy shënime anësore. Prej fletës 119 deri në fletën 122 ka ngrënie nga insektet, sipër në anën e djathtë. Fleta 125 është e ngjitur në anën e brendshme duke zënë tekstin. Në faqen verso të fletës 130 janë zhdukur ca shkronja në fundin e rreshtave nga lagështia. Në rreshtin e parë të fletës 143 janë prishur disa shkronja edhe në faqen verso; po kështu dhe në fletët 144, 145, 146 e 147. Gjithashtu, prej fletës 149 deri në 161 rreshti i parë, ka fjalë ose shkronja të dëmtuara ose të zhdukura. Fleta 161 në fund ka një të prerë në mënyrë horizontale (për shkak se është marrë një pjesë pergamene formë rripi; kjo është nën tekstin, ndofta për shkak të ndonjë mbishkrimi që mund të ketë pasur). Dy fletët e fundit të kodikut janë errësuar shumë anash,

por teksti lexohet.

Shënime anësore: Në fletën 14 ruhen këto shënime anësore: 1- "Zonja konteshë e Skuripekut". 2- "Meshtari Foti i zonjës Skuripeku". Në fletën 15 ruhen dy mbishkrime të tjera: 1- "Kontesha e Skuripekut". 2- "O zot, kujto shpirtin e sherbëtorit të perëndisë, meshtar Skuripekut". Këto shënime janë pa datë.

Këto shënime i kemi gjetur dhe gjetkë. Prej tyre rezulton se kontesha është e shoqja e Skuripekut, që ka të ngjarë të jetë nga familja e njohur e Skurajve. Sipas burimeve të tjera në artet figurative këta bashkëshortë kanë jetuar në shekullin e 14-të. Në këtë kodik dëshmohet se shënimet e konteshës janë më të vona se teksti burimor. Shënimet janë në ngjyrë të zezë. Këto shënime të konteshës, gjithashtu, dëshmojnë se ajo nuk e ka njohur mirë greqishten, siç del nga gabimet ortografike të shënimeve.

Mendojmë se është vepruar mirë që nuk janë hequr kapakët e dëmtuar të vjetër të kodikut, sepse si dërrasat me copa lëkure sipër, por sidomos mënyra e lidhjes së kodikut, paraqesin mjaft interes për atë mjeshtëri.

Ky kodik, duke qenë me shkronja të tipit të mesëm, mendojmë se duhet t'i atribuohet shekullit të 13-të.

Kodiku nuk ka zbukurime.

## **KODIKU I 28-TË, I BERATIT**

(JETËSHKRIME SHENJTORËSH E MARTIRËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 27.5 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 158.

Grafia: Me shkronja të vogla, në një kolonë. Numri i rreshtave për faqe ndryshon prej 22 deri 28. Teksti është shkruar në bazë të linjave të gravuara. Shkrimi është i tipit të mesëm, shkronjat janë në ngjyrë kafe.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë, mbi të cilën ka zbukurime të stampuara, ornamente lineare në relief. Lëkura është e mbërthyer me gozhdë të gjera, me koka të dhëmbëzuara. Këto duhet të jenë afërsisht të kohës prej shekullit të 12-të deri në shekullin e 13-të.

Kodiku ka 158 fletë të numëtuara, por i mungojnë disa të fillimit.

Dëmet: Përveç zhdukjes së fletëve të para, fleta fillestare është me vrima, të shkaktuara nga insektet. Gjithashtu janë errësuar pergamena dhe shkrimi, si tek e para, ashtu dhe tek e dyta. Ndërmjet fletëve 74 e 75 lidhja e kodikut është prerë dhe kodiku është ndarë më dysh. Aty ku lidhen fashikujt e kodikut lëkura e kapakëve është grisur në shumë vende dhe ka nevojë për restaurim.

Kodiku nuk ka asnjë aplikim artistik, përveç grafisë së tij, që është me vlera estetike dhe mund të cilësohet mjeshtërore.

Në bazë të grafisë, kodiku duhet t'i atribuohet kohës ndërmjet shekullit të 12-të dhe atij të 13-të.

## **KODIKU I 29-TË, I BERATIT**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 24 x 17.5 cm.

Sasia e fletëve: 186

Teksti: Në një kolonë, me 22 rreshta për faqe, me shkronja të vogla të tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët. Pas fundit të çdo ungjilli ka shënime rreth tij, me grafi të kuqe të zbehtë.

Titujt janë me shkronja kapitale.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me pëlhurë, e cila ka mbetur fragmentare, kurse dërrasa e kapakut të poshtëm është brejtur mjaft nga mola. Lidhja e fashikujve të kodikut është e vjetër, dhe fashikujt ka rrezik të shpëputen nga lidhja.

Dëmtimet: Kodiku në fjalë ka pësuar mjaft dëme. Fleta që mbulonte kapakun nga faqja e brendshme është grisur, kurse fletët 1-8 ruhen të fragmentuara. Kodikut i mungojnë shumë fletë të Ungjillit sipas Mateut. Ky ungjill, kështu i dëmtuar, fillon me vargjet: "Nuk mund t'i shërbeni perëndisë dhe ...". Shumë fletë janë shqitur pjesërisht nga lidhja. Fleta 41 verso nuk korrespondon me tekstin e fletës 42. Duket se ka hyrë këtu gabimisht. Ndërmjet fletëve 75 e 76 duket se mungon një fragment teksti, ose është shpëputur një fletë. Fleta fillestare e Ungjillit sipas Lukës, sipër titullit me shkronja kapitale, ka të prerë vinjetën, të cilën një dorë skandaloze e ka marrë. Prej fletës 144 ka depërtuar lagështia deri në fletën 145. Fletët 181-183 rreshtat e parë i kanë të dëmtuar. Pas kësaj dy fletë janë shpëputur nga lidhja dhe fleta e fundit ka mbetur fragment. Kjo nuk ka tekst ungjilli, por lutje. Fjala e Shën Gjon Gojartit në fletën e fundit nuk ruhet e gjitha, sepse vazhdimi në fletën pasuese është grisur.

Sipas grafisë së tekstit, kodiku duhet t'i atribuohet afërsisht fillimit të shekullit të 13-të.

Fletët e pastra kanë një pamje shumë të bukur, që ua jep grafia e theksuar bukurshkrimore, e cila duket si e stampuar.

## **KODIKU I 30-TË, I BERATIT**

(MARTIROLOGJI DHE JETË SHENJTORËSH-AGJIOGRAFI-)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 29 x 24.3 cm.

Teksti: Në dy kolona, me shkronja të tipit të mesëm, në ngjyrë kafe, me 40 rreshta për kolonë, me shkronja të imëta.

Titujt e e lëndës: Gjenden në fletën e parë:

Jeta dhe veprimtaria e Shën Kozmait dhe e Damianoit, fleta 1.

Martirizimi i katër martirëve të shenjtë, fleta 4 verso.

Martirizimi i katër martirëve të tjerë, fleta 13.

Jeta e atit tonë oshënar, Joaniqit të Madh, fleta 23.

Jeta dhe martirizimi i dy shenjtorëve, Galaktioni dhe Epistimiti, fleta 42.

Jeta e një oshënar, fleta 47 verso.

Martirizimi i martirëve të shenjtë në Melitinë, fleta 52.

Tregime mbi disa mrekulli të arkistrategut Mihael, të mbledhura, të zgjedhura nga Dhjata e Vjetër dhe ajo e Re, fleta 55 verso.

Jeta e nënës sonë oshënares Matrona, fleta 63.

Jeta dhe veprimtaria e oshënares Theoktite (të Lesvias, Lesbos), fleta 75.

Martirizimi i martirit të madh, shenjtit Mina të Egjiptit, fleta 81 verso.

Jeta dhe veprimtaria e atit tonë oshënar Amfilok, fleta 84.

Jeta dhe veprimtaria e atit tonë oshënar Grigor, peshkopit të Agragantinoit, fleta 88 verso.  
 Martirizimi i dëshmores së madhe dhe të bukur (murgeshë) Ekaterina, fleta 112 verso.  
 Jeta e atit tonë shenjt ndër shenjtorë e dëshmor, Klementi, peshkopit të Romës; rreth apostujve të Pjetrit dhe Palit (jeta dhe veprimtaria e tyre në mënyrë sinoptike, përmbledhëse), fleta 118 verso.  
 Martirizimi i martirit të shenjtë Jakov Persianit, fleta 170.  
 Jeta dhe veprimtaria e një oshënar, fleta 177 verso.  
 Jeta dhe veprimtaria e atit tonë Stefan, fleta 183.  
 Dëmet: Nga 26 tituj të jetëshkrimeve të shenjtorëve dhe të martirëve që përmenden në listën e faqes së parë, vetëm 18 ruhen të plota. Të tjerat janë në fragmente, të brejtura nga mola. Gjithashtu, mungojnë fletët që kanë humbur pas asaj me numër 204. Fletët që kanë ngrënë insektet dhe kanë mbetur të fragmentuara janë në pjesën 154-179, si dhe 196-204, që është fleta e fundit. Në fletën 2 është prerë dhe marrë titulli i pjesës që i kushtohet jetës së Shën Kozmait dhe Damianoit. Fletë të ngrëna nga insektet janë dhe ato me numër 84-132 dhe 133-136. Insektet kanë dëmtuar katër rreshtat e fundit të kolonës së djathtë. Insektet kanë dëmtuar një pjesë që ndofta i përket peshkopit të Aleksandrisë, që vjen në listë pas jetës së Klementit të Romës.  
 Martirizimi i Mërkurit dhe i një oshënar vjen pas pjesës kushtuar peshkop Pjetrit të Aleksandrisë. Për këtë nuk dihet faqja ku fillon, sepse lënda është dëmtuar nga mola.

### **KODIKU I 31-TË, I BERATIT**

(LOGOS - FJALIME, LIGJËRATA - DHE MARTIROLOGJI)

Materiali: Pergamenë.  
 Përmasat: 22.2 x 17.3 cm.  
 Sasia e fletëve: 102.

Teksti: Në një kolonë, me shkronja të vogla të tipit të mesëm, me ngjyrë kafe, me 33 rreshta për faqe.

Artikullit të parë nuk i ruhen dy fletët e fillimit dhe nuk është e mundur të konstatohet për çfarë bëhet fjalë, fleta 1 e 2.

Martirizimi i martirëve të mëdhenj Eustratit dhe tre të tjerëve, fleta 2-20.

Bisedë mbi Efremin e lumtur, fleta 20-25.

Mbi të Dielën e Pranverës, fleta 25-29.

Magjistër dhe orator Simeoni, martirizimi i dëshmorit të shenjtë Shën Theodor Stratilatit, fletët 29-38 verso.

Logos e Simeon Magjistrin dhe oratorit: martirizimi i dëshmorit të shenjtë Shën Vasilit, fletët 38-44 verso.

Jeta dhe veprimtaria e atit tonë oshënar Gjonit (Joanit) të Aleksandrisë, fletët 45-72.

Kujtim mbi apostujt e shenjtë të Krishtit, fletët 72-82.

Martirizimi i dëshmores së shenjtë Varvara (Barbara), fletët 82 verso deri 89.

Nga Simeon Magjistri, oratori: mbi atin tonë Shën Kollin, peshkop i Mirës së Likisë, fletët 89 verso deri 102. Kjo bisedë është e pa përfunduar, sepse fletët ku vazhdonte kanë humbur.

Kodiku në fjalë nuk e ka as fillimin as mbarimin, por dhe në fletët që ruhen ka pësuar dëme. Fletët 14-27, në pjesën e poshtme, janë ngrënë nga mola, por fatmirësisht duke mos dëmtuar tekstin. Gjithashtu, prej fletës 41 deri në fletën 49 poshtë, si dhe prej fletës 71 deri në fletën e fundit 102, vërehet i njëjti dëmtim.

Ky kodik është shkruar mbi fletë pergamene të mbetur, fragmentare, në disa pjesë dhe shumë e trashë, e shtrembëruar nga lagështia. Duke u mbështetur në grafinë e tij, kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 13-të.

## KODIKU I 32-TË, I BERATIT

(VËLLIM PREJ TRE LIBRASH NË DORËSHKRIM)

I pari është psaltir, përmban psalmet e Danidit; dy të tjerëve, duke mos e pasur fillimin, nuk qe e mundur t'u atribuohet titull. Nga disa pjesë që mund të lexohen duket se përmban pjesë të ndryshme teologjike, historike e morale, këto të trajtuara në mënyrë teorike. Ka dhënie mendimi apo gjykimi, që në sllavishten kishtare thuhet “rasudjvanje”, mbi çështje të ndryshme. Libri i dytë përmban çështje teologjike, nga këto më tepër dogmatike.

Materiali: Letër.

Përmasat: 21.5 x 14.6 cm.

Sasia e fletëve: 384, ku përfshihen dhe shumë fragmente që janë të ngrëna nga mola. Por edhe pas fletës 384 ka shumë fletë të tjera, të brejtura nga insektet, me të cilat numri i përgjithshëm i fletëve arrin deri në 407.

Teksti i tre librave është në një kolonë, por secili prej tyre ndryshon në grafi. I pari, që fillon me fletën 1 shkon deri në fletën 109. I dyti, që përmban psalmet, fillon nga fleta 110 dhe shkon deri në fletën 195 dhe i treti fillon prej fletës 218 dhe shkon deri në fletën 407.

Kapakët: Prej dërrase dhe mbi të është ngjitur një karton i trashë. Këta janë të dëmtuar shumë në pjesët anësore (të brejtur nga mola).

Ndërmjet këtyre dy librave të fundit ruhen disa fletë, prej asaj me numër 196 deri në atë me numrin 217, të cilat ndryshojnë nga tre librat e këtij vëllimi, duke përmbajtur këshilla fetare morale.

Teksti i librit të parë, si rregull me shkronja të vogla me ngjyrë kafe të errët, herë-herë rezulton me shkronja në forma të mëdha.

Shkruesi i këtij libri shumë grafemave u jep disa forma të ndryshme, gjë që kërkon të mësohet mirë leximi në këtë tekst, të njihet alfabeti, që të mund të kuptohet. Veç këtyre ka dhe shumë fjalë të shkurtuara, me dy ose tre shkronja, ose një shkronjë të vetme, që simbolizon një fjalë, të cilat mund të lexohen në kontekst, duke u mbështetur në kuptimin e fjalëve të plota ose të të gjithë frazës. Në këtë tekst janë dhe disa iniciale pak më të mëdha se ato të rëndomtë.

Teksti i librit të tretë është më i vështirë se dy të parët, për arsye të shkrimit me shkronja më të vogla dhe penës më të trashë. Nganjëherë rezultojnë nga dy-tre fjalë të ngjitura. Në këtë libër nuk ka as kapituj as iniciale, që të kuptosh se ku fillon një pasos (paragraf) dhe ku nis zhvillimi i një mendimi tjetër. Ngjyra e grafisë është kafe pak më e çelët se në kodikë të tjerë. Libri i psalmeve ka një grafi aq të imët, sa që shkronjat përfshihen brenda një milimetri. Bëjnë përjashtim shkronjat grafikisht më të mëdha siç është “ksi” ose “u” e ndonjë tjetër. Grafia e psalmeve ka një mjeshtëri të shkëlqyer, për hir të shkronjave të imëta. Faqja e psalmeve, duke qenë lartësia e fletës 21.2 cm, përfshin 46 rreshta shkrimi. Kjo është grafia me shkronja të imëta në gjithë literaturën tonë mesjetare.

Libri i psalmeve, në tri fletët e para, ka një hyrje ose një parathënie. Psaltiri fillon me psalmin e parë “I lumtur është ai njeri”, në fletën 112, dhe mbaron në fletën 194, me psalmin “Çdo frymë le të lavdërojë Zotin”. Në këtë psaltir psalmet nuk i shohim të jenë ndarë me numra, siç janë sot, prandaj nuk mund të konstatohet sa psalme përfshihen në këtë libër.

Kodikun në fjalë nuk ka stolisje, përveç grafisë së shkëlqyer të psalmeve.

Në këtë kodik grafinë po ia atribuojmë shekullit të 13-të, ndonëse është e vështirë të jemi të saktë në datimin e tij.

**KODIKU I 33-TË, I BERATIT**

(KALENDAR FETAR VJETOR - SYNOPSIS -)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 20.3 x 15 cm.

Sasia e fletëve: 142.

Teksti: Në një kolonë për faqe, me 24 rreshta secila, me shkronja të tipit të mesëm, në ngjyrë kafe të çelët. Inicialet dhe titujt janë në ngjyrë të kuqërremtë, me shkronja kapitale.

Kapakët: Janë të rinj, të vënë nga arkivistët. Kapakët e vjetër nuk janë ruajtur.

Datimi: Duke u mbështetur në grafinë e bukur, duhet t'i atribuohet shekullit të 12-të deri në shekullin e 13-të.

Kodiku është një farë kalendari kishtar, që përmban festat për çdo ditë të 12 muajve të vitit. Kur festat janë të rëndësishme, ka dhe udhëzime se çfarë këndohet e lexohet në ditët e tyre. Synopsi i tyre tregon dhe çfarë lexohet e këndohet gjatë kreshmëve deri të shtunën e madhe. Kjo lëndë gjendet në librin kishtar që e quajnë „triodh“.

Zbukurime artistike: Në fletën 18 kodiku ka një vinjetë të pikturuar në formë shiriti të ngushtë, gërshetuar me një kordon të bardhë, mbi sfond të kuqërremtë. Një vinjetë e tillë ruhet dhe në fletën 45, dhe një e tretë në fletën 74 verso. Kurse në fletën 85 ruhet një vinjetë në formë shiriti mjaft të gjerë, stolisur prej një linje valëzuese, e cila ka zbukurime të imëta në fushat që lë bosh. Linja valëzuese, linjat e tjera dhe zbukurimet e vogla janë të bardha, mbi një sfond të kuqërremtë, ose në ngjyrë kafe të errët.

Dëmtimet: Fleta e parë në gjysmën e sipërme është grisur shumë dhe nxirë, në faqen recto dhe në faqen verso. Fleta 2 ka gjithashtu grisje në pjesën e poshtme. Kjo grisje ka dëmtuar tre rreshtat e fundit. Prej fletës 2 deri në fletën 26 pergamena është ngrënë prej insekteve në pjesën e poshtme, duke mos cënuar rreshtat e shkruar. Fletët e para të kodikut deri tek fleta e gjashtë kanë pësuar mjaft ndotje. Ndotjet përsëriten dhe bëhen më të rënda sidomos prej fletës 104 deri në fletën 137, kurse prej fletës 138 deri në fund dorëshkrimi ka pësuar ndotje të tilla që e kanë zhdukur shumë dhe tekstin.

**KODIKU I 34-T, I BERATIT**

(LITERATURË PATROLOGJIKE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 25.8 x 16.5 cm.

Grafia: E tipit të mesëm, në ngjyrë kafe të errët dhe të çelët.

Kodiku nuk ka pasur kapakë, kapakët e rij i janë vënë nga arkivistët.

Kodiku ka shkrimet që pasojnë:

Mbi atin tonë Simeon Stilitin; fleta 1-2.

Zbulimi dhe tregimi i atit tonë oshënar Arhip pranë tempullit të manastirit të Arkistrategut qiellor Mihael, fletët 7-11.

Mbi lindjen e Hyjlindëses, Logos (fjalim, ligjëratë) e muajit shtator, fletët 12-23 verso.

Mbi ngritjen e kryqit, fletët 19 verso deri 23 verso.

Jeta dhe veprimtaria dhe martirizimi i Shën Eustathit (Evstathit) dhe bashkëshortes së tij, e muajit shtator, fletët 24-32.

Mbi izraelitin që u bë i krishterë, fletët 2-9 verso.

Mbi mishërimin e arianëve, fleta 5 verso.

Nga Shën Gjon Gojarti, kryepeshkop i Kostandinopojës; mbi Theofaninë; fletët 10-12.

Logos nga Amfiloku, kryepeshkop i Ikonisë (Konya?), e muajit shkurt, fletët 10-12.



Mbi fariseun, Logos prej Shën Gjon Gojartit, kryepeshkop i Kostandinopojës, fleta 16 verso deri 20 verso.

Mbi ardhjen e dytë të zotit tonë Jezu Krisht, mbajtur në ditët e kreshmës, prej Shën Gjon Gojartit, kryepeshkop i Kostandinopojës.

E Diela e Djathit, tregim nga jeta e Adamit dhe Evës zbuluar Moisiut, fletët 23 verso deri 29 verso.

Mbi Shën Teodorin, fleta 29 verso deri te fleta 34.

Mrekullia e Teodor Stratilatit.

E Diela e Ortodoksisë, fletët 38.

Martirizimi i 40 shenjtorëve në qytetin Sevastopol, fleta 46 verso deri te fleta 51.

Martirizimi i martirit të shenjtë Vlashit në qytetin Sevastopol, fletët 51-55 verso.

Mbi jetën e (një njeriu me emrin) Aleksii, fletët 5-59 verso.

Ungjillëzimi i së mbishenjtës Mari, e muajit mars, fletët 59-64.

Nga Amfiloku, peshkop i Ikonisë (Konya?); mbi Llazarin katërditësh, fletët 64-66.

Nga Epifani i Kipros (Qipros): Logos mbi ditën e dafinës, fletët 65-69.

Nga Evraim (Siriani): mbi shitjen e Josifit (në Misir), fletët 69 verso deri 83.

Nga Shën Gjon Gojarti, kryepeshkop i Kostandinopojës: Logos mbi laviren dhe fariseun, fletët 83-84 verso.

Nga Shën Gjon Gojarti, kryepeshkop i Kostandinopojës: mbi tradhtinë e Judës, fletët 84 verso deri 85 verso.

Idem: Logos mbi pësimet e zotit tonë Jezu Krisht, fleta 85 verso deri 86 verso.

Nga Epifani, peshkop i Kretës: mbi varrimin e zotit Krisht, fletët 86-87.

Nga Shën Gjon Gojarti: mbi Pashkën dhe Shën Thomain, fletët 87-101.

Idem: mbi ulokun, fletët 101-105.

Nga Evraim Siriani: mbi dhënien me devotshmëri, lutje dhe pendim, fletët 105- 107.

Nga Shën Gjon Gojarti: mbi shërbesën e Jezu Krishtit, fletët 107-109 verso.

Idem: mbi pesëdhjetoren (pendikostinë), fletët 109 verso deri 111.

Porositë e atit tonë Shën Vasilit: mbi gjendjen e meshtarëve dhe të dhjakëve (dhiakonëve), fletët 111 verso deri 112.

Nga Shën Gjon Gojarti: mbi kreshmën dhe lutjen, fletët 112-113.

Mbi gjetjen e kryqit, fleta 113 verso deri fleta 121 verso.

Mbi jetën e atit tonë oshënar Martinit, e muajit prill, fletët 121 verso deri 123 verso.

Mbi atin tonë oshënar jeromonaku Kostandin, e muajit prill, fletët 121 deri 123 verso.

Mrekullia që ndodhi tek një i vdekur, mbajtur i pavarrosur, fletët 123 verso deri 124.

Mbi një djalë që është plagosur, fletët 123-124 verso.

Mrekullia mbi shiun, fletët 124 verso deri 125 verso.

Shkurt mbi jetën e Efrosinit, fletët 127-128 verso.

Nga etërit e shenjtë: zgjedhja e shkrimeve të shenjta, dobia e atyre që lexojnë këto shkrime, fletët 128 verso deri 129 verso.

Martirizimi i dëshmorit të madh Shën Gjergj, e muajit prill e maj, fletët 129 verso deri 133.

As fletët, as kalendari, nuk janë të vijueshëm dhe të renditur.

Dëmtimet: Fletët 33-34 verso përmbajnë një pjesë (teksti) pa fillimin. Kjo pjesë bën fjalë mbi profet Ilian, nga Dhjata e Vjetër. Logosi i atit tonë Shën Gjon Gojarti mbi gratë e këqija, që gjendet në fletët 37 dhe 38, është dëmtuar, sepse në këtë pjesë pergameni është nxirë pjesërisht prej një lloj lëngu të derdhur mbi të, aq sa mezi lexohen fjalët. Kurse fleta 38, përveç nxirjes, që i ka bërë të palexueshëm shumë rreshta, ka dhe një pjesë të madhe të grisur. Ka shumë fletë që janë zhdukur, gjë që konstatohet nga mospërfundimi i tekstit. Prej fletës 39 deri në fletën 45 gjendet teksti me luftën e kryeengjellit Mihael me të ligun, por fletët e para mungojnë. Për këto nuk dimë nëse kanë qenë. Ky tekst mbaron me fletën 45 verso, që është fleta e fundit e tij.

**KODIKU I 35-TË, I BERATIT**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 18.5 x 13 cm.

Sasia e fletëve: 428.

Teksti: Në një kolonë, me 26 rreshta për faqe. Shkronjat janë në ngjyrë kafe të çelët. Titujt e ungjijve janë me shkronja kapitale. Nistoret e çdo ungjilli janë me shkronja të mëdha kapitale të stolisura me ngjyra.

Grafia: E tipit të vonë, por me vlerë bukurshkrimore.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë, zbukuruar prej linjash të presuara. Cepi i kapakut të sipërm është këputur dhe një pjesë lëkure në anën e poshtme të lidhjes ka rënë nga kodiku, i brejtur nga mola.

Stolisja: Kodiku stoliset me tri figura të pikturuara në fletët e para të fillimit të çdo ungjilli. Figura e ungjillorit Gjon me sa duket ka pasë munguar.

Kodiku ka edhe tri vinjeta.

Ungjillorët kanë thuajse të njëjtin kompozim, ndenjor mbi një fron para tryezës së shkrimit dhe para një pulti. Tek të tria figurat duket një engjëll duke u zgjatur nga pas dhe duke i prekur kallamin me të djathtën e shtrirë, gjë që simbolizon inspirimin prej së larti (frymëzimin hyjnor). Fronet janë në ngjyrë të gjelbër të errët, ose të çelët, ose të kuqe. Figurat stolisën me zbukurime në ngjyrë të kuqe ose blu. Mateu stoliset me blu në të gjelbër të errët, me pala të ndritura prej ari dhe me veshje të kuqe, duke ngjyer kallamin në shishe. Marku paraqitet duke prekur kallamin dhe Luka duke shkruar në libër. Më mirë nga portretet e ungjillorëve ruhet ai i Mateut dhe në përgjithësi figura e tij. Tek Mateu dhe tek ungjillorë të tjerë engjëjt i shohim me fletët përpjetë, paraqitur me mjaft elegancë, në ngjyrë të kuqe dhe blu. Tek Marku hitoni është i kuq, në format e dala në ngjyrë violetë të çelët, mbi fron të kuq. Tek Mateu dhe Luka e kuqja kombinohet duke u vendosur ndërmjet dy ngjyrave kontraste. Portretet e tyre dhe të engjëjve modelohen në ngjyrë kafe.

Vinjetat e tyre janë horizontale, në formë shiriti. Ato kanë motive në formë zemrash, me linja valëzuese dhe në trajtë medalionesh, prej ngjyrash blu, të kuqe dhe kafe, por pa ndonjë vlerë artistike.

Ndër figurat e ungjillorëve vlerë artistike më të dukshme paraqet ajo e Mateut, jo se është ruajtur shumë më mirë nga dy të tjerat, por se është trajtuar më me kujdes.

Vlera e këtij kodiku vërehet sidomos në grafisë e tij shprehëse.

Kodiku në fjalë nuk mund të jetë më i vjetër se shekulli i 14-të.

**KODIKU I 36-TË, I BERATIT**

(PERIKOPE UNGJIJSH)

Materiali: Letër.

Përmasat: 32 x 21.6 cm.

Sasia e fletëve: 127.

Teksti: Me grafi bukurshkrimore dhe në dy kolona për faqe; grafia është e tipit të mesëm, në ngjyrë kafe.

Kodiku ruan disa vinjeta në fillim të perikopeve. Këto kanë formën e germës „p“ -pi greke - ose formë shiriti. Fusha e tyre është e stolisur me motivin e zemrave të stlizuara. Inicialet e perikopeve janë vizatuar me forma të ndryshme dhe janë jo shumë të mëdha. Të gjitha këto stolisje janë me ngjyrë të kuqërremtë të çelët.

Datimi: Në mbyllje të tekstit të fletës së fundit ruhet data e shkrimit, viti 6830 - viti i krijimit të botës sipas mendimit kishtar, ose viti 1322, sipas kalendarit të sotëm.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë, e cila është nxirë dhe plasur në shumë vende, sikur të ishte djegur nga zjarri. Kapaku i poshtëm është shqitur nga të brejturit e molës, duke lënë një pjesë të hollë në të lidhurit; ka nevojë për restaurim.

Dëmtimet. Fleta e parë ka një pjesë të palexueshme në tekst nga një errësim që ka pësuar. Ndërmjet fletës 7 e 8 është shkëputur një fletë. Fletët 77, 78, 79 dhe 80 janë shqitur nga kodiku dhe janë marrë në mënyrë të vrazhdë. Fletët nga fundi janë njollosur shumë.

## **KODIKU I 37-TË, I BERATIT**

(PATROLOGJI DHE MARTIROLOGJI - E ETËRVE DHE E MARTIRËVE TË KISHËS -)

Materiali: Letër.

Përmasat: 30 x 21 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 398.

Teksti: I çdo çështjeje fillon me nistore në ngjyrë të kuqe. Shkrimi është me kapitale, por të vogla, pa zburime.

Grafia: E tipit të mesëm dhe ka vlerë bukurshkrimore. Është në ngjyrë kafe, në dy kolona për faqe.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë me motive lineare që formojnë ornamente të presuara, në formë zemrash, lulesh ose gjethesh të stilizuara. Kapakut të poshtëm të kodikut, në anën e sipërme, një pjesë e lëkurës i është brejtur dhe nga kjo ka dalë dërrasa. Kodiku nuk ka stolisje. Në faqen 237 është një vinjetë e kompozuar prej linjash të kuqe, por pa art e pa përmbajtje.

Dëmtimet: Kodiku ka pësuar shumë dëmtime nga lagështia. Prej fletës 1 deri në fletën 31 është zhdukur një pjesë e tekstit nga ana e sipërme e kolonave dhe pak edhe nga ajo e poshtme. Gjithashtu, lagështia e ka prekur tekstin prej fletës 361 deri në fletën e fundit 398. Dëmet në tekst fillojnë gradualisht e rriten në mënyrë progresive, ku më shumë e ku më pak. Prej fletës 376 e tutje fillon të zhduket teksti në mënyrë të palexueshme dhe prej fletës 384 teksti është lagur fare. Në fletën 127 në kolonën e djathtë është prerë gjysma e poshtme e fletës dhe është marrë. Fletët e parafundit kanë pësuar grisje dhe dy prej tyre janë dëmtuar shumë.

Në faqen verso të fletës së fundit të kodikut ruhet ky mbishkrim: "U shkrua ky libër në vitin 6835 (viti 1327 sipas kalendarit të ri), në kohën e mbretit të shumëdevotshëm dhe krishtdashës Andronik Paleologut e të së shumëdevotshmes dhe kishtdashëses zonjës së Andronik Paleologut, perandorit të romakëve" (nënkuptohet: „të romakëve të Lindjes“, domethënë të Bizantit).

Ky mbishkrim, që gjendet në fletën e fundit prej pergamene; grafia e kodikut, që është e gjitha në letër, e krahasuar me grafitë e kodikëve të datuar si të shekullit të 14-të; na vërtetojnë se i gjithë kodiku është i shekullit të 14-të dhe se dy fletët e fundit me mbishkrimin janë përdorur për ta përforcuar lidhjen e kodikut, kështu që dhe grafia e tij është e vitit 1327.

Shkrimet që përmban kodiku:

Më 6 të muajit shtator fillon jeta e atit tonë Simeon Stilitit. Po më 6 të këtij muaji është dhe një tregim i shkurtër mbi një mrekulli që ka ngjarë, nga kryeengjëlili Mihail.

Më 8 të këtij muaji: Logos mbi lindjen e të gjithënderuarës dhe të përmbilavdëruarës zonjës sonë hyjëlindëse dhe gjithmonë virgjëreshë Mari. Po mbi këtë fletë është një tjetër logos mbi lindjen e Shën Mërisë, nga Joan Damaskioni.

Më 14 të të njëjtit muaj: Logos i improvizuar mbi përkujtimin e kryqit të dhënë, nga Andrea, kryepeshkop i Kretës.

Po në këtë muaj: jeta, veprimtaria dhe martirizimi i Shën Eustatit (Evstathit) dhe i bashkëshortes së tij dhe fëmijëve, Agapiut e Theopistit.

Më 6 të muajit tetor: martirizimi i të shumëfamshmit apostull Thoma.

Më 18 të po atij muaji: Fjetja e apostullit të shenjtë e të ungjillorit të shumëfamshëm Luka.

Më 26 të këtij muaji: martirizimi i martirit të madh e të lavdëruar Shën Mitrit.

Më 1 të muajit nëntor: jeta dhe veprimtaria e shenjtorëve çudibërës Kozmait dhe Damianoit, si dhe e nënës së tyre Teodorës.

Më 2 të këtij muaji: martirizimi i pesë martirëve të lavdërueshëm e të shenjtë.

Më 8 të këtij muaji: mbi arkistrateg Shën Mëhillin dhe mbledhjen e fuqive pa trup.

Më 11 të këtij muaji: martirizimi i martirëve të mëdhenj të lavdëruar e të shenjtë Minait, Viktorit e të tjerë.

Më 12 po të këtij muaji: kthimi i lipsanit të atit tonë Shën Gjon Gojarti.

Më 14 të këtij muaji: vepra dhe martirizimi i apostull Filipit të lavdëruar.

Më 17 të këtij muaji: mbi atin tonë të shenjtë Grigorin, peshkopin e Nisit; mbi jetën dhe mrekullitë e atit tonë shenjt ndër shenjtorë Grigorit, peshkopit të Neokesarisë (Cesarisë së Re?).

Më 21 të këtij muaji: (Logos) nga ati ynë Jermanoi, kryepeshkop i Kostandinopojës; bisedë hyjnizuese mbi Shën Mërinë.

Më 27 të këtij muaji: martirizimi i të lavdëruarit Shën Jakovit të Persisë, që ka qenë martirizuar në kohën e sundimit të persëve dhe të mbretit të Romës, në kohën e Arkadit (Arkadhit).

Më 4 të muajit dhjetor: martirizimi i dëshmoret së madhe Varvara (Barbara).

Më 6 të këtij muaji: aktiviteti i atit tonë Shën Kollit, kryepeshkopit të Mires së Likisë.

Më 10 të këtij muaji: martirizimi i martirit të shenjtë Minait.

Më 13 po të këtij muaji: martirizimi i martirëve të shenjtë e të lavdëruar të Krishtit, Eustatit, Auksentit, Eugjenit dhe Orestit.

Më 17 të të njëjtit muaj: martirizimi i shtatë djemve.

Më 22: martirizimi i Anastasisë së Romës.

Më 25: (Logos) nga ati ynë Grigor Theologu; mbi lindjen e zotit tonë Jesu Krisht.

Më 10 të muajit janar: (Logos) nga ati ynë shenjt ndër shenjtorë Grigori, kryepeshkop i Kostandinopojës; logos i mëvonshëm mbi varrin e Shën Vasilit të madh.

Amfiloku, peshkop i Ikonisë (Konya?): mbi jetën dhe mrekullitë e atit tonë Shën Vasilit, kryepeshkopit të Qesarisë (Caesarea) dhe të Kapadokisë.

Mbi mohimin e Krishtit. Mbi Anastas Persianin. Mbi Evraim Sirianin. Mbi gruan mëkatare. Mbi Josif Izraelitin dhe mbi mjekun.

Më 5 të këtij muaji: ati ynë shenjt ndër shenjtorë Grigor Theologu, peshkopi: mbi ujët e bekuar; Logos tjetër (idem), mbi pagëzimin e shenjtë.

Jeta dhe aktiviteti i një oshënari me emrin Joan.

## **KODIKU I 38-TË, I BERATIT**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Letër.

Përmasat: 25 x 19.5 cm.

Sasia e fletëve: 239.

Grafia: E tipit të vonë, e shkruar në ngjyrë kafe, me vlerë estetike.

Shkrimi: Në një kolonë, me 21-22 rreshta secila. Nistoret e çdo perikopeje janë me shkronja kapitale pak të zmadhuara dhe të stolisura me nga një bisk luleje të stilizuara. Kurse inicialet fillestare të çdo ungjilli janë të mëdha e të stolisura me lule të stilizuara në ngjyrë të kuqërremtë, me madhësi 7-9 cm.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me pëlhurë kadifeje të kuqe, e cila është ngrënë pak

anash dërrasës. Kapaku i poshtëm është ngrënë pak në sipërfaqe.

Ky kodik stoliset me katër skena të ungjillorëve, të cilat janë pikturuar secila një fletë para fletës fillestare të ungjillit. Sipër, para fillimit të çdo ungjilli, ruhet dhe nga një vinjetë, me motivin e linjave të harkuara, që lidhen njëra me tjetrën dhe në vendet ku takohen kanë nga një si lilan tri ose katër petalësh, të bardhë mbi sfond të kuqërremtë. Ungjillorët Mateu, Marku dhe Luka janë kompozuar para një sfondi arkitekturor, ulur mbi frone para tryezës së shkrimit. Luka është para një pulti, kurse Gjoni është kompozuar me Prohorin, gjithashtu ulur mbi frone, por para një sfondi shkëmbor, pa tryezën e shkrimit.

Ungjillorët paraqiten në pozicion ndenjor, në mënyrë krej natyrore, me këmbë zbathur, vendosur mbi një nënkëmbëse, ulur mbi jastëkë. Mateu ka ungjillin në duar duke e lexuar, Marku del me ungjillin mbi gjunjë duke shkruar, Luka duke e lexuar dhe Gjoni duke i cituar Prohorit, që është duke shkruar. Mateu dhe Luka fronin e kanë me mbështetëse, kurse Marku dhe Gjoni pa mbështetëse.

Tri figurat e ungjillorëve të parë duken si mbi një tarracë të godinës ku gjendet ungjillori, kurse në sfondin e Markut duket dhe një godinë tjetër së largu, me dritare të harkuara nga sipër. Skena stoliset dhe me një pëlhurë, që është varur prej një çatie në tjetrën, kjo duket e punuar si me shirita dhe kalema me vegjë. Një stolisje e tillë vërehet dhe mbi sfondin e Lukës, me pëlhurë prej një rës godinë në tjetrën.

Të katra figurat e ungjillorëve janë trajtuar në mënyrë të theksuar artistike me proporcione të rregullta, me pozicione krejt natyrore, me lëvizje të matura, me një siluetë të hirshme gracioze. Kudo bie në sy talenti i fuqishëm i artistit, por sidomos në modelimin e portreteve me anë të detajeve të hollësishme, jo vetëm me individualitet të theksuar, por dhe me shprehje të ëmbël, të fuqishme dhe origjinale tek secili. Vetëm se piktori i talentuar nuk ka pasur parasysh moshën e Markut, i cili, kur ka shkruar ungjillin, sipas të dhënave të literaturës së kohës, ka qenë në moshë shumë më të vogël nga të tjerët, kurse këtu paraqitet i moshuar si dhe të tjerët.

Këto skena janë monokrome (njëngjyreshe), në të kuqërremtë të lehtë, si dhe në kafe të lehtë. Tek Marku është dhe brerorja e verdhë, që imiton arin.

Vinjetat e kodikut nuk përmbajnë ndonjë vlerë artistike, po ashtu dhe inicialet fillestare të çdo ungjilli.

Kodiku nuk e ka emrin e kopjuesit, as të piktorit të figurave, por, duke u mbështetur në grafisë e tipit të vonë, por elegante, mendojmë se duhet t'i atribuohet me bindje të plotë shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 39-TË, I BERATIT**

LETËRSI BIBLIKE DHE PATROLOGJIKE

MBI ÇËSHTJE TË NDRYSHME JETËSORE MORALE SIPAS FRYMËS SË DHJATËS SË RE

Materiali: Pergamenë.

Sasia e fletëve: 175.

Grafia: E tipit të vonë.

Shkrimi: Në ngjyrë kafe të errët, inicialet janë me shkronja kapitale. Nga nistoret vetëm një është e vizatuar, por pa ngjyra. Shkrimi është në një kolonë, me 20-30 rreshta për kolonë.

Fleta e parë e kodikut është grisur pjesërisht në anën e sipërme, kurse në fund të fletës 2 verso fillon parathënia, që shkon deri në gjysmën e faqes së fletës së tetë. Prej këtu fillojnë titujt e çështjeve që përmbahen në këtë kodik, si pason:

Mbi pendimin dhe cila është koha e pendimit; mënyrat me anë të të cilave arrihet pendimi, si dhe mbi frytet e tij.

Si njeriu nuk duhet të jetë gjithnjë kundërshtar dhe të jetë i pastër në studimin e atyre që i

pëlqen dhe i do Perëndia.

Mbi dashurinë ndaj Perëndisë dhe si ta dëshmosh këtë.

Ç'është nderimi për Perëndinë dhe ç'është të mos jesh i ndershëm.

Mbi dashurinë ndërmjet njëri-tjetrit dhe mënyrat si arrihet ajo.

Si për të shpëtuar nuk mjafton rrëfimi, po të mos ruhen porositë e Perëndisë.

Mbi besën dhe mbi njohjen e fjalëve të Zotit.

Mbi dijen dhe padijen e atyre që na imponohen.

Ç'është fundi i mëkatit dhe i porosisë së Perëndisë.

Mbi gjykimet e Perëndisë dhe sesi duhet t'ia kemi frikën Zotit.

Si të mos jemi kundërshtues në çdo fjalë dhe sidomos si të jemi të ndërgjegjshëm dhe të veprojmë sipas dëshirës së Perëndisë.

Si çdo realizim duhet të kryhet sipas vendit dhe kohës së përshtatshme.

Mbi atë që nuk di dhe lë pas dore punët e tij, duke shpresuar në rezultatet e të tjerëve.

Mbi ata që mendojnë të kenë dobi nga bashkëjetesa, më të mirat e më të pëlqyerat dhe nuk e arrijnë.

Si duhet të sillesh në kohën e tashme.

Mbi mënyrën dhe sjelljen e atyre që kanë studiuar porositë e Perëndisë.

Mbi ata që pengojnë dhe ata që pengohen në porosinë e Perëndisë.

Mbi pagëzimin; ç'është arsyeja dhe fuqia e pagëzimit.

Mbi kungimin e trupit dhe të gjakut të Krishtit dhe ç'kuptim kanë këto.

Si bëhet i butë e i mirë njeriu para Perëndisë dhe për çfarë shkakut digjet ose prej çfarë gjëje largohet nga Zoti; gjithashtu me se afrohet.

Mbi të mundurit dhe mbi ata që nuk duhet të merren me mëkatet e atyre.

Mbi gënjeshtren dhe mbi të vërtetën.

Mbi fjalën e ngathët dhe fjalët e rëndësishme të ekonomisë (së shpëtimit).

Para se të veprojmë a të flasim duhet të mbështetemi në dëshmitë e shkrimit të shenjtë dhe pastaj në ato të zakonit.

Si të mbërrihet, sipas fuqisë, për t'i ngjarë Perëndisë dhe shenjtorëve.

Mbi atë që është për t'u kritikuar tek burrat e mirë dhe tek të kundërtit.

Me çfarë mënyre do të vërtetohemi mbi mjeshtërinë, zanatin.

Mbi vlerësimin e mallkimeve të Perëndisë.

Mbi detyrat (borxhet) dhe mbi shtimin ose larjen e tyre.

Mbi ata që bëjnë skandal dhe mbi ata që kanë pësuar skandalin.

Mbi çka duhet të veprojmë njeriu, që brenda mundësisë dhe formës më të mirë të pajisë (me të njëjtat vlera) dhe të tjerët.

Mbi ata që merren me punë të kota.

Mbi nderimin e të shenjtave dhe mirëvendosjen e tyre.

Mbi kënaqjen sipas mundësisë me të paktat.

Si duhet me prituri mirë.

Mbi qëndrueshmërinë në skandalet.

Mbi largimin e të këqijave dhe mbrojtjen e të dobtëve, të sëmurëve.

Mbi sa janë thënë për përmbushjen e ligjeve (profecive).

Mbi ndryshimin e porosive të ligjit dhe të ungjillit.

Sa është e lehtë barra e Zotit, kurse sa e rëndë ajo e mëkatit.

Mbi njëllojshmërinë (barazinë) dhe përlësinë.

Mbi pasjen kujdes të realizimeve të të mëdhenjve dhe të të vegjëlve.

Mbi pasurinë dhe vobektësinë dhe ç'vazhdon pas tyre.

Mbi bamirësinë dhe punën.

Mbi të gjykuarin dhe mbi atë që gjykon veten ose tjetrin.

Mbi paqen dhe mbi bërjen e paqes.

Mbi të ardhurit keq për mëkatarët dhe si duhen pritur; kur duhet t'i largojmë dhe kur duhet t'i afrojmë.

Mbi të gjykuarit dhe mbi të dalluarit.

Mbi faljen (lutjen): kur, përse, si dhe për çfarë duhet bërë lutja e falenderimit.

Mbi realizimet dhe mbi ngritjen (e duarve).

Mbi arritjen e dhuratave të Perëndisë dhe mbi transmetimin e tyre.

Mbi nderin dhe lavdinë e njerëzve.

Mbi ndryshimet e dhuratave të Perëndisë dhe harmonizimi ndërmjet atyre që i kanë dhe atyre që i shpërdorojnë.

Mbi ngasjet dhe kur duhet të tërhiqemi, si duhet t'u bëjmë ballë.

Mbi frikën dhe guximin në rrethana të ndryshme.

Mbi gëzimin dhe mbi ata që pësojnë për Krishtin.

Si duhet me u lutur për një qëllim.

Mbi ata që braktisin, mbi ata që përpiqen për shprestari dhe mbi ata që bashkëluftojnë me ata.

Mbi ata që vdesin të hidhëruar.

Mbi ndryshimin e shekullit të tanishëm dhe të ardhshmit.

Mbi ato gjëra që në përgjithësi ose në përafërsi janë të ndaluara nga shkrimet e shenjta dhe mbi ato që pranohen.

Mbi ata që përdorin predikimin e ungjillit.

Deshifrimi i listës me përmbajtjen e temave të kodikut në fjalë ka pasë shumë vështirësi për arsye të ndërtimit të fjalive sipas frymës së kohës kur ai është konceptuar. Me gjithë këto vështirësi, dëshifrimi i tyre u krye, në disa raste dhe me ndihmën e ndonjë specialisti që ka njohuri në greqishten e vjetër, si dhe me ndihmën e shumë fjalorëve greqisht-frëngjisht, greqisht-italisht dhe greqisht-greqisht. Nga kjo punë e mundimshme mendoj se është arritur mjaft. Titulli i pjesës me numër 50 e ndonjë tjetër mbetën pa u deshifruar.

Kodikun në fjalë, në saje të paleografisë së tipit të vonë, mund t'ia atribuojmë kohës prej dekadave të fundit të shekullit të 13-të deri në gjysmën e shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 40-TË, I BERATIT**

(ÇËSHTJE MURGJËRIE DHE TË NDRYSHME)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 25 x 17.5 cm.

Sasia e fletëve: 122.

Grafia: E tipit të vonë, shkruar në një kolonë, në ngjyrë të errët, me 33-34 rreshta për kolonë.

Kapakët: Të vënë nga restoratorët e AQSH.

Dëmtimet: Kodiku nuk i ka as fletët fillestare, as ato të fundit. Fleta 1, në të dy faqet, ka vende me tekst të fshirë; kjo vazhdon dhe në fletën 6 verso, 7 recto, 9 recto, në fletën 10 verso, në fletën 14 verso. Fleta 38 është e palexueshme në mjaft rreshta. Fleta 45 verso, si dhe fleta 117 sipër në të katër rreshtat e para janë brejtur në disa pjesë të pergamenës, duke dëmtuar leximin. Fleta 122, që është e fundit, në disa vende është brejtur nga pak, kurse faqja verso ka mjaft fjalë të zhdukura nga fshirja.

Fletët e këtij kodiku janë prej pergamene të dobët dhe me pjesë të prera si anash dhe në mes të shumë fletëve. Këto prerje mund të kenë ndodhur para se të shkruhet teksti. Gjithashtu nuk ka asnjë stolisje.

Tituj të lëndës së kodikut:

Fleta 1-16: Pjesë pa titull.

Fleta 19-21: Mbi dy gra.  
 Fleta 21-22: Mbi Serapionin.  
 Fleta 22-41 verso: Fillimi i tregimeve.  
 Fleta 41 verso-43: Mbi rrënimin e Jeruzalemit.  
 Fleta 43-44: Mbi Paladiun.  
 Fleta 44-45-verso: Mbi Eulogun.  
 Fleta 45-48-verso: Mbi Visarionin.  
 Fleta 48 verso-49: Mbi vëllain që ka rënë dhe është mundur.  
 Fleta 49 verso-50 recto-55 recto: Sipas të lumturit Dhosithe, që u bë së pari nxënës i Doriteut.  
 Fleta 55-64: Logos i atit tonë Dhorotheut, mbi ndarjen në shkallë të ndryshme ose mbi mohimin.  
 Fleta 64: Isidor Pilusioti mbi paracaktimin.  
 Fleta 64-66: Kufijtë, caqet e peshkopit trashëgues.  
 Fleta 66-68: Mbi dorëzimin e mbretërisë.  
 Fleta 68-69 recto: Mbi çështje të rrëfimit.  
 Fleta 69 recto-70 verso: Mbi të filluarit e shkrimeve të shenjta.  
 Fleta 70-72 recto: Cilat janë metodat e të ligut.  
 Fleta 72-73 verso: Mbi qetësinë.  
 Fleta 73-75: Mbi pasionin që të arrish lavdi të kotë.  
 Fleta 75-77: Logos këshillues.  
 Fleta 77-82: Mbi ata që kanë rënë për shkak pakujdesie ose mëkati.  
 Fleta 82-109: Logos asketik, pyetje e përgjigje atit tonë Maksim.  
 Fletët 109-111: Mbi një grua në një ujdhesë bashkë me djalin e saj.  
 Fletët 111-115: Mbi dy vëllezër fshatarë.  
 Fletët 116 verso 119: Titull me shkurtime, fraza të palexueshme.  
 Fletët 119-122: Mbi murgun që gjendej në një ujdhesë, të cilit i erdhi mysafir një saraçen me emrin Abraham (Avraam).  
 Fleta 122: Titulli bën fjalë për një Mario, por nuk lexohet dot.  
 Duke u mbështetur në grafinë e tipit të vonë, kodiku në fjalë duhet t'i atribuohet kohës nga fundi i shekullit të 13-të deri në gjysmën e parë të shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 41-TË, I BERATIT**

(MARTIROLOGJI DHE JETË SHENJTORËSH)

Materiali: Letër e trashë, shumë artizanale.

Përmasat: 30 x 20 cm.

Sasia e fletëve: 152.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, ngjyrë kafe të errët, kurse inicialet janë të pikturuara në forma figurash të ndryshme.

Dëmtimet: Tri fletët e para janë dëmtuar shumë. Fleta 4 është grisur në mënyrë vertikale, duke i lënë rreshtat e dy faqeve në fragmente, kështu që kësaj flete nuk mund t'i nxirret përmbajtja. Prej fletës 3 deri në fletën 18 letra është dëmtuar në cepin e poshtëm, duke mos e prekur tekstin. Shumë fletë të kodikut janë shqitur nga lidhja. Lidhja e fletëve të kodikut është shumë e dobët. Ndërmjet fletëve 37 e 38 është grisur një fletë dhe është marrë. Gjithashtu dhe fleta 41 është grisur e është marrë. Fletët e para dhe fletët e fundit të kodikut nuk ruhen.

Këto dorëshkrime, të tipit „martirolog“ (gr.), kanë një rëndësi të veçantë sepse u përkasin qendrave kishtarë shqiptare ku janë gjetur. Ato tregojnë ndikime të jetës së kishës nga qendrat



kishtare nga ka ardhur „martirologu“ (dorëshkrimi).

Martirologu në fjalë, duke pasur karakter Perëndimor, që bie në sy në figurat në miniaturë, na bën të supozojmë që duhet të jetë porositur prej princit shqiptar Karl Topisë, i cili ishte katolik, ose duhet të jetë porositur prej princërve Balshaj, të cilët kishin nën vartësinë e tyre në atë kohë dhe Beratin.

Përveç këtyre, ky kodik pajiset me shumë miniatura. Ka 13 figura, 7 gjysmëfigura, 30 portrete, 11 kafshë, 12 shpezë, të gjitha këto në miniaturë. Shumica e tyre janë përdorur si iniciale (paraprirëse të tekstit). Secila prej tyre përfytyron shenjtin për të cilin flitet në kodik, ose për të cilin është dhënë jetëshkrimi i tij. Disa prej tyre përfytyrojnë mënyrën e martirizimit të figurës, duke u djegur në zjarr me kokë të prerë, duke u torturuar i lidhur etj.

Miniatura e këtij kodiku ndryshon nga miniaturat e kodikëve të tjerë të vendit tonë, shkruar prej njerëzve tanë, për karakterin e saj Perëndimor. Vetëm në këtë kodik hasim miniatura jierarkësh me veshje jierakike të kishës romane, figura mbretërishe dhe portrete mbretërishe me kurora dhe veshje mbretërore Perëndimore.

Një tjetër karakteristikë e kësaj miniaturë qëndron në mënyrën e trajtimit të saj. Figurat janë vizatuar të thjeshta. Forma, plastika dhe lëvizjet realizohen vetëm me anë të linjës, pikturuar këto me akualet, me dy ngjyra, kafe e të kuqe, disa nga të cilat janë arrirë me mjaft art.

Më të mirat janë të një miniaturisti të sprovuar, si skicograf, të një niveli të lartë artistik për kohën kur ato janë realizuar. Këto janë pikturuar me një lehtësi prej artisti, pa sforcime, në disa raste dhe me pozicione natyrore.

Kjo miniaturë dëshmon që piktori i saj duhet të ketë qenë nga Perëndimi. Kjo duhet të ketë ndodhur në shekullin e 14-të, në kohën e sundimit të princit të dëgjuar shqiptar Karl Topisë, ose në kohën e princave Balshaj, që në këtë kohë sundonin dhe Beratin. Ka të ngjarë që kodiku të jetë porositur prej ndonjërit nga këta princa.

Pra, në bazë të grafisë dhe të miniaturës kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 42-TË, I BERATIT**

(MINEJ, KALENDAR MUJOR)

Materiali: letër e trashë.

Përmasat: 25 x 21.2 cm.

Sasia e fletëve: 200.

Teksti: Në njëshkolonë. Grafia - e tipit të vonë, në ngjyrë të zezë, por bukurshkrimore, me iniciale të mëdha në ngjyrë të kuqe.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me lëkurë, të stolitur me dekore, kryesisht vizuale të presuara, në kapakun e sipërm dhe në të poshtmin.

Kodiku përmban kalendarin për katër muaj: shtatorin, tetorin, nëntorin dhe dhjetorin.

Kodiku ruan vetëm dy vinjeta, e para në fletën 95 dhe e dyta në fletën 143. Të dyja janë në formë shiriti të gjatë, me zbukurime lineare të thjeshta. Format dhe ngjyrat, ndonëse të thjeshta, janë harmonizuar për ta bërë miniaturën mjaft të shikueshme, duke i paraqitur ato shumë të hirshme. E para ka më tepër elegancë, sepse mbi sfondin e kuq të shiritit kalon një linjë e trashë e bardhë, duke lëshuar në distancë të barabartë linja të kurbëta, të cilat nga sfondi lëshojnë tri linja të zeza, që ndahen njëra prej tjetrës prej dy ose tri pikash të zeza. Sfondi ose fusha e shiritit përkufizohet prej bordurave të verdha. Këto ngjyra të pakta të zeza mbi të bardhë dhe linjëza gjarpëruese e bardhë mbi sfondin e kuq i japin mjaft elegancë dekorit. Kurse vinjeta tjetër nuk ka elegancën e së parës.

Dëmtimet: Në fletën 189 është prerë pjesa e letrës nga sipër, afërsisht 5-6 cm, dhe është marrë bashkë me disa rreshta të tekstit. Fleta 190 është e bardhë, e pashkruar. Ana e sipërme

e fletëve ka pësuar pak dëm nga lagështia, si dhe anash. Edhe ky kodik, sipas kaligrafisë dhe duke u nisur prej letrës së trashë, duhet t'i atribuohet afërsisht kohës prej fundit të shekullit të 13-të deri në gjysmën e parë të shekullit të 14-të. Më saktësisht, jo më vonë se dy dekadat e para të këtij shekulli.

### **KODIKU I 43-TË, I BERATIT**

(MINEJ I MUAJIT MARS DHE JETË SHENJTORËSH)

Materiali: Letër.

Përmasat: 30 x 21 cm.

Sasia e fletëve: 117.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, me shkronja ngjyrë kafe të errët. Titujt janë me shkronja të kuqe, shkrimi është kaligrafik. Përmban tekstin kalendarik të 31 ditëve të marsit. Dekoracione nuk ka.

Kapakët: Prej dërrase të zhveshur nga ndonjë veshje lëkure ose stofi që duhet të ketë pasur përsipër. Dërrasat janë brejtur prej molës, sidomos ajo e poshtmja. Fleta e parë ka një të grisur, duke dëmtuar gjashtë rreshtat e sipërm, si dhe titullin. Ka dhe shumë vrima, të shkaktuara nga mola, duke prekur vende-vende tekstin. Fleta 31 ka një pjesë të grisur nga fundi i rreshtave, duke dëmtuar rreshtat 3-7. Fleta 32 është errësuar shumë nga lagështia dhe ndotur nga një lëndë si prej dylli. Fletët e kodikut janë errësuar shumë nga lagështia. Prej fletës 57 deri në fletën 88, ka më shumë errësim. Dy fletët e fundit kanë pësuar dëm edhe nga grisja, sidomos ajo e fundit, me numër 117.

Në bazë të grafisë artistike bukurshkrimore kodiku duhet t'i atribuohet me afërsi kohës nga fundi i shekullit të 13-të deri nga gjysma e shekullit të 14-të.

### **KODIKU I 44-T, I BERATIT**

(MINEJ I MUAJIT DHJETOR)

Materiali: Letër.

Përmasat: 38 x 19.4 cm.

Sasia e fletëve: 163.

Teksti: Në njëshkolonë.

Grafia: E tipit të vonë, shkrimi në ngjyrë të zezë, titujt dhe inicialet me të kuqe.

Përmban shërbesat e çdo dite të muajit dhjetor.

Stolisje: Nuk ka.

Dëmtimet: Ky është një nga ata kodikë që kanë pësuar shumë dëme.

Kapakët: Prej dërrase, por të brejtur nga mola, prandaj i janë vënë kapakë të rinj nga restauratorët e AQSH. Fletës 1 i është grisur gjysma dhe është marrë; gjysma tjetër ka shumë pjesë të brejtura nga insektet. Fleta 15 poshtë ka të grisur një copë letre, pa dëmtuar tekstin. Prej fletës 1 deri në fletën 26 një pjesë e madhe e rreshtave është errësuar nga lagështia, duke ruajtur lexueshmërinë e fjalëve. Prej fletës 27 deri në fletën 33 dorëshkrimi është dëmtuar, duke mbetur të lexueshme vetëm fragmente shkrimi. Fleta 43 është grisur në mënyrë të pjerrët. Prej fletës 44 deri në fletën 46 vazhdon një njollë e errët në një pjesë të tekstit. Ndërmjet fletës 46 dhe asaj 52 fletët kanë fare pak tekst fragmentar. Prej fletës 52 deri në fletën 58 vazhdon njolla e lagështirës, por duke u lehtësuar gradualisht fletë pas flete. Fletët 60-70 ruhen pa dëme, kurse fleta 71 ka pësuar një grisje të vogël pa dëm serioz. Fletët 72-74 janë grisur përgjysmë dhe pjesa e grisur është marrë. Nga këto ruhen vetëm 11 rreshtat

e poshtëm. Fletët 75-109 ruhen të pa dëmtuara. Fletët 112 dhe 113 kanë të grisur një pjesë poshtë, duke dëmtuar nga një fjalë në faqet recto e verso. Në fletët 118 verso, 119 verso, 120 recto e verso dhe 122 gjenden vizatime dekorative me motive zogjsh ose dekore vizuale të vona, pa asnjëfarë vlere, veçse kanë shëmtuar kodikun. Fleta e fundit, me numër 163, ka pak grisje pa dëme. Në disa fletë të fundit duar të vona kanë bërë pak zhgarravina me penë, që e shëmtojnë kodikun.

## **KODIKU I 45-TË, I BERATIT**

(MINEJ)

Materiali: Letër.

Përmasat: 39.5 x 35 cm.

Sasia e fletëve: 358.

Teksti: Në dy kolona.

Grafia: E tipit të vonë, shkrimi në ngjyrë kafe, nistoret kanë ngjyrë të kuqërremtë të çelët. Prej fletës 188 e në vijim grafia ka ngjyrë të gjelbër, deri në fund të faqes 358.

Kodiku përmban materialin kalendarik të shërbesave të tre muajve: të dhjetorit, janarit dhe të shkurtit.

Stolisjet: Kodiku ka një figurë (njerëzore) para një shpeze të stilizuar, fare e rëndomtë, në fletën 303. Fleta 329 ka një portret gruaje në formë skice, duke bekuar me të djathtë. Kodiku ka dhe gjashtë vinjeta, gjegjësisht në fletët 5, 62 recto, 79 verso, 108 recto, 215 recto dhe 336 verso, të gjitha pa ndonjë art.

Dëmtimet: Fleta 1 ka pësuar grisje në shumë vende. Fletët 2 deri 24 janë dëmtuar në cepin e sipërm, aty ku janë lidhur. Fleta 205 është grisur në pjesën e poshtme, pa cënuar tekstin. Fleta 116 ka një të grisur në mes të kolonës. Gati të gjitha fletët e kodikut kanë pësuar ngapak dëm nga lagështia.

Faqet e para të kodikut mungojnë.

Duke u mbështetur në grafinë e vonë dhe stilin e zbukurimeve artistike të kodikut, ky duhet t'i atribuohet afërsisht gjysmës së parë të shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 46-TË, I BERATIT**

(MINEJ)

Materiali: Letër.

Përmasat: 27 x 20.6 cm.

Sasia e fletëve: 164.

Fleta e parë përmban një parathënie të tekstit dhe është në njëshkollonë. Prej fletës 3 deri në fletën 15 teksti është prapë në njëshkollonë, kurse prej fletës 16 deri në fletën 164, që është fundi i kodikut, teksti është në dy kolona.

Përveç fletës së parë, që përmban hyrjen, prej fletës 3 deri në fletën 15 ka mbetur një pjesë teksti e muajit shkurt, pas tij fillon muaji i marsit dhe pas tij muaji i prillit. Teksti i këtyre muajve përmban poezi që lexohen sipas kalendarit, për çdo ditë të muajit përkatës.

Grafia nuk është e një dore. Shkrimi i parathënies nuk korrespondon me grafinë e tekstit në njëshkollonë. Nga ana tjetër, grafia e tekstit në njëshkollonë (pas hyrjes) nuk korrespondon me atë në dy kolona. Grafi estetike është ajo e 15 fletëve në njëshkollonë.

Kodiku nuk ka asnjë aplikim zbukurues, përveç shkrimit të tekstit të 15 fletëve, që ka vlerë artistike.

Dëmtimet: Kodiku i ka kapakët prej dërrase. Ai i sipërmi është brejtur pak nga mola, e cila ka

dëmtuar ngapak edhe fletët e para, si dhe pjesën prej fletës 37 deri në fletën e fundit, me numër 164. Nga mola ose insektet kanë pësuar dëme edhe fletët 24-46. Fletët 3-24 janë dëmtuar nga lagështia, duke prekur dhe disa rreshta të tekstit.

Duke u mbështetur në grafinë e vonë të të tri stileve të ndryshëm të të shkruarit, mendojmë se kodiku duhet t'i atribuohet fundit të shekullit të 14-të ose shekullit të 15-të, gjysmës së parë të këtij shekulli.

### **KODIKU I 47-TË, I BERATIT**

(PENDIKOSTAR - LIBËR I PESËDHJETORES)

Materiali: Letër.

Përmasat: 21.8 x 14 cm.

Sasia e fletëve: 363.

Grafia: Në ngjyrë kafe të çelët. Në fletët 362 e 363, ndonëse kanë mbetur gjysmëfletë, për shkak të dëmtimit, mund të lexohet titulli i tekstit: "Mbi ngalljen e Llazarit", punë e kryepeshkopit të Ikonisë (Konya, qytet i Azisë së Vogël).

Ky kodik, duke qenë shumë i dëmtuar nga lagështia, është e vështirë të përcaktohet tipologjikisht, pasi nuk mund të konstatohet mirë përmbajtja e tij. Nga fragmente që janë të lexueshëm rezulton se kodiku është libër kishe i llojit pendikostar ("libri i shërbesave të pesëdhjetores", 50 ditëve pas Pashkës). Ky libër përmban lutje në poezi, që përdoren prej së Dielës së Pashkës deri në ditën e pesëdhjetores. Kjo përputhet me fjalën „pentikoçaris”, që është shkruar në faqen verso të kornizës. Aty është shkruar dhe fjala "apostolos" (apostull), por nuk mund të konstatohet ndonjë figurë apostulli, nga dëmet e lagështisë.

Dëmtimet: Kodiku në fjalë është dëmtuar nga lagështia aq shumë, saqë nuk mund të nxirret përmbajtja. Kam bindjen se, po të restaurohet, është e mundur që teksti ekzistues të bëhet i lexueshëm.

Sipas fragmenteve të grafisë së ruajtur, mendojmë që kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 14-të.

### **KODIKU I 48-TË, I BERATIT**

(MINEJ SINOPTIK, TRIODH DHE LUTJE KULTI)

Materiali: Letër.

Përmasat: 21 x 15.2 cm.

Sasia e fletëve: Nga ky kodik janë ruajtur vetëm 99 fletë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët.

Kodik përmban përkujtime gati për gjithë shenjtoret, duke i cilësuar: martirë, oshënarë ose etër, për çdo ditë të 12 muajve të vitit, duke përmendur dhe festat e mëdha të vitit të krishterë.

Duke qenë se kisha kishte si fillim të vitit 1 shtatorin, renditja e shenjtoreve dhe e shërbesave përkatëse fillon me shtatorin. Këtu po vemë numrin e fletëve, në cilat fletë fillon e mbaron çdo muaj, si pason:

Shtatori fillon me datën 18 të muajit dhe mbaron me datën 26 të muajit, duke u përshkruar në fletët 1 dhe 2. Fletët që kanë pasur ditët e para dhe të fundit të muajit janë zhdukur.

Tetori fillon me datën 20 të muajit dhe mbaron në datën 31, duke u përshkruar prej fletës 3 recto deri në fletën 5 recto.

Nëntori fillon në fletën 5, me ditën 1 të muajit dhe mbaron në fletën 9 verso, me datën 30 të

muajit.

Dhjetori fillon në fletën 9 verso, me ditën 1 të muajit, deri më 31 dhe mbaron në fletën 15 verso.

Janari fillon me datën 1, fleta 15 verso, dhe mbaron me datën 31, në fletën 20 recto.

Shkurti fillon me datën 1, fleta 20 verso, dhe mbaron në fletën 25 recto, me datën 29.

Marsi fillon në fletën 25 verso, me datën 1, dhe vazhdon deri me datën 6 të muajit. Këtu ka ndërprerje, marsi rifillon me datën 9 dhe vazhdon deri me datën 13, rifillon me datën 20 dhe vazhdon deri më datën 25. Ky muaj mbaron me datën 26.

Prilli fillon me datën 1 të muajit në fletën 26 recto dhe vazhdon deri me datën 11 të muajit, po në fletën 26 recto. Rifillon me datat 22, 23, 25, 26, ndërpritet dhe mbyllet me datën 30, në fletën 27 verso.

Maji fillon me datën 1, fleta 27 verso, dhe mbaron me datën 31, fleta 32 recto.

Qershori fillon me datën 1, fleta 32 verso dhe mbaron me datën 30 të muajit, fleta 37 verso.

Korriku fillon me datën 1 në fletën 37 verso dhe mbaron me datën 30 në fletën 42 recto.

Gushti fillon me datën 1 në fletën 42 verso dhe mbaron në datën 31 në fletën 47 verso.

Pas minejit sinoptik fillon libri i triodhit, poezitë për të dielat, me këtë renditje:

E Diela e Publikanit dhe Fariseut, fleta 47 verso.

E Diela e Djalit Plagprishës, fleta 48 recto.

E Diela e të Lidhurave, fleta 48 recto.

E Diela e quajtur e Bardhë, fleta 48 verso.

E Diela e Djathit, fleta 48 verso.

E Diela e Ortodoksisë, fleta 49 recto.

E Diela e dytë e Kreshmëve, fleta 49 recto.

E Diela e tretë e Kreshmëve, fleta 49 verso.

E Diela e Kryqit, fleta 49 verso.

E Diela e katërt e Kreshmëve, fleta 50 recto.

E Diela e pestë e Kreshmëve, fleta 50 recto.

E Shtuna e Lazarit, fleta 50 verso.

E Diela e Dafinës, fleta 50 verso.

Java e Madhe, fleta 50 verso.

E Diela e Pashkës, fleta 51 verso.

E Diela e Thomait, fleta 51 verso.

E Diela e Mirëprurësve, fleta 51 verso.

E Diela e Ulokut, fleta 51 verso.

E Diela e Samaritanes, fleta 52 recto.

E Diela e të Verbërit, fleta 52 recto.

E Diela e Etërve të Shenjtë, fleta 53.

Pendikostia (pesëdhjetorja), fleta 53.

E Diela e Gjithë Shenjtorëve, fleta 53.

Prej fletës 53 verso deri në fletën 87 dorëshkrimi ka poezi që mund të përdoren në të gjitha festat e vitit.

Prej fletës 88 deri në fletën 91 verso, në një pjesë pa titull, me sa duket ka porosi për murgjit.

Prej fletës 92 dorëshkrimi ka porosi për murgjit. Kjo vazhdon deri në fletën 99, e cila është e fundit. Prej këtu ky tekst është ndërprerë.

**KODIKU I 49-TË, I BERATIT**

(TRAJTESA TEOLOGJIKE, NGA VEPRAT E GRIGORIT TË NISIT, SHKRUAR NË SHEKULLIN E 4-T TË ERËS SË RE)

Materiali: Letër e hollë dhe me shkëlqim.

Përmasat: 36 x 17.3 cm.

Sasia e fletëve: 216.

Grafia: E tipit të vonë.

Shkrimi: Në ngjyrë kafe të çelët. Tekstet i mungon fillimi dhe mbarimi, që do të thotë se i janë hequr fletë nga fillimi dhe nga fundi. Kodiku nuk ka titull dhe as përmbajtje apo pasqyrë të titujve të çështjeve që trajtohen.

Fleta 26 në të dyja anët ka një shkrim prej pene të trashë me shkronja më të mëdha e ngjyrë të errët. Po ky shkrim haset në fletën 32 verso, si dhe në ndonjë fletë tjetër. Dy faqet e fletës së fundme janë me shkronja më të mëdha e të trasha, si dhe faqja verso e fletës 115, kurse faqja recto e kësaj flete është e pashkruar.

Dëmtimet: Katër fletët e para janë brejtur shumë nga mola, duke dëmtuar tekstin. Fleta e fundit është ngrënë shumë nga insektet.

Në disa faqe ruhen shënime anësore që me dy–tre fjalë duan të tregojnë për çfarë flitet në atë vend, por këto janë të rralla e të pakta krahasimisht me sasinë e madhe të fletëve të tekstit.

Ja dhe disa prej tyre:

Në fletën 24 është shënimi anësor: Mbi shfaqjen e egërsisë së vërtetë.

Në fletën 132: Mbi zemërimin e faraonit.

Në fletën 133: Mbi yjet e pastër të virtytit.

Në fletën 135: Mbi prekjen e errësirës.

Në fletën 138: Mbi mënyrën e të ushqyerit të qengjit.

Në fletën 140: Përse thërret tek mua, përse më drejtohesh?

Në fletën 173 verso: Shenjtërimi, çlirimi, Pashka e kryehierarkut.

Në fletën 175: Ushqimi.

Në fletën 176: Themeli kryesor i shëndetit.

Në fletën 151: Mbi të shenjtin e të shenjtëve.

Në fletën 142 verso: Mbi rregullimet, sistemimet.

Në faqen verso të kapakut të vjetër të kodikut peshkopi Joasaf i Beratit ka dhënë një shënim me rëndësi si vijon: "Ky dorëshkrim përmban shkrime të Grigorit të Nisit, Joasafi i Beratit".

**KODIKU I 50-TË, I BERATIT**

(PSALTIR I DAVIDIT - LIBËR I PSALMEVE -)

Materiali: Letër

Përmasat: 20.5 x 13.5 cm.

Sasia e fletëve: 198, në letër.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë. Titujt dhe inicialet janë në ngjyrë të kuqe.

Datimi: Në faqen e parafundit, fleta 197 verso, ruhet data e riprodhimit të kodikut, viti 6919 (viti 1411 sipas kalendarit të ri).

Deri në fletën 185 recto, kodiku përmban 150 psalme të Davidit dhe ode të Asafit, (poezi, këngë) shkruar për raste (të kremte) të ndryshme.

Prej fletës 185 recto fillon një psalm i papërfshirë brenda këtyre 150 psalmeve të para. Ky përmban kujtimin e duelit që bëri Davidi me Goliatin. Pas këtij psalmi në faqen verso të fletës 185 fillon kënga e Moisiut, që gjendet në librin „Dalja“ („Ekzodos“). Në fletën 186 verso fillon kënga e Moisiut, që gjendet në librin „Ligja e dytë“ („Dhefteronomion“).

Në fletën 189 verso rreshtat e fundit fillojnë me fjalët: Lutja e Anës mëmës së Samuelit.

Në fletën 190 verso fillon kënga e profetit Arakum.

Në fletën 192 rekto fillon kënga e profetit Isaia.

Në fletën 192 verso fillon kënga e profetit Jona.

Në fletën 194 verso fillon kënga e etërve të shenjtë.

Në fletën 197, në gjysmën e faqes recto, fillon mbishkrimi që pason: “U shkrua dhe u përfundua ky psaltir me kontributin dhe shpenzimet e të nderuarit jeromonak dhe arkimandrit zotit Maksim dhe e vunë në manastirin e shenjtë të të perëndindëruarës të lavdëruar, zonjës sonë Hyjlindëse dhe gjithmonë virgjëreshë, Mari, në Vriazezis, ku dhe tani ... arkimandriti gjendet; ai atë e mori në dorëzim për këtë kishë të shenjtë të Perëndisë dhe për mësim të fëmijëve. (Ai) që e jep këtë jashtë kishës pastë kundërshtar të përmbishenjtën Hyjlindësen në këtë jetë dhe në të ardhmen. U shkrua me dorën time, të të përvuajturit Theodhorit, që u dha, sekretar i Beratit ... pranë zotit (kreut) Teodor Muzakës dhe (që) qëndron në kalanë në mes të Skraparit, i mbyllur me pranga që prej plot tri vjet. Dhe kushdo që ta lexojë këtë duhet të lutet dhe jo të mallkojë gabimet, sepse u shkrua në vuajtje të mëdha, dëshpërime (duke qenë) në gjendje të keqe, dhe të më kuptojë mua trifish të mjerin. Në vitin 6919 (1411)“.

## KODIKU I 51-TË, I BERATIT

(TRAJTESA TEOLOGJIKE, INSTRUKSIONE SHPIRTËRORE DHE MORALE TË EVRAIM SIRIANIT)

Materiali: Letër

Përmasat: 29 x 22 xm.

Sasia e fletëve: 300.

Grafia: E tipit të vonë, ngjyrë kafe të errët, me tekst në një kolonë.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë.

Autori i kopjimit: Jeromonak Simeoni i manastirit të ungjillizimit (Evangjelistra), në kalanë e Beratit.

Viti i riprodhimit: 1425.

Dëmtimet: Kodikut i kanë grisur 13 fletë në fillim, duke e lënë mjaft fragmentare lidhjen e vëllimit.

Në fund të librit janë dy fletë shtesë me përmasa të fletëve të kodikut, me grafi më të vogël dhe me tekst në dy kolona, që përmbajnë një shënim me shkrim të imët, ku gjendet titulli i dorëshkrimit, me shkronja të kuqe. Shënimi ka fjalët: “Kanonet e apostujve të shenjtë”.

Kodiku ka disa shënime, që po i japim këtu më poshtë:

Mbi kapakun prej dërrase, në faqen verso, ruhet ky mbishkrim: “Njoftim. Ky dorëshkrim përmban instruksione shpirtërore dhe morale të ndryshme, të atit tonë Evraim (Sirianit)”. Kjo vepër është shkruar në shekullin e 4-t të erës sonë. Mbishkrimin e shkruan Joasafi, peshkop i Beratit, më 1877.

Në fletën 298 ruhen dy mbishkrime. I pari thotë: “... libër është i së mbishenjtës Hyjlindëses së ungjillizimit (evangjelistës) dhe kushdo që ta dëmtojë pastë mallkimin e etërve perëndidashës”. Ky mbishkrim është shkruar nga kopjuesi i librit. Kjo rezulton nga mbishkrimi tjetër, që gjendet po në këtë faqe, dhe kumton si pason: “Unë jeromonak Simeoni e shkrojta këtë libër të Evraim (Sirianit). Kushdo që ta ketë këtë libër, që është në manastirin e Vangjelistrës (ungjillizimit), pastë mallkimin e 318 etërve të dhënë tek Perëndia si edhe mallkimin e të gjithë shenjtorëve...”. „Kushdo që ta ketë“ këtu ka kuptimin brenda manastirit, kurse mallkimi u takon atyre që e nxjerrin jashtë.

Disa tituj rreth përmbajtjes së kodikut:

Në fletën 32: Mbi ndërrimin e vendit (lëvizjen prej njërit vend në tjetrin).

Fleta 41: Mbi përlësinë.

Fleta 48: Mbi laviret.

Fleta 96: Mbi virgjinitetin dhe urtësinë.

Fleta 279: Mbi testamentin që u lë nxënësve të tij Evraimi.

Në këtë frymë trajtohen dhe çështjet e tjera të kodikut.

### **KODIKU I 52-TË, I BERATIT**

(MINEJ I JANARIT)

Materiali: Letër.

Përmasat: 28 x 21.5 cm.

Sasia e fletëve: 206.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë. Titujt e shënimit janë në ngjyrë të kuqe, si dhe inicialet.

Ky kodik përmban poezitë e shërbesës për çdo ditë të muajit janar. Këto poezi janë të lidhura me kultin.

Dy fletët e para dhe dy të fundit janë në pergamenë dhe nuk i përkasin këtij vëllimi. Nga grafia del se teksti i tyre nuk është shkruar prej së njëjtës dorë. Këto katër fletë duket se kanë mbetur nga një minej tjetër, më i vjetër, i zhdukur.

Ktitori (porositësi, pronari) i minejit është Leu, legjislator i qytetit të Beratit, siç rezulton nga mbishkrimi i fletës 204 verso, si pason: “U shkrua ky minej (mujor) me shpenzimet e të shumënderuarit Leu, legjislator i qytetit të Beratit, dhe e vuri në manastirin e Shën Mitër Mirablit të lavdëruar, të cilin e ndërtoi prej themeli në qytetin e Beratit, për shpëtimin e shpirtit të tij dhe për faljen e mëkateve, si dhe për kujtimin e prindërve të tij, që kanë kaluar më parë“. U shkrua në vitin 6937 (1429).

### **KODIKU I 53-TË, I BERATIT**

(KANONE - POEZI FETARE NË PROZË - QË LEXOHEN NË DITËT E FESTAVE GJATË VITIT NËPËR FALTORE)

Përmasat: 28 x 20 cm.

Sasia e fletëve: 343.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vjetër. Shënimit e poezive janë në ngjyrë të kuqe. Nga një fragment vinjete në fletën e parë mendojmë se pikërisht me të duhet të ketë filluar kodiku.

Dëmtimet: Katër fletët e para të kodikut janë grisur përgjysmë në drejtimin gjatësor, kështu që fragmentet e tekstit të tyre nuk e japin kuptimin e plotë të poezisë. Prej fletës 5 deri në fletën 10 teksti është dëmtuar në pjesën e sipërme nga lagështia. Gjithashtu, prej fletës 16, teksti ka pësuar dëmtime në dy rreshtat e sipërm. Kurse fleta 21 ka një pjesë të grisur, që ka formën e një pyke, dhe që ka dëmtuar ngapak katër rreshta. Edhe në fletën 22 tre rreshtat e parë kanë pësuar dëmtim nga lagështia. Nga mesi kjo fletë ka pësuar një grisje të pjerrët nëpër tekst, por teksti ruhet dhe mund të lexohet. Fleta 57 ka pësuar një djegie të pjerrët dhe ka dëmtuar 19 rreshtat e fundit gati në mënyrë të plotë.

Fleta e parafundit, në faqen verso, ruan të njëjtin titullim dhe të njëjtin lloj poezie, por me shkronja krejt të zeza, kurse fleta e fundit është ngjitur në kapakun e poshtëm.

Kapakët: Janë veshur me lëkurë, e cila është brejtur nga insektet dhe lagështia.

Datimi: Duke u mbështetur në grafinë e tekstit, ky kodik duhet t'i atribuohet gjysmës së parë të shekullit të 15-të.



## **KODIKU I 54-T, I BERATIT**

(MINEJ I DHJETORIT)

Materiali: Letër.

Përmasat: 28 x 20.6 cm.

Sasia e fletëve: 181.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët. Shënimet dhe inicialet e vargjeve (stihëve) të këngëve (ode) janë në ngjyrë të kuqe në një kolonë. Dy fletët e fundit nuk janë të këtij kodiku; këto janë prej pergameni dhe në dy kolona, me grafi shumë më të imët nga ajo e tekstit të kodikut.

Dëmtimet: Ky kodik fletën fillestare dhe kapakun e sipërm nuk i ka. Duhet të kenë qenë prej dërrase dhe veshur me lëkurë, sikurse është kapaku i poshtëm. Arkivistët e kanë veshur me kapakë të rij. Prej fletës 1 deri në fletën 23 letra është dëmtuar pjesërisht në pjesën e sipërme nga lagështia. Prej fletës 170 deri në fletën 180 teksti i dorëshkrimit ka pësuar dëme nga lagështia, më tepër në gjashtë fletët e fundit. Dy fletët e fundit kanë mjaft vrima në tekst.

Mund të themi se kodiku përmban emrat e shenjtorëve që përkujtohen në çdo ditë të dhjetorit. Sidomos me hollësi përmban tekstin kushtuar festave të mëdha të këtij muaji deri të dielën pas Krishtlindjeve.

Datimi: Duke u mbështetur në grafinë e tipit të vonë dhe duke e krahasuar me të tjerë, ky kodik duhet t'u atribuohet dekadave të para të shekullit të 15-të.

## **KODIKU I 55-TË, I BERATIT**

(MINEJ)

Materiali: Letër.

Përmasat: 28 x 20.5 cm.

Sasia e fletëve: 231.

Teksti: I shkruar në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët. Titujt janë në kafe të çelët.

Ky vëllim përmban tekstet përkatëse të minejit të muajit shtator, tetor, nëntor, dhjetor, janar, shkurt. Për muajin shkurt ruhen vetëm fletët që kanë tekstin deri në datën 10 dhe një gjysmë faqe të datës 11, të tjerat janë zhdukur.

Për përmbajtjen e kodikut po vëmë në dukje faktin që emrat e martirëve ose shenjtorëve nuk korrespondojnë me ata të botuar në sinekdhinos, të paralajmëruar në përmbajtje dhe as me datat e ditëve të festimit të tyre, as me emrat. Me sa duket, listën dhe ditët e festimit të çdo shenjti i kanë marrë nga qendra kishtare jovendëse, siç ka qenë Jeruzalemi, Antiokia, Roma, Aleksandria, Efesi etj. Këto qendra i përmendim për arsye se një skedim i këtyre minejve ose i martirologëve tregon ndikimet që kanë ardhur në kishën tonë.

Stolisjet: Ky kodik stoliset me shumë inicialet të pikturuara me motive të ndryshme. Këtu vërejmë, përveç atyre me linja dhe motive teratologjike, siç quhen në këtë gjini të artit kishtar, këto me madhësi të vogël dhe afërsisht mesatare. Ka edhe pak vinjeta me linja në formë shiriti horizontal, jo me vlerë të madhe artistike. Vetëm njëra mund të veçohet, në faqen verso të fletës 31, që flet mbi titullin e muajit tetor, me motivin e rrathëve, që shkelin e shkelen prej rrathësh të tjerë, por e lënë përgjysmë.

Dëmtimet: Ky kodik ka pësuar shumë dëme. Prej fletës 1 deri në fletën 9 kodiku ka pësuar, sipër, grisje. Në fletët e para ka pësuar dëme edhe teksti. Disa nga këto fletë janë zbehur nga lagështia, ndaj teksti nuk mund të lexohet. Ndërmjet fletës 9 e fletës 10 është grisur një fletë

dhe është zhdukur. Fleta 10 ka një të prerë vertikalisht dhe pjesa e prerë është marrë, me sa duket për inicialin e pikturuar. Fletët kanë pësuar dëme nga lagështia deri në fletën 31 verso, ku fillon muaji tetor.

Tetori ruhet në pak fletë, me sa duket pa radhë kronologjike.

Shtatori nuk ka radhë në renditjen e shenjtoreve. Prej muajit tetor deri në janar, duke e përfshirë edhe këtë, minejt kanë radhitje kronologjike të plotë.

Prej fletës 40 deri në fletën 42 ka një ndërprerje, sepse mungon fleta 41, e cila është vënë ndërmjet fletëve 152-153.

Muaji shkurt gjendet prej faqes verso të fletës 221, deri në fletën 231. Një pjesë e tekstit është zhdukur. Mund të jetë ngjitur në fillim të këtij kodiku.

E meta e këtij kodiku qëndron në mungesën e datës e të muajit dhe (mos)përmendjen e emrit të çdo shenjtë. Po të ishte ndryshe, mund të konstatoheshin cilat fletë mungojnë.

Prej fletës 221 deri në fletën 231 fletët kanë një të brejtur prej molës, në mënyrë gati të rruzullt, në pjesën e sipërme.

Datimi: Duke u mbështetur në grafinë e tij, kodiku duhet t'i atribuohet dekadave të para të shekullit të 15-të.

## **KODIKU I 56-TË, I BERATIT**

(MINEJ)

Materiali: letër.

Përmasat: 28 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 203.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët. Inicialet janë të mëdha e të stolisura, në ngjyrë të kuqerremtë.

Ky kodik, duke pasur fletë të zhdukura, mund të themi se përmban tekst për muajin prill, që fillon prej fletës 10 verso, më datë 11 që flet për Shën Antipën, dhe vazhdon deri në fund të muajit, që mbyllet me fletën 79 recto.

Në fletën 79 verso kodiku përmban një shkrim nga Evraim Siriani, me titullin: “Mbi punët e mira të tij dhe mbi pushimin e Perëndisë”. Ky shkrim shkon deri në fletën 80 verso. Kurse fleta 81 recto ka një shënim të Joasafit të Beratit, ku bekohen ata njerëz që e marrin këtë kodik dhe pasi e lexojnë e kthejnë në kishë, por ata që e marrin dhe e përvetësojnë kodikun Joasafi i mallkon me emrin e 318 etërve të koncililit të parë ekumenik: Marrçin sëmundjen e lebrës!

Prej fletës 81 verso fillon muaji i majit, me datën 1. Maji zë pjesën prej fletës 81 deri në fletën 203, dhe mbyllet me datën 26. Fletët e tjera janë zhdukur.

Dëmet: Prej fletës 1 deri në fletën 7 teksti nuk mund të përcaktohet se cilit muaj i përket. Këto në të shumtën e tekstit janë fshirë dhe ndotur shumë.

Datimi: Në bazë të grafisë edhe ky kodik duhet t'u përkasë dekadave të para të shekullit të 15-të. Duhet të jetë kopjim po i murgut Simeon të manastirit të Vangjelistrës, në kala të Beratit.

Kodiku i 7-të, i Vlorës; shek. XI.  
Mbulesë origjinale, ana e pasme;  
zbukurim në formë barelievi: skena  
e kryqëzimit të Krishtit.



Kodiku i 7-të, i Vlorës; shek. XI.  
Mbulesë origjinale, ana e pasme;  
zbukurim në formë barelievi, detaj:  
Krishti me kryqin.





133


Kodiku i 5-të, i Vlorës; shek. XI.  
Mbulesë origjinale, ana e  
përparme; zbukurime në formë  
barelievi të motiveve ungjillore.

1. Kodiku i 25-të, i Beratit; shek. XII-XIII; fl. 1 r. Vinjetë dhe nistore kapitale.

2. Kodiku i 31-të, i Beratit; shek. XIII; fl. 2 r. Shkrim me vlera kaligrafike.

3. Kodiku i 29-të, i Beratit; shek. XIII-XIV; fl. 212 r. Vinjetë në hyrje të tekstit të ungjillit sipas Gjonit. Nistore kapitale të zbukuruara në stilin e hershëm.

4. Kodiku i 89-të i Beratit; shek. XIV; fl. 30 r. Shkrim me vlera kaligrafike.




1



2



3



4





Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 17 r. Vinjetë, kryeshkronjë e zbukuruar dhe tekst me vlera kaligrafike.





Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 1 r. Vinjetë, shkrim kaligrafik minuscul me vlera estetike.




1. Kodiku i 41-të, i Beratit; shek. XIV; fl. 92 v. Shkrim i veçantë njëshkolonë, me zburkime të nistores kapitale dhe me figurën e një kleriku të lartë.

2. Kodiku i 47-të, i Beratit; shek. XIV; fl. 268 v. Kryeshkronjë me zburkime ekstravagante.

3. Kodiku i 44-t, i Beratit; shek. XIV-XV; fl. 26 v. Fletë e dëmtuar.


4. Kodiku i 42-të, i Beratit; shek. XIII-XIV; fl. 1 r. Vinjetë që paraprin fillimin e një ungjilli, fletë e dëmtuar.




1




2



3





4





1. Kodiku i 42-të, i Beratit; shek. XIII-XIV; fl. 95 r. Vinjetë dhe tekst i dëmtuar.

2. Kodiku i 45-të, i Beratit; shek. XIV; fl. 108 r. Vinjetë dhe bukurshkrim.



Kodiku i 83-të, i Shkodrës; shek. XIV; fl. 18 r - 19 v. Shkrim latin, që lidhet me emrin e shën Agustinit.

comodu n̄ ē p̄mittēndū gub. 2. dū q̄s habent oporū b̄ q̄  
 ad eōd h̄oc b̄n̄ s̄t̄ p̄mittēndū ad corp̄ q̄ nec p̄ s̄t̄ m̄bū m̄  
 p̄ozalē q̄ue modicū q̄ q̄s̄lū. **Ec̄. 2. 2. 1. 8** **2. 2. 2. 1. 8**  
 p̄ctaculoſ domi q̄ p̄mittēndū p̄ctaculoſ ad q̄s̄lū b̄n̄  
 p̄ctur d̄n̄z ac̄tōn̄ v̄t̄. **Deuſuſm̄ m̄ozū q̄ p̄ctaculoſ ē p̄q̄**  
**id̄ q̄ p̄ct̄ veniō. D̄uſo.** **Deuſuſm̄ asp̄idū q̄ sanabile. 2. 2. 2. 1. 8**  
 ē q̄ uenitūz asp̄idū cōdit̄ dormit̄do i q̄ n̄ s̄t̄ doloſoz  
 m̄ōn̄. p̄t̄ q̄ l̄ d̄ c̄t̄opar̄n̄. q̄ nolet̄ m̄ōn̄ s̄t̄ doloſoz  
 b̄n̄ uenitūz asp̄idū q̄ dormit̄do m̄ōn̄ ē. **Q̄ic̄ ē p̄t̄ p̄m̄**  
**p̄q̄ d̄n̄z d̄imon̄ h̄ōi f̄ac̄ ip̄y dormit̄. Dormit̄ n̄ audir̄ n̄ m̄**  
**d̄er̄ n̄ ābulat̄. Q̄ic̄ d̄imon̄ p̄ aſp̄er̄ h̄ōi uſūz q̄ audir̄ corp̄**  
**q̄ p̄ct̄ ad ſalutē. s̄. uſūz ad corp̄ q̄ alia b̄n̄. Et̄ h̄ō p̄ q̄ s̄t̄**  
**dormit̄ m̄ōn̄ p̄ p̄t̄ dormit̄do i id̄ q̄ fac̄t̄ n̄ p̄t̄. Et̄ p̄t̄**  
**iudic̄. 2. 2. 2. 1. 8. D̄uſo. ad uſūz. Q̄ic̄ m̄ōn̄ dormit̄do n̄**  
**l̄ct̄ audir̄ n̄ s̄t̄. ca q̄ t̄m̄t̄ q̄t̄ id̄ nec̄t̄er̄ fac̄t̄ q̄**  
**p̄ct̄ d̄n̄ q̄ cōdit̄ s̄t̄ sp̄ialit̄ gub̄ p̄ct̄er̄. Et̄ si ſozt̄ ad**  
**cōt̄ fac̄t̄dū q̄ f̄ac̄ duo p̄m̄ q̄ neḡt̄ ſozt̄ q̄ n̄ nec̄t̄ ad**  
**ſalutē. q̄ p̄t̄ gub̄m̄ p̄t̄. **Am̄b̄l̄ ignozat̄ ignozabit̄. 2. 2. 2. 1. 8****  
**ē q̄ f̄ac̄ q̄ id̄ q̄ n̄ deb̄t̄ si n̄ t̄m̄t̄. Et̄ p̄t̄ p̄t̄ p̄t̄ d̄ uo**  
**n̄ō. asp̄idū q̄ dormit̄do h̄ōi iſt̄. habent̄ q̄ p̄ct̄ gub̄**  
**ſit̄ i ſozt̄. **habent̄ q̄ q̄ n̄ f̄ac̄ q̄ n̄ f̄ac̄ q̄ n̄ mult̄. Et̄****  
**id̄ ſit̄ iſt̄ p̄ct̄. **Sanct̄ q̄ n̄ h̄ō q̄ op̄m̄z****  
**ſit̄ p̄ct̄ d̄zozat̄ ad l̄om̄dūz sp̄ialit̄ m̄ ē q̄ ad h̄oc**  
**cōt̄ n̄ q̄t̄ aſp̄r̄abile ē. id̄ ad d̄n̄ v̄bent̄ q̄t̄ q̄ p̄t̄ ſal**  
**uare n̄t̄ n̄t̄. **Am̄b̄l̄ q̄t̄m̄t̄. **D̄m̄ca. 2. p̄t̄ p̄ct̄.******

**id̄ q̄ h̄ō ueloz ad audir̄dūz ē. 2. 2. 2. 1. 8. Et̄ d̄n̄ ſap̄it̄**  
**p̄t̄. 1. 9. V̄n̄ ē ſozt̄ n̄ ē b̄n̄. **Et̄ ē b̄n̄ n̄z n̄t̄ p̄t̄****  
**m̄ p̄ct̄ q̄ ē ſozt̄ m̄ozēdi q̄s̄t̄er̄ i d̄uob̄. s̄. i h̄oc q̄ ad̄**  
**l̄ozp̄m̄i n̄abillo q̄ d̄ō aſp̄m̄i. **It̄ud̄ uō q̄ ad̄ l̄ozp̄m̄i****  
**ē i nob̄z l̄ozp̄m̄i q̄ p̄ct̄ m̄ozēdi. s̄. q̄ n̄t̄m̄t̄. **M̄lud̄ n̄****  
**q̄ d̄ō aſp̄m̄i p̄t̄ n̄t̄ m̄ozēdi. q̄ h̄ōi q̄s̄t̄er̄ cōt̄**  
**b̄n̄ n̄z p̄ct̄m̄ p̄ct̄. **Ad̄ uſūz n̄t̄ corp̄ ſit̄ h̄ō n̄t̄ n̄z****  
**ſit̄ n̄t̄ q̄t̄ ca ſit̄ i uſūz l̄ozp̄m̄i d̄n̄ d̄t̄ q̄t̄ ca n̄t̄**  
**n̄t̄ d̄ō aſp̄m̄i q̄ p̄ct̄m̄i. **Et̄ q̄ n̄t̄ am̄abile q̄****  
**cōt̄i v̄t̄ am̄abile q̄ n̄ i m̄ōdūz cōt̄ i ca p̄t̄ q̄t̄**

traet a cūct̄ q̄ ad ymaginē d̄ factū cōt̄m̄ p̄ct̄m̄ cōt̄  
 ē p̄ p̄t̄ d̄ozt̄ ab̄ō i cōm̄m̄t̄bilē ad b̄ō cōm̄m̄t̄bilē q̄ d̄  
 q̄ cōt̄d̄ m̄ozēdi cōt̄d̄ n̄t̄a n̄t̄ i q̄ q̄s̄t̄er̄ cōt̄ n̄t̄  
 b̄n̄. **Et̄ n̄ ē ſozt̄ n̄t̄ p̄ q̄ iſt̄ q̄s̄t̄m̄ q̄ t̄m̄m̄ p̄ct̄m̄ p̄**  
**p̄ct̄m̄ cōt̄ ad̄ n̄t̄ n̄t̄ ſozt̄ ē p̄ct̄m̄z n̄t̄ d̄t̄. Et̄ id̄**  
**ſozt̄m̄ n̄t̄ ſalutē q̄s̄t̄er̄ i audir̄ n̄t̄ n̄t̄ d̄t̄. **Et̄ ē q̄ op̄****  
**poſt̄ h̄ō f̄ic̄ d̄n̄ id̄oz iudic̄ n̄t̄ d̄an̄p̄t̄er̄ f̄ic̄ cōt̄**  
**d̄m̄ n̄t̄oz d̄yā q̄ iudic̄ n̄t̄ ſalutē cōt̄m̄ n̄t̄oz**  
**2. 2. 2. 1. 8. Et̄ q̄ d̄ n̄t̄ d̄t̄ audir̄. **Et̄ ē lib̄t̄ audir̄ n̄t̄****  
**na d̄ n̄t̄ ſozt̄. Et̄ id̄ illi q̄ n̄ lib̄t̄ audir̄. **loḡ d̄ d̄n̄ q̄ d̄oz****  
**ſozt̄ ſit̄ oūdit̄ q̄t̄oz n̄t̄ d̄t̄. **Et̄ ē lib̄t̄ audir̄ d̄ d̄oz****  
**oūdit̄ ſit̄ cōt̄ auct̄ cōt̄m̄i auct̄. **Et̄ ad̄ p̄ct̄m̄z ſalutē****  
**oūdit̄ q̄ oūdit̄ ſit̄ cōt̄ auct̄ cōt̄m̄i p̄ct̄ d̄yā ſit̄ d̄**  
**cōt̄ n̄t̄ p̄p̄t̄. **Q̄ic̄ h̄ō oūdit̄. **D̄m̄ca iſt̄ n̄t̄ aſp̄******

**Et̄ p̄ct̄m̄z iudic̄ iudic̄ p̄t̄. **Et̄ ē p̄ct̄m̄z iudic̄****  
**n̄t̄ q̄ d̄iligēti agēdūz ignozat̄ cōt̄ ſim̄l̄ cōt̄ n̄t̄**  
**l̄ozn̄ p̄t̄. **Et̄ p̄ct̄m̄z q̄ h̄ō poſt̄ iudic̄ cōt̄m̄z****  
**iſt̄m̄ q̄ p̄ct̄m̄z b̄n̄t̄ q̄ ḡt̄ i f̄ic̄m̄. **Et̄ ē cōt̄ n̄t̄****  
**b̄n̄ h̄ōi. s̄. n̄t̄ v̄t̄ ſanct̄ q̄ h̄ōi f̄ic̄m̄ v̄t̄ d̄n̄z q̄t̄oz**  
**v̄t̄ d̄m̄t̄ q̄ h̄ōi. **Et̄ p̄ct̄m̄z ſit̄ m̄m̄oz b̄n̄. **Et̄ n̄t̄******  
**m̄oz b̄n̄ q̄ ſit̄ m̄m̄oz. **Et̄ q̄ uſūz ſit̄ h̄ōi n̄t̄ p̄ct̄****  
**cōt̄ b̄n̄ f̄ic̄m̄ max̄ iudic̄ q̄ p̄ct̄m̄z b̄n̄t̄ q̄ d̄ozp̄t̄**  
**d̄oz m̄ō q̄ d̄ozp̄t̄ iudic̄t̄ aliq̄ zoz p̄ct̄m̄z d̄m̄t̄ n̄t̄. **Et̄****  
**cōt̄ oūdit̄ ē i m̄ō l̄ozoz q̄t̄ uſūz ſit̄ i d̄p̄t̄oz l̄oz**  
**uſūz p̄ct̄ m̄m̄oz q̄ ſit̄ v̄t̄ p̄ d̄oz n̄t̄oz q̄t̄oz i d̄oz. **Et̄****  
**ad̄ d̄ozp̄t̄ q̄ n̄t̄ i q̄ d̄ozoz. **Et̄ q̄ uſūz ē i l̄ozoz****  
**d̄p̄t̄oz q̄t̄ uſūz i l̄ozoz m̄ō l̄ozoz l̄oz uſūz cōt̄ p̄ct̄**  
**m̄m̄oz m̄m̄oz q̄ ſit̄. **Et̄ p̄ct̄m̄z q̄ max̄ ſit̄ max̄ ſit̄****  
**n̄t̄ p̄ct̄ n̄t̄. **Et̄ p̄ct̄m̄z d̄p̄t̄oz ſozt̄ q̄ q̄ uſūz p̄ct̄****  
**d̄oz l̄oz. s̄. cōt̄ q̄ q̄ cōt̄ m̄ozoz. **Et̄ q̄t̄oz b̄n̄ ſoz****  
**t̄m̄ cōt̄ ſit̄ cōt̄m̄z q̄ cōt̄m̄z d̄oz h̄ab̄t̄. **Et̄ ſit̄****  
**l̄ozoz p̄ct̄m̄z m̄ōt̄ n̄t̄. **Et̄ n̄t̄ n̄t̄ m̄m̄oz q̄ ſit̄ d̄m̄****  
**uſūz cōt̄ ſit̄ p̄ct̄m̄z q̄t̄oz d̄oz h̄ab̄t̄ uſūz n̄t̄oz**  
**p̄ct̄ cōt̄ ſit̄ maḡ. **Et̄ q̄ d̄ozp̄t̄ q̄ p̄ct̄ h̄ōi cōt̄ ē q̄****



141

1. Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 12 r. Miniaturë.

2. Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 15 v. Miniaturë e thjeshtë me kryqin, shkurtesën e emrit të Krishtit dhe dekoracione.

3. Kodiku i 9-të, i Beratit; shek. XI; fl. 7 r. Vinjetë dhe bukurshkrim.



2





3

1

1. Kodiku i 70-të, i Beratit; shek. XVIII; fl. 30 r. Bukurshkrim me dekoracion në vendin e kryeshkronjës.

2. Kodiku i 68-të, i Beratit; shek. XVII; fl. 16 r. Zbukurim i veçantë me forma gjeometrike.






143

1. Kodiku i 70-të, i Beratit; shek. XVIII; fl. 2 r. Bukurshkrim.

2. Kodiku i 69-të, i Beratit; shek. XVIII; fl. 2-3. Bukurshkrim.

3. Kodiku i 68,-të i Beratit; shek. XVII; fl. 15 v. Bukurshkrim.




1

2

3

Kodiku i 66-të, i Beratit; shek. XVII; fl. 172r - 173v. Bukurshkrim dhe anëshkrime.







1



2



1

1. Kodiku i 67-të, i Beratit; shek. XVII-XVIII; fl. 6 r - 7 v. Zbukurime të thjeshta, vinjetë me forma gjarpëruese.

2. Kodiku i 68-të, i Beratit; shek. XVII; fl. 2 r. Kryeshkronja të zbukuruara.

Kodiku i 13-të, i Beratit; shek. XII-XIII. Mbulesë origjinale me zbukurime në metal. Deizis i madh.



## KODIKU I 57-TË, I BERATIT

(MINEJ)

Materiali: Letër e trashë.

Përmasat: 20.5 x 22 cm.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët, me tituj e inicialet të kuqe.

Kapakët: Prej dërrase të trashë dhe të brejtur shumë nga mola.

Kodiku ka poezi në prozë, të muajit mars, deri në faqen 77 recto, duke pasur të plota 31 ditët e muajit.

Muaji prill fillon me datën 1 të muajit, në faqen 77 verso, dhe përmban vetëm 15 ditë të muajit, dhe shkon deri në fletën 120.

Dy fletët e para të kodikut, si dhe dy të fundit (121 e 122), nuk janë të këtij dorëshkrimi. Këto janë shumë të dëmtuara nga grisja, nga mola dhe nga lagështia.

Kodiku ka pësuar shumë dëme, sidomos nga lagështia. Fletët 1 deri 4 janë nga më të dëmtuarat nga lagështia. Fleta e dytë ka dhe pak grisje në tekst. Prej fletës 117 deri në fletën 122 përsëritet dëmtimi nga lagështia. Buzët e fletëve në shumë vende janë të cfluara. Kodiku është veshur me kapakë të rij nga arkivistët.

Ky kodik nga grafia i përngjan tekstit të minejve të mëparshëm, ndonëse konstatojmë që nuk janë të një dore. Duke u mbështetur në grafinë e tij, kodiku duhet t'u atribuohet dekadave të para të shekullit të 15-të.

## KODIKU I 58-TË, I BERATIT

(LETËRSI PATROLOGJIKE - SHKRIME TË ETËRVE TË SHENJTË -)

Përmasat: 21.6 x 13.6 cm.

Sasia e fletëve: 132.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe.

Faqja 1 fillon me titullin "Jeta dhe veprimtaria e Shën Grigorit, kryepeshkopit të Kostandinopojës, Teologut. E shkruar nga Grigor prezviteri" (meshtari). Kjo shkon deri në fletën 31.

Prej fletës 32 nis artikulli i Grigorit, peshkopit të Mitilinit (Metilenës): "Logos (fjalim, ligjëratë) mbi zonjën tonë, Hyjlindësen, kur hyri në tempull prej prindërve të saj, në moshë trevjeçare" (prej fletës 32 deri në fletën 41 verso).

Prej fletës 41 verso: Nga ati ynë shenjt ndër shenjtorë Germanoi Omologjeti: "Logos mbi ungjillëzimin e zonjës sonë Hyjlindëses" (deri në fletën 61 verso).

Prej fletës 62 recto: Nga ati ynë Shën Vasil, kryepeshkop i Cesaresë dhe Kapadokias, "Logos mbi lindjen e Krishtit" (deri në fletën 76 recto).

Fletët 77-78 nuk i përkasin këtij kodiku, sepse nuk është e njëjtë as grafia e tekstit, as madhësia e fletës.

Fletët 79-94 recto: Nga Shën Gjon Gojarti (Chrysostomos), "Logos për Telonin dhe Fariseun".

Prej fletës 94: Nga Shën Gjon Gojarti, "Mbi kreshmën" (deri në fletën 95 verso). "Prapë mbi kreshmën", deri në fletën 107 verso.

Prej fletës 107: Logos i dobishëm për shpirtin. "Mbi ikonën e Krishtit në Kostandinopojë" (deri në fletën 115 recto).

Prej fletës 115 recto: Logos "Mbi kryqin e çmuar dhe jetëdhënësin Jezu Krisht", prej atit tonë Josif, kryepeshkop i Selanikut (përfundon në fletën 119).

Logos "Mbi kreshmën", e atit tonë Shën Gjon Gojartit, kryepeshkop i Kostandinopojës, fletët

119 verso deri në 123.

Fleta 123 verso: Logos nga Shën Gjon Gojarti, vijon deri në fletën 132, që është e fundit.

Dëmtimet: Ky kodik ka pësuar një dëm të rëndë prej fletës 110-132, që është brejtje e katër rreshtave të fundit prej molës. Prej fletës 1 deri 9 në pjesën e sipërme teksti është dëmtuar nga lagështia. Lagështia ka depërtuar dhe në disa fletë të tjera të kodikut, por duke mos dëmtuar tekstin.

Kodiku është shkruar në letër nga prezviter Grigori, që duhet të ketë qenë ndonjë klerik i Beratit.

Kodiku duhet t'u atribuohet dekadave të fundit të shekullit të 14-të, përfundim që e nxjerrim nga grafia.

## **KODIKU I 59-TË, I BERATIT**

(TRIODH)

Materiali: Letër

Përmasat: 28 x 22.

Sasia e fletëve: 268.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe të errët. Shënimet janë në ngjyrë të kuqe.

Kodiku përmban lutje, psalme e poezi të kreshmës së madhe. Ndër këto është dhe pjesa fillestare e poezisë në prozë të himnit akatist. Pjesët e tjera të këtij himni janë zhdukur. Gjithashtu dhe shumë pjesë të fillimit të triodhit janë zhdukur. Triodhi nuk ka as fillim, as mbarim. Pjesët që ruhen nuk cilësohen se për cilat të diela lexohen. Këtu shënohet numri i psalmit që lexohet, por nuk shënohet kur, në cilën të dielë ose në cilën ditë lexohet. Ka lutje të mbrëmjes e të mëngjesit që lexohen në kishë, por nuk cilësohet në cilën të dielë ose ditë lexohen. Nga përmbajtja e lutjeve kuptohet se ato janë të së Dielës së Kryqit, ose të së Premtes, të meshimit të së Dielës së Katërt. Duke mos pasur titujt e festës, nuk jepet të kuptohet sa fletë janë zhdukur në fillim dhe sa në mbarim.

Ruhet vetëm kapaku i fundit, i vjetër, i brejtur nga mola. Kapakët e rij janë veshur nga arkivistët. Në bazë të paleografisë së tekstit kodiku ka të ngjarë t'i atribuohet fillimit të shekullit të 15-të.

## **KODIKU I 60-TË, I BERATIT**

(NOMOKANON - RREGULLORE KISHTARE -)

Materiali: Letër.

Përmasat: 22.2 x 15.5 cm.

Sasia e fletëve: 238.

Autori kopjues i nomokanonit: Në lidhje me këtë ruhet një mbishkrim në fletën 237, si pason: "Ju që lexoni këtë nomokanon të Gjergjit, kujtojeni këtë që e kopjoi. Paça falje për disa gabime që kam bërë nga padia. U shkrua me shpenzimet e të shumëdevotshmit ndër meshatarë zotit Joan, bir i Gjergjit të hershëm. Muaji 6 gusht në vitin 1786".

Nga këto shënime ose mbishkrime nxjerrim këto të dhëna rreth nomokanonit në fjalë: Kopjuesi i nomokanonit është anagnost (i panjohuri) Gjergji dhe ktitori (porositësi) i tij është meshtar Joani (Gjoni), bir i një Gjergji të hershëm. Është kopjuar në gusht të vitit 1786.

Grafia: Është fare e vonë, e shekullit të 18-të. Formulimi gjuhësor është jo i mirë, gjë që tregon nivelin e ulët kulturor në përgjithësi të krahinës burimore të autorit, Vello, në kohën kur e shkroi, siç rezulton prej këtij nomokanoni.

Si dhe nomokanonet e tjera, afërsisht të kësaj periudhe, edhe ky thuajse ka të njëjtën përmbajtje, me pak diferencime të vogla. Kjo sepse nomokanonet konceptoheshin në bazë të kanoneve të vjetra, por jepen në gjuhën e vonë për t'u kuptuar më shumë nga ata që do ta lexojnë në atë periudhë.

Këtu më poshtë po vemë në dukje disa nga çështjet që përmban ky nomokanon:

Mbi gjykatësit, që duhet të jenë për të gjithë simpatikë; duke mos besuar fjalë pa i shqiptuar mirë, fleta 20 recto.

Mbi drejtësinë dhe si duhet vepruar me të drejtën, fleta 20 verso.

Mbi ata që duan të bëhen peshkopë, meshtarë ose dhiakonë dhe kur ndonjëri nga këta akuzohet, fleta 24.

Mbi klerikët dhe faljet e tyre të ndryshme dhe si gjykohen.

Mbi probleme të ndryshme klerikale.

Mbi çështje kalogjerike (të kallogjerëve); çështje murgjerie, fleta 76 verso deri në fletën 79 recto.

Nga detyrat e meshtarit: Nëse ndonjëri ka armiqësi dhe mban armiqësi të mos pranohen në kishë dhuratat e tij, as të mos i jepet kungimi, fleta 107 verso.

Me rastin e fejesës detyrat që kanë të fejuarit, fleta 110.

Mbi shkallët (e lidhjes në gjak) që lejojnë fejesën ose ndalojnë fejesën për ata që do të fejohen, fleta 114.

Shkallët (e trashëgimisë gjenetike) dhe fejesat, prej fletës 124 deri në fletën 136 verso. Vazhdon mbi martesat.

Mbi trashëgiminë e fëmijëve, fl. 168.

Mbi shkresën e çështjeve që duhet të njoftojë koncilin hierarkik, në të cilin nuk është thirrur (kleriku) e të tjera si këto që përmenden më sipër.

Kodiku ka nevojë për restaurim të kapakëve.

## **KODIKU I 61-TË, I BERATIT**

(OROLOG)

Materiali: Letër.

Përmasat: 22 x 14.7 cm.

Sasia e fletëve: 233.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe. Shënimet dhe inicialet janë në ngjyrë të kuqerremtë.

Por teksti ka një vlerë të theksuar kaligrafike (bukurshkrimore).

Gjendja e kodikut: Kapakun e sipërm, të vjetrin, nuk e ka. Fletët e para mungojnë. Fletët 9 e 10 kanë pësuar mjaft ngrënie nga mola, duke dëmtuar dhe tekstin. Edhe fletët e fundit dhe kapaku i poshtëm në pjesën e sipërme janë brejtur nga insektet, duke dëmtuar dhe lëkurën me të cilën është mbuluar. Ka shumë nevojë për restaurim. Ky kodik ka dhe mjaft fletë të ndotura.

Kodiku, si libër orolog, përmban lutje, që përdoren gjatë ditëve të javës në tempull.

Duke u mbështetur në grafinë e tij, kodiku nuk mund të jetë më i hershëm se shekulli i 16-të dhe i 17-të.

**KODIKU I 62-TË, I BERATIT**

(TYPKON - LIBËR LITURGJIE)

Materiali: Letër.

Përmasat: 15.7 x 11.7 cm.

Sasia e fletëve: 264.

Teksti: Në një kolonë.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë.

Grafia: E tipit të vonë.

Shkrimi: Në ngjyra kafe të errët, kurse shënimet dhe inicialet - të kuqe.

Kodiku është libër shërbese liturgjike, i njohur me emrin tipikon. Është një libër që përmban rregullore liturgjike, që tregon çfarë teksti prej leximeve dhe këndimeve duhet të përdoret në shërbimet e kultit për festat e mëdha, të vogla dhe për çdo ditë të rëndomtë të vitit. Kështu, ata që ishin meshtarë në kishë e përdornin këtë rregullore tipike si udhëzues për përgatitjet për çdo ditë të vitit. Tipikoni u shërbente për të ditur çfarë duhej të lexonin ose të këndonin.

Ky kodik ka pësuar shumë dëme:

Lëkura e kapakëve është grisur në anën e lidhjes së fashikujve.

Tri fletët e para janë brejtur nga mola.

Prej fletës 40 deri në fletën 63 ka brejtje nga mola në mënyrë vertikale.

Fleta 82 ka pësuar pak djegie në anën e poshtme, duke dëmtuar pak tre rreshta.

Në fletën 243 ka mbetur një fragment i vogël, fleta 244 është grisur, duke lënë vetëm disa shkronja fillestare të rreshtave; fleta 245 është ngrënë nga mola në mënyrë vertikale, duke e lënë faqen pa pjesën më të madhe të tekstit. Fleta 246 dhe ajo 247 janë brejtur nga mola, duke dëmtuar nga katër rreshta në anën e sipërme. Në fletët 249-252 ka mbetur vetëm një fragment me disa shkronja.

Fletët 253-267 janë brejtur nga mola në mënyrë vertikale, kurse në tri nga këto fletë, tri fletët e fundit, ruhen vetëm nga dy-tri shkronja.

Tipikoni ndahet sipas muajve të vitit, duke filluar me shtatorin.

Muaji shtator fillon në fletën 18 recto.

Muaji tetor fillon në fletën 34 verso.

Muaji nëntor fillon në fletën 40 verso.

Muaji dhjetor fillon në fletën 49 verso, tek fleta e grisur.

Muaji janar fillon në fletën 61 recto.

Muaji shkurt fillon në fletën 74 verso.

Muaji mars fillon në fletën 78 recto.

Muaji prill fillon në fletën 87 verso.

Muaji maj fillon në fletën 89 verso.

Muaji qershor fillon në fletën 92 recto.

Muaji korrik fillon në fletën 96 recto.

Muaji gusht nuk shquhet, sepse nuk është theksuar fillimi me shkronja të kuqe si në muajt e tjerë.

Në fletën 106 fillon triodhi me të Dielën e Publikanit dhe të Fariseut.

Edhe fillimi i librit të Pesëdhjetores nuk është cilësuar me shkronja të kuqe. Në fletën 182 fillon lista e festave të mëdha të çdo muaji, që vazhdon deri në fletën 185 recto.

Në fletën 185 janë disa shënime rreth librit të tipikonit, të shkruara nga murgu Mark. Në fletën 186 murgu Mark e cilëson veten "jeromonak Marku", që do të thotë se është dorëzuar dhe prift. Në tetë fletë janë dhënë udhëzime se si tipikoni ndihmon për përdorimin e teksteve liturgjike në festat fetare. Fleta 248 verso si dhe fleta 249, janë shkruar nga një dorë tjetër, gjë që konstatohet nga ndryshimi i grafisë. Fleta 249 është zbehur shumë.

Datimi: Në bazë të grafisë, kodiku duhet t'i atribuohet fundit të shekullit të 14-të dhe mund të shkojë deri në fillim të shekullit të 15-të.

## **KODIKU I 63-TË, I BERATIT**

(MINEJ I MUAJIT TETOR)

Përmasat: 21.3 x 14.2 cm.

Sasia e fletëve: 306.

Teksti: Në një kolonë dhe i shkruar në letër.

Grafia: E tipit të vonë. Titujt dhe shënimet janë në ngjyrë të kuqe, kurse teksti në ngjyrë kafe.

Kodiku përmban kalendarin e jetëve të shenjtorëve të 31 ditëve të tetorit, si dhe tekstin që përdoret në faltore për shenjtin e çdo dite.

Kodiku, duke pasur disa fletë të zhdukura, fillon me fragmente që i takojnë datës 2 të muajit, në fletën 3 të kodikut. Po në këtë fletë, faqja recto, fillon teksti i datës 3, që i përket Dionis Areopagjtit, dhe vazhdon me tekstet që u përkasin shenjtorëve në ditët e muajit që përmendëm dhe që festohen. Kjo vazhdon deri në datën 31 të tetorit.

Në fletën 306 recto ruhet një shënim më i vonë se teksti i kodikut, ku thuhet se librin minej të tetorit e bëri një prift, emri i të cilit është i palexueshëm. Gjithashtu edhe datimi nuk u dëshifrua dot.

Në këtë shënim fleta është prerë. Kjo na bën të supozojmë se mund të ketë pasur ndonjë shënim me emrin e riprodhuesit, si dhe datën kur e ka riprodhuar. Fatkeqësisht një dorë e vrazhdë (në tekst: “skandaloze”) e ka prerë dhe e ka marrë atë copë të fletës.

Kodiku ka disa fletë të shqitura nga vëllimi. Fleta 1 është dëmtuar nga grisja në pjesën e poshtme, kurse fleta 2 është errësuar shumë në tetë rreshtat e sipërm, duke zhdukur tekstin. Pjesët e tjera të kodikut ruhen në gjendje të mirë, me pak ndotje në dy-tri fletët e para fillestare dhe në ato të fundit.

Duke u mbështetur në grafinë e tekstin, ky kodik duhet t’i atribuohet fundit të shekullit të 15-të ose fillimit të shekullit të 16-të.

## **KODIKU I 64-T, I BERATIT**

(PSALMET E DAVIDIT)

Përmasat: 23.3 x 14 cm.

Sasia e fletëve: 134.

Grafia: E tipit të vonë.

Shkrimi: Në ngjyrë kafe, titujt me të kuqe.

Kodiku përmban psalmet dhe këngët e Davidit, si dhe disa ode të Asafit. Duke e krahasuar përmbajtjen e psalmeve dhe të odeve me botimin e Septuaginta-s (Dhjata e Vjetër, përkthim greqisht) të Alfred Rahlfsit, që konsiderohet botim kritik nga më të shquarit, kemi konstatuar se dorëshkrimi ynë korrespondon plotësisht me atë të Rahlfsit, përveç ndonjë rasti kur ndonjë shkronjë shumë rrallë është përdorur në mënyrë të gabuar. „Gabim“ tjetër i riprodhuesit është se kreun 116 e ka quajtur kreu 115. Gjithashtu në „himnin e tre djemve“ teksti vazhdon deri në vargun („stihun“): “Bekoni o meshtarë Zotin, ju shërbëtorët e Zotit”, kurse pjesa tjetër e himnit është zhdukur.

Dëmtimet: Ky kodik ka pësuar shumë dëme. Fleta 1 ka pësuar shumë dëme nga brejtja e molës. Fleta 2 ka më pak dëme. Fleta 8 ka pësuar grisje nga fundi, duke dëmtuar dhe tekstin. Të gjitha fletët, tek cepi i poshtëm, atje ku lidhet kodiku, kanë pësuar shumë dëme, por teksti në to pak është dëmtuar.

Letra e kodikut është shumë e dobët dhe ka nevojë urgjente për restaurim. Edhe lëkura e kapakëve është dëmtuar.

Vlera e këtij kodiku nuk është e vogël, se është kopjuar mirë, me ndonjë gabim fare të vogël. Në bazë të grafisë së vonë, kodiku duhet t'i atribuohet kohës prej shekullit të 15-të deri në shekullin e 16-të ose të 17-të.

### **KODIKU I 65-TË, I BERATIT**

(KANONE - POEZI NË PROZË - DHE TREGIME TË NDRYSHME)

Materiali: Letër.

Përmasat: 21 x 13.5 cm.

Sasia e fletëve: 323.

Prej fletës 1 deri në fletën 58 dorëshkrimi përmban kanone, poezi në prozë, ose prozë poetike, që lexohen gjatë festave në kishë. Këto vazhdojnë edhe prej fletës 59 deri në fletën 101. Më tej ka tekste të ndryshme.

Grafia: Ky kodik është shkruar prej duarsh të ndryshme dhe me grafi të ndryshme, disa në ngjyrë të zezë dhe disa në ngjyrë kafe.

Dëmet: Kodiku është nga ata që kanë pësuar shumë dëme. Fleta 1 ka pësuar grisje në mes, edhe fleta 13. Ndërmjet fletëve 55 dhe 56 është shkëputur një fletë. Prej fletëve 56-59 ka pak grisje në mes të tekstit. Prej fletës 57 teksti fillon të errësohet dhe ky errësim vazhdon deri në fletën 64, kurse prej fletës 64 deri në fletën 86, veç errësimit, ka dhe grisje. Errësimi dhe grisja vazhdojnë deri në fletën 101.

Në fletët 106-135 ka dëme fizike në pjesën e sipërme dhe në të poshtmen, gjë që ka bërë që nga teksti të kenë mbetur vetëm fragmente. Gjithashtu fletët 155-202 kanë pësuar shumë grisje në pjesën e sipërme. Prej fletës 202 e në vijim, nga lagështia, gjysma e tekstit në anën e sipërme është zhdukur e zbehur thuajse fare. Të gjitha grafitë e këtij kodiku tregojnë se dorëshkrimi duhet t'i atribuohet afërsisht fillimit të shekullit të 17-të.

### **KODIKU I 66-TË, I BERATIT**

(NOMOKANON -)

Përmasat: 20 x 14.7 cm.

Sasia e fletëve: 320.

Data e shkrimit: Në vitin 7121 (1613), më 15 dhjetor.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe, kurse titujt janë shkruar me të kuqe.

Ky kodik është rregullorë që përmban ligje dhe norma fetare morale, pak a shumë të njohura, sepse çdo peshkopatë duhej të kishte një nomokanon për administrimin fetaro-moral të besimtarëve (në tekst: „besnikëve“). Në këtë kodik nuk ka çështje me përmbajtje vetëm shoqërore; kështu që e gjithë përmbajtja e çështjeve që trajtohen është përshkruar në frymë moralo-fetare.

Ndonëse me një përmbajtje të tillë, po ekspozojmë mjaft çështje që trajtohen në të, si vijon: Mbi gjykatësin, si duhet të jetë i afërt e simpatik për të gjithë dhe të mos u besojë fjalëve pa i shqyrtuar.

Mbi drejtësinë dhe si duhet të veprojë gjykatësi për drejtësinë.

Mbi ligjin, ç'është ligji dhe mbi paligjësinë.

Mbi kanonet (rregullat) e pashkruara të kishës („kanone që nuk janë shkruar“) dhe ato të qyteteve.

Për çfarë arsyeje e dorëzon peshkopi patrikun.

Mbi atë që dëshiron të bëhet peshkop.

Mbi shtatë dhuratat e shpirtit të shenjtë.

Si duhet t'i pagëzojë fëmijët prifti.



Mbi krezmimin.

Përse bëhet përshpirtje për të vdekurit.

Mbi gabimet në shërbimet liturgjike.

Po të ketë ndonjëri armiqësi, të mos i pranohet mesha në kishë.

Mbi fejesat në raste të ndryshme: Nëse vdes i fejuari, i vëllai i tij mund të martohet me të fejuarën e të vëllait.

Mbi ndarjen e të fejuarve në raste të ndryshme:

Mbi shkallët e kurorëzimit - nga fleta 175 deri 187.

Shkaqet përse njeriu ndan gruan, fleta 207.

Rreth konflikteve ndërmjet burrit dhe gruas.

Shkaqet e ndryshme të ndarjes së burrit nga gruaja dhe anasjelltas, të ndarjes së gruas nga burri.

Kur ndonjë nga bashkëshortët kërkon vdekjen.

Mbi vdekjen e burrit pa lënë testament, fleta 226.

Mbi trashëgimitë pas vdekjes së burrit kur ka vëllezër e nipër, fleta 227.

Mbi trashëgimitë e burrit e të gruas, fleta 228.

Mbi fëmijët e prindërve, të burrit e të gruas.

Fëmijët duhet të nderojnë prindërit e tyre, fleta 224.

Mbi trashëgimitë, fleta 237.

Mbi betimin, fleta 241 verso.

Mbi djemtë, se si duhet të ndihmojnë e nderojnë prindërit e tyre.

Mbi Pashkën e të krishterëve, e cila bie për t'u festuar prej datës 22 të muajit mars deri në 25 të muajit prill.

Detyrat e klerikëve: rrëfimi.

Prej cilës moshë fillojnë t'i njihen mëkatet njeriut?

Rreth mëkateve të njerëzve, fleta 259.

Mësime morale nga Niqifor Ksanthopulli, prej fletës 270.

Mbi kreshmën, fletët 274-275.

Mbi kreshmën, nga Shën Thanasi i madh.

U ndalohet kreshma grave lehona dhe të sëmurëve, fleta 276.

Rreth sinodeve të kishës, gjithsej 7, fleta 280.

Lista e patrikëve dhe të kryepeshkopëve të Kishës lindore dhe nënshkrimet e tyre. Si duhet t'u shkruajë peshkopi për çështje të ndryshme superiorëve të tij.

## **KODIKU I 67-TË, I BERATIT**

(NOMOKANON)

Materiali: Letër.

Përmasat: 21.2 x 15.2 cm.

Sasia e fletëve : 326.

Teksti: Në një kolonë.

Grafia: Në ngjyrë të zezë, titujt dhe inicialet të kuq, stili i shkrimit i tipit fare të vonë.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë. Lëkura në anët e lidhjes së fletëve është grisur dhe zhdukur.

Si edhe kodikët e tjerë të tipit „nomokanon“, edhe ky kodik është gati i njëjtë në paraqitje si nomokanonet e tjera, si rregullore fetare.

Karakteristika kryesore e këtij kodiku qëndron në përmbajtjen e tij morale-fetare dogmatike.

Çështje kryesore të trajtuara në të janë:

Rreth doktrinës së fesë së krishterë ortodokse.

Rreth çështjeve dogmatike.

Mbi çështjet e sinodeve të Kishës lindore ortodokse.

Rreth problemeve dogmatike morale.

Mbi organizimin e personave me grada klerikale.

Mbi detyrat e secilës pozitë klerikale në kryerjen e ceremonive të pagëzimit, në fejesat, martesat, si edhe shërbimet e ndryshme të kultit.

Rreth figurave të shquara të kishës dhe kontributit të tyre në përpilimin e detyrave dhe në ndëshkimin e shkelësve të normave morale fetare, si kundër lavirësisë, simonisë, vjedhjeve etj.

Rreth atyre që quhen “mëkate të rënda”, sipas frymës së pikëpamjeve të fesë së krishterë.

Duke u mbështetur në grafinë e tekstit, ky kodik duhet t'i atribuohet kohës prej shekullit të 17-të deri në shekullin e 18-të.

### **KODIKU I 68-TË, I BERATIT**

(LETËRSI LAIKE, HYRJE NË LOGJIKË)

Materiali: letër.

Përmasat: 21.5 x 15.4 cm.

Sasia e fletëve: 66 .

Kodiku mban titullin “Hyrje në logjikë” dhe është punë e Anastas Vasilopulit, shkruar në vitin 1696, dhuruar kërkuesit (porositësit, ktitorit); i cili, duke qenë se mban emrin e Joasafit të parë, peshkopit të Beratit, duhet të jetë nga Bubullima.

Duke qenë se kodiku mban si datë vitin 1696, vetë ky fakt tregon se intelektualët tanë, siç është Joasafi i Beratit, janë marrë me probleme filozofike edhe në shekullin e 17-të. Kjo do të thotë se edhe në periudhën otomane, intelektualët tanë merreshin me probleme të larta, sidomos kur dimë, nga burime të tjera autentike, që të dy Joasafët e Beratit kanë qenë me origjinë nga fshati Bubullimë i Myzeqesë.

### **KODIKU I 69-TË, I BERATIT**

(NOMOKANON)

Materiali: Letër.

Përmasat: 22.3 x 16.2 cm.

Numri i fletëve: 65.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë, kurse titujt në ngjyrë të kuqe.

Në fletën 2 verso gjendet shënimi: “Ish-peshkopi (ose mitropoliti) i Durrësit zoti Gerasim, i cili erdhi në eparki në vitin 1833, në nëntor, data 8, u preh me Zotin në (vitin) 1837, në 22 shtator. Në (vitin) 1838, 28 korrik, erdhi (mitropolit) i Durrësit i shumëhirshmi muzikant i ditur zoti Anthim”.

Ky kodik përmban rregulla ose ligje kishtare të lidhura me emrat e autorëve që i kanë konceptuar, si pason: Grigori i Kostandinopojës, Vasili i madh, patrik Foti. Një vend më vete zë kanoni i apostujve, kanoni i Antiokas, kanoni i 16-të i sinodit. Ka, gjithashtu, çështje morale të trajtuara sipas apostullit Pal, të perandorit Justinian, perandorit Kostandin të sinodit të Selanikut, të Shën Gjon Gojartit; të sinodit të katërt, të sinodit të gjashtë, të Vasilit të Madh, të sinodit të Kartagjenës (në tekst “të Qithargjenës”), të perandor Konstandinit dhe në vazhdim janë regjistruar kanonet me burimin nga kanë ardhur.

Ky nomokanon, duke qenë i vogël, përmban probleme ose çështje fetaro-morale nga më

kryesoret dhe është konceptuar bukur.  
Duke u mbështetur në grafinë e tekstit, kodiku në fjalë duhet t'i atribuohet shekullit të 18-të.

### **KODIKU I 70-TË, I BERATIT**

(MESHAR, MESA E SHËN GJON GOJARTIT DHE LITURGJIA E PARASHENJTËRUAR E GRIGOR THEOLOGUT)

Materiali: Letër.

Përmasat: 18.2 x 12.2 cm.

Sasia e fletëve: 72.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë, kurse titujt dhe inicialet janë në ngjyrë të kuqe. Ka dhe inicialet më të mëdha, të pikturuara po në ngjyrë të kuqe.

Kodiku stoliset me dy vinjeta. Njëra është në fletën 6 dhe e dyta në fletën 54.

Kodiku është riprodhuar nga prifti me emrin Gjika, i cili, në mbishkrimin që ka lënë, veten e tij e quan „mëkatar“ dhe e konsideron „më të voglin, më të mjerin, të paditurin“.

Duke u mbështetur në grafinë e vonë, mund të themi se kodiku duhet t'i atribuohet afërsisht shekullit të 18-të.

### **KODIKU I 71-TË, I BERATIT**

(LETËRSI LITURGJIKE; SHËRBESA TË KRYEHIERARKËVE ATHANAS DHE CIRIL TË ALEKSANDRISË)

Materiali: Letër.

Përmasat e kodikut: 22.3 x 16.1 cm.

Sasia e fletëve: 31.

Grafia: E tipit të vonë, shkruar në ngjyrë të zezë.

Ka edhe shërbesa të një prifti dëshmor, Ermollaut, bashkë me të tjerë si dhe të dëshmores së Shënepremtes, më 26 korrik.

Riprodhimi i kodikut është bërë nga Teodhor Haxhifilipi (Dhaskal Todri, Elbasanasi).

Shënimi i Dhaskal Todrit: “Viti 1789, mars 11. Ky shënim i tanishëm këtu u shkrua me dorën time, të Theodhor Haxhifilipit, me shpenzimet e të shumënderuarve zotit Athanas, rrobaqepës Nixhatit dhe të Gjergjit Nan Pavlit, për shpëtimin e shpirtave të tyre“.

### **KODIKU I 72-TË, I KORÇËS**

(OKTOIH, ANTOLOGJI MUZIKORE KISHTARE BIZANTINE)

Materiali: letër e hollë e bardhë.

Përmasat: 15.3 x 10.5 cm.

Sasia e fletëve: 280.

Grafia: Njësoj si e tekstit ashtu dhe e notave. Në të dy rastet është e bukur, në ngjyrë të zezë. Titujt dhe pikëzimet janë në ngjyrë të kuqe.

Stolisja: Kodiku stoliset me vinjeta lineare të bardha me të kuqe, që shërbejnë si dekor mbi fillimin e tekstit.

Datimi i kodikut shenjohet poshtë fletës së fundit verso. Përmbajtja e shënimit është si vijon: “U përfundua ky libër në muajin qershor, më 13, ditën e dielë, viti 1736; u shkrua prej meje ...“.

Firma e autorit duhet të ketë qenë në fletën tjetër, e cila është grisur dhe marrë.

Dorëshkrimi përmban pjesë muzikore të poetëve kishtarë bizantinë:

Fleta 1 fillon me zërin e katërt të muzikës kishtarë bizantine.

Fleta 21 fillon me zërin tërthor i parë.

Fleta 45 fillon me zërin tërthor i dytë.

Fleta 64 fillon me zërin e rëndë të muzikës kishtare.

Fleta 83 fillon me zërin tërthor i katërt.

Përveç këtyre pjesëve të librit të llojit “oktoih” – tetëzërash - dorëshkrimi përmban dhe pjesë të ndryshme muzikore të muzikës kishtare të këtyre autorëve:

Në fletën 102, pjesë të autorit Kostandin Nagulasit të përpunuara nga Gasi-u.

Në fletën 105, këngë të Shën Mërisë, nga Emanuil Krisafi, i cili ka shumë pjesë të tjera në këtë dorëshkrim.

Në fletën 106, pjesë nga Joani i Ëmbli (Gliki).

Në fletën 128, dhoksologji e madhe nga Melhisedek Dekresti.

Në fletën 143, dhoksologji e madhe nga Emanuil Krisafi.

Në fletën 153, himni i Shën Mërisë për çdo kohë, poezi e bukur e zotit Joan Kukuzelit, mjeshtrit (në tekst: „maestrit“).

Në fletën 156, mesha e shenjtë e atit tonë shenjt ndër shenjtorë Gjon Gojartit, kryepeshkopit të Kostandinopojës.

Në fletën 162, himnet kerubike të Emanuil Krisafit dhe kryepsalmet.

Në fletën 181, himni kerubik i së Shtunës së Madhe, nga Niqifor Hlikoi.

Në fletën 228, dhoksologjia e madhe, nga prift Balasi, nomofilakt i kishës së madhe, tetrafonik (katërzërash).

Në fletën 237, himni i kungimit, nga prift Balasi.

Në fletën 277, himn nga Koroni.

Në fletën 278, mesha e parashenjtëruar, pjesë nga Joasafi, Kukuzeli i Ri.

Në fletën 280, himn nga Joan Llambadhari.

Në fletën 301, himn nga Joan Kladha.

Në fletën 318, himn nga Jerjerark Germanoi.

Në fletën 355, himn nga Theofan Kazriqik.

Në fletën 379, himn nga Panajot Llambadhari.

Në fletën 386, himn nga jeromanak Damiano Malodhoi (Melodhoi).

Në fletën 388, himn nga Meletie Karakalini, jeromonak.

Në fletën 408, himn nga Pietri i Ëmbël (Glikiu).

Në fletën 447, himn nga Pjetër Bizanti, kryepsallt.

Në fletën 456, që është e fundit, janë këto shënime në fund: “Ky libër mori fund më 1736, në muajin korrik, më 3 dhe 4, ditën e dielë. U shkrua prej meje... “. Fatkeqësisht emrin e autorit riprodhues e kanë zhdukur, duke prerë letrën.

Përmbi titujt e himneve shpesh herë kodiku ruan ornamente me vizatime interesante, të ngjyrosura me të kuqe.

Titujt i ka të shkruar me germa të vogla e me ngjyrë të zezë me pikësime të kuqe, në mënyrë të theksuar kaligrafike, porsitipografisë.

Inicialet e çdo himni paraqiten me germa të mëdha të kuqe e të stolisura me ornamente të kuqe.

Fleta 77 verso dhe 88 recto janë pa shkrim.

Çdo poezi fillon me nga një inicial të stolisur me ngjyrë të kuqe, si dhe shënimet orientuese të poezive.

Kodiku ruan vineta në fletët: 1, 11, 23, 33, 42, 51 verso, 54, 65 verso, 98 verso, 147, 189.

Ndërmjet fletës 115 dhe 116 mungojnë disa fletë, për të cilat nuk mund të përcaktohet numri.

Në fund kodiku ka dhe 4 fletë të tjera të pashkruara.

Si vepër arti dorëshkrimi paraqitet një kompleks artistik në gjininë e vet.

Sikurse u tha më sipër, përveç autorëve të tjerë të shumë muzikantë, aty ruhen dhe pjesë të Jan Kukuzelit, me një himn të tij, muzikant i madh e i shquar në muzikën bizantine, nga

Durrësi, të cilin kopjuesi i dorëshkrimit e quan “maestro”.

Për përmbajtjen interesante të pjesëve të autorëve muzikantë të ndryshëm, ndër të cilët ruhet dhe pjesa e durrësakut tonë Jan Kukuzelit; për paraqitjen artistike të veprës; si në shkrimin kaligrafik të notave të tekstit, të ornamenteve dhe të inicialeve; si për faktin që ky dorëshkrim e kapërcen numrin e katërqind e pesëdhjetë faqeve, duke qenë i vitit 1736, ai dëshmon për lulëzimin e këtij arti gjatë kohës kur u shkrua, jo vetëm nëpër manastiret e vendit tonë, por për më gjerë. Prandaj jemi të mendimit se vlefata e këtij dokumenti kultural është shumë e madhe.

### **KODIKU I 73-TË, I BERATIT**

(TEOLOGJI, ÇËSHTJE TË DOKTRINËS SË SHENJTË)

Materiali: Letër.

Përmasat: 22.2 x 15.7 cm.

Sasia e fletëve: 164.

Grafia: E tipit të shekullit të 18-të, në ngjyrë të zezë.

Titujt: Në ngjyrë të kuqe. Pak iniciale janë të pikturuara. Grafia është e imët.

Stolisja: Në fletën e dytë sipër kodiku ka një vinjetë në formë shiriti, me motivin e një linje valëzuese, e nxjerrë e gjithë anash dhe me nistoren e parë, të pikturuar.

Dëmet: Në fletën e parë kodiku ka një të prerë prej 3-4 cm. Në këtë pjesë të letrës ka pasur një shënim. Gjithashtu fleta e parafundit është prerë. Dyshohet se në to ka pasur shënime me rëndësi, por një dorë e papërgjegjshme („skandaloze“) i preu dhe i mori.

Përmbajtja e teologjisë së shenjtë është ndarë në disa leksione, të cilat ndahen në shumë kapituj.

Ky kodik përmban probleme ose çështje dogmatike, të cilat analizohen dhe arrijnë në dogmën e sotereologjisë në lidhje me frymën hyjnore. Është shkruar me një gjuhë të rëndë, si dhe me një shkrim të imët, me vështirësi i lexueshëm.

### **KODIKU I 74-T, I BERATIT**

(FIZIKA DHE METAFIZIKA)

Titulli i plotë i veprës: “Fizika, vepër (studim), konceptuar nga mësuesi i shumëditur zoti Teodor Anastas Kavalioti, nga Voskopoja; është dhënë nga ai për shkollën e re të ndërtuar në atdheun e tij”.

Përmasat e vëllimit: 19.3 x 15.4 cm.

Sasia e fletëve të Fizikës: Gjithsej 82, por katër fletët e para janë të pashkruara.

Sasia e fletëve të shkruara të Metafizikës: 56.

Sasia e fletëve të shkruara të Fizikës e të Metafizikës: Gjithsej 134.

Teksti i kodikut fillon me hyrjen, që zë dy faqet e fletës së parë. Pas hyrjes fillon parathënia, me titullin në fund të faqes verso të fletës së parë. Kjo mbaron në pjesën e poshtme të fletës së dytë, nën të cilën fillon titulli.

Grafia: E tipit të shekullit të 18-të, në njëshkolonë dhe në ngjyrë kafe të errët.

#### FILOZOFIA

Në fletën 10 fillon Ndarja e fizikës, me formulimet e fizikës.

Në fletën 10 verso: çështje mbi fillimet.

Në fletën 18 verso: mbi esencën.

Në fletën 22 recto: mbi stolisjen.

Në fletën 23 verso: mbi bazat e kimisë.  
 Në fletën 25 verso: mbi vendin.  
 Në fletën 26 verso: mbi vendin e palëvizshëm.  
 Në fletën 31 verso: mbi barometrin.  
 Në fletën 32 verso: mbi lëvizjen sipas vendit.  
 Në fletën 39: mbi nisjen.  
 Në fletën 42: mbi trupat e nxehtë dhe të ftohtë.  
 Në fletën 43 verso: mbi natyrën.  
 Në fletën 45 verso: mbi igrasinë dhe lagështinë.  
 Në fletën 47 verso: mbi lëvizjen dhe moslëvizjen (qëndrimin).  
 Në fletën 49: mbi cilësinë dhe dendësinë.  
 Në fletën 52: mbi dritën.  
 Në fletën 56: mbi elementet.  
 Në fletën 56: mbi ndjenjën.  
 Në fletën 58: mbi tokën.  
 Në fletën 59 recto: mbi ujërat.  
 Në fletën 60 recto: mbi zjarrin.  
 Në fletën 64 recto: mbi botën.  
 Në fletën 68 recto: mbi sferën, hapësirën.  
 Në fletën 71 verso: mbi meteorët.  
 Në fletën 75: mbi shpirtin e gjallë.

#### METAFIZIKA

Në fletën 91 recto është titulli: “Metafizika dhe Parathënia“.  
 Kapitulli i parë fillon në fletën 91 verso dhe ka për titull: “Mbi të qenurit dhe mënyrën ose cilësinë“.  
 Në fletën 94: kategoritë e përbashkëta të të qenurit dhe mënyrat e tij.  
 Në fletën 99: mbi kategorizimin vetëm të të qenurit ose që i përkasin atij.  
 Në fletën 103: mbi aksiomat e para të ekstazave të të qenurit dhe mënyrat e tij në përgjithësi, si edhe mbi idetë e tyre të përgjithshme të kategorizuara.  
 Në fletën 110: mbi ekzistencën e Perëndisë.  
 Në fletën 113: mbi ekzistencën kryesore të Perëndisë, madje edhe mbi pavdekësinë dhe përjetësinë.  
 Në fletën 115: mbi pafundshmërinë e Perëndisë.  
 Në fletën 118: mbi dijen, dëshirën, gjithëfuqishmërinë, lirinë dhe mbi gjykimet hyjnore.  
 Në fletën 121 verso: mbi krijesën.  
 Në fletën 123 verso: mbi përmbajtjen dhe providencën.  
 Në fletën 124: mbi kujtesën dhe mësimin e Perëndisë.  
 Në fletën 132: mbi engjëllin.  
 Në fletën 132 verso: mbi natyrën e shpirtit të njeriut.  
 Në fletën 133: mbi mënyrën si duhet të njohë mendja e njeriut.  
 Tre titujt e fundit nuk munda t'i përkthej për shkak të mosnjohjes së disa fjalëve.

### **KODIKU I 75-TË, I GJIROKASTRËS**

(UNGUJ NË PERIKOPE DHE OMILIE)

Materiali: Letër.  
 Përmasat: 21.5 x 15.5 cm.  
 Sasia e fletëve: 431.

Grafia: E tipit të vonë, afërsisht e fundit të shekullit të 14-të deri në dekadat e para të shekullit të 15-të; është shkruar në ngjyrë të zezë, kurse tituj dhe inicialet në ngjyrë të kuqe.

Dëmet: Kodiku nuk i ka fletët e para dhe as të fundit. Ndërmjet fletëve 254-266 fletët janë shqitur e marrë (gjithsej 12 fletë).

Omilia e parë, së cilës i mungon fillimi, i përket perikopesë që përmban tekstin rreth Fariseut. Omilia e dytë, ndonëse nuk ka fletët e para, kuptohet se përmban perikopenë me paravolinë rreth djalit plangprishës.

Omilia e tretë është e së Dielës së të Lidhurave. Përmban perikopenë ungjillore mbi ardhjen e dytë të Krishtit dhe mbi gjyqin e fundit.

Omilia e katërt ka pjesë nga Ungjilli sipas Mateut; kjo pjesë lexohet të Dielën e Djathit: mbi faljen e mëkateve njëri-tjetrit.

Omilia e pestë, e së Dielës së Parë të Kreshmëve, që quhet “e ortodoksisë”, ditë në të cilën festohet fitorja e Kishës kundër herezive (në tekst: “eretive”). Kjo ditë u caktua pas fitores kundër ikoniklastëve (nënkupto: idoltarisë, idhujtarisë pagane).

Omilia e gjashtë, nga Ungjilli sipas Markut, pjesë që lexohet të Dielën e Dytë të Kreshmëve, perikope ungjillore mbi shërimin e ulokut.

Omilia e shtatë, nga Ungjilli sipas Markut, me perikopenë që lexohet të Dielën e Tretë të Kreshmëve; përmban perikopenë e mësimin të Krishtit: “Kush dëshiron të vijë pas meje, të mohojë veten e tij, të marrë kryqin e tij e të më vijë pas; ai që vjen pas meje do të pësojë shumë”.

Omilia e tetë, nga Ungjilli sipas Markut, që lexohet të Dielën e Katërt të Kreshmëve, përmban perikopenë mbi shërimin e të demonizuarit.

Omilia e nëntë, nga Ungjilli sipas Markut: mbi kërkesën e të bijve të Zebedeut (në tekst: “Zevdeut”) drejtuar Krishtit që, kur të vejë në mbretërinë e tij, të vendosë pranë vetes Jakovin dhe Joanin, njërin në të djathtë të tij dhe tjetrin në të majtë. Ka dhe një pjesë tjetër: “Ai që përul veten e tij do të lartësohet dhe anasjelltas”.

Omilia e dhjetë, e cila lexohet të Shtunën e Llazarit, ka perikopenë mbi ngjalljen e Llazarit.

Omilia e njëmbëdhjetë, nga Ungjilli sipas Gjonit, me perikopenë që lexohet të Dielën e Dafinës, mbi hyrjen e Krishtit në Jeruzalem.

Omilia e dymbëdhjetë, që lexohet të Dielën e Pashkës, me perikopenë e ngjalljes së Krishtit.

Omilia e trembëdhjetë, me perikopenë që lexohet po të Dielën e Pashkës.

Omilia e katërbëdhjetë, që lexohet të ejten e Javës së Pashkës, me perikopenë mbi gëzimin e ngjalljes.

Omilia e pesëmbëdhjetë, sipas Ungjillit sipas Gjonit, mbi shfaqjen e Krishtit apostujve.

Omilia e gjashtëmbëdhjetë, nga Ungjilli sipas Markut, me perikopenë e së Dielës së Mirëprurësve, mbi shfaqjen e Krishtit Mirëprurësve.

Omilia e shtatëmbëdhjetë, nga Ungjilli sipas Gjonit, me perikopenë e shërimit të ulokut.

Omilia e tetëmbëdhjetë, nga Ungjilli sipas Gjonit, me perikopenë e gruas mëkatare.

Omilia e nëntëmbëdhjetë, nga Ungjilli sipas Gjonit, lexohet të Dielën e të Verbërit, ka perikopenë e shërimit të të verbërit.

Omilia e njëzetë, nga Ungjilli sipas Gjonit, perikope që lexohet të Dielën e 318 etërve të kishës, të sinodit (këshillit, koncilin) të parë.

Omilia e njëzetënjëtë, nga Ungjilli sipas Gjonit, perikope që lexohet të Dielën e Pesëdhjetores (pendikostisë), mbi zbritjen e shpirtit të shenjtë mbi apostujt.

Omilia e njëzetedytë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Etërve të Shenjtë.

Omilia e njëzetetretë, nga Ungjilli sipas Mateut, pjesë që lexohet të Dielën e Dytë.

Omilia e njëzetekatërt, nga Ungjilli sipas Mateut, perikope që lexohet të Dielën e Tretë.

Omilia e njëzetepesë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Katërt.

Omilia e njëzetegjashtë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Pestë.

Omilia e njëzeteshtatë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Gjashtë. Omilia e njëzetetë, nga Ungjilli sipas Mateut, përmban perikopenë e ulokut, që u shërua, i takon të Dielës së Shtatë.

Omilia e njëzetënëntë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja e nginjës (ngopjes) së pesëmijë burrave në shkretëtirë, e Diela e Tetë.

Omilia e tridhjetë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Nëntë, me tekstin që tregon ecjen e Pjetrit mbi ujërat e detit dhe si shpëtohet nga mbytja prej Jezuit.

Omilia e tridhjetenjë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Dhjetë, me pjesën e shërimit të djalit me sëmundje të rëndë.

Omilia e tridhjetedytë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Njëmbëdhjetë, mbi faljen e borxheve një borxhliu dhe mbi dënimin e njërit nga Zoti për dhunën ndaj shokut të tij, pse i kishte një borxh të vogël.

Omilia e tridhjetetretë, nga Ungjilli sipas Mateut, perikopeja që lexohet të Dielën e Dymbëdhjetë, për djalin e pasur që kërkoi të dijë prej Jezuit: “Çfarë duhet të bëj që të fitoj mbretërinë e Perëndisë”; dhe kur Jezui (i tha) të shesë pasurinë e tij që të bëhet i pasur, ai u dëshpërua dhe iku. Nga kjo bisedë doli mësimi i Jezuit: “Më kollaj është të hyjë deveja nëpër vrimë të gjilpërës, se sa i pasuri në mbretërinë e Perëndisë”.

Omilia e tridhjetekatërt, nga Ungjilli sipas Mateut, pjesë që lexohet të Dielën e Trembëdhjetë, me përmbajtjen e alegorisë (në tekst: “parabullës”, paravolisë, rrëfenjës alegorike), mbi zotninë që mbolli një vreshtë dhe ua dha bujqve që t’ia punojnë e t’U marrë prodhimin dhe kur erdhi koha e prodhimit dërgoi njerëzit e tij që ta marrin, por bujqit nuk u dhanë gjë, prandaj disa i rrahën e i përzunë të poshtëruar, të tjerë i vranë. Zotëria më në fund dërgoi të birin e tij, të cilin gjithashtu e vranë, që të trashëgonin vreshtën e tij. Nxirret përfundimi që vrasësit do të vriten dhe vreshta do t’u jepet të tjerëve.

Omilia e tridhjetepesë, nga Ungjilli sipas Mateut, me perikopenë mbi dasmën që bëri një mbret për birin e tij. Kur qenë bërë të gjitha gati, dërgoi shërbëtorët e tij t’i thërrasë të grishurit, duke i njoftuar se të gjitha ishin gati, por secili nga ata justifikohet se ishte i zënë me punë e nuk mund të shkonte. Kur pa mbreti se nuk erdhën, urdhëroi shërbëtorët e tij të thërrasin të vobektët e të çalët që do të gjejnë nëpër rrugë. Si e bëri dasmën me ta, tha: “Shumë janë të thirrur, por pak janë të zgjedhur” etj.

Omilia e tridhjetegjashtë, nga Ungjilli sipas Mateut, me perikopenë mbi djalin e pasur që pyeti Jezunë: (Mësues), çfarë të mire duhet të bëj që të fitoj jetën e amëshuar?”. (Meqenëse ai i kishte ruajtur porositë e Moisiut). Kur i tha Jezui “po deshe të bëhesh i përsosur, shite gjithë pasurinë tënde dhe jepua të vobektëve, se do të kesh thesare në qiej dhe eja pas meje”, djaloshi iku i dëshpëruar.

Omilia e tridhjeteshtatë, nga Ungjilli sipas Mateut, pjesa që lexohet të Dielën e Gjashtëmbëdhjetë, me rrëfenjën e Krishtit mbi tallantat (talente - monedhë me vlerë të madhe = me 27) (kg ar ose argjend). Tregohet se si një zotëri u dha shërbëtorëve të tij nga një sasi të ndryshme tallantash, që duke i punuar t’i shumojnë. Por kur erdhi të kërkojë llogari sa i shumuan, i lavdëroi ata që i shumuan dhe i uroi të kalonon një jetë të mirë, ndërsa ata që nuk e kishin punuar tallantin e tij, duke e kthyer siç e mori, i dënoi. Tallantat janë talentet - dhuratë që e ka njeriu prej lindjes.

Omilia e tridhjetetë, nga Ungjilli sipas Mateut, me perikopenë mbi shërimin nga Jezui të vajzës së gruas kananease joizraelite.

Omilia e tridhjetenëntë, nga Ungjilli sipas Lukës, perikopeja mbi zënie e një shumice të madhe peshqish me kërkesën e Jezuit në thellësinë ku apostujt gjithë natën ishin lodhur dhe nuk kishin zënë.

Omilia e dyzetë, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë mbi porosinë e virtutit më të lartë të Jezuit, mbi dashurinë jo vetëm ndaj çdo njeriu, por dhe ndaj armiqve, sepse u thoshte: “Nëse doni ata që ju duan, çfarë meritash keni? Kështu bëjnë e duan edhe ata që janë paganë”.



Omilia e dyzetenjëtë, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë që lexohet të Dielën e Njëzetë, e cila përmban tekstin mbi ngjalljen e djalit të vetëm të gruas së ve në qytetin Nain.

Omilia e dyzetedytë, nga Ungjilli sipas Lukës, që lexohet të Dielën e Njëzetenjëtë, me perikopenë mbi mbjellësin që mbjell farën.

Omilia e dyzetetretë, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë që lexohet të Dielën e Njëzetedytë, që përmban tekstin me rrëfenjën e L Lazarit dhe të pasurit.

Omilia e dyzetekatërt, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë që lexohet të Dielën e Njëzetetretë, që përmban shërimin e të demonizuarit në vendin e Gadaranëve

Omilia e dyzetepestë, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë që lexohet të Dielën e Njëzetekatërt, mbi ngjalljen e të bijës së Jairit dhe të gruas që vuante 12 vjet nga hemoragjia.

Omilia e dyzeetgjashtë, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë që lexohet të Dielën e Njëzetepestë, me tekstin mbi ligjvënësin që pyeti Jezuin: “Ç’duhet të bëj që të fitoj jetën e amëshuar” dhe mori si përgjigje: “Duaje Perëndinë dhe të afërmin tënd si veten tënde”.

Omilia e dyzeteshtatë, nga Ungjilli sipas Lukës, me perikopenë që lexohet të Dielën e Njëzetegjashtë, me tekstin mbi njeriun që i prodhoi toka shumë dhe thoshte me vete: “Do t’i prish depot e mia e do të ndërtoj më të mëdha dhe do t’i them shpirtit tim: hapi e gëzohu, të gjitha i ke”. Dhe Perëndia do t’i thotë: “I marrë, sonte do të marr shpirtin tënd, ato që ke kujt do t’i mbesin?!” Dhe ky arrin në përfundimin që njeriu duhet të jetë i pasur në virtytet shpirtërore dhe jo në pasuri materiale.

## **KODIKU I 76-TË, I BERATIT**

(UNGJJI)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 21 x 15.7 cm.

Sasia e fletëve: 86.

Grafia: E tipit të vonë.

Teksti: I shkruar në një kolonë, me 19 rreshta për kolonë.

Grafia: Në ngjyrë kafe. Titulli dhe inicialet janë në ngjyrë kafe të çelët, po ashtu dhe titujt e perikopeve.

Ky dorëshkrim duhet të ketë qenë katërungjillësh. Për shkak të dëmtimit ka mbetur i plotë vetëm Ungjilli sipas Markut, kanë mbetur katër fletë të Ungjillit sipas Lukës, kurse nga ai sipas Mateut ruhen 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, që u takojnë pjesëve të parafundit.

Nëntë fletët e para kanë pësuar dëme në tekst. Dëmet janë më të theksuara në fletët 1-5. Ungjilli sipas Gjonit mungon fare.

Kodikun në fjalë ka nevojë për t’iu restauruar fletët e kalbura nga lagështia, për forcimin e lidhjeve të fashikujve, si dhe për vënien e kapakëve të rij, sepse të vetët i mungojnë.

Duke u mbështetur në grafinë e vonë, ky kodik duhet t’i atribuohet fundit të shekullit të 14-të ose fillimit të shekullit të 15-të.

## **KODIKU I 77-TË, I BERATIT**

(UNGJJI NË PERIKOPE)

Materiali: Pergamenë me fletë të trashë, jocolësore.

Përmasat: 24 x 15.8 cm.

Sasia e fletëve: 198.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe. Titujt janë në ngjyrë të kuqe, si dhe inicialet.

Teksti: Në një kolonë. Inicialet i ka të mëdha.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me lëkurë, me linja dhe motive të presuara, të vizatuara.

Dëmet: Kapaku sipër e ka mjaft të grisur mbulesën prej lëkure. Nga fashikulli i parë i kodikut kanë mbetur vetëm dy fletë. Nga këto e para është grisur mjaft në pjesën e poshtme. Dy fletët e para janë errësuar ngapak. Në fletën 96 kanë prerë një pjesë pergamene, pa dëmtuar tekstin. Në fletën 145 anash tekstit kanë zhgaravitur vonë me ngjyrë të zezë. Prej fletës 165-169, duke e përfshirë dhe këtë të fundit, në pjesën e sipërme fletët janë ndotur pak nga lagështia. Kapaku është i shqitur nga lidhja.

Kodiku përmban perikope të cilat lexohen gjatë festave, por dhe gjatë ditëve të rëndomta. Këtu mungojnë jo vetëm pjesë perikopesh nga fillimi dhe mbarimi i kodikut, por mungon dhe pasqyra që tregon cili perikop lexohet në një ditë e cili në një ditë tjetër.

Duke u mbështetur në grafinë e tipit të vonë, kodiku duhet t'u atribuohet dekadave të fundit të shekullit të 14-të.

### **KODIKU I 78-TË, I GJIROKASTRËS**

(PENDIKOSTAR)

Materiali: Letër.

Përmasat: 21 x 16 cm.

Sasia e fletëve: 290.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë kafe, në një kolonë.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me lëkurë. Ato janë dëmtuar shumë. Kapaku i poshtëm thuajse e ka të zhdukur lëkurën, kurse i sipërmi e ka shumë fragmentare. Fletët e para janë zhdukur krejt. Fleta 1 ruhet pjesërisht, po kështu dhe katër fletët e fundit. Fragmente fare të parëndësishme ruhen në fund të kodikut. Këto tregojnë se janë zhdukur dhe shumë fletë të tjera. Dy fashikujt e parë kanë shumë fletë me tekst të zbehtë. Fleta 33 është e zbehtë shumë dhe e grisur prej poshtë deri në gjysmën e saj. Fleta 134 e ka bosh faqen verso, të pashkruar.

Kodiku është libër i pesëdhjetores, pendikostar. Si i tillë ai përmban shërbesat që bëhen në kishë prej të Dielës së Pashkës deri në ditën e pesëdhjetores - pendikostisë - 50 ditë pas Pashkës.

Kodiku duhet t'u atribuohet dekadave të para të shekullit të 15-të ose fillimit të shekullit të 16-të. Mund të jetë shkruar në periudhën e sundimit osman. Edhe ky kodik ka nevojë për restaurim.

### **KODIKU I 79-TË, I GJIROKASTRËS**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 19.9 x 13.5 cm.

Sasia e fletëve: 303.

Grafia: E tipit të vonë, por me vlerë të lartë artistike. Shkrimi i kodikut është në ngjyrë kafe, me 21 rreshta për faqe.

Teksti: Ndjek linjat e presuara mbi pergamenë. Inicialet janë me shkronja kapitale të kuqe, por jo të mëdha, veçse të stolisura me zbukurime. Këto janë të dukshme në fillim të tekstit të ungjijve.

Zbukurimet: Si ato të kodikëve të vjetër, me shije, veçse jo me ato vlera artistike që kishin të vjetrit, që janë me finesë të rrallë.

Grafia: Punë e një dore, pra dhe teksti është uniform, përveç faqes 183 verso dhe asaj 184, që janë të një dore tjetër, shkruar me një penë më të trashë. Teksti ruhet i gjithë i padëmtuar. Vetëm fleta e fundit ka një copë të grisur, po duke mos cënuar tekstin.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me argjend, të stolitur me skena të punuara me savat. Skena është ndërtuar me përfytyrimin e Krishtit në tre çaste: 1. Krishti me tre apostuj, duke u ngjitur në majë të malit Thava; 2. Krishti i shpërfytyruar në majë të malit ku, përveç apostujve anash tij, janë edhe dy profetët: Moisiu dhe Elia. Apostujt janë kompozuar përmbys, sipas tekstit të ungjillit, nga drita e shpërfytyrimit. 3. Krishti përfytyrohet brenda një mandorle, që interpreton dritën e hyjnitetit.

Dekorimi: Kodiku stoliset me skena të pikturuara me pamje të dy ungjillorëve: të ungjillor Gjonit dhe të ungjillor Lukës. I pari del në faqen 238 dhe i dyti në faqen 147. Ungjillorët janë pikturuar para një tryeze shkrimi dhe një pulti. Gjoni paraqitet i ulur mbi një fron të madh me një mbështetëse sipër, që vjen e harkuar. Froni dhe tavolina e shkrimit janë ngjyrë kafe të errët, stolitur me linjëza ari. Gjoni i ulur mban në dorë kallamin e shkrimit. Pjesa e sipërme e trupit të tij, si dhe portreti, kanë qëndrim vertikal, stolitur me hiton të kuqërremtë të çelët dhe intonacion në blu të çelët. Ungjillori i ka këmbët të mbathura me shollëza, mbi një nënkëmbëse të madhe të kuqërremtë të çelët. Portreti i tij, me një ballë të lartë, me mjekër e flokë mjaft të thinjura, është i arrirë. Ka një vështrim duke u menduar, siç ndodh me figurat e filozofëve antikë të vonë. Ngjyra okër e intonuar me nuanca i jep njëfarë plastike figurës. Kjo figurë, me ngjyra të çelëta, shquhet mbi një blu të errët dhe mbi dysHEME të gjelbër.

Kompozimi: Ungjillori Luka, sikurse dhe Gjoni, paraqitet para tryezës së shkrimit dhe pultit, ulur mbi një fron pa mbështetëse. Është kompozuar me një qëndrim të zgjatur, duke ngjyer kallamin e shkrimit në bojë mbi tavolinë. Veshjet e tij, si të Gjonit, paraqiten me rrudha e pala dhe ngjyra të njëjta, si dhe me mjaft nuanca në detajet e trajtimit të figurave. Megjithatë, vështruar nga trajtimi i përgjithshëm, në krahasim me figurat e dorëshkrimeve të shekujve të 10-të deri të 12-të, këto dy figura paraqiten të një niveli artistik më të ulët, ndonëse nuk janë pa art. Duke pasur parasysh grafinë bukurshkrimore të kodikut, si dhe trajtimin e figurave të ungjillorëve në miniaturë, mendojmë që kodiku, afërsisht, mund t'i atribuohet shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 80-TË, I GJIROKASTRËS**

(MESHAR)

Materiali: Letër.

Përmasat: 15.2 x 6 cm.

Sasia e fletëve të shkruara: 138.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë. Titujt janë me shkronja kapitale në ngjyrë të kuqe. Inicialet janë të vizatuara në ngjyrë të kuqe.

Shkrimi: Kaligrafik, me germa mjaft të mëdha. Ka edhe proskomidinë, por pjesët e para të saj janë të zhdukura.

Kapakët: Veshur me lëkurë. Kapaku i poshtëm ka mbetur vetëm me dërrasën. Kapaku i sipërm me gjithë një fashikull është shkëputur nga lidhja.

Përmbajtja: Ka meshën e Shën Vasilit të Madh

1. Duke u mbështetur në grafinë, kodiku duhet t'u atribuohet dekadave të fundit të shekullit të 15-të, ose dekadave të para të shekullit të 16-të.

**KODIKU I 81-TË, I BERATIT**

(OKTOIH-ANTOLOGJI MUZIKORE BIZANTINE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 25.7 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 220.

Grafia: Në ngjyrë kafe të çelët, e tipit të vonë, kurse notat në ngjyrë kafeje të errët, në një kolonë, me 24 rreshta tekst dhe 24 rreshta të notave.

Kapakët: Prej dërrase. Duhet të kenë qenë veshur me lëkurë. Sot ruhet vetëm ai i poshtmi, edhe te ky vetëm dërrasa. I sipërmi mungon.

Gjendja: Katër fletët e para të kodikut janë të shqitura nga fashikulli, kurse shumë të tjera duhet të jenë zhdukur. Fletët e para janë errësuar dhe grisur ngapak. Nga ana e djathtë është dëmtuar dhe teksti.

Fleta e fundit është e brejtur shumë nga mola. Dy fletët e fundit janë shkruar nga një dorë tjetër, e cila, në një shënim më të vonë, mallkon ata që mund ta vjedhin kodikun. Kodiku ka edhe fashikuj të shqitur.

Grafia: Me vlerë kaligrafike të shkëlqyer, por është tepër e zbehtë në shumë fletë. Në fletën 117 ruhet një vinjetë në formë shiriti, që përkufizon një fushë katërkëndëshi. Ky shirit stoliset me motive në formë zemrash të stilizuara, vizatuar në ngjyrë kafe të çelët.

Kodiku përmban poezi të muzikuara, me alfabetin muzikor bizantin kishtar. Janë këngë që këndohen në festat kishtarë të vitit, por në tekst nuk janë theksuar festat e vitit në të cilat këndohet secila prej tyre. Këtë ne e konstatojmë nga teksti në fletë, kur është i qartë.

Në bazë të grafisë, kodiku duhet t'i atribuohet shekullit të 14-të.

**KODIKU I 82-TË, I ELBASANIT**

(LËNDË TË NDRYSHME)

Materiali: Letër.

Përmasat: 16 x 11 cm.

Sasia e fletëve: 633.

Kodiku ka grafi të ndryshme, sepse shkrimet e tij nuk janë të një kohe. Edhe letra, edhe autorët e teksteve, janë të kohërave të ndryshme. Në disa pjesë, ku pena ka qenë e trashë, shkrimi është hapur dhe teksti nuk lexohet. Këtu nuk ka grafi të tipit të vjetër, por dhe në grafitë e kohërave të mëvonshme gjejmë shumë shkurtime fjalësh, që janë shpikje e autorëve të shkrimeve dhe jo trashëgim nga shkurtimet e grafisë së kodikëve të vjetër. Kodiku në fjalë ka dhe shkrime me grafi të bukur, si në fletët 34-47, 298-330 etj.

Kodiku ruan disa figura grafike, pa ngjyra, në dy fletë, 13-15. Pikturat janë shumë të imëta, me skena të kompozuar prej shumë figurash, por me vlerë, sepse të tilla, të ruajtura tek ne deri në ditët tona, janë të pakta.

Fletët e para të kodikut janë zhdukur dhe nuk dihet sa kanë qenë. Dëmi më i madh i këtij dorëshkrimi rezulton ndërmjet fletëve 97-138. Këto fletë janë krejt fragmentare, saqë prej tyre nuk mund të lexohet gjë e saktë.

Në këtë dorëshkrim ruhet vetëm kapaku i poshtëm, që është prej lëkure dhe i presuar me linja me zburime.

**KODIKU I 83-TË, I SHKODRËS**

(JETË SHENJTORËSH, NË GJUHËN LATINE)

Përmasat: 20 x 13.6 cm.

Sasia e fletëve: 175.

Teksti: Në një kolonë dhe është shkruar në ngjyrë kafe të errët. Një pjesë e tekstit, shkruar në dy kolona, është në ngjyrë të errët.

Sipas një shënimi, shkruar në kohëra të vona, pa nënshkrim, kodiku datohet i vitit 1341. Në këtë shënim është dhënë titulli i kodikut në gjuhë latine.

Për autorin e veprës, sipas shënimit të vonë në gjuhën shqipe, thuhet: "Autori i veprës nuk dihet, por ka të ngjarë të jetë e Shën Agustinit".

Titujt e tekstit janë në ngjyrë të kuqe, kurse grafia është e shkruar me majë pene të gjerë.

Kapakët: Prej kartoni dhe lidhja është veshur me lëkurë.

Kodiku është sjellë në Arkivin Qendror Shtetëror prej Bibliotekës Kombëtare.

165

## **KODIKU I 84-T, I VOSKOPOJËS**

(EKSODISTIKON - LIBËR SHËRBESASH NË VDEKJEN E JERARKËVE)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 32 x 22 cm.

Sasia e fletëve: 24.

Kapakët: Prej dërrase, të veshur me lëkurë, të stolitur me motive të presuara prej linjash me forma të stilizuara.

Kodiku përmban lutje që lexohen gjatë shërbesës së varrimit të jerarkëve (klerikëve të lartë) në kisha.

Grafia: E shekullit të 18-të, në ngjyrë të zezë. Titujt dhe shumë iniciale janë të rëndomta, me ngjyrë të kuqe. Shkrimi është në një kolonë.

Në fund të fletës 24 ruhet mbishkrimi që pason në gjuhën greke: "U shkrua ky eksodhistikon me dorën e më të voglit ndër meshtarë, të priftit Nikollë, në Voskopojë, në lagjen e Shën Thanasit, dhe iu dhurua meshtarëve (të kishës) së Shën Mërisë, në lagjen Saraçan të Voskopojës, më 1738".

Kodiku në fjalë stoliset me vinjeta në formën e germës „p“-pi greke. Këto janë të mbushura me motive floreale të stlizuara. Kodiku stoliset gjithashtu dhe me iniciale të mëdha të pikturuara me motive prej gjarpërinjsh, si dhe me motive kuçedrash dhe më rrallë me motive shpezësh. Në këto piktura mbizotëron ngjyra e gjelbër dhe bluja. Ka dhe të tilla që trupin e kanë të stolitur me ar; këto nuk kanë ndonjë vlerë artistike.

## **KODIKU I 85-TË, I KORÇËS**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: pergamenë.

Përmasat: 21. 2 x 15.5 cm.

Sasia e fletëve: 221.

Teksti: Në njëshkolonë.

Sasia e rreshtave për kolonë: 26.

Gjendja e kodikut: Fleta e parë është grisur dhe marrë. Fleta e parë që ruhet fillon me vargun (në tekst: „st“, „stihun“) 17 të kreut të parë, me fjalët e fundit të këtij stihu. Ungjilli sipas Mateut është në fletët 1-58. Në gjysmën e fletës 58 verso fillon përmbajtja e perikopeve të Ungjillit sipas Markut, që vazhdon deri në fletën 59 verso. Fleta 6 verso ruan figurën e ungjillorit Luka. Ungjilli sipas Lukës fillon në fletën 61 dhe mbaron në fletën 98 verso. Po në këtë fletë, verso, fillon përmbajtja e perikopeve të Ungjillit sipas Lukës, deri në fletën 99 verso. Në fletën 100

fillon Ungjilli sipas Lukës, deri në fletën 165 recto. Kurse në të njëjtën fletë verso fillojnë perikopetë e Ungjillit sipas Gjonit. Ungjilli sipas Gjonit fillon në fletën 166 dhe mbaron në fletën 221.

Dëmtime: Ndërmjet fletëve 99 dhe 100 është shqitur një fletë. Në këtë fletë duket se ka qenë figura e Lukës. Ndërmjet fletëve 165 e 166 duket gjithashtu një fragment i vogël i fletës prej letre me pak ngjyrë të kuqe, që është këputur e hequr. Kjo tregon se aty ka qenë figura e ungjillorit Gjon, kurse ajo e Mateut është shqitur me gjithë fletën fillestare të tekstit të këtij ungjillori. Fleta 161 ka tri të grisura, por këto janë qepur me fije në ditët tona. Prej fletës 201 deri në fund të kodikut, në pjesën e sipërme, fillon një ngjyrë e kuqe e përhapur nga lagështira që duhet të ketë vepruar, e cila në vazhdim të fletës zmadhohet deri në fund të kodikut. Fletët 211 e 212 janë skuqur aq shumë, saqë kjo ka dëmtuar shumë tekstin, kurse disa nga fletët në vijim kanë mbetur në fragment dhe të dëmtuara krejt.

Duke u mbështetur në grafinë e këtij kodiku, dorëshkrimi duhet t'i atribuohet shekullit të 14-të.

## **KODIKU I 86-TË, I ELBASANIT**

(NOMOKANON)

Materiali: Letër.

Përmasat: 20 x 14.8 cm.

Sasia e fletëve: 185.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë. Titujt dhe inicialet janë në ngjyrë të kuqe. Inicialet janë të vizatuara me motive të ndryshme dhe me format të madh.

Gjendja e kodikut: Kodiku nuk ka kapakë. Fleta 1 ka dy copa të vogla të shkëputura e të humbura. Fletët e para janë shkëputur nga lidhja. Kodiku nuk i ka fletët e fundit. Teksti ruhet deri në fletën 185. Kanë humbur shumë pjesë teksti me fletët e munguara të kodikut.

Këtu po vemë në dukje disa nga titujt që trajtojnë çështje që përmban kodiku, si pason:

Fletët 1-3 përmbajnë çështjen mbi gjykatësit, mbi ligjet dhe mbi drejtësinë.

Fletët 6, 7, 8, 10, 11-16 dhe 30: Mbi jerarkët klerikë, mbi detyrat, të drejtat dhe gabimet e tyre.

Fletët 31-36, 39, 41, 44-46, 48, 51-56, 57-60, 109: Çështje të ndryshme të shërbimit dhe të jetës klerikale.

Fletët 113-139: Në lidhje me pagëzimin.

Fleta 140-144: Rreth fejesave. Djali duhet të jetë i moshës 14 vjeç e lart dhe vajza prej moshës 12-vjeçare e lart. Djalit që është fejuar me një vajzë dhe vdes pa e takuar të fejuarën, i vëllai mund t'ia marrë të fejuarën për grua.

Në vijim shtjellohet se prej ç'shkaqesh ndahet fejesa.

1. Të fejuarit ndahen nëse, sipas ligjit, nuk kanë moshën për fejesë. 2. Nëse njëri nga të fejuarit kapet në shtrat me një njeri tjetër. 3. Të fejuarit ndahen kur janë nga fe të ndryshme. 4. Nëse konstatohet që të fejuarit nuk e duan njëri-tjetrin dhe prindërit i kanë fejuar pa dëshirën e tyre. 5. Fejesa prishet nëse njëri prej tyre vendos të bëhet murg.

Më tej flitet për shkallët (e trashëgimisë, të lidhjes në gjak) dhe martesat.

Autori i këtij nomokanoni vëllezërit prej një babe e një nëne i quan të shkallës së parë. Vëllezërit prej një nëne dhe prej dy baballarësh, ose prej një babe dhe prej dy nënash; i quan të shkallës së dytë; kurse fëmijët e vëllezërve, që quhen kushërinj të parë, janë të shkallës së katërt. Kur lindin kushërinjtë e dytë fëmijë, të cilët në mes të tyre janë kushërinj të tretë, lidhja në mes tyre është e shkallës së tetë.

Fleta 147: Mbi kushërinjtë. 1. Kushërinj nga gjaku, 2. Kushërinj nga krushqia, 3. Kushërinj nga vjehrra, 4. Kushërinj nga pagëzimi, 5. Kushërinj nga adoptimi.

Fleta 148: Ndërmjet kushërinjve të shkallës së shtatë dhe të tetë kurrë të mos bëhet bashkimi-martesa.

Vijon me pjesë tjetër të nomokanonit.

Kush quhet ungj?

Mbi adoptimin dhe pagëzimin.

Çështje të ndryshme të martesës, të bashkëshortëve, që janë të zakonshme.

Çështje testamentesh; në disa raste jo shumë të qarta.

Prapë mbi testamentet.

Mbi kujdestarët e fëmijëve që nuk janë në moshë (të rritur).

Në faqen e parë verso ruhet një mbishkrim në të cilin lexojmë: “U shkrua në kohën e hirësisë së mitropolitit dhe ekzarkut të gjithë .... (e palexueshme) Joasafit ... të miqve dhe të meshtarëve të nderuar .. me mbiemrin e tij Makri, kurse atdheu im i mbidheshëm (është) Zaqinhi (?). (Shkruar) prej mej meje, më të voglit dhe më të vobegtit, Emanuel, biri i dobët i ish-ekonomit të kishës mitropolitane të skelës së Shën Mitrit. Në vitin 7071 prej krijimit të botës dhe prej lindjes së zotit tonë Jezu Krishtit në vitin 1562, mars 5”.

Nga ky mbishkrim del se kodiku në fjalë mund të jetë me origjinë nga Greqia.

## **KODIKU I 87-TË, I ELBASANIT**

(ΟΚΤΟΙΗ)

Materiali: Letër.

Përmasat: 20.3 x 15 cm.

Sasia e fletëve: 168 fletë.

Grafia: Si e notave, dhe e tekstit, është me shkrim kaligrafik të dorës së parë. Notat janë në ngjyrë të zezë, grafia e tekstit në ngjyrë kafe të çelët. Titujt e këngëve janë shkruar në ngjyrë të kuqe dhe shenjat theksuese (pikëzimet) të notave janë të kuqe.

Kapakët: Prej dërrase të veshur me lëkurë, të stolitur me zbukurime floreale, motive të stilizuara, realizuar me relief me anë të presimit.

Datimi i këtij dekori mund të bëhet me përafri, duke e krahasuar me dekoret e kësaj gjinie arti në kodikët e tjerë. Ka të ngjarë që kapakët prej lëkure të këtij kodiku të jenë të ndonjë libri më të vjetër. Kapakët e kodikut janë grisur e dëmtuar aty ku lidhen me fletët.

Ky kodik përmban poezi të ndryshme kishtarë bizantine, të anotuara, që këndohen në kishë gjatë gjithë vitit në shërbimet e kultit të ritualit Lindor.

Kodiku fillon me psalmin e parë të Davidit, i cili është vënë në nota. Nga fleta 11 fillojnë këngët e quajtura “Zbritësore”, kompozuar në nota. Këto janë këngë të festave të mëdha që festohen gjatë vitit, si zbritësoret e Krishtlindjes, të Pashkës etj. Prej fletës 42 fillojnë poezitë e “javës së madhe”. Këtu vërehen poezi që përdoren në shërbimet e kultit, por me interes është fakti që në shumë prej tyre figuron dhe emri i autorit:

Në fletën 97 është himni kerubik me autor Vasil Stefanin e Bizantit.

Në fletën 105, në disa poezi të shërbesës së mëngjesit, përmendet si autor “kir Petri”-zoti Pjetër. Po ky autor përmendet në fletën 112, ku ka dhënë doksologjinë, duke e shenjuar të plotë emrin e tij, Pjetër Lambadari.

Në fletën 116 verso, gjithashtu, doksologjia është kompozuar nga Pjetër Lambadari.

Në fletën 124 poezia është e Petro Bizantinit, po ashtu dhe ajo në fletën 129. Kurse muzika e fletës 147 është e “kir Kirillit”-zotit Ciril, peshkop në një ujdhesë greke. Ndër kompozitorët përmendet dhe zoti Meleti, si dhe Daniel protopsalti i Kishës së Madhe (është Kisha e Shën Sofisë në Kostandinopojë).

Autori që ka shkruar këtë kodik, duke e plotësuar dhe me kompozime të të tjerëve, përmendet në mbishkrimin që është brenda vinjetës në formën e germës “ϣ”-pi greke - si pason: “Ky libër u konceptua prej kryepsaltit të Kishës së Madhe të Krishtit, në kohën kur ishte patrik zoti Grigor Peloponezioti, me ndihmën e tij, më 1810”.

Kodiku në fjalë me muzikë bizantine, ndonëse nuk është shkruar e kompozuar në vendin tonë, ka vlerën e vet për arsye se njerëzit tanë gjithashtu kanë kompozuar muzikë bizantine kishtare, e cila mund të krahasohet me kompozime të këtij kodiku dhe të nxirren përfundime interesante, për të mos përmendur muzikantin tonë të famshëm, Jan Kuzelin nga Durrësi, që njihet ndër më të mëdhenjtë kompozitorë të muzikës bizantine në përgjithësi.

Jam i mendimit që kodiku ka nevojë për riparimin e kapakëve, duke i lidhur mirë me tekstin, që të mos pësojë dëmtime.

Fleta e frontespicit, që përmban titullin e librit, vendin e shkrimit e të tjera, nuk i përket këtij kodiku. Ky dorëshkrim fillon me fletën 1, që përmban vinjetën në formë të germës “ϣ” (pi greke), me motivet e thurjes së shiritave të kuq, të bardhë e të verdhë, brenda së cilës qëndron shënimi i dhënë më sipër.

## **KODIKU I 88-TË, I BERATIT**

(PERIKOPE UNGJËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 25 x 19.3 cm.

Sasia e fletëve: Ruhen vetëm 93 fletë.

Përmasat: 25 x 19.3 cm.

Teksti: Në dy kolona, me 22 rreshta për kolonë, me grafi të tipit të vonë, por me vlerë bukurshkimore, me ngjyra me vlerë artistike, shkruar me ngjyrë kafe, kurse inicialet janë të mëdha e në ngjyrë të kuqe, ndonjë i rrallë i stolisur (fleta 34 verso). Gjithashtu titujt e perikopeve janë me shkronja të kuqe.

Kodiku ka pësuar shumë dëme, si vijon: Fleta e parë numerike fillon me stihun (vargun) 43 të kreut 1 të Ungjillit sipas Lukës, me fjalët: “... Dhe nga më ngjau kjo, që të vijë e ëma tim zot tek mua...”, që do të thotë se kodikut i mungojnë shumë fletë fillestare. Në fletën e fundit teksti mbaron me stihun (vargun) 20 të kreut të fundit të Ungjillit sipas Mateut. Kjo tregon se kodiku nuk l ka as fletët e fundit, se kodikut i kanë zhdukur dhe shumë perikope nga ungjijtë e tjerë.

Veç këtyre dëmeve, nga fleta 1-8 materiali është i brejtur nga insektet, që kanë dëmtuar ngapak rreshtat e kolonave nga fundi.

Kodikut i kanë prerë në disa vende pjesë pergamene, duke mos dëmtuar tekstin.

Fletës së parë, në dy faqet, kolonat e tekstit i janë zbehur shumë. Në disa rreshta nuk duket asnjë fjalë. Prej fletës 39 deri në fletën 43 cepi i poshtëm i pergamenës është ngrënë nga mola, ku më shumë e ku më pak, duke mos prekur tekstin.

Fletët 53 e 54 janë kalbur nga lagështia dhe në kolonat ka shumë pjesë të vogla me shkronja që kanë rënë dhe janë zhdukur.

Disa nga fashikujt janë zgjidhur nga vëllimi, prandaj këto duhet të restaurohen me këtë rast.

Kodikut duhet të pajiset me kapakë për t’u siguruar.

Në faqen 28 kodiku ruan një vinjetë në ngjyrë të gjelbër, të kuqe e kafe të errët. Ky dekor nuk paraqet ndonjë finesë. Kodiku ruan dhe disa inicialet të vizatuara, të cilat janë arrirë pak a shumë në mënyrë artistike, ndonëse nuk krahasohen me dekoret elegante të kodikëve të shekullit të 10-të, të 11-të, të 12-të etj., sepse këto të fundit qëndrojnë shumë lart nga ana artistike.

Duke u mbështetur në grafinë e tipit të vonë, si dhe në konsideratat për dekoret pa shumë art, mendojmë se kodikun në fjalë duhet t’ia atribuojmë afërsisht fundit të shekullit të 14-të.



## KODIKU I 89-TË, I BERATIT

(PERIKOPE UNGJIJSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat e fletëve: 25.5 x 21 cm.

Sasia e fletëve: 52 fletë.

Teksti: Në dy kolona, me 20-21 rreshta për kolonë, me grafi të tipit të vonë, por cilësore, artistike, në ngjyrë kafe. Titujt dhe inicialet janë prej ari, por jo të stolisur.

Kodikun stolisur vetëm me një vinjetë në formë shiriti, që ngjan me germën **p**-pi greke - me lule të stilizuara, trashëguar nga dekoret e kodikëve të shekullit të 11-të, por pa finesën e tyre dhe në format më të madh, pikturuar brenda dhe jashtë rrathëve të vegjël. Kjo vinjetë, ndonëse mjaft e zbetë, vlerësohet për ngjyrat e kultivuara mirë në vendet që janë ruajtur.

Kodikun e kemi gjetur të shpërndarë në fashikuj, në pjesë fashikujsh ose fletë të shkëputura. Këto, pasi i mblohdhëm, i sistemua në një radhë, thuajse të rregullt, sepse kodiku ka humbur shumë perikope ose pjesë perikopesh, kështu që nuk mund të arrihej një sistemim plotësisht i rregullt. Fakti që kodiku ruan vetëm 52 fletë, tregon se nuk mund të ketë një sistemim të perikopeve sipas rregullit që kanë pasur kur u riprodhua në fillim. Pra, kodiku në fjalë përbëhet prej disa fashikujsh të shkëputur, dhe jo vetëm që nuk i ruan të gjitha perikopetë, por, dhe disa prej atyre që ruhen, nuk janë të plota, ose kanë mbetur në fragmente.

Ky kodik ka dhe të meta të tjera. Fleta 1 ka të ngrënë një pjesë pergameni anash. Teksti i kolonës së djathtë është zhdukur krejt. Kolona tjetër është me tekst të dëmtuar nga të fshirët dhe vinjeta ka pësuar mjaft në fshirjen e ngjyrave, kurse faqja rekto është shumë e ndotur. Faqja verso ruan tekstin me disa shkronja të fshira në fillim të çdo rreshti të kolonës së majtë. Fletët 2 e 3 janë prerë në mënyrë horizontale, në pjesën e sipërme dhe të poshtme, duke ruajtur pjesë teksti nga mezi i fletëve, që kanë mbetur fragmentare. Këto fragmente teksti kanë të ruajtura pjesë të perikopesë. Fleta 6, në faqen recto, e ka shumë të zbetë tekstin, kurse fletët e tjera e kanë të ruajtur. Grafia, si rregull, është e pastër dhe me vlera artistike. Për të dhënë të plotë përmbajtjen, cilën perikope përmban çdo fletë, po i radhisim këtu më poshtë. Dhënia e perikopeve sipas autorit dhe sipas kreut të stihut të tekstit, deri në cilin stih ruhet, jep përmbajtjen e plotë të këtij kodiku të dëmtuar rëndë.

Fleta 1 e kodikut përmban tekstin deri në gjysmën e stihut 14 të kreut 1 të Ungjillit sipas Gjonit.

Fletët 2 e 3 ruajnë fragmente të kreut 2 të Ungjillit sipas Gjonit, vargjet (stihët) 1-11.

Fleta 3: prej kreut 3, vargu 16 deri kreu 3 vargu 20, tekst fragmentar.

Fleta 4: prej kreut 6 të Ungjillit sipas Gjonit, vargu 14, deri kreu 6 vargu 7.

Fleta 5 përmban perikopenë nga Ungjilli sipas Markut, prej kreut 15, vargu 43, deri kreu 16, vargu 8.

Fleta 6 verso, kolona e djathtë, ka perikope të Ungjillit sipas Gjonit prej kreut 4, vargu 49, deri kreu 4, vargu 54.

Fleta 6 verso ka perikopenë e Ungjillit sipas Gjonit, kreu 6, vargu 27, deri kreu 6, vargu 33.

Fleta 8 recto: idem, prej kreut 6, vargu 48, deri kreu 6, vargu 39.

Fleta 8 verso: idem, prej kreut 6, vargu 40, deri kreu 6, vargu 44.

Fleta 9: idem, prej kreut 6, vargu 48, deri kreu 6, vargu 54.

Fleta 11 recto: idem, kreu 5, vargu 2, deri kreu 6, vargu 11.

Fleta 12 recto: idem, kreu 9, vargu 1, deri kreu 9, vargu 38.

Fleta 15 recto: idem, kreu 11, vargu 47, deri kreu 11, vargu 54.

Fleta 16 recto: idem, kreu 12, vargu 19, deri kreu 12, vargu 36.

Fleta 17 verso: idem, kreu 12, vargu 36, deri kreu 12, vargu 47.

Fleta 18 verso: perikope të Ungjillit sipas Markut, prej kreut 16, vargu 9, deri kreu 16, vargu 20.

Fleta 20: perikope të Ungjillit sipas Gjonit, prej kreut 3, vargu 26, deri te vargu 33.

- Fleta 20 verso: idem, kreu 20, vargu 19, deri vargu 20.  
 Fleta 21 recto: idem, kreu 5, vargu 28, deri kreu 5, vargu 30.  
 Fleta 21 recto: idem, kreu 5, vargu 30, deri kreu 6, vargu 3.  
 Fleta 23 recto: idem, kreu 2, vargu 16, deri kreu 2, vargu 22.  
 Fleta 23 verso: idem, kreu 3, vargu 22, deri vargu 26.  
 Fleta 24 recto: idem, kreu 5, vargu 13, deri kreu 5, vargu 16.  
 Fleta 24: idem, kreu 6, vargu 54, deri kreu 6, vargu 69.  
 Fleta 25 recto: idem, prej kreut 7, vargu 1, deri kreu 7, vargu 13.  
 Fleta 26 verso: idem, kreu 7, vargu 14.  
 Fleta 28 recto: idem, prej kreut 7, vargu 38, deri kreu 7, vargu 52.  
 Fleta 29 verso: perikope të Ungjillit sipas Mateut, prej kreut 18, vargu 10, deri në kreun 18, vargu 14.  
 Fleta 30 recto: perikope të Ungjillit sipas Gjonit, prej kreu 8, vargu 12, deri kreu 8, vargu 31.  
 Fleta 30 verso: idem, prej kreut 8, vargu 20, deri në vargun 30.  
 Fleta 31 verso: idem, kreu 8, vargu 31, deri në kreun 8, vargu 42.  
 Fleta 32 verso: idem, prej kreut 4, vargu 5, deri në kreun 4, vargu 17.  
 Fleta 34 recto: idem, prej kreut 20, vargu 21, deri vargu 24.  
 Fleta 35 recto: idem, prej kreut 5, vargu 19, deri kreu 5, vargu 24.  
 Fleta 35 verso: idem, prej kreut 5, vargu 24, deri në vargun 27.  
 Fleta 36 recto: idem, prej kreut 19, vargu 25, deri në kreun 21, vargjet 24-25.  
 Fleta 36 verso: idem, kreu 15, vargu 9.  
 Fleta 36 verso: idem, kreu 15, deri vargu 10.  
 Fleta 37: perikope të Ungjillit sipas Lukës, prej kreut 1, vargu 63, deri në vargun 80.  
 Fleta 38 verso: perikope të Ungjillit sipas Mateut, prej kreut 16, deri në vargun 19 të të njëjtit krye.  
 Fleta 39 verso: perikope të Ungjillit sipas Gjonit, prej kreut 17, vargu 11.  
 Fleta 40 verso: idem, deri në kreun 17, vargu 24.  
 Fleta 41 recto: perikope të Ungjillit sipas Mateut, prej kreut 27, vargu 27, deri në kreun 27, vargu 32.  
 Fleta 42: idem, prej kreut 17, vargu 1, deri kreu 17, vargu 8.  
 Fleta 43 recto: idem, kreu 17, vargu 1, deri në kreun 17, vargu 9.  
 Fleta 44 recto: idem, kreu 14, vargu 1, deri në kreun 14, vargu 13.  
 Fleta 45 recto: perikope të Ungjillit sipas Markut, kreu 6, deri vargu 21.  
 Fleta 46 verso: perikope të Ungjillit sipas Lukës, prej kreut 2, vargu 22, deri kreu 2, vargu 40.  
 Fleta 48 recto: perikope të Ungjillit sipas Gjonit, prej kreut 12, vargu 24, deri në kreun 12, vargu 36.  
 Fleta 49 verso: perikope të Ungjillit sipas Mateut, kreu 20, vargu 1, deri kreu 20, vargu 16.  
 Fleta 51 recto: perikope të Ungjillit sipas Lukës, prej kreut 1, vargu 24, deri kreu 2, vargu 41.  
 Fleta 48 verso: perikope të Ungjillit sipas Mateut, prej kreut 11, vargu 2, deri kreu 11, vargu 15.  
 Fleta 53 recto: idem, kreu 4, vargu 25, deri kreu 5, vargu 12.
- Në perikopenë që gjendet në fletën me numër rendor 42 kopjuesi anonim, me sa del nga krahasimi, ka pasur tekstin e Ungjillit sipas Lukës dhe e ka quajtur të Mateut. Me këtë rast mund të themi se kopjuesi ka shumë moskorrektesë dhe bën ndryshime, duke mos e pasur me kujdes kopjimin e përpiktë të origjinalit. Kjo vërejtje është për perikopenë e Ungjillit sipas Mateut, që gjendet në fletën 42.
- Duke u mbështetur në grafinë e këtij kodiku të fragmentuar, ky duhet t'i atribuohet dekadave të fundit të shekullit të 14-të.

**KODIKU I 90-TË, I BERATIT**

(LETËRSI UNGJILLORE, "UNGJIJTË E MËNGJESORES")

Materiali: Letër.

Përmasat: 15 x 10 cm.

Sasia e fletëve: 106.

Kapakët: Prej dërrase, veshur me lëkurë. Kapaku i poshtëm ka mjaft të brejtura nga insektet.

Janë gjithsej 11 në numër; pjesë të vëna në muzikë, me nota bizantine. Këndohen në kisha, në meshat e të dielave, siç këndohen dhe të tjera poezi të llojit oktoih.

Prej fletës 1 deri në fletën 53 katër rreshtat e fundit kanë pësuar një ndotje, por duke mos i dëmtuar tekstin dhe notat. Titulli i kodikut në fletën e parë zbukurohet me një vinjetë të zbehtë, në formë katërkëndore, në ngjyrë të kuqe, si dhe titulli i librit, i cili është i palexueshëm. Gjithashtu në kapakun e sipërm, në faqen verso, është një mbishkrim i zbehtë i palexueshëm. Grafia e tekstit dhe e notave: Në ngjyrë të zezë, me inicialet dhe thekse (pikëzime) të kuqe. Tekstit me shumë vështirësi mund t'i lexohen disa fjalë, veç të tjerash sepse është i ndarë në rrokje sipas notave dhe është i shkruar me forma jo të plota të germave. Nga këto partitura muzikore, disa quhen "të Grigorit": në fletën 2 recto dhe fletët 93 e 97.

Datimi, ndonëse është i vështirë, për arsye se format e shkronjave nuk janë të plota, me përafërsi mund t'i atribuohet fundit të shekullit të 17-të dhe viteve të para të shekullit të 18-të.

**KODIKU I 91-TË, I BERATIT**

(HRISTOIDHIA: ZAKONE TË MIRA - LETËRSI UNGJILLORE-MORALE)

Materiali: Letër.

Përmasat: 29 x 24 cm.

Sasia e fletëve: 84.

Në fillim kodiku përmban një shënim me përmbajtjen që pason: "Letër nga i shumëpërendidashuri, peshkopi ... zoti Maksim". Në fund të kësaj letre ruhet ky shënim tjetër: "U shkrua kjo kristoidhi me dorën e Joasafit të Beratit, më 1756, në shtator, datë 4".

Në fletën 69, Joasafi, peshkopi i Beratit, ka shkruar një shënim, ku thotë: "Kristoidhia është përkthyer nga gjuha latine në gjuhë greke nga i dituri, i rëndësishmi, i shkëlqyeri Andon Bizantini, profesor në shkollën e Kostandinit".

Kopjimi i hristoidhisë është shkruar nga Joasafi i Beratit, kurse parathënia e saj duhet të jetë punë e Joasafit, peshkop i Beratit, nga burime epigrafike të monumenteve të Myzeqesë, e disa me origjinë nga fshati Bubullimë i Myzeqesë.

Ky kodik ka një përmbajtje të lartë morale dhe Joasafi tregon një figurë intelektual të shëndoshë në shekullin e 18-të.

**KODIKU I 92-TË, I KORÇËS**

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 19.5 x 13.3 cm.

Sasia e fletëve: 420.

Teksti: Në një kolonë, me 17 rreshta për kolonë.

Grafia: Me fjalë të pandara, me shkronja të tipit të mesëm, në ngjyrë të kuqe.

Titulli fillestar i çdo ungjilli është me shkronja kapitale, ari, shkruar në mënyrë kaligrafike të theksuar.

Përveç grafisë artistike me vlera të theksuara të titujve të çdo ungjilli, si dhe të inicialeve të mëdha, kodiku stoliset dhe me katër vinjeta të bukura në formë katërkëndore. E para është në fletën 10: fillimi i Ungjillit sipas Mateut. E dyta është në faqen 130, ku fillon Ungjilli sipas Markut. E treta gjendet në faqen 210, ku fillon Ungjilli sipas Lukës dhe e katërta në faqen 340, ku është fillimi i Ungjillit të Gjonit. Veç këtyre, kodiku stoliset dhe me katër vinjeta të vogla mbi listën e krerëve të çdo ungjilli. Vinjeta e vogël e Ungjillit sipas Mateut ruhet në faqen 6 recto. Gjithashtu, kodiku stoliset dhe me 11 copë vinjeta të stolisura në ndarjen e tyre me shirita të ngushtë të gërshetuar me një linjëzë të kuqe. Këto janë pikturuar në faqet e fletëve, prej 1-5. E njëmbëdhjeta është në faqen 6 recto.

Katër fashikujt e parë janë shkëputur nga lidhja, si dhe fashikulli i fundit.

Duke u mbështetur në grafinë e kodikut, ky vëllim duhet t'i atribuohet dekadave të fundit të shekullit të 13-të dhe fillimit të shekullit të 14-të.

## KODIKU I 93-TË, I KORÇËS

(KATËRUNGJILLËSH)

Materiali: Pergamenë.

Përmasat: 15.3 x 12 cm.

Sasia e fletëve: 309.

Forma e tekstit: Rreshtat e shkrimit janë radhitur në formë kryqi deri në fletën 281.

Prej fletës 282 teksti është në një kolonë, deri në fletën e fundit, 308.

Grafia: E tipit të mesëm dhe në ngjyrë kafe.

Titujt e perikopeve janë mbi faqen ku fillon perikopeja. Inicialet e çdo ungjilli, gjithashtu, janë në ngjyrë ari, por të pikturuara dhe në format të madh.

Stolisja e kodikut: Përveç që kodiku në fjalë stoliset me grafinë e tij bukurshkrimore, me titujt kryesorë të çdo ungjilli me shkronja kapitale ari, si dhe me titujt e perikopeve, dekoracioni kryesor i tij qëndron në katër figurat e ungjillorëve, të pikturuara në faqen para faqes fillestare të çdo ungjilli. Secila figurë ungjillori është kompozuar në një mjedis shkrimtari mesjetar, ndenjtur mbi frone me mbështetëse të lartë ose të ulët, me ungjillin të hapur në pëqi, para tyre së shkrimit, e cila mban orenditë e shkrimit, si dhe të një pulti, që mban ungjillin e ungjillorit me faqe të shkruara. Kompozimi i tyre thuhet është krejt i njëjtë, por me gjeste e lëvizje natyrore të ndryshme. Mateu është i ulur, si dhe të tjerët, por me dorën në mjekër dhe i menduar. Marku është dhënë ndenjtur, duke mbajtur ungjillin me të djathtën, Luka me kallamin e shkrimit në dorë, kurse Gjoni duke vështruar segmentin qiellor të hapur dhe duke e treguar atë me gishtin e së djathtës. Vetëm Gjoni e Luka, fronet mbi të cilët janë ulur i kanë me mbështetëse të ulët e të kuqe, kurse Mateu dhe Marku kanë ndenjtur mbi frone me mbështetëse të lartë, por të harkuar nga sipër e me mbështetëse.

Të gjitha figurat janë modeluar me plastikë të mirë dhe pjesët e trupit janë trajtuar në mënyrë reale, si dhe modelimi i portreteve: Mateu stoliset me një hiton të gjerë prej palash natyrore, ngjyrë violetë të çelët gracioze. Përdorimi i ngjyrave është arritur me shkallëzim, duke i vënë mirë në dukje format e trupit. Kjo plastikë mjaft reale bie në sy dhe në modelimin e portreteve, të duarve e të këmbëve në mënyrë reale në të gjitha figurat.

Këto figura të bukura evidentohen mirë mbi sfondin prej ari të ndritshëm, duke e vënë në dukje mjaft mirë talentin e këtij piktori tonë anonim. Ndonëse trajtimi i këtyre figurave është arritur me vlerë të lartë artistike, në atë të Mateut dhe atë të Lukës nuk është arritur në tërësi harmonizimi i ngjyrave në skenë, për arsye se fronet e tyre janë dhënë në ngjyrë të zezë, që stonon me ngjyrën violetë të hitonit dhe ngjyrën e artë të sfondit.

Përveç figurave dhe vinjetave, nuk janë pa vlerë artistike disa dekoracione të tjera prej lulesh të ndryshme të stilizuara, të cilat, megjithatë, qëndrojnë larg nga ana artistike në krahasim me vinjetat e kodikëve të shekujve të 11-të dhe të 12-të.

Na rezulton se mosha e kodikut duhet t'i atribuohet fillimit të shekullit të 12-të ose dekadave të para të po këtij shekulli.

## **KODIKU I 94-T, I KORÇËS**

(TEOLOGJI, MENDJA E TË URTIT DHE FLOKËGJATIT GJON PAGËZORI -NË TEKST: JOAN BAPTISTI)

Materiali: Letër e hollë.

Përmasat: 16 x 11.1 cm.

Sasia e fletëve të shkruara: 94.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë, por me shkronja të imëta e shumë të holla, me tituj dhe iniciale në ngjyrë të kuqe, në një kolonë, me 22 rreshta për kolonë.

Gjendja e kodikut: Kapakët janë prej kartoni, të veshur me lëkurë, e cila është stolitur me një bordurë të presuar, në formë zigzagu, shoqëruar prej një linje ari të ndritshëm. Fashikujt janë lidhur me mjeshtëri, në pjesën e sipërme tek lidhja është grisur pak lëkura. Në përgjithësi kodiku ruhet në gjendje fare të mirë.

Ky kodik përmban çështje filozofike morale, të ndara këto në 19 krerë, të cilët po i radhisim këtu më poshtë:

Kreu 1: Diferencimi i të urtit ose i të diturit.

Kreu 2: Çfarë mendimi ka i dituri dhe i urti (i mençuri), mbi të qenit e Perëndisë.

Kreu 3: Çfarë mendimi ka i dituri mbi fenë.

Kreu 4: Çfarë mendimi ka i dituri mbi pavdekshmërinë.

Kreu 5: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi lirinë.

Kreu 6: Çfarë mendimi ka i dituri mbi njeriun e mirë.

Kreu 7: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi njeriun e mirë.

Kreu 8: Çfarë mendimi ka i dituri mbi të mirën.

Kreu 9: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi virtytet.

Kreu 10: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi njeriun e mirë.

Kreu 11: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi vetveten .

Kreu 12: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi veten.

Kreu 13: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi pikëpamjet e mendimet e të tjerëve.

Kreu 14: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi dashurinë ndaj të huajve.

Kreu 15: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi qëllimet e të tjerëve.

Kreu 16: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi pësime e njerëzve.

Kreu 17: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi ligjet e njerëzve.

Kreu 18: Çfarë pikëpamje ka i dituri mbi qeverimin e botës.

Kreu 19: Çfarë mendimi ka i dituri mbi jetën e vdekjen.

Duke u mbështetur mbi grafinë e vonë të kodikut, si dhe mbi stilin e gjuhës greke të periudhës së vonë, mendojmë që ky kodik nuk mund të jetë më i hershëm se mesi i shekullit të 18-të.

Vlera e kodikut në fjalë qëndron në faktin që dëshmon se intelektualët tanë të kësaj periudhe merreshin dhe me probleme filozofie, sepse ky kodik i përket kohës kur vepronte Akademia e re e Voskopojës.

**KODIKU I 95-TË, I TIRANËS**

(OKTOIH)

Përmasat: 19.2 x 14 cm.

Sasia e fletëve: 61.

Kodiku përmban poezi të quajtura *kinonika*, që njihet si e kompozitorit Pjetër Peleponeziotit. Në fletën 9 verso thuhet se kompozimi është “i Joan Kladhës”, kryepsalt, kurse në fletën 10 verso fillon himni kerubik. Në fletën 10 verso fillojnë poezitë të quajtura „zbritësoret“, të zërit të katërt. Në fletën 19 verso fillojnë zbritësoret e zërit të parë. Në fletën 24 verso fillojnë zbritësoret e zërit të parë. Në fletën 27 verso fillojnë zbritësoret e zërit të katërt. Në fletën 32 recto fillon zëri i tërthorit të dytë. Në fletën 41 verso fillon zbritësorja e kryqit. Në fletën 44 verso poezia është e Joan Kladhës. Në fletën 45 verso poezia e meshës është “e Joanit të Embëglitë” (Joan Glikoi). Në fletën 47 fillon një poezi që këndohet të Dielën e Pashkës së Madhe.

Prej fletës 48 deri në fletën 67 ka tekste poezie në prozë, të pavëna në nota. Fleta 57 verso është vulosur me një vulë të vogël, në të cilën lexohet emri “Thoma” dhe data “1837”. Në këtë faqe verso fillon poezia “kinoniko” deri në faqen 58 verso. Në fletën 59 verso deri në fletën 60 recto ka një tjetër kinoniko, që shkon deri në fletën 61 recto.

Në faqen verso të kapakut të sipërm ruhet anëshkrimi si pason: “Është pronë e tempullit të ungjillëzimit në Tiranë, prill 1895, epitrop Zoraqi”.

Në fletën 61 ruhet ky mbishkrim i mëvonshëm: “Ky libër është me emrin e të voglit jeromonak Agathangjelit, që është në Tiranë. Ai që e gjen tek vjedhësit ka bekim të trefishtë. Jeromonak Agathangjeli nga Tirana. Më 1937 ka vdekur at Agathangjeli”.

Grafia i përket fillimit të shekullit të 19-të.

**KODIKU I 96-TË, I KORÇËS**

(LITURGJI)

Përmasat: 19.7 x 14.3 cm.

Sasia e fletëve: 33.

Kodiku, deri në fletën 6 recto, përmban lutje të mbrëmësore. Në fletën 7 fillon shërbesa e meshës, me lutjet që thotë meshari para se të fillojë mesha. Kjo vazhdon deri në fletën 13 recto dhe mbyllet në fletën 33 recto.

Kapakët e kodikut janë prej lëkure dhe brenda një katërkëndëshi kapaku i sipërm ka të presuar në relief shenjën „deizis“, ku përfytyrohen Shën Mëria dhe Gjon Pagëzori më këmbë, anash Krishtit të kryqëzuar. Në kapakun e poshtëm është dhënë një motiv prej linjash të kurbëta, brenda një katërkëndëshi të presuar.

Para se të fillojë teksti i meshës, janë lidhur 15 gjysma fletësh prej letre, me poezi kishtare. Kjo pjesë është shumë e dëmtuar. Kurse në fund të tekstit liturgjik vazhdojnë përsëri të tilla fletë me tekst, si dhe ato para tekstit liturgjik, edhe këto shumë të dëmtuara.

Fashikujt e kodikut thuajse janë të shkëputur krejt nga lidhja. Fleta 31 është e grisur në mes horizontalisht, por jo e shkëputur fare. Pas fletës së fundit me tekst, është një fletë që ka pësuar grisje pikërisht mbi një si mbishkrim, që sipër mban datën 1753 dhe fjalët: “Mikro Sarandari”, „Dhimas-Maria“.

Në fletën 6 verso është një figurë e Krishtit, pikturuar pa art. Në fletën 7 recto, anash titullit me shkronja kapitale të kuqe, janë pikturuar lule të stilizuara me ngjyra të rënda: të gjelbër, blu e të kuqe.

Grafia është në ngjyrë të zezë, inicialet të kuqe, të tipit të shekujve të 16-të dhe 17-të.

## KODIKU I 97-TË, I GJIROKASTRËS

(NOMOKANON)

Përmasat: 19.2 x 14 cm.

Sasia e fletëve: Parathënia dhe titujt e përmbajtjes janë deri në fletën 19, kurse teksti që përmban ligjet ka 296 fletë, gjithsej fletë 315.

Kapakët: Prej kartoni, veshur me lëkurë.

Grafia: E tipit të vonë, në ngjyrë të zezë, titujt në ngjyrë të kuqe.

Në fund të parathënies, faqja 13, ruhet data: viti 1562.

Kodiku ruhet në gjendje të mirë, vetëm se fletët 252-256 janë të shkëputura nga lidhja.

Titujt e parë flasin për gjykatësin, se si ai duhet të jetë i drejtë dhe me sjellje të tillë që të simpatizohet prej të gjithë njerëzve. Shkruhet mbi drejtësinë dhe se si gjykatësi duhet të jetë i drejtë. Shkruhet mbi ligjet: ç'janë e drejta dhe ç'është paligjësia. Shkruhet mbi zakone të popullit, që nuk janë të shkruara. Shkruhet mbi patrikun si kryetar i përgjithshëm i kishës. Shkruhet mbi hierarkët (peshkopët), detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe për klerikët e gradave më të ulëta, si priftërinjtë dhe dhjakonët, mbi detyrat e tyre. Shkruhet mbi klerikët dhe se kujt i përket t'i gjykojë, si dhe parapamjet e dënimeve që u jepen atyre që kanë shkelur ligjet. Këto jepen me hollësira për çdo klerik, i çdo grade që të jetë.

Pas këtyre shkruhet mbi të krishterët, detyrat që ata kanë kundrejt kishës, si pagëzimi, marrja pjesë në shërbimet fetare etj.

Nomokanoni përmban çështje rreth fejesave dhe martesave, prej cilës moshë mund të fejohen e të martohen të rinjtë. Gjithashtu jepen me hollësi shkallët e gjinisë që kanë njerëzit, në cilën shkallë gjinie djali dhe vajza mund të martohen.

Në nomokanon përfshihen dhe çështje rreth trashëgimisë e shumë të tjera.

Këto çështje dhe të tjera si këto i përmbajnë gati të gjithë nomokanonet e kishave të ritit lindor. Ajo që konsiderohet esenciale nga kisha gjendet në të gjitha nomokanonet që përmbahen në arkivin tonë. Ndryshimi në mes tyre qëndron në faktin se disa nomokanone janë më të vogla, më të shkurtëra në çështje, disa të tjera janë më të mëdha, duke trajtuar çështje edhe më të imëta, por janë përpjekur që t'i qëndrojnë frymës së kanoneve të quajtura "të apostujve" dhe të vendimeve të koncileve të njohura nga Kisha lindore.

Këto shërbejnë për të ditur se populli ynë, përveç kanoneve popullore, ka pasur dhe kanone kishtarë, të cilat shërbenin për të ruajtur traditat e tyre morale.

## KODIKU I 98-TË, I ARDENICËS<sup>1</sup>

(LETËRSI FETARE)

Kodiku në fjalë përbëhet prej fashikujsh katër, gjashtë ose tetëfletësh, prej pergamene, me dimension 14.2 cm gjatësi dhe 12.2 cm gjerësi. Ka mundësi që disa fashikuj të jenë përdorur për së dyti, pasi në fletën 6 duken në dritë disa beta dhe omega të mëdha.

Kodiku përmban letra të Pjetrit, Palit, Gjonit, Judës, që përfshihen në tekstin kanonik të Dhjatës së Re.

Në krye të çdo letre, kodiku ka një përmbledhje dhe koment të shkurtër prej një autori të panjohur që nuk përfshihet në tekstin kanonik të Dhjatës së Re.

Anash kodiku ka shënime që shërbejnë si një lloj treguesi për lëndën, burimin e citateve, rastet e përdorimit etj. Shënimet, po ashtu si dhe titujt e nëntitujt, janë të shkruara me bojë të kuqe, po kjo nuk është e detyrueshme. Shpesh boja është e njëjtë me atë të tekstit në përgjithësi.

1. *Pasaportat e kodikëve në vazhdim, janë përpiluar nga të tjerë autorë.*

Kodikut i mungojnë frontespici dhe faqet e para, si dhe faqet e fundit.

Përmbajtja e kodikut është si vijon:

Pjesa e fundit e letrës së Pjetrit, fletët 1-2.

Përmbajtja e letrës së parë të Gjonit (nuk përfshihet në tekstin kanonik të Dhjatës së Re).

Letra e parë e Gjonit.

Përmbajtja e letrës së dytë të Gjonit (nuk përfshihet në tekstin kanonik të Dhjatës së Re).

Letra e dytë e Gjonit.

Përmbajtja e letrës së dytë të Gjonit (nuk përfshihet).

Letra e tretë e Gjonit.

Përmbajtja e letrës së Judës (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e Judës.

Prologu i librit të Palit apostull (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Dëshmia (martirizimi) i Palit apostull (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Përmbajtja e letrës së parë drejtuar të krishterëve të Romës (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e parë e Palit drejtuar të krishterëve të Romës (mungon paragrafi 25 në fund).

Përmbajtja e letrës së parë të Palit drejtuar të krishterëve të Korinthit (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e parë e Palit drejtuar të krishterëve të Korinthit (paragrafi 25, 26, 27 dhe 28 janë prishur).

Përmbajtja e letrës së dytë të Palit drejtuar të krishterëve të Korinthit (nuk është në Dhjatën e Re).

Letra e dytë e Palit drejtuar të krishterëve të Korinthit.

Përmbajtja e letrës drejtuar të krishterëve të Galatës (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra drejtuar të krishterëve të Galatës.

Përmbajtja e letrës së Palit drejtuar të krishterëve të Efesit (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e Palit drejtuar të krishterëve të Efesit (pjesërisht, mungojnë disa paragrafe).

Përmbajtja e letrës drejtuar të krishterëve të Filipit (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e Palit drejtuar të krishterëve të Filipit.

Përmbajtja e letrës së Palit drejtuar të krishterëve të Kolosit (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e Palit drejtuar të krishterëve të Korinthit.

Përmbajtja e letrës së parë të Palit drejtuar të krishterëve të Selanikut (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e parë e Palit drejtuar të krishterëve të Selanikut.

Përmbajtja e letrës së dytë të Palit drejtuar të krishterëve të Selanikut (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e dytë e Palit drejtuar të krishterëve të Selanikut.

Përmbajtja e letrës së Palit drejtuar çifutëve (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e Palit drejtuar çifutëve.

Përmbajtja e letrës së parë të Palit drejtuar Timotheut (nuk përfshihet në Dhjatën e Re).

Letra e parë e Palit drejtuar Timotheut (jo e plotë).

Përmbajtja e letrës së dytë të Palit drejtuar Timotheut (jo e plotë).

Letra e dytë e Palit drejtuar Timotheut (jo e plotë).

Letra e Palit drejtuar Titit (jo e plotë).

Sipas mendimit tonë kodiku duhet t'i përkasë shekullit të 12-të ose të 13-të, duke u nisur nga lloji i kaligrafisë dhe nga fakti se pergamena ka filluar të mos përdoret për këto lloje shkrimesh që në shekullin e 11-të dhe është zëvendësuar plotësisht nga letra në shekullin e 13-të.

Në fund duhet shtuar se pjesët që nuk përfshihen në Dhjatën e Re përbëjnë anën origjinale që ia shton vlerën këtij kodiku.

*Shënim shtesë:* Në fletën 6 duken disa shkronja që të lënë të mendosh se fleta është përdorur për së dyti: me sa duket këtu kemi të bëjmë me atë që i thonë palimpsest. Dorëshkrimet e hershme i janë nënshtruar shpeshherë këtij procesi, kryesisht për mungesë pergamene.



Nga përpunimi kimik i palimpsestëve në shekullin e kaluar janë zbuluar vepra të Ciceronit, të Platonit ose të klasikëve të tjerë që mendoheshin si të humbura.  
Pasaporta u përgatit nga Zef Simoni në Tiranë më 5.11.1986.

177

## KODIKU I 99-TË, I KORÇËS

(REGEST, VENDIME TË SINODEVE (KËSHILLAVE) KISHTARE TË MITROPOLISË SË KORÇËS PËR PROBLEME TË JETËS SË KISHËS, PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, FETARE, ARSIMORE, HUMANITARE DHE ADMINISTRATIVE)

Përmasat: 260 mm x 440 mm.

Numri i fletëve (të numërtuara): 109.

Koha e shkrimit: Viti 1676 (data më e hershme). Shkrimi më i hershëm përmban formulën kishtare të falënderimit të besimtarëve që dhurojnë pasuri për kishën, duke filluar prej kohës kur ky kodik iu dhurua Kishës së Shën Mërisë. Kjo formulë është përkthyer në shqip së paku dy herë, nga dy klerikë, në gjysmën e parë të shekullit të 20-të, për nevoja shërbese. Me këtë rast, secili përkthyes ka pasuruar listën e emrave të dhuruesve me më të rritë. Falënderimi bëhej Ditën e Ortodoksisë.

Regesti ka vazhduar të mbahet për afro dy shekuj e gjysmë me radhë. Shenjimi i fundmë është i vitit 1943. Këtë e shkroi Ilo Mitkë Qafëzezi, "më 26 të vjeshtësë së parë më 1943". Ky saktëson se "shkrimin e kësaj faqe e diktoi imzot Çamçe". Për mitropolitin Agathangjel Çamçe, I. M. Qafëzezi shkruan se „është i pari mitropolit korçar që nga ditët e Parthenit (1670-1676) dhe të Joasafit të parë (1709-1741). Në përbërje të kodikut ka copëza fletësh me tekste të mëvonshme, deri në mesin e shekullit të 20-të (fletët 95-97: „Kisha e Shën Ilias“, „Ilogaria e qirinjve“). Ilo Mitkë Qafëzezi kishte ndërmend ta përkthente këtë kodik, bashkë me disa dorëshkrime të tjera që i përshkroi në vitin 1943. Ndërsa Kosta Naçi njofton se „një përkthim për përdorim të brendshëm të Kodikut të Madh të Korçës ka bërë Petraq Pepo“, por ky përkthim nuk u gjet, me gjithë kërkimet që u bënë në disa institucione. Nga këto kërkime del se P. Pepo ka kumtuar shkurtimisht rreth këtij kodiku në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike.

Dorëshkrimi nuk ka një grafi të vijueshme. Mund të identifikohen tre-katër shkrime afatgjata, njëri prej të cilëve me vlera estetike. Shkrim me vlera kaligrafike ka në fletët 48 dhe 53. Shkrimi më i bukur gjendet në fletët 62 verso deri 63. Në fletët 82-94 ka shkrim me bojë lejla. Në fletën 58 ka, gjithashtu, kaligrafi dhe gjendet e vetmja nistore kapitale e dekoruar, por shumë thjesht, sa për të kujtuar shkrimin e vjetër. Herë pas here përsëritet shkrimi me ngjyrë ari, por prej varaku (fleta 16 verso, fleta 21 verso, fleta 27 verso). Disa prej shkruësve kanë vënë nënshkrimin në fund të tekstit. Ka nënshkrime me vlera, për stërhollimet e tepëruara të tyre, që të kujtojnë stilin e nënshkrimeve të sulltanëve. Disa nënshkrime janë në ngjyrë të blertë dhe ngjajnë me vizatime në miniaturë (fleta 32 verso, fleta 36 verso).

Materiali: Letër e trashë, e fortë, industriale. Kodikut i janë bërë here pas here shtesa prej letre tjetër, më të hollë, të vijëzuar. Fashikulli i parë i tij është me letër të re. Ndërkaq, gati gjysma e fletëve të letrës së hershme është pa tekst. Fashikulli i parë, i cili ka vetëm 4 fletë të shkruara, është prej letre të vonët. Herë pas here kodiku përmban një fletë letre me shenjë të fshehtë, që mund të dallohet vetëm duke e vendosur përballë dritës (e ngjashme me letrën e sekretuar). Kjo ka një shenjë që në pozicionin recto duket si një hënëzë, e cila përsëritet tri herë, duke u zmadhuar progresivisht, kurse në pozicionin verso duket si germa **s** e greqishtes së vjetër (jo sigma, por **s**-ja lunatike në formën e germës **C** të shqipes). Letra me tri hënëzat që rriten gjendet në fletët 35, 73, 75-76, 79-80.

Prej fletës 36 e në vijim letra është prerë afërsisht 1.5 cm horizontalisht në anë, për të krijuar boshllëqe për renditje të përshkallëzuar të shkronjave orientuese për lëndën që do të përmbante kodiku, pak a shumë si në fjalorët. Shkronjat, megjithatë, nuk janë vendosur në radhë alfabetike,

as sipas greqishtes. Shkronja e parë është **C** (fleta 36); pastaj germa **P** (fleta 40), germa **E** (fleta 62), germa **S** (fleta 71), vijojnë germat **H**, **L**, **X**, **Q**. Disa prej germave të tjera janë të palexueshme. Këto janë shkruar me të kuqe dhe me dekoracione floreale anash. Janë një imitim i nistoreve kapitale të shkrimeve të hershme ungjillore. Duket se shkronjat orientuese janë vizatuar herët. Ka mundësi që këto të kenë qenë inicialet e kishave ose të famullive, njëfarë treguesi gjeografik-rajonal, por nuk është respektuar. Nuk ka renditje lënde sipas germës orientuese.

Kodiku ka disa numërtime të fletëve një mbi një. Numërtimi i fundmë është ai që u është bërë nga arkivistët. Ka numërtime të tjera, të pjeshme, me shifra romake e me numra arabë, të paktën katër. Në disa fletë ka deri gjashtë numërtime. Në këtë përshkrim fletët referohen sipas numërtimit të fundmë, të bërë prej arkivistëve. Në disa fletë ka shkrime të ngjitura, që nuk janë krijuar nga Mitropolia. Një shkrim i tillë i ngjitur, që gjendet në një letër të hollë të tejdukshme, është në fletën 81 verso.

Kodiku ka kapakë të dyfishtë. Kapakët e brendshëm janë prej kartoni, të veshur me letër, mbi të cilën ka motive floreale. Zbukurimet i ka pasur letra vetë, nuk janë vizatuar me dorë (letër industriale dekorative). Kjo vërehet nga fakti se dekoracionet vijojnë edhe në pjesën e brendshme të kapakut, në masën që është kthyer letra. Në qendër gjendet një tufë lulësh, trëndafila, që të kujtojnë zbukurimin e shtëpive të krishtera për festa fetare (Krishtlindje, Pashkë). Në krye dhe në fund të letrës ka një shirit lulësh më të vogla të gërshetuara. Këto janë të thjeshta, pa vlerë artistike. Sundon ngjyra e kuqe, e blertë dhe lejla. Lulet e stilizuara janë pesëfletëshe dhe jo trifletëshe, siç ndodh zakonisht në shkrimet e krishtera.

Kapaku i jashtëm është më i vjetër dhe duhet të jetë kapaku origjinal i kodikut. Ky është prej fletësh letre të presuara e të ngjitura me njëra-tjetrën, të veshura me lëkurë, pa zbukurime. Në gjendjen e sotme duket sikur ky kapak është pak më i vogël se përmasa e fletës, por kjo ndodh sepse fletët janë shqitur. Në të dyja anët e brendshme të kapakut të vjetër gjenden shenjime të një dore, me grafi relativisht më të hershme, ndoshta grafia më e hershme e gjithë tekstit.

Për këtë kodik në Fondin 488 nuk ekziston skedë (pasaportë). I vetmi shenjim që gjendet prej autorit të katalogut, Theofan Popa, është se „kemi kapërcye numrin (dhe kemi përshkruar më parë „Kodikun e 100-të, të Fierit“), sepse kodiku me numër 100 ishte vënë (ishte bërë pjesë e Fondit 488) pa u punuar kodikët e tjerë (pa u pajisur me të dhënat përshkrimore)“. Në kapakun e dorëshkrimit gjendet ky titullim, që është përgatitur prej arkivistëve: „Kodiku i madh i Korçës, që përfshin ngjarje të viteve 1572-1941, si dhe lista (listën) e pasurive të Mitropolisë së Korçës (të) vitit 1887“.

Është quajtur „kodiku i madh“, me sa duket, për shkak të përmasave mjaft të mëdha të letrës.

Shkaku i hyrjes me vonesë në Fondin 488 duhet të shpjegohet me faktin se për një kohë relativisht të gjatë ky kodik ka qenë pjesë e një fondi tjetër, me referenca arkivistike: Fondi 141 (Mitropolia e Korçës), Dosja 622.

Sido që thuhet se kodiku bën fjalë për ngjarje që fillojnë prej vitit 1572, as grafia, as koha e shkrimit nuk janë të shekullit të 16-të. Dëshmohet qartazi nga një shenjim se ky kodik filloi të shkruhej në vitin 1676, „kur ishte patrik i Ohrit Joasaf Voskopojari“. Në një dëshmi tjetër në gjuhën shqipe, që ruhet si shtojcë e kodikut dhe ka titullin „Pikërisht e njëshme“, thuhet: „Joasaf-i, me dëshirën e Perëndisë kryepiskop i Justinianës ... kryetar i Ohrisë dhe patriark i Bullgarisë, gjithë Maqedonisë dhe gjithë Shqipërisë, prej Voskopoje, vërteton (dëshmon) /se / në vitin 1725 u ngrit ky tempull i burimit jetëdhënës të Korçës dyke qenë dhespot hirësi e tij mitropolit’ i Korçës dhe Zvezdës, dyke qenë ekzark i fort të lumturit z. Parthen prej Korçe, prej të cilit u dhurua ky kodik në ditët e epitropëve dhe ndërtonjësve të kësaj kishe... U vendos që ky kodik i dhuronjësve të këndohet çdo vit ditën e sotme, që quhet e diela e ortodoksisë“.


Kjo mund të jetë arsyeja që Ilo Mitkë Qafëzezi, në një shenjim të shkruar në vitin 1943 në brendësi të fletës së kodikut, e quan „Codex Zosimea-Partheni-Kavalioti“. Zosimea apo Zosimi


Kodiku i 24-t, i Beratit; shek. XIII;  
fl. 64 r. Miniaturë, shembëllim  
portreti ungjillori, në pozicionin e  
shkruesit.



1. Kodiku i 7-të, i Vlorës; shek. XI; fl. 3 r. Vinjetë vetëm në njërën kolonë.



2. Kodiku i 88-të, i Beratit; shek. XIV; fl. 39 r. Shkrim me nistore të zbukuruar.





1. Kodiku i 87-të, i Elbasanit; shek. XIX; fl. 11 r. Fletë partiture me muzikë kishtare (në alfabetin bizantin).

2. Kodiku i 87-të, i Elbasanit; shek. XIX; fl. 38 r. Zbukurime brenda së njëjtës fletë.




1. Kodiku i 85-të, i Korçës; shek. XIV; fl. 60 v - 61 r. Shembëllim i portretit të ungjillorit Mark.

2. Kodiku i 86-të, i Elbasanit; shek. XVI; fl. 150 v. Bukurshkrim.



1



2



183

Ungjillori Mark, miniaturë.

1. Kodiku i 96-të, i Korçës; shek. XVIII; fl. 20-21. Zbukurime imituese të stilit të vjetër: portret kleriku dhe motive floreale.

2. Kodiku i 99-të, i Korçës; shek. XVII-XIX; fl. 19 r. Një nga shkrimet më me vlerë të këtij dorëshkrimi, në pikëpamjen kaligrafike.


3. Kodiku i 99-të, i Korçës; shek. XVII-XIX; fl. 19 r. Bukurshkrim.



1




2



3






1. Kodiku i 23-të, i Beratit; shek. XIII; fl. 64 r. Vinjetë.

2. Kodiku i 96-të, i Korçës; shek. XVIII; fl. 3 r. Bukurshkrim dhe dekoracion me motive floreale.

3. Kodiku i 97-të, i Gjirokastrës; shek. XVI; fl. 1 r. Vinjetë dhe nistore kapitale, zbukurime të thjeshta në një fletë të dëmtuar.






1. Kodiku i 5-të, i Vlorës; shek. XI; fl. 233v - 234 r. Vinjetë dhe miniaturë, shembëllim portreti ungjillori, mjaft e dëmtuar.

2. Kodiku i 50-të, i Beratit; shek. XV; fl. 9 v. Bukurshkrim, fletë e dëmtuar.

3. Kodiku i 95-të, i Tiranës; shek. XIX; fl. 1 r. Shkrim muzikologjik.



Kodiku i 10-të, i Vlorës; shek. XI-XII; fl. 150 v. Shembëllim i portretit të ungjillorit Luka. Vlerësohet shumë për pozicionin didaktik si shkruar.





Kodiku i 95-të, i Tiranës; shek. XIX; fl. 59 r. Zbukurime të stërholluara.


Kodiku i 93-të, i Korçës; shek. XIII;  
fl. 92 v. Miniaturë, shembëllim  
portreti ungjillori në stilin e vjetër.



μνησθη Τιμωθεις ο οσω  
 Τηρω ο ο τανελθης εν τη βασι  
 λεια σου θωσον με ως μεσος φιλχθ  
**Α**ρχησιν θωσων εν τω βουρεως ηχη  
 ετο κεφατα εριουσιν τοις αμαρτωλοις  
 εριου εριου εριου εριου εριου  
 προς σε εισησασσ ο ον με εισησ  
 αμαρτωλων εν εριου εριου εριου  
 εριου εριου εριου εριου εριου  
 προς σε εισησασσ ο ον με εισησ  
 εριου εριου εριου εριου εριου  
 εριου εριου εριου εριου εριου

Kodiku i 72-të, i Korçës; shek. XVIII; fl. 32 r. Shkrim muzikologjik kishtar (tekst dhe nota).

Kodiku i 92-të, i Korçës; shek. XIII-XIV; fl. 340 r. Vinjetë me shkrim të pruarar, në hyrje të ungjillit sipas Gjonit.



ΕΥΑΓΓΕΛΙΟΝ  
 ΚΑΤΑ ΙΩΑΝΝΗΝ  
 ἀρχὴ ἡὐτοῦ ἄρχοντος καὶ λόγος  
 ἡὐτοῦ πρὸς τὸν θεόν. καὶ ὁ θεὸς ἡὐτοῦ  
 λόγος οὗτος ἡὐτοῦ ἀρχὴ πρὸς  
 τὸν θεόν· πάντα δι' αὐτοῦ ἐγένετο.  
 καὶ χωρὶς αὐτοῦ ἐγένετο οὐδὲ  
 ἓν ὃ γέγονεν· ἐν αὐτῷ ζωὴ  
 ἡὐτοῦ· καὶ ἡ ζωὴ ἡὐτοῦ τὸ φῶς τῶν

ΕΙΣ ΤΟ  
 Χ  
 ΠΑΣ

ΤΑΡΑΧΗ ΠΡΟΣ ΤΟ  
 ΑΙΜΑ

ἰ  
 Α

ἰ  
 Ε

ἰ  
 Ε

ἰ  
 ΙΔ







ΕΥΑΓΓΕΛΙΟΥ Τ'ΑΚΕΦ'ΑΛΑΙΑ:

- ἁ Π τῆσ'ἀπογραφῆσ:  
 β Π τῶμ'ἀγραυλοῦστων ποιμῶ  
 μων:  
 γ Π συμβῶμοσ:  
 δ Π ἀμμασ τῆσ'προφῆτιδωσ:  
 ε Π τῶν ἰσχυρῶν ἰσχυροῦσ πρὸσ  
 ἰσοἀμμῆσ:  
 ς Π τῶμ'ἀβρωτῆσ ἀμτωμ τὸμ  
 ἰσοἀμμῆσ:  
 ζ Π τῶσ'ἰσχυροῦσ τῶσ'ἰσχυροῦσ:  
 η Π τῶσ'ἰσχυροῦσ τῶσ'ἰσχυροῦσ  
 μίου:  
 θ Π τῆσ'ἀβρωτῆσ ἀμτωμ τῶσ'ἰσχυροῦσ:



194

Kodiku i 93-të, i Korçës; shek. XIII;  
fl. 141 r. Ungjillori Luka,  
shembëllim



ishte arkiveshkv (mitropolit) në vitin 1607, fill mbas Gavrilin (1572-1580). Emri i Parthenit është zgjedhur për të njëjtën arsye, si mitropolit korçar i respektuar. Emri i Kavaliotit mund të jetë zgjedhur për faktin se kodiku ka fletë të tëra për Voskopojën (fletët 86-87 dhe të tjera). Sipas Ilo Mitkë Qafëzezit, „Codex Zosima-Partheni-Kavalioti“ mund të jetë një „titull i paskajuar i këtyre kondikëve /kodikëve / për diturina të kërkimeve ballkanike“ (titull i përgjithshëm). Në të njëjtin shenjim ky përmend edhe një „kodik të Llassos“, të cilin e titullon „Codex Neofit Gjirokastriti Llassos“. Ky dijetar, i cili ka punuar me dorëshkrimet e bibliotekës së Mitropolisë së Korçës për afro dy muaj, nuk jep të dhëna për kodikun e dytë. Përmend përveçse e ka kopjuar „në 7-8 radhë, me afro 100 fletë“. „Llassos“ ishte emri i një arke për mbledhje të hollash për bamirësi.

Një tekst tjetër, gjithashtu në gjuhën shqipe, që përsërit pak a shumë tekstin e cituar më sipër për dhurimin e kodikut nga Joasafi prej Voskopoje, lejon të kuptohet se bëhet fjalë për një përkthim shqip të shenjimit me grafi relativisht të vjetër, që gjendet në dy anët e brendshme të kapakëve origjinalë. Nga ky version i të njëjtit tekst del se kisha që iu dhurua kodiku quhej „Zonja Shën Mëri“, se në atë kohë mitropolit i Korçës ka qenë Sallasfori i Zvezdës, se kjo kishë „u zografis prej zotërinjtë vëllezërit Zografët“, se „u shkruhen emrat në këtë kodik të gjithëve atyre që kanë falur ...“ pasuri e ndihma për kishën.

Në fakt, pjesën më të madhe të lëndës së kodikut e zënë regjistrimet e dhuratave të besimtarëve për kishën: toka, para, sende me vlerë, punishte. Të dhëna të tilla përmbajnë fletët 6-7, 9-15, 17-23, 42-45, 72-73, 80-82. Midis dhuruesve bie në sy emri i Athanas Zografit (fleta 52); emri i „kryetarit / princit të Hungaro-vllahisë Joan Mavrokodhrato“ (ky përmendet edhe një herë tjetër si dhurues i madh, sepse jep çdo vit 150 groshë për shkollat e Korçës, fleta 90).

Sipas A. Plasarit, „Hungarovllahi emërtohej asikohe principata rumune e Vllahisë për t'u dalluar prej „Vllahisë së Madhe“ të Epirit dhe Maqedonisë, qeverisur prej Engëllorëve. Trajta „Hungarovllahi“ daton prej shekullit të 14-të...“ („Mendimi“, 2003, nr. 2, f. 43).

Përmendet gjithashtu emri i rusit Pavel Molenskij, që ka dhuruar një petrahil të qendisur me flori dhe sende të tjera; esnafi i bakejve, që ka dhuruar „korën e Triarhondëve“; një banor i Korçës me mbiemrin „Kukuzeli“ / „Kokuzeli“, që ka dhuruar një vreshtë. Nga lista e dhuruesve mësohet për ekzistencën e një „kore të Shën Kryqit“, të një „kore tjetër“ të Zografit që tregon „Zotin Krisht kur lindet“, si dhe për mjaft vepra të tjera të artit kishtar, që nuk dihet se çfarë fati kanë pasur dhe a mund të gjenden më.

Në fletën 19 gjenden dy tekste të ngjitura mbi fletën e kodikut: njëri osmanisht dhe tjetri në gjuhën greke. Teksti osmanisht ka vulë dylli me shenja heraldike të qarta. Ka mundësi që vula e dyllit të jetë e Mitropolisë dhe vetë teksti të jetë një testament. Në vulë duket qartë imazhi i një shqiponje me krahë të hapur dhe me një kokë, me profil nga e djathta. Shqiponja ka dekor që formohet me degë të harkuara. Në anën e djathtë lexohen geramat GZ, e para më e madhe se tjetra. Shkronja duhet të ketë pasur edhe në anën e majtë, por këto nuk lexohen. Poshtë shihet viti, 1827. Vula të dëmtuara dylli ka edhe në fletë të tjera (fleta 24 verso, 67 verso).

Pjesa më e rëndësishme e kodikut, në pikëpamje të përmbajtjes, është ajo që bën fjalë për vendimet e regjistruara në kodik. Disa prej tyre kanë të bëjnë me jetën laike të besimtarëve. Në fletët 48-51 përshkruhet veshja e dhëndrit dhe e nuses. Janë regjistruar vendime të esnafëve, sipas mjeshtërive. Një vendim i vitit 1847, siç del nga një shënim pa emër (duhet të jetë i K. Naçit), përcakton rregullat e esnafit të bukëpjekësve dhe ndëshkimet për ata që shkelin këtë rregull, ku bie në sy gjoha e rreptë prej 500 groshësh. Një vendim tjetër i përket esnafit të armëpunuesve. Në fletën 17 gjendet një vendim i esnafit të kasapëve, të cilët vendosin që të dielave dhe në ditët e festave të therin bagëti me radhë: kush vepron kundër këtij vendimi dënohet me gjobë dhe „me një zifafet“ falas, për t'u ripranuar në esnaf. Nga vendimet kishtarë ka: për emërime epitropësh, për shpërblime klerikësh, për caktimin e dhjakëve, për caktim pleqësie. Në fletën 60 ruhet një përshkrim mbi trajtimin e ankesës (së besimtarëve) ndaj një kleriku. Ka disa vendime për çështje financiare, evidentim dhuruesish,

administrim pasurie, dhënie trojesh etj.

Kodiku përmban regjistrime të fejesave, çështje të pajës dhe të prikës (fletët 56, 66-67), që paraqesin interes etnozakonor. Ka edhe testamente, akte shit-blerjeje, deklarim trashëgimie (fleta 41, fletët 77-79).

Një pjesë tjetër e kodikut përmban thjesht llogari, balance të shpenzimeve të kishës në rrjedhë kronologjike (fl. 28-32, 40-45, 64-68 etj.).

Fleta 20 përmban një mallkim ndaj një mosbesuesi / heretiku /-anatemim.

Në fletët 40-64 herë pas here ka të dhëna për shkurorëzimet.

Në fletën 27 gjendet ky shenjim: “Në vitin 1856-1857 u ndërtua shkolla e re e vajzave, greqisht, me shpenzime të besimtarëve. Mësuese e parë e shkollës së vajzave u caktua Ekaterina V. Kundurioti (Kunturiotis) nga Athina. Në vitin 1849 u krijua “arka e shenjtë”, e mbiquajtur “Llassos”, me vendim dhe me dhurime të besimtarëve. Të ardhurat nga kjo arkë u përdorën për shkolla dhe kisha, si dhe “për vajzat e pamartuara” (si duket për çështje prike). Veçanërisht një ndihmë të madhe dërguan patriotët e Egjiptit. Emrat e secilit dhurues janë regjistruar në kodik. Gjer më sot, 30 janar 1861, kapitali arrin dy mijë lira turke“.

Në fletën 60 është ruajtur një letër e Patriarkanës drejtuar parisë dhe të krishterëve të Korçës lidhur me ankesat që këta kanë bërë kundër klerikut Neofit. Letra është dërguar nga „kryeepitropi i Kostandinopojës dhe i Romës së Re, patriku ekumenik Joakim“. Ankesa është regjistruar një fletë më pas. Patriarkana ka ndërmjetësuar për pajtim (fletët 62-63).

Në fletën 62 gjendet gjurma e një vule të vogël të njomë, ku mund të lexohen germat **RTZS**. Ka edhe një germë në fillim që nuk lexohet. Germat janë të alfabetit latin; kjo dallohet nga fakti që shkruhet **s** latine dhe jo sigma e greqishtes. Fleta 62 dhe ajo 63 kanë shkrimin më kaligrafik të të gjithë kodikut.

Në fletën 66 ka kronika për Voskopojën.

Në fletën 82 Ilo Mitkë Qafëzezi ka shenjuar shqip përkthimin e një teksti të një kleriku, që ai e quan „shkresë e dhaskal Kostë Xhepit, Vithkuqarit“, ku thuhet: „Ju lutem, këtu do të ketë vend letra arzuhall e adresuar Ali (pashës) Tepelenës“. Por nuk vërehet të ketë vërtet një letër të tillë; kjo fletë, verso, është bosh.

Në fletën 83 gjendet një raport përmbledhës i veprimtarisë së Mitropolisë së Korçës për vepra bamirësie. Ky raport është hartuar meqenëse mjeku Joan Llambridhi, i cili cilësohet „i dëgjuar“, ka vendosur të botojë një libër për bamirësinë. Raporti është shkruar, ose së paku është parë e miratuar nga „mitropolit i Korçës dhe Përmetit“, Dorotheu, në vitin 1879. Në këtë raport ka të dhëna të hollësishme mbi ndarjen administrative të Korçës dhe të Përmetit, mbi zhvillimin ekonomik dhe jetën shoqërore, mbi çifligjet dhe „fshatrat e pavarur“, mbi shkollat edhe kishat. Sipas vlerësimit të Mitropolisë, Korça ndahet në tri pjesë: Korçë, Devoll dhe Opar. Në fletët 83 dhe 86 bëhet fjalë vetëm për Oparin.

Në fletën 86 shkruhet për krijimin e “Vëllezërisë për të varfërit“, më 1870, „me ndihmën e mytesarifit Asim pasha. Në këtë shoqëri bënin pjesë të krishterë e muslimanë dhe përfitonin ndihmë të varfërit pa dallim. Kjo shoqëri ndërtoi në qytet të parën „foshnjore“ / çerdhe / dhe pagoi shpenzimet e mësueses për dy vjet. Me financat e kësaj shoqërie u hap një shkollë fillore në Pogradec, një tjetër në Opar dhe një e tretë në Borovë të Kolonjës. Në të njëjtën fletë është shkruar për ndërtimin e çezmave nga bejlerët e Plasës dhe nga një qytetar me emrin Jani Banga. Aty shkruhet gjithashtu për punën që bënë më 1784 ndërtuesit „gegë e voskopojarë“ („moskopoliti“) për ndërtimin e orës së madhe të qytetit mbi këmbanën e madhe pranë pazarit. Sipas një të dhëne që gjendet në këtë fletë, në vitet 1750-1760 voskopojarët kishin arritur të mbledhnin 400 mijë aspra për shkollat. Në atë kohë tregtarët e Voskopojës kishin veprimtari në Austri, në Vllahi, në Bullgari e Maqedoni, si dhe në Serbi. Qyteti kishte esnafin e hekurpunuesve, të bakejve, të kasapëve dhe të argjendarëve. Në këtë kohë, sipas të dhënave të mbajtësit të kronikës të kodikut, Voskopoja kishte shtypshkronjë të mirë.

Në fletën 87 flitet prapë për Voskopojën. Ka të dhëna për banorët e saj në kohën e lulëzimit (të

paktën 12 mijë), për shkollat, për rregullimin urban të qytetit, për gjuhët që janë folur (përmendet shqipja, greqishtja dhe vllahishtja).

Në të njëjtën fletë përshkruhet se si „koxha Mirahori“ - është fjala për Iljaz bej Mirahorin, pasi u kthye në musliman, fitoi simpatinë e sulltan Bajazidit dhe, si mirënjohje për përfitimet, ndërtoi një xhami atje ku ishte Kisha e Shën Parashqevisë. Thuhet se kjo „ka ndodhur 392 vjet më parë“, që do të thotë se shenjimi është mbajtur përafërsisht në vitet 1860-1870, duke pasur parasysh se fermanët e Sulltanit të sipërpërmendur për dhënie timari beut të Mirahorit i takojnë vitit 1486.

Në fletën 88 gjendet një kronikë e hollësishme mbi pasojat e tërmetit të vitit 1879, tërmet që „rrëzoi mbi dy mijë oxhaqe“ dhe u pasua nga një thatësi e madhe. Pasoj një zjarr i përbindshëm, që dogji „600 punishte“. Në të njëjtin vit u mat temperatura më e ulët që mbahej mend gjatë dimrit, minus 17 gradë. Për këtë arsye u ngritën çmimet aq sa nuk ishte parë e dëgjuar ndonjëherë. Po në këtë fletë falënderohet Mehmet pasha nga Plasa, i cili kishte ndërtuar një rezervuar uji të pijshëm, përkundër kopraxisë së „bankierit Sina“, që nuk dha asgjë.

Është pretenduar që ky kodik përmban ngjarje „prej vitit 1572“, sepse nga fundi, në fletën 92, është lista e mitropolitëve të Korçës prej vitit 1572 deri më 1923. Një pjesë e listës (Jerthe Jakopulli nga Çarshova e Përmetit, Visarion Xhuvani, Kristofor Kissi, Evloj Kurilla-Llavrioti, Agathangjel Çamçe etj.) është shkruar shqip.

Në vijim kodikut i bashkëngjiten tekste prej fletësh që nuk janë të tij. Në njërin prej tyre gjendet një listë me titullin „Dihma prej Konize“ / Ndhima prej Konice/, ku përmenden mbiemrat: Floqi, Ziçishti, Panariti, Vasi, Çekrezi, Pishtari, Furxhi etj. Fletët 103-106 janë po ashtu shtojca. Një shënim bën të ditur se „ky është shkrimi i të ndjerit Vani Bimblli“.

Kjo pasaportë u përgatit nga Shaban Sinani duke iu referuar përmbajtjes së këtij kodiku, në të gjitha pjesët e tij përbërëse; si dhe të dhënave të kufizuara që përmbajnë mjetet e kërkimit arkivistik (titulli i dosjes etj.), dhe disa shënimeve të gjetura aty-këtu nëpër fletët e kodikut nga Ilo Mitkë Qafëzezi, Petraq Pepo dhe, ndoshta, të ndonjë kleriku të Mitropolisë së Korçës. Iu bashkëngjit kodikut sot, më 19.03.2003.

#### **Burimet:**

1. Pepo, Petraq: „Kodiku i madh i Korçës si burim historik“, në „Konferenca e parë e studimeve albanologjike“, II, Tiranë 1965, f. 530-536.
2. Pepo, Petraq: „Materiale dokumentare mbi veprimtarinë e zanatçinjeve të Korçës e të Voskopojës në shekullin e 18-të e të 19-të“, Studime historike, 1967/1, f. 166-181.
3. Giakoumis, Konstantinos: „The monasteries of Jergucat and Vranishte in Dropull and of Spelaio in Lunxheri as monuments and institutions during the ottoman period in Albania 16<sup>th</sup>-18<sup>th</sup> centuries“, tezë doktorate në dy vëllime, Birmingham University, shkurt 2002.
4. Naço, Kosta: „Të dhëna për kodikët e Shqipërisë“, fl. 1-3, dorëshkrim.
5. Plasari, Aurel: Shën Nifoni në oborrin e Skënderbeut, „Mendimi“, 2003/2, f. 42-48.

## **KODIKU I 100-TË, I FIERIT**

(I REGJISTRUAR ME KONTRATA FEJESASH TË POPULLATËS SË MYZEQESË)

Materiali: Letër.

Përmasat: 22.2 x 15.9 cm.

Sasia e fletëve: 101.

Në vend të kapakëve kodiku ka dy fletë letre dhe sipër tyre një fletë pergamene për ta mbrojtur. Kodiku përmban vetëm kontratat e fejesave, të cilat fillojnë më datën 1 të muajit maj 1819 dhe mbarojnë më 12 të muajit dhjetor 1843.

Nga të dhënat që gjenden në këtë kodik rezulton se zakoni i regjistrimit të kontratave të

fejesave, ndonëse fillon nga gjysma e parë e shekullit të 19-të, ka shumë të ngjarë që të jetë trashëguar nga shekujt e mëparshëm mesjetarë, madje jo vetëm në Myzeqe, por dhe në krahina të tjera të vendit tonë. Këto kontrata të regjistruara ishin një lloj akti juridik, sepse nënshkruheshin dhe prej dëshmitarëve që ishin po ata që shkruanin kontratat.

Studimi i këtyre kontratave ka rëndësi të veçantë për të dhënat e tyre zakonore kanunore dhe etnografike gjuhësore. Duke studiuar veshjet që u jepeshin të fejuarve si bazë materiale në martesën e tyre mund të bëhen edhe vlerësime të tjera. Këto janë një material me të dhëna ekonomike etnografike që venë në dukje faktorët e jetës shoqërore të krahinës së Myzeqesë në këtë periudhë historike.

Kodiku në fjalë përmban akte të ndryshme që lidheshin midis prindërve të djalit e të vajzës që do të martoheshin, për pajën e detyrimin në të holla që do t'i jepte djali vajzës. Në bazë të këtyre akteve jepej prej priftit leje e martesës dhe paguhej prej prindërve taksa përkatëse për Mitropolinë e Beratit. Këto raste regjistroheshin në manastirin e Shën Kozmait, për të mos shkuar njerëzit gjer në Berat, nga varej Manastiri.

Në çdo akt shënohen veshjet që do t'i bënte djali nuses, emër për emër, si dhe shuma e parave.

Materiali që përmban kodiku ka karakter më tepër etnografik.

Mendojmë që mund t'u jepet studiuesve, qoftë të vendit apo të huaj, për studim.

Përgatitur nga etnografja Llambrini Mitrushi, Tiranë, 1965.

## DORËSHKRIMET KISHTARE MESJETARE TË SHQIPËRISË <sup>1</sup>

THEOFAN POPA

199

**M**e mbarimin e luftës antifashiste në Shqipëri u krijuan kushte të favorshme për punë shkencore. Punonjës të shkencës nisën ekspeditat kërkimore dhe bënë një punë të madhe për grumbullimin dhe sigurimin e monumenteve të rëndësishme të vendit. Gjatë ekspeditave u siguroa thesari i madh artistik i popullit tonë; u regjistrua një numër i madh monumentesh arkitekturore antike e mesjetare; u zbulua dhe u identifikua piktura monumentale dhe ajo me kavalet /ikonografia mesjetare/; u grumbullua dokumentacioni epigrafik i monumenteve dhe i veprave artistike të tyre, dokumentacion që nxori në dritë autenticitetin e kulturës mesjetare shqiptare, mjeshtrit e talentuar mesjetarë shqiptarë të të gjitha gjinive artistike.

Përveç të tjerash, u grumbullua dhe një sasi e konsiderueshme librash në dorëshkrim - kodikë agjiografikë mesjetarë, që i përkasin periudhës historike prej shekullit të 6-të deri në atë të 15-të, si dhe dorëshkrime më të vona, më pak të rëndësishme, të riprodhuara gjatë periudhës osmane, deri në shekullin e 18-të.

Sasia e kodikëve të zbuluar, që janë riprodhuar deri në shekullin e 15-të, ka arritur vitet e fundit në 62 vëllime. Nuk përjashtohet zbulimi i kodikëve të tjerë, që mund të ruhen ende nëpër familje.

Që Shqipëria të trashëgojë një sasi të madhe dorëshkrimesh, që prej shekujve të fillimit të mesjetës, kjo nuk është një gjë e çuditshme, për faktin se, sikurse është bërë e njohur, ajo është vend traditash të lashta kulturore.

Si vend kulture të lashtë për Shqipërinë, së pari, flasin qendrat e njohura antike urbane të vendit, si Dyrrahu, Butrinti e të tjera. Në këto qendra dëshmohet një kulturë e shkëlqyer greko-romake, ndikimet e së cilës përvetësohen në mënyrë krijuese nga popullata autoktone ilire. I njohur është fakti i përhapjes së krishtërit në Shqipëri qysh nga shekujt e parë të erës së re, gjë që argumentohet kryesisht nga burimet arkivore dhe arkeologjike, si dhe nga një sërë monumentesh të kulturës paleokristiane, që po zbulohen kohë pas kohe nëpër vise të ndryshme të vendit, siç janë mozaikët e shkëlqyer të kishës së Linit dhe të asaj të Tushemishtit (Pogradec), të bazilikës së Elbasanit dhe asaj të Sarandës, të baptisterit të njohur të Butrinitit etj., të cilët i takojnë një periudhe prej shekullit të 4-t deri në atë të 8-të të erës së re. Këto mozaikë kanë një lidhje të ngushtë me dokumentet arkivore: me aktet e koncileve ekumenike të kishës, në të cilët kanë marrë pjesë e kanë nënshkruar peshkopë të peshkopatave më të vjetra të vendit tonë. Ndër ta, peshkopi i Pulheriopolit (Beratit) përmendet në aktet e koncilin të parë ekumenik të Nikesë.

Me gjithë faktin e njohur që Mesjeta karakterizohet herë-herë me rënie të botës së vlerave të kulturës, ku hyn dhe rënia e shkrimit dhe e librit, gjë që shpjegohet me ndryshimet ekonomiko-shoqërore pas shoqërisë skllavopronare, duhet thënë se shfaqja e kishës së krishterë, me tendencën për t'u shtrirë në të gjitha shtresat shoqërore, bëri që të ruhej tradita e shkrimit dhe e librit, si një mjet komunikimi për literaturën propagandistike dhe për atë liturgjike, pa të cilën nuk mund t'i kryente funksionet e saj.

Me rastin e ngritjes dhe të organizimit të Ohrit si kryekishë nga perandori Justinian, nën juridiksionin e së cilës përfshiheshin gati të gjitha peshkopatat e viseve tona, lulëzimi i kulturës, i mbështetur dhe inkurajuar prej tipareve artistike antike të vona, u bë një dukuri pozitive, që reflekton në monumentet tona mozaikale dhe dorëshkrimore paleokristiane të ruajtura deri

në ditët tona.

Në shekujt e mëvonshëm, gati gjatë gjithë Mesjetës, dihet që Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë Bizantine, e cila ushtroi një ndikim të thellë mbi tiparet e strukturës ekonomike-shoqërore dhe mbi kulturën e vendit. Ky ndikim, gjithashtu, pasqyrohet në veprat artistike të gjinive të ndryshme, që stolisin monumentet tona mesjetare, ndër të cilat përfshihen edhe dorëshkrimet e vjetra, kodikët mesjetarë të vendit.

Kur flasim për ndikime nga kultura e Bizantit, nuk supozojmë një riprodhim të thjeshtë pasiv të saj, sidomos kur është fjala për realizimin e veprave artistike, sepse një popull me një specifikë të veçantë, si populli shqiptar, duke përfutur ndikime të një kulture të huaj, do të sillej në mënyrë krijuese duke futur elemente të kulturës së vet, sipas natyrës, gustos dhe ambientit të vet.

Të tilla elemente të reja me tipare vendëse vërehen, ku më shumë e ku më pak, në të gjitha gjinitë e arteve të thesarit tonë artistik mesjetar, madje ato tek ne hasen deri në thellësitë e Mesjetës edhe në kodikët mesjetarë.

Këta kodikë, ndonëse janë në gjuhë greke, e cila ishte gjuhë e shkrimit gjatë Mesjetës në Bizant, si dhe latinishtja në Perëndim (të dyja mbizotërojnë si gjuhë të kishës dhe të kulturës), kanë një rëndësi të veçantë për historinë e kulturës së vendit tonë, sepse dëshmojnë për zhvillimin e literaturës mesjetare edhe në këtë anë të rajonit. Ata përfaqësojnë dëshmitë më të vjetra të shkruara që ka ruajtur populli ynë, janë një dëshmi e gjallë e traditave tona kulturore gjatë erës së re, qysh prej shekujve të parë të saj, dhe provojnë se populli ynë në periudhën mesjetare ka ecur krahas popujve të tjerë të kulturuar.

Për ekzistencën e kodikëve mesjetarë të vendit tonë, i pari që ka shkruar është Anthim Aleksudhi, i cili, qysh në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të, shkroi për dorëshkrimet kishtarë të Shqipërisë gjatë gjithë periudhës historike prej paleokrishtëritimit deri në kohët moderne. Në veprën e tij mbi peshkopatën e Beratit ai ka përshkruar dhe gjashtë kodikë dorëshkrime të kishave të tij.

Përveç kodikut më të vjetër, të quajtur „Beratinus“ nga shkrimtari francez Batiffol, të cilin ai ia ka atribuar shekullit të 6-të dhe hyn në grupin e kodikëve më të vjetër mesjetarë, me grafi prej shkronjash kapitale argjendi të shkrirë mbi pergamenë të purpurt, që sot paraqitet shumë e zbehtë; si dhe kodikut të quajtur „i arti i Anthimit“ (shekulli i 9-të), i shkruar me shkronja të vogla prej ari të shkrirë, kodikët e tjerë prej pergamene e letre janë shkruar me ngjyrë kafeje me nuanca të ndryshme sipas kohës së riprodhimit. Disa nga këta kodikë titujt dhe inicialet i kanë prej ari.

Pak më vonë pas Aleksudhit, shkrimtari francez Pier Batiffol vjen në Berat dhe i bën një studim thesarit dorëshkrimor të kishave të qytetit. Në veprën e tij shumë të rëndësishme „Les manuscrits grecs d'Albanie et Codex Purpureus Beratinus F“ ai botoi një katalog të vogël të dorëshkrimeve të Beratit, duke dhënë disa karakteritika të tyre, gjithsej 16 kodikë, nga ata që ai kishte mundur të shikonte. Në këtë botim ai ka dhënë të transkriptuar kodikun e parë dhe më të vjetër të vendit tonë, të cilin e quajti „Codex Purpureus Beratinus“.

Ndonëse këto botime të para rreth kodikëve tanë kanë rëndësinë e tyre (ai i Aleksudhit ka meritën se i pari informon për ekzistencën e dorëshkrimeve mesjetare të vendit dhe ai i Batiffolit ka meritën se paraqiti disa prej tyre në formën e një katalogu të vogël, me të dhëna të shumta shkencore), duhet thënë se në to gjendja e dorëshkrimeve të Beratit nuk paraqitet e plotë. Kjo ka ngjarë për faktin që, siç pohon Batiffoli vetë, „nuk m'u lejua veçse të bëj një inventar të shkurtër; kam përshtypjen dhe s'jam aspak i sigurt që të kem parë gjithçka nga dorëshkrimet“. Këtë e tregon edhe numri i pakët i kodikëve që përshkruan në veprën që ai ka botuar, në krahasim me ata që janë ruajtur deri sot.

Përshkrimet që Batiffoli u ka bërë dy kodikëve më të vjetër, ndonëse me kërkesa strikte shkencore, paraqiten të pamjaftueshme e të mangëta. Duke pasur parasysh këto rrethana dhe duke qenë të grumbulluar pranë Arkivit Qendror Shtetëror thuajse të gjithë kodikët e Beratit, të Vlorës e të viseve të tjera të vendit, që përbëjnë thesarin dorëshkrimor të Shqipërisë;



duke pasur parasysh katalogët e botuar nga Aleksudhi, Batiffoli e të tjerë, morëm përsipër të punojmë një katalog më të plotë të kodikëve tanë, duke shenjuar në skedën/pasaportën e secilit karakteristikat kryesore identifikuese, sa më të plota të jetë e mundur, që nga studimi i tyre të mund të nxirren të dhëna me interes të veçantë për historinë e kulturës sonë mesjetare, të hershme e më të vonë, periudha historike për të cilat burimet arkivore paraqiten fare të vobekta.

Me këtë rast na duket me vend të themi dy fjalë dhe rreth historikut të këtij thesari dorëshkrimor mesjetar të vendit tonë, i cili në pjesën më të madhe përbëhet prej kodikëve të Beratit, që përfaqësojnë edhe mburrjen e bibliografisë mesjetare. Kjo bibliografi në kohët e vona është pasuruar edhe me burime nga vise të tjera.

E vlen të vërejmë se disa nga kodikët që përmban lista e Batiffolit fatkeqësisht nuk ekzistojnë më, ndër të cilët edhe një „Liturgji e Gjon Gojartit“, me shkrim korsiv prej argjendi të tretur, shkruar mbi pergamenë të purpurt. Së bashku me „Beratinus-1“ dhe me „Kodikun e Artë të Anthimit“, ky i fundit me shkrim prej ari, ai vlerësohej si pasuri e rrallë në listën botërore të kodikëve krisografikë të tipit bizantin. Në atë kohë dorëshkrimet e kësaj vjetërsie dhe tipologjie nuk arrinin një duzinë ekzemplarësh. Kjo listë e vogël e kodikëve krisografikë që gjenden nëpër bibliotekat e mëdha të botës dihet që edhe sot nuk e ka rritur numrin e ekzemplarëve. Një dorëshkrim tjetër i çmuar shumë nga Batiffoli është „Diptiku i kishës së shën Gjergjit“ në kalanë e Beratit. Sipas Batiffolit, ai “ka qenë i çmuar shumë lart” për vjetërsinë dhe bukurinë e tij. Fatkeqësisht ky kodik, gjithashtu, nuk ruhet më në koleksionin e kodikëve që arritën deri në kohët moderne. Siç dihet, në këtë dorëshkrim gjendej një shënim që bënte fjalë për një episod në lidhje me mbrojtjen e thesarit dorëshkrimor të Beratit. Aty përmendet një figurë e shquar në Berat, me emrin Skuripeqi. Këtë emër e gjejmë të përmendet edhe në Kodikun e 2-të të Beratit, fleta 44 e 45. Në shenjim thuhet se „Skurikeqi, bashkë me zonjën (me të shoqen) konteshë“ dhe të birin Fotinoin, si besimtarë të krishterë të kishës së shën Gjergjit në Berat, në vitin 1356, kur ushtritë serbe do të sulmonin qytetin, i cili ishte braktisur nga popullata sepse nuk ishte në gjendje të mbrohej, me lutjen e murgut Theodhul, mori përsipër mbrojtjen e thesareve të kishave dhe së bashku me kallogjerin ngritën “të 27 dorëshkrimet e çmueshme që kishte manastiri i Theologut dhe kisha e shën Gjergjit“, të dy në kala të Beratit. Në këto dorëshkrime përfshihej edhe Beratinus-1. Dorëshkrimet u fshehën në një kullë të kalasë. Lista e këtyre dorëshkrimeve dhe e objekteve të tjera të çmueshme që u fshehën në kullë është botuar në fletët e fundit të librit të Batiffolit. Nga këto dorëshkrime që përmenden në atë listë ka një numër të madh që nuk ruhen më.

Me gjithë dëmtimet e shumta që kanë ardhur nga rrebeshet e luftërave, Berati edhe sot mbetet një dëshmi e gjallë e një qendre të pasur kulturore mesjetare, me arkitekturën monumentale të kultit, me veprën e kulturës murale e të kavaletit (ikona), që stolisin nga brenda monumentet. Në Berat ishte zhvilluar qysh herët një traditë e pasur në fushën e arteve të vogla të aplikuara, të artizanatit, të argjendarisë, që dëshmohej me vepra arti prej shekullit të 13-të e deri në ditët tona, me vepra arti të skalitjes së drurit, të qëndisjes me fije ari dhe argjendi etj. Duke qenë në kushte të tilla, Berati u bë qendër e një tradite artistike me tipare pak a shumë të kristalizuara <sup>2</sup>.

Interesante dhe me rëndësi të dorës së parë janë të dhënat nga studimi i paleografisë së këtyre dorëshkrimeve, si monumente më të lashta të historisë së shkrimit në vendin tonë dhe në një shkallë më të gjerë.

Kodiku ynë më i vjetër „Beratinus“ përmban 190 fletë pergamene të ngjyrosura me të kuq të thellë (purpur), që sot për fat të keq paraqitet shumë e zbehtë. Është shkruar me germa prej argjendi të tretur, me përjashtim të disa faqeve, ku disa fjalë janë shkruar me ar. Germat janë të tipit kuadrat, të mëdha. Shkrimi është i vazhdueshëm, pa ndarje të fjalëve. Format i fletëve është 314 x 268 mm. Nga analizat që u janë bërë germave dhe nga krahasimi që shkencëtarët kanë bërë me tekset e pakta të ruajtura të këtij tipi, është konkluduar që ky kodik i purpurt i Beratit I takon shekullit të 6-të.

Kodiku i dytë i Beratit, që njihet në shkencë me emrin “Codex Aureus Anthimi” (Kodiku i artë i Anthimit), i quajtur kështu sipas emrit të peshkopit të mitropolisë së Beratit në shekullin e 19-të, është shkruar mbi pergamenë, me germa ari të tretur dhe përbën një gjë të rrallë në përgjithësi. Ky kod paraqitet me vëllim më të madh nga ai i pari, me 413 fletë me format 24 x 19 cm dhe është shkruar me germa të një tipi shumë më të vonë nga ai me germa të rrumbullakëta.

Që populli ynë e njihje mirë vlerën e thesareve dorëshkrime të lashtësisë së vet dhe që dinte t’i mbronte me çdo sakrificë, kjo dëshkohet edhe gjatë kohëve të reja. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur ushtritë naziste ishin në Berat, kërkuan nga këshilli kishtar i qytetit të dorëzoheshin kodikët më të vjetër të vendit, por priftërinjtë e këshillit/sinodit rezistuan, duke rrezikuar jetën e tyre para nazistëve, dhe nuk i treguan ku i kishin fshehur.

Pas luftës, kur u regjistrua dhe u identifikua thesari trashëgimor i vendit, në të cilin bënë pjesë dhe dorëshkrimet kishtarë mesjetare, nga punonjësit e shkencës me shqetësim të madh u konstatua se mungonin dy kodikë shumë të moçëm, që përbënin vlerat më të rëndësishme të këtyre dorëshkrimeve. Mungonte Beratinus-1, më i vlefshmi dhe më i rëndësishmi, i lashtësisë paleokristiane, me shkrim argjendi; si dhe tjetri, Beratinus-2, me shkrim ari, që quajtur „Kodiku i Anthimit“. Për ekzistencën e këtyre kodikëve kishte të dhëna të sigurta deri në pragun e mbarimit të luftës. Siç u mësua më vonë në Berat, kodikët në fjalë kanë qenë fshehur me qëllim të mirë, për t’u shpëtuar rreziqeve të luftës. Fatkeqësisht, kur u zbuluan, të dy kodet u gjendën në gjendje aq të dëmtuar, sa që mendohej se do të ishte i pamundur restaurimi i tyre. Por kujdesi që u tregua, me marrjen e masave të duhura për restaurim, dha mundësi rikthimin në jetë të këtyre monumenteve tona me kaq rëndësi.

Meritë e çmuar për restaurimin e këtyre kodikëve i përket Institutit të Arkeologjisë të Kinës; shkencëtarëve kinezë, të cilët, edhe në këtë rast, kanë treguar zotësi dhe kompetencën që karakterizojnë shkencën e këtij vendi. Si u restauruan, kodikët u kthyen në atdhe dhe u vendosën pranë Arkivit Qendror Shtetëror në Tiranë.

Gjatë Mesjetës, deri në gjysmën e shekullit të 15-të, kur u shpik shtypshkronja, dihet që librat janë prodhuar me dorë, mbi papirus ose pergamenë. Në Bizant, prej shekullit të 13-të, shkruheshin edhe në letër. Duke pasur parasysh faktin që gjatë kësaj etape historike vendi ynë ishte i krishterë dhe i mbushur me faltore të krishtera, kuptohet që ato faltore duhet të kenë qenë të pajisura me biblioteka për nevojat e kultit dhe për komunikim administrativ të tyre. Meqenëse për nevojat që u përmendën literatura e asaj kohe duhej të ishte me mijëra vëllime, mund të përfundohet se ato nuk mund të importoheshin nga jashtë, përveç rasteve të rralla. Këto dorëshkrime janë riprodhuar në atelietë e qendrave tona dhe prej njerëzve tanë, siç dëshkohet nga të dhënat e kodikëve të ruajtur deri më sot.

Të dhënat që flasin për riprodhimin e dorëshkrimeve kishtarë në vendin tonë dhe prej njerëzve shqiptarë janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Në një fletë të Kodikut të 50-të të Beratit gjendet shënimi autograf i riprodhuesit, ku thuhet: “U shkrua dhe u përfundua ky psalltir me shpenzimet e zotit Maksim, i cili ia dhuroi atë Manastirit të shën Mërisë në Vriazezis... U shkruajt me dorën time, të të përvoja Theodhor, logothet (sekretar) i Beratit pranë Theodhor Muzakës, në vitin 1411“.

Kisha e shën Mërisë dhe manastiri mesjetar në fshatin Vërri ruhen dhe sot në Myzeqe, në jug të fshatit Bubullimë. Emrin e riprodhuesit, të sekretar Theodhorit, e gjejmë edhe në një shënim tjetër të gjatë në një fletë pergameni, që i është lidhur në fund Kodikut të 24-t të Beratit. Kjo fletë paraqitet e grisur keq në drejtim gjatësor, duke e vështirësuar gati krejt leximin e shënimit. Nga fjalët e mbetura të këtij shënimi lexohet qartë: “U shkrua nga Theodhor gramatia (sekretari) dhe ... iu dha Gjergjit të madh, në vitin 1438“.

Kodiku në të cilin ka qenë futur kjo fletë me shënimin e mësipërm i atribuohet afërsisht fundit të shekullit të 12-të dhe fillimit të shekullit të 13-të. Prandaj, sekretar Theodhori i këtij shënimi, ka shumë mundësi të jetë i njëjti person që ka lënë edhe autoshkrimin si riprodhues i kodikut të 50-të. Në të dy shënimet korrespondojnë emri i kopjesit, Theodhorit; titulli i tij si sekretar;

vendi ku gjenden kodikët dhe afërsisht koha e shkrimit, me një diferencë prej 27 vjetësh. Sa për fjalët "... iu dha Gjergjit të madh", jemi të mendimit se pas këtij emri duhet kuptuar Gjergj Arianiti. Këto fjalë nuk mund t'i referohen Gjergj Kastriot Skënderbeut, i cili në vitin 1438 ende nuk ishte i dëgjuar në Shqipëri.

Në fletën 292 verso të Kodikut të 51-të të Beratit, në dy shënime autografe të riprodhuesit, lexohen fjalët: "Ky libër është i kishës së shën Mërisë dhe gjendet në manastirin e Vangjelistës... E shkrova unë, jeromonak Simeoni, në vitin 1425.

Kisha e shën Mërisë ruhet edhe sot në lagjen Kala të Beratit, në muret rrethuese të ish-manastirit mesjetar. Ka shumë mundësi që dhe jeromonak Simeoni të ketë qenë një nga murgjit e atij manastiri.

Në fletën 204 recto të Kodikut të 52-të të Beratit, në shënimin ktitorial (porositës), ndër të tjera lexojmë: "U shkruajt ka minej me shpenzimet e zotit Leu, legjistator i qytetit të Berat; ai ia dhuroi minejn manastirit të shën Mitrit, që e ndërtoi prej themeli në qytetin e Beratit... U shkrua në vitin 1429". Edhe kisha e ish-manastirit të shën Mitrit ruhet ende në kala të Beratit.

Në këto shënime autografe të pakontestueshme të autorëve të kodikëve të Beratit rezulton se dorëshkrimet e këtij qyteti janë të murgjëve tanë dhe të shkruara nga skriptorë (shkrues) vendës. Një punishte (shkollë) për dorëshkrime ungjillore ka shumë mundësi të ketë qenë në manastirin e Ungjillizimit (Vangjelistës).

Këto të dhëna autografe, që kanë mundur të shpëtojnë nga rrebeshet shumë të vështira gjatë shekujve të Mesjetës, dëshmojnë më së miri, gjithashtu, për vazhdimësinë e traditës së riprodhimit të dorëshkrimeve ungjillore të vendit tonë dhe prej njerëzve tanë deri vonë, edhe në periudhën osmane.

Si dëshmi të traditës së riprodhimit të dorëshkrimeve në Berat dhe në vise të tjera të vendit, përveç të dhënave të drejtpërdrejta nga kodikët, që u radhitën më sipër, ka edhe të tjera, të cilat në mënyrë të tërthortë dëshmojnë për vazhden e asaj tradite kulturore të vendit tonë. Për këtë traditë flasin stoqet e mëdha të dorëshkrimeve që kanë pasur kishat e Beratit, si dhe qendra të tjera kulturore mesjetare të vendit, të cilat i gjejmë të regjistruara në inventarët e thesareve të kishave, siç gjejmë të dhëna edhe për vetë kodikët që kanë shpëtuar deri më sot. Veç këtyre, për stoqe kodesh të tjera, që kanë pasë ekzistuar deri në ditët tona dhe që janë zhdukur tani vonë nga rrebeshet e luftërave, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore, ose nga zjarre aksidentale, dëshmojnë njerëz që i kanë parë me sytë e vet, ose që i kanë pasur nën mbikqyrjen e tyre dorëshkrimet.

Në faqet 126 e 127 të veprës së sipërpërmendur të Batiffolit është botuar lista e 27 kodeve të zgjedhura si më të çmueshmit të kishës së shën Gjergjit dhe të asaj të Theologut në Berat, të cilat i shpëtoi Skuripeqi me murgun Theodhul. Gjithashtu në Kodikun e 7-të të Vlorës, fleta 2 recto, lexojmë listën e objekteve me vlerë të kishës së Shënepremtes, ku gjenden të regjistruar dhe 16 tituj libra në dorëshkrim, si pronë të asaj kishe.

E njohur dhe e pasur me dorëshkrime ka qenë deri nga gjysma e shekullit të 19-të biblioteka në manastirin e shën Mërisë së Kokomesë, pranë Sarandës, ajo e ipeshkvisë së Gjirokastrës, si dhe ajo e manastirit të shën Gjon Theologut pranë Delvinës, të cilat nuk ekzistojnë më.

Nga një tregim i voskopojarit Stefan Buzali, që ka qenë epitrop (kujdestar) në manastirin e shën Prodhomit të Voskopojes, mësuam se gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur u dogj Voskopoja nga nazistët, u dogjën në shtëpinë e tij në Voskopoje më se 20 vëllime librash në dorëshkrime, pronë të bibliotekës së manastirit të shën Prodhomit të Voskopojes.

Këtu e shohim me vend të vëmë në dukje ngjarjen fatkeqe që u ndodhi dy kodikëve më të vjetër e më të vlefshëm të thesarit dorëshkrimor të vendit tonë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Gjithashtu dihet për dëmin e madh të shkaktuar nga një zjarr aksidental që ra në manastirin e Ardenicës, në Myzeqe, më 1924, i cili, përveç thesareve shumë të tjera të çmueshme, dogji dhe mjaft libra dorëshkrime mesjetare, të cilat i kanë parë njerëz që rrojnë edhe sot.

Para Luftës së Dytë Botërore, edhe nëpër manastiret tanë të vegjël, ose kisha fshatrash, si

në katedralen e Elbasanit, në kishën qendrore të Ziçishtit (Korçë) etj. gjendeshin nga një ose më tepër libra në dorëshkrim, siç na kanë treguar njerëz që i kanë parë me sy, të cilat sot nuk gjenden më.

Duke u mbështetur në të dhënat që u radhitën më sipër dhe në të tjera që nuk po i radhisim, del qartë se Shqipëria gjatë periudhës historike bizantine, si dhe gjatë periudhës osmane, ka pasë qenë e pasur në biblioteka me dorëshkrime, por, për shkak të rrethanave shumë të vështira gjatë rrebesheve të luftërave, nga ajo pasuri e thesarit dorëshkrimor vetëm një pakicë ka mundur të shkojë deri në ditët tona dhe këto më tepër në kishat e Beratit dhe në rezidencën ipeshkvnore të atij qyteti.

Ekzistenca e një pasurie kaq të madhe dorëshkrimesh në vendin tonë gjatë mesjetës dëshmon në mënyrë të tërthortë se këto duhet të jenë riprodhuar në vend dhe kurrsesi të kenë ardhur nga jashtë. Nuk ekskludohet që ndonjë kodik të jetë blerë e sjellë nga jashtë, siç dëshmohet nga të dhënat e disa dorëshkrimeve, sidomos gjatë shekullit të 17-të, gjë që korrespondon me kohën e kufizimeve që pati krishtërimi për shkak të fesë zyrtare të ish-Perandorisë Osmane.

Përveç Kodikut të Purpurt të Beratiit, shkrimi i të cilit është prej argjendi të shkrirë mbi pergamenë të purpurt, që sot paraqitet shumë e zbehtë dhe atij që mban emrin e Anthimit, shkruar me germa ari të shkrirë mbi pergamenë të pangjyrosur<sup>2</sup>, kodikët e tjerë prej pergamene e letre janë shkruar me ngjyrë kafe të zakonshme.

Të gjithë kodikët agjiografikë të këtij katalogu, përveç dy dorëshkrimeve laike të vona të shekullit të 18-të, sipas përmbajtjes së tyre mund të ndahen në tre grupe:

1. Grupi i kodikëve biblikë;
2. Grupi i kodikëve liturgjikë;
3. Grupi i kodikëve agjiografikë.

Në grupin e kodikëve biblikë përfshihen dorëshkrime të Dhjatës së Vjetër, nga të cilët sot ruhen 3 ekzemplarë (psaltirë), dhe libra dorëshkrime nga Dhjata e Re, që numërohen 10 vëllime katërngjijsh<sup>3</sup>.

Nga kodikët dorëshkrimorë mesjetarë, që janë gjetur dhe sot dhe ruhen pranë Arkivit Qendror të Shtetit, gjithsej mbërrijnë në 100 copë, nga të cilët 92 vëllime të riprodhuar gjatë periudhës paraosmane, deri në shekullin e 15-të; si dhe 15 të tjerë të kohës së sundimit osman, që shkojnë deri në shekullin e 18-të.

Nga këto, dorëshkrime të shkruara në pergamenë janë 35 vëllime, që shkojnë deri në shekullin e 14-të, kurse 26 të tjerë janë të shkruajtur në letër dhe shkojnë prej gjysmës së dytë të shekullit të 13-të deri në dekadat e para të shekullit të 14-të. Periudhës pas okupacionit osman i takojnë 15 libra dorëshkrime në letër, që arrijnë deri në shekullin e 18-të.

Nga kodikët tanë të shkruar në pergamenë, një pjesë janë prej pergamene të kualitetit të parë, ngjyrë të bardhë; të tjerët janë në ngjyrë të fildishtë, shumica pergamenë e kualitetit të dytë e të tretë. Kurse dorëshkrimet në letër, ato të shekullit të 13-të (dy vëllime) dhe ato të fillimit të shekullit të 14-të, janë prej letre të trashë, që vjen si në të verdhë, kurse ato të fundit të shekullit të 14-të dhe sidomos ato të shekullit të 15-të e më të vonët, janë prej një letre shumë më të hollë e më të bardhë.

Duke qenë se kodikët tanë janë shkruar gjatë shekujve të Mesjetës, duke filluar prej më të hershmeve e deri te më të vonët, edhe paleografia e tyre ndryshon sipas shekujve kur ata janë riprodhuar.

Kodiku ynë më i vjetër, "Beratinus", është shkruar me shkrim të vazhdueshëm pa ndarje midis fjalëve. Gerमत i ka të tipit kuadrat, kapitale të tipit të vjetër të përzier, domethënë me të mëdha biblike. Format i fletës është 314 x 268 mm. Të dhëna më të hollësishme rreth karakteristikave të këtij kodiku me shumë rëndësi të literaturës paleokristiane janë dhënë tek botimi i Batiffolit.

Me rastin e kërkimeve tona, një tjetër kodik zbulohet në Berat, me shkrim të vazhdueshëm,

pa ndarje midis fjalëve. Gërmat i ka kapitale <sup>4</sup>.

Teksti i kodikut është me dy kolona për faqe, me 25 rreshta për kolonë, me shkrim të vazhdueshëm, pa ndarje midis fjalëve, fjalët pa thekse e pnevma (pauza), por nganjëherë në ndonjë germë të disa fjalëve ka nga tri pika. Nëpër tekst hasen shumë fjalë të shkurtuara, si p.sh. ANO, KC, CTPON etj. Disa germa dalin nga madhësia e rreshtit si epsilon, zeta, rota. Grafia është në ngjyrë kafe. Gjatë tekstit fjalitë ndahen njëra nga tjetra me anë të kryqeve. Kodiku ruan vetëm dy vinjeta formë kuadrati të stolisura me motive gjeometrike dhe shpesh të stilizuara. Teksti, përveç inicialeve të stilizuara, që arrijnë madhësinë e dy rreshtave, ka dhe shumë iniciale të mëdha të pikturuara jashtë kolonës së tekstit, me madhësi deri në 5 cm, të stolisura këto me ngjyrë kafe dhe ar të ndritshëm.

Për këto karakteristika dhe për faktin se grafia e kodikut paraqitet më e ngushtë nga ajo e „Beratinus-it“, gërmat më të vogla dhe lartësia e tyre më e vogël, duke munguar ajo kaligrafi e kodikëve paleokristianë; veç kësaj, duke u mbështetur edhe në motivet e vona të vinjetave dhe të inicialeve të stolisura, të gjitha këto na bindin që kodiku në fjalë nuk mund të jetë më i hershëm se ai i gjysmës së parë të shekullit të 9-të dhe jo më i vonë se fundi i këtij shekulli. Kjo edhe për faktin se në këtë shekull mbaron shkrimi i kodeve me germa kapitale dhe fillon shkrimi me germa korsive me bishta.

#### **Shënime të redaksisë:**

1. Teksti botohet sipas origjinalit që ruhet në AQSH, me disa redaktime. Punimi ishte përgatitur për të shërbyer si mjet informimi për studiuesit, si hyrje e katalogut të kodikëve mesjetarë të Shqipërisë.
2. Një vlerësim analogjik është bërë për zhvillimin e mjeshtërive artistike në Berat, në Mesjetë, nga prof. Aleks Buda, në artikullin e botuar në vitin 1971, që ribotohet në këtë vepër.
3. Ndyshe nga mendimi i autorit, në listat ndërkombëtare të letërsisë ungjillore të shkruar në pergamenë të purpurt gjendet edhe Beratinus-2.
4. Këtë kodik autori nuk e ka identifikuar në „Katalogun ...“ e përgatitur prej tij. Studiuesi britanik Roderic L. Mullen ka bërë krahasime të një fragmenti kodiku me shkrimin e Beratinus-1.



## RRETH “VENDLINDJES” SË KODIKËVE MESJETARË TË SHQIPËRISË<sup>1</sup>

KOSTA NAÇO

207

Në Arkivin Qendror të Shtetit ruhet një koleksion i konsiderueshëm kodikësh mesjetarë të shkruar në gjuhën greke, në pergamenë, ashtu dhe në letër. Këto dorëshkrime janë një material autentik, që na vjen nga thellësia e shekujve, në një kohë kur burimet për historinë e Shqipërisë për shekujt VI-XI janë të varfra.

Natyrisht, numri i kodikëve që kanë arritur te ne është shumë herë më i vogël në krahasim me numrin e kodikëve të shkruar nëpër kishat, manastiret dhe në qendrat e tjera të shkrimit në vendin tonë. Burimet e ndryshme historike njoftojnë se numri i kodikëve ishte shumë më i madh. Kjo çështje mund të përbëjë në të ardhmen objektin e një studimi të veçantë.

Kodikët janë shkruar në gjuhën greke, se gjuha greke ka qenë për një kohë të gjatë gjuha zyrtare e Perandorisë Bizantine, ku bënte pjesë edhe vendi ynë; ka qenë gjuha e kishës ortodokse, dhe ishte afirmuar si gjuhë kulture në përgjithësi.

Këto dorëshkrime të shkruara në gjuhën greke i cilësuam “*kodikë mesjetarë<sup>2</sup> shqiptarë*”, për arsye se në pjesën e tyre dërmuese janë shkruar në vendin tonë, prej njerëzve tanë, siç do të përpiqemi ta provojmë më poshtë. Për të provuar këtë, do të mbështetemi, së pari, në të dhënat që na japin kodikët, dhe kryesisht në shënimet e tyre bibliografike dhe anëshkrimet, dhe, së dyti, në njoftimet që na japin burimet historike nga fushat e tjera, që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi lidhen me çështjen që trajtojmë.

Në përgjithësi, kopjuesi, pasi kishte kopjuar kodikun, në fund të tekstit linte një shënim bibliografik, në të cilin theksonte kohën kur e mbaroi së kopjuari, vendin ku e shkroi, emrin e vet, emrin e personit ose të institucionit që financoi punën për kopjimin e kodikut, zotëruesin e kodikut, që mund të ishte një person ose një institucion (kishë ose manastir në përgjithësi), dhe arsyen pse e shkroi kodikun.

Natyrisht, të rralla janë shënimet bibliografike kaq të plota. Zakonisht gjejmë shënime bibliografike për kohën, emrin e autorit dhe më rrallë për vendin ku u shkrua.

Veç kësaj, shumë nga shënimet bibliografike janë shuar, nga që koha dhe kushtet e papërshtatshme të ruajtjes kanë dëmtuar kodikun dhe natyrisht, edhe shënimet bibliografike, që zakonisht liheshin në fletën e fundit.

Fatmirësisht, në kodikët që kemi, hasim një pjesë të mirë kodikësh që i ruajnë shënimet bibliografike. Këto shënime tregojnë se në qendrat kishtarë, manastiriale dhe në qendra të tjera të vendit tonë kopjoheshin kodikë, të cilët kanë një natyrë të larmishme përsa i përket përmbajtjes së tyre: ata përmbajnë tekste ungjillore, jetëshkrime shenjtorësh, mujore<sup>3</sup>, psalme, muzikë dhe letërsi bizantine e deri tekse historike dhe filozofike.

Po japim disa nga këto shënime:

Në Kodikun e 13-të të Beratit<sup>4</sup> gjejmë shënimin e mëposhtëm: “*Ky ungjill është punuar në kohën e Andreas e të Joanit të Papa Joanit dhe në kohën e Nikollë Anastasit dhe të Konstandinit, të bijtë e Joanit, me kontributin e tyre. Dhe iu kushtua tempullit të nderuar të Fjetjes së Shën Mërisë, 1729, mars 30. Me dorën e Voskopjarit Filip Anastasit,*”.

Kodiku i 21-të i Beratit, në fletën 31, ruan vitin e kopjimit, që është viti 1181, dhe emrin e autorit, që është dhjakon Joaniqi (dhjaku Gjon).

Një shënim interesant gjejmë në fletën 251 të Kodikut të 24-t të Beratit. Shënimi është shumë i dëmtuar nga grisja e fletës në mënyrë vertikale, saqë nuk mund të lexohet gjë, veç dy fjali: “*i është dhënë Gjergjit të Madh,*” dhe në fund të fragmenteve, data 6946 (viti i krijimit të botës

sipas kishës, gjegjësisht viti 1438 sipas kalendarit të ri); “*E shkroi Theodhor Gramatia*”. Ky Gjergj i Madh që përmendet, nuk mund të jetë heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti, për arsye se ky në atë kohë nuk ishte bërë i dëgjuar që të quhej i madh, por ka mundësi të jetë Gjergj Arianiti, i cili atëherë sundonte në Myzeqe<sup>5</sup>. Shkruesi i shënimit fragmentar është Teodori, që duhet të ketë qenë *gramatia* (sekretari) i qytetit të Beratit. Në këtë kohë Berati ka qenë “*qytet shumë i shkëlqyer*”, siç shkruan piktori Onufri në mbishkrimin autograf të tij në Kishën e Shën Apostujve në Kostur të Greqisë, të cilën e ka pikturuar.

Në Kodikun e 27-të të Beratit hasim katër anëshkrime, që janë shënime të mëvonshme nga koha e kopjimit të kodikut. Në këto anëshkrime hasim emrin e një meshtari të quajtur Foti Skuripeqi, dhe të gruas së tij, që thirrej kontesha Skuripeqi. Ka të ngjarë që kjo të jetë nga familja e njohur e Skurajve. Sipas burimeve të tjera, që i gjejmë në artet figurative, këta bashëshortë kanë jetuar në shek. XIV. Këto shënime të konteshës dëshmojnë se kjo nuk e ka njohur mirë greqishten, siç del nga gabimet drejtshkrimore të shënimeve.

Në Kodikun e 49-të gjejmë një shënim të peshkopit të Beratit, Joasafit, që ishte me origjinë nga Bubullima e Lushnjës.

Kodiku i 50-të u shkrua nga Teodori, ish-sekretar i Beratit pranë zotit Teodor Muzaka dhe që në kohën kur e shkroi ka qenë i mbyllur në kalanë e Skraparit.

Kodiku i 51-të i Beratit, që është i vitit 1426, është kopjuar nga jeromanak Simeoni në manastirin Evangjelista<sup>6</sup>, në kala të Beratit. Ndërsa Kodiku i 52-të u shkrua në vitin 6937 (gjegjësisht 1429), dhe kjo saktësohet në shënimin bibliografik<sup>7</sup> të këtij kodiku, ku thuhet: “U shkrua ky minej (mujor) me shpenzimet e të shumënderuarit Leut, legjislatori i qytetit të Beratit, dhe u vu në manastirin e Shën Mitrit”.

Shënime bibliografike kanë edhe kodikë të tjerë, por nuk dua të lë pa theksuar se Kodiku i 71-të u shkrua me dorën e Teodor Haxhifilipit, që është i njohur edhe për alfabetin e hartuar prej tij, ndërsa në Kodikun e 72-të gjejmë edhe një himn të Jan Kukuzelit nga Durrësi, të cilin kopjuesi e quan “maestro”.

Në Kodikun e 74-t është kopjuar fizika dhe metafizika e voskopojarit Anastas Kavalioti.

Veç kodikëve të plotë kemi edhe fragmente kodikësh prej pergamene. Në shumë kodikë prej letre janë lidhur fletë të shkruara pergamene për të forcuar lidhjen. Këto fletë janë pjesë nga kodikë më të vjetër, të dëmtuar dhe të shkatërruar. Kjo vërteton faktin se numri i kodikëve ka qenë shumë herë më i madh, gjë që përforcohet nga të dhënat dokumentare.

Peshkopi i Beratit, Anthim Aleksudhi, në librin e vet “*Përshkrim i shkurtër historik i mitropolisë së shenjtë të Beratit*”, na njofton se në Berat gjendej edhe një kodik tjetër me shkronja të arta, i shkruar në pergamenë, të cilin sot nuk e kemi<sup>8</sup>. Po ashtu, shumë manastire dhe kisha të tjera të përmendura të vendit tonë kishin kodikë të vjetër të shkruar në pergamenë, të cilët sot nuk gjenden.

Karakteristikë e kodikëve tanë mesjetarë është vazhdimësia e tyre në planin kohor nga shekulli VI, që është kodiku më i hershëm, gjatë gjithë periudhës bizantine, madje edhe gjatë periudhës së sundimit osman, çka tregon se forcat tona intelektuale edhe në periudhën e errët të sundimit osman bënë përpjekje për të zhvilluar kulturën e tyre. Nga ana tjetër, kjo dëshmon se ekzistonte një traditë, një bosht i qëndrueshëm, një elitë intelektuale brenda vendit, ndryshe pushtimi osman do ta kishte shuar fare traditën e kopjimit të kodikëve.

Fakti që në vendin tonë ekzistonin shumë kisha dhe manastire të ndërtuara nga njerëzit tanë, që kishin shkollat, bibliotekat dhe arkivat e tyre, ku kodikët ishin pjesë e pandarë e pajisjeve të këtyre institucioneve; fakti tjetër që në vendin tonë u thirrën sinode lokale kundër herezive të ndryshme fetare që shpërthyen gjatë mesjetës, duke mbështetur vendimet e sinodeve të shenjta ekumenike, si dhe fakti që nga gjiri i popullit tonë, edhe në kohërat më të errëta të pushtimeve kanë dalë personalitete të shquara, si në fushën politike, në atë të arteve, të shkencës, si dhe figura hierarkësh të kishës, dëshmojnë për një ngritje kulturore e intelektuale, që pasqyron një zhvillim të caktuar ekonomik, për një qëndrim aktiv të forcave politike dhe intelektuale shqiptare.




Një karakteristikë tjetër është shpërndarja e gjerë gjeografike e kodikëve brenda vendit. Kemi kodikë nga Vlora, Gjirokastra, Voskopoja, Korça, Elbasani, Berati etj. Shumica e tyre janë gjetur në Berat, por nuk do të thotë se të gjithë u përkasin kishave dhe manastireve të Beratit. Kur Berati u bë qendër ipeshkvnore, mblodhi arkivat, rrjedhimisht edhe kodikët e Vlorës, të Apolonisë, të Bylisit, të Gllavenicës, prandaj është më e madhe sasia e kodikëve të Beratit. Pra, kodikët mesjetarë nuk janë gjetur në dy ose tri qendra të veçuara, por kanë një shtrirje gjeografike mjaft të gjerë, ashtu siç kanë edhe një larmi të mahnitshme tekstesh për sa i përket përmbajtjes.

Ndër kodikët që janë identifikuar plotësisht se janë shkruar në vendin tonë dhe nga njerëzit tanë, një pjesë e mirë janë të një cilësie të lartë për sa i përket kopjimit të tekstit, çka tregon për një nivel të lartë realizimi artistik, sepse të shkruarit bukur ishte me të vërtetë një punë artistike.

#### **Shënime të redaksisë:**

1. Botuar për herë të parë në revistën "Shkenca dhe jeta", viti 1991, nr. 3, fq. 34-36. Ribotohet me pak shkurtime.
2. Ky përcaktim, relativisht i pranueshëm (në kodikët e Shqipërisë ka edhe dorëshkrime të periudhës së paleokrishtërimin, para-mesjetarë), është përdorur më herët nga Theofan Popa.
3. Kalkim i autorit për termin "minej".
4. Në këtë studim autori të gjithë kodikët i cilëson "të Beratit", pavarësisht se cili ka qenë burimi vendor i tyre. Kjo mund të ketë ardhur edhe nga njësimi i shkurtesave që ka përdorur autori prej redaksisë (Kod. Br.).
5. Ky konstatim gjendet analogjikisht në „Katalogun ...“ e Theofan Popës, hyrje.
6. Në kishën e ungjillëzimit.
7. Këtu fjala „bibliografik“ është në kuptim jo terminologjik.
8. Duhet të jetë fjala për „Liturgjinë e Shën Gjon Gojartit“.



**UNGJILLI SIPAS MATEUT DHE SIPAS MARKUT, GREQISHT <sup>1</sup>**  
 ("CODEX PURPUREUS BERATINUS", F)

EDOARDO CRISCI  
 SHABAN SINANI <sup>2</sup>

**SHEKULLI I 6-TË; PERGAMENË, 314 MM X 268 MM; FLETË-190**  
 BERATINUS-1, TIRANË, ARKIVI QENDROR I SHTETIT

I. Ky kodik i famshëm, i dëmtuar pjesërisht, përmban ungjijtë sipas Mateut dhe sipas Markut. I pari zë faqet nga 1 recto deri 112 recto. I dyti zë faqet 115 recto deri 190 recto. Faqja 112 recto është e bardhë, ndërsa faqet 113 recto deri 114 recto përmbajnë krerët ("kejalaiia") e Ungjillit sipas Markut.

Sipas një përlllogaritjeje të studiuesit belg Pierre Batiffol, dorëshkrimi duhet t'i kenë humbur rreth 40 fletë. Ato që mungojnë i përkasin Ungjillit sipas Mateut: 1-6, 3; 7, 26-8, 7; 18, 29-19, 3; 23, 4-13; dhe Ungjillit sipas Markut: 14, 62-16, 20.

Kodiku është i shkruar mbi pergamenë të purpurt me germa të argjendta, dhe me inicialet e kapitujve të florinjta. Teksti paraqitet i ndarë në 2 kolona, me përmasa rreth 210 x 190 mm <sup>3</sup>, dhe me 17 rreshta të shkruar. Dorëshkrimi është i shkruar me gërma të mëdha biblike, shkrim që u shenjtërua që në shekullin e 3-të pas Krishtit, dhe vazhdoi të përdorej në praktikën librore deri në shekullin e 9-të. Në këtë ekzemplar, nëpërmjet formave grafike, dokumentohet një fazë e përparuar e rregullsisë në shkrim <sup>4</sup>. Gërmat janë të modulit të madh dhe paraqesin një kontrast të stërholluar dhe të studiuar ndërmjet vijëzave mjaft të trasha dhe atyre tepër të holla. Zbukurimet shtesë të nxjerra në pah në forma kuadrate dhe trekëndore të vogla, kompletojnë vijat horizontale, e nganjëherë dhe ato pingule të disa gërmave, kryesisht gama, delta, ypsilon, pi, tau, psi. Për t'u shënuar është dhe prirja e mbarimit të vijave pingule të gërmave me një prerje tërthore nga e djathta në të majtë (p.sh.: pi, tau, ypsilon, psi).

Monumentaliteti i formave, mrekullia e stilit grafik, e për më tepër përdorimi i pergamenës së purpurt si dhe bojërat e çmuara, e bëjnë këtë dorëshkrim të barabartë me dorëshkrimet e tjera të purpura të së njëjtës periudhë si: "Rossanensis" (Rossano Calabro, muzeu i dioqezës), "Sinopensis" (Paris, Biblioteka Kombëtare e Francës, Suppl. gr. 1286 <sup>5</sup>; "Kodiku N", ungjij (fragmente të të cilit paraqiten dhe këtu: Vat, gr. 2305; "Gjeneza" i Vjenës (Vjenë, Biblioteka Kombëtare e Austrisë, Theol. gr. 31).

Ky lloj prodhimi libror (luksoz) është konceptuar më tepër për ekzaltimin simbolik e figuror të tekstit të shenjtë dhe të vlerave të lidhura me të, sesa për leximin logjik e kuvendor, ose për praktikën liturgjike të përditshme.

Veçanërisht domethënës, në këtë kuptim, është përdorimi i pergamenës së purpurt, për cilësitë thellësisht simbolike të rrënjësura në të tilla vlera. Dihet që e purpura në kohën e Diokleacianit ishte ngjyrim i atributit tipik të madhështisë perandorake. Pergamena e purpurt u përdor në libra duke filluar nga shekulli i 4-t. Publilio Optaziano Porfirio i dedikoi Konstandinit një përmbledhje me poezi shkruar me ar e argjend. Pak a shumë të së njëjtës kohë janë ankimet e Shën Jeronimit kundër mburrjes së tepërt me kodikët e purpurt të shkrimit, shpesh jokorrektë në mënyrën filologjike.

Me gjithë këtë pozicion të papajtuësëm (që pasqyron polemikën e etërve të kishës ndaj

librave të shenjtë dhe përdorimit të së purpurtës) në prodhimin libror realizohet, siç vëren dhe Gulielmo Cavallo, “një zhvendosje e vlerave semantike nga simbolizimi i pushtetit perandorak në shenjtërinë hyjnore“, ku fjala e krishterë merr ngjyrimin e purpurt, e kjo gjë i përçon librit (tekstit) vlerën e sendit të adhuruar, vlerë që fuqizohet me përdorimin e bojërave të çmuara (argjend dhe ar), nga ripunimi i shkrimeve të praktikës librore të kohës, në format monumentale grafike, dhe, në disa raste, nga shtimi i cikleve ikonografike“. (Cavallo 1987, p. 14)<sup>6</sup>. Ky shkrim shquhet për vlerat e veta sidomos në krerët (“kejalaiia”), në ndarjet /fletët / paralajmëruese; në kanonet e Eusebit dhe në titujt e zakonshëm të kohës. Në kodikun “Beratinus” germa e madhe biblike („maiuscola ogivale“) është e drejtë.

Datimi i dorëshkrimit si i shekullit të 6-të bazohet, veç vlerësimeve të natyrës kodikologjike, tipologjisë dhe teknikave librore në realizimin e dorëshkrimeve, edhe mbi argumente paleografike, të bazuara mbi vlerësimin e dinamikave të zhvillimit kanonik të germës së madhe (majuskole) biblike.

Për sa i përket origjinës së dorëshkrimit, në mungesë të të dhënave objektive, supozohet, megjithëse me rezervë, që mund të ketë ardhur nga zona siro-palestineze<sup>7</sup>. Duke parë analogjitë e qarta grafike mes “Beratinus-it” dhe të famshmëve: “Rossanensis“, “Sinopensis“, “Kodikun N” dhe “Gjeneza” e Vjenës, mendohet të jenë prodhime të të njëjtit laborator, të përshtatur, me sa duket, për realizimin e kodikëve të luksit, që të kënaqnin kërkesat e larta, si ato laike, ashtu dhe ato kishtarë. Prania e dorëshkrimit në qytetin e Tiranës është dokumentuar që nga shekulli i 14-të. Në diptikun e Kishës së Shën Gjergjit, që ndodhet në kështjellën e Beratit, besimtari Skouripekis përmendet që, në vitin 1356, gjatë marshimit të serbëve, i nxitur nga murgu Theodulos, çoi në një vend të sigurt 27 dorëshkrime të çmuara, midis të tjerash dhe “Beratinus“.

**II.** “Codex Purpureus Beratinus“ (Tiranë, Arkivi Qendror i Shtetit) dhe „Codex Aureus Anthimi“ (Tiranë, Arkivi Qendror i Shtetit, Beratinus-2) kanë qenë ndër veprat e artit që figuronin në listën e pasurive kulturore “të kërkuara“ gjatë Luftës së Dytë Botërore. Autoritetet kishtarë dhe besimtarët e Beratit, të cilët ishin urdhëruar të dorëzonin menjëherë të dy dorëshkrimet, refuzuan të tregonin vendin në të cilin i kishin fshehur, megjithëse kjo për ta ishte një sakrificë e madhe. Ato i kishin fshehur në gurët që vishnin anët e brendshme të një pusi.

Në vitet që pasuan, për një periudhë kohore të caktuar, të dy dorëshkrimet u quajtën të zhdukura. U rishfaqën në vitin 1968, në një kishë në lagjen “kala” të Beratit, për fat të keq tepër të dëmtuara.

Në vitin 1971, në bazë të një marrëveshjeje ndërshtetërore, Kodiku i Purpurt i Beratit u dërgua në Kinë për t’u restauruar. Përveç restaurimit, i cili u krye me sukses, u realizua dhe një riprodhim i njësojtë, që shërben për qëllime studimore, në vend të origjinalit.

Për të siguruar një ruajtje që t’i qëndrojë kohës, të gjitha faqet e dorëshkrimit, pas restaurimit, janë futur në pllakëza xhami me mbyllje hermetike. Kodiku është ndarë në nëntë volume, që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë.

Ngjyra e purpurt e pergamenës të Beratinus-1 ka pësuar një zbehje dhe çngjyrosje progresive gjatë shekujve. Vetë pergamena është brejtur dhe dëmtuar.

Kapaku është metalik, me dekoracione në relief. Kapaku është mjaft më i vonët se kodiku<sup>8</sup>. Midis veshulëve të stilizuar, mbi dy pllakëza të sheshta, është paraqitur skena e kryqëzimit të Krishtit. Në dy anët janë përkatësisht Shën Mëria dhe Shën Gjon Pagëzori. Rreth tyre qëndrojnë engjëjt mbrojtës. Një pllakëzë tjetër ka ringjalljen, e shoqëruar kjo në katër anët nga ungjillorët, secili me simbolet e veta.

“Codex Purpureus Beratinus“ është i përfshirë në programin “Kujtesa e Botës“ (“Memoire du Monde”) të Unesco-s dhe është gjithnjë nën kujdesin e këtij organizmi ndërkombëtar.

Në të shkuarën ky kodik është ekspozuar vetëm dy herë në Shqipëri. Në jubileun e madh të 2000-vjetorit të krishtërimit, kodiku, për herë të parë, me leje të posaçme të autoriteteve shqiptare, ekspozohet jashtë kufijve shtetërorë, në ekspozitën “Ungjijtë e Popujve“, organizuar

nga Biblioteka Apostolike e Vatikanit për nder të kësaj ngjarjeje të madhe.

### **Bibliografi:**

1. Batiffol, Pierre: *“Evangelorium codex graecus purpureus Beratinus F”*, në *“Mélange d’archéologie et d’histoire”*, Ecole Française de Rome, 1885 (5); p. 358-386.
  2. Batiffol, Pierre: *“Les manuscrits grecs de Berat d’Albanie et le Codex Purpureus F”*, në *“Archives des missions scientifiques et littéraires, 3<sup>ème</sup> sér., 1887 (13), p. 437-556.*
  3. Alexoudes, Antimus: *“Katalogos ton en tais ieraiis ekklesiais tis sinoikias Kastrou, poleos Beratiou ...”*, 1900.
  4. Koder, Johannes: *Zur Wiederentdeckung zweier Codices Beratini“*, në *„Byzantinische Zeitschrift 65 (1972) p. 327-328.*
  5. Cavallo, Guglielmo: *„Il codice purpureo di Rossano: libro, oggetto, simbolo“*, në *„Cavallo-Gribomont-Loerke“*, 1987.
- Ekspozohen 20 fletë, duke filluar nga fleta 163 recto (Ungjilli sipas Markut, 9, 47-10, 1) dhe kapaku metalik.

### **Shënime shpjeguese:**

1. Skedë e *“Kodikut të Purpurt të Beratit”*, botuar italisht në *„I Vangeli dei Popoli“*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 2000, p. 130-133.
2. Pjesa e parë e skedës u përgatit nga Edoardo Crisci, kurse pjesa e dytë e saj nga Shaban Sinani.
3. Përmasat e fletës së këtij dorëshkrimi në skedën përkatëse jepen gabim. Sikurse njoftohet në nëntitull, përmasat e sakta të fletës janë 314 mm x 268 mm.
4. Në tekst përdoret fjala *“canone”*, por nga konteksti përjashtohet çdo kuptim tjetër i kësaj fjale, si: a. Tabelë përmbledhëse dhe orientuese e leximit dhe përdorimit me lehtësi të ungjijve (*“kanonet e Eusebit”*); b. Rregullore, ligj, nom, që ka të bëjë me funksionimin e brendshëm të kishës. Në kontekstin e përdorur ka kuptimin e rregullit në të shkruar.
5. *„Suppl. gr. 1286”* është forma e shkurtuar e citimit të këtij kodiku në indeksimin ndërkombëtar të dorëshkrimeve ungjillore nga Gregory-Aland.
6. Citimet e brendashkruara janë të autorëve dhe identifikohen në bibliografinë në përmbyllje të skedës.
7. Përkundër kësaj teze, ka dijetarë shqiptarë e të huaj që flasin për një kryqëzim ndikimesh *„të Lindjes dhe të Perëndimit”* (Buda) dhe, madje, për një shkollë lokale të shkruarve të dorëshkrimeve ungjillore (Mullen).
8. Kapaku mban vitin 1804.



**DORËSHKRIMET BIBLIKE QË GJENDEN  
NË ARKIVIN QENDROR TË SHTETIT NË SHQIPËRI (TIRANË),  
TË KATALOGUAR NË FONDIN 488<sup>1</sup>**

RODERIC L. MULLEN (PH. D)

215

I.

Në maj të vitit 2002 pata privilegjin të shikoj dorëshkrimet në gjuhën greke të Testamentit të Ri, dhe dorëshkrime të tjera të ngjashme, në Arkivin Qendror të Shtetit, në Tiranë. Dua të falenderoj dr. Shaban Sinanin, drejtor i këtij Arkivi, dhe bashkëpunëtorët e tij, për ndihmën e tyre bujare gjatë vizitës sime në Tiranë. Gjithashtu falënderoj z. Altin Hysi dhe ndihmësit e tij në Shoqatën Biblike Shqiptare, për ndihmën që më dhanë në realizimin e kësaj vizite.

Dorëshkrimet që do të diskutohen në këtë artikull janë sjellë nga vende periferike të Shqipërisë në vitet '60 dhe janë sistemuar në Fondin 488 të Arkivit Qendror Shtetëror nga Theofan Popa etj. Nga fotot duket se disa nga dorëshkrimet ishin në gjendje të mjerueshme, kur ato u sollën në Arkiv.

Fondi 488 përfshin 100 tituj të përshkruar, të cilëve më pas iu bashkëngjitën edhe 17 fragmente. Johannes Koder dhe Erich Trapp u lejuan të shihnin disa nga këto dorëshkrime në vitet '60, por, me sa duket, në këtë kohë ende nuk ishte bërë sistemimi i tyre, kështu që në artikullin e tyre të botuar në vitin 1967 japin një përshkrim të plotë të dorëshkrimeve, por nuk përmendin numrat e tyre përkatës në katalogun ku bëjnë pjesë. Në vijim, në vitin 1972, Koder shkroi një artikull të shkurtër në të cilin ai jep numrat e katalogut në fjalë për Kodikun e Purpurt të Beratit (Gregory -Aland 043) dhe Beratinus-2 (Gregory-Aland 1143).

Lista që vijon është një përpyetje për të analoguar dorëshkrimet e Fondit 488 të AQSH me listën e dorëshkrimeve të Alexoud-it në vitin 1882 (rishtypur në vitin 1900), me atë të Batiffol-it më 1887, të Koder-it dhe Trapp-it më 1967 dhe 1972, dhe me numrat e "Listës Kurzgefasste" të Gregory-it dhe Aland-it.

Janë të njohura në gjithë botën peripecitë në historinë e Shqipërisë. Për këtë arsye nuk ishte e papritur për mua që një numër i konsiderueshëm dorëshkrimesh, të përshkruar në librat e vjetër, të mos gjendeshin në katalogët e arkivave, pra të ishin të papërmendur edhe nga autorët e hershëm.

Dorëshkrimi „Liturgjia e Shën Gjon Gojartit (John Chrysostom), i shkruar me ar, dikur në zotërim të Anthim Alexoudes-it, nuk ishte parë më që prej vitit 1886.

Numrat e referencës të kodikëve në këtë artikull janë vendosur sipas skedave që ruhen në AQSH, pas katalogimit nga Popa, dhe siç janë paraqitur nga Sinani në formë të shkurtuar. Datat e vendosura janë shënuar sipas Popës.

**Kodiku i Beratit, nr. 1 (“Codex Beratinus“)** <sup>2</sup>

Gregory-Aland: 043 (F).

Tipi: Katërungjillësh.

Koha: Shekulli i 6-të.

Materiali: Pergamenë e purpurt.

Numri i fletëve: 190 (tashmë të ndara në 9 volume). U zbulua në grykën e një pusi, ku ishte fshehur, dhe u restaurua në Kinë më 1971 (Sinani 31-31).

Numri i kolonave për faqe: 17.

Përmasat e faqes: 23 cm lartësi x 24 cm gjerësi.

Sipërfaqja e tekstit: 21 cm lartësi x 19 cm gjerësi <sup>3</sup>.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Shkruar me argjend.

Shënime: Teksti në grafi germëmadhe biblike, dëmtime të rëndësishme në krye dhe në fund të fletës.

Kapaku: I vjetër, argjend (jo i veti).

Referenca të mëparshme <sup>4</sup>: Aleksoudes, 352; Batiffol (1885), 357-376; Batiffol (1887), 467-556; Koder, 327-328.

**Kodiku i Beratit, nr. 2 (“Codex Anthimus“)**

Gregory-Aland: 1143.

Tipi: Katërungjillësh.

Koha: Shekulli i 9-të.

Materiali: Pergamenë e purpurt <sup>5</sup>.

Numri i fletëve: 413 (844 faqe, ndarë në 21 volume). U zbulua në grykën e një pusi, dhe u restaurua në Kinë në vitin 1971 (Sinani 31-31).

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 17.

Përmasat e faqes: 24 cm x 19 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 15 cm x 10cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Shkruar në ar.

Shënime: Teksti me germa të vogla, i dëmtuar rëndë në faqet e Ungjillit sipas Gjonit (John).

Nuk ka kapakë të vjetër.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 352-353; Battifol (1887), 443-446; Koder, 328.

**Kodiku i 3-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Fragmente ungjijsh <sup>6</sup>, 2372.

Tipi: Ungjill në perikope.

Koha: Shekulli i 9-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 145.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 25.

Përmasat e faqes: 28 cm x 18 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafia e tekstit në ngjyrë kafe, titujt në ngjyrë të kuqe dhe kafe.

Shënime: Grafia është në shkrim dore (të vogla).



Nuk ka kapakë të vjetër; faqja e parë me germa dore të derdhura.  
Referenca të mëparshme: Koder dhe Trapp, 202, nr. 6; 212, nr.25.

#### **Kodiku i 4-t, i Beratit**

Gregory-Aland: 1141.  
Tipi: Katërungjillësh.  
Koha: Shekulli i 10-të.  
Materiali: Pergamenë.  
Fletë: 238.  
Kolona për faqe: 1.  
Rreshta për kolonë: 25.  
Përmasat e faqes: 20.5 cm x 16 cm.  
Sipërfaqja e tekstit: 13.5 cm x 10.5 cm.  
Prejardhja: Berat.  
Të tjera: Grafia në ngjyrë kafe dhe të kuqe.  
Shënime: Teksti me germa të vogla; tabelat e kanoneve, titujt dhe nistoret janë shkruar me ar.  
Kapaku: Dru i mbuluar me lëkurë.  
Referenca të mëparshme: Alexoudes, 356-357.

#### **Kodiku i 5-të, i Vlorës**

Gregory-Aland: 2252.  
Tipi: Katërungjillësh.  
Koha: Shekulli i 11-të.  
Materiali: Pergamenë.  
Numri i fletëve: 308.  
Kolona për faqe: 1.  
Rreshta për kolonë: 22.  
Përmasat e faqes: 23 cm x 18 cm.  
Sipërfaqja e tekstit: 15.5 cm x 11 cm.  
Prejardhja: Vlorë (Valona).  
Të tjera: Grafia në ngjyrë kafe.  
Shënim: Ka figurën e Shën Mërisë (gr. "Panagias").  
Kapaku: Dru i veshur me lëkurë, me panele argjendi në qendër dhe në katër cepat.  
Referenca të mëparshme: Nuk ka.

#### **Kodiku i 6-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Fragmente ungjijsh, 1204.  
Tipi: Perikope ungjijsh.  
Materiali: Pergamenë.  
Koha: Viti 1043.  
Fletë: 50.  
Kolona për faqe: 2.  
Rreshta për kolonë: 26.  
Përmasat e faqes: 22 cm x 19 cm.  
Sipërfaqja e tekstit: 18 cm x 15 cm.  
Prejardhja: Berat.  
Të tjera: Grafia ngjyrë kafe dhe e zezë.

Kapaku: Dru i mbuluar me lëkurë.  
Referenca të mëparshme: Alexoudes, 353.

#### **Kodiku i 7-të, i Vlorës**

Gregory-Aland: Nuk e përmendin në "Kurzgefasste Liste".  
Tipi: Fragmente ungjijsh.  
Koha: Shekulli i 11-të.  
Materiali: Pergamenë.  
Fletë: 287.  
Kolona për faqe: 2.  
Reshta për kolonë: 21.  
Përmasat e faqes: 27 cm x 22.3 cm.  
Sipërfaqja e tekstit: 21.5 x 17.  
Prejardhja: Vlorë (Valona).  
Të tjera: Grafi ngjyrë kafe.  
Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.  
Referenca të mëparshme: Koder dhe Trapp, 199, nr.1. Por, ose Koder dhe Trapp, ose Popa, gabohen në lidhje me datën.

#### **Kodiku i 8-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Nuk ka të dhëna.  
Tipi: Fragmente ungjijsh.  
Koha: Shekulli i 11-të.  
Materiali: Pergamenë.  
Fletë: 348.  
Kolona për faqe: 2.  
Reshta për kolonë: 20-23 dhe 35-36.  
Përmasat e faqes: 26.4 cm x 21.4 cm.  
Sipërfaqja e tekstit: Rreth 19 cm x 14.5 cm.  
Prejardhja: Berat.  
Të tjera: Grafi ngjyrë kafe e çelët deri në ngjyrë kafe të errët dhe e zezë.  
Shënime: Së paku dy duar, dy grafi.

#### **Kodiku i 9-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Nuk ka të dhëna.  
Tipi: Fragmente ungjijsh e të tjera.  
Koha: Fundi i shekullit të 11-të dhe fillimi i shekullit të 12-të.  
Materiali: Pergamenë.  
Fletë: 151.  
Kolona për faqe: 2.  
Reshta për kolonë: 24.  
Përmasat e faqes: 31.5 cm x 24 cm.  
Sipërfaqja e tekstit: 24 cm x 17 cm.  
Prejardhja: Berat.  
Të tjera: Faqja 2 ka tekste muzikore bizantine.  
Shënime: Përfshihen poezi dhe materiale të tjera që u kushtohen martirëve.  
Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë të regjur.  
Referenca të mëparshme: Alexoudes, 362-363; Koder dhe Trapp, 203.

**Kodiku i 10-të, i Vlorës**

Gregory-Aland: 2253.

Tipi: Katërungjillësh.

Koha: Shekulli i 11-të deri shekulli i 12-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 305.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 21.

Përmasat e faqes: 28.2 cm x 20.3 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 19.5 cm x 12.5 cm.

Prejardhja: Vlorë (Valona).

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë ngjyrë të gjelbër të errët, me medalione argjendi.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 11-të, i Vlorës**

Gregory-Aland: Nuk i përmendin në "Kurzgefasste Liste".

Tipi: Fragmente ungjijsh.

Koha: Shekulli i 11-të, fillimi i shekullit të 12-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 254.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 16.

Përmasat e faqes: 32 cm x 25 cm.

Sipërfaqja e tekstit: Nuk u mat.

Prejardhja: Vlorë (Valona).

Të tjera: grafi ngjyrë kafe.

Shënime: Në faqen 93 përmendet shkruesi Gjon (John), meshtar.

Kapaku: Dru i mbështjellë me stof të gjelbër, me pllakëza argjendi.

Referenca të mëparshme: Koder dhe Trapp, 203.

**Kodiku i 12-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 1707.

Tipi: Trajtesa ungjillore nga Theofilakti ("Theophylact").

Koha: Gjysma e dytë e shekullit të 12-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 603.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për faqe: 20.

Përmasat e faqes: 22.2 cm x 16 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe dhe e zezë.

Shënime: Faqja e parë është në dy kolona.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë, kapur me vidha.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 365; Koder dhe Trapp, 202.

**Kodiku i 13-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 758.

Tipi: (Letërsi ungjillore?).

Koha: Shekulli i 12-të, fillimi i shekullit të 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 320.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 22.

Përmasat e faqes: 35 cm x 27.7 cm.

Përmasat e tekstit: 22 cm x 18 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe, inicialet blu, titujt me ar.

Shënime: Shkruar në kohën e Andreas dhe papa Gjonit.

Kapaku: Dru i veshur me pafka argjendi.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 353, 3.

**Kodiku i 15-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 2244.

Tipi: Katërungjillësh.

Koha: Shekulli i 12-të deri shekulli i 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 356.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 17.

Përmasat e faqes: 21 cm x 16.5 cm.

Përmasat e tekstit: 13.5 cm x 11 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe, e kuqe e errët; titujt me ar.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 16-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Ndoshta 882.

Tipi: (Letërsi ungjillore?).

Koha: Shekulli i 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 161.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 12-13.

Përmasat e faqes: 27.4 cm x 18.8 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 16 cm x 8.5 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe me pika ngjyrë të kuqe të errët; germat e mëdha janë të kuqe.

Kapaku: Dru i mbështjellë me stof.

Referenca të mëparshme: Ky kodik mund të jetë i njëjti që gjendet tek Gregory-Aland me numrin 882. Por Batiffol, 441, 7 është fare i paqartë në referencat e tij, duke e përshkruar si: "lectionnaire mutile, membranaceus in quarto du XIII siècle".

**Kodiku i 17-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 1764.

Tipi: Fragmente ungjijsh.

Koha: Fundi i shekullit të 13-të-fillimi i shekullit të 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 99.

Rreshta për kolonë: 17.

Përmasat e faqes: 22 cm x 15.5 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe.

Kapaku: Dru i dëmtuar.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 360, Batiffol (1887), 441-442; Koder dhe Trapp, 203-205.

**Kodiku i 19-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 1709-2353.

Tipi: Fragmente ungjijsh.

Koha: Shekulli i 12-të deri shekulli i 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 195.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 21.

Përmasat e faqes: 15.3 cm x 11.5 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 11 cm x 8 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe.

Shënime: Gregory-Aland 1709, f.142-195; idem, tek "lectionary"-fragmentet e ungjijve: 2353; f. 1-141.

Kapaku: Origjinali mungon.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 366; Koder dhe Trapp, 207-208.

**Kodiku i 21-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 1207.

Tipi: Fragmente ungjijsh.

Koha: viti 1181.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 41.

Përmasat e faqes: 21.6 cm x 15.3 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 13.5 cm x 11 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe e errët.

Shënime: Në faqen 41 nuk ka tekst; Alexoudes e ka shënuar këtë dorëshkrim me 47 faqe.

Kapaku: Origjinali sipër ka humbur.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 365; Koder dhe Trapp, 206-207.

**Kodiku i 22-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 1433.

Tipi: Letërsi ungjillore.

Koha: Shekulli i 12-të deri shekulli i 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 172.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 22-23.

Përmasat e faqes: 25.8 cm x 22 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 17.5 cm x 13 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi kafe e ndritshme, titujt në ngjyrë të kuqe.

Kapaku: Dru i mbuluar me lëkurë.

Referenca të mëparshme: Alexoudes, 362; Koder dhe Trapp, 199.

**Kodiku i 24-t, i Beratit**

Gregory-Aland: Nuk e përmendin në "Kurzgefasste Liste".

Tipi: Fragmente ungjijsh.

Koha: Shekulli i 13-të.

Fletë: 252.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 27.

Përmasat e faqes: 33 cm x 26.8 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 25 cm x 19 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë kafe e errët.

Shënime: Iu dha "Gjergjit të Madh" (Skënderbej?)<sup>7</sup>.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.

Referenca të mëparshme: Koder dhe Trapp, 203, nr. 9. Mund të jetë gjithashtu dhe Gregory-Aland: 882, por në krahasim me kodikun e 16-të të Beratit, duket shumë më i madh për t'u cilësuar si "quarto".

**Kodiku i 26-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 2246.

Tipi: Katërungjillesh.

Koha: fundi i shekullit të 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 185.

Kolona në faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 19.

Përmasat e faqes: 18 cm x 14 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 10.5 cm x 7.5 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi e kuqe dhe ngjyrë kafe. Titujt në ngjyrë të kuqe.

Shënime: Jo i plotë Gjoni:18, teksti mbaron pas rho, nu, alfa.

Kapaku: Origjinali mungon.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 27-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Nuk e përmendin në "Kurzgefasste Liste".

Tipi: Omilie <sup>8</sup>.

Koha: Shekulli i 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 191.

Kolona për faqe: 1.

Përmasat e faqes: 18.6 cm x 14.3 cm.

Prejardhja: Voskopoje <sup>9</sup>.

Kapaku: Nuk ka.

**Kodiku i 29-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Ndoshta 1711.

Tipi: Ungjill.

Koha: Fundi i shekullit të 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 186.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 22.

Përmasat e faqes: 24 cm x 17.5 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 16.5 cm x 10.5 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi ngjyrë të errët, shënimet me të kuqe.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 35-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Ndoshta 2247.

Tipi: Ungjill.

Koha: Jo më i hershëm se shekulli i 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 228 (Katalogu i Popës përmban një gabim në tekst; është shkruar gabim 428 fletë).

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 26.

Përmasat e faqes: 18.5 cm x 13 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 12.5 cm x 8.5 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët jo të fortë.

Shënime: E dëmtuar pjesa e parë e Ungjillit sipas Mateut.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 36-të, i Beratit**

Gregory-Aland: Ndoshta 1209.

Tipi: Perikope ungjijsh, fragmente ungjijsh.

Koha: Viti 1322.

Materiali: Letër.

Fletë: 187.  
 Kolona për faqe: 2.  
 Rreshta për kolonë: 29.  
 Përmasat e faqes: 32 cm x 21.6 cm.  
 Sipërfaqja e tekstit: 22.5 cm x 15 cm.  
 Prejardhja: Berat.  
 Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët.  
 Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.  
 Referenca të mëparshme: Nuk ka.

#### **Kodiku i 38-të, i Beratit**

Gregory-Aland: 1705 dhe / ose 1708 (ndoshta).  
 Tipi: Ungjill.  
 Koha: Shekulli i 14-të.  
 Fletë: 239.  
 Kolona për faqe: 1.  
 Rreshta për kolonë: 21-22.  
 Përmasat e faqes: 25 cm x 20 cm.  
 Sipërfaqja e tekstit: 15.5 cm x 12 cm.  
 Prejardhja: Berat.  
 Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët.  
 Shënime: Referenca tek Gregory-Aland është e mundshme nëse dorëshkrimi fillimisht është regjistruar në Berat, para se të sillej në Tiranë.  
 Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.  
 Referenca të mëparshme: Nuk ka.

#### **Kodiku i 75-të, i Gjirokastrës**

Gregory-Aland: 1709 (fragmentet, lectionary).  
 Tipi: Perikope ungjijsh, omilie.  
 Koha: Fundi i shekullit të 14-të, fillimi i shekullit të 15-të.  
 Materiali: Letër.  
 Fletë: 431.  
 Kolona për faqe: 1.  
 Rreshta për kolonë: 23.  
 Përmasat e faqes: 21.5 cm x 15.5 cm.  
 Sipërfaqja e tekstit: 15.5 cm x 10.5 cm.  
 Prejardhja: Gjirokastrë / (Ar)gyrocaster.  
 Të tjera: Grafi në ngjyrë të zezë, titujt dhe inicialet me të kuqe.  
 Shënime: Përmban 47 omilie, tekste ungjillore, me shënime orientuese dhe shpjeguese anash.  
 Kapaku: Prej druri.  
 Referenca të mëparshme: Mund të jetë dorëshkrimi i Gregory-Aland me numër 1709 (letërsi ungjillore, lectionary), por përmasat mund të jenë ngatërruar me Kodikun e 97-të të Gjirokastrës, i cili është libër lutjesh. Mund të jetë, ndoshta, dhe dorëshkrimi që identifikohet nga Gregory-Aland në numrin 1706.



**Kodiku i 76-të, i Beratit**

Gregory-Aland: (ndoshta) Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste“.

Tipi: Ungjill.

Koha: Shekulli i 14-të deri shekulli i 15-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 86.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 19.

Përmasat e faqes: 21 cm x 15.7 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 14 cm x 10.5 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët, titujt në të errët të zbehtë.

Shënime: Përmban 19 fletë me pjesë nga Ungjilli sipas Mateut, vazhdon me Ungjillin sipas

Markut dhe pastaj me Ungjillin sipas Lukës.

Kapaku: I dëmtuar.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 77-të, i Beratit**

Gregory-Aland: (ndoshta) 1208, fragmentet (lectionary).

Tipi: Perikope ungjijsh.

Koha: Më i vonë se shekulli i 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 198.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 23.

Përmasat e faqes: 24 cm x 15.8 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 17.5 cm x 11 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të zezë, nistoret në të kuqe.

Kapaku: Dru i mbështjellë me lëkurë.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 79-të, i Gjirokastrës**

Gregory-Aland: 2514.

Tipi: Ungjill.

Koha: Shekulli i 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 303.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 21.

Përmasat e faqes: 19.9 cm x 13.5 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 15.5 cm x 9 cm.

Prejardhja: Gjirokastër / (Ar)gyrocaster.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët, titujt dhe nistoret në të kuqe.

Kapaku: Prej druri me mbulesë argjendi.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 85-të, i Korçës**

Gregory-Aland: Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste“.

Tipi: Ungjill.

Koha: Shekulli i 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 221.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 26.

Përmasat e faqes: 21.2 cm x 15.5 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 15.5 cm x 9.5 cm.

Prejardhja: Korçë.

Të tjera: Disa rreshta janë shkruar në të kuqe, tani të zbehtë. Ka shënime në mes dhe në fund. Një ose dy fletë janë të dëmtuara.

Kapaku: Origjinali është dëmtuar.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 88-të, i Beratit**

Gregory-Aland: (ndoshta) Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste“.

Tipi: Perikope ungjillore.

Koha: Fundi i shekullit të 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 93.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 22.

Përmasat e faqes: 25 cm x 19.3 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 16 cm x 12.5 cm.

Prejardhja: Korçë.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të zezë, titujt dhe nistoret në të kuqe.

Shënime: Hapet me urimet e Elizabetës për Shën Mërinë.

Kapaku: I dëmtuar.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 89-të, i Beratit**

Gregory-Aland: (ndoshta) Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste“.

Tipi: Perikope ungjillore.

Koha: Më i vonë se shekulli i 14-të.

Materiali: pergamenë.

Fletë: 53.

Kolona për faqe: 2.

Rreshta për kolonë: 21-22.

Përmasat e faqes: 25.5 cm x 21 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 18.5 cm x 15 cm.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët, titujt dhe nistoret prej ari.

Shënime: Përmban perikope nga Ungjilli sipas Mateut, kreu 4 ose 5.

Kapaku: I dëmtuar.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 92-të, i Korçës**

Gregory-Aland: (ndoshta) Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste”.

Tipi: Ungjill.

Koha: Fundi i shekullit të 13-të, fillimi i shekullit të 14-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 420.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 17.

Përmasat e faqes: 19.5 cm x 13.3 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 13 cm x 6.5 cm.

Prejardhja: Korçë.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të zezë të fortë, ka dhe shkrim me të kuqe.

Shënime: Përmban pjesërisht Ungjillin sipas Gjonit.

Kapaku: Origjinali i dëmtuar.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 93-të, i Korçës**

Gregory-Aland: (ndoshta) Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste”.

Tipi: Ungjill.

Koha: Shekulli i 13-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 309.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 26.

Përmasat e faqes: 15.3 cm x 12 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 11 cm x 8 cm.

Prejardhja: Korçë.

Të tjera: Grafi në ngjyrë të errët, nistoret prej ari.

Shënime: Tekst në formë kryqi.

Kapaku: Prej druri, ndoshta në fillim me mbulesë tjetër.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku i 97-të, i Gjirokastrës**

Gregory-Aland: Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste”.

Tipi: Libër lutjesh.

Koha: Viti 1562.

Materiali: Letër.

Fletë: 315 (sipas Katalogut të Popës), por ngjan të jenë 256.

Kolona për faqe: 1.

Rreshta për kolonë: 20.

Përmasat e faqes: 19.4 cm x 14 cm.

Sipërfaqja e tekstit: 14 cm x 8.5 cm.

Prejardhja: Gjirokastër / (Ar)gyrocaster.

Shënime: Kapaku i këtij kodiku mund t'i jetë vënë Kodikut të 75-të të Gjirokastrës.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku fragment 2, i Beratit**

Gregory-Aland: Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste”.  
 Tipi: Perikope ungjijsh.  
 Koha: gjysma e parë e shekullit të 13-të.  
 Fletë: 50.  
 Kolona për faqe: 2.  
 Përmasat e faqes: 42.4 cm x 27 cm.  
 Prejardhja: Berat.  
 Shënime: Grafi në ngjyrë të zezë.  
 Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku fragment 5, i Voskopojës**

Gregory-Aland: Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste”.  
 Tipi: Perikope ungjijsh.  
 Koha: Shekulli i 14-të.  
 Fletë: 26.  
 Kolona për faqe: 2.  
 Përmasat e faqes: 27.5 cm x 20.1 cm.  
 Grafia: Në ngjyrë të errët.  
 Prejardhja: Voskopojë.  
 Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku fragment 7, i Voskopojës**

Gregory-Aland: Nuk është i regjistruar në “Kurzgefasste Liste”.  
 Tipi: Ungjij.  
 Koha: Shekulli i 14-të.  
 Fletë: 4.  
 Kolona për faqe: 1.  
 Reshta për kolonë: 18.  
 Përmasat e faqes: 18.6 cm x 14.3 cm.  
 Prejardhja: Voskopojë.  
 Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku fragment 12, i Beratit** <sup>10</sup>

Gregory-Aland: Fragment 2245 (?).  
 Tipi: Katërungjillësh.  
 Koha: Shekulli i 14-të.  
 Materiali: Pergamenë.  
 Fletë: 4.  
 Kolona për faqe: 1.  
 Reshta për kolonë: 20.  
 Përmasat e faqes: 24.3 cm x 17.6 cm.  
 Përmasat e tekstit: 20.5 cm x 13 cm.  
 Prejardhja: Berat.  
 Të tjera: 3 faqe janë me vrima në të gjithë sipërfaqen.  
 Shënime: Fleta e parë fillon me Ungjillin sipas Lukës, 20, 3. Të tjerat nuk vijojnë sipas radhës.

**Kodiku fragment 13, i Vithkuqit**

Gregory-Aland: Nuk e përmendin.

Lloji: Katërungjillësh.

Koha: viti 1728.

Materiali: I papërcaktuar.

Fletë: 1.

Prejardhja: Vithkuq.

Të tjera: Shkrime biblike?

**Kodiku fragment 15, i Beratit**

Gregory-Aland: Nuk përmendet.

Fletë: 1.

Prejardhja: Berat.

Të tjera: Ka një shënim me mallkimin e 318 etërve kundër çdonjërit që merrte hua librin dhe e humbte.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

**Kodiku fragment 16, i Voskopojës**

Gregory-Aland: Nuk përmendet.

Koha: Fundi i shekullit të 14-të, fillimi i shekullit të 15-të.

Materiali: Pergamenë.

Fletë: 9.

Përmasat e faqes: 30 cm x 23.4 cm.

Prejardhja: Voskopojë.

Të tjera: Inicialet janë me ngjyrë të kuqe, germat janë të gjera, me ngjyrë të zezë.

Shënime: Ka pesë paragrafë të Ungjillit sipas Gjonit dhe tre sipas Markut.

Referenca të mëparshme: Nuk ka.

Disa kodikë (jo vetëm me përmbajtje biblike) janë gjetur midis dorëshkrimeve të pakataloguara, që i takojnë fondit të manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Gjithashtu në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë ndodhen disa dorëshkrime të vona, të cilat mund të jenë ose jo biblike. Dr. Sinani me dashamirësi më sqaroi se në librin e tij kishte një pasakësi në shtyp lidhur me vendndodhjen e manastirit të Shën Gjon Vladimirit. Në libër thuhet se manastiri ndodhet në Durrës. Në të vërtetë shenja me këtë emër ka predikuar në Durrës, ku ka shërbyer si klerik, por manastiri ka qenë në Elbasan.

Ende vazhdojnë të sistemohen dorëshkrime të pakataloguara nga manastiri i Shën Gjon Vladimirit në Elbasan.

**II.**

Ajo që unë gjeta në Shqipëri, është një pasuri e madhe, e pabesueshme, për të cilën kurrë s'kam menduar se do ta gjeja në një vend të tillë, të cilit shumë vetë në botë nuk ia dinë as emrin <sup>11</sup>.

Pasi vizitova dhe qytetin e Beratit, që ka qenë një qendër e mjeshtërisë së shkrimeve të shenjta, u binda përfundimisht se dorëshkrimet ungjillore që ruhen në arkivat e këtij vendi, duke qenë trashëgimi kulturore e Shqipërisë, janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë botërore.

Dorëshkrimet ungjillore që ruhen në Shqipëri nuk mund të shihen të shkëputura nga

dorëshkrimet e tjera të gjetura në botë. Kam parasysh dorëshkrimet e krishtërimin të hershëm që ruhen në Vatikan, në arkivat dhe muzeumet e Britanisë, Francës, Rosisë, Italisë, Austrisë, Greqisë e Egjiptit.

Kur flasim për historinë e krishtërimin dhe vendin e Shqipërisë në këtë histori, duhet fillimisht të theksojmë atë që ka shkruar Shën Pali: “E predikova Ungjillin nga Jeruzalemi në Iliri”. Pra ai e ka predikuar edhe këtu, në këtë vend, ku sot është Shqipëria. Shumë prej misionarëve të krishterë shkuan në Romë, ku dhe u martirizuan, mbase nëpërmjet rrugës “Egnatia” që kalon mes për mes Shqipërisë.

Tani le të kthehemi te “Kodikun e Purpurtë të Beratit”. Përderisa është gjetur në këtë vend, duhet menduar se ai është një tekst vendës. Me këtë kuptoj se ai i përket fondit dhe traditës kulturore të vendit ku është gjetur. Kjo është e njëjta gjë sikurse themi se shkrimet e gjetura në Egjipt apo Jeruzalem, në Itali apo në Greqi, u përkasin traditave të atyre vendeve. Shqipëria është historikisht fqinje e këtyre vendeve. Pasi u njoha me dorëshkrimet dhe me kontekstin vendor të ruajtjes shumëshekullore të tyre, e kuptova edhe më mirë këtë të vërtetë. Kuptova se Berati ka qenë vërtet qendër e kopjimit të këtyre dorëshkrimeve. Jo vetëm kaq, njerëzit e këtij qyteti kanë ditur t’i ruajnë monumentet e tyre kulturore-fetare dhe t’ua lenë trashëgimi brezave që vijnë pas. Unë mendoj se Berati ka qenë një nga qendrat e krishtërimin jo vetëm për Shqipërinë, por edhe më gjerë.

Në dorëshkrimet e AQSH-së gjeta vlera që nuk ma merrte mendja se do t’i gjeja. Duke studiuar katalogët e dorëshkrimeve ungjillore që qarkullojnë në Perëndim, unë mendoja se do të gjeja “Kodikun e Purpurtë të Beratit”, “Kodikun e Artë të Anthimit”, dhe ndonjë tjetër. Mirëpo gjeta plot 100 kodikë të bashkuar në një fond dhe 100 të tjerë të shpërndarë në fonde të ndryshme. Këta përbëjnë një bibliotekë të tërë.

Në botë numërohen 7 kodikë të purpurt. Dy nga këta gjenden në Shqipëri. Të mendosh që nga 7 botime të tilla të hershme luksoze dy prej tyre ndodhen në Shqipëri! Kjo është një gjë e madhe, që flet shumë. Dorëshkrimet që u kopjuan në pergamenë me ngjyrë të purpurt janë prodhime të shtrenjta. Vetëm persona të pasur, kishat e mëdha e vende të fuqishme mund të porositnin vepra të tilla. Kjo do të thotë se Shqipëria e shekullit të 6-të ka qenë një vend i pasur.

Ajo që më ka bërë shumë përshtypje pasi kam lexuar tekstin është devocioni, pasioni, këmbëngulja e atyre njerëzve që kanë punuar mbi këta libra. Kam parë e kam lexuar shumë shkrime të shenjta, që nga Jeruzalemi e deri në Athinë, që nga Shtetet e Bashkuara e deri në Britani. Mirëpo shkrime të tilla të qarta e të kuptueshme, si në Shqipëri, rrallë kam lexuar. Ato formojnë një grup të veçantë, kanë individualitetin e tyre, pra është një grup në harmoni me shkrimet e tjera të hershme të gjetura në botë, por me karakteristika dalluese.

Do të mund të mësohej më shumë rreth këtyre dorëshkrimeve dhe vlerës së tyre, në qoftë se dikush do të bënte një studim më të thelluar, për shembull, për miniaturat që kanë ato. Gati të gjitha dorëshkrimet në AQSH kanë në fillim një pikturë në miniaturë. Sipas llojit të dorëshkrimit, ajo mund të jetë shembëllturë e ungjillorit që ka shkruar tekstin: e Markut, e Mateut, e Lukës apo e Gjonit. Ata paraqiten të ulur duke shkruar. Mirëpo, në disa dorëshkrime, unë zbulova diçka të pazakontë: një ungjillor që qëndron më këmbë dhe i dikton skribit (shkruesit) në pozicion ulur, të shkruajë tekstin ungjillor. Kjo pikturë paraprin Ungjillin sipas Gjonit, i cili është shumë i vlerësuar në teologji. Kjo pikturë me dy njerëz, ungjillorin dhe nxënësin, tregon për një mendësi të panjohur, të cilën unë nuk e kam hasur asgjëkund.

Shumë rëndësi ka, për të qartësuar individualitetin lokal të këtyre shkrimeve, faqosja, kompozimi i rreshtave, kujdesi për çdo germë të derdhur në ar apo argjend. Pra, nuk kemi të bëjmë me një punë shkel e shko, por me një punë të kujdesshme. Të përfytyrosh se ç’vetëdije kanë pasur njerëzit që vazhdimisht kanë rrezikuar për këto dorëshkrime! Kemi të bëjmë me një mjeshtëri.

Këto vlerësime unë munda t’i formuloj duke qenë se në AQSH m’u krijuan mundësitë të

këshilloj vetë dorëshkrimet origjinale. Kur ke librin në dorë të duket sikur bisedon ballë për ballë me atë që e ka shkruar këtu e 16 shekuj më parë. Prandaj dua të falenderoj në mënyrë të veçantë dr. Shaban Sinanin, si dhe punonjësit e tjerë të arkivave të Shqipërisë, të cilët më kanë ndihmuar si askund tjetër. Besoj se ata e tejkaluan detyrimin zyrtar thjesht për të më ndihmuar.

Dy gjëra më duhet të bëj urgjentisht. E para, të hartoj një raport të hollësishëm për kolegët e mi në Birmingham. Të dhënat e deritanishme, që gjenden në listat ndërkombëtare të dorëshkrimeve të letërsisë ungjillore, do të krahasohen me të dhënat e marra nga burimi i drejtpërdrejtë. E dyta, të bëj një relacion për z. Sinani, i cili, gjithashtu, është një njohës i mirë i kodikëve të Shqipërisë. Pas kësaj, nga të dyja palët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, do të jetë e qartë çfarë është shkruar në katalogët ndërkombëtarë në Perëndim me atë që ka në të vërtetë.

Erdha nga Anglia në Shqipëri për të studiuar këto dorëshkrime, të cilat jashtë Shqipërisë nuk janë shumë të njohura. Është shumë e rëndësishme që bota t'i njohë. Ajo duhet të dijë se çfarë ka konkretisht në këtë traditë Shqipëria. Duke njohur këto vlera, bota Perëndimore do të ketë një vlerësim tjetër, më të madh, për Shqipërinë dhe kulturën e saj; pra, të vlerësojë këtë vend të vogël me një kulturë të madhe e të hershme. Shqipëria ka kontributin e vet në letërsinë ungjillore.

Përsa u përket dorëshkrimeve që ndodhen në AQSH është e rëndësishme të shihet se si lidhen ato me njëra-tjetrën. A krijojnë ato një tablo të gjerë e në vazhdimësi? "Beratinus-1" e "Beratinus-2" janë produkte të një kulture të lartë. Kjo do të thotë se në kohën që janë shkruar Shqipëria zinte një vend të rëndësishëm në rajon. Që me shikimin e parë kuptohet nga teksti dhe nga stili i të shkruarit se këto dorëshkrime janë të lidhura me dorëshkrimet e tjera botërore të krijuara në fillimin e mijëvjeçarit të parë para erës së re.

Tani e kuptoj pse ka qenë aq e madhe lufta për t'i grabitur këta kodikë, apo për t'i zhdukur krejtësisht nga Shqipëria. Sa më e madhe ka qenë kjo luftë, aq më e madhe ka qenë dhe dashuria e njerëzve për t'i ruajtur ata e për t'ua lënë brezave që do të vijin më pas. Këta libra janë krijuar këtu, në këtë vend, e nga këta njerëz, ndryshe ç'kuptim do të kishte sakrificat!

### Burimet<sup>12</sup> :

Aland, Kurt: *Kurzgefasste Liste der Griechischen Handschriften des Neuen Testaments*, 2<sup>nd</sup> Edition, (Berlin-Walter de Gruyter, 1994).

Katologos tou en tais ieraïis ekkhlhsias ths sunoikias kastrou, polews Beratiou ths mh tropolews Beogradwn euriskomenwn arcaïwn ceïrografwn'. *Deltion ths Istorikhhs kai Eqnologikhhs Etairias ths Ellados* 5 (1900): 352-369 & plates 1-12 (Alexoudes, Anthimus).

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave: *Arkivi Qendror i Shtetit* (Tiranë, 1999).

Batiffol, Pierre: „Evangeliorum Codex Graecus Purpureus Beratinus F“, *Mélanges d'archéologie et d'histoire (École française de Rome)* 5 (1885): 358-76 & plate xvi.

Batiffol, Pierre: „Les manuscrits grecs de Bérat d'Albanie et le codex purpueus F“. *Archives des missions scientifiques et littéraires*, 3rd Series, 13 (1887): 439-556.

Koder, Johannes: „Zur wiederentdeckung zweier Codices Beratini“, *Byzantinische Zeitschrift* 65 (1972): 327-328.

Koder, Johannes, and Erich Trapp: „Katalog der Griechischen Handschriften in Staatsarchiv zu Tirana“, *Jahrbuch der Österreichischen Byzantinischen Gesellschaft* 16 (1967): 197-214.

Popa, Theofan: „Pasaporta të kodikëve të fondit 488“, 1983, dorëshkrim, AQSH.

Sinanin, Shaban: *Kështjella e virtytit*, (Tiranë, 2001).

*I Vangeli dei Popoli*, (Vatican City, Biblioteca Apostolica Vaticana, 2000).

**Shënime shpjeguese:**

1. Ruhet në gjuhën angleze pranë AQSH-së. Botohet i plotë në përkthimin shqip.
2. Autori, sikurse dhe katalogues të tjerë të dorëshkrimeve biblike e ungjillore, në emërtimin e identifikimin e kodikëve rregullisht përdor shkurtesa: Kod. Br. 2. Në tekst jepen emërtime të plota.
3. Për herë të parë në një katalog veçohen përmasat e tekstit.
4. Është një prej kontributeve më të rëndësishme të autorit përcaktimi i plotë i burimeve të mundshme për çdo kodik të përshkruar a diskutuar në studimet kodikologjike jashtë vendit.
5. Në studimet e autorëve shqiptarë Beratinus-2 është cilësuar „prej pergamene të bardhë”. Ndrejje shumë e rëndësishme prej autorit.
6. Gregory-Aland përdorin termin “Lectionary”. Autori përdor temrin “gospels lectionary”. I përgjigjet termi kishtar “perikope”. U preferua të përkthehet me një fjalë më të njohur të shqipes, me të njëjtin kuptim, “fragmente”.
7. Çështje e sqaruar saktë nga Theofan Popa.
8. Kodiku i 27-të, në fakt, nuk përmban omilie, por letërsi ungjillore.
9. Kodiku i 27-të vjen nga Berati. Ai njihet, veç të tjerash, për shënimin se si u mbrojtën dorëshkrimet e rëndësishme nga Skuripeki më 1356.
10. Autori zgjodhi për krahasim vetëm dorëshkrimet që: 1. Ishin me përmbajtje ungjillore; 2. Ishin me material pergamenë; 3. Ishin objekt diskutimi në inventarët ndërkombëtarë të dorëshkrimeve ungjillore. Për këtë arsye nuk ka konsiderata për më shumë se dy të tretat e dorëshkrimeve. Në një variant paraprirës autori ka bërë krahasime, analogime dhe vlerësime edhe për kodikë të tjerë, që kanë numër reference ndërmjet 30 dhe 100 të katalogut dhe inventarit të fondit 488.
11. Këto vlerësime dr. Roderic L. Mullen i shprehu gjatë bashkëbisedimit të zhvilluar pranë DPA-së me studiues të paleokrishtërimin dhe paleografisë (ligjërata e tij ruhet në gjuhën angleze pranë AQSH-së), si dhe gjatë një interviste që u përgatit për shtyp nga z. F. Sejdiq.
12. Burimet dhe referencat e brendashkruara janë të vetë autorit.



## BERATINUS-1 - NJË REFERENCË THEMELORE NË TRADITËN E SHKRIMEVE TË SHENJTA

SHABAN SINANI

I.

Qyteti i Beratit është një vendbanim antik ilir, i themeluar në kufijtë e shekullit të 6-të dhe të 5-të para erës së re. Në shekullin e 4-t mori karakterin e një qyteti, kurse në shekullin e 3-të ishte qytet-kështjellë. Në periudhën antike njihet me emrin *Antipatrea*. Më vonë, në terminologjinë e administratës kishtarë, Berati është njohur me emrin *"Pulheriopol"*. Peshkopi i këtij qyteti ishte pjesëmarrës dhe nënshkrues i akteve të konciliumit të parë ekumenik të Nikesë dhe përmendet si *"peshkopi i Pulheriopolit"*.

Periudha kulturore e Beratit prej fillimeve si qytet, deri në mesin e shekullit të 6-të të erës së re, dëshmohet kryesisht në gjetjet arkeologjike dhe në burimet e autorëve antikë grekë e romakë. Prej shekullit të 6-të fillon periudha e dokumentuar e kësaj kulture. Me të mirënjohurin *"Kodiku i Purpurt i Beratit"*, një prej dorëshkrimeve më të vjetra të letërsisë ungjillore në shkallë botërore, nis historia e shkrimeve origjinale të Beratit dhe të gjithë hapësirës historike shqiptare. Ky dorëshkrim, tipologjikisht *një model i ungjijve germëmëdhenj* („*maiuscle*“), në gjendjen që ka mbijetuar deri në kohët moderne, përmban, me pak mungesa, dy ungjij: sipas Mateut dhe sipas Markut. Disa studiues, ndër të cilët edhe Anthimus Alexoudes, që e bëri i pari të njohur, mendojnë se në krye të herës dorëshkrimi ka pasur të katër ungjijtë. Deri në mesin e shekullit të 19-të besohej se ka një lidhje historike dhe burimore thelbësore midis këtij kodiku dhe shkrimeve të *Shën Gjon Gojartit* (Joan Chrysostomos), siç shkruajnë Alexoudes dhe Pierre Battifol<sup>1</sup>. Në fakt, shkolla e shkrimit të „*Beratinus-1*“ është e njëjta me atë të „*Sinaiticus*“, „*Alexandrinus*“, „*Vaticana B*“, „*Genesi di Vienna*“ („*Windobonae*“, sipas emrit të vjetër të qytetit të Vienës) etj.

Deri në mesin e shekullit të 20-të „*Kodiku i Purpurt i Beratit*“ është përdorur jo vetëm si libër biblioteke, por edhe si libër liturgjike, por vetëm një herë në vit, në ditën e emrit të shenjtorit që besohet të jetë autor i tij. Në kohën kur u shkruan dy ungjijtë e këtij kodiku, lënda ungjillore ende nuk ishte njësuar përfundimisht; sapo ishte vendosur se *cilët do të ishin librat kanonikë të Besëlidhjes së Re*. Kjo e bën më të rëndësishëm në vlerat e tij. Janë shumë të pakta dorëshkrimet ungjillore të periudhës parastandarde.

„*Kodiku i Purpurt i Beratit*“ ka rëndësi për historinë e zhvillimit të mendimit të krishterë. Është shkruar me germa të argjendta në pergamenë të kuqe, që simbolizonin fillimisht madhësi perandorake dhe më pas vlerat e fjalës së shenjtë (gr. „*Logos*“). Nistoret e tekstit janë shkruar me ar të tretur. Në ekspozitën *"Ungjijtë e Popujve"*, që u hap në jubileun e 2000-vjetorit të krishtërimit në Vatikan, veç „*Kodikut të Purpurt të Beratit*“, kishte vetëm dy kodikë të tjerë të purpurt: *"Sinopensis O"*, i Bibliotekës Kombëtare të Parisit dhe *"Rossanensis"* i bibliotekës së arkiveshësisë së dioqezës së Rossana-s (Itali).

Berati ishte për shekuj me radhë, pas Apolonisë dhe Bylis-it, *një kryeqendër e krishtërimit* në Ballkan. Dorëshkrimet e ruajtura në bibliotekën e Kishës së Shën Gjergjit dhe në atë të Ungjillizimit përbëjnë vlera që nuk gjenden në botë. Deri në mesin e shekullit të 19-të në këtë bibliotekë ruhej edhe dorëshkrimi origjinal i *"Liturgjisë së Shën Gjon Gojartit"*. *"Kodiku i artë i Anthimit"*, me të cilin themelohet *tradita e ungjijve germëvegjël* në Shqipëri („*minuscle*“), u shkrua në shekullin e 9-të. Shkrimet e shenjta krijuan në këtë qytet një traditë të njohur në

shkallë europiane.

Berati është qytet i mjeshtërisë së artit të zbatuar kishtar. Vetë shkrimi i dy kodikëve të purpurt që janë ruajtur në këtë qytet është *jo vetëm një teknokraci e bartjes së kumteve gojorë në kumte të shkruar, por edhe një mjeshtëri artistike. „Kodiku i Purpurt i Beratit“* u shkrua në një kohë kur kumtet e shenjta po kalonin nga rrëfimi gojor në formën e shkruar. *Kjo është koha kur shkrimi i shenjtë zëvendëson fjalën e shenjtë.*

Në mesjetën e hershme Berati kishte gjashtë shkolla piktore dhe bukurshkrimi (kaligrafie). Vetë ky fakt dëshmon në dobi të një tradite të qëmoçme të mjeshtërisë së shkrimit, si art i zbatuar, siç konsiderohet me të drejtë prej paleografëve. Në Berat gjenden kryevepra të piktorit të shquar të afreskeve dhe ikonografisë së stilit bizantin, të ndikuar fort nga shkolla e Rilindjes Europiane, veçanërisht prej asaj kreto-venete, *Onufri*. Me emrin e tij është identifikuar terminologjikisht një prej nuancave të ndezura të së kuqes në pikturën kishtarë, ndoshta jo rastësisht e ngjashme me të purpurtën e kodikëve.

Dy ungjijtë prej pergamene të purpurt, që lidhen me emrin e Beratit, bëjnë pjesë në „*familjen e kodikëve të purpurt*“, inventari i plotë i së cilës numëron gjithsej në shkallë botërore në kohën e sotme vetëm shtatë dorëshkrime.

Në periudhën arbërore Berati ishte zotërim i Muzakajve dhe bënte jetën e një qendre të rëndësishme urbane, me lidhje të forta kulturore dhe ekonomike me Perëndimin dhe Lindjen. Në këtë periudhë emri i tij herë-herë del në formën greqishte „*Belegradon*“.

Qyteti i Beratit u bë i njohur edhe për traditën e shkrimeve në gjuhët orientale. „*Sixhilati i sherijes së Beratit*“, një prej regjistrave më të rëndësishëm të ngjarjeve, zhvillimeve dhe protagonistëve të historisë së Shqipërisë e të Ballkanit në periudhën osmane, është mbajtur për rreth katër shekuj me radhë. Ky regjistër ka mbi 210 vëllime dhe përmban të dhëna me karakter enciklopedik për gjithçka ka ndodhur në këtë anë të botës. „*Sixhilati i sherijes së Beratit*“ është një burim të dhënash të pazëvendësueshme për popullsinë, pronat, zhvillimin e dhënien e së drejtës, emërimet dhe lirimet e funksionarëve të administratës, dënimet dhe gradimet, ndëshkimet dhe shpërblimet, gjendjen kulturore dhe fetare, raportet e së drejtës shtetërore me atë etno-zakonore, luftërat dhe paqet, kryengritjet dhe nënshtrimet, ndodhitë e natyrës, epidemitë, vitet e urisë, vitet e bollëkut, mrekullitë dhe çuditë e botës, të ngjarat e të pangjarat. „*Sixhilati i sherijes së Beratit*“ ka të dhëna për një hapësirë prej Besarabisë (Moldavi) në Gjibraltari. Ngjarja më e hershme shenjohet në vitin 1604 dhe e fundmja në vitin 1913. Ky regest përbën një burim të dhënash që mund të cilësohen si enciklopedi më vete.

Në kohët moderne në Berat shfaqen shkrimet në gjuhën shqipe, e cila, për rrethana të njohura, nisi të shkruhej vonë, krahasimisht me jetën e gjatë shumëshekullore të qytetit. Për këtë arsye, dorëshkrimet e trashëguara nga institucionet laike e klerikale, si dhe nga qytetarët beratas, janë kryesisht në „*gjuhët imperiale*“, „*gjuhët perandorake*“.

Një tradite relativisht të hershme të shkrimeve në shqip i takon „*Kodiku i Kostë Beratit*“, ose „*Dorëshkrimi i Kostandin Beratit*“, apo „*i jeromonakut Kostë*“, për të cilin, veçmas për vlerat dhe rëndësinë e alfabetit, kanë bërë me kohë studime të vlefshme Ilo Mitkë Qafëzezi dhe Namik Ressuli.

Në këtë qytet janë krijuar dokumente për rolin e popullit dhe të personaliteteve të këtij qyteti në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe në periudhën shtetërore. Kjo traditë është shprehje e një qyteti që lindi e u rrit midis vlerash kulturore, të cilat i pranoi bujarisht, pavarësisht nga vinin, si shkrime të shenjta të krishtërimit apo si letërsi fetare e besimeve të tjera. Fryma shembullore e ekumenizmit, e bashkëjetesës, që shpreh përmbajtja e dokumenteve të krijuara a ruajtura në Berat, midis „*Kodikut të Purpurt të Beratit*“ dhe „*Sixhilatit të Beratit*“, dy kryevlera të trashëgimisë arkivore - secila në llojin e vet - përbën një përvojë historike me vlera bashkëkohore<sup>2</sup>.

„*Kodiku i Purpurt i Beratit*“ është ekspozuar një herë, për disa orë, në jubileun e 2400-vjetorit të qytetit të Beratit, në kushte të forta sigurie dhe pa njoftim publik, pas dhënies së lejes me

shkrim të Presidiumit të Kuvendit Popullor (1989). Ai është ekspozuar edhe një herë tjetër, gjithashtu heshturazi, në festimin e 50-vjetorit të themelimit të arkivave kombëtare të Shqipërisë, më 1999, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar. Në vitin 2000, me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, një vëllim prej 20 faqesh i *“Kodikut të Purpurt të Beratit”* u paraqit në ekspozitën më të madhe ndërkombëtare kushtuar 2000-vjetorit të krishtërimit, *“Ungjijtë e Popujve”*, organizuar nga Biblioteka Apostolike e Vatikanit.

*“Beratinus-1”* iu paraqit edhe një herë një publiku të zgjedhur në Pallatin e Brigadave, në ekspozitën *“Kodikët e Shqipërisë - përmendore të historisë së mendimit njerëzor”*, që u zhvillua nën kujdestarinë e kryetarit të shtetit, në maj të vitit 2002. Fillimisht arkivistët iu drejtuan autoriteteve kishtarë të vendit, duke propozuar ekspozimin e *“Kodikut të Purpurt të Beratit”* dhe të disa kodikëve të tjerë në një mjedis ku mund të ishte e pranishme edhe liturgjia dhe ku do të merrnin pjesë përfaqësues të politikës, shkencës, dijes e kulturës, si dhe të faltoreve dhe besimtarëve. Por përpjekjet e arkivistëve për të lidhur në një nismë të gjithë faktorët bashkëpunues nuk gjetën një përfundim pozitiv, për shkak *“të kalendarëve të ndryshëm të faltoreve”* dhe të zotimeve të parashikuara të tyre.

## II.

*“Kodiku i Purpurt i Beratit”*, i njohur ndërkombëtarisht edhe me emrin *“Beratinus-1”*, i shenjuar në regjistrin e letërsisë biblike botërore me shifrën *“042 F”*, vlerësohet si një prej dëshmive më të vjetra të shkruara të Besëlidhjes së Re<sup>3</sup>. Për këtë arsye ai është objekt studimi jo vetëm prej paleografëve, arkeografëve, burimologëve e njohësve të diplomatikës, por edhe prej bibliologëve.

Duke qenë një vepër e rrallë, siç dëshmohet nga dokumentet, *“Beratinus-1”*, si rregull, është ruajtur me një rreptësi të admirueshme. Deri në mesin e shekullit të 20-të ai u paraqitej besimtarëve një herë në vit, më 27 janar, në ditën kur festohej emri i Shën Gjon Gojartit, kryepeshkop i Kostandinopojës, i cili, sipas burimeve arkivore, vdiq më vitin 407 (*Bruce M. Metzger, “Der Text des Neuen Testaments”, Stuttgart 1966, s. 89*). Prekja e këtij kodiku, që vendësit e kanë njohur më shumë me emrin *“Ungjilli i Shën Gjon Gojartit”*, ka qenë një privilegj i priftërinjve të urdhërit të lartë, i peshkopëve dhe mitropolitëve. Besimtarët mund ta puthnin atë në shenjë mrekullimi vetëm në ditën e emrit të shenjtit që mendohej si shkruer i tij. *“Beratinus-1”* ka jetuar e mbijetuar midis realitetit, gojëdhënës e legjendës. Sa është bërë e njohur, sido që dorëshkrimi më shumë ka qendruar i fshehur, larg syve të njerëzisë, se i shfaqur (siç ndodh edhe tani), në Berat është trashëguar një përgjegjësi e fortë bashkësie, kishtarë dhe laike, për mbrojtjen e tij. *“Beratinus-1”* ka mbijetuar ndaj rreziqeve të kohës prej kësaj përgjegjësie, prej fshehtësisë së rreptë të klerikëve dhe popullit.

Sipas Alexoudes, për herë të parë ky kodik u rrezikua prej *“frankëve kampaneze”*, që do të thotë prej frankëve të krahinës së Shampanjës (fr. *„Champagne“*). Prania e *“frankëve kampaneze”* është e lidhur historikisht me sundimin anzhuin (shekulli i 12-të e më këndej). Dihet se, në vitin 1356, kur Berati u sulmua nga ushtritë e car Uroshit, ishte *“një zonjë konteshë”*, një murg me emrin Theodulo, si dhe një qytetar beratas me emrin Skuripeki, që e shpëtuan kodikun dhe 26 dorëshkrime të tjera të vjetra nga rrëmbimi<sup>4</sup>.

Shumë është folur për rreziqet që i janë kanosur këtij dorëshkrimi gjatë Luftës së Parë Botërore. Janë të besueshme rrëfimet gojore të më të moçmëve të Beratit, sepse gjatë asaj lufte u kërkua që dy ungjijtë e moçëm *„të merren në mbrojtje”* për t'u dërguar në muzetë dhe kancelaritë e metropoleve Perëndimore, sikurse u dërguan statuja të Apolonisë dhe të Butrintit, ikona e ikonostasë të punuar prej mjeshtrish vendës qindra vjet më parë. Madje humbi çdo gjurmë, prej atyre viteve deri sot e kësaj dite, edhe një portret i rrallë i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, dhuruar Princ Wied-it nga oborri i perandorit Franc Jozef, menjëherë pas fronëzimit. U zhduk mbasi kishte arritur në Shkodër.

Më të besueshme i bën rreziqet që ndoqën ungjijtë e vjetër të Beratit gjatë Luftës së Parë

Botërore, një dëshmi e tregtarit beratas Vangjel Bojaxhiu, pjesë e një ditari të gjatë, të mbajtur prej tij në vitet 1914-1917. Ky ditar përmban të dhëna të hollësishme të kronikës së një qyteti, në luftë me ushtri kundërshtare dhe aleate midis tyre dhe njësoj pushtuese ndaj vendësve. Nuk dihen saktë rrethanat se si ky ditar është bërë pronë e Arkivit Qendror Shtetëror. Mund të jetë dhuruar nga trashëgimtarët e autorit, mund të jetë mbledhur nga bashkëpunëtorët e rrjetit arkivor në Berat, që kanë qenë jo të paktë, por mund dhe të jetë shtetëzuar. Fragmenti që bën fjalë për rrethimin e Kishës së Shën Gjergjit nga ushtria austriake botohet për herë të parë <sup>5</sup>.

*17 prill, e dielë.*

*... tellalli thirri, me urdhër të bashkisë, që Berati të mos japë as gjënë më të vogël jashtë Beratit, si në Fier, Lushnje dhe gegëve dhe se ay që do t'ua shesë atyre gjënë më të vogël do të ketë gjobë të madhe. Ata që janë nga Skrapari, Tomorica dhe Mallakastra, domethënë nga rrethi i Beratit, kur të duan ndonjë gjë, të marrin leje nga bashkia me shkrim dhe pastaj ta blejnë gjënë.*

*18 prill, e hënë.*

*Në mbrëmje tellalli thirri që qumështi të shitet për dy grosh oka, kosi për dy grosh e gjysmë oka dhe djathi për gjashtë grosh oka. Ata që do ta shesin më shumë do të kenë 500 grosh gjobë.*

*Që die mbrëma komandanti austriak thirri nga të gjitha lagjet e krishtera nga dy persona si pleq të lagjes. Nga kalaja thirri epitropë Anast. Drobonikun, Leon Sallamandën dhe Thoma Capon, si dhe Vasil Naçon dhe K. Novon, të cilët të gjithë u paraqitën ne prefekti dhe pritën që të vijë komandanti, i cili nukë erdhi.*

*Në bisedim të tanëve me prefektin, ay u tha tërthorazi çështjen e thirrjes së komandantit, që domethënë komandanti don të shojë të dy Ungjijtë e Vjetër që kini ju me vleftë, por juve mos kini frikë, u tha prefekti, se nuk i marrin, vetëm t'i shohën duan.*

*Duke mos ardhur komandanti die mbrëma, prefekti u tha të shkojnë sonte dhe të vijnë nesër në mëngjes (domethënë sot, e hënë në mëngjes) dhe vajtën sot të gjithë sa ishin thirrur, dhe komandanti u tha këto:*

*"... në kishën e kalasë kini një Ungjill shumë të vjetër, të paçmueshëm, të cilin duam ta shohëm dhe ta sigurojmë neve, që të mos pësojë gjë, për shkak të rrethanave të këqija të këtyre kohëve".*

*Tanët u përgjegjën se nga më pleqtë kështu kemi dëgjuar, por ne nuk i kemi parë dhe as që dimë se ku janë, se neve në krye kemi mitropolitin, ay do ta ketë me vehte ose do t'ia kenë rrëmbyer gjatë grabitjes së 20 shtatorit 1914. Neve, si epitropë të kishës, jemi vetëm për kujdesin e kishës, domethënë përe rrogat e priftërinjve, të psaltëve, kandillonaftëve etj. Për Ungjijtë nuk kemi dieni.*

*Atëherë komandanti u tha se Papa Spirua (prift shqipëtar që ka ardhur këto ditë) na tha se juve i kini në kishë.*

*Tanët u përgjigjën se, në qoftë se kini dyshim, ajdeni vetë në kishë të shihni. Dhe ay (komandanti) tha se nesër do t'i nxirri më nj'anë të gjithë Ungjijtë e kishës dhe do të vijë Papa Spirua t'i shojë. Tanët u përgjigjën "me gjithë kënaqësi" dhe kështu u dhanë leje të shkojnë.*

*20 prill, e mërkurë.*

*Nga ora tre p. m. (pas mesdite) komandanti austriak u ngjit në kala me Papa Spiron dhe me një përckthenjës dhe vajtën në kishë që të shohën Ungjijtë, sipas urdhërit të datës 18 të k. m. (këtij muaji). Nga tanët ishin të pesë të thirrurit prej komandantit, siç është thënë më lart, por u thirr edhe veqili i dhespotit Papa Zaharia dhe duke ekzaminuar me radhë Ungjijtë nukë gjetën atë që kërkonin dhe u thanë tanëve se kërkojmë një Ungjill të vjetër, dorëshkrim. Papa Zaharia u përgjegj se neve këta kemi, në ka qenë një më i vjetër neve nukë dimë. Mitropolitin mund ta dijë dhe, bile, përsëriti Papa Zaharia, sipas të thënit të komandantit mitropolitin me kohë kishte bërë një raport në Vjenë se në kohën e rebelëve iu votn një gjë shumë e*

*çmuar dhe mund, tha Papa Zaharia, të ishte ay Ungjill që kërkoni juve.*

*Pasi i shqyrtuan të gjitha librat që kishin shkuan pa bërë gjë. (Papa Spirua ka qenë më shumë shkak).*

*U bë një komision për të mejtuar si të bëjnë për misër, se të gjithë të vobegtit pllakosnë në prefekturë”.*

III.

Studiuesit e kodikëve në Shqipëri kanë qenë gjithnjë të paktë, tejet të paktë. Përveç kufizimit ideologjik (pozita ateiste e periudhës ideokratike); përveç pamjaftueshmërisë së një discipline për të dhënë shpjegime shkencore rreth përmbajtjes dhe vlerës së tyre, pamjaftueshmëri që ndoshta mund të tejkalohet duke zbatuar parimet, metodën dhe *“shkencën borgjeze”* të antropologjisë; ka ndikuar edhe kufizimi i kontaktit të drejtpërdrejtë njohës me dorëshkrimin<sup>6</sup>. Studiues të Perëndimit (francezë, belgë, italianë, gjermanë, austriakë, britanikë): kryesisht të teologjisë, arkeografisë dhe të paleografisë, i kanë botuar që prej afro një shekulli e gjysmë artikujt e tyre, duke iu referuar kryesisht jo dorëshkrimit vetë, por botimit të transliteruar të tij prej Pierre Battifol, në librin *“Codex Purpureus Beratinus F”*. Në fakt, për transliterimin e Battifol-it ka pasur vërejtje në lidhje me saktësinë (Popa, Naçi, Mullen).

Deri vonë dihej se *“Beratinus-1”* është fshehur dhe ka mbetur i zhdukur për një kohë të gjatë, që prej viteve të Luftës së Dytë Botërore. Mirëpo, sipas një dokumenti të pabotuar, që ruhet në fondet e AQSH<sup>7</sup> dhe që mban titullin *“Informacion i muzeut lokal të Beratit drejtuar Arkivit të Shtetit mbi zbulimin e materialeve dokumentare me rëndësi”*, hartuar më 30.12.1963, del se kodiku ka pasur një periudhë fsheheje edhe më të hershme dhe se rishfaqja ndërmjet dy luftërave ka qenë fare episodike. *Në këtë dokument del për herë të parë gjithashtu se kodiku ka qenë vlerë në kërkim edhe nga ushtria fashiste italiane.* Hartuesi i informacionit ka dijeni për vlerën e kodikëve.

Sido që ky dokument është hartuar rreth një gjysmë shekulli pas ditarit të tregtarit Bojaxhiu, ka përputhje sa i takon përshkrimin të sjelljes së ushtrisë austriake ndaj Kishës së Shën Gjergjit dhe këshillit të saj.

Në informacionin e muzeut të qytetit të Beratit herë-herë duket se ka mungesë koherence. Flitet se kodiku i fshehur para luftës nuk është zbuluar *“nga organet e pushtetit popullor”*, ndërkohë që bëhet fjalë për një paraqitje të fundme të dorëshkrimit në vitin 1940; bëhet fjalë për dy vende fsheheje (prapa ikonostasit dhe në një kasafortë të Kishës së Shën Gjergjit); për tri ushtri që e kanë kërkuar dhe kanë përdorur edhe armët për të arritur dorëzimin e tij. Në anën tjetër, duket se hartuesi i informacionit ngatërron *“Kodikun e Purpurt të Beratit”*, i cili përdorej si libër liturgjie një herë në vit, me *“Kodikun e Artë të Anthimit”*, që paraqitet me emrin *“Ungjilli i Evangjelistës”*-ungjill i kishës së ungjillizimit.

Njoftimet nga muzeu i qytetit të Beratit, tre-katër vjet para se kodiku të zbulohet, janë të mbushura me shqetësim. Mundet që ky informacion, *“i mbajtur në katër kopje”* dhe *“i vërtetuar nga kryetari i komitetit ekzekutiv”*, të jetë hartuar edhe në përgjigje të ndonjë *“detyre nga lart”*, qoftë të institucioneve akademike, qoftë të institucioneve të tjera.

Ajo që bie më shumë në sy në informacion është fuqia e betimit të bërë prej priftërinjve të këshillit të kishës (por është thënë edhe prej besimtarëve) për të mos e treguar dorëshkrimin. Është fakt i njohur se pleqësia e Kishës së Shën Gjergjit kishte bërë betimin para ikonës së Shën Mërisë që të mos i tregonte dy dorëshkrimet e vjetra, qoftë edhe duke bërë një betim të rremë, *“se nuk dimë gjë”*. Mirëpo ngjan se fuqia e këtij betimi nuk u shua as me përfundimin e luftës. Hartuesi i informacionit mendon se heshtja rreth fatit të kodikëve *“mund të jetë e lidhur dhe e kushtëzuar nga botëkuptimi i ruhajtjes së këtij objekti simbas mënyrës së vjetër, pa i treguar vendin ase njeriut”*.

Ankthi që ndihet në këtë dokument për ndarjen nga kjo jetë e njerëzve që kishin bërë betimin për të mos treguar përforcon mendimin se duhet të ketë ekzistuar një traditë e *“mbrojtjes me betim”*.

“Në bazë të kërkimeve që ka bërë muzeu lokal i Beratit për zbulimin e materjaleve dokumentare me rëndësi për historinë lokale të qytetit dhe të rethit të Beratit, e cila fillon me lashtësinë e shekujve dhe vazhdon deri në ditët e sotme, rezultoi se në qytetin tonë ruhen nga persona privat dhe nga institucionet fetare materjalet dokumentare si më poshtë vijojnë:

1. Ungjilli Johan Gojartit, i njohur edhe nën emrin Ungjilli i Johan Krisostomit. Si mbasë të dhënave gojore, është ungjilli i dytë në botë për sa i përket vlerës historike, duke u mbështetur në vjetërsinë e tij, e cila i përket shekujve të parë të erës së re. Ky ungjill, dihet se ka ekzistuar prej shekujsh dhe ka qarkulluar në bazë të traditës si trashëgim brez mbas brezi në një rethë të ngusht njerëzish të përbër nga dhespoti, priftit, epitetropët, kryeepitetropët, antarët e këshillit kishtar dhe pleqët e paris të lagjes “kala”. Këta ishin betuar që sekretin e vendit të ruajtjes të mos ja tregonin ase një njeriut. Ky betim ishte bërë mbi ungjill dhe mbi ikonë.

Shumë të huaj kanë ardhur dhe janë interesuar për ta bler këtë me shuma të mëdha parash, shumë legjenda janë thurur nga populli mbi këtë objekt, por mbi çdo (mbi këtë) legjendë mund të ketë një bërthamë racionale. Historiani korçar Ilo Mitkë Qafëzezi në punimet e tija mbi historikun e Beratit gjatë kohës së regjimit të Zogut e ka përmendur edhe këtë objekt. Ka njohur formën, dimesjonet (madhësit), moshën, alfabetin, mënyrën e shkrimit dhe përmbajtjen e këti dokumenti.

Si mbasë të dhënave që ka dhënë më gjallje Thoma Capua me shkrim dhe që ruhen në arkivin e muzeut lokal, rezultojnë këto të dhëna:

Në kohën e Luftës parë Botërore, kur Berati ishte i okupuar nga ushtrit austrohungareze, të cilat në këtë kohë luftonin në tokën tonë kundër ushtrive të Antantës, dhe ishin përqëndruar në lagjen “kala” të Beratit, nga ana e tyre u kërkua për t’u marë për muzeun e Vjenës, ose të Budapestit me të gjitha mjetet që kjo ushtri pushtuese dispononte. Thoma Capua ka thënë se oficerët austrohungar iu kërcënuan edhe me arëm zjari për ta dorëzuar. Në këtë kohë Thoma Capua ishte kryeepitetrop i kishës katedrale të kalas. Për të shpëtuar nga presionet e pushtuesit, këtë objekt me rëndësi ndërkombëtare e fshehu në një gropë mbrapa ikonostasit të kësaj kisha.

Mbas largimit të Thoma Capos nga kjo kishë në kohën e regjimit të Zogut, ky ungjill i groposur u çgropos nga persona (të cilët janë ende edhe sot e kësaj dite) të pidentifikuar akoma nga organet e Ministris Punëve të Brendshme, nga kryesia e komitetit ekzekutiv të k.p. të rrethit, këshilli popullor i lagjes “kala” e muzeu lokal...

Ekzistenca e kasafortit të kishës katedrale të lagjes “kala”, i cili (kasaforti) është akoma i paçelur, dhe mungesa e çelësit, i cili mund të jetë fshehur me qëllim dhe me paramendim nga personat e pidentifikuar akoma, mund të japë një farë shprese se mund të gjendet këtu. Humbja e çelësit, ose fshehja e tij, nuk është gjë e rastit. Kjo mund të jetë e lidhur dhe e kushtëzuar nga botëkuptimi i ruajtjes së këtij objekti simbas mënyrës së vjetër, pa i treguar vendin ase njeriut.

Nga gropa mbrapa ikonostasit të ajodhimës të kishës së shëmëris ky u nxuar në kohën e Zogut. Okupacione të tjera erdhën, interesat e huaja u shtuan, pushtuesit fashist italian u interesuan edhe për këtë vlerë për ta tërhequr në arkivat dhe muzetë e tyre.

Mbas vitit 1940 deri sot ky objekt është lënë në heshtje. Pleqtë e lagjes “kala” vdiqën; nga këta sot jeton vetëm Nas Dyshniku, i cili vazhdon të jetë epitetrop i kësaj kisha. Të dhënat e Nasit mund të jenë relative, se rethi brenda të cilit vepronte e jetonte ky objekt ishte i ngusht. Në rast se (gjatë vitit 1964) do të merren masa të me njëhershme për thyerjen e kasafortës, (në rast se) do të zbulohet, mund të pranohet edhe varjanti i ekzistencës tija në kasafort...

Në Berat jeton edhe grumbulluesi i materjaleve shumë të rëndësishme Vlash Papa, i cili (njihet) si kërkues, studjos i historis Beratit, megjithëse deri sotë nuk ka botuar asë gjë; mund të jetë në dijeni deri në një farë shkalle edhe për këtë objekt.

Në lagjen “Vakëf” të qytetit të Beratit jeton edhe një tjetër person, me emrin Papa Theodor Lako, i cili ka shërbyer dhe shërben si prift në kishat e qytetit për një kohë shumë të vjetër deri

sotë. Edhe drejtori i shtëpis kulturës “Margarita Tutulani” shoku Vangjel Lako ka digjuar diçka nga i jati rreth këtij objekti. Për veçse këtyre, informata mund të meren nga Irakli Saatëçiu dhe persona të tjerë, duke përfshir edhe nënën e Vasil Sallabandës, e cila mund të ketë digjuar gjë nga i shoqi sajë Lone Sallabanda dhe nga i kunati i saj Kristaq Sallabanda, të dy të vdekur. Pleqtë e tjerë, të cilët mund të ishin në dijeni rreth këtij objekti, kanë vdekur të gjithë. Karakteristikat. I përket shekujve të parë të krishtërimit; mund të supozohet se është objekt paleokristjan, (i shkruar) në kohën kur krishtërimi ishte fe ose besim i skllëvërve dhe i kolonive (kolonëve) të perandorisë skllavo-pronare. Mund të periodizojmë rreth shekujve (të) parë të epokës re. Ka qenë i shkruar në pergamen dhe lëkurë me germa të (h)arta. Ka kapakë të trashë.

Ungjilli me kapakë dhe germa argjendi i njohur nën emërin “Ungjilli i Evangjelistës”. Edhe për këtë ungjill dëshmon në shkrimet e tija historjani korçar Ilo Mitkë Qafëzezi. Simbas traditës fetare ky ungjill ruhesh në kishën e shëngjegjit të lagjes “kala” dhe një herë në vit nxiresh si mbasë rritit fetar. Zhdukja e këtij ungjilli është analoge me (zhdukjen e) të parit. Hollësirat mbi këtë mund t’i japin personat e përmendur më lartë, si dhe Andon Arapi”<sup>8</sup>.

Individët që përmenden në këtë relacion ndoshta mund të ndihmojnë për të saktësuar emra të tjerë njerëzish që kanë kontribuar për mbrojtjen e kodikëve, klerikë e laikë, të cilët do të meritonin një nderim të posaçëm prej bashkësisë. Mbrojtësit e monumenteve të arkeologjisë kanë tashmë një gur përkujtimor në Myzeqe, në nderim të përpjekjeve të tyre për të mos lejuar grabitjen e trashëgimisë kulturore antike të vendit. Priftërinj dhe laikë të kishave të lagjes “Kala” të Beratit, me rol në fshehjen e kodikëve në rrezik dhe zbulimin e tyre më vonë, meritojnë diçka më shumë.

#### IV

“Kodiku i Purpurt i Beratit” është një prej vlerave të jashtëzakonshme kulturore të hapësirës shqiptare, një përmendore e traditës së shkrimeve të shenjta në Shqipëri dhe në gjithë hapësirën biblike të kohës së krishtërimit të hershëm.

Popujt që kanë një të shkruar qysh prej paleokrishtërimit, sikundër janë latino-romanët, judejtë, helenët dhe iliro-shqiptarët, kanë një privilegj të madh historik dhe kulturor. Në këta popuj krishtërimi u pranua në një kohë kur ishte i pandarë. Si i tillë, ndër iliro-shqiptarët paleokrishtërimi parapriu traditën e ekumenizmit, jo vetëm ndërmjet degëve të krishtërimit, por dhe midis besimeve abrahamike në përgjithësi.

Dymijë vjet më parë, kur popujt e përfshirë në hapësirën biblike pranuan mendimin e krishterë, duke i sjellë kësaj bote për herë të parë barazinë më të madhe, barazinë e qenieve njerëzore ndaj vlerave hyjnore, pavarësisht nëse ishin aristokratë apo skllëvër, ndoshta nuk e dinin se po ndryshonin rrjedhat e historisë.

Njeriu që e përshkroi i pari dorëshkrimin 15-shekullor të Kishës së Shën Gjergjit, duke e bërë të njohur si vlerë e përveçme e fondit botëror të letërsisë biblike, ka qenë peshkopi i Mitropolisë së Beratit Anthim Aleksudhi (Anthimus Alexoudes). Në vitin 1862 ai botoi në Korfuz veprën “Vështrim historik mbi historinë e mitropolisë së shenjtë të qytetit Belegradon, tani Berat, dhe mbi vendet nën vartësinë e saj”, ku koleksionit të bibliotekës së Mitropolisë iu kushtua një vëmendje e veçantë. Alexoudes përshkroi gjithsej gjashtë “ungjij në membranë” (në pergamenë), ndër të cilët edhe *Beratinus-1* dhe *Beratinus-2*, si dhe, sipas gjasave, “Kodikun e liturgjisë së Shën Gjon Gojartit”, që më pas humbi.

Sipas Alexoudes-it, “ungjilli në membranë me ngjyrë vishnje” ka pasur edhe dy ungjijtë e tjerë, Ungjillin sipas Lukës dhe Ungjillin sipas Gjonit, por këta humbën në kohën e “frankëve kampaneze”.

Disa vite më pas, më 1882, ishte belgu Dyshen (Ludovico Duschesne), i cili, duke bashkuar tri cilësi të dorëshkrimit: tipin e tij (kodik), ngjyrën e pergamenës (e kuqe e thellë, e purpurt) dhe emrin e qytetit (Berat), e bëri të njohur në Perëndim këtë dorëshkrim thuajse përpikmërisht me emrin me të cilin pak kohë më vonë do të pagëzohej përgjithnjë: “Kodiku i Purpurt i

*Beratit*". Sipas Batiffol-it, në atë kohë në gjithë botën kishte gjithsej 12 të tillë ("un dusine"), kurse Duschesne mendonte se duhej të ekzistonin 15 ("un cinquieme specimen de manuscrit grec en parchemin couleur pourpre")<sup>9</sup>.

Që nga koha kur Ludovico Duschesne botoi artikullin e tij në "*Bulletine critique*" kanë kaluar shekuj e dekada dhe numri i dorëshkrimeve të kësaj hershmërie jo vetëm nuk është shtuar, por është reduktuar.

Megjithatë, është franco-belgu Pier Batifol (Pierre Batiffol) ai që përfundimisht nguliti emrin e dorëshkrimit të trashëguar shekull pas shekulli në bibliotekat e letërsisë ungjillore të Shqipërisë. Titulli i një monografie të botuar prej tij më 1886 në Paris mban emrin "*Kodikun i Purpurt i Beratit*": "*Les manuscrits grecs en Albanie et Codex Purpureus Beratinus* F".

Ndër njerëzit shqiptarë të letrave, merita e vlerësimit të parë publik-shkencor të këtij dorëshkrimi është e Ilo Mitkë Qafëzezit, i cili e përshkroi atë, bashkë me "*Kodikun e Artë të Anthimit*", në vitet 1930-1940, në rubrikat bibliografike të buletinit të Bibliotekës Kombëtare dhe në shtyp. Shkrime rreth kodikëve të Shqipërisë u botuan edhe nga Namik Ressuli, por kryesisht për ata të kohëve të vona dhe për vlerat laike, gjuhësore e etnografike.

Sipas hartuesve të historikut të krijimit të fondit të kodikëve në AQSH, rezulton se këshillimi i mendimit të specialistëve për vlerën e "*Kodikut të Purpurt të Beratit*" ndodh për herë të dytë, afërsisht katër dekada më pas. Në vitin 1967, Johannes Koder dhe Erich Trapp, botuan një katalog të dorëshkrimeve bizantine në Arkivin e Shtetit në Tiranë (*Johanes Koder and Erich Trapp: "Katalog der Griechischen Handschriften in Staatsarchiv zu Tirana", botuar në "Jahrbuch der Österreichischen Byzantinischen Gesellschaft 16 (1967): 197-214*). Dy vjet më vonë, sipas dëshmitave arkivore, del se autoritetet e arkivave shtetërore kërkuan një vlerësim prej specialistëve vendës:

*"Më datën 14/IX/1969 u thirr specialisti Theofan Popa për të vlerësuar kodikët, i cili dha këto mendime: Dy kodikët në dorëshkrim që u gjenden në Berat konsiderohen si të humbur prej shumë vjetësh. Njëri nga këta njëjet dhe konsiderohet në përgjithësi si një nga kodet më të vjetër të botës së krishterë".*

Në botën shkencore studimi i "*Kodikut të Purpurt të Beratit*" për afro një shekull vijoi duke pasur si referencë tekstin e tejkruar prej Batiffol-it. Gregory-Aland, në botimet dhe ribotimet e tyre të përmirësuar dhe plotësuar gjatë një shekulli të plotë, kushtuar traditës së përbotshme të dorëshkrimeve të fjalës së shenjtë, rikonfirmuan vendin e këtij dorëshkrimi në pikëpamje të renditjes kronologjike dhe i shtuan listës një varg dorëshkrimesh të tjera të gjetura në Shqipëri.

Një diskutim i gjatë është zhvilluar e zhvillohet për burimin e dorëshkrimit. Guglielmo Cavallo, një studiues i mirënjohur i paleografisë, e kushtëzon përdorimin e së purpurtës si ngjyrë hyjnizuese e perandorëve, duke e sjellë origjinën e saj në Kostandinopojë, ku ka ekzistuar më vonë një shkollë shkrimesh të shenjta. Në të kundërtën, bashkëhartuesi i skedës së paraqitjes së dorëshkrimit në ekspozitën "*Ungjijtë e Popujve*", Edoardo Crisci, mendon se "*mund t'i takojë shkollës së shkrimeve të rajonit siro-palestinez*"<sup>10</sup>. Studiues të tjerë e lidhin burimin e dorëshkrimit me Antioche-n, rajonin judeo-aramaik.

Argument kryesor i këtyre studiuesve për të përjashtuar mundësinë e një shkolle vendëse të shkrimeve të shenjta është se hapësira iliro-shqiptare ishte periferi e botës ku u lind krishtërimi. Si duket, pozita e hapësirës iliro-shqiptare ndaj hapësirës së krishtërimin të hershëm, vlerësohet ndarë prej historisë dhe në kushtet e ndikimit të sotëm të raporteve "*qendër-periferi*". Në lidhje me këtë debat vlen të theksohet se disa toponime të Shqipërisë bregdetare, duke përfshirë emrin e qytetit antik "*Foinike*" - *Finiqi i sotëm*, me historinë e të cilit lidhen disa prej letrave biblike të apostujve ("Finikasve"), si dhe toponimi "Galile" në shpinë të Himarës, por nuk përjashtohet edhe një lidhje midis emrit të fshatit "Palasë" (më herët "Paleste") dhe emrit të Palestinës, kanë lidhje me toponiminë hebraike. Nga kjo toponimi antike aramaike ka mbërritur deri sot emri *Orikum*, që mund të shpjegohet me toponimin biblik "*Jeriko*". Në veri të Shqipërisë gjendet një kishë e paleokrishterë, emri i së cilës ligjet me një shenjtor hebre, *Shën Sergjin*.



Sikurse dihet, një nga udhëtimet e Shën Palit preku hapësirën iliro-shqiptare, e cila ishte pjesë e hapësirës burimore biblike. Në shkrimet e shenjta thuhet *“Nga Jeruzalemi në Iliri kam kryer shërbimin e Krishtit” (E Palit - Romakëve, 15:19)*. Në vitet 53-56 Shën Pali kaloi një dimër në Nikopojë dhe qëndroi në Apoloni. Peshkopi i parë i Dyrrah-ut, Cesari, u shugurua pikërisht gjatë këtij udhëtimi të ungjillorit Pal (*“Dhe mbasi kishin kaluar nëpër Amfipoli dhe nëpër Apoloni, arritën në Selanik”, Veprat e Apostujve 17:1*). Në një letër të Shën Palit thuhet: *“Kur të dërgoj Artemin ose Titikun, eja sa më shpejt tek unë në Nikopojë, sepse vendosa ta kaloj dimrin aty” (E Palit - Titit 3:12)*. Një nga martirët e parë të krishtërimin, Shën Asti, u ekzekutua më 117 në Dyrrah. Siç dihet, udhëtimi apostolik i Shën Palit lidhej me bashkësitë hebreje që ekzistonin në hapësirën ballkanike <sup>11</sup>.

Viti 2000, vit jubilar i 2000-vjetorit të krishtërimin, bëri që të rikthehet vëmendja ndaj kësaj veprë monumentale të mendimit njerëzor, që ka sfiduar shekujt dhe mijëvjeçarët me modestinë dhe heshtjen solemne të saj. Në ekspozitën *“Ungjijtë e Popujve” (“I Vangeli dei Popoli”) Beratinus-1* u vlerësua si një privilegj i rrallë dhe u vendos i dyti në radhë, për nga rëndësia dhe kronologjia, përkrah *“Codice B”* ose *“Codice Vaticana”* dhe *“Codex Sinopensis”* të Bibliotekës Kombëtare të Francës. Të krahasueshëm me *“Beratinus-1”* janë gjithashtu dytre kodikë të tjerë, që janë gjetur në Izrael (*“Sinaiticus”*), në Greqi (*“Petropolitanus”*), në Petersburg dhe në Londër. Sipas vlerësimeve të Theofan Popës, në *“Kodikun e Purpurt të Beratit”* gjendet *“një prej varianteve më të vjetra të tekstit të Dhjatës së Re”*.

Dr. Francesco D’Aiuto, nënprefekt i Bibliotekës Apostolike të Vatikanit, studiues i paleografisë, njohës i traditës së shkrimeve të shenjta dhe i gjuhëve të vjetra të letërsisë biblike, nën kujdesin e të cilit u bë renditja profesionale e dorëshkrimeve të ekspozitës *“Ungjijtë e Popujve”* (Romë, 2000), e bashkon *“Kodikun e Purpurt të Beratit”* me *“2-3 kodikët më të vjetër”* të botës (*“codices antiquissimi”*). Në parathënien e veprës së vëllimshme me të njëjtin titull D’Aiuto dhe dy bashkëpunëtorët e tij G. Morelli dhe A. Piazzoni, shkruajnë: *“... në ekspozitë, në fakt, do të jenë të paraqitur, ngjitur me fragmentin e “Codice N” të Vatikanit (Vat. gr. 2305), të tjerë modele (shembuj) të kësaj tradite fine të librit, si “Codex Sinopensis” i Bibliotekës Kombëtare të Francës (Paris) - Supl. gr. 1286, që përmban skena nga jeta e Krishtit, dhe mbi të gjitha një dorëshkrim i çmuar, për një kohë të gjatë i konsideruar i humbur, kurrë ndonjëherë i ekspozuar jashtë, për një publik ndërkombëtar, “Kodiku i Purpurt i Beratit”, pronë e Arkivave të Shtetit të Shqipërisë (Beratinus-1)”* <sup>12</sup>.

*“Kodiku i Purpurt i Beratit”* është një dorëshkrim që i takon një periudhe jo më të vonët se gjysma e parë e shekullit të 6-të. Ka mendime se mund të jetë edhe më i hershëm. Është pranuar të jetë me këtë kronologji duke iu referuar një kufiri me shkallë të lartë pagabueshmërie. Ende nuk janë sistemuar argumentet për një kufi më të hershëm pagabueshmërie, disa prej të cilave mund të ishin:

1. Ngjyra e purpurt e këtij dorëshkrimi, në fillim ngjyrë e pergamenës mbi të cilën shkruheshin përjashtimisht himnoret perandorake dhe më pas e kushtëzuar simbolikisht si shprehje e një respekti hyjnor për shkrimet e shenjta, pas shekullit të gjashtë në gjithë letërsinë ungjillore botërore nuk është përdorur më. Por *„është e mirënjohur, faktikisht, se e purpurta, qysh në kohën e Dioklecianit, pati marrë një ngjyresë funksionale shenjuese të madhështisë perandorake. Për përdorimin e pergamenës së purpurt në teknikën e shkrimit ka të dhëna të sigurta vetëm prej fillimit të shekullit IV. Optaziano Porfirio i kushtoi Kostandinin një rapsodi në vargje shkruar në pergamenë të purpurt me argjend e ar dhe pak a shumë të së njëjtës kohë janë përkthimet e Jeronimit”* <sup>13</sup>.

2. Shkrimi i pandashëm (scriptio-continua), me fjalë të ngjitura dhe me disa thekse karakteristike të greqishtes para-mesjetare, *pa pnevma*, pa thekset karakteristike të greqishtes së mesme, që nisi të shkruhej me mbylljen e periudhës antike. Greqishtja e mesme del në shkrime jo më herët se shekulli i 6-të.

3. Karakteri para-standard (i paranjësuar) i teksteve ungjillore (sipas Mateut dhe Markut). Sipas Aleks Budës, ky dorëshkrim i takon një periudhe kur *“arsyeja njerëzore kishte ende*

*kompetencë mbi shkrimin e shenjtë“.*

Gati një shekull e gjysmë më parë, kur ishte për një vizitë në Kishën e Shën Gjergjit të Beratit, studiuesi belg Pierre Batiffol, duke iu referuar vlerësimeve të Alexoudes, e pati krahasuar paleografinë e dorëshkrimit të *“Kodikut të Purpurt të Beratit”* me *“Liturgjinë e Shën Gjon Gojartit”* (Chrysostomit) dhe pati pohuar se të dyja mund t'i takojnë pikërisht dorës së këtij shenjtori. Besimtarët shqiptarë ia dedikonin pakushtimisht veprën atij. Madje edhe Papa Klementi XI, me origjinë shqiptare, e mbante shtatoren e Shën Gjon Gojartit pranë.

Sido që nuk është provuar nëse *“Kodiku i Purpurt i Beratit”* i takon vërtet dorës së Shën Gjon Gojartit, ekzistojnë disa të dhëna të tërthorta që të shtyjnë të besosh se ka një lidhje të fortë mes tyre:

1. *“Kodiku i Purpurt i Beratit”* kronologjikisht lidhet me mesin e shekullit të 6-të. Dihet se Shën Gjon Gojartit ka jetuar afërsisht një shekull më herët. Sipas të dhënave të studiuesit gjerman Kurt M. Mertzeg, Shën Gjon Gojartit vdiq në Kostandinopojë më 407. Për të tejkaluar këtë *mospërputhje përjashtuese* duhet të përfillen jo vetëm argumentet e kronologjisë absolute, por edhe ato të një kronologjie relative, më të hershme se shekulli i 6-të.

2. Sikurse shkruan Batiffol-i, atdheu i Shën Gjon Gojartit ishte Antioche-a. Në këtë fakt gjendet një tjetër *mospërputhje përjashtuese* midis moshës së dorëshkrimit, moshës së autorit dhe vendit të pretenduar të origjinës. Mirëpo, sipas një dëshmie të atë Zef Valentinit, shenjuar në vitin 1929, në vitin 403 Shën Gjon Gojartit u internua në viset e Epirit, gjë që do të thotë në hapësirën ballkanike: *„Viti 403: Shë Chrysostomi (Shën Gjon Gojartit) internue n’Epir”*<sup>14</sup>. Duke qenë murg dhe i internuar në një mjedis të izoluar, në vetmi dhe metidim, shkrimi i teksteve të shenjta është një punë që vinte, të thuash, vetvetiu.

3. Sipas studiuesve shqiptarë, duke përfshirë kërkimet e prof. Kristo Frashërit mbi paleokrishtërimin në Shqipëri (*“Studia Albanica” 1995-1999, p. 14-28*), gjithashtu rezulton se Shën Gjon Gojartit e ka prekur fizikisht hapësirën shqiptare.

4. Në praktikën liturgjike shumëshekullore *“Kodiku i Purpurt i Beratit”* u paraqitej besimtarëve vetëm një herë në vit, dhe kjo ishte pikërisht dita përkujtimore (dita e emrit) e Shën Gjon Gojartit. Pavarësisht se nuk është lënë ndonjë shpjegim teologjik pse kodiku, deri në vitet ’30 të shekullit të kaluar, paraqitej vetëm në ditën e emrit të Shën Gjon Gojartit, një lidhje kushtëzuese e nënkuptuar ekziston.

Tejkalimi i *„mospërputhjeve përjashtuese“*, duke shtuar argumentet që dëshmojnë traditën e një shkolle vendëse të shkrimit të zbatuar, do të përforconte tezën se *“Kodiku i Purpurt i Beratit”*, për rreth 15 shekuj, nuk ka ndërruar vend. Ai u ruajt në të njëjtën hapësirë. Sipas disa studiuesve, ka të ngjarë që Beratinus-1 të ketë qenë dhuratë e perandorit të Bizantit për kishën e Labovës së Kryqit (dëshmohet me dokumente se Kostandinopoja i ka dhuruar një ungjill kësaj kisha) dhe më pas dorëshkrimi mund të ketë ndjekur rrugën: Apoloni - Bylis - Gllavinicë - Berat).

V.

*“Kodiku i Purpurt i Beratit”* ka pasur mbijetesë të vështirë.

Nuk dihet se si i ka shpëtuar rrezikut të doktrinës, pas njësimi të teksteve biblike, por dihet mirë se, prej shekullit të 14-të, kur ishte njohur mirë tashmë vlara e tij, të paktën tri herë ky dorëshkrim i rrallë është rrezikuar për t’u grabitur<sup>15</sup>.

Kjo dëshmi është përmendur për herë të parë prej Alexoudes, pastaj prej Batiffol-it dhe më pas prej Theofan Popës dhe është shqipëruar e interpretuar thuajse e plotë prej arkivistit Kosta Naçi<sup>16</sup>. Skuripeki i shpëtoi kodikët prej grabitjes nga ushtria e car Uroshit. Hartuesit e historikut të kodikëve emrin e shpëtuesit të dorëshkrimit e shenjojnë *“Skuripeku”*. Studiuesit italianë shënojnë *“Skouripekis”*. Kosta Naçi mendon se dora që ka vënë anëshkrimin në *“Diptikun e Kishës së Shën Gjergjit”* duhet të jetë e një individi që greqishten nuk e kishte gjuhë amtare, sepse *“anëshkrimi ka gabime ortografike, që tregojnë se autori nuk e ka njohur mirë greqishten”*. Naçi përfundon se shpëtuesi *„ka të ngjarë që të jetë nga familja e njohur e*

*Skurajve*“: A. Baçi shton se shpëtuesi ishte “i njohur me emrin Foti Skuripeki”, dhe se ai i nxori kodikët nga rreziku “bashkë me zonjën konteshë dhe me murgun Theodulo, më 6 korrik të vitit 1356”.

Përveç rrezikut të “*frankëve kampaneze*”, që përmendet nga Alexoudes-i, të serbëve të car Uroshit, të ushtrisë austro-hungareze gjatë luftës së parë të përbotshme, dëshmohet se “*dy ungjijtë e moçëm të Beratit*” janë kërkuar edhe nga ushtria italiane e ajo gjermane. Në historikun e kodikëve të Beratit, që ruhet pranë AQSH-së, thuhet se komanda e ushtrisë hitleriane kishte urdhër që të gjente dhe të rrëmbente domosdoshmërisht floririn e Bankës së Shqipërisë dhe “*Kodikun e Purpurt të Beratit*”. Ushtria naziste e rrethoi Kishën e Shën Gjergjit dhe shpalli se, po të mos dorëzohej dorëshkrimi, priftërinjtë do të vriteshin. Këshilli i Kishës së Shën Gjergjit, në këto kushte, i kërkoi leje ikonës së Shën Mërisë të mos i ndëshkonte nëse do të dëgjonte nga anëtarët e sinodit një betim të rremë. Pas kësaj lutjeje, gjashtë anëtarët e këshillit (sinodit) e fshehën dorëshkrimin në një pusëtë nëntokësore të maskuar pranë altarit dhe i deklaruan komandës së ushtrisë së huaj se ishin gati të betoheshin para ikonës së Shën Mërisë se nuk dinin asgjë se ku gjendej vepra e kërkuar:

*Në vitet e para mbas çlirimit, punonjësit tonë të shkencës, gjatë gjurmimit për të gjetur e identifikuar monumentet e kulturës s'onë, konstatuan me shqetësim të madh mungesën e dy kodeve mesjetarë, që përbënin pjesën më të vlefshme të bibliotekave të dorëshkrimeve të Beratit. Hetimi i kodikëve të fshehur u bë një problem, jo vetëm për punonjësit e shkencës, por edhe për njerëzit e thjeshtë të popullit. Organet e pushtetit në Berat kishin të dhëna dhe sinjalizime nga populli se në mitropoli, në lagjen Kala, ndodheshin të fshehur dy kodikë. Duke u nisur nga kjo e dhënë, shokët e komitetit ekzekutiv e të degës së punëve të brendshme, kontrolluan fasadën e brendshme të kishës në pjesën lindore të joadhimës (sic! - është fjala për ajodhimën) - hoqën tre pllaka guri dhe u duk një bodrum që ishte rreth 2 metro i gjatë dhe 1,5 metro i gjerë. Brenda në bodrum u gjend një arkë prej llamarine, brenda së cilës ishin kodikët, të mbështjella me kashtë. Kapakët ishin metalikë, ndërsa fletët e brendëshme ishin pjesërisht të prishura nga lagështira dhe myku. Gjithashtu brenda në arkë u gjend dhe një kuti e vogël prej dërrase, ku ishte vendosur një medalion i rrumbullakët i lidhur me zinxhir, i larë me argjend. Këtë medalion e përdorte prifti në ditët e festave fetare.*

*Është për t'u vënë në dukje se për gjetjen e këtyre kodikëve një kontribut të madh ka dhënë qytetari beratas Nasi Papapavli, me indikacionet e tij të sakta ku duhej kërkuar (për) kodikët e fshehur, si dhe me sinjalizimet e dhëna nga qytetari beratas Dhimitër Tutulani, nëpunës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit.*

*Kodikët bashkë me medalionin ju dërguan nga Berati ministrisë së arsim-kulturës në Tiranë, e cila me datën 21 gusht 1968 ia dorëzoi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit<sup>17</sup>.*

*“Kodiku i Purpurt i Beratit” pati fat të vështirë edhe pas luftës. Në vitin 1968 (e më pas), kur dorëshkrimi u bë pronë shkencore-kulturore e arkivave shtetërorë, u shkruan disa artikuj për të shpjeguar zhdukjen e tij për afro 30 vjet. Për vendin e fshehtë ku ishte vënë kodiku janë përdorur termat: pusëtë, kanal, qimiter, bodrum etj. Përgjithësisht është pranuar mendimi se autoritetet kishtarë nuk i nxorën kodikët nga frika e dhunës ateiste. Kështu përshkruhet gjendja dhe në “Historik ...”. Mirëpo, nga një qarkore e nënshkruar nga kryepiskopi Pasis dërguar episkopatave, zëvendësive mitropolitane e episkopale dhe administratave të manastireve, në emër të Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, Kryesis së Sinodit të Shenjtë, thuhet<sup>18</sup>:*

*Me qëllim që të mund t'evitohet prishja dhe zhdukja e dokumentave me vlerë historike, që ndodhen nëpër arshivat dhe bibliotekat kishtarë dhe që përbëjnë burime të rëndësishme për historinë e popullit dhe e vendit t'onë, studimit të së cilës pushteti ynë popullor është duke i kushtuar një rëndësi të veçantë, jemi marë vesh me drejtuesit e Arshivave të Shtetit, që këto dokumenta, të mbahen në arshivat në fjalë, ku është siguruar ruajtja e tyre nga çdo pikëpamje. Dihet mirë dhe prandaj është e tepërt të vihet gjerësisht në dukje këtu neglijenca dhe indiferentizmi i reguar në të kaluarën në këtë drejtim, qoftë nga an' e autoriteteve shtetnore*

*apo kishtare, gjë që ka lejuar të prishen dhe të çduken prej injorancës e vjedhjeve sistematike dokumenta shumë të çmueshme për historinë t'onë.*

*Duke marrë parasysh sa më sipër, udhëzoheni që t'iu jipni çdo lehtësi kompetentëve të Arshivave të Shtetit, të cilët janë të pajisur me këtë autorizimin t'onë, në mënyrë që ata të mund të studjojnë dhe të bëjnë kërkime lirisht në arshivat dhe bibliotekat t'ona, ku mund të ndodhen të shpërndara dokumenta nga të lart-përmendurat, tërheqja e të cilave, kur këto konstatohen prej tyre si të vlefshme, duhet të bëhet me anën të një proces-verbali të nënshkruar prej marësit në dorëzim dhe dorëzuesit.*

Sikurse del nga dokumenti, autoriteti kishtar jo vetëm që nuk është druajtur për t'ua dorëzuar arkivave dorëshkrimet e vjetra, duke dëshmuar kulturë dhe përgjegjësi, por e ka kërkuar zyrtarisht bashkëpunimin me arkivat për kryerjen e kësaj detyre. Kjo e bën jo fort të besueshëm "konspiracionin" e priftërinjve të Beratit për të mos i dorëzuar dorëshkrimin. Mbetet një arsye tjetër: fuqia e betimit për të mos treguar. Kodikët u bënë të ditur vetëm atëherë kur pleqësia e kishës ishte rralluar shumë dhe kishte rrezik që, për shkak të betimit, sekreti të merrej me vete, në botën tjetër. Nëse do të pranohej "konspiracioni për shkak të ateizmit", si shpjegohet që kodikët iu dhanë arkivave pikërisht në vitin e shpërthimit të lëvizjes ateiste të rinisë komuniste të Shqipërisë?

Për 14 shekuj me radhë, dhjetëra e qindra breza besimtarësh, para këtij dorëshkrimi janë lutur, kanë heshtur, kanë kërkuar ndjesë, kanë shprehur dëshira e aspirata, kanë projektuar të ardhmen, kanë derdhur lotë devocioni e pendese, kanë kërkuar përsosjen dhe kanë tentuar lartësimin. Një botë të tërë mban me vete ky dorëshkrim!

## VI.

Koleksioni i kodikëve të Shqipërisë përbën një prej pasurive më të rëndësishme kulturore të popullit shqiptar në të gjitha kohërat e një fond vlerash të parikrijueshme për historinë e mendimit të krishterë në përgjithësi. Ky koleksion, i cili ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit, përbëhet nga 100 vëllime, që përbëjnë vepra të plota (dorëshkrime) dhe 17 fragmente. Jashtë këtij fondi<sup>19</sup> numërohen edhe disa dhjetëra kodikë të tjerë, që i takojnë manastirit të Shën Gjon Vladimirit, Mitropolisë së Drinopolit e arkipeshkvisë së Shkodrës. Përveçse në AQSH, kodikë ka pasur edhe në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë, në Bibliotekën Kombëtare dhe në biblioteka familjare<sup>20</sup>.

Në këtë trajtesë fjala „*kodik*“ përdoret në kuptimin terminologjik që ka në shkencën e arkivistikës, sikurse dhe në atë të bibliologjisë, si „*vepër në dorëshkrim me përmbajtje biblike, liturgjike, agjiografike*<sup>21</sup>, *martirologjike, patrologjike*“, ndryshe nga kuptimi që jepet në fjalorët e gjuhës shqipe, si „*regjistër të dhënash kishtare*“. Për të emërtuar këto dorëshkrime janë përdorur edhe terma të tjerë, të përafërt, si „*kodekset*“, „*kode*“ etj.

Kodikët e Shqipërisë, veçmas ato të periudhave më të hershme, *janë dorëshkrime që kanë rëndësi botërore për historinë e zhvillimit të letërsisë së krishterë, prej fillimeve deri në kohët moderne*. Këta kodikë kronologjikisht ndjekin njëri-tjetrin gjatë 13 shekujve me radhë (prej shekullit të 6-të deri në shekullin e 18-të). Pjesa më e madhe e teksteve të tyre janë në greqishten antike dhe bizantine.

„*Kodiku i Purpurt i Beratit*“ gjendet në listën botërore të letërsisë ungjillore i indeksuar numerikisht 043. Pierre Batiffol i referohet një thënieje të Alexoudes-it se në mbulesën e „*Kodikut të Purpurt të Beratit*“ ka lexuar vetë një shënim të trashëguar në formë legjende prej një periudhe shumë të vjetër („*époque ancienne*“), sipas të cilit autori i dorëshkrimit duhet të ketë qenë Shën Gjon Gojarti (Joan Chrysostome): „*Voyez les lettres de cet évangile écrit par le propres mains de saint Jean Chrysostome, lors'qu'il etait dans sa patrie, à Antioche, diacre de l'évangile*“<sup>22</sup>. Në një shënim (fusnotë) edhe Batiffol, pasi e ka përfunduar artikullin e tij prej 35 faqesh, paraqet dyshimin nëse ky dorëshkrim i atribuohet Shën Gjon Gojartit „*prej legjendës*“ apo se ekzistojnë të dhëna të provueshme për këtë.

Nuk është dëshmuar përfundimisht, por as është përjashtuar përfundimisht, nëse „*Kodiku i*

*Purpurt i Beratit*” i takon vërtet dorës së Shën Gjon Gojartit. Por ekzistojnë disa të dhëna të tërthorta që të shtyjnë të besosh se ka një lidhje të fortë dhe jo rastësore mes tyre:

1. “*Kodiku i Purpurt i Beratit*” kronologjikisht lidhet me një periudhë jo më të vonë se mesi i shekullit të 6-të, por nuk përjashtohet të jetë më i hershëm. Sipas një dëshmie të atë Zef Valentinit, në vitin 403 Shën Gjon Gojarti (Joan Chrysostomos) u internua në viset e Epirit, gjë që do të thotë në hapësirën e brendshme ballkanike<sup>23</sup>. Internimi i Shën Gjon Gojartit në Epir i jep një pjese të jetës së këtij shenjtori karakterin e një murgjërie, priftërie, shugurimi, devocioni dhe vetmie të dyfishtë: prej vetëzgjedhjes dhe prej dënimit. Mesi i shekullit të 6-të (apo diçka më vonë) është kufiri i pagabueshmërisë në vlerësimin relativ të burimit kronologjik të dorëshkrimit. Ky kufi nënkupton se vepra nuk mund të jetë shkruar më vonë, por nuk e përjashton të jetë dorëshkruar më herët. Epoka e së *purpurtës së thellë* (lëndë e dorëshkrimit) dhe e shkrimit të vazhdueshëm (“*scriptio continua*”) me germa nistore kapitale biblike - stili i kaligrafisë së tij - fillon në shekujt e tretë dhe të katërt<sup>24</sup>.

2. Sipas studiuësve shqiptarë, duke përfshirë kërkimet e arkivistëve të specializuar, rezulton se në hapësirën paleoshqiptare „*ka ekzistuar një elitë intelektuale brenda vendit*“<sup>25</sup>. Mendimi se dorëshkrimet e periudhës së paleokrishterë duhet të lidhen me një vatër domosdoshmërisht pranë burimit biblik të krishtërimit, me një fjalë me një metropol të tij, si hapësira izraelite apo siro-palestineze, s’është i pakundërshtueshëm. Së pari, sepse në hapësirën biblike rajoni paleoballkanik jo vetëm që nuk është periferi, por përmendet nominalisht.

3. Në praktikën liturgjike shumëshekullore “*Kodiku i Purpurt i Beratit*” u paraqitej besimtarëve vetëm një herë në vit, dhe kjo ishte pikërisht dita përkujtimore e Shën Gjon Gojartit.

Një tezë krejt e përkundërt, që buron „nga mungesa e të dhënave“, duke e pranuar këtë paraprakisht, është ajo e një burimi alokton të dorëshkrimit. Kjo tezë mbështetet kryesisht në faktin se dy kodikë të tjerë të purpurt, „*Sinopensis O*“ dhe „*Vindobonensis*“, mendohet se janë krijuar në hapësirën siro-palestineze. Theofan Popa rezervohet të thotë diçka saktësuese në favor të autoktonisë / aloktonisë së dorëshkrimit, por citon Batiffol-in, e ky Alexoudes-in, që „*kodiku njihet si pronë e Kishës së Shën Gjergjit në kala të Beratit*“<sup>26</sup>.

I shkruar vetëm një shekull e gjysmë pas “*La Vulgata-s*”, përkthimi latin i Biblës sipas Shën Jeronimit (i njohur prej shqiptarëve si “Shën Gjëri”), „*Kodiku i Purpurt i Beratit*“ është një dorëshkrim me rëndësi historike për fillimet e letërsisë biblike. Sipas dijetarëve bibliologë dhe paleografë, ai është një ndër katër-pesë kodikë më të vjetër në gjithë botën. Duchesne mendonte se është i pesti. Aleks Buda mendonte se, kur Battifoli botoi librin e tij për dorëshkrimet greke në kishat e Shqipërisë, lista e kodikëve krysografikë, të shkruara në ar e argjend, „*nuk e arrinte një duzinë ekzemplarësh*“<sup>27</sup>.

Bashkëkohës me dorëshkrime të tilla të famshme si “*Sinopensis O*” - sipas emrit të qytetit Sinope të Turqisë perëndimore, ku u gjet në fund të shekullit të 18-të nga një studiues francez, sot pronë letrare e Bibliotekës Kombëtare të Francës; „*Codex Purpureus Rossanensis*“ (Rossano Calabro, Museo dell’Arcivescovado) dhe “*Vindobonensis*” (Biblioteka Kombëtare në Napoli), „*Petropolitanus Purpureus N*“ (022) - Peterburg, “*Kodiku i Purpurt i Beratit*” renditet në themelet e letërsisë kishtarë, si referencë themelore e saj.

Rëndësia e këtij dorëshkrimi rritet mjaft prej faktit se dorëshkrimi i parë i letërsisë biblike, i njohur me emrin “*Codex Sinaiticus*”, që përmban pjesë të “*Dhjatës së re*” (gjendet në British Museum) në aramaisht (hebraisht), i takon shekullit të katërt<sup>28</sup>, pra, është jo më shumë se një shekull e gjysmë pas tij.

“*Kodiku i Purpurt i Beratit*” është një dorëshkrim, kronologjia relative e të cilit argumentohet. *Guglielmo Cavallo* vëren „*una spostamento di valori semantici dalla simbiologia della sacralità divina*“, kur „*il verbo cristiano assume il colore porpora, atto a conferire al libro/testo la valenza di oggetto di adoratio: valenza potenziata dall’uso di inchiostri preziosi (argento e oro)*“<sup>29</sup>.

Sipas studiuësit të njohur italian të teksteve liturgjike, Edoardo Crisci, stili i të shkruarit - paleografia - veçmas forma e germave të mëdha biblike (maiuscule), që është zbatuar në dorëshkrimin e „*Kodikut të Purpurt të Beratit*“, shfaqet në historinë e shkrimit në shekullin e

tretë pas Krishtit dhe vazhdon deri në shekullin e nëntë. Kodiku i Purpurt i Beratit përmban një formë të avancuar të kanoneve grafike të këtij stili, si dhe zbulime në formë katrore dhe trekëndore. Germat që marrin rëndësi me formën e tyre grafike për të përcaktuar një kronologji relative të burimit të dorëshkrimit janë: *gamma, delta, epsilon, pi, tau, psi*<sup>30</sup>. Monumentaliteti i grafisë dhe ngjyra e purpurt e thellë, fillimisht atribut tipik i madhështisë perandorake dhe më pas shprehje e adhurimit të shkrimit të shenjtë, gjithashtu janë tregues të rëndësishëm të kohës kur u shkrua vepra. Ngjyra e purpurt lidhet me kohën e sundimit të Dioklecianit, kurse shkrimi i artë e i argjendtë mbi pergamenë të purpurt dëshmohej në poezitë e Optaziano Porfirio-s, kushtuar perandorit Kostandin. Sipas studiuesit Guglielmo Cavallo, në kohën kur mendohet të jetë shkruar „Kodiku i Purpurt i Beratit“ kishte ndodhur një spostim i vlerave shenjuese të këtij shkrimi dhe të kësaj ngjyre prej fuqisë perandorake në sakralitetin divin. Vlerësimi për kohën e lindjes së këtij dorëshkrimi lidhet me vlerësime të natyrës së kodikologjisë, të tipologjisë dhe teknikës së realizimit të vetë suportit, si dhe me vlerësime paleografike.

“Kodiku i Purpurt i Beratit **F**” u shkrua në një periudhë kur lënda biblike ende nuk ishte kanonizuar, ishte në përpunim. Dy ungjijtë që përmban dorëshkrimi kanë shmangie prej teksteve standarte të Biblës. Batiffol ka përmendur disa prej mospërputhjeve ndërmjet tekstit të njësuar të ungjijve dhe tekstit të trashëguar në këtë dorëshkrim. “Kodiku i Purpurt i Beratit **F**” ka 190 fletë dhe përmban dy ungjij: sipas Matheut dhe sipas Markut. Është shkruar me germa të derdhura prej argjendi. Për një kohë të gjatë, sipas vlerësimit të ekspertëve, mendohej se është shkruar “në fletë të ngjashme me letrën e zakonshme, që ka të ngjarë të jetë prodhuar nga ngjeshja e shumë elementeve petëzore me natyrë bimore, siç janë fletët e papirusit”<sup>31</sup>. Por bizantologët, para dhe pas këtij konstatimi laboratorik, mendonin e mendojnë se lënda e dorëshkrimit është pergamenë. Kjo tashmë është pranuar e provuar prej shqyrtimesh më të imëta laboratorike.

Sipas përshkrimit të Batiffol-it, Ungjilli sipas Mateut gjendet nga fleta 1 recto deri fletën 112 recto. Fleta 112 verso është bosh. Fleta 113 dhe 114 recto e verso përmbajnë krerët e Ungjillit sipas Markut (kefalia). Në kohën që e lexoi Batiffol, dorëshkrimi kishte humbur rreth 40 fletë. Me shumë zotësi ka vërejtur i ndjeri Theofan Popa se dorëshkrimi përmban një greqishte pa thekse të domosdoshme për shkrimin e saj prej shekullit të 6-të e kënde, si dhe me disa shkurtime që janë karakteristike për greqishten e para këtij shekulli.

Zbulimet gjenden në kufijtë e dy vijave paralele vertikale, që kthehen në kënd të drejtë horizontalisht. Vija vertikale interpretohet si tentim i hyjnore, kurse vija horizontale si shenjzim i fatit vdekëtar-kalimtar të njeriut. Bibliologët mendojnë se ky motiv, që rimerret edhe në dorëshkrimet e mëvonshme biblike, liturgjike ose agjiografike që janë ruajtur në Shqipëri, paraqet “*ekuilibrin shpirtëror të individit*”. Teknika e leximit të numerizuar të dorëshkrimit bën të njohur ekzistencën e një parateksti, teksti dhe mbiteksti.

Bizantologët shqiptarë, veçmas i ndjeri Theofan Popa, në studime të krahasuara, mbështetur në ligjet e ndryshimit të fonetikës historike të greqishtes nga antikiteti në periudhën e paleokrishtëritit e më kënde, i kanë interpretuar në një semantikë tjetër vlerat tingullore të disa prej grafemave të këtij dorëshkrimi, për rrjedhim edhe të përmbajtjes së tij. Nga autorët vendës veçohen për studime të posaçme për kodikët Theofan Popa, Ilo Mitkë Qafëzezi, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Gazmend Shpuza, Kosta Naçi, Llambrini Mitrush, Dhorca Dharmo. Theofan Popa ka shkruar një studim krahasues për një interpretim të ri të tejskrimeve të Batiffol-it, sidomos për vlerën e disa grup-grafemash kur janë në fqinjësi.

Në vitet '70, në bazë të një marrëveshjeje ndërshtetërore, “*Codex Purpureus Beratinus F*” u dërgua për restaurim pranë Institutit Arkeologjik të Kinës, ku u realizua një riprodhim identik, plotësisht i shfrytëzueshëm për studime. Vetë origjinali u restaurua, duke siguruar tejkalimin e gjendjes kritike dhe duke premtuar jetëgjatësi, përmes teknikës së mbylljes hermetike të fletëve një nga një ndërmjet dy xhameve organikë në boshllëk. Mbas restaurimit, “*Beratinus-1*” u nda në nëntë vëllime, të cilat ruhen pranë Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë. Gjatë kësaj

kohe dorëshkrimi është studiuar nga bibliologë e paleografë amerikanë, gjermanë, bullgarë. Vepra ka qenë e ekzaminuar në laboratorët e Fakultetit të Shkencave Natyrore, para dhe pas kthimit, nën kujdesin autoritar të prof. Kolë Popës. Sipas vlerësimeve të d3r. Bruce Rigdon, specialist i letërsisë ungjillore në Universitetin e Çikagos, i cili studioi kohët e fundit disa nga dorëshkrimet e periudhës së paleokrishtërimin që gjenden në AQSH, teknologjia e restaurimit të Kodikut të Purpurt të Beratit është e shkëlqyer<sup>32</sup>. Kjo teknologji bazohet në mbylljen hermetike të çdo faqeje të dorëshkrimit në xham organik. Me këtë teknologji janë restauruar edhe dorëshkrimet e vjetra hebraike.

Si përmbyllje do të përsërisim edhe një herë që në ekspozimin për herë të parë jashtë atdheut të vet, në ekspozitën jubilarë *“I Vangeli dei Popoli”*, të organizuar nga *Biblioteca Apostolica* e Vatikanit, *“Codex Purpureus Beratinus F”* u vlerësua si një ngjarje kulturore ndërkombëtare, dhe u tha se *“mbi të gjitha veçohet paraqitja e dorëshkrimit të rrallë dhe shumë të çmuar”*<sup>33</sup> të tij. *“Pa këtë dorëshkrim, ekspozita jonë do të ishte e mangët”*, u shpreh zëvendësprefekti i Bibliotekës Apostolike të Vatikanit, monsinjor Francesco D’Aiuto<sup>34</sup>.

Duke u nisur prej faktit se në arkivat shqiptare ruhen mbi 100 dorëshkrime të tipit *“kodik”*, në të cilët janë kopjuar gjatë 12 shekujve me radhë shkrimet e shenjta, *“Testamenti i Vjetër”*, ungjijtë dhe tekste të tjera të shërbesës ekleziastike, mendohet se ato mund të jenë shkruar nga murgj vendës. Veç faktit se këto dorëshkrime krijojnë një traditë të letërsisë kishtarë, vijonë në ndihmë të këtij përfundimi edhe të dhëna të tjera. Hapësira iliro-biblike gjendet brenda asaj që zakonisht quhet *“hapësirë biblike”*. Në librat e shenjtë Shën Pali citohet të pohojë: *“Për këtë arrita t’ju sjell të gjithëve lajmin e mirë për Mesinë, nga Jerusalemi e për qark në Illyricum”*<sup>35</sup>. Faltoret e para të krishtërimin në këtë hapësirë u ngritën qysh në mesin e shekullit të dytë pas Krishtit (kisha e Linit dhe ajo e Tushemishtit). Në hapësirën e iliro-shqiptarëve u formuan edhe disa personalitete që themeluan letërsinë e krishterë. Kryelutja mijëvjeçare e krishtërimin Perëndimor *“Ty zot të lavdërojmë” - “Te Deum Laudamus”*, e cila u kompozua nga Shën Niketa i Dardanisë (ose Shën Niketa i Remesianës), u përhap në disa variante në Europën Perëndimore pas vitit 525 dhe është edhe sot një prej vlerave kryesore të krishtërimin. Sipas burimeve serioze të arkeomuzikologjisë, duke përfshirë ato britanike, franceze dhe italiane, Niketa ka shkruar se *“ishte dardan” (“dardanus sum”)*. Ndërsa përkthimi i parë i Biblës prej hebraishtës në latinishtë, i njohur me emrin *“La Vulgata”*, u arrit në vitin 405, nga një ilir tjetër i shenjtëruar, Jeronimi i Eusebit (Hieronymus). Shën Niketa dhe Shën Jeronimi, që pasuruan kulturën e krishtërimin të Perëndimit, patën bashkëkohës e pasues që dhanë të njëjtën ndihmesë historike për pasurimin e letërsisë së krishtërimin Lindor, përmes përkthimeve në greqishte të vjetër të ungjijve në dorëshkrimet e tipit *“kodik”*.

*“Beratinus-1”* dhe kodikët e tjerë të Shqipërisë janë vepra me rëndësi edhe për historinë e kulturës e të shkrimit të shenjtë, por dhe të artit të shkruarit në përgjithësi. Teksti i dorëshkrimit ka një vlerë të papërrjashtueshme *si art i zbatuar*.

*“Kodiku i Purpurt i Beratit F”* është i regjistruar në listën e veprave më të rëndësishme të njerëzimit, të njohur me emrin *“Memoire du Monde” (“Kujtesa e Botës”)* dhe prej disa vitesh gëzon kujdesin e drejtpërdrejtë të Unesco-s.

Ai, gjithashtu, vazhdon të ndikojë për krijimin e një imazhi më pozitiv për vendin ku është ruajtur edhe 1500 vjet pasi është shkruar. Paraqitja e këtij dorëshkrimi në ekspozitën e *“Ungjijve të Popujve”* ngjalli një vëmendje ndërkombëtare ndaj vlerave që janë trashëguar prej shumë shekujsh në këtë vend.

Kodikët e Shqipërisë janë përmendore të kulturës dhe qytetërimit të krishterë dhe mbajnë vulën e hapësirës biblike-ekumenike ku kanë jetuar shqiptarët dhe të parët e tyre. Ata janë burim krenarie për bibliologët, për njohësit e shkrimeve të shenjta e për kishën, por edhe objekt studimi për etno-psikologjinë, për gjuhën dhe teknikën e shkrimit, për kaligrafinë, për artet e zbatuara figurative dhe për ikonografinë.

Kodikët janë enciklopedi të vërteta të mendimit të krishterë.

## Referenca bibliografike:

1. Pierre Batiffol, në veprën monografike *“Les manuscrits grecs de Berat d’Albanie et le Codex Purpureus F”*, që e shkroi dhe e botoi në Paris më 1886, pas ftesës që i bëri një mik i tij, konsull në Greqi, duke përshkruar stilin e të shkruarit të kësaj vepre, citon Alexoudes, i cili, në një shenjim në kapakun e dorëshkrimit, kishte gjetur këtë të dhënë: *“Voyez les lettres de cet évangile écrit par le propres mains de saint Jean Chrysostome, lors’qu’il etait dans sa patrie, à Antioche, diacre de l’évangile”*: *“Shiheni shkronjën e këtij ungjilli, shkruar me dorën e vetë Shën Gjon Gojartit, kur ishte në atdheun e tij në Antiokë”*. Ludovico Duschesne, në artikullin e tij botuar në *“Bulletin critique”*, mendonte se „nuk është tamam dora e Shën Gjon Gojartit“.

2. Në lidhje me frymën ekumenike që dëshmohet prej dokumenteve të krijuara dhe të ruajtura në Berat, shih për më gjerë: Shaban Sinani, *“Sta kazu albanski izvori”*, hyrje në katalogun *“Crno Gora u arhivskim dokumentima Albanija”*, Tiranë-Cetinje, 2001, f. 3-10; nga i njëjti autor: *“Arkiva të hapur në shoqëri të hapur”*, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe i Arkivave Federale të Zvicrës, Tiranë 2002, f. 167-172; po ai, *“Kështjella e virtytit”*, Tiranë 2001, f. 8-51.

3. Dorëshkrimet e identifikuar me ndajshtesë alfabetike pas referencës numerike janë dorëshkrimet më të hershme të traditës së letërsisë ungjillore. Sipas kataloguesve të tyre, mund të jenë ruajtur jo më shumë se 60-70 dorëshkrime që i takojnë periudhës ndërmjet shekullit të 4-t dhe shekullit të 10-të. *“Germa e ndajshtuar përcakton radhën që zë ai në vargun e dorëshkrimeve më të lashta të ruajtura të “Testamentit të Ri” kristian”*- Aleks Buda, *“Thesare kulturore që i kthehen popullit”*, botuar në *“Zëri i popullit”*, 28 janar 1972. I pari prej tyre mban ndajshtesën *“Aleph”* - A. Vetëm kodikët më të rëndësishëm të listës botërore të letërsisë ungjillore kanë ndajshtesë identifikuese: *“Codex Vaticana B”*, *“Codex Sinopensis O”*, *“Codex N”* (tetraungjill, greqisht, muzeu i Selanikut). Shih për më gjerë: *“I Vangeli dei Popoli”*, edizioni Rinnovamento nello Spirito Santo, Biblioteca Apostolica Vaticana, Roma 2000, p. 122-133. Po ashtu: *“Novum Testamentum Graece”* nga Nestle-Aland, Deutsche Bibelgesellschaft, 1993, p. 693. Siç dihet, kodikët e mëvonshëm u indeksuan vetëm numerikisht, por pa privilegjin e ndajshtesës alfabetike, siç është identifikuar, bie fjala, një kodik tjetër i Shqipërisë, i shekullit të 12-të, me numrin 1709-po aty, p. 709. Shih edhe: *“Die Handschriften Des Griechischen des Neuen Testaments”*, *Beschreibende Verzeichnung Der Maiusklen*, p. 123.

4. Kosta Naçi, *„Rreth “vendlindjes” së dorëshkrimeve mesjetare të Shqipërisë në gjuhën greke“*, botuar në *“Shkenca dhe jeta”*, nr. 127, janar 1991, f. 34-35. Ky studiues ka vënë re edhe një fakt të tërthortë mjaft domethënës për një traditë vendëse të shkrimit dhe kopjimit të dorëshkrimeve ungjillore. *„Në shumë kodikë prej letre janë lidhur fletë pergamene të shkruara për të forcuar lidhjen. Këto fletë janë pjesë nga kodikë më të vjetër të dëmtuar dhe të shkatërruar. Kjo vërteton faktin se numri i kodikëve ka qenë shumë herë më i madh“* - art. i cit. Ndërsa Apollon Baçe, në artikullin *“Kodekset e Beratit”*, botuar në gazetën *“Zëri i popullit”*, 18 gusht 1983, e sheh si një fakt me peshë të dhënë që gjendet në *„Kodikun e 27-të të Beratit“*, ku një anëshkrim na bën të ditur se një banor i këtij qyteti, i njohur me emrin Foti Skuripeki, bashkë me zonjën konteshë dhe me murgun Theodulo, më 6 korrik të vitit 1356 shpëtuan dorëshkrimet më të rëndësishme të kishës: *„Kur hynë serbët në Berat dhe bridhnin poshtë e lart në rrugicat jashtë kalasë, unë, Skuripeqi, i dhurova (nënkupto: i shpëtova) manastirit të Theologos dhe Kishës së Shën Gjergjit 27 libra nga më të mirët e më të zgjedhurit. I mbajta në krahë e shpatulla dhe bëra katër rrugë. Po të mos ndërhynim ditën e parë, ditën e dytë s’do të gjendej asgjë, pasi serbët ... edhe të vdekurit i nxorën nga varri“*.

5. AQSH, *Fondi 486, Dosja 660*, Fletët (e origjinalit) 46-47, si dhe: Shaban Sinani, *“Arkiva të hapur në shoqëri të hapur”*, botim i DPA, Tiranë 2002, f. 118-125.



6. Në lidhje me mundësitë që ofron dija antropologjike për studimet rreth kodikëve shih më gjerësisht: *Shaban Sinani, "Kodikët e Shqipërisë - sprovë për periudhizim e klasifikim", në "Kultura popullore", 1-2, 2000, f. 13-41. Nga i njëjti autor: "Kodikët", në "Historia e popullit shqiptar", vëllimi I, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2002, f. 351-353.*
7. Shih më gjerësisht: AQSH, Fondi "Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Dosja 14, Viti 1963, fl. 1-3", si dhe: *Shaban Sinani, "Arkiva të hapur në shoqëri të hapur", botim i DPA, Tiranë 2002, f. 118-125.*
8. Po aty, AQSH, Fondi "Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Dosja 14, Viti 1963, fl. 1-3"
9. *Batiffol Pierre, "Les manuscrits grecs de Berat d'Albanie et le Codex Purpureus F", Paris 1886, p. 5-36.*
10. *Edoardo Crisci, "Vangelo di Matteo e Marco", botuar në "I Vangeli dei Popoli", edizioni Rinnovamento nello Spirito Santo, Biblioteca Apostolica Vaticana, Roma 2000, p. 127.: „Quanto al luogo di origine del manoscritto, in mancanza di dati oggettivi si è ipotizzato - sia pur cautamente - che possa trattarsi della regione siro-palestinese, considerate le cospicue grafiche tra „Beratinus“ i già ricordati „Rossanensis“, „Sinopensis“, „Codice N“ e „Genesi di Vienna“, tutti manoscritti che in quell'ambito, appunto, si ritengono prodotti, forse addirittura nel medesimo laboratorio di copia ...“. Një mendim të ndërmjetëm ka shprehur Aleks Buda: „Një analizë paraprake lejon të thuhet se „Kodiku i Purpurt i Beratit“ ka disa lexime teksti, që janë të veçantë për të; në formimin e tekstit të tij kanë kontribuar tradita të ndryshme, që lidhen me Lindjen, me Sirinë, edhe me Perëndimin“, ar. cit. Shih edhe: „I codici purpurei“, në: „Medioevo“, october 2000: „Tra questi figura una primizia assoluta - senz'altro un riguardo all'ente organizzatore - il Codex Beratinus, il più antico manoscritto conservato in Albania, del quale si erano perse le tracce da decenni“, p. 9.*
11. Në „*Veprat e apostujve*“, toponimia e hapësirës biblike burimore përmban ndër të tjera: *Qipron (13), Selanikun (17), Athinën (17), Korintin dhe Efesin (18), Maqedoninë dhe Greqinë (19), Maltën dhe Romën (28), si dhe Illyricumin (Romakëve, 15). Në periudhën që pasoi paleokrishtërimin Berati dhe Ohri ishin kryeqendra të krishtërimit. Sipas një studimi të bullgarit Trendafil Krstanov, Shën Klementi ka shkruar në Berat një palimpsest që ruhet në Vatikan dhe që gabimisht për një kohë është konsideruar se ishte shkruar në Beograd: „El palimpsesto bulgaro del Vaticano-el mas antiguo libro bulgaro y panoslavo“.*
12. *G. Morelli dhe A. Piazzoni, „I Vangeli dei Popoli“, Roma 2000, p. 6-21.*
13. *Sh. Sinani, E. Crisci, „I Vangeli dei Popoli“, f. 132.*
14. Gjendet në: AQSH, "Urdhëri Jezuit" - Kolegji Saverian i Shkodrës, "Regjistër mbi inventarin e materialit dokumentar arkivor, grumbulluar e sistemuar nga bashkëpunëtorët e Kolegjit Saverian, përpiluar nga rektori i kolegjit Zef Valentini", Dosja nr. 73, Viti 1929.
15. *Anëshkrim në Kodikun e 27-të të Beratit, AQSH, Fondi 488.*
16. *Kosta Naçi, „Rreth “vendlindjes” së dorëshkrimeve mesjetare të Shqipërisë në gjuhën greke“, botuar në “Shkenca dhe jeta”, nr. 127, janar 1991.*
17. *“Historiku i kodikëve”, AQSH, Fondi i DPA, V. 1972.*
18. Qarkorja është nënshkruar nga krye-episkopi Paisi, në Tiranë, më 9/10/1956, dhe u është përcjellë kishave e manastireve e evidencuar me nr. prot. 45/l. Origjinali ruhet në AQSH.
19. Ky fond u krijua në AQSH në vitet 1980 dhe njihet me emrin „Fondi 488“. Kontributi kryesor për përpunimin e të dhënave themelore të dorëshkrimeve ungjillore që u bashkuan në këtë koleksion i takon dijetarit Theofan Popa, autor i veprës „Katalogu i dorëshkrimeve kishtarë mesjetare të Shqipërisë“. Mbi bazën e studimeve të këtij autori, nga arkivistët e vendit, përgjatë rreth dy-tri dekadave, u përgatitën pasaportat dhe inventari i kodikëve. Për përsosjen e mjeteve të informimit dhe të kërkimit të dorëshkrimeve të „Fondit 488“ ka një ndihmesë të çmueshme Kosta Naçi. Shih edhe: QEOFANIS POPA - ENAS SUGCPONOS IERAPOSTOLOS , BASILEIOU M. KASKANTAMI, EKDOSEIS HELAFOS, AQHNA.
20. Nuk ka ndonjë ndarje kriteriale ndërmjet kodikëve të këtyre institucioneve prej atyre të

“Fondit 488“. Vihet re se në „Fondin 488“ ka kryesisht dorëshkrime të letërsisë ungjillore në gjuhën greke. Por nuk mungojnë edhe kodikë të shkruar në latinisht. Madje ka edhe kodikë që i përkasin liturgjisë së kishës romane. Rasti më interesant është ai i „Kodikut të 83-të“, të arkiveshvisë së Shkodrës, që vlerësohet i shkruar në vitin 1341, me 173 fletë, në letër, në një kohë historike kur dy kishat, pas skizmës së madhe të vitit 1054, ishin në konflikt të rreptë. Kodiku përmban jetë shenjtoreësh, është shkruar latinisht, dhe përfaqëson një vepër të Shën Agostinit. Ndërsa “Kodiku i 91-të i Beratit”, dorëshkrim i shekullit të 18-të, me 84 fletë letre, është një përkthim prej latinishtes në greqisht, kopjuar prej Joasafit të Beratit (Bubullimë e Myzeqesë). “Kodiku i 91-të” përmban “zakone të mira” (hristoidhia). Ai paraqet interes edhe për marrëdhëniet midis letërsisë ungjillore të kishës ortodokse me atë të kishës katolike.

21. Nga gr. “*agios*”-i shenjtë, shenjtërore. Shpesh ky term përdoret me kuptim të shtrembëruar, madje edhe me trajtë gjuhësore të gabuar (hagjiografike, haxhiografike).

22. Pierre Batiffol, “*Les manuscrits grecs de Berat d’Albanie et le Codex Purpureus F*”, Paris 1886, p. 6-8.

23. “Viti 403: Shë Chrysostomi (Shën Gjon Gojarti) internue n’Epir“ - në Fondi Arkivor “Urdhëri Jezuit” - Kolegji Saverian i Shkodrës, “Regjistër mbi inventarin e materialit dokumentar arkivor, grumbulluar e sistemuar nga bashkëpunëtorët e Kolegjit Saverian, përpiluar nga rektori i kolegjit Zef Valentini”, AQSH, Dosja nr. 73, Viti 1929.

24. “Dell’uso di pergamenee purpuree in ambito librario si ha notizia certa solo a partire dal IV secolo“ - Edoardo Crisci, në „I Vangeli dei Popoli“, op. cit. p. 131. „Il manoscritto é vergato in maiuscula biblica, scrittura che si canonizza già nel corso del III secolo d. C.“ - po aty, p. 130. Shih edhe: “The Birth of The Codex”, by Colin H. Roberts, The British Academy, 1983.

25. Roderic L. Mullen bën fjalë për një “shkollë vendëse të shkruesve”. Shih edhe Shaban Sinani, “Kështjella e virtytit”, Tiranë 2001, f. 7-51.

26. Theofan Popa, „Katalogu i dorëshkrimeve kishtarë mesjetare të Shqipërisë“, dorëshkrim, AQSH, f.15. Më gjerësisht: Anthimi Aleksudhes, “Description abrégée et historique de la sainte métropole de Belgrade, aujourd’hui Bérat”, 1868 - titulli cituar sipas Pierre Batiffoli-it; *Katologos tou en tais ierais ekkhsias ths sunoikias kastrou, polews Beratiou ths mh tropolews Belegradwn euriskomenwn arcainwn ceirografwn. Deltion ths Istorikhs kai Eqnologikhs Etairias ths Ellados* 5 (1900): 352-369 & plates 1-12, by Alexoudes, Anthimi. Alexoudes saktëson se ç’ rrugë ka ndjekur dorëshkrimi, për aq sa i takon periudhës historike të njohur.

27. “Le të shtojmë se edhe sot ky numër nuk ka mundur të rritet“, Aleks Buda, art. cit.; „Midis tre kodikëve të rinj që u zbuluan atëherë, dy ishin kodikët e Beratit“; po aty.

28. Aleks Buda: „Shkenca vazhdon të interesohet për “Kodikun e Purpurt të Beratit“, si një nga variantet më të lashtë të tekstit të Testamentit të Ri“, art. cit.

29. Guglielmo Cavallo, “I Vangeli dei Popoli“, p. 132.

30. Edoardo Crisci, duke argumentuar me vlera të paleografisë burimin kronologjik të “Kodikut të Purpurt të Beratit”, vëren „una fase avanzata di svolgimento del canone: le lettere sono in modulo grande e presentano un artificioso e studiato contrasto fra tratti assai spessi e tratti sottilissimi; marcate appendici ornamentali, in forma quadratini e triangolazioni, completano i tratti orizzontali e talora obliqui di alcune lettere, soprattutto gamma, delta, epsilon, pi, tau, psi“, op. cit., p. 130.

31. Kolë Popa, “Ekspertizë e kampionëve të dy kodikëve të vjetër kishtarë“, dorëshkrim, DPA, viti 1972, dosja 18, faqe 1-3.

32. Kathleen Matsushima & Bruce Rigdon, „Report of Codex“, AQSH, dorëshkrim, 2000.

33. Francesco D’Aiuto, në parathënien e veprës „I Vangeli dei Popoli“, duke vlerësuar rëndësinë e ekspozitës jubilarë të Fjalës së Shenjtë, veçon „soprattutto un prezioso manoscritto a lungo considerato disperso e mai prima esposto dinanzi a un pubblico internazionale, il “Codex Purpureus Beratinus“ dell’Archivio di Stato di Tirana (Berat 1)“, p. XXV. Shih edhe:

„Codex B: The Gospels of the Peoples“, by Lucy Gordan, në „Antiquarian Book“, october 2000: „The Codex Purpureus Beratinus and its magnificent embossed silver binding, long considered lost, on loan from the State Archives of Tirana and never before publicly exhibited in the West“.

34. Francesco D’Aiuto, letër, arkivi i DPA, 2000.

35. “E Palit, romakëve“, 15: 14.



## RRETH NJË STUDIMI MONOGRAFIK TË PAPËRFUNDUAR PËR KODIKËT E SHQIPËRISË

(KATALOGU DHE PËRSHKRIMET E KOSTA NAÇOS)

NEVILA NIKA

I.

Pasuria dokumentare që ruhet pranë Arkivit Qendror Shtetëror në Tiranë mund të konsiderohet padyshim një thesar i paçmuar, sidomos duke pasur parasysh historinë e trazuar mijërvjeçare nëpër të cilën ka kaluar vendi ynë. Grumbullimi i kaq shumë vlerave në këtë institucion është arritje e disa brezave arkivistësh. Dhe, ndërkohë që sot gjithkush mund t'i studiojë apo edhe thjesht t'i kundrojë të gjitha këto, pyetjet që vijnë natyrshëm, sapo të krijohet mundësia e njohjes, janë: Nga erdhën, kush i krijoi, kush i ruajti, kush shpenzoi për krijimin e tyre, kujt duhet t'i jemi mirënjohës për këtë thesar etj., etj.

Pjesa më e vjetër e me vlera krejtësisht të veçanta e dokumenteve të këtij arkivi, ashtu si edhe në të gjitha vendet europiane, janë ato me prejardhje nga komunitetet fetare të krishtera (ortodokse e katolike). Po cilët ishin këta njerëz, që me aq përkushtim e vetëmohim i krijuan e i mbrojtën edhe me jetën e tyre këto dorëshkrime kaq të vyera?

“Ata quhen të tillë nga një farë Kristus, që u dënua me vdekje nga Pons Pilati, gjatë mbretërimit të Tiberit”. Dhe pikërisht nga kjo referencë e parë për krishtërimin, të cilën e kemi në sajë të historianit romak Taciti, kuptojmë përse doktrina e krishterë ishte më e fortë se sistemet e tjera fetare. Ajo bazohet në një person konkret, dhe jo si besimet e mëparshme, të cilat bazoheshin në ngjarje e fenomene të mbinatyrshme që duhej të kishin ndodhur shumë kohë më parë në thellësinë e shekujve. Pra, Krishti ishte “Biri i njeriut”; dhe mrekullia e ringjalljes së tij kishte ndodhur gjatë mbretërimit të Tiberit, në kohën e konsullit Pons Pilati. Premtimit të madh për një lumturi hyjnore të përjetshme, që Krishti ua bënte pasuesve të tij, shpirtrat e këtyre nuk mund t'i rezistonin. Por kishte edhe të tjera gjëra që, me sa duket, ushtronin një ndikim shumë më të thellë dhe që ne sot nuk mundemi t'i përfytyrojmë: Jezui mundej në çdo çast të kthehej në tokë për “të gjykuar të gjallët e të vdekurit”. Forca parashikuese e Shën Gjonit për Apokalipsin dhe bindja e palëkundshme e evangjelistëve e ngriti besimin e të krishterëve të parë deri në atë pikë sa për ata asnjë rrezik tokësor nuk përbënte pengesë. Mësuesi ishte gjithnjë pranë besimtarëve jo vetëm në ushtrimin e e riteve fetare, por edhe në jetën e përditshme. Krishtërimi ofronte “forcën e Shpirtit të Shenjtë” dhe afërsinë me Zotin; besimet e tjera nuk ofronin asgjë tjetër veçse një përvojë fetare të vakët dhe që bëhej e mundur vetëm herë pas here nëpërmjet “sakramenteve”. Sipas historianit Daniel-Rops, “për një të krishterë mesazhi i Jezuit nuk është një shpikje, një doktrinë filozofike e lindur në trurin e një gjeniu; është akoma më shumë: zbulimi nga Zoti i shprehjes përfundimtare jo vetëm nga një e vërtetë, por nga e Vërteta e Përjetshme, ajo që njerëzit kanë dëshiruar, hamendësuar, nganjëherë edhe afuar, por kurrë nuk është formuluar e tëra. Dhe akoma më shumë që mesazhi e tij është vetë Jezui, që u largohet kategorive të kohës dhe të hapësirës. Dhe është drama e Shëlbimit, që nuk është vetëm një fakt historik, që u zhvillua në një epokë dhe në një vend saktësisht të njohur; por është një element i përhershëm i dramës së përjetshme të njeriut që rrjedh pa ndalur në sekretin më të madh të zemrës së tij.”

Jezui i kishte mësuar pasuesit e tij se Zoti është një Atë jo vetëm për hebrejtë, por për të

gjithë njerëzit, pa dallim race apo gjendjeje shoqërore. Apostujt e zgjedhur prej tij kishin filluar predikimet menjëherë. Pikërisht ditën e Rrëshajave Shën Pjetri kishte predikuar para turmës së popullit. “Dhe po atë ditë raportojnë “Punët e Apostujve”, numri i dishepujve u rrit me rreth 3000 persona.” Por pikërisht në të njëjtën kohë nisi edhe persekutimi më i egër ndaj tyre e që do të vazhdonte me shekuj.

Hebreu Sanhedrin, i cili kishte dashur dhe arritur të realizonte vdekjen e Jezu Krishtit, u përpoq t'i kundërvihej përhapjes së këtij besimi dhe organizoi persekutimet. Dhjaku Etien u vra me gurë disa muaj më vonë pas dramës së Kalvarit. Ky është martiri i parë i kishës.

Midis persekutorëve të të krishterëve të parë u dallua një hebre i quajtur Saul nga vëllezërit e tij dhe Pal nga greko-romakët. Ai u konvertua mrekullisht në fenë e krishterë gjatë një udhëtimi të tij në Damask dhe që nga ajo kohë u shndërrua në një ndër propagandistët më të zjarrtë të fesë së krishterë. Ai ungjillizoi një numër të madh qytetesh në Azinë e Vogël, në Maqedoni, Iliri, Greqi dhe ndoshta edhe në Kretë dhe Spanjë. Më shumë se kushdo tjetër ai kontribuoi në organizimin e komuniteteve të para të krishtera. Themeloi në Korint një komunitet që shumë shpejt pati një komunitet binjak në Romë. Të dy këto qytete kishin marrëdhënie shumë të ngushta në fushën e tregtisë. Përpara se të hynte në kontakt të drejtpërdrejtë me vëllezërit e tij në bregun e Tiberit, Pali kishte shkruar për ta letërën “Romakëve”. Por në Romë ai shkoi si i burgosur. Meqenëse në Jeruzalem bashkatdhetarët e tij kishin kërkuar ta vrisnin me gurë, sepse kishte shkelur rregullat e tempujve hebreje, autoritetet romake ndërhyjnë në këtë konflikt, duke e dërguar Palin në Romë për t'u gjykuar nga vetë Perandori. Vetë Pali gëzonte të drejtat e qytetarit romak. Eshhtë i panjohur vendimi që u dha ndaj tij, pasi për të që nga kjo kohë nuk flitet më. Në një letër të drejtuar komunitetit të krishterë të Filipopolit /“Filipianëve”/ ai shkruan se dëshiron “të dërgohet e të bashkohet me Krishtin”. Ka shumë mundësi që pak më vonë nga shkrimi i kësaj letre dëshira e tij të jetë realizuar. Sipas të gjitha gjasave, Pali vdiq si martir, atij iu pre koka. Pikërisht në vendin e ekzekutimit, më vonë, besimtarët e krishterë romanë ndërtuan një katedrale e cila u quajt “Katedralja e Shën Palit jashtë mureve”. Ky rrobaqepës tendash, njeri kokulur, që gjatë udhëtimeve të ungjillizimit ushqehet nga puna e duarve të tij, u shndërrua në një hero të besimit të krishterë. Pa dyshim të njëjtin fat pësoi në Romë edhe Shën Pjetri, si edhe mijëra të krishterë të tjerë, të cilët u flijuan, por nuk e mohuan Jezu Krishtin dhe besimin e krishterë.

Shën Gjoni, autori i ungjillit të katërt, Apokalipsit dhe tri letrave, punoi më shumë në Azinë e Vogël. Ai u arrestua dhe u torturua gjatë sundimit të Domicianit, por vdiq në Efes në moshë të kaluar nga vdekje natyrore. Përveç apostujve, shkrimet e Testamentit të Ri përmendin emrat e dhjetëra klerikëve dhe laikëve që, nën drejtimin e ipeshkëve të vendosur në qytetet e mëdha, përhapnin doktrinën e krishterë.

II.

Nëse në fillimet e përhapjes dhe përqaimit të këtij besimi, besimtarët nuk kishin pothuaj asgjë të shkruar, me kalimin e viteve u bë më se e domosdoshme përcjellja e Fjalës së Shenjtë nëpërmjet shkrimit. Gjatë sundimit të Ptolementit Filadelf Testamenti i Vjetër u përkthye nga hebraishtja në greqisht prej 72 dijetarëve hebrej dhe njihet sot me emrin “Septuaginta” ose “Versioni i të 70-ve”. Në shekullin e katërt e gjithë Bibla, që do të thotë “Libri i librave”, tashmë e përkthyer edhe në latinisht, duke u bazuar në përkthimin e „të 70-ve“, u redaktua dhe u përshtat nga Shën Jeronimi. Ky përkthim, i vetmi që u njoh zyrtarisht nga kisha, quhet “Vulgata”. Përdorimi i këtij termi nuk do të thotë aspak se kishim të bënim me një libër të rëndomtë, por me një libër që gjithkush e kuptonte dhe mund e duhej ta mbante pranë.

Bibla, si një përmbledhje e shkrimeve të shenjta, është e ndarë në dy pjesë: Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re. Në pjesën e Dhjatës së Vjetër janë tre grupe të librave të shenjta të hebrejve (Pentateuku, Profetët, Agjiografët) dhe që i takojnë besimit, historisë, institucioneve dhe zakoneve të hebrejve. Ndërsa në pjesën e Dhjatës së Re përfshihen 4 ungjijtë, Veprat e Apostujve, Letrat e Apostujve dhe Apokalipsi.

Me përkthimin e Biblës mund të thuhet se më në fund çdo besimtar ose jo i tillë mund të njihej me jetën e veprën e Jezu Krishtit dhe fjalën e Zotit. Pikërisht nga këto dorëshkrime me vlera të përbotshme mori hov kudo në botën e qytetëruar shkrimi ose thjesht kopjimi i këtyre dorëshkrimeve me përmbajtje fetare, historike, e shoqërore. Është një mendim i pranuar nga të gjithë se këto dorëshkrime ishin (jo vetëm për atë kohë kur u krijuan, por edhe sot) vepra të vërteta arti. Për këto dorëshkrime me vlera të rralla shpenzohej shumë si nga ata që punonin drejtpërsëdrejti për krijimin e tyre ashtu edhe nga ata që financonin materialisht.

Në Arkivin Qendror Shtetëror sasia e këtyre dorëshkrimeve është relativisht e madhe, duke pasur parasysh historinë e trazuar të trevave shqiptare dhe Gadishullit Ballkanik në përgjithësi. Ushtri të panumërta armike i shkelën këto troje duke lënë pas tyre vetëm shkatërrim e mjerim të pamatë. E, natyrisht, një nga pasuritë tona më të çmuara, arkivat e familjeve të mëdha shqiptare dhe ato të komuniteteve të krishtera, u dëmtuan mjaft rëndë. Në shumicën e rasteve ato u zhdukën pothuaj krejtësisht, sidomos arkivat e fisnikëve shqiptarë. Me gjithë këto humbje, ne sot përsëri mund të mburremi se Arkivi Shqiptar zotëron dorëshkrime me vlera botërore. Dhe e gjithë kjo është falë sakrificave e përkushtimit fetar e atdhetar të klerikëve e besimtarëve të krishterë shqiptarë, të cilët edhe u flijuan për t'i krijuar e mbrojtur këto dorëshkrime.

Për të bërë të njohur këtë pasuri përmasash të tilla, pothuaj të panjohur për publikun shqiptar e të huaj, në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë ka vite e dekada që punohet. Përgatitja e një katalogu të plotë, ku do të përfshiheshin të dhënat për të gjithë kodikët të cilët ruhen pranë këtij institucioni, është padyshim një ndërmarrje jo e lehtë. Puna u nis nga i ndjeri prof. Theofan Popa, nga fundi i viteve 1970. Popa jo vetëm që ndër të parët e ndoshta ndër të vetmit që edhe në periudhën më të vështirë për historinë e komuniteteve fetare në Shqipëri ishte interesuar për t'i shpëtuar nga zhdukja e sigurt këto dorëshkrime, por u angazhua me shumë përkushtim për hartimin e një katalogu shkencor mbi kodikët dhe një tjetër katalogu mbi miniaturat e kodikëve. Disa vjet pune të tij në Arkivin Qendror qenë mjaft frytdhënëse. Katalogu mbi Koleksionin e Kodikëve hartuar nga prof. Theofan Popa është i pari gur në këtë drejtim.

III.

Nga fundi i viteve 1980 punonjësi i Arkivit Qendror, z. Kosta Naço, duke vazhduar veprën e prof. Theofan Popës, nisi punën për hartimin e një katalogu të plotë mbi kodikët e shkruar në gjuhën greke, që gjenden në të gjitha fondet në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë. Duke qenë se kjo është një punë tepër voluminoze e për rrjedhojë kërkon mjaft kohë, puna vazhdon akoma. Dalja në dritë e kësaj vepre do të jetë padyshim e mirëpritur veçanërisht nga rrethet e studiuesve shqiptarë e të huaj.

Punimi ka një strukturë të qartë dhe me baza shkencore. Kështu, autori, duke ndjekur kritere mjaft profesionale, për secilin kodik jep këto elemente:

1. Vendndodhja e kodikut në AQSH.
2. Emërtimi i kodikut.
3. Materiali i përdorur (pergamenë, letër apo papirus).
4. Përmasat e kodikut.
5. Sasia e fletëve të kodikut.
6. Të dhëna mbi tekstin.
7. Kapakët e kodikut.
8. Shkrimi i përdorur.
9. Gjendja fizike e kodikut.
10. Përmbajtja e kodikut.
11. Zbukurimet (pikturat e dekoret).
12. Shënime bibliografike.
13. Anëshkrime.
14. Datimi e krahasimi me kodikë të tjerë.

Sipas K. Naços, nisur nga përmbajtja e kodikut, është më se normale që kodikët të ndahen

në disa grupe, të cilat janë:

1. Kodikë me përmbajtje teologjike, që janë tekste të Dhjatës së Vjetër, si Pentateuku, Oktateuku e Psaltirët; tekste të Dhjatës së Re, që janë katër ungjijtë të ungjillorëve Mateu, Marku, Luka e Gjoni, bëmat e Apostujve të Shenjtë, fjalimet e Etërve të shpallur të shenjtë nga Kisha, si të Gjon Gojartit, Vasilit të Madh, Gregorit, Gjon Klimakut, Efrem Sirianit, Isaak Sirianit, Teodor Prodhomit, Maksim Peloponezit etj., panagjerike etj. Në këtë grup autori ka përfshirë edhe përshkrimet rreth jetës dhe martirizimit të shenjtoreve të shpallur nga kisha. Ai, gjithashtu, bën përpjekje për të krahasuar këto shkrime me tekstet e Bibliotheca Hagiographica Graeca, me tekstet paterike (të etërve) dhe ato gerondike (urtësore), që janë tekste murgjërish, në të cilat ata bëjnë komente rreth teksteve teologjike të shoqëruara me ngjarje jetësore.

2. Kodikë me përmbajtje liturgjike e kishtare, të cilët, sipas autorit, janë: Profecitë e Dhjatës së Vjetër, Evangjelistarët, Apostujt, Minejt (mujoret), Sinaksarët, Triodet, Eklogai (Përzgjedhjet), Pendikostaret, Parakletiket, Oktoiku, Orologjion, Tipikon, Eukologjet, Agjasmataret, Tri liturgjitë, Akoluthiet dhe kodikët e manastireve.

3. Kodikët me muzikë kishtare bizantine sipas z. Naço janë konsideruar si dorëshkrime mjaft të vlefshme dhe që paraqesin shumë interes. Ai mendon se shkrimi muzikor bizantin, ku kontribut të padiskutueshëm ka dhënë shqiptari Jan Kukuzeli, i mbiquajtur “mjeshtri”, duhet studiuar me shumë kujdes si muzika ashtu edhe tekstet kishtare liturgjike poetike, si edhe autorët e tyre.

4. Kodikët të cilët përmbajnë tekste filologjike e historike sipas autorit janë të pakët në numër. Megjithatë ai në këtë grup ka përfshirë veprën e Teodor Kavaliotit.

5. Kodikët me përmbajtje juridike e mjekësore bëjnë pjesë në grupimin e fundit, ku z. Naço ka klasifikuar kodikët e Arkivit Qendror. Sipas tij këta kodikë përmbajnë tekste me karakter juridik, si kanone (kanune) apostolike dhe sinodike, si edhe nomokanone. Ndërsa kodikët me përmbajtje mjekësore janë ata kodikë në të cilët përfshihen receta magjike ose edhe tekste të mjekësisë popullore.

Punimi do të jetë i pajisur me një parathënie të z. Kosta Naço, si edhe me tregues të ndryshëm (emëror, gjeografik, objekti).

Nga vepra e tij e pambaruar janë zgjedhur disa pjesë prej kapitullit mbi kodikët që gjenden në fondin 488: “Koleksioni i kodikëve”. Sipas z. Naço në vepër do të zënë vend edhe kodikët që gjenden në fondet e tjera që ruhen pranë Arkivit Qendror Shtetëror në Tiranë. Këto fonde janë jo vetëm të komuniteteve fetare ortodokse, por edhe nga fonde të personaliteteve etj.

Për Kodikun nr. 45, të Beratit, z. Naço, mbasi ka bërë një përshkrim të hollësishëm të gjendjes fizike të kodikut, vëren veçoritë e këtij kodiku në lidhje me tekstin, vinjetat e zbukurimet e tjera, si edhe për kapakët. Kështu ai shkruan se: “...fletët e fundit kanë disa shtylla ose gjysma shtyllash të pashkruara, ç’ka më bën të mendoj se kopjuesi i kishte lënë boshe me qëllim pikturimi me vinjeta ose me miniatura. Kapakët e kodikut janë vënë nga restauratorët e Arkivit. Kapakët origjinalë kanë humbur, ç’ka ka ndikuar edhe në humbjen e disa fletëve nga fillimi dhe fundi i kodikut. Lidhja e fashikujve është bërë me spango që dallohet nga gjurmët që kanë mbetur ende.

Në fletën 5 verso është një vinjetë në formë drejtkëndëshi e kufizuar me bordurë me të bardhën e letrës, ndërsa vijat janë kafe e errët. Fusha është kafe e çelët. Ka të dala anësore në cepat me zbukurime floreale. Po ashtu edhe brenda drejtkëndëshit.

Në fletën 11 recto është një vinjetë drejtkëndëshe me të dala anësore. Janë përdorur të njëjtat ngjyra si në vinjetën e parë, që janë edhe ngjyrat e bojërave të përdorura për të shkruar tekstin e kodikut. Kjo vinjetë në fushë ka zbukurime vizuale në formë gërshetash të ndërthurura. Ka inicial në formë gjarpëri të përdredhur. Ndërsa iniciali a paraqitet me një zog të mbërthyer në një shkop”.

Ndërsa për Kodikun nr.48, të Beratit, autori na jep plot të dhëna me shumë interes, sidomos përsa i takon përmbajtjes:



“Fletët e para të kodikut kanë humbur. Fletët 1 e 2 janë shkëputur nga lidhja. Në përgjithësi të gjitha fletët kanë vrima të shkaktuara nga mola. Po ashtu kanë edhe njolla të shkaktuara nga lagështia. Fletët e fundit të kodikut kanë humbur. Grafia e tekstit është shkruar në njëshkolonë me 23-25 rreshta për secilën faqe. Boja e përdorur është kafe e hapur. Me këtë bojë janë shkruar edhe shkronjat kapitale nistore. Nga studimi me kujdes i grafisë rezultoi se kodiku është shkruar nga një dorë. Autori është anonim ngase nuk kemi fletët e fillimit dhe sidomos ato të fundit ku autori mund të kishte lënë ndonjë shënim bibliografik. Titujt e teksteve janë shkruar edhe me ngjyrë të verdhë në bezhë me qëllim që të shquhet qartë. Kjo bojë duhet të jetë shtuar më vonë. Shënime bibliografike apo kronikale nuk ndeshen në fletët e kodikut.

Në fletën 1 recto: flitet për Shën Simeonin, patriarkun e Jeruzalemit; për Shën Trofinin dhe Shën Dorinentin; për Dëshmorin e shenjtë Eustathi.

Në fletën 1 verso: për apostullin e shenjtë Kodhrati; për profetin Jonà dhe dëshmorin e shenjtë Fokà.

Në fletën 2 recto; e protodëshmores së shenjtë Thekla.

Në fletën 2 verso: e dëshmores sonë të shenjtë Frosina; metastaza e Shën Gjon Theologut.

Në fletën 3 recto: e dëshmorit të shenjtë Artem; Atit tonë të shenjtë Ilarion.

Në fletën 3 verso: e Atit tonë të shenjtë Averq; apostullit të shenjtë Jakov; dëshmorit të shenjtë Aret dhe atyre që e shoqëronin.

Në fletën 4 recto: e dëshmorit të shenjtë Markjan dhe Martirit (?); dëshmorit të shenjtë Dhimitër; Shën Nektarit.

Në fletën 4 verso: e dëshmorëve të shenjtë Terent dhe Neorul; dëshmores së shenjtë Anastasia; Shën Markjanit, peshkop i Sirakuzës.

Në fletën 5 recto: e dëshmorëve Shën Kozma dhe Damian; Shën Akindineve.

Në fletën 5 verso: e atit tonë të shenjtë Joaniq; dëshmorëve të shenjtë Galaktion dhe Epistimon.

Në fletën 6 recto: e Shën Pavlit Homologjet; dëshmorëve të shenjtë Ankti dhe Taurioni.

Në fletën 6 verso: e dëshmores së shenjtë Matrona; dëshmorit të shenjtë Orest; dëshmorëve të shenjtë Mina, Viktor, Vikent dhe Atit tonë të shenjtë Teodor Hmolliti.

Në fletën 7 recto: e atit tonë të shenjtë Gjon Eleimon; Atit tonë të shenjtë Gjon Gojart; apostullit të shenjtë Filip.

Në fletën 7 verso; e dëshmorëve Samonas, Gurias dhe Amvivi; apostullit dhe ungjillorit Mateu.

Në fletën 8 recto; e atit tonë të shenjtë Grigorit Çudibërës; dëshmorit të shenjtë Platon.

Në fletën 8 verso; e Shën Grigor Dekapolitit; eksodet e të Mbishenjtëruarës Perëndilindëse; dëshmorëve të shenjtë të Kikilisë.

Në fletën 9 recto: e Shën Jakovit të Persit; Atit tonë të shenjtë Stefani i Ri.

Në fletën 9 verso: dëshmorit të shenjtë Paramoni (Paravoni); apostullit të shenjtë Andrea; profetit të shenjtë Naum.

Në fletën 10 recto: e profetit të shenjtë Jakov; profetit të shenjtë Sofron.

Në fletën 10 verso: e dëshmores së shenjtë, të madhe, Varvara.

Në fletën 11 recto: e atit tonë të shenjtë Nikolla; atit tonë të shenjtë Ambrozi.

Në fletën 11 verso: e atit tonë të shenjtë Patapi; arrestimi i Shën Anës; dëshmorëve të shenjtë Mina hermogjeni dhe Agrafi.

Në fletën 12 recto: e atit tonë të shenjtë Daniel Stilistit; atit tonë të shenjtë Spiridon; dëshmorit të shenjtë Eustrat dhe atyre që ishin me të.

Në fletën 12 verso: e dëshmorëve të shenjtë Toristi dhe Leuku; dëshmorit të shenjtë Eleuteri; tri fëmijve të shenjtë dhe Daniel Profetit.

Në fletën 13 recto: për lindjen e Krishtit dhe të etërve të shenjtë; dëshmorit të shenjtë Sebastian.

Në fletën 13 verso: e dëshmorit të shenjtë Ignat; dëshmores së shenjtë Juliana.

Në fletën 14 recto: e dëshmores së shenjtë Anastasia nga Roma; dëshmorëve të shenjtë të martirizuar në Kretë; Shën Evgjenisë; mbi lindjen e atit tonë të shenjtë Jezu Krisht.

Në fletën 14 verso: e dëshmorit të shenjtë Enthim; protomartirit të shenjtë Stefan dhe Shën

Theodorit; Shën Dhimitrit.

Në fletën 15 recto: e fëmijve të shenjtë; Shën Markelit; të shenjtit e homologjetit Theodor.

Në fletën 15 verso: e dëshmores së shenjtë Anysia; profetit të shenjtë David dhe Josifit dhe Jakovit vëllait të Perëndisë; peritomi i zotit tonë Jezu Krisht dhe të atit tonë Vasil.

Në fletën 16 verso: e atit tonë të shenjtë Silvestër; profetit të shenjtë Mallah; dëshmorit të madh Teon.

Në fletën 16 verso: e atit tonë të shenjtë Teoktist dhe Shën Fosterit; Shën Teofanisë.

Në fletën 17 recto: e dëshmores së shenjtë Domenika; e dëshmorit të shenjtë Polieukt; atit tonë të shenjtë Grigorit të Nishit; atit tonë të shenjtë Theodor.

Në fletën 17 verso: e Shën Tatianës; e dëshmorëve të shenjtë Ermit dhe Stratonik; Shën Asvadisë rënë në Raixha.

Në fletën 18 recto: e atit tonë të shenjtë Joan Kalivati.

Në fletën 18 verso: e atit tonë të shenjtë Andon; etërve tanë të shenjtë Athanas dhe Ciril; atit tonë të shenjtë Makar të Egjiptit.

Dhe kështu në vijim, siç u pasqyrua më lart, Naço vazhdon të japë hollësisht përmbajtjen e këtij kodiku.

Për Kodikun nr. 50, të Beratit, veçojmë përcaktimin mbi tekstin dhe grafisë e tij: "... teksti është shkruar në njëshkolonë, me nga 23 deri në 27 rreshta për faqe. Grafia është e tipit të vonë, e shkruar shumë bukur e shumë qartë. Grafia është me bojë kafe të thellë. Shkronjat anësore kapitale dhe titujt e tekstit janë shkruar me bojë të kuqe, ndërsa inicialet e mëdha të stilizuara janë shkruar me të kuqe të gërshetuar me të bardhën e letrës dhe herë pas here është shtuar pak e zezë ose bezhë. Shkronjat kapitale janë me lule ose me shumë antena që i japin bukuri. Çdo gjë në këtë kodik është shkruar me shije dhe me art. Brenda tekstit ndeshemi edhe me përdorimin e shkronjave kapitale. Teksti është shkruar nga një dorë e vetme".

Për Kodikun nr.51, të Beratit, Naço, pasi jep me hollësi përmbajtjen, dëmet e gjendjen e kapakëve, vëren: "Dy fletët e fundit të kodikut janë të shkruara me shkrim të imët në dyshkolonë, ndryshe nga pjesa tjetër e kodikut. Gjithashtu edhe letra është tjetër. Kjo na bën të mendojmë se këto dy fletë i janë shtuar kodikut më vonë, por që ka shumë mundësi të jenë më të hershme nga vetë kodiku. Ato mund të jenë shkëputur nga ndonjë kodik më i vjetër ose janë mbeturina të një kodiku më të hershëm".

Gjatë studimit të Kodikut nr.52, të Beratit, që është mineji i muajit janar, autori, pasi ka nxjerrë të gjithë përmbajtjen e tij, jep disa të dhëna me shumë interes sidomos në lidhje me ngjashmërinë e këtij kodiku me Kodikun nr.51, të Beratit,: "Kapakët janë prej dërrase të veshur me lëkurë me zbukurime floreale dhe lineare të presuara. Dërrasa është me vrima të shkaktuara nga brejtësit (insektet-mola). Po ashtu edhe lëkura është e dëmtuar, pasi në pjesën më të madhe është e ngrënë duke u dëmtuar kështu cipa e hollë e zezë. Dëmtimi është i atillë sa që pak gjurmë mbeten nga zbukurimet floreale dhe lineare të stilizuara. Në kurriz dy kapakët janë lidhur edhe me copë prej liri e spango prej liri që forcon lidhjen. Në anën e hapjes ka dy thumba në kapakun e parë ku fiksohej kodiku kur mbyllej. Lidhja e kapakut në kurriz, veç dy cepave me spango të ngjeshur fort, bëhej edhe në katër vende të tjera në largësi të njëllajtë. Në anën e hapjes së kapakut të poshtëm në dy anët kapaku kishte lidhje trekëndëshe me tre fije lëkure ku fiksoheshin në thumbat që gjëndeshin në kapakun tjetër. Kapakët dhe mënyra e lidhjes e Kodikut nr.52, të Beratit, janë pothuajse të njëjtat me ato të Kodikut nr.51, të Beratit. Po ashtu, edhe zbukurimi i kapakëve është i njëjtë. Tipare të tjera të përbashkëta midis këtyre dy kodikëve të lartpërmendur janë cilësia e mirë e letrës, kafja e thella e bojës, që është e njëjtë në të gjithë kodikun, dora e vetme e shkruarit (kopjuesit), e kuqja e titujve dhe inicialeve kapitale, si edhe stili dhe motivet e njëjta të shkronjave kapitale anësore të stilizuara. Afërsia e kohës së kopjimit të Kodikut nr.51, të Beratit, dhe atij nr. 52; cilësia e lartë e shkrimit dhe tiparet e tjera të përbashkëta, si edhe shtimi në të dy anët e

këtyre kodikëve të fletëve nga fragmente kodikësh për përforsim na bën të supozojmë se kopjuesi i Kodikut nr.52, të Beratit, duhet të jetë Simeoni, që kopjoi disa vjet më parë edhe Kodikun nr.51, të Beratit. Gjë tjetër e përbashkët e këtyre kodikëve është se ata janë të datuar. Kështu mund të bëjmë fjalë për një shkollë shkrimi në kishat dhe manastiret e kalasë së Beratit, sa që marrin edhe porosi nga autoritetet të larta të vendit e më tej. Si në shënimin bibliografik të Kodikut nr.51, të Beratit, ashtu edhe në atë të Kodikut nr.52, të Beratit, vihet re se autorët (ose autori) bën gabime ortografike, çka tregon për mangësi gjuhësore njohëse të kopjuesit, që duhet të ishte kopjues shqiptar”.

Nga të dhënat për Kodikun nr.53, të Beratit, që është një dorëshkrim me kanone (poezi fetare në prozë) veçohet fakti që autori e quan me interes, midis të tjerash, përshtkrimin e shenjave ujore: “Veçanti e këtij kodiku është se ka vetëm një shenjë ujore në të 338 fletët e tij.

Shenja ujore alternohet midis fletëve. Kjo shenjë ka dy rrathë të lidhura midis tyre me një vijë që përfundon në një kryq latin. Në pesë fletët e fundit ndeshim një tjetër shenjë ujore, që në këto fletë është dy herë. Kjo shenjë është një pëllëmbë e shtrirë që mban një lule gjashtëpetalëshe. Duke vëzhguar me kujdes shenjat, si shpeshmërinë e tyre, vazhdimësinë e tekstit, cilësinë e letrës etj. mund të shtrojmë disa pyetje:

A është letra e njëjtë, apo fletët e fundit janë shtuar ngaqë letra nuk doli për të shkruar tekstin? Pse të jetë e njëjta shenjë ujore në gjithë kodikun dhe vetëm në pesë fletët e fundit (kodikun e kemi të plotë) ndeshim një shenjë tjetër ujore?

Në qoftë se 5 fletët e fundit janë shtuar më vonë nga kopjuesi, se nuk i mjaftoi letra dhe nëse letra nuk është e njëjtë, a duhet hedhur hipoteza se lidhja e letrës në kodik bëhej në Berat dhe nuk ishte i lidhur që në prodhimin e letrës?

Kapakët e kodikut, sipas Naços, janë prej dërrase të veshur me lëkurë. Në kurrizin midis dy kapakëve është vendosur copë prej liri për lidhje dhe fiksion. Lidhja është bërë me spango prej liri. Fiksioni i kapakëve të kodikut bëhet në mes me një thumb dhe lidhëse prej lëkure, në ndryshim nga disa kodikë që fiksohen në dy anë. Lëkura e kapakëve është e dëmtuar shumë nga insektet dhe lagështia. Kapakët kanë zbukurime floreale dhe lineare të presuara”. Ndërsa më poshtë ai vazhdon me analizën e grafisë së tekstit. “Grafia ka vlera burkurshkrimore. Teksti është shkruar me një bojë kafe të thellë, ndërsa titujt janë shkruar me ngjyrë të kuqërremtë. Me këtë ngjyrë janë shkruar edhe shkronjat nistore kapitale. E veçanta e grafisë së këtij kodiku është se brenda tekstit ka edhe shkronja kapitale të kuqërremta. Teksti është shkruar në njëshkolonë me nga 32 rrjeshta për çdo faqe. Shkrimi është i drejtë, i njëtrajtshëm dhe i shkruar nga një dorë. Ndryshim kanë fletët 338-342, ku teksti është shkruar nga një dorë tjetër me bojë të kuqe. Shkronjat kapitale të stilizuara dhe vinjetat janë me ngjyrë të kuqërremtë”.

Nga Kodiku nr.57, i Beratit, veçojmë të dhënat për shenjat ujore, grafinë dhe kapakët:

”Letra e këtij kodiku nuk është e njëjtë. 23 fletët e para janë me shenja ujore. Këto fletë janë më të holla dhe me një farë shkëlqimi. Pjesa tjetër janë fletë pa shkëlqim, të punuara trashë dha pa shenja ujore, çka na bën të mendoj se letra e këtij kodiku është dyprejardhjesh (Perëndim-Lindje), e lidhur në vendin tonë dhe e shkruar prej njerëzve tanë.

Grafia: është ngjyrë kafe e çelët.

Titujt dhe shkronjat kapitale nistore janë me ngjyrë të kuqërremtë.

Teksti është shkruar në njëshkolonë me 27 deri në 35 rrjeshta për faqe. Në 23 fletët e para ka më shumë rrjeshta sepse shkrimi është më i vogël, ndërsa në fletët e tjera shkrimi është më i trashë. Në tekst ka gabime ortografike.

Shkronja kapitale të stilizuara nuk ka.

Shënime bibliografike dhe kronikale nuk ka.

Duket se shkrimi është shkruar nga dy duar. Fletët e para (deri në fletën 23) kanë shkrim të ndryshëm.

Fleta e parë dhe dy të fundit janë shkëputur nga një kodik tjetër dhe janë vënë për të përforsuar

kodikun.

Kapakët janë prej dërrase që duhet të kenë qenë veshur me lëkurë. Dërrasat janë konsumuar anash dhe kanë shumë vrime të shkaktuara nga mola. Lidhja e kapakëve është bërë me spango në 5 pika fiksime plus dy lidhjeve anësore të shtrënguara fort”.

Kodiku nr.62, i Beratit, që është një “tipikon”, për studiuesin K. Naço paraqet interes, përveç të tjerash, për grafinë e tekstit. Kështu, sipas tij: “Grafia e këtij kodiku është shumë kaligrafike e me shumë art. Teksti është shkruar në njëshkolonë me nga 20 rreshta për çdo faqe. Boja e grafisë është kafe e thellë. Shkronjat nistore kapitale dhe shkronjat në fillim të fjalisë (kapitale) janë me bojë të kuqe. Grafia është me shkrim të vogël. Rrallë përdoren edhe shkronja kapitale. Më të shpeshta janë shkronjat si: **E, G, T, Y**. Grafia e fletëve 65-66 ndryshon pak nga grafia tjetër, sepse e para është më e trashë, po ashtu ndryshon edhe forma e shkronjave. Ndoshta është shkruar nga ndonjë dorë tjetër. Fletët 179 verso deri në 181 verso kanë grafi jo të mirë. Duket se e ka shkruar një dorë jo e stërvitur mirë.

Shkronjat nistore kapitale janë me bojë të kuqe dhe një pjesë me bojë çiklamin.

Një veçori e përgjithshme e kodikut është se /shkrimi/ ndryshon vende- vende: 1. Përsa i përket animit (këndit); 2. Përsa i përket trashësisë së shkronjave; 3. Përsa i përket bojës së shkrimit, herë më e thellë (kafe) dhe herë më e çelët; 4. Përsa i përket hapjes së shkronjave dhe fjalëve nga njëra tjetra. Anëshkrimet ku tregohen kapitujt janë me ngjyrë çiklamin. Karakteristikë tjetër e shkrimit të këtij kodiku është të qenit, i imët”.

“Psallmet e Davidit” janë lënda e Kodikut nr.64, të Beratit. Gjatë studimit të këtij kodiku Naço, pasi ka shqyrtuar përmbajtjen, jep të dhëna mbi dëmet që ka pësuar kodiku, kapakët e tij, grafinë, zbulimet, teksit etj. Sipas tij, “... grafia është e tipit të vonë dhe ka vlera kaligrafike. Ajo është shkruar nga një dorë dhe është e bukur. Ka shumë shkronja nistore kapitale në ngjyrë të kuqe dhe shkronja kapitale të stilizuara. Fleta 118 ka shkrim ndryshe. Duhet të jetë shkruar nga një dorë tjetër, pasi ka humbur fleta origjinale. Edhe pesë fletët e para kanë shkrim tjetër, që do të jetë shtuar më vonë dhe është përdorur ngjyra kafe. Teksti është shkruar në njëshkolonë me 24 rreshta për faqe. Në fletët e para jepet përmbajtja e kodikut, në formë të përmbledhur të shtatë psallmet. Kodiku ka një vinjetë në fletën 64 verso, ku mbizotëron kafeja e çelët e tekstit dhe e bardha e letrës. Boja e shkrimit dhe grafia e fletëve 2-6 dhe 118 ndryshojnë nga pjesa tjetër”.

Për Kodikun nr.66, të Beratit, mbasi na paraqet hollësishtëm përmbajtjen, Naço jep vlerësimet përsa i takon grafisë së kodikut dhe datimit të tij: “Grafia është me ngjyrë kafe të çelët. Titujt dhe shkronjat kapitale nistore janë të kuqe. Ka shumë gërma kapitale të stilizuara. Teksti është shkruar nga një dorë në njëshkolonë me nga 17 rreshta për faqe. Ka një rregullsi të madhe si përsa i përket grafisë ashtu edhe paraqitjes. Brenda tekstit hasim përdorimin e shkronjave kapitale si: **E, D, Y, T, b, q**.

Kapakët e kodikut kanë humbur. Kodiku është restauruar nga restauratorët e Arkivit Qendror, të cilët kanë shtuar edhe kapakët imitacion të kapakut të vjetër prej lëkure.

Kodiku është i plotë nga fillimi deri në fund. Vetëm se 9 fletët e para janë grisur në pjesën më të madhe të tyre, duke dëmtuar tekstin. Fleta e parë në faqen verso ka një shënim të mëvonshëm, që është dëmtuar shumë. Megjithatë teksti është ruajtur pjesërisht.

Kodiku në fletën 2 fillon me një tekst hyrje, që ndoshta jepte të dhëna për kodikun. Përmendet këtu peshkopi i Beotisë, Joasafi.

Në fund të kësaj hyrje jepet një datë 5 janar 1562, që ndoshta është data e fillimit të kopjimit të kodikut.

Në fletën 3 faqja verso fillon të jepet pasqyra e lëndës së këtij kodiku, që vazhdon deri në faqen 24 recto. Fletët 24 verso dhe 25 rektio janë të pashkruara. Në fletën 26 fillon teksti i plotë i kodikut”.

Ndër të tjera, për Kodikun nr.70, të Beratit, që përmban “Meshën e Shën Gjon Gojëartit”, autori, pasi ka analizuar gjendjen fizike të kodikut dhe shkrimin, ka arritur në përfundimin se:

“Kodiku ruhet i plotë. Kapakët janë prej kartoni. Mbi to janë shtuar nga restauratorët e Arkivit Qendror kapakë të rinj pa hequr të vjetrit. Letra është kaba, e trashë.

Teksti është shkruar në njëshkolonë. Secila faqe ka nga 17-18 rrjeshta.

Grafia është e tipit të vonë, shkruar me bojë kafe të errët, ndërsa titujt dhe shkronjat nistore kapitale të stilizuara me të kuqe të thellë (ngjyrë tulle).

Inicialet e stilizuara janë shumë të bukura, me shumë antena dhe me motive floreale (lule). Këto shkronja janë të mëdha.

Shënimi i faqes së parë të këtij kodiku është interesant, qoftë për emrin e autorit, qoftë për gabimet e shumta drejtshkrimore të kopjuesit gjë që më bën të mendoj se kopjuesi ishte shqiptar dhe nuk e zotëronte mirë gjuhën greke.

Mendoj se teksti është shkruar nga një dorë, por duke përdorur dy mënyra të shkruari. Në disa faqe të kodikut autori e bën shkrimin e drejtë dhe me shkronja me përmasa më të mëdha dhe në disa faqe e bën shkrimin të përkulur dhe me shkronja më të vogla.

Brenda tekstit me shkrim minuskul hasim përdorimin e shkronjave majuskule, si p.sh. **Q**, **G**, **S**, **C**, **E**, **B**, **G**.

Ndeshemi me të shkruarat në dy rrjeshta, një shkronjë mbi një tjetër  $w^T_N$  duke imituar të shkruarit e kohrave më të hershme. Natyrisht ky përdorim nuk është i shpeshtë”.

Në fondin “Koleksioni i kodikëve” ka natyrisht edhe kodikë me prejardhje nga qytete të tjera të Shqipërisë. Kështu, Kodiku nr.78, i Gjirokastrës, që është “pendikostar”, ka zënë vend në këtë studim. Autori, pasi jep të dhëna me interes për gjendjen fizike të kodikut, analizon grafinë e tij.

“Grafia e kodikut: Teksti është shkruar në njëshkolonë me nga 24 rrjeshta për faqe, me përjashtim të fletëve 96-111 që kanë 22 rrjeshta për faqe. Në këto faqe ndryshon pak edhe stili i të shkruarit në krahasim me pjesën tjetër të tekstit, ku grafia është e njëjtë. Shkronjat nistore kapitale janë të kuqërremta pjesërisht dhe bojë bezhë. Titujt janë shkruar me bojën e shkronjave nistore kapitale. Mendoj se kodiku është shkruar nga një dorë.

Kam një mëdyshje përse i takon bojës nga fillimi i kodikut deri në fund, gjë që do të thotë se kopjuesi e përgatiste vetë bojën dhe hera herës nuk e arrinte të njëjtën cilësi. Më rrallë kopjuesi mund të përdorte penë tjetër, që mund të ishte më e hollë ose më e trashë nga e para brenda një kodiku, gjë që duket nga grafia e tekstit të kodikut. Megjithatë mund të thuhet se shkronjat nistore kapitale janë dy llojesh në këtë kodik, ato të stilizuara dhe ato të pastilizuara. Të parat janë të ngarkuara me lule, antena, me motive Lindore. Zakonisht në kodikët më të vonshëm, siç është edhe ky, ndihet një farë lirie më e madhe e kopjuesit. E njëjta gjermë e stilizuar mund të ketë përmasa dhe motive të ndryshme.

Vinjetat janë të thjeshta, pa art, por që autori përdor motive të njohura më parë.

Kodiku nuk ka anëshkrime bibliografike sepse si fillimi ashtu edhe fundi tij është i dëmtuar”. Duke përfunduar mund të them se studimi i z. Naço do të jetë padyshim një ndër studimet më të vyera të kryera deri më sot. Vlera e kësaj vepre është shumëplanëshe. Krahasimi me punimet e tjera të kryera nga studiues të huaj për këto lloj dorëshkrimesh është bërë me mjaft kujdes dhe ka nxjerrë në pah shumëllojshmërinë e dorëshkrimeve të tilla në Shqipëri. Fakt ky që, sipas autorit, dëshmon për ekzistencën në vendin tonë të një shkolle vendase për krijimin e tyre. Duke lexuar përshkrimin e hollësishëm të gjendjes fizike dhe sidomos dëmeve që kanë pësuar dorëshkrimet nga koha e nga njerëzit, të krijohet përshtypja se autori ka përpara një qënie të gjallë e jo thjesht një dorëshkrim. Me sa duket fuqia e një dorëshkrimi që përmban shkrime të shenjta është e tillë sa që imponon këtë trajtim. Vetëm mendimi se këto dorëshkrime të krijuara shekuj më parë mbijetuan deri në ditët tona, u jep atyre cilësi, ndoshta edhe të mbinatyrshme. Jeta e tyre është padyshim e mbushur me të fshehta, por një gjë është e sigurtë, diçka hyjnore i mbrojtë e i shpëtoi ato nga shkatërimi.

Në vijim, për të lehtësuar vlerësimin e lexuesit për qëllimin dhe arritjet e kësaj vepre ende të papërfunduar për kodikët e Shqipërisë, po japim një shembull të plotë përshkrimor të një

kodiku, shkëputur nga punimi i z. Naço:

“Vendndodhja: Në Arkivin Qendror, F. 488, Kodiku Br. 4.

Emërtimi i kodikut: Katërungjill.

Materiali mbi të cilin është shkruar: pergamenë e një cilësie shumë të mirë.

Përmasat e kodikut: 20,5 cm x 16 cm. Trashësia me gjithë kapakët është 8 cm.

Teksti është shkruar në një kolonë me nga 25 rreshta në çdo faqe.

Kapakët e kodikut janë prej dërrase veshur me lëkurë dhe mbi të veshur me pëlhurë, që ruhet jo e plotë.

Shkrimi i tekstit është në ngjyrë kafeje të hapur, në të kuqe. Shkronjat e kanoneve, kapitujt e çdo ungjilli si dhe inicialet e perikopeve janë prej ari. Shkrimi i përdorur në këtë kodik është shkrimi miniskul. Shkrimi është tepër i bukurshkruar, një punë me të vërtetë artistike nga më të mirat e bukurshkrimit bizantin. Përmasat e shkronjave janë të rregullta, po ashtu edhe hapësira midis shkronjave si edhe midis fjalëve. Shkrimi është i drejtë me një anim shumë të lehtë nga e djathta. Megjithëse kodiku është shkruar me shkrim miniskul, në të hasim edhe përdorimin e shkronjave kapitale, por vetëm në fillim të rreshtave, herë pas here.

Gjendja fizike: Nga kodiku janë shkëputur gjithsej 11 fletë pergameni. Konkretisht janë hequr: 2 fletë midis fletëve 1 e 2 me numërimin e sotëm; 1 fletë midis fletëve 3 e 4; 1 fletë midis fletëve 4 e 5; 1 fletë midis fletëve 72 e 73; 1 fletë midis fletëve 116 e 117; 1 fletë midis fletëve 124 e 125; 1 fletë midis fletëve 196 e 197 dhe 2 fletë midis fletëve 237 e 238. Midis fletëve 180 e 181 është shqyer 1 fletë.

Përmbajtja e kodikut: Kodiku përmban katër ungjiit pas Mateut, Markut, Lukës e Gjonit. Në fletët 2 deri 4 janë dhënë kanonet që tregojnë peikopetë, që lexohen gjatë gjithë vitit dhe festave sipas Eusebit dhe shënime rreth kanoneve. Fleta e parë e kanoneve është prerë dhe ka humbur. Në fletën 5 përfshihen kapitujt (kefalaia). Kapitujt nuk janë të plotë, sepse është shqyer një fletë në të cilën fillonin kapitujt. Në fletën 6 dhe 7 rektō përfshihet epistola e Eusebit dërguar Karpianit rreth 10 kanoneve. Në fletën 7 verso janë shkruar kapitujt e Ungjillit pas Mateut, gjithsej 21 kapituj. Në fletët 9 deri 72 përfshihet teksti i Ungjillit pas Mateut. Në fletët 73 e 74 përfshihen kapitujt dhe çështjet (hythothesis) të Ungjillit pas Markut. Në fletën 74 duhej të ishte miniatura me portretin e ungjillor Markut, por fleta fatkeqësisht është shqyer. Në fletën 75 fillon teksti i Ungjillit pas Markut, që vazhdon deri në fletën 113 rektō. Në fletët 113 verso deri 115 përfshihen kapitujt dhe çështjet e Ungjillit pas Lukës. Në fletën 116 verso është portreti i ungjillor Lukës duke shkruar Ungjillin. Teksti i Ungjillit pas Lukës vazhdon deri në fund të fletës 185. Në fletët 186 e 187 përfshihen kapitujt dhe çështjet e Ungjillit pas Gjonit. Në fletën 118 verso është portreti i Ungjillor Gjonit. Në fletët 189 deri në fletën 237 përfshihet teksti i Ungjillit pas Gjonit. Fleta e fundit nuk ka asnjë lidhje me kopjesin e këtij kodiku. Kjo përmban një pjesë nga Ungjilli pas Gjonit, që bën fjalë për episodin e faljes së Savrës.

Piktura e dekoret: Në tri fletët e para ruhen gjashtë kanone me ornamente prej skemash të ndryshme të pikturuara prej lulesh të stilizuara në të cilat mbizotëron më shumë ngjyra blu dhe vijat përkufizuese të tyre janë prej ari. Sipër tyre janë pikturuar nga dy pallonj, thëllëza dhe tre zogj të stilizuar, mbi çdo kanon nga dy shpendë. Kodi ruan figura e piktura të tre ungjillorëve: në fletën 8 ruhet figura e Ungjillor Mateut; në fletën 116 ruhet figura e Ungjillor Lukës, në fletën 188 ruhet figura e Ungjillor Gjonit, midis fletëve 74 e 75 duhej të ishte figura e Ungjillor Markut, por është shkëputur një fletë.

Këto figura, me gjithë dëmet që kanë pësuar, sidomos në portretet, paraqesin mjaft interes. Vlera e tyre artistike është e madhe, parë nga çdo aspekt; nga ana e kompozimit, ngjyrës, plastikës etj.

Kodiku ruan vinjeta të pikturuara me të njëjtat motive lulesh si tek kanonet. Këto gjenden në fletët: 6, 7, 9, 73, 74, 75, 113, 115, 117, 186 dhe në dy faqet e fletës 189.

Shënime bibliografike: Kopjuesi i kodikut nuk la asnjë shënim bibliografik, që hasim në kodikë të tjerë dhe që në përgjithësi bëjnë fjalë për autorin, për kohën kur u shkrua, për vendin ku u

shkrua, për financuesin, si edhe për zotëruesin, që mund të jetë institucion apo person i veçantë.

Anëshkrime: Ky kodik në anën e brendshme të kapakut dhe në fletën e parë ka gjithsej tre anëshkrime, të cilat po i paraqesim më poshtë:

Anëshkrimi i parë:

Në muajin mars në datën tetë tërmet i madh. U çanë kisha, ranë shtëpi, u hap toka. Kështjella e Tepelenit ra e gjitha dhe u vranë 300 shpirtra.

Anëshkrimi i dytë:

Në muajin mars në datën tetë tërmet i madh ra në mesnatë duke u gdhirë e djela, u çanë kisha dhe ranë shtëpia dhe kisha dhe kështjella shumë dhe toka u çu dhe në meshën e madhe të Evangjelizmoit ra kështjella e Tepelenit dhe u vranë 300 shpirtra.

Anëshkrimi i tretë:

Viti 1701 në muajin mars në datën 8 ra tërmet i madh në mesnatë duke u gdhira e djelë, pothuajse u çanë kisha dhe ranë shumë shtëpi dhe kisha dhe shumë kështjella ose fortesa dhe në shumë vende toka u hap dhe shpërthyen ujra dhe mbajti tërmeti i madh 17 ditë dhe në datën 25 në meshën e madhe të Evangjelizmoit ra tërmeti i madh dhe ra kështjella e Tepelenit dhe u vranë 300 njerëz vetëm atë natë të Evengjelizmoit dhe më pas pak nga pak pushoi.

Këto tre anëshkrime bëjnë fjalë për një ndodhi. Ato plotësojnë njëra-tjetrën. Shkronjat që bëjnë fjalë për vitin kur ra tërmeti janë shkruar keq dhe ishte shumë e vështirë për t'i deshifruar, megjithatë arrita të deshifroj vitin 1701. Kjo datë duhet kryqëzuar me njoftime të tjera për të qenë të sigurt.

Këto anëshkrime janë shkruar pa ndonjë bukurshkrim, me gabime ortografike dhe sintaksore çka tregon se janë shkruar nga një shqiptar që nuk e zotëronte mirë gjuhën greke.

Krahasimi i tekstit të këtij kodiku me botimin kritik të tekstit të Dhjatës së Re. Pas një krahasimi të pjesëshëm të tekstit ungjillor të këtij kodiku me tekstin e botimit kritik të Nestle-Aland rezultoi se kodiku për të cilin është fjala ka ndryshime të cilat konsistojnë në: 1. Ka fjalë që mungojnë në tekstin kritik; 2. Ka përdorimin e shpejtë të pikave gjë që çon në përdorimin e fjalëve të vogla, 3. Ka edhe ndonjë mungesë në drejtshkrim si hipogjegrameni, theksi etj. 4. Në shumë raste mungon përdorimi i -s- fundore. Krahasimi se çfarë ka më tepër dhe çfarë mungesa ka do të na nxjerrë në pah se me cilët kodikë ka ngjashmëri dhe me cilët jo, çka do të na ndihmojë edhe për përcaktimin e origjinës së tekstit të kopjuar. Ky krahasim do të plotësohet më mirë edhe me krahasimin e miniaturave, vinjetave dhe zbukurimeve të tjera“.

#### **Burime:**

1. Çarl Grimberg, Ragnar Svanström - "Histoire Universelle" vol.III
2. H.Daniel-Rops - "Histoire du Christianisme"
3. Taciti - "Analet", vol.III
4. Enciclopedia "Britanica"
5. Enciclopedia "Trecani"





## FJALORTH SHPJEGUES<sup>1</sup>

A.C.: Shkurtesë për “para Krishtit”. Nga lat. “ante Christum”.

A.D.: Shkurtesë për “Anno Domini”, viti i Zotit, në kuptimin “viti kalendarik pas Krishtit”, kryesisht në shkrimet e Kishës romane.

*Ad limina apostolorum*: Idiomë e latinishtes: Kufiri /afati normativ i raportimit apostolik/; afati i detyrueshëm prej tre vjetësh i raportimit me shkrim prej ipeshkvinjve katolikë për Selinë e Shenjtë. Ka qenë një herë në tre vjet; sot ky afat është (së paku) një herë në pesë vjet.

*Agjiografi-a*: Nga gr. “agios”, me kuptimin “i shenjtë”; dhe “grafios”, “shkrim”: një kategori dorëshkrimesh kishtarë që përmbajnë jetë shenjtore dhe vepra të tyre. Shkrime për jetën e shenjtoreve; shkenca për gjërat e shenjta.

*Akacian-e*: Skizma ~. Ndarja e parë në historinë e krishtërimin ndërmjet Kishës perëndimore (romane) dhe Kishës lindore (bizantine). Ndodhi për shkak të rivalitetit të Romës dhe Kostandinopojës për ndikim mbi ipeshkvitë. Skizma akaciane u takon viteve 484-519, kur papa Feliks i 3-të dhe pushteti perandorak i Romës së Lindjes hynë në konflikt për çështje të pushtetit administrativ kishtar. Në hapësirën ilirike gjatë skizmës akaciane mbajtën anën e papa Feliksit të 3-të ipeshkvinjtë e Prevalitanisë, të Epirus Vetus (Epiri i Vjetër), të Dardanisë. Ipeshkvia e Durrësit mbajti anën e Lindjes.

---

1. *Shqipja është një gjuhë që e ka prekur fjalorin biblik qysh prej kohës së krishtërimin të hershëm. Një varg emrash të përveçëm biblikë e ungjillorë; toponime historike të kësaj hapësire, emra të përgjithshëm të terminologjisë kishtarë, kanë, për këtë shkak, formën e tyre të shqipëruar. Kështu, është shkruar “Gjon” për “Joan”, sepse forma “Gjon” del si e tillë në trajtë të shkruar në faltoret e shqiptarëve qysh në shekullin e 7-të. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, kur emrat e përveçëm nuk kanë të bëjnë me figura biblike, por me personazhe historike, në kllapa është dhënë edhe forma e huazimit të mëvonshëm të të njëjtit emër biblik, kurse në disa raste të tjera është zbatuar parimi historik dhe është respektuar forma që ka përdorur vetë personaliteti, si: Jan Kukuzeli i Ri, Joasafi i Beratit etj.*

*Megjithatë, për të lehtësuar kuptimin e kësaj lënde relativisht të panjohur në botën shqiptare të letrave, është përgatitur një fjalorth shpjegues. Theksojmë se fjalori u referohet kuptimeve që kanë këto terma në studimet për kodikët. Në raste të veçanta, kur ka qenë e nevojshme të saktësohet një kuptim prej tjetrit, është dhënë edhe përmbajtja semantike e termit në përdorimin kishtar.*

*Shumica e termave të këtij fjalorthi burojnë nga greqishtja e mesme, me përdorim shumëshkullor në shkrimet dhe shërbesat kishtarë. Kuptimet e tyre në greqishte citohen sipas ligjërimit “katharevus”. Pjesa më e madhe e termave lidhen me tipologjinë e dorëshkrimeve kishtarë (ungjill, katërungjillësh, omilie, perikope ungjillore, psalm, martirologji, patrologji, tipikon). Një pjesë tjetër lidhet me paleografinë (scriptio continua, pnevma, uncialle, hrysografi, diptik, kodik). Një pjesë e tretë e termave që u ndje e nevojshme të shpjegohen lidhet me terminologjinë e shërbesës kishtarë, pa të cilën nuk do të mundësohej leximi tërësor i tekstit. Për plotësimin, saktësimin dhe redaktimin e këtij fjalorthi, që shpresoj se do të lehtësojë të kuptuarit e shkrimeve të këtij botimi, falënderoj përzemërisht zotin Grant van Cleve dhe z. Robert Walker (Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë), dom Nikë Ukgjinin dhe dr. Nevila Nikën, në mënyrë të veçantë znj. Lila Plasari, për ndihmën e tyre të çmuar dhe të pakursyer që më dhanë për përzgjedhjen e leksemave, plotësimin dhe saktësimin e tyre.*

*Akatist-e:* Himn ~; ceremoni ~. Një nga himnet më të rëndësishme që i kushtohen Shën Mërisë në ritualin Lindor (ortodoks), si dhe ceremonia gjatë së cilës këndohet ky himn.

*Alelujah!:* Fjalë e gjuhës hebraike. Urim që hebrejtë bënin për Perëndinë. Gjetet si fjalë e papërkthyer kryesisht në Dhjatën e Vjetër, por përdoret dy-tri herë edhe në Dhjatën e Re. Fjalë për fjalë do të thotë: “Lavdia i takon Atij”, domethënë Perëndisë. Pjesa e fundme e kësaj formule të ngurtësuar urimi (-jah) është shkurtësë e emrit hebraik të Perëndisë, që u përftua në greqishten e hershme e patransliteruar: tetragram-it (“jvh”).

*Alef:* Më shpesh “aleph”. Ndajshitesë identifikuese e një prej dorëshkrimeve ungjillore më të hershme në shkallë botërore. Në alfabetin hebraik përfaqëson një shenjtë të vetme, një grafemë, sikurse shkronja “פ” për Kodikun e Purpurt të Beratit. Është germa e parë e alfabetit hebraik, që vijon me: bet, gimel, dalet, he, vau, zain, het, tet, jod, kaf etj.. Alfabeti hebraik përdoret shpesh për renditjen kanonike të pjesëve të Biblës (për shembull, të psalmeve), ngjashmërisht me përdorimin e alfabetit të greqishtes së vjetër për renditjen e këngëve të poemave homerike, prej shkollës aleksandrine. Në greqishte të njëjtit rend të alef-it i përgjigjet germa “alfa” dhe në arabisht germa “elif”.

*Altar-i:* Forma më e vjetër në shqip: “Iter-i”. Term i trashëguar prej periudhës pagane. Vendi i flijimit. Në kuptimin kishtar: vendi ku meshtari shërben meshën dhe kryen sakramentet.

*Amin!:* Urim që përmyll një lutje (“Ati ynë”, “Ave Maria”, të gjitha lutjet). Në shqip thuhet “Ashtu qoftë!”. Në kodikun e Antonio Babit, dorëshkrim që ruhet në AQSH dhe që vlerësohet të jetë shkruar në vitin 1744, gjenden 19 mallkime shqip e italisht, të cilat në tekst shenjohen “të vitit 1704”, ku urimi “amen” përkthehet “ashtu kjoftë!”.

*Amshim-i:* I pafundmë, i pasosur, pa fillim e mbarim. Amshimi, në ligjërimin biblik, është atribut i Zotit, Atit. Jezu Krishti thotë: “Unë jam alfa dhe omega”, nisja dhe mbarimi. “Jeta e amshuar” është jeta në këtë botë, që vazhdon me jetën e premtuar në parajsë.

*Anëshkrim-i:* Quhen “anëshkrime” tekstet që gjenden në anësoret (“margina”) e dorëshkrimeve ungjillore. Anëshkrimet janë tekste që nuk u takojnë shkruarësve të kodikëve. Klerikë të lartë që i kanë pasur në përdorim ato, në raste ngjarjesh të jashtëzakonshme, kanë shkruar, më vonë, në boshllëkun e anësoreve, shkurtimisht njoftime për to (rasti i shpëtimit të ungjijve nga ushtria e car Uroshit, i një tërmeti të fuqishëm në Tepelenë në vitin 1701). Disa anëshkrime njoftojnë se ç’dorëshkrime ka kisha dhe kush është autori i tyre (rasti i Diptikut të Kishës së Shën Gjergjit, ku thuhet se “kjo shkronjë-e “Beratinus-1” - është pikërisht e dorës së Shën Gjon Gojartit).

*Antipatrea:* Emri antik i Beratit. Del si emërtim qendre urbane së paku katër shekuj para Krishtit. Por ka të ngjarë që, edhe emërtimi “Antipatridi” (“Polychronio Antipatridis”, peshkop pjesëmarrës në Concilli Calchoedonensimus, shekulli i 5-të), të jetë një formë tjetër, e vonshme dhe e greqizuar, e të njëjtit emër, paralelisht me “Pulheriopolis” / “Pulcheriopolis” (“Monumenta montenegrina”, I, Podgorica 2001, s. 91).

*Antologji-a:* Huazim prej dy fjalësh të greqishtes: “anthos” - lule dhe “logos” - fjalë, me kuptimin e figurshëm: kopshti i fjalës së zgjedhur, buqetë /tufë/ e fjalës së zgjedhur. Përmbledhje me pjesë të zgjedhura: kryesisht muzikore, por edhe prozodi, psalme, ligjërata etj.

*Apokrif-e:* Ungjill ~; shkrime ~. Nga gr. “apokruphos”, fj. për fj. me kuptimin “i fshehtë”. Apokrifi i një libri apo dorëshkrimi është paraqitja e shtrembëruar e këtyre, duke ruajtur emrin e autorit të parë. Term i përdorur për të dalluar shkrimet kanonike të Besëlidhjes së Vjetër dhe të Besëlidhjes së Re, prej atyre jokanonikë. Shën Jeronimi dorëshkrimet apokrife të Besëlidhjes së Vjetër i ka përcaktuar si libra “deuterokanonike” / “dhefterokanonikë”, fj. për fj. “dytësorë në krahasim me shkrimet e kanonizuara”. Në Besëlidhjen e Re, apokrifë janë, ndër të tjerë, Ungjilli sipas Judës dhe Ungjilli sipas Thomajt / Tomës, të cilët nuk janë pranuar nga teologjia kishtare si pjesë të saj. Ka edhe letra apokrife, që nuk përfshihen në “Dhjatën e Re”. Ungjijtë dhe shkrimet apokrife i takojnë periudhës së krishtëritimit të hershëm, fazës së kalimit prej fjalës së shenjtë në shkrimin e shenjtë. Kanë vlerë historike për studime bibliologjike dhe tekstologjike (“textual criticism”).

*Apostull-i:* Njëri prej 12 nxënësve të Krishtit. Ata që e morën lajmin e gëzueshëm të ungjillit drejtpërsëdrejti nga goja e Jezu Krishtit. Krishtërim apostolik është krishtërimi i predikuar drejtpërsëdrejti prej 12 apostujve. Apostolimi është koha e kryesimit të Kishës së parë të Shën Pjetrit prej një Pape të shuguruar.

*Apsid/ë-a:* Term që përdoret në përshkrimin arkitekturor të kishës. ~ përfaqëson një pjesë gjysmëharkore, së brendshmi dhe së jashtmi, të ndërtesës së kishës, që rregullisht gjendet në murin lindor të saj. Në disa raste, në kisha të thjeshta, ~ ndërtohet jo në formën e gjysmëharkut, por në formën e faqeve që lakohen pak nga pak, duke formuar një gjysmëhark të përafërt. Në raste të tilla nuk mund të jenë më pak se tri faqe.

*Aramen-i:* Kryesisht në shumës: “aramenët, populli i Aramit”, djalit të Semit, që mbahet si babai i aramenëve dhe kaldenjve: Mbretëria e Aramenisë apo e Sirisë u themelua prej Aramit. Vend në lindje të lumit Jordan, që i përgjigjet Palestinës së sotme. Pasardhësit e Aramit jetuan në rajonin e grykëderdhjes së lumit Tigër dhe të Eufratit. Armenia është Palestina e vjetër dhe gjuha e aramenëve është gjuha e palestineve të vjetër. Jezui foli dhe predikoi në gjuhën aramene. Shumë shkrime biblike dhe ungjillore në burim janë në këtë gjuhë. Alfabeti i shkrimeve në gjuhën aramene e ka burimin prej shkrimit të fenikasve, nga burojnë shumica e alfabeve të atij rajoni. Për shkak të rolit mjaft të rëndësishëm politik dhe tregtar të shteteve të vogla aramene, gjuha e tyre pati një rol imperial, që figurativisht mund të krahasohet me rolin e anglishtes në kohët moderne. Gjuha e aramenëve, e cila rreth viteve 500 para Krishtit flitej që nga Egjipti e Azia e Vogël deri në Indi, për shumë kohë është vlerësuar si gjuhë botërore.

*Arianiz/ëm-i:* Një prej zhvillimeve më të hershme të heretizmit. Doktrinë e priftit Arius, që jetoi në Aleksandri në vitet 256-336. Heretik i famshëm, themelues i sektit të arianizmit. Arianizmi kundërshtonte bashkimin në trini të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Në mënyrë të veçantë ardhjen e njëjtë dhe barazinë e Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në trini, për rrjedhojë edhe të qenët Perëndi të Jezu Krishtit. Pikëpamja e arianizmit ishte se Ati është Zot i vetëm dhe qëndron më lart se Biri, i cili është bërë Zot përmes hyjnizimit të njeriut vetë. Koncili i Nikesë (viti 325 pas Krishtit) dhe më pas edhe ai i Kostandinopojës (381) e dënoi arianizmin si herezi. Arianizmi nuk ka lidhje me burimin arian (indoeuropian) të shumicës së popujve të Europës dhe as me të kuptuarit të arianizmit si epërsi racore (shek. i 20-të).

*Arketip-i:* Nga gr. “arheios” dhe “typos” - model parak, tip i vjetër. Model, shembulli i parë, forma më e hershme dhe më e besueshme si burimore, origjinale, për një tekst. Arketipi është gjedhja primitive mbi të cilën është mbështetur hartimi i një vepre, lëndore ose mendore. Në filologji “arketip” përdoret në kuptimin “model ideal, lehtësisht i kuptueshëm, mbi të cilin

mbështeten apo rikrijohen veprat”. Sipas Platonit, “arketipi i të gjitha gjërave reale është ideja e së mirës”. “Arketip” është, gjithashtu, term i studimeve të tekstologjisë kritike për shkrimet ungjillore. Njihen tre-katër arketipe themelore të Dhjatës së Re. Arketipe quhen tekstet ungjillore që pranohen si më të afërtat me burimin e ungjijve. “Beratinus-1” konsiderohet një prej arketipeve më të vjetra dhe më origjinale të tekstit të Dhjatës së Re, sepse ndërthur ngjyresa të shkollës aleksandrine / siro-palestineze / Lindore / të shkrimeve të shenjta, me ato të shkollës Perëndimore (“western”). Kopjuesit e dorëshkrimeve ungjillore, para se të fillonin nga puna, duhej të siguronin tekstin arketip. Gjetja e arketipit përbënte një prej vështirësive më të mëdha. Sipas K. Naços, vazhdimësia e shkrimeve ungjillore në Shqipëri provon ekzistencën e arketipeve në këtë hapësirë.

*Arkimandrit-i:* Kreu i një manastiri bizantin. Shkallë hierarkie e lartë në murgjëri, një shkallë më e lartë se ajo e igumenit.

*Arkipeshkv-i:* Kleriku që udhëheq një provincë/ krahinë kishtarë, të përbërë nga disa ipeshkvi, i ndihmuar nga ndihmësit dhe këshilltarët (sufroganët).

*Arkiv-i:* Nga gr. “arhaios”, me kuptimin “i vjetër”. Institucioni që merret me diplomatikën, pasurinë dokumentare; me mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe shërbimin e dokumenteve. Vetë pasuria dokumentare e një familjeje, zyre, subjekti, vendi a shteti. Arkivat më të hershëm u takojnë faltoreve të krishtera, të cilat kishin “bibliotekat e dorëshkrimeve”. Një prej arkivave më të pasur me dorëshkrime të hershme është ai i Mitropolisë së Beratit. Sipas një dëshmie të Batiffol-it, në kohën kur ai vizitoi Beratin (1886), kishte mësuar se në Gjirokastër ruhej një dorëshkrim ungjillor i shekullit të parë dhe një tjetër i shekullit të katërt. Origeni, një prej mbledhësve më të hershëm të dorëshkrimeve ungjillore, gjeti në Nikopojë (Arta e sotme) një ungjill të shekullit të parë. Në fillimet e mijëvjeçarit të dytë zhvillohet tradita e arkivave të familjeve patronimike (bujaria arbërore). Në këto familje, krahas nëpunësisë dhe funksionarëve të tjerë, gjendet edhe kancelari, sekretari (“gr. “gramatikoi”), logotheti (mbajtësi i korrespondencës). Funksionet e kancelarit pranë Gjergj Kastriotit i kryente arkipeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli. Në Europë shërbimi arkivor nisi të shndërrohej në një veprimtari institucionale duke filluar prej fundit të shekullit të 17-të dhe fillimit të shekullit të 18-të.

*Asket-i:* Besimtar i devotshëm i krishtërimin, që, në emër të jetës së amshuar, heq dorë nga të mirat e jetës tokësore. Asketët, ose “ashkëtinjtë”, siç del në një shqipe më të hershme, rrojnë larg botës, i kushtohen botës së mendimeve, shpesh zgjedhin për të jetuar shpella shkëmbore ose manastire. Për asketët jeta në këtë botë nuk ka kuptim të jetohet. Përmes besimit në ringjalljen dhe në amshimin asketët shprehin besimin në ungjillin e Krishtit.

*Atë:* Titull, emërtim i një ipeshkvi të Kishës romane. Pop, papas.

*Autokrator:* Epinom i perandorëve të mëdhenj të Bizantit, krahas: caesar, sempre august. Perandori Justinian ishte “autokrator, caesar augustous, në emër të Zotit Jezus Krisht, Atit tonë”.

*Bazilik/ë-a:* Kishë e periudhës së fillimeve të krishtërimin të ligjshëm (shek. i 4-t e vijim). Rrënja e kësaj fjale vjen nga greqishtja “*basileus*”, me kuptimin “basile”, “mbret”. Në shekujt e parë të erës së re bazilika quheshin gjykatores e perandorisë. Kur perandori Konstandin vendosi të shpallë krishtërimin fe zyrtare të shtetit të vet, për të mundësuar ngritjen e faltoreve të krishtera, dhuroi shumë ndërtesa perandorake, ndër të cilat edhe bazilika (gjykatore), për t’i kthyer në kisha. Arkitektura e bazilikave të perandorisë ndikoi për disa shekuj edhe në arkitekturën e kishave të reja që u ngritën pas shpalljes së krishtërimin si fe e ligjshme.

*Bekim/e-t*: Në përdorimin kishtar rregullisht del vetëm në shumës: tetë bekimet. Sipas Biblës, bekimi është atribut i Zotit. Por, në një kuptim më të ngushtë, po në ligjërimin biblik, bekon edhe njeriu. Ku Zoti bekon, përmes bekimit të tij tregohet dashuria dhe besimi tij në njeriun. “Zoti e bekoji njeriun pas krijimit” (Gjen. 1, 28). Njeriu i përshpirtshëm bekon Zotin. Në këtë kuptim, bekimi i Perëndisë prej njeriut do të thotë se e adhuron dhe e lavdëron atë. Në Besëlidhjen e Re thuhet se Zoti e ka dërguar Krishtin për ta bekuar njerëzimin. Meshtari (prifti), duke u lutur, ndan bekimet e Zotit, Jezu Krishtit, gjatë dhe jashtë liturgjije. Kryefamiljari ndan bekimet (urimet) e veta në familje etj.

*Beratinus-i*: Emri më i hershëm dhe më i përdorshëm për Kodikun e Purpurt të Beratit. Shenjohet shpesh “Beratinus-1” për ta dalluar nga Kodiku i Artë i Anthimit, që njihet me formën e shkurtuar “Beratinus-2”. Kodikët e tjerë të Beratit (afro 70) nuk mbiqehen “beratinus”.

*Bib/ël-la*: Nga gr. “bibliou”, libër me kuptimin e plotë të fjalës, libër “par excellence”, libri i librave. Bibla është përmbledhje e shkrimeve të shenjta të krishtera, që ndahen në dy pjesë: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re. Për këto përdoren disa sinonime: Ligji, Dhjata, Testamenti, Diodati. Bibla ka shkrime: kozmogonike, mitologjike, teologjike, historike, poetike e letrare.

*Blat/ë-a*: Buka e meshës; blatë, mblatë; buka e kungimit sipas ritualit të Kishës lindore. Shenjëzon trupin e Krishtit, kurse vera në të cilën ngjyhet shenjëzon gjakun e Krishtit. Përmes kungimit shprehet bashkimi ritual në Krishtin. Ka edhe përdorim të pavarur në ligjërim laik. Blatë-blatim është të kushtuarit e një dhurate të madhe një hyjnie apo një çështjeje. Agamemnoni ia blaton të bijën mbarësisë së fushatës së luftës së grekëve kundër trojanëve. Vëllezërit mjeshtra në baladat shqiptare të murimit ia blatojnë nusen e re themelive të urës, për mbarësinë e ndërtimit. Më herët del në forma relativisht arkaike: “ëmblatë”, “amblatë”, si duket me përdorim eufemik. Blatë quhet edhe pajisja që përdor amvisa për të zbukuruar bukën e meshës: zakonisht me shenjë kryqi, me figura tripjesëshe, por herë-herë edhe me figura të botës laike (shqiponjë etj.).

*Br.:* Shkurtesë për idiomën “Kodik i Beratit” (jo vetëm për Beratinus-1 dhe 2, por për çdo kodik me prejardhje nga Berati).

*Brev/ë-a*: Letër, zakonisht e shkurtër, e Papës, shkruar mbi pergamenë dhe, si rregull, e certifikuar me vulë plumbi.

*Buzm-i*: 1. Festë pagane në nderim të kultit të zjarrit. 2. Nderim i paraprindërve sipas doktrinës së krishterë (Adami dhe Eva); 3. Ritual i nderimit të Krishtlindjes; 4. Një dru i stolitur dhe i ushqyer sipas traditës pagane, si një qenie e gjallë, që duhet të digjet pa u shuar gjatë gjithë natës së Krishtlindjes. Në traditën pagane është thënë se Buzmi është një kujtim i festave dionisiake.

*Christotokos*: Një prej epinomeve të Shën Mërisë, Hyjlindësja, Nëna e Krishtit (shih edhe “Theotokos”). U përdor deri në periudhën e herezisë nestoriane (shek. i 5-të). Më pas u ruajt dhe mbeti si term i fjalorit historik kishtar.

*Conflate reading*: Idiomë e përdorur në studimet e hershme bibliologjike për të veçuar disa shprehje ungjillore që ruhen në dorëshkrime të paranjësuar. Fj. për fj. “shkrirje e dy a më shumë varianteve / metateksteve / në një të vetëm”. Është përdorur nga Batiffol edhe për “Beratinus-1” - raste të leximeve fragmentare jokanonike, me shkrirje të dy a më shumë ngjyresave. Në “Beratinus-1” ka fragmente të tilla kalimtare pikërisht kur ndërthuren shprehje

karakteristike të shkollës siro-palestineze të shkrimeve të shenjta me ato të shkollës Perëndimore. Kjo e bën “Beratinus-1” shumë të rëndësishëm për studime tekstologjike kritike (“textual criticism”).

*Cpolitana*: Shkurtesë për “Constantinopolitana”. Pjesë e një idiome ku përdoret edhe ky term: “acta ~”, “epistola ~” - akte të Kostandinopojës, letra të Kostandinopojës.

*Deisis-i*: Një kompozim me motive biblike dhe ungujlore, në artin e miniaturës (por edhe në ikonografi, në periudhën e mëvonshme), në të cilin gjenden bashkë figura e Shën Mërisë dhe figura e Shën Gjon Pagëzorit. Nëse ky kompozim përmban edhe figurat e profetëve dhe të shenjtorëve, ky quhet “deisis i madh”. Ndonjëherë transliterohet edhe në formën “deesis”.

*Dekalog-u*: Përmbledhja që përmban “Dhjetë Porositë”, apo “Dhjetë Urdhërimet”, që përbën thelbin e Besëlidhjes së Perëndisë (JHVH) me “popullin e zgjedhur”, hebrejtë. Dekalogu është pjesë e Besëlidhjes së Vjetër. Sipas Biblës, Dekalogu iu rrëfye Moisiut nga Perëndia në kohën kur populli i Izraelit kishte qëndruar rrëzë malit të Sinait. Nganjëherë quhen edhe “Dhjetë Ndalimet” apo “Dhjetë Tabutë”, sepse porositë, si rregull, urdhërojnë ndalime: mos adhuro tjetër Zot, mos e merr në gojë emrin e Zotit, mos vra, mos shkel kurorën, mos vidh, mos dëshmo të pavërteta, mos lakmo gjënë e tjetrit, mos uro të keqen e tjetrit. Porosi pohuese janë vetëm dy: kremto të dielën dhe të kremtet e vitit dhe ndero prindin.

*“Dekreti i së dielës”*: Dekreti i famshëm i perandorit Konstandin, urdhëruar në vitin 321 të e. s., sipas të cilit e diela sanksionohet si ditë pushimi dhe festë zyrtare e perandorisë, sikurse është në besimin e krishterë. Ky dekret konsiderohet si fillimi i kthimit të krishtërimin në fe zyrtare (Edwin Jasques, “Shqiptarët”, 1995, f. 160 e botimit shqip).

*Deuteronomi*: Nga greqishtja. Fj. për fj.: “Ligji i dytë”. Shih: “Ligji i përtërirë, kuptimi 2.

*Devocional/e-t*: Sendet me të cilat besimtarët ftohen në fe dhe përshpirtje: kryqi, medalioni, epitafi, figurat.

*Diadoh-u*: Nga gr. “diadoch”, me kuptimin “pasues”. Deri në periudhën e reformave të Justinianit diadohu ishte drejtor i një shkolle me drejtim neoplatonian. Në këto shkolla merreshin edhe njohuri mbi krishtërimin. Si rregull, Platoni konsiderohej nxënës i Moisiut ose anasjelltas, dhe nën emrin e ideve të Platonit mësoheshin në shkolla Dhjata e Vjetër dhe ungujtitë. Në vitin 529, me mbylljen e Akademisë së Athinës, përfundon edhe epoka e këtyre shkollave dhe përgjithësisht epoka e shkollave pagane. Me reformat e Justinianit shkollimi u vu nën kontroll të rreptë dhe latinishtja e humbi statusin si gjuhë e detyrueshme për t’u mësuar nga nxënësit.

*Dioqez/ë-a*: Provincë, si njësi e administrimit kishtar. Ipeshkvi, peshkopatë, eparki. Në periudhën e krishtërimin të hershëm provinca ishin, ndër të tjera,,: Epiri i Vjetër (Epirus Vetus), Epiri i Ri (Epirus Nova), Praevalitania.

*Diplomatik/ë-a*: Nga gr. “dhiplomata”, dëshmi. Shkenca që merret me dokumentet, dokumentalistika, arkivistika. Një nga korpuset më të rëndësishme të diplomatikës iliro-shqiptare është “Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia”, “Dokumente dhe dëshmi të ilustruara për Shqipërinë deri në Mesjetë”, përgatitur nga Thalloczy, Jireçek dhe Sufflay.

*Diptik-u*: Nga gr. “diptykhos”, i palosur në dysh, dyfletësh. Në lashtësi diptik quhej një regjistër

publik i përbërë nga dy tabela. Më pas mori kuptimin e një vepre arti të përbërë prej dy panelesh, të fiksuara ose të lëvizshme. Secila pjesë e diptikut përbën një vepër arti më vete. Kjo është e vlefshme të thuhet edhe për triptikun. Në Mesjetë ka kuptimin e një ikone që paloset më dysh dhe u paraqitet besimtarëve në raste të kremtesh të veçanta. I mirënjohur është “Diptiku i Kishës së Shën Gjergjit” në Berat, ku gjendet shënimi për beratasin Skouripekis dhe zonjën konteshë, që, së bashku me murgun Theodulo, shpëtuan 27 kodikë nga më të vjetrit prej sulmit të ushtrive të car Uroshit (1356); studiuesit mendojnë se kjo është informata e parë për ekzistencën e “Beratinus-1” në këtë qytet. Në letërsinë shkencore Perëndimore transliterohet në formën “Diptyh”. Për ikonat apo shkrimet e palosura në tresh përdoret termi “triptik”, i cili ka hyrë edhe në fjalorët e letërsisë. Triptiku, si rregull, përmban tre motive nga jeta e Jezuit, prej lajmërimit të Shën Mërisë nga kryeengjëlli Gabriel për lindjen e afërme të Mesisë, deri tek ringjallja. Është i mirënjohur, për shembull, “Diptiku i Wiltonit” / “Dyflëtëshi i Wiltonit”, viti 1395, në të cilin paraqitet Rikardi i 2-të, për të cilin Shën Gjon Pagëzori, Shën Eduard Rrëfyesi (Konfessori) dhe Shën Edmundi i luten Krishtit ta pranojë dhe bekojë. Në një rën fletë paraqiten tre shenjtët dhe Rikardi i 2-të, kurse në tjetrën Shën Mëria me Krishtin fëmijë. Në krye lart duket flamuri i kryqëzatave, me fushë të bardhë dhe kryq të kuq. Dy nga shenjtoret, Rrëfyesi dhe Edmundi, janë mbrojtës të familjes mbretërore (për më gjerë, tekst dhe ilustrime, shih: E. Gombrich, “Historia e artit botëror”, Tiranë 1996, f. 215-216).

*Dorëshkrim-i:* Term i arkivistikës. I përgjigjet greqishtes “autograf” dhe termit ndërkombëtar “manuscript”. Përdoret për të treguar një akt të shkruar, që ka karakterin e një vepre të plotë, që nuk është shkruar për t’u botuar. Është përdorur, nga disa studiues (Ilo Mitkë Qafëzezi) edhe forma “shkresëdorë”, kalk prej “autograf”, por jo i qëndrueshëm gjuhësisht.

*Dypapat-i:* Periudhë historike kritike në jetën e Kishës katolike. Për shkak të mosnjohjes së autoritetit papnor të atit të shenjtë papa Urbani VI, i cili apostoloi në vitet 1378-1389; u shpall papë, me qendër në Avinjon, me përkrahjen e francezëve anzhuinë, Klementi VII, i cili apostoloi paralelisht në vitet 1343-1382. Një pjesë e familjeve fisnike shqiptare, duke përfshirë Topiajt, njohën autoritet papnor Klementin VII, i cili herë-herë quhet edhe “pseudopapë”. Dypapati parapriu lëvizjet e mëdha që ndodhën në jetën e kishës me shpërthimin e Reformës.

*Dhjak-u:* Dhjakon, gjakoni, në Kishën romane. Shërbëtor në një kishë, shkalla më e ulët e hierarkisë kishtarë. Shugurimi i një dhjaku nga ipeshkvi quhet “dhjakonat” / “gjakonat”.

*Dhjata e Re:* Libër i shkrimeve të shenjta të krishtërimin, pjesa e dytë e Biblës. Dhjata e Re përmban shkrimet mbi jetën dhe veprat e Jezu Krishtit, si dhe mësimet e kishës së parë. Dhjata e Re përmban 27 libra. Përfshin katër ungjijtë: sipas Mateut, sipas Markut, sipas Lukës dhe sipas Gjonit, si dhe “Punët e Apostujve”, letrat dhe Zbulesën. Në shkrimet ungjillore të Kishës romane Dhjata e Re përfshin edhe “Apokalipsin”. Shkrimet burimore të Dhjatës së Re janë në greqisht. Librat kanonikë të Dhjatës së Re dhe renditja e tyre është vendosur e konsoliduar në shekullin e 4-t. Sinonime të këtij emërtimi janë: Testamenti i Ri, Besëlidhja e Re, Ligji i Ri etj. Në teologjinë hinduse Dhjatës së Re i përgjigjet “Bagavad Gita” ose shkurt “libri i Gita-s”, që është pjesë e epit të Mahabharata-s, sido që nuk janë të njëjtë. Analogjikisht, Dhjatës së Vjetër në teologjinë hinduse i përgjigjet pjesa e parë e të njëjtit ep, Upanishadat, ose Vedat vedanta (Eliade). Gjithë Bibla u përkthye në latinisht në shekullin e 4-t nga Shën Jeronimi (Hieronymus), i njohur ndër shqiptarët edhe si Shën Gjëri. Ky ishte përkthimi i vetëm i njohur zyrtarisht nga Kisha romane deri në kohën e Reformës (shekulli i 16-të). Njihet me emrin “Vulgata”.

*Dhjata e Vjetër:* Libër i shkrimeve të shenjta të krishtërimin dhe të hebrenjve, pjesa e parë e Biblës. Përmban shkrimet e shenjta të epokës para ardhjes së ungjillit të Jezu Krishtit. Përmban gjithsej 39 libra, që në ligjërimin biblik konsiderohen “të frymëzuar nga Zoti”. Përmbledhje e mitologjisë hebreje dhe e ndikimeve të kulturave të afërta me të. Eposi heroik legjendar i hebrenjve dhe libër besimi i tyre. Dhjata e Vjetër në përgjithësi është shkruar në hebraisht. Në shkencën e letërsisë trajtohet si mitologji dhe epike e popullit hebre dhe krahasohet me “Iliadën” dhe “Odisenë” e grekëve, “Gilgameshin” e shumerëve dhe “Qadesh-in” e egjiptianëve të vjetër. Dhjata e Vjetër ka tri përmbledhje librash: Pentateuku-n - pesëlibërshin; profetët dhe shenjtoret. Ndër të tjera, më në hollësi, përmban librin e Zanafillës (Gjeneza), të Daljes (Ekzodus), librin e numrave, librat e kronikave, librin e psalmeve (të Davidit), librin e fjalëve të urta, “cantica canticorum” (kënga e këngëve), librat e profecive, librat e Makabenjve e të tjerë. Sipas Dhjatës së Vjetër, Ligja e Vjetër ishte privilegj i “popullit të zgjedhur të Perëndisë”, hebrenjve, kurse Dhjata e Re është dhuratë e Perëndisë për të gjithë popujt që besojnë në Ringjalljen. Dhjata e Vjetër përmban edhe shkrime me karakter historik, etnologjik, të dhëna për jetën e judejve dhe zakone të jetës së tyre.

*Dhoksologji-a:* Në ligjërimin biblik: “shpallja e lavdisë së Zotit për njerëzimin; lutje Zotit përpara fillimit të një pune shumë të rëndësishme. Shprehja e plotë e besimit në Zotin. Në ritualin Lindor dhoksologjia është mesha më e rëndësishme prej të gjitha meshëve të vitit. Meshë që celebrrohet vetëm prej jerarkëve të lartë (mitropolitë e të tjerë). Në letrën e Palit Romakëve (16: 25-27) pjesa përmblyllëse quhet “dhoksologji” dhe nëntitullohet “Lavdi Zotit!": “Atij që mund t’ju forcojë/ Sipas Ungjillit tim dhe predikimit të Jezu Krishtit / sipas zbulësës së misterit / mbajtur fshehur për kohë të amshuara / por tani shfaqur - dhe me anë /të shkrimeve të profetëve / me urdhër të hyjit të amshuar / iu lajmërua mbarë popujve paganë / për t’i bindur në besimin e fesë - / një të vetmi Hyj, të gjithëditurit / i qoftë, nëpër Jezu Krishtin lavdi / në agim të shekujve, amen”.

*Dhuratë-a:* Term i letërsisë kishtarë. Zakonisht përdoret në shumës: dhuratat. Tek autorët e vjetër dhe tek arbëreshët: “dhurëtiljetë”. Të tilla janë shtatë dhe mbiquhen “dhurata të shpirtit të shenjtë”: urtësia, mençuria (inteligjenca), këshilla, forca, dija (shkenca), mëshira dhe frika e Perëndisë (“dhurëtiljë e dresë së Tinëzot”, Matranga).

*Ekumenik-e:* E përgjithshme, universale, përbashkuese, që ka të bëjë me gjithë botën e krishterë. koncil ~; vendime ~; hapësirë ~: këshilla, vendime dhe hapësira me karakter njësuës. Përdoret edhe termi: “katekumenik”, kompozitë prej gr. “kathos” - “botë” dhe “ekumenik” - përbashkues. Term me të njëjtin kuptim, por me semantikë të përfortuar.

*Ek-fonetik-e:* Periudha ~ e muzikës bizantine; periudha më e hershme e kësaj muzike, me alfabet specifik. Një prej reformatorëve të këtij alfabeti ishte Jan Kukuzeli. Parashtesa “ek” ka karakter përfortues. Stil tjetër i kësaj polifonie është ajo “dodekafonike”.

*Ekleziastik:* Me këtë fjalë, prej së cilës rezultoi më vonë termi “kishë” dhe “kishtar”, shprehën në greqishte përkthyesit e Septuangita-s kuptimin e fjalës hebraike “kohelet”, që do të thotë “bashkim”, “mbledhje”, “lidhje”. (“Bibla”, përkthim i dom Simon Filipajt, Ferizaj 1994, f. 864). Libri i kishtarit, që bën pjesë në Dhjatën e Vjetër, ka kuptimin e librit të “atij që bashkon”.

*Ekzark-u:* Nga gr. “exarcus”. Titull i themeluar nga perandori Justinian, në shenjë vullneti për të ndihmuar organizimin e jetës së kishës me fuqitë e pushtetit laik. Në periudhën e Justinianit ekzarku ishte ndihmës i patriarkut të Kostandinopojës, të cilit i takonte detyra e organizimit të kishës, e nderimit të patriarkut prej zyrave shtetërore perandorake.



*Ekzarkat-i:* Në periudhën e sundimit të perandorit Mauric, Bizanti vuri nën kontroll thuajse në tërësi Illyricum-in dhe një pjesë të Italic-ut. Me zgjerimin e autoritetit të perandorisë dhe të kishës perandori Mauric ndërmori edhe riorganizimin e kishës. Në këtë periudhë për herë të parë shfaqet “ekzarkati” (“exarchatus”), që do të thotë njësi / provincë, në krye të së cilës gjendet ekzarku, në figurën e të cilit bashkohen pushtete laike, fetare dhe ushtarake.

*Eleous/ë-a:* Epinom i njohur i Shën Mërisë në traditën e dorëshkrimeve ungjillore dhe të miniaturës. Quhet ~ një miniaturë ku Shën Mëria paraqitet bashkë me Krishtin fëmijë, që e përkëdhel Shën Mërinë si nënë. Studiuesit e ikonografisë i japin këtij veprimi kuptimin e mëshirës (Drishti).

*Engjëll-i:* Figurë e rëndësishme e botës biblike. Krijesa të Perëndisë për të mbrojtur njeriun prej rreziqeve dhe “së ligashit”. Në fillim, sipas ligjërimit biblik, kishte vetëm “engjëj të mirë”, por, më vonë, një pjesë e tyre nuk iu bindën vullnetit hyjnor dhe Perëndia i dërgoi në ferr. Dita e engjëjve mbrojtës, sipas ritualit roman, festohet më 2 tetor.

*Epanagog/ë-a:* Hyrje, kreu hyrës në një traktat të periudhës së Vasilit të 1-rë, shkruar për veprën “Bazilika”. Për herë të parë në një vepër të shkruar eparku i Kostandinopojës cilësohet “figura e tretë” e protokollit perandorak.

*Epark-u:* Nga gr. “eparchos”, term kuptimisht i barasvlershëm me idiomën latine “praefectus urbi”, gjyqtar i qytetit. Në vitin 359 Konstanci i 2-të u shpall “epark i Romës së vjetër”. Titulli i eparkut ishte një prej më të rëndësishmëve të perandorisë. Ishte figura e parë, me një status të veçantë, për organizimin e shtetit perandorak. Pushteti i eparkut përshkruhej kështu: “Gjithë shoqëria, të gjithë qytetarët, tërë populli, nuk kanë asnjë pushtet mbi eparkun e qytetit”. Eparku i Kostandinopojës gjithnjë është quajtur “glorissimus”. Por në shekullin e dhjetë, me riorganizimin e protokollit perandorak, eparku zbriti në rangun e 18-të. Nga gjysma e dytë e shekullit të 12-të eparku ishte thjesht një “sevast”.

*Epifani-a:* Në lashtësi ishte festë që përkujtonte vizitën e mbretërve. Në Dhjatën e Vjetër epifania është shfaqje e plotfuqishmërisë së Zotit: “Tashmë Helidori ishte aty, te vishtari, kur zotëruesi i shpirtërave, i gjithpushtetshmi /Zoti/, bëri një dukje të jashtëzakonshme, kështu që të gjithë ata që guxuan të hyjnë, të tmerruar nga fuqia e Hyjit, u ra të fikët dhe i mbuloi tmerr” (“Bibla”, 1994, f. 1353, përkthim i dom Simon Filipit). Episodi që përshkruhet më sipër ndodh në Jeruzalem, kur heroi Helidor ndëshkohet nga Epifania, shfaqur në formën e një kalorësi të tmerrshëm, që sjell triumfin dhe dëshmon fuqinë hyjnore. Më pas kjo fjalë ka marrë kuptime që lidhen me të njëjtin thelb, por duke u lidhur me kalendarin e të kremteve të të krishterëve. Në krishtërimin Lindor është festë e bekimit të ujit dhe dritave, që kremtohet në mënyrë panegjirike më 6 janar. Në ligjërimit biblik është ardhja e dijetarëve për të vërtetuar dhe adhuruar Jezuin. Në krye të herës ka pasur kuptimin: “shpallja (shfaqja, dëftimi) e Zotit nëpërmjet Jezu Krishtit”. Kjo lidhet me një kuptim më të hershëm, prejfoljor, të kësaj fjale, që shprehimisht do të thotë: ai (i lavdishmi) që del si një monument nga dheu (për shkak të meritave të tij). Ngjashmërisht del nga uji me kryqin e gjetur fituesi i garës në ditën e Shën Vasilit (tek ortodoksët). Befana në ritualin Perëndimor. Në shqipen liturgjike të ritualit roman thuhet “festa e dëftimit” apo e “të dëfyerit”.

*Epitaf-i:* Vizatim në copë pëlhure të fortë, zakonisht me qendrisje në filigran, i imazheve dhe përfytyrimeve për kryqëzimin dhe ringjalljen e Krishtit. Ruhet nga meshtari në kishë dhe nxirret në procesion publik një herë në vit, ditën e Pashkës. Epitafi më i rëndësishëm i botës shqiptare është ai i Gllavenicës, i cili i takon shekullit të 13-të.

*Epitili:* Nga greqishtja. Sinonim i termit “vinjetë” (shih).

*Eremit-i:* Nga gr. “eremos”, me kuptimin “zbrazëti”. Urdhër murgjerie që shprehet në vetëveçimin e besimtarit të devotshëm, që i është kushtuar këtij urdhëri, prej gjithë botës njerëzore, me qëllim meditimin e thellë dhe lartësimin hyjnor. Eremitët kanë jetuar në mjedise të pabanuara natyrore dhe me ushqime rastësore, kryesisht në shpella.

*Eukaristik-e:* Pjesa ~ e meshës. Nga greqishtja. Pjesa falënderuese e meshës. Kjo pjesë përmban një formulë kushtimi Perëndisë për të pranuar e bekuar bukën dhe verën që do të përdoret për kungimin e besimtarëve. Eukaristia u themelua nga vetë Jezu Krishti, natën e “ultima cena-s”. Krishti u ndau bukën dhe verën apostujve duke u thënë: trupi dhe gjaku im janë aty; buka dhe vera janë dëshmitarët e Dhjatës së Re. Në Bibël, në ligjërimin e Jezuit, thuhet shprehimisht: “Unë jam hardhia”.

*Evangelistra:* Përdoret edhe në formën “Evangelista”: Ungjillizimi. Kisha e ungjillizimit.

☞ : Ndajshesë për “Kodikun e Purpurt të Beratit”, sinonim i tij. Kodikët më të rëndësishëm në shkallë botërore kanë një ndajshesë të tillë alfabetike, për dallim prej kodikëve të tjerë, të cilët në katalogë kanë vetëm një numër. Kodiku me ndajshesën e parë është Aleph. Codice Vaticana ka ndajshesën N. Kodiku “Sinopensis” i Parisit ka ndajshesën O.

*Faksimil/e-ja:* Nga lat. “fac simile”, fj. për fj. me kuptimin “bëje të ngjashme”. Faksimile është një tekst që riprodhohet në përbërje të një botimi në formë analogjike me origjinalin. Riprodhim fototipik i një dokumenti me vlerë ilustruese.

*Fanar-i:* Vendndodhja e Patriarkanës së Stambollit, selia e patriarkut. Prej këndeje edhe “fanariot”, përhapës i ideologjisë dhe doktrinës së Fanarit.

*Famulli-a:* Është juridiksioni i një kishe, hapësira banuese mbi të cilën ajo ka përsipër kujdesin shpirtëror të besimtarëve. Bashkësia e besimtarëve të një kishe; rajoni mbi të cilin ka autoritet (hije, tagër) një kishë. Famullia, megjithëse njësi më e vogël, mund të ketë selinë amë dhe degëzimet. Nga i njëjti burim është edhe fjala “familje”.

*Famullitar-i:* Prifti që drejton njësinë më të vogël të kishës, famullinë, në emër të ipeshkvit.

*Filipianët:* Banorët e Filipit (Philippi), qytet në Maqedoninë e vjetër. Dijetarët e vendosin në afërsi të Kavalla-s së sotme. U drejtohet Shën Pali me letrat e tij apostolike: “Paul addressed his letter to the Christians who resided in Philippi and to their bishops and deacons (1:1). At the time he wrote, Philippi was already an ancient and historic city. It was built and fortified in 358-357 BC. by Philip II of Macedon (the father of Alexander the Great) and named after himself. The site Philip chose for his new fortification was the old Thracian city of Crenides (or Daton) in northeast Greece (Macedonia). It was located about eight miles from the sea in a very fertile region that was enriched by an abundance of springs and by the gold that was mined there (Straboni, Shmidt). Philippi became world-prominent, however, as the place where the battle between Brutus and Cassius, the assassins of Julius Caesar, and Antony and Octavian took place in 42 BC. Antony and Octavian emerged as the victors. When Octavian later defeated Antony at Actium (31 BC) and took to himself the title of Augustus, he rebuilt Philippi, established a military outpost there, filled it with Roman soldiers, veterans of his wars and Antony’s partisans evicted from Italy, made it a colony (Iulia Augusta Philippensis) - Schmidt, 2233-2234. Thus when Paul made his first visit to Europe he purposely neglected

the port city of Neapolis to begin preaching the gospel in the small but more important city of Philippi of the first district of Macedonia (Acts 16:12). Për identifikimin e vendit të Filipianëve mund të këshillohen: Nestle-Aland, "Novum Testamentum Graece", 26<sup>th</sup> ed., si dhe: Metzger.: "A Textual Commentary on the Greek New Testament", New York, United Bible Societies, 1971, p. 444-446; Zuntz, G.: "Textual Criticism of Some Passages of the Acts of the Apostles", in "Classica et Mediaevalia" 3-1940, 36-37. "The story of Paul's arrival in Philippi and the beginning of the Church there is told in dramatic fashion by Luke to underscore heavily the significance of the transition of the gospel mission from Asia Minor to Europe" - Conzelmann, "Primitive Christianity", p. 96). Për identifikimin historik të qytetit Filip (Philippi) që përmendet në Letrat e Apostujve, që ndonjëherë është lidhur edhe me qytetin Plovdiv të Bullgarisë së sotme (emri i hershëm i tij është Philipopolis) shih: Henle, F. A.: "Philippi und die Philippergemeinde" (1893); Lemerle, P.: "Philippe et la Macédonie orientale à l'époque chrétienne et byzantine", Paris 1945; Picard, C.: "Les dieux de la colonie de Philippes vers le I<sup>er</sup> siècle de notre ère, d'après les ex voto rupestres", 1922; Schmidt, J.: "Philippoi", 1938.

*Fjala*: Shih "Logos". Në Ungjillin sipas Gjonit teksti fillon me vargjet: "Në fillim qe Fjala / e Fjala ishte në Hyjin / e Fjala ishte Hyji" ("Bibla", përkthim i dom Simon Filipajt, Ferizaj 1994, f. 1505).. Poeti i madh gjerman Goethe provoi të ndryshonte sloganin biblik, duke bërë bindje të personazhit të vet në "Fausti" sloganin "Në fillim qe veprimi".

*Fjetja e Shën Mërisë*: Emër kisha në Berat. "Fjetja" - në kuptim eufemik.

*Flori dhe Lauri*: Martirë të krishtërimin në periudhën e hershme. Ishin vëllezër binjakë dhe jetonin në Kostandinopojë. Pas martirizimit të mësuesve të tyre, Prokul e Maksim, erdhën në Dardani. U vunë në shërbim të sundimtarëve dardanë, të cilët, duke i njohur si mjeshtra të ndërtimit, kërkuan prej tyre ngritjen e një faltoreje. Në fund të punës Flori dhe Lauri ia kushtuan faltoren që ndërtuan Jezui Krishtit dhe e kthyen në kishë. Jetuan në gjysmën e parë të shekullit të 2-të deri në dekadat e para të shekullit të 5-të. "Në asnjë burim mesjetar nuk bëhet fjalë për ugjillizim të shqiptarëve. (Kjo do të thotë se) ky krishtërim ishte bërë në kohë më të hershme" (K. Jireček). Herë-herë quhen edhe "Floriani e Laurini".

*Fr.*: Shkurtesë për idiomën "kodik i Fierit".

*Franceskan-i*: Urdhër i kishës katolike, themeluar në vitin 1208 nga Shën Francesku i Asizit, në të cilin bëjnë pjesë: observantët, konventualistët, kapuçinët. Priftërinjtë e këtij urdhëri quhen fretër dhe vishen me veladon ngjyrë kafe, me kapelë në anën e pasme. Frat është emër popullor për priftin franceskan, për dallim nga klerikët e tjerë të të njëjtit rang të kishës katolike, të cilët thirren: "dom", "don", nga lat. "dominus", zot, zotëri. Forma më e hershme e këtij huazimi ka lënë gjurmë në toponomastikë (Domën, Domaj, Dome, emra fshatrash).

*Frytet biblike*: Në ligjërimin biblik "frytet e zgjedhura" janë ulliri (për vajin shërimtar, me të cilin lidhet një prej emrave eufemikë të Krishtit-Shëlbuesit), rrushi (për verën, që bashkon besimtarët në Krishtin gjatë meshës) dhe fiku (për ëmbëlsinë, por edhe për faktin se, bashkë me ullirin dhe rrushin, nuk pranoi të bëhet mbret mbi bimët - këtë e pranoi manaferra). Përshkruhen si „fryte të shenjtëruara“ në „Dhjatën e Vjetër“, pjesa „Ngritja e Izraelit“, në formën e një rrëfenjeje që Joatami ua thotë krerëve të popullit të Izraelit për të gjykuar nëse kanë ditur ta zgjedhin mirë mbretin e tyre. Kulti i ullirit është, megjithatë, më i hershëm se krishtërimi. Në „Dhjatën e re“ fiku u mallkua nga Jezui sepse nuk i dha fryt në ditën që qe i uritur.

*Gardian-i*: Mbikëqyrësi i një manastiri franceskan.

*Golgotha*: Emër vendi në hapësirën historike hebreje. Fj. për fj. do të thotë “vendi i kafkës” (nga hebr.). Është vendi ku judejtë kryqëzuan Krishtin, me pëlqimin e “praetorium-it” romak, të kryesuar prej Pons Pilatit, i cili, megjithatë, e shpalli të pafajshëm për “lex romanae”. Judejtë kërkuan që Jezui të ndëshkohej sipas ligjeve të Perandorisë Romake, sepse sipas ligjeve të veta nuk ishte i lejuar dënimi me vdekje. Kalvari.

*Gr.*: Shkurtesë për “greqisht”. Herë-herë kjo shkurtesë përkthehet në formën “greke”: dorëshkrim në gjuhën greke, ungjill i shkruar në greqisht. Në klasifikimin botëror të shkrimeve të shenjta përdoret paralelisht me kuptim sinonimik “shkrimet bizantine”, por jo për “Septuaginta-n” (shih).

*Grafi-a*: Stil të shkruari me germa dore. Përdoret për të përcaktuar veçoritë dhe individualitetin e shkrimeve ungjillore: grafi e hershme, grafi e mesme, grafi e vonët. Grafi germëmadhe, grafi germëvogël, grafi e imët me shkronja dore, grafi me shkronja kapitale (të ngjashme me shkronjat e shtypit).

*Grafem/ë-a*: Shenjë, njësia më e vogël e grafisë, shkronjë dore e një grafie. Përdoret zakonisht për të veçuar shenjat e veçanta alfabetike të shkrimeve të vjetra.

*Gramatia*: Huazim nga greqishtja: sekretari, kancelari, shkruesi.

*Gj.*: Shkurtesë për idiomën “kodik i Gjirokastrës”.

*Gjerondik-e*: Tekste ~. Herë-herë shkruhet “gerondike”. Nga greqishtja, me kuptim të fjalëpërfjaltë “urtësore”. Shkrime të urta, kryesisht nga mençuria e etërve të kishës.

*Hebre-u*: Etnonim i izraelitëve. Në kuptimin biblik: popull i zotit, i zgjedhur prej Perëndisë. Pasardhësit e Abrahamit, historia e të cilit tregohet në Bibël. Të vendosur në Kanau në mijëvjeçarin e 2-të para Krishtit, ata u ngulitën më pas në Egjiptin e sotëm, ku gjetën begati. Të shndërruar gati në skllëvër prej vendësve, duke pasur si prijës Moisiun dhe më pas Xhoshuenë, ata u shpërngulën dhe u vendosën në Palestinë, ku themeluan një mbretëri, të mbështetur në qeverisjen e gjykatësve. Më pas kjo u nda në dy pjesë: në mbretërinë e izraelitëve dhe në atë të judejve. Kjo ndodhi në vitin 931 para Krishtit. Hebrejtë provuan pushtimin e asirëve, pastaj të babilonasve dhe më pas të selusidëve. Rifituan lirinë për fare pak kohë në shekullin e 2-të para Krishtit dhe më pas u pushtuan nga romakët (viti 63 para Krishtit). Në vitin 1948, për herë të parë pas dy mijë vjetësh, hebrejtë krijuan shtetin e tyre, me pëlqimin e fuqive fitimtare të luftës antifashiste, si një ngushëllim për judeofobinë dhe holokaustin, një prej krimeve më të mëdha të historisë së njerëzimit.

*Hiton-i*: Nga gr. “chiton”, tunikë prej liri, e thjeshtë, që vishej prej grekëve të lashtë. Fjalë që del në ligjërimin e Jezu Krishtit. Më pas mori kuptimin e veshjes karakteristike të klerikëve dhe gjykatësve: togë, pelerinë, mantel, tunikë. Ka përdorim edhe në jetën laike: hitoni i priftit / hitoni priftëror; por dhe “hitoni i gjykatësit” etj. Në ligjërimin e Jezusit, shprehja e përkthyer shqip “atij që do të të çojë në gjyq për të të marrë këmishën, jepja edhe tunikën” - në gegërishten kishtarë “mallotën” (Mateu: 5: 40), nënkupton një veshje të zakonshme të besimtarit.

*Hrysobul/ë-a*: Nga gr. “chrysobulle”. Dokument i rëndësisë parësore në zyrat perandorake bizantine. Hrysobula është akt (letër, dëshmi) i certifikuar me vulë të artë dhe i nënshkruar me dorën e vetë perandorit (autograf).

*Hrysografi-a*: Nga greqishtja, me kuptimin e drejtpërdrejtë “shkrim i artë”, dorëshkrim prej ari, por edhe shkrim i qendisur me ar: ungjij krysografikë, ikonë krysografike. Në dorëshkrimet e AQSH-së, “Beratinus-2”, i njohur edhe me emrin “Kodiku i Artë i Anthimit”, është një katërungjillësh tipik krysografik. Në shumë dorëshkrime të tjera, duke përfshirë edhe “Beratinus-1”, ka elemente të krysografisë. Një pjesë e tyre kanë prej ari nistoret dhe titujt e krerëve; një pjesë tjetër kanë arte të zbatuara kishtare (miniatura, vinjeta) me sfonde prej ari ose me punim prej ari. Sipas K. Naços, në Fondin 488 ka të paktën 10 dorëshkrime krysografike dhe rreth 35 të tjerë ku ka prani të krysografisë.

*Hypothesis*: Nga gr. “hypothesis”, hipotezë. Këtu ka kuptimin “çështjet”. Bashkërenditet me “kefalalaia”. Pjesë e ungjillit që paralajmëron krerët dhe çështjet.

*Hypogjergamen-i*: Term i paleografisë, lloj theksi karakteristik i greqishtes së drejtshkruar.

*IC XC*: Shkurtesë e emrit të Jezu Krishtit. Gjendet në miniatura, por edhe në shkrime ungjillore, duke përfshirë “Beratinus-1”.

*Ikonoklasti-a*: Nga gr. “eikon” - imazh i shenjtë, dhe “klazein”, të thyesh. Lufta me ikonat. Konflikti i gjatë i kishës me idhujtarinë (idoltarinë) pagane në mesjetën e hershme. Konflikti buronte nga qëndrimi i ndryshëm ndaj ikonave. Tek besimtarët vazhdonte të ekzistonte dëshira për t’i shembëlyer hyjnitë, si në epokën antike, kurse kisha ishte kundër shenjtërimit të perëndive pagane në ikona. Në shqip kjo fjalë-rrënjë (ikonë) ka hyrë në periudhën e paleokrishtërimin, që i përgjigjet periudhës ilire, prandaj del edhe në formën e rotacizuar “korë”. Ikonoklastia ka lënë gjurmë edhe në toponomastikë. Në Turqinë e sotme gjendet qyteti Konya, që fillimisht quhej Ikonya - qytet i ikonave. Lufta kundër ikonave në krishtërim mori karakter të ashpër në shekullin e 7-të dhe mbaroi në shekullin e 9-të. Ikonografia kishtare, megjithatë, njohu përhapje në Kishën lindore vetëm nga shekulli i 12-të. Në Kishën romane, në vend të saj, u zhvillua afresku dhe piktura murale (në periudhën e Reformës dhe të protestanizmit). Deri në mesjetën e vonët ekzistonte një sekt heretik që e luftonte kultin e imazheve të shenjta, duke e konsideruar hyjnoren të papërshtueshme dhe të papërfytyrueshme (taboo). Nga ky sekt ikona konsiderohej shprehje paganizmi dhe adhurimi për hyjnitë mitologjike. Diskutimi për ikonën vazhdon edhe sot, brenda dhe jashtë krishtërimin. Në besimin hindu, edhe në kohët moderne, shtrohet çështja se “ndërsa ne nuk kemi zgjidhur ende çështjen se cilës (prej disa milionë) perëndi t’i besojmë, në Perëndim diskutojnë se a duhet të besojmë dhe si duhet të besojmë”.

*Imation-i*: Veshje e brendshme priftërore e periudhës së Mesjetës. Del në miniatura.

*Index librorum prohibitorum*: Nga lat. “regjistri i librave të ndaluar”. Ky regjistër, i cili mbahej nga autoritetet papnore, përmbante rreth 20 mijë tituj librash dhe dorëshkrimesh, të cilat, duke qenë heretike, jokanonike ose në mospajtim me doktrinën, ndalohej të lexoheshin nga besimtarët.

*Inscription-s*: Shkrime në reliev në gur. Shkrime në formë kushtimi për faltore të rëndësishme të krishtërimin (në portikë, në fasada). Mbishkrime me gdhendje. Një i tillë gjendej në kishën e manastirit të Shën Gjon Vladimirit. “Anno ab incarnatione Dni nostri Jesu Christi MCCLXXXI indictione V regnate in Albania serenissimo Principe Domino Karulo Topia primo de domo Francia anno domini eius XXII una cum Illustrissimo suo filio primogenito Dno Georgio hanc ecclesiam fecit”. Teodor Ippen, “Shqipëria e vjetër”, Tiranë 2002, f. 224.

*Ipeshkv-i:* Titulli më i lartë i rendit priftëror. Ipeshkvi emërohet prej Papës, mbi bazën e të dhënave të relatuara nga kisha vendëse.

*Inter omnigenas calamitates:* Idiomë prej latinishtes, zakonisht e papërkthyeshme. Bulë papnore për rajonet ballkanike (Shqipëri, Serbi, Maqedoni), në lidhje me qëndrimin ndaj laramanëve.

*In quarto:* Term i përfutur prej latinisht, si rregull në trajtë të papërkthyer. Shpreh formatin e një dorëshkrimi. "In quarto" janë dorëshkrimet me format shkrimi një të katërtën e fletës së zakonshme që është përdorur në një periudhë historike. Në dorëshkrimet ungjillore të Shqipërisë Batiffol ka përcatuar dy të tillë, me format "in quarto".

*Jeromonak-u:* Nga gr. "iero" - "i shenjtë" dhe "monak" - "murg". Fj. për fj. murg i shuguruar meshtar, i dorëzuar prift.

*Jezuit-ët:* Zakonisht vetëm shumës. Urdhër kishtar katolik i themeluar në vitin 1540 nga Shën Injaci (Ignatio).

*Joasafi i Beratit:* Personalitet i kishës dhe kulturës shqiptare në shekullin e 18-të. I njohur për kulturën e tij të gjerë për historinë e krishtërit dhe të shkrimeve të shenjta. Ka lënë shënime në disa dorëshkrime ungjillore. Njihet si personalitet i kishës dhe i kulturës edhe Joasafi i Bubullimës.

*Kaligrafi-a:* Stil mjeshtëror të shkruari me germa dore, stil bukurshkrimor të shkruari. Arti i të formuarit bukur të karaktereve (shkronjave) të dorës. Përdoret për rastet kur vetë shkrimi është një art i zbatuar dhe karakterizohet nga vlera të veçanta estetike. Sido që përkon në formë të kalkuar (gr. "kalos"-bukur dhe "grafion"-shkrim), nuk është e njëjta me bukurshkrimin, term në pedagogji. Kaligrafia në shkrimet e shenjta ka individualitetin e shkruarit. Arti i kaligrafisë ka një traditë të spikatur në hapësirën historike shqiptare. Një qendër bukurshkrimi ka qenë qyteti i Beratit, ku në Mesjetë kishte të paktën gjashtë shkolla bukurshkrimi. Një qendër tjetër e mjeshtërisë së shkrimit të dorës ishte Durrësi, ku pranë katedrales "vazhdimisht vërtitëshin kopjuesit e dorëshkrimeve". Sipas një historiani raguzian të Mesjetës, Lukari, të cituar nga Noli, edhe fermani me të cilin Gjergj Kastrioti mori në dorë Krujën ishte i kopjuar prej shkruarve vendës, që njihnin mirë edhe shkrim e lartë aristokratik osman.

*Kalvar-i:* Emër vendi në hapësirën historike të hebrenjve. Një kodër në afërsi të Jeruzalemit. Vendi ku u gozhdua Krishti. Është rruga që duhet të përshkojë Jezu Krishti me kryqin e vet mbi supe, i sharë dhe i goditur prej priftërinjve, mosbesues se me të vërtetë ishte prurësi i kumtit të Dhjatës së Re, ungjillit. Ky udhëtim u bë me tre kryqe / të kryqëzuar dhe me katërmëdhjetë ndalesa. Golgota. Ka marrë kuptimin e figurshëm të një mundimi të jashtëzakonshëm.

*Kanon-i:* Nga gr. "kanon", me kuptimin "ligj", "dekret", "rregull", "kanun". Rregull, nom, ligj në përgjithësi. Rregull i përgjithshëm që lidhet me besimin ose disiplinën fetare. Përmbledhje e librave të konsideruar si të frymëzuar nga zoti, frymë e providencës. Lutje dhe ceremoni të meshës pas hyrjes, deri në komunikim. Në terminologjinë e kritikës tekstuale të shkrimeve biblike përdoret për të identifikuar tipologjikisht një grup dorëshkrimesh që përmbajnë rregullore për zgjidhjen e çështjeve laike në përputhje me doktrinën e krishterë. Këto rregullore merrnin miratimin e sinodeve apo koncileve të peshkopëve / ipeshkvinjve. Disa kanone, të përgatitur prej protagonistëve të mëdhenj të kishës, kanë mbijetuar për shekuj me radhë. Paraqesin

interes kulturor për studime krahasuese, veçanërisht për raportet e së drejtës kishtare me atë laike etnozakonore.

*Kanon-i:* ~ e Eusebit (të famshëm të Cesaresë). Ky jetoi midis viteve 265-340 të erës së re. Konsiderohet babai i historisë së krishtërimin, autor i së parës sprovë për një histori të Kishës. Nga i njëjti burim, si në kuptimin 1. Tabela sinoptike që lehtësojnë përdorimin kalendarik të ungjijve. Këto tabela tregojnë se ç'pjesë e ungjillit lexohet në të kremtet, sipas radhës kalendarike. Ato tregojnë gjithashtu bashkëpërkimet e lëndës së dy, tre apo katër ungjijve. Janë të famshme kanonet e Eusebit, që njihen me këtë emër sipas atij që i hartoi për herë të parë. Kanonet e Eusebit janë gjithsej dhjetë. Ato janë shkruar në shekullin e 4-t. Kodikët e Shqipërisë përmbajnë kanone të Eusebit. Kanonet janë formë e hershme e artit të zbatuar kishtar. Pasqyrat apo tabelat sinoptike të tyre, në të cilat me anë të shkurtesave prej dy-tri shkronjave tregohen perikopetë e ungjijve që lexohen për çdo ditë të vitit, përmbajnë edhe zbukurime të larmishme dhe me vlerë estetike.

*Kapel/ë-a:* Një kishëzë e vogël, zakonisht në përbërje të një ndërtese, që kryen edhe funksione të tjera, të një pallati, rezidence. Kapela mund të jetë dhe një kishëzë e vogël brenda një kishe të madhe.

*Kapelan-i:* Ndhimësi i ipeshkvit, vikari.

*Kardinal-i:* Klerikë të urdhërit më të lartë. Emërohen nga Papa, janë këshilltarë të tij dhe kanë të drejtë të zgjedhin Papën.

*Katekiz/ëm-mi:* Nga gr. "kathekehis", me kuptimin e drejtpërdrejtë: udhëzime gojore, në formën e pyetje-përgjigjeve, për mësimet fetare në përgjithësi. Libër instruktiv, me karakter bashkëbisedues, në ndihmë të meshtarëve, për të arritur edukimin fetar të besimtarëve. Katekizmi, si rregull, ndërtohet në formën e dialogut ndërmjet meshtarit dhe besimtarit (rishtarit), mësuesit dhe nxënësit (mjeshtrit dhe nxënësit). Përmes dialogëve shtrohen pyetjet më të rëndësishme të të kuptuarit të krishtërimin dhe të të ushtruarit të ritualit të krishterë, si dhe jepen përgjigjet dogmatike, që përjashtojnë dyshimin në krishtërim.

*Katërungjillësh-i:* Dorëshkrim që përmban katër ungjijtë, sipas renditjes kanonike: sipas Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit. Në përdorimin kishtar: "tetravangjel". U preferua ky kalk, që do të thotë "katër në një", për shkak se, sipas pikëpamjes kishtare, nuk ka katër ungjij, por një ungjill të vetëm të Jezu Krishtit, në paraqitje të katërfishtë (dom Simon Filipaj).

*Katërzërësh-i:* Sistem i vjetër, bizantin, i shkrimit të kompozimeve polifonike liturgjike; tetrafonia. Në këtë sistem përdorej një alfabet muzikor i ndryshëm nga ai që themeloi Bah-u, që ka në bazën e vet pentagramin (pesëvijëshin). Murgu Guido D'Arezo kompozoi për herë të parë në shekullin e 10-të një himn për Shën Gjon Pagëzorin dhe u bë shpikësi i shtatënotëshit, të shprehura nëpërmjet disa shenjave të veçanta për çdo notë. Shenjat e tij tregojnë tingullin vetë dhe kohëzgjatjen e tij. Kukuzeli përshtati një alfabet prej tetë notash. Pjesa më e madhe e antologjive muzikore që përmbajnë kodikët e Shqipërisë janë shkruar me sistemin katërzërësh.

*Katolik-e:* Kisha ~. Kisha romane. Nga gr. "kathos", botë. Kishë e përbotshme.

*Katharevus-a:* Një prej dy ligjërimeve kryesore të greqishtes së vonët, greqishtja konservative e liturgjisë, e kishës përgjithësisht, por, deri vonë, edhe e shkencës.

*Kefalaia*: Transliterim i së njëjtës fjalë me burim nga greqishtja: “kefalalaia”, me kuptimin “krye”. Krerët e ungjijve.

*Kemtar-i*: Një kupë e vogël metalike, zakonisht e veshur me argjend, që mbahet prej një zinxhiri të zbukuruar dhe që shërben për të mbajtur prushin e për të shpërndarë timjanin në shërbesat e kultit. Në terminologjinë e kishës ortodokse quhet edhe “timiaton”, nga i njëjti burim si dhe “timjan”.

*Kënga e këngëve* (Cantica canticorum): Pjesë e Dhjatës së Vjetër, një prej librave të saj. Ka kuptimin “më e bukura këngë” dhe përmban kultin e martesës, të dashurisë dhe të kurorës. Përkthim strukturor nga “shir hashshirim” - me të njëjtin kuptim si më sipër, nga hebraishtja. Mendohet se autor i këtij libri është Salomoni (“Bibla”, përkthim i dom Simon Filipajt, Ferizaj 1994, f. 876).

*Kinonika*: Nga greqishtja. Veprimtari që ka karakter publik. Muzikë kinoniko - muzikë për publikun, muzikë e thjeshtë, e kuptueshme, popullore.

*Kish/ë-a*: Vjen nga gr. “ecclesia”, dhe kjo prej hebr. “kohelet”, që do të thotë “vendi i bashkimit”. Kisha është shtëpia e lutjes, vendi i predikimit të fjalës së Zotit, institucioni ku bashkohen besimtarët vëllezër në Krishtin. Në një kuptim më të gjerë kisha është shenjë e tërë bashkësisë së krishterë.

*Kisha e Madhe*: Si emërtim i përveçëm gjithnjë ka kuptimin e Kishës së Shën Sofisë. Në një kuptim tjetër do të thotë: “kisha katedrale”.

*Kisha lindore*: Kisha ortodokse, Kisha bizantine. Shpesh përdoret edhe “kisha jonë”.

*Kisha e parë*: Kisha e themeluar nga Jezu Krishti. “Ti je Pjetri, që do të thotë “gur”, dhe prej teje kam për të ndërtuar kishën time, që nuk do të mund ta mposhtin as dyert e ferrit”, citohet në shkrimet kishtarë Jezu Krishti në bisedë me apostullin e vet Pjetrin. Shën Pjetri quhet themeluesi /kryetari/ i Kishës së krishterë. Froni i Shën Pjetrit trashëgohet nga Papa / Patrikët. Herë-herë krishtërimi apostolik njihet edhe me termin “kisha e hershme” (“Bibla e ilustruar për të rinj”, Ferizaj 1987, f. 471).

*Kisha romane*: Kisha katolike, krishtërimi Perëndimor. Kishës romane i përket edhe Kisha unite (bizantine-katolike), si kisha e arbëreshëve të Italisë, e cila varet nga Kongregacioni i Kishave orientale në Romë. Ndarja përfundimtare e kishave në ortodokse dhe katolike, apo, siç thuhet, “skizma e madhe / shizma e madhe”, ndodhi në vitin 1054. Familjet patronimike shqiptare u luhatën për disa shekuj me radhë midis njërës dhe tjetrës qendër kishtarë. Balshajt pranuan fillimisht ortodoksinë, por më pas e mohuan me shkrim dhe betim skizmën. Topiajt, megjithëse mbetën të krishterë të ritualit roman, në periudhën e krizës së Selisë së Shenjtë, ose, siç quhet ndryshe, periudha e dy-papatit, njohën si autoritet qendror të katolicizmit papën e Avinjonit.

*Ko.*: Shkurtesë për idiomën “kodik i Korçës”.

*Kodik-u*: Nga lat. “codex”. Në greqisht: “kodikos”, në kuptimin e parë një përmbledhje dispozitash apo rregullash legjislativë. Në këtë botim përdoret në kuptimin e ngushtë: dorëshkrim, si rregull, i një veprë të plotë, me përmbajtje biblike, ungjillore, liturgjike, agjiografike, martirologjike, patrologjike; përgjithësisht teologjike-kishtarë. Në një kuptim më të gjerë kodik



do të thotë dorëshkrim, si rregull në formën e një vepre të plotë, që përmban trajtesa filozofike-morale laike në frymën e shkrimeve të shenjta. Term ende i pangulitur mirë. Përdoren paralelisht format: “kodik”, “kod”, “kodeks”, madje edhe “kondik”. Kodik është edhe “Meshari i Gjon Buzukut”. Kodik është gjithashtu dorëshkrimi i Pal Engjëllit, në të cilin gjendet formula e pagëzimit. Sipas disa dijetarëve, janë ruajtur rreth 6000 kodikë me vepra unguilllore dhe biblike (dom Simon Filipaj), që meritojnë vëmendje në pikëpamje të tekstologjisë kritike. Por hartuesit e katalogëve më të mëdhenj të këtyre dorëshkrimeve (Aland) identifikojnë afërsisht 2300 kodikë të tillë, në tre grupe.

*Kodikografi-a:* Dija që merret me përshkrimin e kodikëve. Me përshkrim kodikografik kuptohet: a. Paraqitja e jashtme e dorëshkrimit; b. Të dhëna të përgjithshme (përmasat, numri i fletëve, numri i kolonave dhe i rreshtave për kolonë; c. Lloji i lëndës së përdorur (papyrus, pergamenë, letër); d. Karakteristika të shkrimit (germëmadh, germëvogël); e. Tipologjia e përmbajtjes së dorëshkrimit (biblike, unguilllore, patrologji, agjiografi, martirologji, teologji, liturgji, antologji muzikore, oktoih, omilie, orolog, minej, sinops, filozofi, filologji); f. Shënime rreth autorit / kopjuesit; ktitorit / porositësit; pronarit, dhuruesit, përkushtuesit; g. Anëshkrimet, kronika historike që përmbajnë; h. Shenjat (shigjeta, gishti tregues, klepsidra, shenja të zodiakut); i. Zbukurimet (bukurshkrimi, kryeshkronjat, portretet e unguillorëve dhe ilustrime të tjera, miniaturat, vinjetat, kanonet / tabelat e Eusebit, zbukurimet e kapakëve); j. Gjendja e dorëshkrimit, dëmtimet e mundshme, si mund të shërohen këto dëme; k. Koha kur u shkrua kodiku (datim relativ dhe absolut, kur është e mundshme); l. Prejardhja, vendi ku është krijuar ose është ruajtur. Kodikografia dallohet nga kodikologjia për faktin se kjo e fundit studion vlerën e dorëshkrimit në kuadër të tekstologjisë kritike (interesim i historisë së evolucionit të mendimit të krishterë).

*Kongregat/ë-a:* Një departament parësor në administratën kishtarë të Selisë së Shenjtë, që ndihmon Papën për drejtimin e kishës katolike. Kongregacion.

*Kolegji Ilirik:* Institucion kishtar i formimit të klerikëve. Gjithashtu konvikti i nxënësve të kësaj shkolle që formon priftërinj. Kolegji Ilirik ka funksionuar në Loreto, Fermo dhe Monte Gargano. Ky kolegji ka përgatitur edhe priftërinj shqiptarë. Nën kujdesin e Vick Zmajevic-it kolegji ilirik në shekullin e 18-të u hap në Zarë. Një kolegji ilirik është njohur me emrin e Shën Adrianos.

*Koncil-i:* Këshill, sinod, kuvend. Një prej koncileve më të rëndësishme të jetës së kishës katolike është ai i Trentit, në të cilin u përcaktuan masat e rimëkëmbjes së kishës pas tërmetit të Reformës. Koncili i Trentit përcaktoi masat e domosdoshme për reformimin e kishës dhe mbrojtjen e imazhit të saj përmes këtyre masave, që njihen me emrin “Kundërreforma”. Një prej koncileve më të rëndësishme për jetën e kishës në Shqipëri është ai i Mërçisë, i njohur me emrin “Kuvendi i Arbni”, i mbajtur nën drejtimin e Vick / Vincenc Zmajevic-it dhe me bekimin e Papës Klementi i 12-të.

*Koptik-e:* (“kœptiche”). Kisha ~: Kisha e egjiptianëve të vjetër. Në shkrimet tekstologjike shpesh quhet ~ edhe Kisha armene.

*Krezmim-i:* Një prej mistereve / sakramenteve / të krishtërimit. Nga lat. “quaessima”, huazuar, me sa duket, në një periudhë të hershme të shqipes, ndoshta prej periudhës parashqipe. Në ligjërimin biblik krezmimi është themeluar nga Jezu Krishti vetë dhe përfaqëson një ritual që kryhet nga meshtari, i cili, duke i vënë dorën në ballë besimtarit, lutet për të dhe i shenjon kryqin, “duke i dhuruar me këtë shpirtin e shenjtë” (Heffler etj.).

*Kreshm/ë-a:* Agjërim i të krishterëve, ndalim i të gjitha ushqimeve me burim botën e gjallë dhe kufizim i një pjese të atyre bimore. Një formë e të shprehut të asketizmit. Kreshma mbahet, si rregull, para Pashkëve. Është shprehje dedikimi, përvujtnie dhe barazie.

*Kriptë-a:* Vend i fshehtë. Kishë e vogël apo kapelë nëntokësore, kryesisht e periudhës së paleokrishtërit, por të tilla u shfaqën edhe në kohën e kontakteve të para të botës shqiptare me Perandorinë Osmane.

*Kriptografi-a:* Nga greqishtja: “shkrim i fshehtë”. Fragmente kalimtare në shkrimet ungjillore ose në dorëshkrime të tjera, që nuk mund të kuptohen me lexim të drejtpërdrejtë (duhen çkyçur, dekodifikuar).

*Kristoithi-a:* Nga greqishtja, me kuptimin fj. për fj. “zakone të arta”, moral i artë, i shkëlqyer. Libër që përmban përshkrime virtytesh, në kuptimin e doktrinës së krishterë. Një prej dorëshkrimeve të rralla të ruajtura në AQSH, që përmban “kristoithi”, është përkthimi i një teksti origjinal prej latinishtes në greqisht në shekullin e 18-të!

*Krisht-i:* Forma e kalkuar në greqisht e emrit hebraik “Messiah”. Kuptimi i drejtpërdrejtë i kësaj fjale është “i vajosuri”, ai që është vajosur, ai që është pagëzuar, ose, më saktë, i ungjillizuari. Në Dhjatën e Vjetër, qysh prej Moisiut, vajosja kishte kuptimin e mbushjes me Frymën e Shenjtë. Mbiquajtja e Krishtit me këtë atribut rrjedh pikërisht prej këtij kuptimi. Në përdorimin teologjik Krishti është Shpëtimtari. Krishti u kryqëzua kur ishte në moshën 33 vjeç, në vitin 4-6 pas erës së re. Për këtë arsye shumë mendojnë se ai lindi disa vite më vonë se viti 33 (i erës së vjetër).

*Krishtlindje-t:* Në shqipen tradicionale “Kërshëndellat”. Dita e lindjes së Krishtit, afërsisht 29-27 vjet para fillimit të epokës së re. Festa më e gëzueshme e të krishterëve. Ndryshe prej festës së Pashkëve (rilindja), lindja e Krishtit festohet në të njëjtën ditë nga të gjitha kishat. Mori emrin Jezu (hbr. “Xhoshua”) të tetën ditë pas lindjes.

*Kryeshkronj/ë-a:* Term i shqipëruar i paleografisë, me kuptim sinonimik me idiomën “iniciales / nistore kapitale” (shih).

*Ktitor-i:* Huazim nga greqishtja. Ka kuptimin: dhuruesi i pasurisë për një vepër kishtare, porositësi i një dorëshkrimi apo veprë arti kishtar, për nevojat e kishës apo të manastirit. Ktitorë të një shumice dorëshkrimesh kanë qenë fisnikët shqiptarë të periudhës arbërore, duke qenë këto dorëshkrime mjaft të kushtueshme, disa herë vepra të vërteta luksi. Sipas një hipoteze, ktitor i Beratinus-1 ka qenë perandori i Kostandinopojës, i cili ia dhuroi atë kishës së Labovës (Gjirokastër). Ktitor i manastirit të Shën Kozmait ishte Ali pashë Tepelena. Ktitor i manastirit të Shën Gjon Vladimirit ishte Karl Topia.

*Kungim-i:* Bashkimi simbolik në Krishtin përmes ngjërimit të bukës së meshës dhe verës, që janë shprehëse të trupit dhe shpirtit të Jezuit. Kungimi është i detyrueshëm (së paku një herë në vit) për Pashkë.

*Kuria:* Nga lat. “curia-ae”; këshill vendimmarrës i bujarisë së një qyteti në periudhën paraprirëse të Rilindjes Europiane. Aktet e këtyre këshillave përmbajnë ndërthurje të së drejtës doktrinare kishtare me atë etnozakonore urbane.

*Kuvendi i Arbnit:* Mbledhje e ipeshkvinjve të krishtërimit roman në Shqipëri, mbajtur në vitin 1703, me iniciativën e arkipeshkvit të Tivarit, Vick Zmajevic, dhe me kujdestarinë e papa Klementit të 12-të. Mori vendime të rëndësishme historike për jetën e kishës dhe të botës laike shqiptare. Disa prej akteve të këtij kuvendi - koncili-u shkruan në gjuhën shqipe. U mbajt në janar, në Mërqi, një fshat i vogël në afërsi të Lezhës.

*Lamentim-i:* Vajtim i profetit Jeronim për Jeruzalemin e rrënuar. Dikur këndohej në kishë gjatë “javës së madhe” të Pashkëve.

*Laramani-a:* Kriptokrishtërimi i rishfaqur në botën shqiptare në periudhën osmane. Dukuri e veçantë e kësaj hapësire. Ruajtja e besimit të krishterë duke zbatuar formalisht rite e shprehje të besimit islam. Zonat më tipike të laramanisë fetare janë Shpati (Elbasan) dhe Lura (Dibër). Në zonën e Shpatit u ruajt deri në shekullin e 20-të tradita që çdo njeri të ketë dy emra (Josif dhe Jusuf, Moisi dhe Musa, Adam dhe Adem), kurse në zonën e Lurës u ruajt tradita që pjesëtarë të së njëjtës familje të kenë të drejtën për të zgjedhur ç’besim do të ushtrojnë. Kisha qendrore në Lurë kishte edhe vendin e posaçëm të pranisë në meshë të jo të krishterëve. Çmohet si shprehje e tolerancës shpirtërore të shqiptarëve.

*Lectionary:* Term i përdorur në klasifikimin e shkrimeve ungjillore të hershme (Gregory-Aland, Nestle-Aland); grupi i tretë i tyre (pas grupit “Maiuscule” dhe grupit “Minuscule”). I përgjigjet të njëjtës term të huazuar prej greqishtes: perikope ungjijsh (shih). Ka kuptimin “ligjërrata ungjillore”, “fragmente ungjijsh”, “shkrime ungjillore në fragmente”, të renditur në mënyrë didaktike për përdorim në kishë, sipas të kremteve, duke i referuar paragrafët e ngjashëm të një ungjilli tek tjetri ose të tjerët. Në greqisht dhe më shpesh në terminologjinë kishtarë: perikope.

*Levi, Leviatan-i:* Figurë e rëndësishme e mitologjisë biblike hebreje. Zakonisht përmenden së bashku, Leviatani dhe Behemoti, si dy figura të mbifuqishme, të tmerrshme, shpesh si përbindësia, që përfaqësojnë rivalitetin e fuqive kozmike. Behemonti është një qenie që ushqehet me bar, dhe për këtë arsye konsiderohet shprehës i fuqisë tokësore ose i tellurokracisë. Përkundrazi, Levi, ose Leviatani, shenjon fuqinë detare ose tallasokracinë. Tek njeriu rrojnë fryma e Leviatani dhe fryma e Behemotit. Fryma e Leviatani zbuloi Amerikën.

*Ligatur/ë-a:* Shenjë ndërlidhëse e një grupi grafemash në shkrimin greqisht. Me anë të një ligature formohet një shkurtesë. Të tilla ka mjaft edhe në “Beratinus-1”, sipas vëzhgimeve të Batiffol-it.

*Ligji i përtërirë:* 1. Përmes Moisiut Perëndia bëri besëlidhje me hebrejtë, duke u dhënë „Dekalogun“, ose „Dhjetë urdhërimet“, të cilat ishin të shkruara në dy rrasa të mëdha guri. Por, kur Moisiu u kthye tek populli prej malit të shenjtë Sinai, i dëshpëruar vërejti se njerëzit kishin ndërtuar shtatoren e një viçi të artë dhe po i luteshin asaj. I bindur se populli i tij nuk e meritonte besëlidhjen me Perëndinë, Moisiu i hodhi në zjarr dhe i shkatërroi rrasat e gurit, me “Dhjetë Porositë”. Më pas, i penduar për humbjen e “kontratës me Perëndinë”, Moisiu u lut përsëri për popullin e Izraelit. Dhe Perëndia i tha: “Shkruaji në dy rrasa të tjera çfarë të dhurova dhe jepja popullit tim”. Teksti që shkroi Moisiu në pllakat e reja, duke përsëritur si i kishte mbajtur mend „Dhjetë Porositë“, u quajt „Besëlidhja e përtërirë“, por shpesh njihet edhe si „Ligji i përtërirë“. 2. “Deuteronomi“, ose, edhe ky, i quajtur „Ligji i përtërirë“, që në mitologjinë hebreje, lidhet me emrin e Jozia-s, ose „mbretit të drejtë“, i cili qeverisi në vitet 693-639 para Krishtit dhe reformoi një shumicë të rregullave fetare dhe laike etnozakonore të herbejve. Jozia e paraqiti para krerëve të fiseve hebreje „Ligjin e përtërirë“ si një dhuratë të Perëndisë.

*Lilan-i:* Trandafil, motiv i përhapur gjerësisht në stolisjet e kodikëve. Ky motiv ka formën e trifletëshit, që lidhet me shenjtërinë e numrit tre.

*Lipsani-a:* Relikte, sende të përdorura prej jerarkëve të lartë të kishës, martirëve, etërve, shenjtoreëve.

*Liturgji-a:* Nga gr. “liturgjima”, kjo me prejardhje prej dy rrënjash: “litos” - publik dhe “ergou” - vepër. Ka kuptimin “radhë e ceremonive dhe lutjeve sikurse është vendosur prej autoritetit shpirtëror përgjegjës”. Ushtrimi publik i këtyre ceremonive dhe lutjeve.

*Logos:* Nga gr. “logos”, arsye. E shkruar me shkronjë të madhe nistore do të thotë: 1. Perëndia (në fillim qe Fjala); 2. Shkrimet e shenjta, Bibla; 3. Ligjërata, fjalime të rëndësishme teologjike të shenjtëve dhe etërve të kishës.

*Logothet-i:* Huazim nga greqishtja, del dhe në formën “logofeti”: zëdhënësi, kancelari, zyrtari që mban korrespondencën (në familjet e mëdha në Mesjetë).

*Lum!:* Qoftë i bekuar! Prej këndeje edhe “lumturi”. Del edhe në përdorim laik, në këngë popullore: “Lum e lum për ty, i lumi zot” (eposi i kreshnikëve). Në përdorimin kishtar: “tetë bekimet”. Në ligjërimin klasik biblik në shqip: “tetë lumnitë ungjillore”.

*Lutj/e-a:* Komunikim shpirtëror i besimtarit me Perëndinë. Lutje kanonike, përveç formave të tjera të shprehjes së dëshirave njerëzore, janë tri: 1. Ati ynë (Pater Noster, Paterimo), që, në kuptimin kishtar, “e tha me gojën e tij të shenjtë vetë Jezu Krishti dhe ua dha dishepujve për ta përhapur, prandaj është më e mira e të gjitha lutjeve”; 2. Lutja e Shën Mërisë (Ave Maria, Theotokea) - janë fjalët me të cilat engjëlli Gabriel (Gavril) iu fal Shën Mërisë; 3. Lutja e Zojës së Shumëmëshirshme (Salve Regina, madre di misericordia, Heredhospina).

*Manna:* Fjalë e gjuhës së aramenëve. Përdoret në Dhjatën e Vjetër. Si rregull nuk përkthehet. Ka kuptimin “ushqim hyjnor i pasosur”. Fj. për fj. në hebraisht “manhu” do të thotë “ç’është kjo?!” Përmes Moisiut Perëndia vuri në provë “popullin e zgjedhur”, hebrejtë. Një prej provave ishte dhurimi i ushqimit të pasosur, me porosinë që askush të mos merrte më shumë se i duhej dhe të mos ruante për nesër. Populli i Moisiut, kur pa në mëngjes se toka ishte mbuluar me ushqimin hyjnor, tha: “Manhu?!” Përshkruhet si diçka që ka formë të bardhë, e përkryer, e përplotë, e patëmetë dhe parajsore, që iu dha njeriut në mes të shkretëtirës (“Bibla e ilustruar për të rinj”, Ferizaj 1987, f. 127). Dhurimi i “manna-së” për popullin e Izraelit pasoi “një prej dhjetë shuplakave / ndëshkimeve popullit të Egjiptit”, që nuk ishte i zgjedhuri i Perëndisë. “Many have speculated on the precise nature of this “manna”, and several partial parallels are known. To the present time in Sinai, certain insects produce honeydew excretions on tamarisk-twigs seasonally every June for some weeks. At night these drops fall from the trees to the ground, where they remain until the heat of the sun brings forth the ants which remove them. These drops are small, sticky, light-coloured, and sugary-sweet, quite strikingly like the biblical descriptions in Ex. 16 and Nu. 11. Other honeydew-producing insects are known in Sinai and elsewhere, e.g. certain cicadas. However, these products do not fit the biblical description in all particulars” (Bodenheimer, F. S.: BA 10, 1947, p. 1-6; Keller, W.: “The Bible as History”, 1956, plate between pp. 112-113). “In South Algeria in 1932 and also about 70 years before, after unusual weather ‘there were falls of a whitish, odourless, tasteless matter of a farinaceous kind which covered tents and vegetation each morning’” (Rendle-Short, A.: “Modern Discovery and the Bible”, 1952, p. 152). “Also in 1932, a white substance like manna one morning covered an area of ground 640 x 18 m on a farm in Natal and was

eaten by the natives. None of these phenomena satisfies the biblical data, and the provision of the “manna” remains ultimately in the realm of the miraculous, especially in its continuity, quantity and 6-day periodicity. The partial parallels cited above may indicate, however, the kind of physical bases used by God in this provision. The “manna” was used by God to teach lessons for spiritual instruction as well as physical sustenance. Israel was told that with the failure of other food (‘suffered thee to hunger’), his provision of “manna” was to ‘make you know that man does not live by bread alone, but that man lives by everything that proceeds out of the mouth of the Lord’. God used the provision of manna on 6 days and not the seventh to teach Israel obedience, and convicted them of disobedience (Ex. 16:19, cf. vv. 20, 25-30). Jesus Christ uses the “manna”, God-given ‘bread from heaven’, as a type of himself, the true bread of life, and contrasts the shadow with the substance: ‘your fathers ate the manna in the wilderness, and they died’ (Jn. 6:49), but he could say, ‘I am the bread of life... which came down from heaven; if any one eats of this bread, he will live for ever’ (Jn. 6:35, 51, and cf. vv. 26-59 passim). Eternal life was made available to man by the merits of Christ’s death (v. 51). In Rev. 2:17 the ‘hidden manna’ represents spiritual sustenance imparted by the Spirit of Christ’. (Kitchen, B.A.: “Reader in Egyptian and Coptic”, University of Liverpool; Douglas, J.: “New Bible Dictionary”).

*Manastir-i*: Institucion klerikal në traditën e Kishës lindore. Bashkësia e murgjve të një institucioni të tillë. Koine. Një prej manastireve të rëndësishme të traditës kishtarë shqiptare është ai i Grotaferrata-s pranë Romës.

*Magji-a*: Nga rrënja indoeuropiane “mag”, në kuptimin “i ditur”. Prej këndeje edhe “magister”, mjeshtër. Në shqip përdoret edhe në kuptimin parak. V. Buhara, në përkthimin e “Shah Namesë”, shkruan se mbretërit thërrisnin magët për të mësuar fatin e tyre. Ka kuptimin dituri e fshehtë. Magët ishin priftërinj persë, asirë dhe egjiptianë, që dinin “dituritë e fshehta” dhe shpallnin kumte për të ardhmen në formën e alegorive, sidomos kur paralajmëronin zymtësi. Magjitë, në historinë e kishës së krishterë, ndahen në: astrologji gjyqësore (shortari), astrologji hyjnuuese, shërimtare dhe magji thesaresh (ndër të tjera edhe alkimia!). Kjo fjalë në “Bibla e ilustruar për të rinj”, Ferizaj 1987, është përkthyer në formën “dijsi”, kurse në ligjërimin etnografik del në formën „distari“.

*Maiusucle*: Stil të shkruari me dorë i periudhës së paleokrishtërimin. Grafi me shkrim dore, por me shkronja të mëdha kapitale. Mbi bazën e stilit të grafisë me shkronja të mëdha biblike, dorëshkrimet më të vjetra janë klasifikuar si “ungjij germëmëdhenj”. Numri i ungjijve germëmëdhenj është tejet i kufizuar, sepse ky stil të shkruari është përdorur midis shekullit të 3-të dhe shekullit të 6-të, fillimisht për shkrime laike, kryesisht kushtime perandorëve. Në arkivat e Shqipërisë gjendet një prej ungjijve të rrallë germëmëdhenj: “Beratinus-1”. Ungjij germëmëdhenj janë edhe: “Sinaiticus”, “Alexandrinus”, “Synopensis”, “Vindobonensis”, “Genesis” - Vjenë, “Codice N”, “Rossanensis”, “Petropolitanus”. Disa studiues kanë bërë fjalë për “germë të madhe biblike” edhe në një dorëshkrim tjetër ungjillor që ruhet në arkivat e Shqipërisë, por asnjëri nuk e ka përcaktuar saktësisht atë (Batiffol, Popa, Mullen).

*Martirologji-a*: Nga gr. “martirologion”: një kategori dorëshkrimesh kishtarë që përmban kryesisht jetëshkrimeve të martirëve të kishës, por ndonjëherë edhe shkrime, meshë dhe ligjërata teologjike të tyre.

*“Mene, tekeli, upharsin”*: Shprehje e njohur biblike që gjendet në Dhjatën e Vjetër në hebraisht. Janë fjalët që lexoi Danieli kur u vu në provë zotësia dhe fuqia parathënëse e tij nga mbreti Baltazar. Danieli lexoi tri fjali prej kësaj shprehjeje: 1. Perëndia do t’i japë fund mbretërisë

sate; 2. Ti nuk ke peshë (nuk vlen gjë) në peshore të Perëndisë; 3. Mbretëria jote do t' u jepet persëve ("farsi") dhe medëve.

*Mesh/ë-a:* Nga lat. "missa-ae". Shërbesa themelore e kishës, në të cilën evokohet sakrifica e kryqëzimit të Krishtit, që shenjohehet në mënyrë ceremoniale me përngjasimin e bukës dhe verës së kuqe me trupin dhe gjakun e Jezuit. Mbahet për çdo të diel, për të kremte të tjera, si dhe çdo ditë kur populli mblidhet vetë. Meshë mbahet edhe për raste të tjera të rëndësishme. Ka meshë të ulëta, në të cilat rënkohet dhe nuk këndohet. Meshët e kënduara quhen meshë të mëdha. Të tilla janë edhe mesha e mesnatës së Krishtlindjes dhe mesha e natës së të Shtunës së Shenjtë. Mesha e mbajtur prej Papës quhet meshë papnore. "Mesha e shenjtë është flijimi pa përgjakje që përmban Dhjata e Re. Në meshën e shenjtë merren frytet e flijimit të Jezuit në kryq, sepse mesha e shenjtë dhe flijimi i Jezusit në kryq janë i njëjti flijim" (Heffler, Konrfeind, Kolarek). Prej shekullit të 14-të janë kompozuar vepra të mëdha vokale për meshë, pa shoqërim instrumental. Kjo traditë vazhdoi deri në shekullin e 16-të. Më pas kompozimet për meshë u shoqëruan edhe me instrumente muzikore (organo veçmas). Përmbajtja e tyre duhej të ilustronte tekste liturgjike që do të predikoheshin prej ipeshkvinjve. Kompozitorët më të famshëm të muzikës së meshës janë Palastrina, Lotti, Bach, Mozart, Hayden, Beethoven, Schubert, Liszt, Guno, Drukne, Stravinskij etj. Mesha e parë në shqip është mbajtur më 1908. Kjo meshë u kompozua dhe u celebrua në Boston nga imz. Fan. S. Noli. Lënda muzikore e kësaj meshe u kompozua nga vetë Noli. Një meshë përkujtimore me këtë lëndë u mbajt në vitin 1978. Një kopje e regjistruar e kësaj meshe ruhet në fonotekën e AQSH-së. Muzikë për meshim ka kompozuar edhe Martin Gjoka. Në kuptimin kishtar mesha është "evokim / kujtim / i shfaqjes, jetës dhe vdekjes së Jezu Krishtit".

*Meshar-i:* Libri i meshëve; libër që përmban lutjet e meshëve për të gjitha ditët e vitit. "Meshari i Gjon Buzukut". Shkrime didaktike për radhën e shërbesave, lëndën biblike-ungjillore dhe mënyrën e komunikimit të tyre.

*Metoh-u:* Nga gr. "metoh"; manastir që varet prej një qendre manastiriale më të rëndësishme (ekonomike dhe fetare). Në huazimin e hershëm del si toponim në formën "Metoq". Prej së njëjtës rrënjë edhe "Metohi".

*Mëkat-i:* Nga latinishtja "peccatum". Fjalë e huazuar në shqipe prej periudhës ilire. Fillimisht, për lehtësi shqiptimi, është shtuar m-ja epentetike "mpekat". Më pas është zhvilluar asimilimi i pandërmjetmë. Në ligjërimin biblik është shkelje e "Dhjetë Porosive" apo Dekalogut. Mëkat bëhet duke menduar kundër Dekalogut, duke folur kundër tij, duke i shkelur me apo pa paramendim porositë ose duke lënë mangur çka kërkohet prej tyre. Mëkatet ndahen në të mëdha ("fyerja e Zotit") dhe të vogla ose të falshme. Në ritualin roman mëkatet rrëfohen. Mëkatet e vogla shlyhen nëse rrëfimi është i thellë.

*Miniatyr/ë-a:* Forma më e rëndësishme e artit të zbatuar kishtar në dorëshkrime. Art i zbatuar i periudhës paraikonografike. Një nga zbukurimet më të hershme në historinë e artit ilustrues. Miniaturat më të arrira janë ato me portretet e ungjillorëve. Këto kanë plotësinë e një veprë arti, me ide dhe përmbajtje, me elemente të kompozimit, me semiotikë mjaft të pasur prej simboleve kishtarë. Miniaturat, në formën e zbukurimores së thjeshtë, shfaqen qysh në dorëshkrimet më të hershme. Në "Beratinus-1" (shek. i 6-të) gjenden dy motive zbukurimore që rishfaqen në traditën e shkrimeve të shenjta për shekuj me radhë: zemrat e stilizuara dhe vijat vertikale e horizontale kënddrejta, shprehje e ekuilibrit shpirtëror. "Koha e artë" e artit të miniaturës është ajo prej mbarimit të "luftës së ikonave" (shek. i 8-të), deri në shfaqjen e ikonografisë (shek. i 12-të).

*Minej-i:* Nga gr. "menaion", muaj. Kalendar kishtar mujor i kishës ortodokse. Përmban të

kremtet e një muaji, të renditura në mënyrë kalendarike për jetën e shenjtoreve. Disa dorëshkrime të këtij lloji kanë të kremtet dhe shërbesat e tre muajve. Ka edhe kalendarë “synopsion”, minej gjithëvjetor. Një synopsis gjithëvjetor e fillon renditjen e të kremteve prej muajit shtator, me të cilin nis viti kishtar.

*Minuscule*: Stil të shkruari me dorë i periudhës së dytë të shkrimeve të shenjta, prej fundit të mijëvjeçarit të parë e në vijim. Grafia e këtyre dorëshkrimeve është mjaft më e vonët se e dorëshkrimeve ungjillore germëmëdha. Në terminologjinë e paleografisë së sotme quhen “ungjij germëvegjël” të gjitha ato dorëshkrime në të cilat, në dallim prej ungjijve germëmëdhenj, është përdorur shkrimi i dorës, me germa në vogla. Në arkivat e Shqipërisë dorëshkrimi më i hershëm germëvogël është “Beratinus-2”. Klasa e ungjijve germëvegjël është mjaft e pasur.

*Mister-i*: Betim. Tek autorët e vjetër të letërsisë shqipe përdoret si rregull në shumës, si sinonim i “sakramendeve”. Misteret /sakramendet/ janë shtatë: pagëzimi, krezmimi, kungimi, rrëfimi, vajimi, urdhëri i shenjtë (priftëria) dhe kurora e martesës. Në kuptimin kishtar, misteret (sakramentet) janë themeluar nga Jezu Krishti.

*Mischellanea*: Term që shpreh tipologjinë e një botimi dokumentesh të vjetra. Përmbledhje aktesh dhe dokumentesh që nuk janë të bashkërenditshme nga pikëpamja e tipologjisë. *Mischellanea christiana*; *Mischellanea byzantina*.

*Mitropolit-i*: Arkipeshkvi i kryeqytetit, i metropolit, apo i një qendre të madhe urbane kishtare, njohur si e tillë nga Patriarkana.

*Msgr.*: Shkurtesë për “monsignore”, imzot, apelativ për klerikë të rangut të lartë të kishës katolike.

*Mutatis mutandis*: Huazim idiomatik latin. Të ndryshosh çfarë është e ndryshueshme; të ndryshosh brenda së mundshmes. Në studimet e tekstologjisë kritike përdoret për të krahasuar tekstin dorëshkrimor me atë kanonik. Nga kjo idiomë rrjedhin dy shkurtesa të njohura: 1. “Inc. mut.” - fillon duke ndryshuar; si dhe 2. “Des. mut.” - përshkruhet me ndryshim.

*Mobed-i*: Nga pers. “mobadhan”, prift që kryesonte një njësi kishtare në Persinë e shekullit të 4-t deri në shekullin e 5-të, në kohën e përzierjes së krishtërit me zoroastrizmin.

*Monogram-i*: ~ i Krishtit. Shenjë e padeshifrueshme, kriptologjike, e emrit të fshehtë të Krishtit në periudhën e fillimeve të krishtërit. Formohet nga tri vija që kryqëzohen në një qendër. Vija vertikale, në pjesën e sipërme, ka një gjysmëmehar, të ngjashëm me atë të germës D. Gjendet në hapësirën e krishtërit apostolik, duke përfshirë edhe kulturën iliro-shqiptare. Monograme nganjëherë quhen edhe disa shkurtesa karakteristike për shkrimet ungjillore dhe mbishkrimet antike e mesjetare të greqishtes.

*Muzeum-i*: Nga gr. “museum”, muze. Në krye të herës kishte kuptimin e një shkolle helene të periudhës së paleokrishtërit, që vazhdoi të ekzistonte deri në periudhën e reformës arsimore të Justinianit. Në këto shkolla formimi i nxënësve bëhej mbi bazat e dijeve klasike të antikitetit. Modeli më i plotë i kësaj shkolle është Akademia e Athinës. Në terminologjinë zyrtare perandorake ato quheshin “muzeume”, për shkak të konservatorizmit. Më vonë muze u quajtën institucionet që mbledhin, ruajnë dhe paraqesin reliktet dhe dëshmi materiale të periudhave të kapërcyera.

*Narteks-i*: Term i përshkrimit arkitekturor të kishës, pjesa perëndimore e saj. Nga i njëjti

burim vjen edhe “ekzonarteks” apo “narteksi i jashtëm”, që shenjon oborrin perëndimor të kishës, i cili mbulohet me një çati të mbështetur mbi murin e jashtëm të kësaj ane të kishës dhe të mbajtur prej shtyllëzash druri ose guri.

*N.D.:* Shkurtesë për “Nostro Dio”, Ati Ynë, Jezu Krishti.

*Nikopojë-a:* Toponim që përmendet në shkrimet Besëlidhjes së Re (“Punët e apostujve”). Identifikohet me qytetin Nikopolis, Preveza e sotme. Ka qenë për një kohë të gjatë qendër ipeshkvie.

*Nomokanon-i:* Shih “kanon”, në kuptimin 1. Dyfishim kuptimor i së njëjtës leksemë, me karakter përforcues: “nom” - ligj, dhe “kanon” - ligj. Rregullore kishtare, me karakter njësuës për zgjidhjen e çështjeve të jetës së besimtarëve.

*NT:* Shkurtesë që përdoret dendur në studime për “Dhjatën e Re” - nga lat. “Nuovum Testamentum”.

*O.F.M.:* Shkurtesë për “Ordine fratelli minori”, urdhri i fetërve të vegjël; që përveçon klerikë të hierarkisë së ulët të priftërisë, kryesisht meshtarë, tek franceskanët.

*Oktateuk-u:* Një nga pjesët përbërëse të rëndësishme të Dhjatës së Vjetër, “Tetëlibërshi”.

*Oktoih-u:* Nga gr. “oktoih”, tetëzërësh. Tekste liturgjike të shkruara në sistemin e vjetër muzikor bizantin, me tetë zëra. Jo të gjithë zërat kanë melos të pavarur. Disa nga zërat kanë këtë përshkrim: zëri i parë kthyes (fj. për fj.: “diagonal”, “tërthor”); zëri i dytë kthyes; zëri i tretë, i rëndi; zëri i katërt kthyes. Një oktoih ka shkruar edhe shkrimtari i rilindjes malazeze vladika Petar Negosh.

*Omilië-a:* Nga gr. “homilia” - mbledhje. Instruksione që u jepen besimtarëve për besimin, bazuar kryesisht tek ungjijtë. Trajtesa të përzgjedhura të etërve të kishës. Në angl. transliterohet në formën “homelye”, në shqip përdoret edhe me shqiptim alternativ “omelie”, që do të thotë: predikim, shpjegimi i fjalës së Zotit. Batifol përdor termin “libër omiliesh” (jo vetëm) për lutjet e përzgjedhura nga Shën Gjon Gojarti, por edhe për pjesë të zgjedhura ungjillore nga teksti i Ungjillit sipas Markut. Popa e përdor për “shpjegime rreth temave ungjillore”. Omilie janë edhe tekste të zgjedhura nga Dhjata e Vjetër. Terminologjikisht omilia është një përmbledhje e shkurtër në gjuhën greke popullore (“dhimotiki”) e liturgjisë së mbajtur (psalme, predikime), të cilat shqiptohen /këndohen / në greqishten e mesme (“katharevus”), që nuk është e kuptueshme për të gjithë.

*Opat-i:* Emri hebraik i kreut të një manastiri. Në burim, në gjuhën e aramenëve, thuhet: “abbsa” ose “avva”. Në kishën romane një lloj manastiri që ka prona dhe pasuri të mëdha quhet “abaci”, kurse kreu i këtij manastiri quhet “abat”.

*Origen-i:* Një figurë e njohur e teologjisë së krishterë. Jetoi në vitet 185-254. Ishte gjurmues i shkrimeve biblike. Vlerësohet si themelues i traditës së kërkimit të dorëshkrimeve ungjillore. Vizitoi, ndër të tjera, Nikopojën (Artën), ku gjeti një version të Dhjatës së Re, të panjohur më parë. Ai i kërkonte dorëshkrimet ungjillore “në gjithfarë vendesh të fshehta, të lashta, dhe i nxirrte në dritë; kur kishte dyshim për autorësinë e tyre, bënte një shënim se këtë përkthim e kishte gjetur /bie fjala / në Nikopojë afër Aktit, kurse një tjetër në një vend tjetër”, sipas Shën Jeronimit (Edwin Jasques, “Shqiptarët”, 1995, f. 162 e botimit shqip). Bie në sy fakti se Origeni



gjeti një dorëshkrim të panjohur ungjillor qysh në shekullin e 2-të deri në atë të 3-të në një qytet që bënte pjesë në Illyricum, si Nikopoja.

*Orologji-a:* Nga gr. “orologion”. Libër kishtar që përmban terma të shkruara të liturgjisë dhe shërbesës. Çdo dije ka orologjinë e vet-leksikonin e vet. “Orolog” quhet gjithashtu një libër kishtar, që tregon se çfarë është e detyrueshme të lexohet nga ungjijtë apo shkrimet nga Bibla në festat fetare të vitit, si dhe shërbesat gjegjëse.

*Ortodoks-e:* Fj. për fj. “e drejtthëna”, kisha që nuk është shmangur nga qëndrimet. Kisha lindore, me kryeqendër Kostandinopojën. Nuk njeh si autoritet administrativ Selinë e Shenjtë. Në krye të kishës ortodokse qendron Patriarku. Kisha ortodokse ka identitetin e vet, të shprehur në kalendarin e të kremteve, në gjuhën e liturgjisë, në praktikën e predikimit dhe të shërbesave.

*Oshënar-i:* Njeri që i është kushtuar jetës së ashkëtinjve dhe i përket këtij urdhëri murgjerie.

*Pagëzim-i:* Rit themelor në krishtërim. Nga lat. “baptesimo”, ruajtur edhe në një formë të përfutur prej këtij huazimi latin të kohës ilire, “bagëm” (Çabej). Me anë të pagëzimit, në ligjërimin biblik, arrihet çlirimi i njeriut prej “fajit të trashëguar”, apo prej “mëkatit të parë”, që lind bashkë me njeriun, Adamin dhe Evën, që nuk iu bindën urdhërit të Perëndisë për të mos prekur “frutin e ndaluar”. Jezui Krishti u pagëzua në lumin Jordan. Përmes pagëzimit të Jezuit njerëzimit iu zbulua trinia: Ati, Biri dhe Shpirti i shenjtë. Shën Trinia festohet të dielën e parë pas ditës së Rrëshajave. Pagëzimi, sipas të njëjtit ligjërim, nuk e çliron njeriun prej mëkateve që bën njeriu pasi është pagëzuar. Në ligjërimin biblik pagëzimi “është porta e të gjitha sakramenteve të tjera”. Asnjë prej këtyre të fundit nuk mund të bëhen pjesë e njeriut pa pagëzimin. “In short, the more baptism is seen as the expression of the baptisand’s faith, the less easy is it to hold to infant baptism. Whereas the more baptism is seen as the expression of divine grace, the easier is it to argue for infant baptism. Either way, Christians should beware of overvaluing baptism in the way that the Judaizers overvalued circumcision (Burial, Circumcision, Faith, Judgment, Laying on of Hands, Repentance, Sacrament, Spirit, Water)” - Aland, K.: “Did the Early Church Baptize Infants?”, 1963; Baillie, J.: “Baptism and Conversion”, 1964; Barth, K.: “Church Dogmatics”, IV/4, 1970; Beasley-Murray: “Baptism in the New Testament”, 1962; “Baptism Today and Tomorrow”, 1966; Wagner, G.: “Pauline Baptism and the Pagan Mysteries”, 1967; Wainwright, G.: “Christian Initiation”, 1969. Forma më e drejtpërdrejtë e shprehjes rituale të pagëzimit në Dhjatën e Re gjendet në letrën e Palit Korinthisve (1:1), ku përdoret idioma “në emër të Krishtit” (“in (eis) name of Jesus”). Në letra të tjera të Palit flitet për “pagëzimin me Krishtin” (“baptized into Christ”), që bibliologët e interpretojnë si një shkurtim të një formule më të plotë. Në letrën Korinthisve përdoret shprehja “i pagëzuar në shpirt me Krishtin” (“baptized in Spirit into Christ”)-12:13. Sipas dijetarëve teologë, uji simbolizon Shpirtin e Shenjtë.

*Paleografi-a:* Dije që merret me studimin e historisë së shkrimit të hershëm. Nga greqishtja “paleos” dhe “grafi” - fj. për fj. “shkrim i vjetër”. Paleografia studion stilet e të shkruarit, individualitetin e tyre dhe periodizimin historik. Paleografia njehson vlerën e grafemave të përdorur në alfabetet shkrimesh të vjetra dhe bën tejkshkrimin e tyre.

*Paleokrishtërim-i:* Krishtërimi i hershëm, periudha e parë e përhapjes së krishtërimin, prej shekullit të 1-rë, që nis 33 vjet pas lindjes së Krishtit, deri në shekullin e 5-të. Disa dijetarë konsiderojnë paleokrishtërimin edhe një periudhë deri 2-shekullore të mëvonshme. Kjo është periudha e martirizimit sistematik të protagonistëve më të mëdhenj të krishtërimin. Në Illyricum

u martirizuan Shën Cesari (Durrës, gjysma e dytë e shekullit të parë) dhe Shën Asti / Ashti (Durrës, dekada e dytë e shekullit të dytë). Në Dardani periudhës së paleokrishtërimin i përkasin Shën Flori dhe Lauri (viti 117-138).

*Palimpsest-i:* Quhej kështu një pergamenë e përdorur disa herë për të shkruar. Teksti i mëparshëm lyhej me bojë dhe mbi këtë shkruhej kumti i ri. Në disa dorëshkrime ka deri 3-4 tekste të mbishkuara. Kjo ndodhte për shkak të shtrenjtësisë së pergamenës. Studiuesit e shkrimeve të vjetra kanë mundur që në dorëshkrime të tilla të zbulojnë tekstin e dukshëm, paratekstin, tekstin para këtij të fundit e kështu me radhë. Në fjalorin e sotëm kjo fjalë ka marrë kuptim figurativ, për një tekst shumënivëlësh. Përdoret për të identifikuar një formë të tillë të shkruari me karakter ndërtekstor, sidomos për ato që quhen “rikrijime”.

*Panagia:* Nga greqishtja: “e tërëshenjtëruara”. Një nga epinomet e shën Mërisë, Virgjëresha; njësoj sikurse në it. „Madona”. Në toponomastikën vendëse huazimi i hershëm rezulton në formën “Panaja” (emër fshati).

*Pandokrator-i:* Krishti ~ . Epinom i njohur i Jezu Krishtit. Vjen nga greqishtja dhe ka kuptimin “i gjithëfuqishëm”. Krishti pandokrator (transliterimi i përpiktë prej greqishtes është “pantokrator”) paraqitet në miniatura dhe ikonografi në një portret ballor, me librin e shenjtë në dorën e majtë dhe me dorën e djathtë të ngritur deri afër supit. Krishti pandokrator i paraqitet besimtarit me një shenjë karakteristike, duke bashkuar në formë rrethore gishtin e madh me gishtin e parafundmë, ndërsa gishtat e tjerë janë të zgjatur drejt. Kjo është shenjë tipike e Krishtit, duke përfshirë edhe miniaturat që e paraqesin fëmijë, si dhe ato ku Krishti është në përfytyrimin e gjykatësit. Me këtë shenjë del edhe Shën Gjon Pagëzori. Ka dhe një manastir me të njëjtin emër në Kostandinopojë.

*Papadikë:* Vargje ~. Shkrime / vargje muzikore bizantine që duhet të këndohen nga prifti (jo nga psalti). Përdoret edhe “stihë papadikë” - vargje priftërore; “stihiar papadik” - këngë priftërore.

*Paravoli-a:* Huazim nga greqishtja. Në lat. është “parabola”. Rrëfime apo tregime alegorike, me karakter didaktik, të cilat Jezu Krishtit i përdor për ta bërë sa më të kuptueshme fjalën e Zotit. Përdoret për të identifikuar pjesët e ungjillit ku Jezui rrëfen ngjarje me aludime. Rrëfime apo tregime alegorike, me karakter didaktik për çështje morale sipas Dhjatës së Re.

*Pashk/ë-a:* E krentja më e rëndësishme e krishtërimin, e diela e ringjalljes së Krishtit pas kryqëzimit dhe varrimit të premtën pasdite. Në Dhjatën e Vjetër Pashka është një prej provave / dëshmime të Perëndisë se populli i Izraelit është populli i zgjedhur dhe i mbrojtur prej tij. Perëndia urdhëroi Moisiun që të porosisë gjithë popullin e Izraelit të bëjë fli dhe të lyejë me gjakun e flisë së blatuar portën e shtëpisë, për t’u dalluar prej të tjerëve dhe për të qenë nën mbrojtje në ditën e kalimit të zemërimin hyjnor. “Passover (beb. “pesa”?) comes from a verb meaning ‘to pass over’, in the sense of ‘to spare’ (Ex. 12:13, 27, etc.). This affords excellent sense; there is no need to jettison the time-honoured view that God literally passed over the blood-sprinkled Israelite houses, whilst smiting the Egyptian ones. The term is used both for the ordinance and for the sacrificial victim”. (Gaster, T. H.: “Passover: Its History and Traditions”, 1949, pp. 23-25). “On the Passover night in Egypt, the lintels and side-posts of all Israelite doors were smeared (apotropaically, some suggest) with the victims blood” (Snaith, N. H.: “The Jewish New Year Festival”, 1947, p. 21). “The blood emphasis has disappeared; an essentially domestic ceremony has become a more formal sacrifice at a central sanctuary with a wider choice of victim; v. 7 stipulates boiling, not roasting, the animal; Passover and Unleavened Bread, here termed the bread of affliction, are integrated more thoroughly

than in Exodus. This is development, event changing to institution, not contradiction; moreover it approximates better to the NT evidence concerning Passover. It is not necessary to assume a great time-gap between the passages; the changed circumstances could have been prophetically foreseen in the wilderness period. It is further recorded that a second Passover, celebrated a month later, was instituted for the benefit of those who had been levitically unclean at the time of the first Passover was celebrated in the plains of Jericho during the Conquest (Jos. 5: 10). Hezekiah's ceremony takes advantage of the legitimate second Passover mentioned above, because the people are not gathered in Jerusalem, and the priests are not in a state of levitical purity, at the earlier date. The brief reference of Ezekiel (45: 21-24) deals with Passover in the ideal Temple of his conceiving. The three points of interest are the fuller participation of the secular leader, the fact of a sin-offering, and the complete change-over from family celebration to public ceremony. The victims specified include bullocks, rams and kids. The prescriptions of Deuteronomy are considerably extended, though not in any new thought-pattern".

*Patrologji-a:* Nga gr. "patrologion", fj. për fj. "shkrim për etërit": një kategori dorëshkrimesh kishtarë që përmbajnë jetëshkrime të 318 etërve të parë të kishës, ndonjëherë edhe ligjërata, shkrime dhe vepra të tyre. Disa prej etërve që zënë vendin më të rëndësishëm në letërsinë patrologjike (ose "paterike") janë: Shën Gjon Gojarti (Chrysostomos), Shën Vasili i Madh, Gregori, Efraim Siriani, Teodor Pararendësi (Prodhromi), Isaak Siriani, Maksim Peloponezi.

*Pendateuk-u:* Një prej pjesëve më të rëndësishme të Dhjatës së Vjetër, "Pesëlibërshi", që përfshin pjesët nga Zanafilla deri tek Ligji i Përtërirë.

*Pergamen/ë-a:* Material me përbërje organike i përdorur për afro njëmijë vjet si suport për shkrimet e shenjta. Nga disa autorë (Alexoudes) përdoret sinonimi "membranë". Lëkurë e regjur dhe e ngjyrosur, e prerë me përmasa të një flete libri, për t'u përdorur për shkrim. Pergamena e purpurt, e përdorur prej shekullit të tretë deri në shekullin e 9-të, është vlerësuar dhe vlerësohet edhe sot si materiali më luksoz i të shkruarit. Pergamena e purpurt fillimisht përdorej vetëm për shkrime kushtuar perandorëve. Më pas pergamena e purpurt u bë shenjzim përjashtimor i shkrimeve të shenjta. Kanë mbërritur deri në ditët tona gjithsej 7 kodikë të purpurt, dy prej të cilëve gjenden në Shqipëri (Mullen).

*Perikope-ja:* Nga gr. "perikope", me kuptimin "fragmente", "pjesë të zgjedhura", "ligjërata". Përdoret për të përcaktuar tipologjikisht një lloj libri të letërsisë ungjillore. Studiuuesit dhe botuesit Perëndimorë të letërsisë ungjillore përdorin idiomën "gospels lectionary", ligjërime ungjillore apo ligjërime prej ungjijve. "Perikope ungjijsh" do të thotë jo vetëm ligjërata dhe fragmente. Perikopeja përmban edhe referencat e nevojshme që lidhin tekstet ungjillore me të kremtet, sipas kalendarit; si dhe vetë ungjijtë me njëri-tjetrin, bashkëpërkimet e tyre. Ka perikope që identifikojnë paralelet përmbajtësore midis dy, tre apo të katër ungjijve.

*Per pedes apostolorum:* Idiomë e latinishtes, si rregull e përdorur në trajtë të papërkthyeshme. Të udhëtosh më këmbë, të prekësh fizikisht një hapësirë, si në udhëtimet apostolike.

*Pesëdhjetor/e-ja:* E kremte e të krishterëve, që përkujtohet 50 ditë pas Pashkës. Në ligjërimin e drejtpërdrejtë biblik është zbritja e Shpirtit të Shenjtë mbi apostujt, dhe kjo quhet Dita e Rrëshajave. Në terminologjinë kishtarë përdoret edhe forma e ardhur prej greqishtes "pendikosti-a" me të njëjtin kuptim. Libri i pesëdhjetores është libri i shërbesave kalendarike për 50 ditët prej Pashkës deri në festën e Pesëdhjetores. Term i përfutur në shqip prej periudhës së krishtëritimit të hershëm. Sinonim: dita e rrëshajave (Noli). Nuk ka lidhje me

festën e hebrenjë Rosh-e-shana, që kremtohet në ditë tjetër dhe me përmbajtje tjetër.

*Pikëzim/e-t:* Shenja të posaçme që përdoren për t'u dhënë vlerën e saktë notave në antologjitë muzikore kishtare bizantine me sistemin e vjetër. Nuk duhet ngatërruar me pikësimin, si pjesë e teknikës së (drejt)shkrimit.

*Pnevma:* Huazim nga greqishtja, shenjë diakritike mbi shkronjat zanore. Term i paleografisë. Dy thekse karakteristike për greqishten e periudhës postantike. Kanë formën e një harku, gati gjysmërrethi, njëri i dizenuar me rrotullim nga e djathta në të majtë, kurse tjetri anasjelltas. Greqishtja e vjetër në krye të herës nuk kishte as thekset e zakonshme dhe as pnevmat. Këto u vendosën fillimisht për nevojat e mësimin të greqishtes prej të huajve, të cilët e kishin të vështirë të mbanin mend vlerën fonologjike të grafemave të saj pa shenja diakritike. Më pas sistemi i këtyre shenjave u bë pjesë e alfabetit dhe e shkrimit edhe për vetë grekët. Për këtë arsye shkrimet që nuk kanë thekse dhe pnevma janë jashtë dyshimit të hershme. Një nga argumentet që “Beratinus-1” është një dorëshkrim jo më i vonët se mesi i shekullit të 6-të është fakti se grafia e tij nuk ka thekse dhe pnevma karakteristike për greqishten postantike.

*Praetorium-i:* Kazermë e legjionarëve romakë, ruajtësve të perandorëve, qeverisësve, komandantëve. Kjo fjalë ka shkaktuar ngatërresa në përkthimin e shkrimeve të shenjta. Në vitin 64 të e. s., gjatë burgimit të tij në Romë, apostulli /Pal/ shkruante se “vëllezërit e tij në Krishtin ishin të pranishëm në gjithë pallatin”, por në tekstin greqisht kjo pjesë e letrës përkthehet “në gjithë praetorium-in” (Edwin Jacques, “Shqiptarët”, 1995, f. 160 e botimit shqip).

*Pr.:* Shkurtesë për idiomën “kodik i Përmetit”.

*Presviter-i:* 1. Huazim nga greqishtja. Fjalë për fjalë do të thotë “epror”, jerark epror. Në disa gjuhë të Perëndimit u huajt përmes latinishtes “presbyter”. Është, sipas Çabejt, rrënja e kryehershme e fjalës shqipe “prift”. Në shkrimet e krishtera përdoret kryesisht në shumës dhe ka kuptimin “pleqtë”. Në Besëlidhjen e Re “këshilli i presbiterëve” është quajtur këshilli i apostujve, si këshill udhëheqës. Presbiterianizmi është rrymë kishtare e themeluar nga Kalvini. Kisha kalviniste ia njeht autoritetin e qeverisjes së kishës një grupi mikst të priftërinjve të lartë. Kisha kalviniste persbiteranie është polikratike. “Presbiter” është dhe term që emërton një vend të posaçëm në Kishën e sotme amerikane, që përfshin altarin dhe është i rezervuar vetëm për priftin. Prej këndeje edhe: “The Presbyteran Church of America” - Kisha presbiterane e Amerikës. Ka kuptimin “prift”, fjalë që ka hyrë në leksikonin e shqipes prej të njëjtit burim qysh në periudhën ilire. 2. Prift në shërbim të ushtrisë.

*Prifti i madh:* Epinom i Krishtit. Por “prifti i madh” herë-herë quhen edhe: 1. Papa; 2. Ipeshkvi.

*Profet-i:* Parafolës, fatthënës, paralajmërues i ngjarjeve të së ardhmes. Në ligjërimin biblik quhen të tillë ata parafolës që i sjellin njerëzimit kumte hyjnore. Ka ndryshim të dukshëm prej orakujve të mitologjisë greko-romake. Një prej librave kryesorë të Biblës është libri i profetëve.

*Propaganda Fide:* Përhapja e besimit. Emër i njohur ndërkombëtar i një zyre të posaçme të Selisë së Shenjtë, detyra e së cilës ishte të njihej paraprakisht me shkrimet teologjike dhe të lejonte ose ndalonte shtypjen dhe përhapjen e tyre. Propaganda Fide është njohur për një kohë, veçanërisht gjatë inkuizicionit, si institucion censure. Detyra e Propaganda Fide-s ishte, gjithashtu, të përgatiste botime, qarkore, udhëzime për shpjegimin doktrinar të çështjeve teologjike dhe edukimin strikt të besimtarëve.

*Propria manu:* Idiomë latine: autoshkrim, shkrim me dorën e vet, dora vetë. Kështu thuhet në

një shënim për autorësinë e shkrimit të “Beratinus-s”. Sipas këtij shënimi në grafinë e këtij kodiku është “propria manu” e Shën Gjon Gojartit.

*Protosebast-i*: Një prej titujve që u takonin anëtarëve të familjes perandorake në Bizant në periudhën e Aleks Komnenit, i treti titull sipas shkallës hierarkike që, si rregull, shoqërohej me përcaktimin “illustrissimus”, i shkëlqyer. Një shkallë më e lartë nderimi për familjen perandorake ishte titulli “sebastokrator”. Këtë titull e kishte fituar vëllai i Komnenit të madh, Niqifori.

*Protopap/ë-a*: Nga gr. “protos”-i parë dhe “papas”-prift, meshtar. Ka kuptimin “prift i parë” apo kryeprift. Protopapë ishte edhe Onufri.

*Provincialiat-i*: Njësia administrative kishtare që raportonte drejtpërsëdrejti në Selinë e Shenjtë. Kreu udhëheqës i kësaj njësie.

*Prozodi-a*: Fj. për fj. nga greqishtja “prosa” dhe “ode”, ligjërim në vargje, rrëfim në këngë, prozë e kënduar, prozë në poezi. Formë e komunikimit liturgjik të teksteve ungjillore.

*Psalm-i*: Tekste biblike në formë të vargëzuar. Këngë, himn. Psalmet janë pjesë e Dhjatës së Vjetër. Në hebraisht quheshin “Sefer tehil’lim”, ose thjesht “Tehil’lim”. Përkthyesit e “Septuaginta-s” i quajtën “psalme”, duke qenë se vegla me të cilën shoqëroheshin, një instrument kordofon i periudhës antike, tek grekët quhej “psalterion”. Psalmet janë 150. Zakonisht njihen me emrin “Psalme të Davidit”. Por autorësia e Davidit mbi të gjitha psalmet është e diskutueshme, sepse vetëm pak prej tyre arrijnë në mendësinë e kohës së Davidit (“Bibla”, 1994, f. 658, përkthim i dom Simon Filipit). Një dorëshkrim që ruhet në Fondin 488 përshkruhet se përmban “Psalme të Davidit e të Goliathit”, sido që, siç dihet, Goliathi ishte kundërshtari dhe viktima e Davidit. Një pjesë e psalme janë himnore (lavdërim i veprave të Zotit), një pjesë janë psalme lutjesore; ka gjithashtu psalme të ankimit dhe të vajtimit dhe të mirënjohjes (falënderimit). Në numërimin e përgjithshëm të psalmeve del edhe një me numrin 151, por këtë të fundit autoriteti i Kishës nuk e pranon si pjesë të librit të psalmeve. Nga “psalterion” rrjedh edhe “psalt-i” - meshtari që këndon lutjet; “psalt” - veprimi i meshtarit gjatë të kënduarit; “psaltir” - libër psalmesh etj. Termi është huazuar edhe në vjershërimin laik (“Psalme murgu” - Asdreni). Nga “psalm” rrjedhin edhe: a. Psaltir - libri i psalmeve; b. Psalt - klerik që këndon psalmet; pjesëmarrës në një kor kishtar që këndon psalme.

*Psikofelik-e*: Rrëfime ~. Shkrime që synojnë shëndetin shpirtëror të besimtarit. Të tilla janë edhe hristoithi-të (shih).

*Pulheriopolis*: Emri i qytetit të Beratit si qendër ipeshkvnore në periudhën e krishtërimin të hershëm. Në antikitet quhej “Antipatrea”. Disa studiues emrin mesjetar të këtij qyteti, në krye të herës Beograd (gr. Velegradon), e kanë shpjeguar si një kalk në sllavisht të rrënjës së ilirishtes “parthin”, me kuptimin “i bardhë”, si kuptimdhënëse e gjithë kompozitës, “qytet i bardhë”. Në “Notitiae episcopatum ecclesiae Constatinopolitane” gjendet emërtimi “Polucairepolews” (nr. 623), i tejshkruar gabimisht me alfabetin latin në formën “Poliheretopolis” (transliterim më i saktë do të ishte “Poluherepoleos” (Monumenta montenegrina”, I, s. 41, Podgorica, 2001). Del edhe në formën “Pulcheriopolis”. Ishte qendër mitropolie qysh në shekullin e 4-t.

*Pult-i*: Vendi i punës i shkruarit. Tavolinë pune, në formë të pjerrët, pak a shumë me të njëjtin kënd si kavaleti i piktorit të sotëm, që i duhej scrib-it për të kopjuar dorëshkrimet e shenjta. “Quo vadis, Domine?!”: Pyetje proverbiale drejtuar shën Pjetrit prej nxënësve, në kohën kur

përhapte krishtërimin nën terror në Romë. “Ku shkon, Zoti im?!”. Më shpesh përdoret në formë të shkurtuar: “Quo vadis?!”, për të shprehur, në mënyrë retorike, një drejtim a rrugë të pashpresë. Sienkievic, një shkrimtar nobelist, një shekull më parë ka shkruar një roman me të njëjtin titull.

*Reform/ë-a:* Fryma e ndryshimit në organizimin e jetës kishtarë në periudhën e Rilindjes Europiane. Rilindja Europiane me shndërrimet e saj të përveçme në jetën e Kishës. Karakterizohet nga slogani “të kthehemi tek burimi”. Reforma tronditi autoritetin e Kishës, në emër të spastrimit të jetës së saj prej deformimeve të klerit. Simbol i Reformës konsiderohet përkthyesi i Biblës gjermanisht, Martin Luteri. Në emër të reformës u kërkua tejkalimi i rolit imperial dhe përjashtimor të latinishtes si gjuhë e vetme liturgjike. Nën ndikimin e ideve të Reformës, Selia e Shenjtë, pak kohë më vonë, ndërmori Kundërreformën, duke shprehur përmes saj pothuajse të njëjtat synime, veçse jo si iniciativa kundërshtarë, por si iniciativa të brendshme.

*Recto:* Term i arkivistikës, me burim latin: ana e pasme e fletës së dorëshkrimit; faqja e numërtuar *çift* e një dorëshkrimi.

*Rev.:* Shkurtesë për “reverendissimus”, lat., me kuptimin “shumë-shumë i nderuar”, shprehje idiomatike që përdoret rregullisht në komunikimin me shkrim të hierarkëve të lartë kishtarë të ritualit roman.

*Ringjallj/e-a:* Thelbi i besimit në Jezu Krishtin si Mesi. Në shqipen e vjetër: “Krishti u ngjall së vdekurish”. Ringjallja është ana tjetër e medaljes së flijimit, sakrificës së lartë. Në ligjërimin biblik Perëndia sakrifikoi birin, Jezuin, për të dëshmuar dashurinë për njeriun, dhe e ringjalli atë për të dëshmuar se ishte një Zot i barabartë në trini. Flijimi i Jezuit dhe ringjallja e tij vulosin Besëlidhjen e Re të njerëzimit besimtar me Perëndinë. Në besimin hindus ringjalljes i përgjigjet rimishërimi (“reincarnazione”).

*Rossanensis:* Emri ndërkombëtar i një kodiku të mirënjohur. U quajt kështu sipas emrit të qytetit Rossano, Itali, ku ruhet edhe sot. Është pronë e arkivit të dioqezës së këtij qyteti.

*Rusic/a-t:* Përdoret vetëm në shumës. Festë fetare që kremtohen ndërmjet Pashkës dhe Pesëdhjetores. Gjysma e Pesëdhjetores, sipas ritualit lindor. Festohet 25 ditë pas Pashke.

*Rushajat:* Shih “Pesëdhjetorja”. Noli përdor “ditën e rushajave” për “ditën e pesëdhjetores” në përkthimin e Longfellowit. Përdoret edhe në formën “rrëshajët”.

*Rruzar/e-ja:* Quhet lutja e posaçme që bëhet për të çmuar jetën, mundimet, kryqëzimin dhe ringjalljen e Krishtit, që shoqërohet me numërimin ritualistik të rruazave, nga e ka marrë emrin.

*Scriptio continua:* Idiomë e ndërkombëtarizuar prej latinishtes. Ka kuptimin “shkrim i vazhdueshëm”, pa ndarje të fjalëve nga njëra-tjetra (tekst në bllok). Dorëshkrimet në scriptio continua, sikurse është dhe Beratinus-1, kanë shumë vështirësi në tejshkrim. Para transliterimit e transkriptimit duhet të bëhet ndarja e fjalëve nga njëra-tjetra, duke u mbështetur në kuptimin kontekstual. Shkrime në scriptio continua ka pasur edhe në lashtësi. Janë të tilla disa mbishkrime (inscriptions) të etruskëve.

*Semit-ët:* Pasardhësit e Samit - Semit, një prej djemve të Noesë, për dallim nga hamitët,

pasardhës të djalit tjetër të Noesë, Ham-it. Nuk përmendet degë popujsh prej djalit të tretë të Noesë, Jafetit. Semitët kanë populluar një pjesë të Azisë së Mesme. Fiset nomade semite ishin të organizuara në fise (tribu) dhe nuk krijuan kurrë një shtet të bashkuar, por kryesisht mbretëri të vogla dhe jo të qëndrueshme. Një mbretëri e tillë semite u krijua me kryeqendër Damaskun, një tjetër me kryeqendër në Harran, një në Hazraël, një në Hamath, një në Zenxhirlin, në këmbë të Amanus-it. Prej këndeje dhe termat “semitizëm” dhe “antisemitizëm”.

*Sermon-e:* Arsyesim i shenjtë që i paraqitet publikut. Gjithashtu kompozim i shkurtër poetik.

*Septuaginta:* Nga lat. “septuaginta” - shtatëdhjetë. Emri i Dhjatës së Vjetër deuterokanonike /parakanonike/ kanonike-dytësore/ në greqishten antike. U quajt kështu sepse u përkthye me urgjencë nga 70 dijetarë, për 70 ditë, për të bërë të njohur Besëlidhjen e Vjetër, librin e shenjtë të hebrenjve, të cilët në shekullin e 3-të deri në atë të dytë para Krishtit kishin themeluar bashkësi të fuqishme (diasporë) në Greqi (Selanik, Filipopolis). Shkurt, shpesh shenjohe vetëm me shifra romake (“LXX”) dhe ka të njëjtin kuptim.

*Sibilë/-a:* Zakonisht në shumës. Parathënëse të fatit në mitologjinë e vonët greke. Fjalë e përbërë, e formuar prej dy rrënjësh: “sio”-“teo”-“dio”, të tria me kuptimin “Zot”; si dhe “bula”, “vula”, me kuptimin “vullnet”. Fj. për fj. “sibilë” do të thotë “shprehëse e vullnetit të Zotit”. Njihen si profetesa të lashtësisë. Janë 10 sibila dhe secila ka një emër e një shërbim, sikurse dhe muzat. Sibilat paralajmëruan ardhjen e Krishtit dhe çlirimin e botës prej mëkateve, prej aktit të flijimit të tij. Për këtë arsye, sibilat, megjithëse nuk kanë libër në përbërje të Biblës (“Dhjatës së Vjetër”), zënë vend të gjerë në shkrimet teologjike. P. Bogdani u kushton sibilave një prej shkallëve të ligjëratave të tij tek “Çeta e profetëve”. Sibilat tek Bogdani marrin emra arbërorë: Sibila Hasnjanja (e Hasit), Sibila Scodrensis (e Shkodrës), Sibila e Shkupit, e Kosovës etj.

*Sinaiticus:* Emri ndërkombëtar i një prej kodikëve më të vjetër në shkallë botërore. Sipas shumë studiuesve është më i vjetri. U quajt kështu sipas emrit të malit Sinai, vend në hapësirën burimore biblike (Izrael). Sinai është vendi i shenjtë ku, në ligjërimin biblik, “Jahve” (Zoti) shpalli Besëlidhjen e vet me popullin e zgjedhur, hebrenjtë, duke u dhënë tabelat e “Dhjetë Urdhërimeve”, i njohur më shumë me emrin “Dekalogu”.

*Sinaksar-i:* Një lloj shkrimi kishtar, që bën pjesë në shkrimet agjiografike, por dallohet për faktin se përmban jetë shenjtore dhe oshënarësh të përmbledhura shkurt. Një prej sinaksarëve që ruhen në AQSH, megjithëse pronë e Kishës ortodokse-lindore, përmban ilustrime kishtarë e laike që janë tipike të Kishës romane: figura me veshje karakteristike të klerikëve romanë, ushtarë me uniforma të stilit perëndimor. Këto ilustrime mund të jenë kopjuar prej ndonjë arketipi me burim Venecian apo Raguzën.

*Sinopensis:* Emri ndërkombëtar i një kodiku të mirënjohur. U quajt kështu sipas emrit të qytetit Synope, që ndodhet në bregun e Detit të Zi, në Turqi, ku është gjetur. Ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Parisit.

*Sinopsion:* Nga gr. “synopsion”. Kalendar fetar me lëndë të shërbesës për gjithë vitin. Tipologjikisht i njëjtë me dorëshkrimet “minej” (shih), por këta janë mujorë ose tremujorë. Kalendari sinopsion është gjithëvjetor.

*Sixhil-i:* Regest, regjistër, libër ku kopjoheshin (prej kadinjve, ose nëpunësisë së administratës vendore) aktet më të rëndësishme të Perandorisë Osmane (fermanë, berate, bujullurdi).

Pasi kopjoheshin, këto akte ktheheshin përsëri në oborin e Sulltanit, ndërsa zbatimi i efekteve të tyre ndiqej sipas përshkrimit në sixhil. Shpesh përdoret edhe forma “sixhilat”. Sixhili më i rëndësishëm që ruhet në Shqipëri është ai i sherijes së Beratit, që përmban mbi 210 vëllime, ku janë regjistruar jo vetëm aktet e qendrës së Perandorisë Osmane, prej vitit 1604 deri në vitin 1913, por edhe kronika e qytetit, ngjarjet më të rëndësishme rajonale, zhvillimet e jashtëzakonshme natyrore.

*Skizm/ë-a:* Ndarje. Përgjithësisht me termin “skizmë” nënkuptohet ndarja më e madhe që ka ndodhur në historinë e krishtërimin, e shënuar në vitin 1054, kur përfundimisht dy kryeqendrat e krishtërimin, Roma dhe Kostandinopoja, përcaktuan kufijtë e autoritetit të tyre. Skizmës së madhe të vitit 1054 i paraprinë konflikte dhe skizma të tjera më të vogla, si ajo e shekullit të 9-të, e mbiquajtur “skizma e Fotiuis-it”. Kufijtë e autoritetit të dy kishave në hapësirën shqiptare lëvizën për një kohë të gjatë. Njihen letrat e betimit të Balshajve, të cilët, pasi ishin bërë skizmatikë, domethënë pasi ishin ndarë nga kisha katolike, kërkojnë me ndjesë të thellë rikthimin nën fuqinë e Atit të Shenjtë, Papës, “duke i rënë mboh përgjithnjë skizmës”. Në ligjërimin popullor kjo fjalë ka edhe formën “shizmë”.

*Skrib-i:* Term i shkrimeve të shenjta, nga lat. “scribere”, shkruaj. Shkruesi, mjeshtri i të shkruarit të teksteve ungjillore. Skribë (shkruer) janë edhe ungjillorët e mëdhenj. Në studimet mbi kodikët shpesh në vend të këtij termi përdoren fjalët “kopjues” apo “riprodhues”, që ngjajnë kuptimisht të mospajtuara. Por skribi është njëherësh autor: “autor” (i grafisë, i përzgjedhjes së lëndës), “kopjues” (zakonisht shkruesi hedh në suport të ri tekste të vjetra, shpesh të pandryshueshme, si Bibla) dhe “riprodhues”. Sipas një klasifikimi të mirënjohur ndërkombëtar ekziston Shkolla e shkruesve aleksandrinë, Shkolla siro-palestineze, Shkolla koptike (e të krishterëve të Egjiptit), Shkolla e shkruesve të Armenisë dhe ajo e Perëndimit. Beratinus-1, sipas Aleks Budës, i përket një shkollë shkruesish ku ndërthuren “tipare të Lindjes dhe të Perëndimit”. Sipas Roderic L. Mullen-it, ka ekzistuar “një Shkollë vendëse” shkrimesh dhe shkruesish në hapësirën shqiptare. Skribët kishin zejen e tyre qysh në antikitet. Kopjuesit e famshëm të shkrimeve greke në stilin aleksandrin dhe për bibliotekën e Aleksandrisë ishin skribë. Në Dhjatën e Vjetër skribët përmenden si marifetçinj dhe hileqarë, mosdashës të Krishtit (“Bibla”, Ferizaj 1994, f. 1496).

*Skouripeki:* Emri i shpëtimtarit të 27 dorëshkrimeve më të vjetra të Mitropolisë së Beratit në vitin 1356, kur ushtria e car Uroshit kërkoi dorëzimin e tyre. “Bashkë me zonjën konteshë dhe murgun Theodulo” ai arriti t’i nxjerrë fshehurazi jashtë kishës këto dorëshkrime. Është shkruar se “Skouripekis” - Skuripeqi - mund të jetë forma e greqizuar e emrit patronimik arbëror “Skura”. Për këtë ngjarje gjendet një anëshkrim në Kodikun e 27-të, të Beratit.

*Skriptorium-i:* Nga lat. “scriptorium”. Qendra të kopjimit të kryeveprave të kohës antike, ngritur në mjeshtëri dhe të përhapura në arealin paleoballkanik, fillimisht nën kujdesin e Perandorisë Romake, e cila kujdesej për mbijetesën e kulturës së lashtë dhe pastaj nën kujdesin e kishës, e cila kujdesej për kopjimin e përpiktë të teksteve ungjillore. Shkronjëtoare, vende ku shkruesit kopjonin tekstet origjinale, duke pasur një arketip përpara, për nevoja të kultit dhe të kulturës (M. Korkuti, “Parailirët, ilirët, arbërit”, Tiranë 2003, f. 80-81). Mendimi se në hapësirën shqiptare ka pasur shkolla bukurshkrimi, që nënkuptojnë skriptoriumet, është mbrojtur edhe nga Th. Popa, K. Naço, R. L. Mullen dhe të tjerë. Në Beratin e periudhës mesjetare numëroheshin së paku gjashtë shkolla bukurshkrimi (Popa). „Në shekullin e 12-të, krahas statutit të qytetit të Durrësit, si rezultat i krijimit të vëllazërive - “confraternitas” - të tregtarëve, të piktorëve, të gurgëdhendësve ... dhe të kopjuesve të librave, që gjendeshin me shumicë rreth katedrales së qytetit ... lindën edhe statutet e veçanta për çdo vëllazëri“ (“Durrësi, itinerar historik, kulturor



dhe arkeologjik“, Tiranë 2003, f. 153).

*Stavrotek/ë-a*: Nga gr. “stavros”, kryq. Çdo mbijetojë që ruan diçka prej kryqit të kryqëzimit të Krishtit. Sipas një gojëdhëne, kisha e Labovës së Kryqit ka pasur diçka të tillë.

*Stih-u*: Varg, rresht, njësia më e vogël në shkrimet ungjillore etj. Përdoret ky term, në vend të “rreshti”, “fjalja”, meqë shkrimet ungjillore kanë lexim të kënduar, që vjen nga gjatësia e ndryshueshme e zanoreve, theksat melodikë etj. Stihu është njëkohësisht njësi e citueshme prej shkrimeve biblike (bashkë me kreun dhe paragrafin). Stihu ka numrin e vet, dhe identifikohet prej këtij numri, pavarësisht se në ç’faqe të dorëshkrimit ndodhet.

*Stratit-i*: Bujk i mobilizuar në një fushatë luftarake, në mbrojtje të themës, famullisë, krahinës; ose në shërbim të një çështjeje ushtarake të tjerëve, kundrejt shpërblimit. Për herë të parë stratitët shfaqen në shekullin e 8-të. Dukuria e stratitëve vazhdon gjatë gjithë Mesjetës. Stratitët shqiptarë janë të njohur si luftëtarë të suksesshëm në një shumicë vendesh europiane, prej rajonit ballkanik deri në Spanjë, Francë e Britani.

*Sufragan-i*: Ndhmës i një kleriku, zakonisht i ipeshkvit.

*Sh.*: Shkurtesë për idiomën “kodik i Shkodrës”.

*Shenj/ë-a*: Më shpesh vetëm shumës: “shenjat”. Zbukurime të shkrimeve të krishtera me vizatime të shenjave të zodiakut (ujori, demi, bricjapi etj.). Shenja ka edhe tek “Meshari” (Pogoni). Shenja e peshkut është përdorur për të shenjuar Krishtin në periudhën e krishtërimin të fshehtë.

*Shëlbuës-i*: Çlirimtari i premtuar prej profetëve. Term i eskatologjisë. Në ligjërimin biblik: Jezu Krishti u dha nga Ati për të na shëlbuar. Shpëtimtari. Epinom i Jezu Krishtit. Nga lat. “salvatore” - shpëtimtar, Messiah.

*Shën Gjëri*: Forma shqipe e emrit të Shën Jeronimit (Hieronymus), përkthyesi i parë i Biblës në latinisht, figurë referenciale e krishtërimin. Lindi në Stiridon, Dalmaci, jetoi në vitet 347-420 pas Krishtit dhe ishte me origjinë ilire.

*Shën Gjon Gojarti*: Forma shqipe e emrit të shenjtit Joan Chrysostomos, një prej reformatorëve më të mëdhenj të historisë së krishtërimin, kryepeshkop / kryepeshkv/ i Kostantinopojës, për një kohë i dëbuar nga kisha dhe “i internuem në Epir” (Valentini). Vdiq më 407. Mbiemri “Gojarti” është një kalkim i kompozitës greqisht “Chrysostomos”. Dita e emrit e këtij shenjtori, sipas kalendarit gregorian, është 13.shtatori. Por, sipas ritualit të kishës lindore, Beratinus-1 u paraqitej besimtarëve në një festë panegjirike më 27 janar, në përkujtim të emrit të Shën Gjon Gojartit. Një kishë apo dhe kishëz që ruan relikte të jashtëzakonëshme të shenjtësh si rregull i mbledh besimtarët në një ditë të caktuar vetëm për nderim të relikteve të shenjta (jo të emrit). Në kishën e Lindjes shën Gjon Gojarti vlerësohet ndër etërit që kanë fituar admirimin e shekujve, njësoj si shën Agustini për kishën e Perëndimit. Lindi në Antiokë, midis viteve 349-354, në një familje në gjendje të mirë. Mori mësim filozofie dhe retorike. Më pas i braktisi këto studime, për t’ju dhënë mësimin të krishterë, meditimit dhe jetës asketike. Fitoi vlerësimin e peshkopit të Antiokës, i cili e zgjedh më 372 midis njerëzve më të afërt, duke e shuguruar një vit më pas. Por Gojarti e braktis shpejt qytetin, duke iu kushtuar një jete të vetmuar dhe me privacione. Më 381 rikthehet në Antiokë dhe në fund të vitit 397 i dedikohet predikimit, ku merr titull të lartë midis oratorëve të shenjtë. Pas vdekjes së patriarkut të Kostandinopojës

Metario më 397, shën Gjon Gojarit u zgjodh në vendin e tij. Por, kur pushteti perandorak ra në duart e perandoreshës Eudossia, mbështetësit e tij humbën çdo ndikim, si pasojë e sinodit “della Quercia” (“i lisit”), i thirrur nga patriarku i Aleksandrisë Theofilo. Chrysostomos u hoq nga detyra. Më 403, në të njëjtin vit, ai u rithirr të merrte detyrën ipeshkvnore. Por ky qe vetëm një kurth. Më 404, natën e Pashkëve, gjatë ceremonisë së pagëzimit, turma hyri në kishë dhe e profanoi. Pesë ditë pas festës së pentikostisë, Chrysostomos dënohet me internim në Armeni (Valentini-Frashëri: në Epir). Duke parashikuar fundin e tij, Joani kërkoi një veshje të bardhë, bëri një mbledhje, u lut për persekutorët, dhe përsëriti për herë të fundit lutjen që qe moto për tërë jetën e tij: “Lavdia e Zotit në çdo gjë”. Vdiq më 14 shtator 407. Rrobat e tij u sollën në Kostandinopojë me një procesion solemn më 27 janar 438, dhe u vendosën në kishën e Apostujve. Perandori Teodosi II, djali i Eudossia-s, priu në krye të kortezhit, duke kërkuar falje për prindërit e tij, që e kishin persekutuar shenjtorin. Chrysostomos është krahasuar me Pagëzorin dhe profet Elian. Ai bëri të rishkëlqejnë në botë mësimet e Krishtit. Prandaj njihet si një nga kolonat mbi të cilat mbështetet kisha. Quhet figurativisht: “honi i urtësisë, kupa e artë nga ku derdhet doktrina e ëmbël dhe e mjaltë”. Imazhet më antike të portretit të tij gjenden në Santa Maria Antiqua, dhe mund të jenë të shekullit të 6-të ose të 7-të. Shpesh paraqitet ndërsa predikon, dhe në këtë rast ka në sfond apostullin Pal, që e frymëzon. Për herë të parë u konsakrua “festa e tre doktorëve” (Vasili i Madh, Gregori dhe Chrysostomos) në shekullin e 11-të, nga perandori Aleks II Komneni (1081-1118). Papa Klementi XI e mbante përkrah shtatoren e shën Gjon Gojartit. Çmohet si një prej reformatoreve më të mëdhenj të krishtërimit (G. Muka, “Ex-Beratinus”).

*Shën Gjon Pagëzori:* Shën Joan Baptisti, Shën Gjon Pagëzuesi, lajmësi i mbërritjes së Mesisë. “The baptism of John: There have been various suggestions as to the origins of Christian baptism-Jewish ceremonial washings, Qumran purification rites, proselyte baptism, the baptism of John. The last of these, the ritual act which gave John the Baptist his nickname, is the most likely candidate: as John is the forerunner of Jesus, so his baptism is the forerunner of Christian baptism. A direct link is established through Jesus’ own baptism by John; some of Jesus’ earliest disciples had almost certainly been baptized by John (Jn. 1:35-42); Jesus, or some of his disciples, seems to have continued John’s practice at the beginning of Jesus’ own ministry (Jn. 3:22f., 26; but 4:1f.); and in the cases of the disciples at Pentecost and of Apollos, it was evidently not thought necessary to supplement their Johannine baptism by baptism in the name of Jesus (Acts 2; 18:24-28). Most likely then it was this earlier practice which was resumed from Pentecost onwards, as ratified by the risen Christ and in his name (Mt. 28:19; Acts 2:38; etc.). John’s baptism itself is probably best understood as an adaptation of Jewish ritual washings, with some influence from Qumran in particular. John’s baptism was primarily a baptism of repentance (Mt. 3:11; Mk. 1:4; Lk. 3:3; Acts 13:24; 19:4). By accepting baptism at John’s hands the baptisands were expressing their repentance (Mt. 3:6; Mk. 1:5) and their desire for forgiveness. It was also a preparatory and symbolical act: it prepared the baptisand for the ministry of the Coming One; and it symbolized the judgment he would bring. In John’s vivid language that judgment would be like a pruning or a winnowing (Mt. 3:10, 12; Lk. 3:9, 17), or like a baptism in Spirit and fire (Mt. 3:11; Lk. 3:16). It is most unlikely that the Baptist was referring here to another ritual act much like his own. Rather he was probably drawing on the powerful imagery of such passages as Is. 4:4; 30:27f.; 43:2; Dn. 7:10 (possibly again under the influence of Qumran). If divine judgment could be likened to a stream of God’s fiery breath (Spirit-same word in Hebrew and Greek), then the Coming One’s ministry of judgment could appropriately be likened to an immersion in that stream. Those who submitted themselves to an act symbolizing that judgment, as an expression of their repentance in face of that judgment, would find it a judgment that purified and cleansed. Those who refused John’s baptism and refused to repent would experience the Coming

One's 'baptism' in all its fierceness and, like the barren trees and the chaff, would be burnt up by it (Mt. 3:10-12). Jesus' baptism by John That Jesus should have undergone a baptism of repentance caused early Christians some difficulty (cf. Mt. 3:14 f.; Jerome, contra Pelag. 3. 2). At the very least it must have been for Jesus an expression of his dedication to God's will and to ministry, perhaps too an expression of his wholehearted identification with his people before God. After his baptism the Spirit came upon Jesus (Mt. 3:16; Mk. 1:10; Lk. 3:21 f.). Many would see here the archetype of Christian baptism-baptism in water and Spirit".

*Shllezhd/ër-i*: Forma e sotme shqipe e idiomës me burim latin "Shën Aleksandër". Shllezhdri festohet në Shqipërinë e Veriut dhe ka një kishë në Orosh. Sipas gojëdhënës, kjo kishë mban emrin e Shën Llezhdrit, sepse ka pasur një relikte të Shën Aleksandrit, një legjionar romak që u martirizua për shkak të pranimit të krishtërit në Azi. Nuk ka dëshmi që Shën Aleksandri të ketë prekur fizikisht hapësirën shqiptare. Ippen mendon se një relikte të tillë mund ta ketë pasur vërtet kjo kishë, por e sjellë nga misionarë të mëvonshëm të këtij shenjtë e martiri. Ndërkaq, dihet se Selia e Shenjtë i ka dhuruar kësaj kishe në shekullin e 18-të "kafkën e Shën Klementit", që ruhej në një arkë të vjetër argjendi. Teodor Ippen, "Shqipëria e vjetër", Tiranë 2002, f. 74.

*Shmija*: Forma e sotshme shqipe e emrit të Shën Eufemisë, huazuar, me sa duket, prej kohës ilire. Në luginën e Fandit, pikërisht në Qafëmali, është një kishë që i kushtohet nderimit të Shën Eufemisë (kisha e Shmijës). Teodor Ippen, "Shqipëria e vjetër", Tiranë 2002, f. 76.

*Shën Niketa*: I njohur më gjerësisht si Shën Niketa i Remesianës ("Niceta of Remessiana" - A. E. Burn, Cambridge, 1905), Shën Niketa i Dardanisë (citet në këtë shkruar për veten e tij: "dardanus sum - jam dardan"), por edhe Shën Niketa i Akilesë ("sancti Nicetae - episcopi Aquileiensis" - "Monumenta montenegrina" II, f. 79). Autor i një prej himneve më të njohura të të gjithë historisë së krishtërit, "Te, Deum, Laudamus!" - Ty Zot të lavdërojmë ("16 shekuj", R. Sokoli). Renditet në grupimin e "scriptores ecclesiastici" - shkrimtarë kishtarë. Ndër popujt sllavë emri i Shën Niketës njihet si "sveti Nikita". Sipas disa burimeve, "Codex Vindobonensis", një prej dorëshkrimeve të mirënjohura të krishtërit të hershëm, përmban "një fragment prej veprave të Shën Niketës ("Edidit haec fragmenta vir cl. Michael Denisius ex codice Vindobonensi saeculi decime, in opere inscripto ..." - "Monumenta montenegrina" II, f. 93. Jetoj në shekullin e 3-të deri në shekullin e 4-t. Një prej ligjërimeve ("Logos") të Shën Niketës paraqitet me titullin "De diversis appellationibus D. N. Jesu Christo conventionibus", ndërsa një tjetër me titullin "De Spiritus Sancti potentia".

*Shën Paraskevi /Parashqevi-a*: Shnaprenda, Shënepremtja.

*Shën Sergji e Baku*: Shenjtorë të periudhës së fundit të krishtërit të hershëm dhe fillimit të krishtërit të shpallur fe zyrtare me ligj. Ishin me origjinë nga Rezafa, që gjendet në qendrën e hapësirës biblike (zona siro-palestineze). Shën Sergji e Baku kanë pasur një faltore të hershme në bregun e Bunës. Studime të posaçme për këtë faltore kanë bërë Sufflay dhe Ippen. Sipas mendimit të disa studiuesve, edhe emri "Rozafa" i kështjellës së Shkodrës duhet të ketë lidhje me "Rezafa-n" e Shën Sergjit dhe Bakut. Kulti i Shën Sergjit ka qenë i përhapur edhe në jug të Shqipërisë, dhe kjo del prej toponimeve të tilla, si Shirgji, Shirgjani etj. Shën Sergji e Baku admiroheshin edhe nga besimtarët sllavë.

*Shlli-a*: Toponim në Shqipërinë Qendrore. Vjen nga emërtimi "Sanctus Elias", i huazuar në shqipe prej periudhës ilirike. Në Shqipërinë Jugore i njëjti huazim del në formën "Shëndëlli-a".  
*Shugurim-i*: Formulë lutjeje e veçantë, që shprehet në ceremoninë e caktuar me të cilën një

objekt ose një person merr vulën e shenjtërit. Shugurohet buka dhe vera në meshim. Shugurohet kleriku kur dorëzohet meshtar, shugurohet peshkopi (ipeshkvi) para se të marrë detyrën e vet. Shugurohet altari kur është gati për meshim, shugurohen vajërat të Ejten e Madhe, para Pashkëve, e kështu bëhen të vlefshëm për dhënien e sakramenteve etj.

*Shumat-i:* Toponim në Shqipërinë Verilindore. Herë-herë del edhe në formën “Shumat”, “Shumbat”. Forma e sotme e huazimit të emërimit “Sanctus Mateus” prej kohës ilirike. I njëjti emërtim biblik del edhe në toponimin “Shtish” - Shën Tish, Shën Matish, Shën Mateu.

*Tabernakul-a:* Vend në altar ku ruhen sakramentet e kungimit.

*Talar-i:* Veshje pritërore në formën e një fastaneje të gjatë (rituali roman).

*Tallant-i:* Në krye të herës një masë prej 27 kilogramësh ari të pastër, që përdorej si matës për vlera dhe shpërblime të rëndësishme. Nga kjo edhe “talent”, dhunti e rrallë.

*Teoforik-e:* Emra ~. Fjalë e përbërë, me burim greqishten. Emra që burojnë prej emrave hyjnorë, kryesisht prej personazheve biblike dhe ungjillore; emra të formuar prej tyre me prapshitesa karakteristike (“Apollonidet”, nga “Apollon”; Teodosius” nga Theo dhe “dosis” etj.).

*Tetragram-i:* Nga gr. “tetra” - katër dhe “gramma” - shenja. Shqip do të thuhet “katërshenjshi”. Forma në shkrimin aramen e emrit të Perëndisë. U quajt kështu sepse në shkrimin aramen emri i Perëndisë ka katër shenja. Duke qenë se shkrimi aramaik ishte silabik (rrokjesor), këto shenja janë bashkëtingëllore, ndërmjet të cilave nënkuptohet prania e një zanoreje, vlera e së cilës varet nga konteksti fonologjik. Tetragrami u përdor për një kohë të gjatë në përkthimet greqisht të shkrimeve biblike sepse emri i Perëndisë konsiderohej tabu dhe i papërkthyeshem. Tetragrami u përdor për një kohë të gjatë edhe për faktin se në emrin e të shenjuarit mbivendoseshin të paktën 100 kuptime, ndërsa mundësitë e shqiptimit (kombinimit të zanoreve imagjinare me bashkëtingëlloret e shkruara) edhe më të mëdha. Dihet se tetragrami përmban grafemat “JHVH”, të cilave shumë studiues të Biblës u japin kuptimin “Jehova”, që do të thotë “Perëndi”.

*Textual criticism:* Studime tekstologjike kritike. Shkollë studimesh kritike laike që merret me shkencorizimin e letërsisë ungjillore, nëpërmjet krahasimit të ungjiljeve kanonikë me dorëshkrimet e para-njësuara. Veç kësaj, tekstologjia kritike bën analogimin dhe krahasimin e dorëshkrimeve më të vjetra për të vërejtur evolucionin e mendimit të krishterë. Studimet e tekstologjisë kritike synojnë “arritjen tek burimi”. Në këto studime merr rëndësi, si objekt, kalimi prej fjalës së shenjtë tek shkrimi i shenjtë, prej predikimit verbal tek ai kanonik.

*Tipiko-ja:* Nga greqishtja “typikon”, statut, rregullore themelore e një bashkësie kishtare.

*Torah:* Libri i shenjtë i hebregjeve. Përmban pjesë të Dhjatës së Vjetër jokanonike ose deuterokanonike (kanonike dytësore).

*Trini-a:* Term biblik i huajtur në gjuhën shqipe qysh prej periudhës së krishtërit të hershëm, siç provohet prej formës “Shëndërtat” - Shën Triadha, Shën Trinia, Trinia e shenjtë. Përdoret edhe në formën “triniteti”. Nacion themelor në krishtërim. Thelbi i këtij nocioni, sipas ligjërimit biblik, është që në Tenzonë (në Zotin) janë tri veta hyjnore: uniteti dhe trinia e Zotit: “tre në një”: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë. I krahasueshem me këtë nocion është ai i Trimurtit në teologjinë

hinduse, ku Brahma (krijuesi), Shiva (ruajtësi) dhe Vishnja (shkatërruesi) janë një, por jo të pandarë dhe jo vazhdim i njëri-tjetrit.

*Triodh-i*: Nga gr. “triadhion”, fj. për fj. “tri këngë”: libër liturgjie, që përmban shërbesat kanonike kishtarë për tri javët para kreshmës, deri të Shtunën e Madhe (Popa). Por quhet “triadh” edhe pjesa e një kalendarit shërbesash gjithëvjetore (synopsion), i njëjtë me kalendarët e përnuajshëm (minej). Përmban poezitë e të dielave të shërbesës dhe lutje kulturi.

*Them/ë-a*: Njësi organizimi kishtar në Perandorinë e Bizantit, që i përgjigjet nocionit të një qarku apo province, siç kuptohet ky term në Perandorinë e Romës në periudhën e paleokrishtërit. Thema zëvendësoi termin latin “dioqezë” dhe shkriu në të njëjtën fjalë edhe kuptimin e termit “provincë”, duke bashkuar një njësi të organizimit shtetëror me një njësi të organizimit kishtar. Themati u ngritën në të njëjtën periudhë me zhvillimin e ekzakratit (prej shekullit të 6-të e në vijim. Në disa burime termi “thema” do të thotë njësi ushtarake që mbron provincën.

*Theotoke-ja*: Nga greqishtja. Një nga epinomet e mirënjohura të Shën Mërisë. Kuptimi i kalkuar: “Hyllindësja” (Noli), lindësja e Jezu Krishtit. Ka dhe një lutje me të njëjtin emër.

*Theopolis-i*: Nga greqishtja, me kuptimin “qyteti i Zotit”, qyteti i shenjtë”. Sipas Biblës, ka disa qytete apo vende të shenjta ose “të Perëndisë”. Për Moisiun vendi i shenjtë ishte mali i Sionit. Për Davidin vendi i shenjtë ishte Hebri. Kuptimi terminologjik: emër figurativ dhe eufemik i vendbanimit hebraik Antiochea. U quajt kështu për herë të parë nga Shën Simoni.

*Ungjill-i*: Nga gr. “euangelion”. Fj. për fj. ka kuptimin “lajm i mirë”, “lajm i gëzueshëm”. Në shqip duket të ketë hyrë përmes latinishtes. Ungjilli është thelbi i Dhjatës së Re, libri më i rëndësishëm i Kishës së krishterë. Janë katër ungjij, por në përdorimin kishtar parapëlqehet të thuhet se Ungjilli është një i vetëm, i shprehur në katër variante (“ungjill i katërfishtë”, dom Simon Filipaj). Ungjilli përmban jetën, veprat dhe kumtin e Jezu Krishtit. Sipas Palit, ungjilli i është dhënë (“i është vënë në dispozicion”) çdo besimtar. Për këtë arsye, besimtarët e parë të krishtërit refuzonin me vendosmëri gati mbinjerëzore, duke pranuar edhe martirizimin, por jo të tradhtonin mësuesin dhe shpëtimtarin e tyre, Jezuin që solli Ungjillin. Nga ky besim (që ungjilli i është dhënë çdo besimtar), hebreu Saul, robaqepës, nga persekutor i egër i rishtarëve të krishtërit, u kthye në një besimtar dhe përhapës i denjë i këtij besimi, duke ndikuar në ungjillizimin e popujve. “Saul” është forma aramene e emrit të Shën Palit (Paul), një prej apostujve më të lavdëruar të krishtërit.

*Ungjillizim-i*: Bashkimi në Krishtin, pranimi i krishtërit. Predikimi i Krishtit dhe predikimi i ungjillit janë idioma me të njëjtin kuptim.

*Ungjilli sipas Mateut*: I pari ungjill në renditjen kanonike të librave të Dhjatës së Re, megjithëse nuk është kronologjikisht më i hershmi. Teksti origjinal është shkruar aramaisht (gjuha e palestinezëve të vjetër), por ky nuk është ruajtur. U shkruajt në këtë gjuhë për hebrejtë e ungjillizuar si të krishterë. Supozohet se teksti në gjuhën greke, që ka shërbyer si bazë për njësimin ndërkishtar të tekstit të këtij ungjilli, është shkruar nga vetë ungjilltari Mateu ose nga një nxënës i tij, nën mbikëqyrjen e mësuesit. Është shkruar jo më vonë se viti 70 i shekullit të parë të erës së re. Sipas Farlatit, “i pari prej apostujve që ka predikuar krishtërimin në Dardani ishte Mateu”, të cilit i takoi të prekte këtë hapësirë në vend të Juda Iskariotit, që ishte caktuar.

*Ungjilli sipas Markut*: Ungjilli i dytë në renditjen kanonike të librave të Dhjatës së Re. Është

shkruar në të njëjtën kohë me Ungjillin sipas Mateut, para vitit 70. Emri i Markut, në fakt, është një epinom, sepse në “Punët e apostujve” (12: 25) thuhet “Gjoni që quhet Mark”.

*Ungjilli sipas Lukës:* Është ungjilli më i hershëm në pikëpamjen kronologjike. U shkrua midis viteve 60-62 (sipas një pjese të studiuesve të Biblës), por, gjithsesi, edhe për pjesën tjetër, ka filluar të shkruhet më së voni prej vitit 65-70. Miku i ngushtë në veprimtari i Shën Palit. Renditet i treti në ndërtimin kanonik të Dhjatës së Re. Mund të thuhet se është dhe autori i Veprave të Apostujve.

*Ungjilli sipas Gjonit:* Është ungjilli i shkruar më vonë në pikëpamjen kronologjike, relativisht në vitet 95-100. U shkrua në greqisht për të krishterët e Azisë së Vogël. Duke qenë i fundmi, ka një rëndësi për sigurimin e koherencës formale dhe përmbajtësore të gjithë teksteve ungjillore. Studimet e sotme bibliologjike i kushtojnë shumë vëmendje Ungjillit sipas Gjonit.

*Uncial-i:* Shkronjë dore karakteristike për një numër tejet të kufizuar dorëshkrimesh të periudhës së krishtërit të hershëm, prej shekullit të 4-t deri në shekullin e 8-të, rrallë herë më vonë. Është përdorur edhe tek “Beratinus”, përveç “Rossanensis” dhe dy-tre të tjerëve. Uncial-i, megjithëse grafemë e shkrimit të dorës, është germë e tipit kapital, e formatit të madh, e mbushur, si rregull kuadrat, me përjashtim të germave “e” (Ē) dhe “C”, të cilat janë dukshëm të hënëzuara (lunatike), sido që edhe të tjerat kanë pak harkim. Uncial-i, sipas paleografëve, u përdor në periudhën e shkrimeve scriptio continua. Zakonisht shkronja e tipit uncial gjendet e përdorur në pergamenë të purpurt, në shkrime ungjillore. Uncial-i merr rëndësi për faktin se lehtëson periodizimin e shkrimeve dhe ndihmon në përcaktimin e kufijve kohorë të dorëshkrimeve. Nuk duhet ngatërruar me termin maiuscule, i cili ka një kuptim më të gjerë. Nuk duhet ngatërruar, gjithashtu, me inicial-et, që është germa fillestare e fjalisë hyrëse në tekstet ungjillore, zakonisht e shkruar në formën kapitale, e zbukuruar. “From the Ninth Century we have Byzantine majuscule (uncial) manuscripts of sufficient number that we can place them more or less into families” (Roderic L. Mullen); “With the fixing of the typikon, the order of festivals and readings for the Christian year, there was a corresponding need felt at the very end of the era of uncial manuscripts for easily usable service books” (Roderic L. Mullen). Uncial-i është përdorur në “Beratinus-1” dhe fragmentarisht në Kodikun e 3-të, të Beratit. Batiffol-i ka përshkruar uncial-in e shkrimit të “Beratinus-1”. Në tekstin e Batiffol-it kjo fjalë germëzohet në formën “oncial”, ndoshta nën ndikimin e formës së shqiptuar. Shenja të “oncial-it” Batiffol-i ka gjetur edhe te “Beratinus-2” e te “Codex Theodhræ”. Për ilustrim të këtyre gjurmëve të shkrimit të vjetër ai veçon e krahason germën “b” të greqishtes.

*Unit-e:* Kisha ~. Kishë që njeh si autoritetin më të lartë hierarkik-administrativ Selinë e Shenjtë dhe ushtron në liturgji ritualin bizantin. Kisha e arbëreshëve të Italisë. Në shekullin e 16-të ka pasur përpjekje për njohjen si Kishë unite nga popullsia e Bregdetit. Këto kërkesa nuk gjetën pohim nga Vatikani. Përpjekje për një Kishë unite në Shqipëri janë bërë edhe në shekullin e 20-të. Idesë së unitarizmit i ka besuar edhe Fan S. Noli.

*Uratë:* Sinonim për “prift”. Lidhet në një çerdhe semantike me “urim” dhe ka kuptimin e njeriut të bekuar, njeriut të veshur me rrobën e bekimit të njerëzve.

*Verso:* Tregues i referencës së një dokumenti arkivor; ana e përparme, ballore e fletës së një dorëshkrimi, faqja e numërtuar *tek*.

*Verri Zezis:* Është transliteruar dhe në formën “Vrizezis”. Toponim që përmendet në

anëshkrimet e një kodiku të Beratit. Ka dy interpretime: Vërzhezhë / Bërzhezhë (Skrapar), vend përkundrejt fshatit Munushtir, ku, sipas regjistrave osmanë, më mesin e shekullit të 15-të ekzistonte manastiri i Shën Mitrit (“monaster ajos Dimitri”). Një interpretim i dytë e lidh këtë toponim me një fshat ndërmjet Beratit, Fierit dhe Lushnjës. Në këtë rast kjo do të ishte forma greqishte e toponimit “Vërria e Zezë”, toponim që është ruajtur deri më sot.

*Vetus Latina-ae*: Shkrimet e krishtera (fragmentare) prej fillimeve deri në përkthimin e plotë të Biblës në latinisht, nga shën Gjëri (Hieronymus): La Vulgata.

*Vija e Teodosit*: Kufiri ndarës i dy perandorive romake, të Perëndimit dhe të Lindjes, nën sundimin e dy djemve të perandorit Teodos, pas vdekjes së këtij të fundit, në vitin 395. “Vija e Teodosit”, duke i ndarë provincat ilirike në vartësi të ndryshme, me zhvendosjet e herëpashershme të saj, sikurse kanë vënë re studiuesit (A. Plasari), ka lënë gjurmë në formimin etnopsikik të shqiptarëve (Shih edhe: Edwin Jacques, “Shqiptarët”, 1995, f. 165 e botimit shqip).

*Vikar-i*: Zëvendësi i ipeshkvit ose zëvendësi i kreut të një manastiri. Vikar quhet edhe zëvendësi i ipeshkvit të vjetër deri në emërimin e ipeshkvit të ri.

*Vindobonensis*: Emri ndërkombëtar i një kodiku të mirënjohur. U quajt kështu sipas emrit të vjetër të qytetit të Vjenës, Windobonæ.

*Vinjet/ë-a*: Një nga format më të përhapura të artit të zbatuar kishtar në dorëshkrime. Vinjetat zakonisht paraprijnë ndarjet e brendshme të veprës në dorëshkrim: ungjijtë, krerët (“kefalaia”). Vinjeta më e shpeshtë është ajo në formën e germës greke  $\rho$ , me formatin e një flete dorëshkrimi. Kjo shkronjë përqarkon faqen në të tri anët dhe shoqërohet me zbukurime të tjera, më të vogla, si rregull edhe me tekst.

*Viti bizantin*: Viti i krijimit të botës, kronologjisë së Kishës bizantine. Kalendari bizantin e fillon numërimin 5508 vjet para Krishtit. Vitet e erës së re shtohen progresivisht. Ky konsiderohet viti i krijimit të botës nga Perëndia, prandaj në terminologjinë e Kishës romane quhet edhe “anno mundi”, shkurt a. m. Sipas këtij kalendari, viti 2000 pas Krishtit është viti 7508. Quhet “viti i Zotit” për dallim nga “viti i Krishtit”, kalendari i erës së re, kalendari i kohës së Krishtit.

*Vizitator-i*: Zakonisht “vizitator apostolik”. I dërguar i posaçëm i administratës së lartë kishtare, si rregull i shkallës së ipeshkvit ose ndihmësit të tij, por jo një rang më i ulët, që inspekton veprimtarinë e famullive, kontrollon veprimtarinë e tyre, ndan krezmimin dhe raporton me shkrim për autoritetet e larta. Vizitatorët i relatojnë periodikisht Selisë së Shenjtë.

*Vl.*: Shkurtesë për idiomën “kodik i Vlorës”.

*Vs.*: Shkurtesë për idiomën “kodik i Voskopojës”.

*Vulgata*: Emër i dytë i Biblës: “La Vulgata”. Titulli i Biblës në përkthimin latin të Shën Jeronimit. U quajt “Vulgata”, herë-herë edhe “Vulgata e re”, për dallim nga “Vetus latina” - shkrimet më të hershme ungjillore në këtë gjuhë, përkthimet para Jeronimit. U njoh me këtë emër që nga shekulli i 5-të, për të treguar shkrime të shenjta të kuptueshme për popullin. “Vulgata” u bë tekst autoritativ dhe i papërkthyeshem në gjuhët e kombeve të Perëndimit deri në epokën e Rilindjes Europiane dhe të Reformës. Përkthimi i parë në gjuhët kombëtare të popujve europianë u bë në këtë epokë, prej Martin Luterit. Në shqip përkthimi i shkrimeve të shenjta fillon me

“formulën e pagëzimit” (1462), që gjendet në një kodik prej afro 30 fletësh të Pal Engjëllit, kryeipeshkv i Durrësit.

*Zbritësore-t:* Përdoret rregullisht vetëm në shumës. Zbritësoret janë këngë që bëjnë pjesë në liturgjinë e festave të mëdha. Njihen si të tilla “zbritësoret e Krishtlindjes”, “zbritësoret e Pashkës” etj. Këngë që ndjekin kalendarin e festës për disa ditë me radhë.

*Zbules/ë-a:* Pjesë e Dhjatës së Re. E shkroi Gjoni, në vitin 95 pas Krishtit. Gjoni ishte ungjillori i fundmë sipas rendit kohor. Jo të gjitha kishat e pranojnë Zbulesën si pjesë kanonike të Dhjatës së Re. Zbulesa përmban kumtin hyjnor që iu njoftua Gjonit për ardhjen e dytë të Krishtit dhe gjyqin e fundmë të Perëndisë. Zbulesa, për këtë arsye, bashkon një përfytyrim madhështor për të ardhmen dhe njëherësh edhe një paralajmërim të tmerrshëm për gjyqin e fundmë.

SHABAN SINANI



## *Përmbajtja*

<b>5...</b> Alfred Moisiu President i Republikës së Shqipërisë	Kodikët e Shqipërisë, përmendore të kulturës njerëzore
<b>7...</b> Koïchiro Matsuura Directeur Général de l'UNESCO	Pierre fondatrice à l'édifice de la patrimoine
<b>9 ...</b> Koïchiro Matsuura Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s	Gur themeltar në ndërtesën e trashëgimisë
<b>11 ...</b> Fjala e botuesit	Kult e kulturë
<b>13 ...</b> Kaliopi Naska, Shaban Sinani	Bëhen të njohur 100 kodikë të Shqipërisë
<b>17 ...</b> Kaliopi Naska, Shaban Sinani	100 Codex de l'Albanie à découvrir
<b>23 ...</b> Antimus Alexoudes	Libra të shenjtë në dorëshkrime në membranë
<b>25 ...</b> Pierre Batiffol	Dorëshkrimi greqisht [en grec] nga Berati i Shqipërisë Codex Purpureus <b>F</b>
<b>47 ...</b> Llambrini Mitrushi	Kodiku i manastirit të shën Kozmait
<b>53 ...</b> Johannes Koder, Erich Trapp	Katalog i dorëshkrimeve në greqisht në Arkivin e Shtetit në Tiranë
<b>81 ...</b> Aleks Buda	Thesare kulturore që i kthehen popullit
<b>85 ...</b> Johannes Koder	Rreth rizbulimit të dy kodikëve të Beratit
<b>87 ...</b> Theofan Popa	Katalog i kodikëve kishtarë mesjetarë të Shqipërisë
<b>199 ...</b> Theofan Popa	Dorëshkrimet kishtarë mesjetarë të Shqipërisë
<b>207 ...</b> Kosta Naço	Rreth “vendlindjes” së kodikëve mesjetarë të Shqipërisë
<b>211 ...</b> Edoardo Crisci, Shaban Sinani	Ungjilli sipas Mateut dhe sipas Markut, Greqisht, (“Codex Purpureus Beratinus <b>F</b> ”)
<b>215 ...</b> Roderic L. Mullen	Dorëshkrimet biblike që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit në Shqipëri (Tiranë), të kataloguar në Fondin 488
<b>233 ...</b> Shaban Sinani	Beratinus-1 - një referencë themelore në traditën e shkrimeve të shenjta
<b>253 ...</b> Nevila Nika	Rreth një studimi monografik të papërfunduar për kodikët e Shqipërisë (Katalogu dhe përshkrimet e Kosta Naços)
<b>265 ...</b>	Fjalorth shpjegues

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Kodikët e Shqipërisë / . - Tiranë :  
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2003  
306 f. ; 28 cm.  
ISBN: 99927-915-0-0

091.14(496.5)  
930.253(496.5:091.14

Shtypur në shtypshkronjën “NËNË TEREZA”  
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr. 17  
Tel: 00355 4 270 592/ 270 593  
Fax: 00355 4 270 594